

UNIVERSITETI I SHKODRËS
“Luigj Gurakuqi”

BULETIN SHKENCOR

Seria e shkencave shoqërore

Viti XLVIII i botimit

Nr. 68

Shkodër, 2018

REDAKSIA

Kryeredaktor - Prof. dr. Artan HAXHI
Sekretar shkencor - Prof. as.dr. Nevila DIBRA
Anëtarë - Prof. dr. Mimoza PRIKU,
prof. dr. Tomor OSMANI, prof. dr. Alfred ÇAPALIKU,
prof.as.dr.Alma HAFIZI

DREJTOR I REVISTËS
Prof. dr. Adem BEKTESHI

Korrektori dhe punoi në kompjuter: Arta Bajrami

Pronë letrare e Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”

Adresa e redaksisë: Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”
Redaksia e Buletinit Shkencor
Seria e Shkencave Shoqërore
Tel/fax: ++399 22 43747

PASQYRA E LËNDËS

- **Gjuhësi**

Xhevat LLOSHI

Sinonimet në “*Fjalorin e orientalizmave*” të T. Dizdarit
Synonyms in the “Dictionary of orientalisms’ by T. Dizdari.....9

Artan HAXHI, Tefë TOPALLI

Terminologjia si sistem (*Fjalor i termave të gjuhësisë*)
Terminology as a system (Glossary of Linguistics Terms).....17

Evalda PACI

Për një studim të thelluar dhe përmbajtësor të elementeve
institucionale të gjuhës latine
A Profound Study of the Institutional Elements of the Latin Language.....27

Erzen KOPERAJ

A ndeshim gjurmë të paskajores të pjesoret në lidhje me foljet modale
do, duhet, mund (duhet shkuom, do marrë)?
Traces of the infinitive forms in the modal verbs will, should,
can + participles (should i go, will take) in Albanian.....39

Merita HYSA

Reflektse të skemave prozodike në proceset fjalëformuese
Reflexes of prosodic schemes in word formation processes.....47

Anisa KOSTERI

Fjalësi krahinor i Veriut në Fjalorthin e Nikollë Gazullit
The Northern Provincial Dictionary in the Glossary of Nikollë Gazulli.....61

Arjola HOTI, Afërdita ANAMALI

Vëzhgime mbi disa dukuri gjuhësore në veprat e Ëngjëll Radojës dhe Pashko Babit

Survey about the linguistic structures in Ëngjëll Radoja and Pashko Babi Works.....77

Bora LOGU

Elemente të stilit gjuhësor të Imzot Vinçens Prennushit, në revistën “Zâni i Shna Ndout”

Stylistic Elements of Monsignor Vincent Prennushi's Lexicon, in the Magazine "Zâni i Shna Ndout" (St. Antony's Voice)87

Dorentina SHPANI

Mënyra lidhore në Dictionarium latino-epiroticum të Frang Bardhit
The Potential Indicative Mood in the Frang Bardh's

Latino-Epiroticum Dictionarium.....95

Aimir OSMANI

Rreth kontributit të veprës së Filip Ndocajt në rrafshin leksikor

About the contribution of the work of Filip Ndocaj to the lexical plain.....101

• **Letërsi**

Alfred ÇAPALIKU

Bota femërore e Kokalarit tek “*Siç më thotë nënua plakë*”
“... *provë shkrimi femëror shqiptar?*”

Women's World in Kokalari's Work.....119

Alma HAFIZI

Dimensioni historik dhe kulturor i nocionit të bibliotekës. Biblioteka e Finzi - Kontinëve

The Historical and Cultural Dimensions of the Notion of Count Finzi's Librar129

Dhurata HOXHA, Drita BRAHIMI

Reflektim mbi figurën e Skënderbeut në shkrimet në gjuhën frënge
Reflection on Scanderbeg's image in French language writings.....141

Fatos DIBRA

E kujt është urtësia e proverbave tek fjalori i Frang Bardhit?
(ose: Një lexim i proverbave të fjalorit të Bardhit)
*Whose is the wisdom of the proverbs in the Frang Bardhi's
dictionary?*.....151

Mimoza PUTO

Pasqyrimi i veprës dhe figurës së shkrimtarit të njohur shqiptar, Ismail
Kadare, në gazetën spanjolle “El País”
Ismail Kadare's Portrayal in the Spanish Newspaper "El País".....179

Eliana LAÇEJ, Lindita KAZAZI

Figura femërore në veprën e Basanit
The female figure in Bassani's production.....185

Alva DANI, Aterda LIKA

Të pathënat e Basanit te “Finzi Kontini”
The silence of Bassani's confessions in "Finzi Contini".....193

Dalila KARAKAÇI

Pasqyrimi i personalitetit të shqiptarit nëpërmjet syrit të autorëve
anglo-saksonë të gjysmës së dytë të shek. XIX: Tozer, Najt, Braun
*Representing the Self through the Eyes of the Others.
The Albanians in the British Travel Writing of the Second Part of
the 19th Century: Tozer, Knight, and Brown*.....201

Irimi PIRANI

Analizë e vlerave në veprën “Vuajtjet e djaloshit Verter”

An analysis of the values in the novel “The Sorrows of

the Young Werther”215

• **Histori**

Kurt GOSTENTSCHNIGG, Karl KASER

Austria’s contribution to Albania’s consolidation (1918 – 1938)

from a postcolonial perspective. A submitted ASF research project

(Monografi)

Kontributi i Austrisë në konsolidimin e Shqipërisë (1918 - 1938)

nga perspektiva postkoloniale. Një projekt hulumtimi i dërguar ASF.....229

Rokin DABERDAKU

Marrëdhëniet e Skënderbeut me Vatikanin (1444 – 1467)

Skanderbeg’s relationships with the Vatican.....253

Ilda ERKOÇI

Shqiptarët në sytë e udhëtarëve britanikë të shekullit XIX

Albanians in the image of 19th century British travellers.....263

Ingrit TIRANA

Ndikimi i revolucionit dixhital në gjuhën e të rinjve

Impact of digital revolution in the language of young people271

• **Gjeografi**

Bresena KOPLIKU, Nevila DIBRA

Potencialet e agroturizmit për një zhvillim të qëndrueshëm rajonal

Agrotourism as a potential for Sustainable Regional Development.....283

Sokol AXHEMI

Politikat mbi popullsinë në Shqipëri. Situata aktuale dhe tendencat
Population Policies in Albania. The Current Situation and Trends.....293

KRITIKË E BIBLIOGRAFI

Alfred Çapaliku –Eleni Karamitri: “*Shqiptarë në liri. Diaspora shqiptare në Amerikë*” (recension)
Albanian people in Freedom. Albanian Diaspora in America (Review).....305

Artan HAXHI, Mimoza PRIKU & Alfred ÇAPALIKU – Bibliografi kronologjike e publikimeve të prof. dr. Kolë Ashtës (1936 - 2017)
Chronological bibliography of prof.dr. Kolë Ashta's publications..307

NEKROLOGJI

Mahir Hoti
(1948 – 2018)
.....317

Hasan Lekaj
(1940-2018).....319

Kolec Topalli
(1938 – 2018).....321

JETA SHKENCORE

I. Veprimtari shkencore	
<i>Scientific activity</i>	323
II. Promovim libri	
<i>Promotional books</i>	328
III. Mbrojtje doktorature	
<i>Dissertation</i>	334

Xhevat LLOSHI

SINONIMET NË “*FJALORIN E ORIENTALIZMAVE*” TË T. DIZDARIT

Ndonëse janë botuar dy fjalorë sinonimesh, kjo fushë e shqipes ka ende shumë punë për të bërë. Arsyeya është se këta fjalorë janë hartuar nga autorët sipas përfytyrimeve të tyre për sinoniminë, mjaft larg nga trajtimet e shkencës gjuhësore. Në “Parathënien” e fjalorit të parë (2002),¹ të shkruar nga A. Dhrimoja, flitet për “karakterin në radhë të parë kujtues të fjalëve nga fjalori”, dhe duke ndjekur këtë hulli janë grumbulluar në një vend mirëfilli të gjitha gjërat që u janë kujtuar hartuesve, pa u shqetësuar nëse ka vërtet marrëdhënie sinonimike ose jo ndërmjet fjalëve e togfjalëshave që pësjtjellohen së bashku. Mjafton të shihen nja dy raste² dhe nuk ka nevojë për hulumtime të tjera. Në “Hyrjen” e fjalorit të dytë (2004),³ qysh te shembujt e parë janë ngatërruar variantet e fjalëve me sinonimet, ndërsa brenda në libër janë quajtur sinonime deri fjalët që shënojnë gjininë me fjalët që shënojnë llojet, kurse nuk është marrë parasysh as lënda e *Fjalorit të gjuhës shqipe* të vitit 1954. Për pasojë, nuk kemi një kornizë shkencore, brenda së cilës të mund të trajtoheshin edhe tema më të veçanta të kësaj fushe. Në këto rrethana, e quaj të dobishme që të paraqes sinoniminë te vepra e Tahir Dizdarit *Fjalori i orientalizmave në gjuhën shqipe* (2005),⁴ sepse lënda e tij mundëson që të vijohet hulumtimi i kësaj fushe të rëndësishme për gjuhën shqipe.

Pas një pune shumëvjeçare dhe me pasion, T. Dizdari është përpjekur të japë një tablo sa më të plotë të gjendjes së turqizimave në gjuhën shqipe deri në fund të Luftës I Botërore. Ndërkaq, nuk është vënë në dukje një anë tjetër e rëndësishme e punës së tij të frytshme. Duke ndjekur traditën e përpunuar gjatë Rilindjes, ai e ka mbajtur parasysh nevojën, që të punohet edhe për të mënjanuar në gjuhën e shkruar huazimet turke, të cilat kishte rrezik ta përmytnin, në qoftë se nuk do të bëheshin përpjekje për të gjetur fjalë të tjera më të përshtatshme për shqipen letrare dhe standarde. Me këtë synim, ai ka gjurmuar fjalë të tjera, që mund të ishin barasvlerëse të turqizimave ose që ishin paraqitur si të tilla nga dashamirësit e shqipes së lëvruar. Njëkohësisht autori është kujdesur, kur ka pasur mundësi ta

përcaktojë, që të shënojë edhe krahinën ku ndeshet një fjalë, si dhe të shtojë vërejtjet në lidhje me përdorimin e saj, domethënë nëse është e përdorimit të gjallë, apo tashmë ka dalë e vjetruar. Me një vështrim të tillë mund të them, se krahas mbledhjes e trajtimit të huazimeve, T. Dizdari ka sjellë edhe një pasuri tjetër brenda fjalorit të vet, domethënë për atë pjesë të leksikut që ka paraqitur, ky është njëkohësisht fjalor sinonimesh.

Do të mjaftonin disa shembuj nga fjalët më të përdorura edhe në gjuhën e sotme. Për *damar* Dizdari ka: *dell, flevë, prials, puls, tejzë, veshtak*. Të dy fjalorët e tjerë nuk i kanë, me përjashtim të ‘dell’. Fjalën ‘faiz’ autorët e vitit 2002 nuk e kanë, domethënë nuk e kanë parë jo vetëm *Fjalorin e gjuhës shqipe* të vitit 1954, por as *Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe* të vitit 1980, kurse Fjalori i vitit 2004 e jep vetëm me referimin të ‘interes’. Dizdari paraqet: *devër, fajde, gjedheshtër, kamatë, lukur, uzurë*. Fjalën *çipllak* nuk e kanë fjalorët aq të vëllimshëm të sinonimeve, madje as Fjalori i vitit 1980. Këtë turqizëm e ka vënë në dukje E. Çabej në studimet etimologjike, sepse edhe G. Meyer-i e kishte përfshirë në fjalorin e vet të vitit 1891. T. Dizdari ka dhënë këto sinonime: *berbecul, blec, caruk, cullak, curak, çupallë, dac, dakull, gollash, gollomesh, gjikaran, karkacul, lakuriq, picak, pilikuri, skuriq*. Ai madje ka përmendur se ka edhe një fshat Çipllakë në rrethin e Elbasanit. Nga ana ime do të shtoj, se kjo fjalë është e dëshmuar si huazim të paktën prej vitit 1790. Përveç kuptimit ‘i zhveshur, i pambuluar’ në përputhje me turqishten, është përdorur edhe për bllokun e kurorës në pusët e shpimit për naftë në Kuçovë pas vitit 1950, si edhe për karabojën, vitriolin.

Nuk e vlen të jepen shembuj të tjerë të shumtë, të cilët dëshmojnë varfërinë e madhe të fjalorëve sinonimikë të botuar më parë. Mund të bëhet vërejtja, se ata fjalorë kanë dalë përpara veprës së T. Dizdarit. Kjo vërejtje nuk qëndron përpara fakteve të padyshimta. Para së gjithash, dihet se T. Dizdari ka nisur të botojë pjesë të punimit të vet që gjashtëdhjetë vjet më parë. Njëkohësisht, punonjësit e Sektorit të Leksikologjisë në Institutin e Gjuhësisë po ashtu prej gjashtëdhjetë vjetësh e kanë pasur në duar punën e tij të daktilografuar të plotë. Varfëria konceptuale dhe lëndore e dy fjalorëve sinonimikë të shqipes shpjegohet me ngushtësinë e mendimeve të autorëve tyre për sinonimet si thjesht fjalë me kuptime të afërta. Ata nuk e njohin se kjo kategori e gjerë fjalësh lidhet me shumanshmërinë e jetës së gjatë të një

populli, me periudha të ndryshueshme historike dhe larminë e shtrirjes gjeografike, me aspekte të ndryshme kulturore e sidomos me vështrimin shumëpërmasor të botës, jo të njëanshëm dhe të cekët botëkuptimor. Po marr për këtë një shembull.

Në të dy fjalorët sinonimikë mungon fjala *beledije*. T. Dizdari e ka dhe jep barasvlerësen shqipe *bashki*, duke shtuar se është përdorur edhe pas vitit 1920. Dëshkohet në gjuhën shqipe prej disa shekujsh. Do të shtoj, se është përdorur jo vetëm në shtyp edhe pas vitit 1945. Sipas Dizdarit, për ta zëvendësuar është propozuar fjala *bashki* nga L. Gurakuqi dhe ndoshta është sajuar nga M. Logoreci. E. Çabej vëren se vetë M. Logoreci është shprehur që e ka krijuar më 1913. Më 1915 Sali Gjuka propozonte të zëvendësohej beledija me *përlymtare*. Gazeta ‘Vullneti i popullit’ më 1930 e kundërshtonte bashkinë dhe paraqiste: *katundari, përlymtare, sundimtari*. Më duket se këtë fjalë e ka krijuar Ndre Mjeda; me ligjin organik të 28 nëntorit 1921 u ngritën në vend bashkitë dhe tashmë në ‘Fletoren zyrtare’ më 1926 ndeshim ‘policia e bashkisë’ dhe më 1927 ‘këshilla bashkiake’.

Pas vitit 1945 termi vijoi të përdorej për një kohë, prandaj në Fjalorin e vogël serbokroatisht-shqip të vitit 1947 ‘opshtina’ është përkthyer thjesht ‘bashki’, krahas ‘komiteti ekzekutiv’ për ‘izvrshni odbor’. Ishte ndjekja e modelit jugosllav dhe atij sovjetik, e cila solli që edhe terminologjia shtetërore të ndryshohej në përputhje me të atij sistemi. Kështu, në vend të bashkisë tashti kishim *komiteti ekzekutiv*, një kalkim nga këto gjuhë sllave, të cilin e gjejmë menjëherë në Kushtetutën (Statuti) e miratuar nga Asambleja Kushtetuese më 14 mars 1946. Edhe *Fjalori shqip-rusisht* i vitit 1950 i ka të dyja: bashki dhe komitet ekzekutiv. Si rrjedhim, në *Fjalorin e gjuhës shqipe* të vitit 1954 lexojmë: bashki – *administratë lokale që merret me rregullimin, pastrimin, ndriçimin etj., të një qyteti*, ndërsa njëkohësisht paraqitet edhe ‘komiteti ekzekutiv’ me një përkufizim të padrejtë për këtë organ ekzekutiv të pushtetit vendor. Me këto mënyra është fshirë fakti, që ndryshimi kishte ndodhur për arsye ideologjike, domethënë për orientimin sipas sistemit sovjetik. Në realitet fjala vijoi të përdorej për ndërtesën e këtij organi dhe askush nuk mund ta thoshte ndryshe, kur u prish **bashkia** në qendër të Tiranës.

Orientimi sovjetik shfaqet hapur në *Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe* më 1980. Aty përkufizimi është kopjuar në pjesën kryesore nga fjala

‘municipalitet’ i *Fjalorit të gjuhës ruse* të vitit 1958 (vëll. II), ku thuhet: ‘organ i vetadministrimit lokal në vendet borgjeze’. Shqip lexojmë: “Organ i vetadministrimit të qyteteve në Shqipëri para çlirimit” dhe vijohet: “organ i vetadministrimit lokal në disa vende të tjera”. Për komitetin ekzekutiv jepet një përkufizim i pafytyrë: “organ drejtues i pushtetit shtetëror”, sepse nuk ishte gjetur ndonjë përkufizim rusisht për ta përshtatur, kështu që leksikografët nuk e dinin se çfarë ishte komiteti ekzekutiv shqip. Vetëm pesë vjet më vonë *Fjalori Enciklopedik shqiptar* do ta quante: organ ekzekutiv-urdhërdhënës i këshillit popullor. Mirëpo do të kalonin sërish pesë vjet të tjerë dhe befas bashkitë nuk ishin më diçka e së kaluarës, as organe të vetadministrimit lokal para çlirimit, as në disa vende të tjera, por bashkitë e njohura nga çdo shqiptar, ndërsa pas vitit 1991 u mënjana nga përdorimi i përditshëm ‘komiteti ekzekutiv’ me lehtësinë më të madhe. Në ribotimin e *Fjalorit enciklopedik* (2008) pranohet qartë: “bashkitë u rikthyen në funksionin e tyre... sipas ligjit të dt. 10.06.1992”.

Në ribotimin e *Fjalorit të shqipes së sotme* më 2002 duket se më në fund leksikografët e kanë kuptuar, që bashkia është organ i pushtetit vendor, por kanë nxituar ta quajnë të vjetruar komitetin ekzekutiv, sepse nuk e dinë që togfjalëshi nuk ka pasur vetëm kuptimin e bashkisë. Kurse në ribotimin e vitit 2008 *bashkia* është kthyer nga organ bazë në organ kryesor shtetëror dhe *komiteti ekzekutiv* është fshirë nga gjuha shqipe, sikur të kenë vdekur që të gjithë ata, që janë gjallë edhe sot dhe që kanë punuar aq shumë kohë nëpër komitetet ekzekutive. Kjo ndodh sepse janë po ata autorë, për të cilët termat fetarë befas ishin shndërruar në të vjetruar në shtetin ateist, sikur nuk kishte asnjë shqiptar mysliman të gjallë në Kosovë e gjetkë, që fliste shqip.

U zgjata me këtë shembull për të treguar sesa e ndërlikuar dhe interesante është marrëdhënia e fjalëve në gjuhë dhe, për pasojë, është e dëmshme një punë shkel e shko dhe me padituri në fushën e sinonimisë.

Nuk e vlen të sjell shembuj të tjerë të panumërt, të cilët dëshmojnë varfërinë e papranueshme të fjalorëve sinonimikë të botuar dhe dobësinë e njohurive e të kërkimeve të autorëve të tyre, që vetëm sa janë ngutur për t’u dukur si të parët në këtë fushë. Nga ana tjetër, kjo është dëshmi e kërkimeve të palodhura të T. Dizdarit, i cili madje me modesti asnjëherë nuk e ka vënë në dukje se po e kryente këtë punë. Me të drejtë T. Dizdari

mund të quhet një mbledhës i zellshëm i fjalës shqipe në traditën më të mirë që nga Kristoforidhi, duke përfshirë edhe burimet e shkruara e në veçanti botimet e folklorit. Po sjell nja dy shembuj.

Për ‘açik’ te Dizdari kemi: *çiltas, faqeza, molladane, nçelë, rrumbullak, sheshit, shkipët, shkoqur, troç, zdaçëm*.

Për ‘ashiqare’: *ballafaqe, botërisht, ditën për diell, haptas, për fushë, qartas, sheshit*.

Për ‘belqim’: *demede, dro, druese, korëza, kushedi, mbase, me gjasë, ndoshta, qaso, thomse*.

Për ‘filiz’: *bilashnjok, bitonjë, llastar, njemzë, pinjoll, punith, rremth, skallua, triskull, trishe, thisk, vllaskonjë*.

Duke gjurmuar fjalët e shqipes përballë turqizimave, në thelb T. Dizdari ka ndjekur traditën rilindëse për pastrimin e shqipes së shkruar nga huazimet e papëlqyeshme dhe në këtë drejtim, ka shtruar rrugën për të plotësuar fjalorët e derisotëm, të cilët janë quajtur “Për pastërtinë e gjuhës shqipe”. Dihet se një vepër të tillë, sado modeste, e nisi A. Xhuvani dhe e botoi më 1950. Aty janë 26 turqizma. Kam shqyrtuar vetëm shkronjën ‘S’ te T. Dizdari dhe më del se ka 54 turqizma,⁵ për të cilët ka dhënë fjalët që mund t’i zëvendësonin, domethënë në një shkronjë janë dy herë më shumë sesa në një fjalor të tërë Ndërsa fjalori i Akademisë së Shkencave *Për pastërtinë e gjuhës shqipe*, që doli më 1998 (kishte qenë gati që më 1992) e ka treguar në parathënie, se i kishte përjashtuar turqizmat për t’i paraqitur në një botim tjetër, i cili duket se as ka për t’u bërë ndonjëherë. Libri i T. Dizdarit mbetet botimi më i mirë për të vijuar mënjanimin e turqizimave tashmë të panevojshme.

Mund të shtrohet pyetja: a ka të meta dhe mangësi nga ky këndvështrim vepra e T. Dizdarit? Natyrisht që ka, por tashti për tashti më e rëndësishme është të nxirret në dukje pasuria e tij për leksikun e shqipes. Do të veçoja vetëm një të metë: renditjen si sinonime të fjalëve që shënojnë lloje të ndryshme. Për shembull, te *dyfek* nuk mund të vihet si sinonim *hutë*, sepse kjo ishte vetëm një lloj pushke e vjetër; gjithashtu nuk është sinonim *martinë*, sepse kjo ka qenë pushkë vetëm e llojit që prodhonte firma Martini. Ose *topanxa* nuk është sinonime me revolen, sepse ishte e një tipi të vjetër me strall dhe mbushej nga gryka. Fjalë të tilla e kanë vendin në një fjalor tematik (frëngjisht quhet fjalor analogjik), që i mungon shqipes. E

veçoj këtë anë, sepse del si një gabim i rëndë gjatë gjithë Fjalorit sinonimik akademik më 2004. Aty na dalka se pisha qenka sinonime me artinin, hormoqin, bredhin e zi e ku ta dish se me çfarë tjetër. Me këtë trajtim jo shkencor del se edhe ngjyra e limonit qenka sinonime me ngjyrën e protokallit dhe unë nuk e di se cili shqiptar do ta pranonte këtë. Në Fjalorin e vitit 2002 me këtë lloj vështrimi shkohet deri në marrëzira, duke thënë, për shembull, se pikëllohem do të thotë edhe *shkretohem, plagosem, çirrem, më shqyhet zemra, s'e dua veten, më pikon zemra gjak* dhe hynere të tjera.

Shkaku i kësaj shkarjeje është metoda e gabuar e punës. Në një kumtesë antishkencore të vitit 1996 thuhej, për shembull, se sipas “gjuhësisë kompjuterike”,⁶ autorit na i dilte që fjala *babanik* nuk paska sinonime, ndërsa disa vjet më vonë unë kam treguar se ka nja 7 a 8 sinonime. Gjithashtu na del se *bomba* qenka sinonime me kumbaranë. Këtë ngatërrim e kanë edhe disa fjalorë të mëparshëm; Dizdari ka dhënë disa togfjalësha nga folklori: *e rreh topi e kumbaraja, krisi topi e kumparaja; duro top e kumbara*. Është fare e qartë, se flitet jo për bomba, sepse nuk ka shqiptar që të thotë “e rreh bomba”, por për dy armë artilerie, njëra është topi dhe tjetra një lloj mortaje e vjetër ose havani. Ajo kumtesë është cituar si mbështetje edhe në artikullin kushtuar drejtpërdrejt fjalorit sinonimik të vitit 2004.

Dëshiroj ta përfundoj duke përsëritur diçka, që e kam shprehur edhe më parë: vepra e T. Dizdarit jo vetëm i ka shërbyer dhe i shërben gjuhësisë sonë në disa drejtime, sidomos për leksikologjinë historike e leksikografinë, por edhe meriton të shihet si një pikënisje e vlefshme për kërkime të reja, përtej rrethit të kufizuar të huazimeve orientale.

SHËNIMET

1. DHRIMO, Ali – TUPJA, Edmond – YMERI, Eshref (2002): *Fjalor sinonimik i gjuhës shqipe, mbi 30.000 zëra*. TOENA, Tiranë; 609 f.
2. Vetëm këta autorë mund të kujtojnë, se ‘mërzitem’ qenka sinonime me: ‘më buçasin veshët; bëhem dauille; urgusem ...’ etj. Po ashtu vetëm për këta autorë qenkan sinonime te fjala ‘rraskapitem’ gjëra të tilla, si: ‘më zë gjuha lesh; shoh vdekjen me sy; pëlcas nga vapa ...’ etj. Ndoshta ky

- është një fjalor humoristik, për të ndihmuar që të kalohet një bisedë degë më degë.
3. THOMAI, Jani – SAMARA, Miço – SHEHU, Hajri – FEKA, Thanas (2004): *Fjalor sinonimik i gjuhës shqipe*. ASHSH, Tiranë. 1084 f. Një vështrim kritik me shembuj përkatës kam dhënë për këtë libër të “Parathënia” e *Fjalorit të emrave të bimëve dhe të kafshëve shqip-latinisht, latinisht-shqip*. Logos-A, Shkup, 2010.
 4. DIZDARI, Tahir (2005): *Fjalori i orientalizmave në gjuhën shqipe*. AIITC, Tiranë, 1200 f.
 5. Ja lista e plotë e këtyre rasteve: sabah – *mëngjes*, sabahli - *herak*, sabahile – *menatë*, sabër – *durim*, sabërli – *durimtar*, sabi – *kërthi*, saç – *veshnik*, sadaka – *lëmoshë*, sade – *i thjeshtë*, - *sadriazem* – *kryeministër*, safë – *kokme*, safi – *i papërzier*, sahatçi – *orëndreqës*, sahib – *zotërues*, sajdis – *nderoj*, sakat – *i gjymtë*, sakatoj – *gjymtoj*, sakatllëk – *gjymtim*, sakën - *se mos*, sall – *vetëm*, sallahan – *djerraditës*, sallgam – *akacie*, sallhane – *thertore*, sarallëk – *verdhëz*, saranxhë – *sternë*, saraxha – *stërkungull*, sarhosh – *dejmarak*, sarraf – *koprrac*, sarrafllek – *koprraci*, saxhak – *këmbje*, sebep – *shkas*, sebepçi – *shkaktar*, sefer – *udhëtim*, sehirxhi – *soditës*, sëkëlldi – *brengë*, sëkëlldis – *brengos*, selam – *të fala*, selvi – *qiparis*, sene – *vit*, setër - *xhaketë*, sevda - *dashuri*, serm – *argjend*, sikter – *shporru*, sira – *radhë*, soj – *fis*, sojak – *biçak*, sokak – *rrugë*, sollak – *mëngjarash*, surrat – *fytyrë*, surratsëz – *buzëpaqeshur*, sus – *hesht*, susak – *kungull ujës*, syngji – *bajonetë*, syrgjyn – *internim*.
 6. DURO, Agron (1996): *Ndërtimi i një modeli për një fjalor të kompjuterizuar të sinonimeve shqipe*, në: “Seminari XVIII ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare”, Toena, Tiranë, f. 337-341. Këtë kumtesë e ka marrë si mbështetje M. Samara në artikullin po aq të cekët: *Probleme të sinonimisë dhe “Fjalori sinonimik i gjuhës shqipe”*, në SF, 1999, nr. 1-2, f. 165-173.

Synonyms in the “Dictionary of orientalisms’ by T. Dizdari***ABSTRACT***

After a long dedicated work T. Dizdari has given us an as full as possible picture of the Turkish loanwords in Albanian until the end of the First World War. Nevertheless a very important aspect of his work is not yet put in evidence. Following the tradition of our Renaissance he tried to give a solution to the problem of the elimination of the unnecessary Turkish words from the written language. With this aim he traced the corresponding Albanian words used by various authors or proposed as substitutes. In this way within his main work he has created a parallel dictionary, namely a dictionary of Albanian synonyms. From this point of view his lexicographical work merits a further study to highlight his contribution to the richness of the Albanian lexicon, and to its modernization eliminating foreign obsolete words.

Artan HAXHI, Tefë TOPALLI

TERMINOLOGJIA SI SISTEM

(Fjalor i termave të gjuhësisë)

(vijon)

ADJEKTIV

1. *Adjektimi* (nga latinishtja *adicere*, *adject-* me shtu), në gramatikën e shqipes së sotme mbiemër, është ajo pjesë e ligjëratës që emërton një tipar (cilësi, veti, marrëdhënie) të sendit dhe përshtatet në gjini, në numër e, për një pjesë, edhe në rasë me emrin e këtij sendi¹. Një *adjektiv* (mbiemër) specifikon vetitë ose attribute të një referenti emër. Ai ka një kategori specifike, kategorinë e shkallës (p.sh.: *i mirë – më i mirë – shumë i mirë*).

Mbiemrat në gjuhën shqipe klasifikohen në bazë të dy kriterëve:

- a. Sipas veçorive morfologjike (të nyjshëm dhe të panyjshëm),
 - b. Sipas kuptimit leksikor (mbiemra cilësorë dhe mbiemra marrëdhëniorë).
2. *Frazë adjektive* është një kategori sintaksore e cila ka një mbiemërsi kokë të saj dhe që mund të ndryshohet nga një ndajfolje e shkallës (*shumë e bukur, vërtetë e vogël, mjaft të ndritshme*) apo një plotësues (*të lodhur nga lufta, krenar nga një arritje*).

ADJUNKT

Adjunkti (nga lat. *adiungere* – me lidhë, me shtu), është një shprehje gjuhësore e përdorur në mënyrë specifike për të dalluar semantikisht një element paraprijës ose pasues. Ai mund të ketë karakter kufizues, duke u realizuar gjuhësisht përmes përdorimit të një nyjeje, një përemri, një fjalie lidhore (*ai libri/ libri im; libri që ai po lexon tani*) ose karakter cilësor (*një libër i pazakontë; ai libri atje tutje*). Në dallim me plotësin, adjunkti nuk është i detyrueshëm nga ana gramatikore, çka do të thotë se ai është një përbërës i lirë. Adjunktet mund të ndahen në klasë të ndryshme sipas funksionit të tyre semantik. Adjunkte tipike janë rrethorët e vendit, të kohës, të mënyrës e të shkakut, që ndryshe quhen edhe përbërës jobërthamorë. Adjunkti përdoret si element përcaktues në raport me një element bartës, nga i cili mund të varet, por edhe mund të ndahet pa dëmtuar përmbajtjen e fjalisë. Pra, ai është një përbërës fakultativi një

¹Akademia e Shkencave e Shqipërisë, *Gramatika e gjuhës shqipe*, I, Tiranë, 2002, f. 153.

konstrukcioni dhe mund të mënjanohet pa e dëmtuar fjalinë. P. sh., *Sot pasdreke, kur të ketë perënduar dielli, do të mblidhemi në shtëpinë e Agronit.* (fjalja e varur kohore *kur të ketë perënduar dielli*, mund të mënjanohet pa e dëmtuar fjalinë: *Sot pasdreke do të mblidhemi në shtëpinë e Agronit*).

ADJUNKSION-

1. Në gramatikën transformacionale, adjunksioni është një veprim elementar sintaksor nëpërmjet të cilit përbërësit, pasi janë zhvendosur nga pozicioni i tyre në strukturën e thellë, janë vendosur në një pozicion të ndryshëm në strukturën sipërfaqësore. Ato bashkohen në diagramën e pemës së strukturës sipërfaqësore si një degë shtesë (\Rightarrow gjithashtu transformim, \Rightarrow pjesë shtuese, Chomsky).
2. Sinonim për shkëputje/ndarje në logjikën formale.

ADNOMINAL

Adnominal (nga latinishtja *ad* + *nominal*, ndajemëror) është një term që i përket gramatikës tradicionale, me të cilin tregohet në një ndërtim endocentrik, ku elementi sintaksor i drejtuar nga një emër kryen funksionin e modifikuesit të vetë emrit. Funksioni adnominal atributiv mund të shprehet nga kategori të ndryshme sintaksore, si: mbiemër (*peshku i zi*, lat. *domus aurea - shtëpia e artë*), sintagmë emërore (*shtëpia e Cezarit, peshku me ngjyrë të kuqe*) apo një fjali e varur (*merr kthesën te shtëpia që ka pullazin e kuq*). Krahas një emri prejfoljor, elementi *adnominal* gjithashtu mund të ketë funksione subjektive apo objektive, në varësi të faktit që në fjalinë korresponduese në bashkëvjajtje me foljen e fundme mbulon rolin e subjektit ose edhe atë të objektit (*lindja e Marios – subjekt*) (*kapja e Marios – objekt*).

Për t'u shënuar është se gjuha angleze mund të shquajë morfologjikisht funksionin adnominal subjektiv nga ai objektiv përmes përdorimit të së ashtuquajturës “*gjinore saksonë*” (p.sh. *John's birth – lindja e Gjonit*), aty ku gjuhët me sistem të pasur rator i shkrijnë të dy funksionet në përdorimin e gjinores.

I ADRESUAR

1. **I adresuari** është një nga dy elementet kryesore të procesit të komunikimit (dërguesi i mesazhit dhe marrësi/i adresuari). Ato ndërveprojnë mes tyre. **I adresuari** është një nga marrësit e menjëhershëm të destinuar të komunikimit nga ana e folësit. Ai është i gramatikalizuar në morfemën e vetës së dytë. E rëndësishme është të

bëhet dallimi midis marrësit dhe të adresuarit: i pari është personi që e merr mesazhin, por nuk është i interesuar direkt për të, ndërsa i dyti është personi të cilit i është drejtuar mesazhi. Ai është personi që dekodifikon dhe interpreton informacionin (e vendos në një kontekst), i jep kuptim dhe vendos se si të sillet më vonë. I adresuari ka funksion njohës ose bindës, domethënë atë të atij që, duke marrë një mesazh, mund të bindet, p. sh.: në rastet e publicitetit, të ftesës, të lutjes ose të një urdhri.

2. Në leksikologji përshkruhet një hyrje ose një njësi leksikore (fjalë ose fjalë e përbërë) nën të cilën janë vënë informacionet që përmban (shqiptimi, etimologjia, përcaktimi, shembujt, idiotizmat, sinonimet, antonimet). Në një fjalor përdorimi i të adresuarit ngatërrohet me një njësi grafike të kufizuar nga dy hapësira tipografike dhe e reduktuar nga një prej formave të paradigmes foljore, emërore apo mbiemërore. Kështu, format e ndryshme të paradigmes së foljes shkoj (*unë shkoj, ti shkon, ai shkon* etj.) janë bashkuar tek paskajorja *me shku*, që përbën të adresuarin. Emrat kanë për të adresuar njëjës. Nëse një fjalë grafike ka dy shpërndarje dhe dy domethënie të ndryshme, ai do të ketë dy hyrje homografe, pra, dy kuptimet kanë etimologji të ndryshme.

ADSTRAT

Adstrat (nga latinishtja *adstratum* e përbërë nga *ad* "afër" + *stratum* "shtresë") në terminologjinë gjuhësore është tërësia e ndikimeve gjuhësore të llojeve të ndryshme të ushtruara nga një gjuhë ndaj një gjuhe tjetër të afërt. Ai është fenomeni i kontaktit dhe i interferencës ndërmjet dy gjuhëve të folura në zona fqinje, zakonisht në marrëdhënie të ndikimit të ndërsjellë, por pa mbisundimin e njëres ndaj tjetres (për shembull gjuha etruske në lidhje me latinishten), pra, pa pasur dallim në prestigj që të favorizojë njëren ose tjetrën. Termi i referohet ndikimit reciprok të dy gjuhëve në kontakt me njëra- tjetrën për një periudhë të caktuar kohore, p.sh. një situatë e tillë mund të ndeshet në kontaktin mes gjuhës flamande dhe asaj frënge në Belgjikë. Gjithashtu *adstrati* është edhe një fenomen sipas të cilit një gjuhë e mëparshme, eventualisht e zhdukur, ushtron ndikimin e saj ndaj një gjuhe pasardhëse. Ndikimi i *adstratit* mund të manifestohet në forma të ndryshme sipas gjuhëve që janë në kontakt, sipas strukturave të tyre e, mbi të gjitha, sipas shkallës së prestigjit që ata mbulojnë në sytë e komunitetit gjuhësor. Popullatat keltike të Galisë p.sh., braktisën gjuhën e tyre në favor të latinishtes, sepse ajo aso kohe ishte gjuha e administratës (prandaj edhe e aristokracisë së re), por, mbi të gjitha, sepse ajo ishte gjuha që përdorej më gjerësisht në komunikim nga tregtarët (pra, edhe e pasanikëve të rinj).

Megjithatë edhe dialektet keltike lanë gjurmë të spikatura e të shumta të adstratit në fonologji, në sintaksë etj. Falë aplikimit të konceptit të *adstratit* edhe parahistoria gjuhësore mund të jetë e studiuar më për ata gjuhë që në mungesë dokumentimit bashkëkohor, mund të shfaqin relikte gjuhësore.

ADVERB

Adverbi (nga latinishtja *adverbium*, nga *ad-* ndaj + *verbum*– folje), në gramatikën e shqipes së sotme ndajfolja, është një pjesë e pandryshueshme e ligjëratës, që emërton një tipar të veprimit a të gjendjes, rrethanat në të cilat vërtetohet ky veprim, ose tregon shkallën e një cilësie a të një rrethane² ose intensitetin e veprimit. Ajo është një kategori leksikore anëtarët e së cilës kanë të njëjtën shpërndarje dhe zakonisht në pikëpamje sintaksore modifikojnë mbiemra, ndajfolje të tjera, folje ose fjali.

Përdoren rregullisht pranë një foljeje, pranë një mbiemri apo pranë një ndajfoljeje për të modifikuar apo saktësuar kuptimin. Më rrallë përdoren pranë një emri prejfoljor (shumë rrallë pranë një emri joprejfoljor).

Semantikisht ndajfoljet klasifikohen në:

- a. ndajfolje përcaktore, të cilat ndahen në: ndajfolje të mënyrës (*hollë, mirë, keq, qetë, shkurt, bukur, thjesht* etj.) dhe në ndajfolje të sasisë (*shumë, fort, tepër, pak* etj.)
- b. ndajfolje rrethanore, të cilat ndahen në: ndajfolje të kohës (*sot, sonte, dje, mbrëmë* etj.), ndajfolje të vendit (*këtu, aty, këndeje, andej, lart, poshtë, anembanë, brenda, jashtë* etj.) dhe ndajfolje të shkakut (*pse, përse, prandaj, andaj* etj.).

ADVERBAL

Adverbal ose ndajfoljor është një term që i përket gramatikës tradicionale i përdorur për të treguar disa funksione sintaksore: karakterizon një veprim foljor, një proces ose gjendje, në lidhje me kohën, vendin, mënyrën, shkakun etj. Këto funksione semantike i korrespondojnë klasifikimit të ndajfoljeve nëkohore, vendore, shkakore etj.. Me të mund të tregohet një ndërtim → endocentrik, ku elementi sintaksor, që i referohet elementit gramatikor të drejtuar nga folja, është i aftë të modifikojë valencën semantike. Në kundërshtim me elementet adnominalë, ato adverbale nuk përdoren në ndërtime endocentrike, por ekzocentrike.

ADVERBALIZIM

Adverbalizim (ndajfoljezim) quhet procesi i formimit të formave

² Akademia e Shkencave e Shqipërisë, *Gramatika e gjuhës shqipe*, I, Tiranë, 2002, f. 357.

ndajfoljore me anë të prejardhjes prapashtesore (*natyrisht, hollësisht, besnikërisht, gabimisht, fytazi, grykas, falas, fluturimthi* etj.), përngjitjes (*gjithandej, gjithmonë, dikund, askund, menjëherë, përreth, sidokudo, anekënd, dyfish*) ose konversionit (*copë, rresht, mot, sheshit*). Ka gjithashtu edhe lokucione ndajfoljore, të cilat janë një grup fjalësh me lidhje të qëndrueshme midis tyre dhe që, si kuptimisht, ashtu edhe gramatikisht, janë të barasvlershme, po jo identike, me ndajfoljen : *tufa-tufa, valë-valë, rreth e rreth, dora-dorës, aty-këtu, ditë për ditë, hap pas hapi, me të qeshur, për së gjalli, dy nga dy, pak nga pak* etj..

AEROMETRI

Aerometria (nga greqishtja e vjetër *ἀερομετρία* (aerometria), nga *ἀέρος* (aéros) - "ajër" + *μέτρον* (metron) - matje) është pjesë e mekanikës fluide që merret me matjen e dendësisë së ajrit. Ose ndryshe shkenca e matjes së vetive të ajrit, duke përfshirë presionin, rrallimin dhe ngjeshjen e tij. Quhet ndryshe edhe pneumatikë (Studimi i vetive mekanike të ajrit dhe të gazrave të tjera).

AEROMETËR

Aerometri (nga greqishtja e lashtë *ἀήρ* - aer "ajër" + *μέτρον* - métron "masë, shkallë, matje") është një instrument që shërben për matjen e densitetit apo të ndonjë parametri tjetër të ajrit.

AFAZI

Afazi (nga greqishtja *aphatos* "pa folur", nga një *a* "pa, privim" + *phanai* "flas") është humbja tërësore ose e pjesshme e një ose e më shumë aftësive komunikative paraekzistuese, si shkak i ndonjë lëndimi organik (kryesisht për shkaqe vaskulare, traumatike apo tumorale) të strukturave encefalike (në zonat e trurit kryesisht i dëmtimit të zonës së Brokës dhe zonës së Vernikut) të destinuara për të bërë kodifikimin apo dekodifikimin e mesazheve të çdo lloji e shkalle sofistikimi, në nisje apo në arritje, me anë të çfarëdolloj kanali komunikimi. Pra, jo vetëm të mesazheve verbale apo transkriptimin e tyre grafik - fonemografik, por çfarëdolloj mesazhi pragmatik, analogjik apo dixhital.

Nga një pikëpamje klasifikative (taksonomike) mënyra më elementare për vlerësimin e një tipi afazie është të dallosh nëse çrregullimi komunikativ është kryesisht dekodifikues (hapësirat gjuhësore kortikale të prapme), i pranimit, i të kuptuarit apo i vlerësimit të mesazheve në arritje, ose është kryesisht kodifikues (hapësirat gjuhësore kortikale të përparme), i shprehjes, i prodhimit apo i formulimit të mesazheve në nisje. Çrregullimet

afazike janë shumë formash. Klasikisht njihen këto forma klinike:

1. *Afazi globale*, lëndim (dëmtim) i të gjithë hapësirës kortikale gjuhësore të hemisferës së majtë; mund të konsiderohet si shuma e të gjitha llojeve të afazisë;
2. *Afazi e Wernicke-s*, e shkaktuar nga dëmtimi i hapësirës (zonës) 22, e karakterizuar nga deficieti i të kuptuarit, të folur spontan fluent (i rrjedhshëm), por i pakuptueshëm si në pikëpamje semantike, ashtu edhe në nivel formal, vështirësi përsëritjeje, anosonjozi (mungesë ndërgjegjësimit për gjendjen e vet), defekte të vizionit, mungesë paralize. Ndryshimi më karakteristik në prodhimin e mesazheve është në nivelin semantik me humbjen e kuptimit të shprehjes, të lidhjeve ndërmjet kuptimeve, prezencës së gjergofazisë (përzierje fjalësh apo siç quhet edhe “*sallatë ruse fjalësh*”), anomisë, neologjizmave, parafazisë semantike (zëvendësimit të fjalëve me të tjera semantikisht të lidhura), parafazisë verbale (zëvendësimit me fjalë semantikisht jo të lidhura).
3. *Afazi e Broka-s*, e shkaktuar nga dëmtimi i hapësirës 44, e karakterizuar nga një të kuptuar të mirë, por me një të folur spontan, jo të rrjedhshëm ose edhe mungesë e tij, jostonjozi (ndërgjegjësimit për gjendjen e vet), prezencë të emiplegjisë së djathtë dhe paralizë faciale. Karakteristika komunikative më themelore është një prodhim verbal jo i rrjedhshëm, me dëmtim të gjuhës deklaruese dhe forma verbale të ngarkuara emocionalisht (sharje, mallkime etj.) ose të folur automatik e serial (përsëritje, lutje, alfabet, numra, ditët e javës etj.). Është i pranishëm edhe ndryshimi i artikulimit verbal (dizartria) e lidhur me çrregullimin motorik të vrimave të fytyrës.
4. *Afazi e përçueshmërisë*, dëmtimi i zonës 40, me të folur spontan, të rrjedhshëm, por me gabime, të kuptuar të ruajtur, jo sonjozi, mungesë emiplegjie, ndonjëherë çrregullime motorike të fytyrës.
5. *Afazi nga dëmtimi i zonave anësore*, që përfshin nënklasa të shumta.

AFEKTIV

Afektiv (nga latinishtja *affectivus*, e prejardhur nga *afficere* “me ba përshtypje”) emocional, shprehës.

1. Quhet *gjuhë afektive* (emocionale apo shprehëse) ajo gjuhë që pasqyron qëndrimin vetjak që u japim fjalëve tona si një manifestim natyror dhe spontan i formave subjektive të mendimit. Është shprehje e pjesëmarrjes emocionale të folësit në procesin e të folurit, duke iu referuar veçanërisht formave të veçanta të leksikut, si mbiemra dhe emra që nënkuptojnë vlerësime, ndryshime, ndërhyrje etj.. Përcaktohet si gjuhë

- afektive ajo gjuhë në të cilën mbisundojnë shprehje dhe fjalë të tipit familjar dhe të regjistrit joformal.
2. *Kuptimi afektiv* i një fjale përbëhet nga të gjitha shoqërimet emocionale të cilat janë të lidhura me të (sinonim me konotacion), krahasohet me kuptimin konjitiv (shenjues, sinonim me denotativ), i cili përfaqëson marrëdhënien e saj me objektin e përcaktuar. P.sh. termi *bashkëpunëtor* mund të ketë një kuptim konjitiv (veprim i bashkëpunimit ndërmjet dy a më shumë personave, të marrurit pjesë në një veprim të përbashkët etj.) dhe një kuptim afektiv (përkeqësues - qëndrimi që dikush mbajti gjatë dhe pas pushtimit të vendit të tij nga të huajt).
 3. *Zgjedhimi afektiv* (i quajtur edhe datival) në gramatikë është një ndërtim tipik i sistemit foljor gjeorgjian, ku së bashku me zgjedhimin e tipit "*unë dashuroj*" ekziston edhe ai i llojit "*për mua është dashuri*"; ky ndërtim herë pas here ndeshet edhe në gjuhë të tjera (p.sh. në gjuhën latine *amandum est*).

AFEMI

Afemi (nga greqishtja *α* a (*pa*) + *φνημ*phēm(ē) (fjalë) + -ia) është një term i përdorur në shekullin XIX për të treguar disa çrregullime të gjuhës së folur të shkaktuara nga dëmtime të hapësirave gjuhësore kortikale. Termi *afemi* sot është zëvendësuar nga *afazi motorike*.

AFEREZË

Aferezë (nga lat. *aphaeresis* - gr. *aphairéo*- marr me vete, heq) është një ndryshim fonetik që konsiston në rënien e një foneme nistore ose në heqjen e pjesës fillestare (një ose disa rrokje) të një fjale. Përgjithësisht është një fenomen fonosintaksor që në shumë raste reflektohet edhe në të shkruar. Ky fenomen është mjaft i zakonshëm në të folur, kurse në të shkruar synon të ruajë vetëm forma tashmë të kristalizuara.

Konsiderohet si *aferetike* forma e nyjës përcaktuese mashkullore njëjës në italishte *il*, *lo*: nga latinishtja *illum* ka kaluar në *lo*, që para zanoreve shndërrohet në *l*; kurse forma *il* ka lindur ndoshta nga nevoja për një zanore mbështetëse.

Në gjuhën shqipe *afereza* shfaqet kryesisht me rënien e zanores nistore të një fjale për shkak të ndeshjes me zanoren fundore të fjalës para saj. Vëmë në dukje, në të folme popullore të Jugut: *ku'shtë*, *sa'shtë*, *përse'shtë*, *Vretoja i ka 'nda* "i ka ënda; në geg. pop. *ma'ndej*; arb. Italisë *i madhi n'Zot* "in zot – zoti ynë". Në shqipe edhe bashkëtingëlloret mund të bien në ligjërim të lidhur kur ndeshen dy fonema të tilla, të cilat u përkasin fjalëve të ndryshme që kanë lidhje të ngushtë me njëra-tjetrën. Kjo dukuri është e

zakonshme sidomos në antroponime e patronime të përbëra, që marrin një theks të vetëm sintagmatik, si p.sh.: *s'und vij* ("s'mund të vij")³.

AFËRSI

Afërsia përcakton një kategori deiktikësh që tregojnë objekte pranë (*ky, kjo, këtu*), përkundrejt deiktikëve që tregojnë objekte të largëta (*ai, ajo, atje*). Në kategorinë e vetës, bëhet një dallim në mes një personi afër dhe një personi larg, kjo kundërvënie në disa gjuhë rezulton me fleksion foljor e emëror, *ky këtu / ai atje*.

IAFËRT

Që ka prejardhje të përbashkët me një tjetër. Në disa gjuhë është kategori e sistemit të përemrave vetorë (p.sh. gjuhët *algonkuiane, nadene*): përemrat vetorë janë të afërt nëse i referohen një objekti, i cili ka qenë përmendur më parë gjatë ligjërimit.

AFIKS

1. *Afiksi* (nga latinishtja *affixus* e *affixum*, që rrjedh nga *affigere* "me ngjitet") në gramatikën e sotme ndajshesë, është një morpheme e lidhur që i shtohet një fjale për të formuar një tjetër. *Afiksi* i bashkohet rrënjës së një fjale për të treguar funksione sintaksore (morfema trajtëformuese), për të ndryshuar kategorinë leksiko-gramatikore të fjalës (morfemat fjalëformuese) ose për të modifikuar kuptimin (morfemat shprehëse).

Afikset dallohen sipas vendit që zënë në lidhje me rrënjën, duke u ndarë në

- prefikse (parashtesat) që i paraprijnë fjalës bazë ose rrënjës (si në lat. *per-ficio* "me krye", shqip *për-dor, ç-liro, mos-besim* etj.);
- sufikse (prapashtesat), që i pasvihen, pra, e ndjekin fjalën bazë ose rrënjën (si në latinisht *rube-sco* "skuq", shqip *fal-as, rrjedh-im, shit-ës, shkodr-an* etj.);
- infikse (brendashtesat), që ndërvihen ose ndërkalen brenda vetë rrënjës (si në greqishten e vjetër *lambáno* "marr", nga rrënja *lab-*, me futjen e ndërshtesës hundore në formimin e temës së kohës së tashme ose në latinisht infiksi *n* tek fjala *jungo* nga një *jug* etj.).

Parashtesat dhe prapashtesat veç të tjerash dallohen edhe për nga tipi i ndryshimeve që shkaktojnë në veçoritë sintaksore e semantike të bazës. Parashtesa në përgjithësi nuk ia ndryshon kategorinë leksiko-

³ Kolec Topalli, *Fonetikahistorike e gjuhës shqipe*, "Dituria", Tiranë, 2007, f. 83.

gramatikore fjalës me të cilën bashkohet, por i jep asaj vetëm një kuptim të ri plotësues, si: *i lexueshëm* > *i pa-lexueshëm*, *flas* > *për-flas* (ndonëse ka edhe raste kur e ndryshon *gjak*>*për-gjak*, *baltë*>*për-balt*, *buzë*>*për-buz* etj.). Kurse prapashtesa (sufiksi) mund ta realizojë një ndryshim të tillë kategorie tek fjala së cilës i prapangjitet (fjala bazë), p.sh. *oriz* > *oriz-ore*, *çel* > *çel-ës*, *larg* > *larg-o*.

2. Në fazat e para të gramatikës gjenerative, afikset konsideroheshin si simbole të cilat përfaqësonin morfema gramatikore që kanë aftësi të kombinohen me morfema leksikore. Ato korrespondojnë me tërësinë e mbaresave të kohës, të pjesores dhe të infinitivit (paskajores). Me praninë e tyre ata shkaktojnë transformimin afiksial (ndajshtesor).

AFIKSIM

Afiksimi (ndajshtesimi) është një mënyrë morfologjike fjalëformimi me anë të së cilës formohen fjalë të reja nga bashkimi i një teme dhe i një apo disa ndajshtesave. Ai është një proces morfologjik prejardhjeje që mbështetet në ndryshimin në plan formal e semantik të një teme fjalëformuese (baze leksikore ose rrënje), përmes shtimit të elementeve morfologjike (morfemave), të klasifikuara në bazë të kriterit të shpërndarjes (pozicionit që zënë ndaj bazës) dhe kriterit funksional (ndikimit mbi bazën).

AFIKSOID

Afiksoid është një teknikizëm i sajuar nga gjermanët, që tregon përdorimin e prefiksoideve dhe sufiksoideve (janë quajtur ndryshe edhe “*gjysëm-fjalë*”⁴). Teknikisht një afiksoid është një morfemë që mund të jetë si leksikore, ashtu edhe derivacionale (sipas klasifikimit funksional të morfemave). Pra, afiksoide quhen një sërë morfemash me kuptim leksikor që bashkohen me fjalë të tjera, por që e kanë humbur pjesërisht vlerën fillestare dhe sillen si një afiks (teknikisht janë morfema leksikore të lidhura). Ato kanë kryesisht prejardhje greke ose latine, si : *euro-*, *auto-*, *bio-*, *pseudo-*, *aero-* ose *-fil*, *-foni*, *-log*, *-fobi*, *-mani* etj.

AFINITET

Afinitet (ndryshe edhe *afri*) quhet një lidhje e afërt apo ngjashmëri që buron nga prejardhja e përbashkët. Flasim për *afinitet* midis dy ose më shumë gjuhëve që kanë prejardhje të përbashkët gjenetike, kur ata paraqesin disa ngjashmëri strukturore (në organizimin e fjalive, në fjalorin e përgjithshëm, në fleksion etj.). P.sh. ngjashmëritë që ekzistojnë midis

⁴Scalise, S. (1994), *Le strutture del linguaggio: morfologia*, il Mulino, Bologna.

sistemit të lakimit të emrave në latinisht dhe sistemit të lakimit të emrave në rusisht janë për shkak të lidhjeve të tyre gjenetike, sepse gramatika krahasuese u jep këtyre dy gjuhëve një origjinë të përbashkët: indoevropianishten.

AFONI

Afoni (nga greqishtja *a-* -jo, pa *+fonia-zë*) është një term i patologjisë së gjuhës së folur, që i referohet një çrregullimi të përkohshëm ose të përhershëm i karakterizuar nga paaftësia totale për të prodhuar tinguj me zë, pra, për të folur (paaftësia e pjesëshme quhet disfoni). Afonia vjen si pasojë e shkaqeve organike (infeksion, traumë apo tumor) ose shkaqeve psikogjenike (stresi apo depresioni).

(vijon)

BIBLIOGRAFI:

- Akademia e Shkencave e Shqipërisë (2002), *Gramatika e gjuhës shqipe*, I, Tiranë.
- Beccaria, G.L. (2004), *Dizionario di linguistica e di filologia, metrica, retorica*, Piccola Biblioteca Einaudi.
- Belluscio, G. & Rrokaj. Sh. (2011), *Fjalor krahasues i termave të gjuhësisë*, Arbëria, Tiranë.
- Dubois, J. & Giacomo, M. & Guespin, L. & Marcellesi, Ch. & Marcellesi, J. & Mevel, J. (2001), *Dictionnaire de linguistique*, Larousse, ISBN : 2-03-532047-X.
- Dubuc, R. (1992), *Manuel Pratique de terminologie*. Linguatex: Brossard.
- Topalli, Kolec (2007), *Fonetika historike e gjuhës shqipe*, "Dituria", Tiranë.
- Scalise, S. (1994), *Le strutture del linguaggio: morfologia*, il Mulino, Bologna

Terminology as a system (Glossary of Linguistics Terms)

ABSTRACT

This article comes is a continuation of the article with the same title which was published in the previous publication. In it, 22 language terms have been explained, which we come across in the field of literature, both in contemporary and traditional one. In our explanations, we have tried to preserve the particular characteristics that often reflect the original value they have, according to different linguistic theories or which might be revised by the Science of Albanian Language to different concepts.

Evalda PACI

PËR NJË STUDIM TË THELLUAR DHE PËRMBAJTËSOR TË ELEMENTEVE INSTITUCIONALE TË GJUHËS LATINE

Ndërsa projekton të propozosh disa linja konkrete në pikëpamje të studimit të latinishtes dhe kontekstit përkatës të klasicitetit evropian së cilës ajo i përket, mendon para së gjithash si do të ekspozohen e shtjellohen disa elemente themelore të civilizimit përkatës, në bazë të të cilit do të qëndrojnë fjalë kyçe, si: *urbs, civitas, res publica, dictātor, imperium, imperātor, forum, consul, lector, censor, quaestor, poëta, orātor, scriba, scriptor, pecunia, stirps* etj.

Për këdo që ndërmerr një studim të tillë, qoftë dhe për të ngulitur për arsye formimi kulturor e profesional disa nocione themelore të kësaj kulture e të qytetërimit përkatës, duhet të jetë e qartë që çdo gjë që paraqitet e normëzuar në sytë tanë apo dhe e sistemuar në njëfarë mënyre nga gramatikanë, shkruet të një historiografie të gjatë që ka të bëjë me Romën si *urbs* dhe konsolidimin e saj nëpër periudha të caktuara historike, është në të vërtetë fryt i një rrugëtimi të konsiderueshëm në kohë e në hapësira të caktuara që kanë përfshirë individin dhe kontekstin social që e rrethoi atë, kontekst i larmishëm dhe për faktin që influksi i kulturave të tjera, indoevropiane dhe preindoevropiane, italike dhe në një kuptim gjenerik të fjalës la gjurmë të qarta në këtë histori unike që ngërthen evolucion gjuhësor, zhvillim gradual e të zgjatur në kohë të një qytetërimi dhe përpjekje për rrënjosjen e një imazhi të qartë të banorit të Romës, tipik në shumë pikëpamje dhe të veçantë në kuptimin që kërkonte me çdo kusht të kishte dhe individualitetin përkatës që do ta dallonte nga etruskët, sabinët, umbrët e popullsi të tjera që kufizoheshin e kontaktonin me bërthamën që më tej do të quhej Romë e që do të përbënte më të rëndësishmin organizim qytetar e politik të zonës së Latiumit.

Propozimi i vazhdueshëm për të studiuar gjuhën latine në nivele universitare dhe pasuniversitare vjen para së gjithash për një arsye të qëndrueshme: rëndësia e studimit të një gjuhe klasike së cilës ky atribut i qëndron më së miri dhe në ditët e sotme për vetë civilizimin dhe hapësirën e gjerë kohore që mbështet me vlera jo thjesht gjuhësore. Roma- caput mundi, e ashtuquajtura *Urbs par excellence*, mbetet dhe sot e kësaj dite

qyteti që përfaqëson dhe evokon vatrën në të cilën u formësua një bërthamë qytetërimi mjaft domethënëse për Evropën dhe Perëndimin.

Nëpërmjet kësaj trajtëse arrihet të qëmtohet në mënyrë të thukët, por jo rastësore një sistem i tërë vlerash dhe elementesh parësore që cek jo vetëm fonetikën e fonologjinë, historinë e alfabetit latin dhe elementet që dëshmojnë influksin e kulturave kufitare më domethënëse të asaj kohe, morfologjinë e pjesët e ligjëratës, por dhe çështje të ndërtimit të frazës, të brendësimit të tekstit në gjuhën latine, kryesisht në përbërje thëniesh proverbiale e sentencash që u përkasin fushave ligjërimore e regjistrave që kanë të bëjnë me jurisprudencën, të drejtën romake, mënyrën e jetesës, konceptimin e të drejtave të individit në shoqërinë romake etj.

Modus vivendi dhe estetika e jetës në këtë shoqëri, statusi familjar dhe impostimi i individit në një kontekst sa social aq dhe politik, marrëdhëniet me fuqitë e kohës dhe ndikimet e pritshme në fushë të civilizimit, format e shfaqjes së gjinive të shkrimit përfshirë epistolografinë dhe letërsinë e shkruar, përpilimi i veprave më domethënëse në këtë letërsi, personalitete autorësh që njëkohësisht përfaqësojnë dhe oratorët e avokatët modelë të kohës, zhvillime politike që u pasqyruan me vepra të veçanta në prozën latine, mbeten me të drejtë objekt trajtimi dhe ndërmendjeje nga një moment në tjetrin.

Të tillë autorë janë Cezari, Ciceroni, Salusti, Virgjili, Ovidi, Seneka. Secili kontribuon në pikëpamje të natyrës së veprës së vet, gjuhës dhe gjinisë përkatëse të shkrimit, secili përfaqëson dhe një gjurmë të pashlyer në një histori unike siç është ajo e Romës së vjetër. Mund të mos jenë krejt të largët mes tyre të tillë autorë, por siç ka raste të përkimit të qartë gjuhësor e kryesisht në pikëpamje të morfologjisë e sintaksës, aq ka dhe shfaqje diversiteti sidomos nëse ndonjë autor ka zgjedhur të ketë pjesë të shkrimtarisë së vet përftesa dhe trajta që evokojnë momente më të hershme të evolucionit të kësaj gjuhe (rasti i Salustit dhe i përdorimeve të veçanta që mbartin tipare të qarta të një faze më arkaike në gjuhën latine).

Jul Cezari mbetet autori i kronikave të shkruara një një prozë të thukët e të kuptueshme për këdo që ndërmerr hapat e parë, por të rëndësishëm në studimin e gjuhës latine. Promovues i mjaft përftësive të një leksiku të veçantë siç është ai ushtarak, përshkruar i jetës dhe zakoneve të popullsisë të Galisë në shekullin e parë para Krishtit, një vend me një konglomerat popullsisë dhe përjetimesh zakonore, por dhe përjetues i një momenti crucial në historinë e qytetit të Romës si lufta civile dhe ndeshja me kolegun e rivalin e tij, Pompeun, e kanë bërë Jul Cezarin një autor sa të trajtuar, aq dhe të lexuar dhe në variante të përkthyer në disa gjuhë, përfshirë gjuhën tonë. Me Jul Cezarin ngulitet një model i burrit të shtetit

që ndërmerr një sërë iniciativash që do të ndikojnë fuqishëm në jetën e senatit romak, në modelin institucional ekzistues, në administrimin e hallkave shtetërore të kohës, por dhe të vetë qytetit dhe kategorive shoqërore të këtij organizimi aq të rëndësishëm për kohën. Me vdekjen tragjike të tij (v.44 para Krishtit) tronditen një sërë ekuilibrash kryesisht politikë, do të largohen prej scene dhe personazhe të tjera, përfshirë Mark Tul Ciceronin, por i hapet udhë afrimit dhe fuqizimit të një pasardhësi (Oktaviani) që do të projektojë një model administrimi të quajtur *imperium*, një individ që do të lërë gjurmë në një sërë fushash themelore: administratë, senat, ushtri, letërsi e kulturë, demografi, veprimtari fetare etj.

Periudha e Augustit shënohet ndër të tjera me dëshmi letrare që do të kenë për autorë të ashtuquajturit autorë të periudhës augustiane, ndër të cilët dhe Virgjilin, përpiluesin e Eneidës, poemës-epope që dhe sot e kësaj dite përfaqëson një prej veprave më të trajtuara e të diskutuara në programet liceale dhe universitare të letërsisë latine. Filologjia dhe studimet mbi tekstin gjejnë pa dyshim fusha gjurmimi në pikëpamje të kompaktësisë përmbajtësore dhe tekstore të pjesëve të caktuara të kësaj poeme, ashtu si dhe historianë të antikitetit do të gjurmojnë vise dhe pika të caktuara të rëndësishme për gjeografinë e periudhave më të hershme në kohë. Shqipërimet më të arrira të pjesëve të kësaj poeme do t'i gjejnë të radhitura në faqet e *Hyllit të Dritës*, por dhe në revistën *Leka*, në dekada të gjysmës së parë të shekullit të kaluar, pajisur me aparat kritik të domosdoshëm për brendësimin përmbajtësor të elementeve themelore të brendisë së këtyre pjesëve dhe me një gjuhë të papërsëritshme në shumë pikëpamje, kryesisht në pikëpamje përkthimtare dhe të pasqyrimin të pasurisë gjuhësore të shqipes.

Autorët latinë më të studiuar gjinden të reflektuar në mjaft glosarë dhe fjalorë të përmasave të mëdha në pikëpamje të leksikut dhe të përdorimeve themelore që ndërtojnë një korpus të rëndësishëm që ka të bëjë me latinishten klasike dhe që përbën një pikënisje të mirë dhe për studimin e periudhave të mëvona që reflektojnë relike, por dhe elemente të qëndrueshme të kësaj faze mjaft të gjurmuar në studimet mbi historinë e gjuhës dhe të letërsisë latine. Të tillë fjalorë e korpuse, me cilësinë e mjeteve didaktike të një rëndësie të veçantë i njeh dhe i mbështet dhe tradita përkatëse mbi këto botime në studimet tona shqiptare, argument ky që do ketë vëmendjen tonë dhe më poshtë.

Një formim i qëndrueshëm në elemente bazike që kanë të bëjnë me njohjen e fonologjisë, sistemit të zanoreve, diftongjeve e bashkëtingëlloreve në gjuhën latine, historinë e alfabetit latin në pikëpamje të një modeli sa të përshtatur, aq dhe të personalizuar sa i takon gjuhës

latine, reflektimin e një sërë përftesash në fushë të epigrafisë latine, morfologjinë e pjesëve të ligjëratisë dhe reflektimin e saj në konceptet e sintaksës së fjalisë e asaj të periudhës, njohja e mirë e një sërë regjistrash dhe e një sërë autorësh që me gjuhën dhe shkrimtarinë e tyre formësuan një ngrehinë lapidare në fushë të klasicitetit latin, duke u bërë modeli dhe burimi i referimit për mjaft thënie, mësimet jete e pedagogjike, momente historike e gjithashtu politike ndihmon përherë studentët dhe studiuesit e ardhshëm në administrimin e një kulture filologjike dhe letrare, në aftësinë për të interpretuar origjinën dhe historinë e evoluimit semantik e kuptimor të mjaft fjalëve dhe rrugën e depërtimit dhe në leksikun e gjuhës sonë shqipe.

Etërit françeskanë të Provincës së Zojës Nunciatë radhiten ndër kontribuesit kryesorë në pasqyrimin dhe nënvizimin e rëndësisë së kësaj kulture, veçanërisht me punime të shqipëruara apo të përpiluara në vazhdë të një procesi që kishte për objektiv qendror promovimin e elementeve themelore të kulturës dhe qytetërimit evropian, sidomos atyre elementeve që të shpinin dhe në një lidhje të natyrshme me krishtërimin dhe historinë e tij.

Do të përmendim këtu Atë Donat Kurtin O.F.M., Atë Viktor Volajn O.F.M., Atë Justin Rrotën O.F.M., Atë Benedikt Demën O.F.M., të cilët me punime të përmasave të ndryshme kontribuan në shqipërime gramatikash, sintaksash të gjuhës latine, të historisë së kulturës klasike e sidomos të Romës së vjetër. Puna e gjithsecilit prej tyre mbetet pasqyrë e një objektivi të qartë për të kontribuar në drejtim të formimit të individit dhe të një shoqërie të pajisur me elementet e një arsimimi sa themelor, aq dhe të përshtatshëm në pikëpamje kulturore. Përpilimet e shqipërimit që mbajnë autorësinë e tyre reflektojnë njëkohësisht dhe individualitetin në pikëpamje të formimit përkatës dhe të personalitetit prej studiuesi që gjithsecili e pasqyron në përmbajtjen dhe specifikën e veprës së ndërmarrë.

Kultura latine pati një impakt të veçantë në botimet tona e në këtë pikëpamje do të duhej të përmendnim një sërë kontribuesh që dhe sot e kësaj dite mbeten elemente me rëndësi dhe sa i përket gramatologjisë latine e pasqyrimin të saj në pikëpamje konceptesh e nocionesh të reflektuara në gjuhën tonë. Kontributi i etërve françeskanë dhe i etërve jezuitë të Shkodrës nuk mbetet asnjëherë i rastësishëm në këtë pikëpamje dhe duhet nënvizuar në këtë rast dhe fakti që ka lënë gjurmë të pashlyera dhe në pikëpamje të terminologjisë përkatëse që lidhet me disa nënsisteme dhe që reflektohet dhe sot e kësaj dite në disiplina të rëndësishme të dijes gjuhësore dhe asaj fonologjike e morfologjike në veçanti.

Tradita përkatëse e kësaj linje gjurmimesh përfaqësohet dhe nga dicionarë që janë gjithashtu pjesë e pandarë e gjithë kësaj ndërmarrjeje. Kolana të veçanta punimesh e metodash që akoma mund të bëhen objekt qasjeje si me arritjet e atëhershme, si me realizimet e sotme në fushë të gramatologjisë latine dhe reflektimit të brendësimit të qytetërimit përkatës nëpërmjet studimit të saj janë vepra të veçanta në pikëpamje të arritjes së realizimit të tyre dhe mjaft me interes nëse vlerësojmë para së gjithash prirjen ndërdisiplinore që i shërben njëherësh edukimit me dije nga disa fusha dhe gjithashtu dhe ngulitjen e koncepteve bazike në drejtim të një formimi të shëndoshë gjuhësor e filologjik.

Përvetësimi i leksikut themelor të gjuhës latine është prirje e qartë në përmbajtjen e këtyre metodave, qoftë dhe kur bëhet fjalë për shpjegime e shtjellime që lidhen me sintaksën latine, aspak të lehtë nëse kemi parasysh si ngërthehen çështje të reksionit rasor dhe semantikës së foljeve të caktuara latine, veçantia e të cilave dhe në pikëpamje të diatezës ofron patjetër një fushë të pamatë qasjesh dhe diskutimesh për gramatologët dhe studiuesit e morfologjisë teorike në përgjithësi.

Të tilla qasje bëjnë të mundur të nënvizohet si uniciteti i klasave të caktuara në një konceptim aq të veçantë dhe kompleks siç është gjuha latine, ashtu dhe përkimet e paevitueshme dhe krejt të kuptueshme nëse bëhet fjalë për përballje nocionesh dhe nënsistemesh mes dy gjuhësh me një prejardhje të qartë të përbashkët që shënohet nga tipare themelore të familjes gjuhësore indoevropiane. Dhe pse në pikëpamje dokumentimi shkrimor dhe në atë të historisë së shkrimit këto dy gjuhë diferencohen në kronologji, qasja mes tyre ofron patjetër të dhëna me rëndësi që mbështesin fuqishëm dhe disiplina që kanë lindur dhe janë ushqyer me këto burime dhe elemente krahasimi.

Një fakt i tillë u vu në përdorim dhe në rastin e përpilimit të gramatikave latine të viteve '20 të shekullit të kaluar, gjithashtu dhe në fjalorët dygjuhësh që në pamje të parë duket se do t'i shërbejnë një destinacioni thjesht shkollor e liceal. Ndër të tjera, falë këtyre botimeve, merr një tjetër vlerë dhe gjurmimi i elementeve latine në gjuhën tonë, sidomos nëse bëhet e mundur dhe një evidentim i tyre në pikëpamje fushash semantike dhe klasash kuptimore të caktuara. Të para në një vështrim kompleks që konsideron së pari faktin që të tilla përpilime kishin për qëllim të funksiononin brenda një sistemi brendësimi didaktik dhe shkencor, të tilla realizime vijojnë të mbeten unike në pikëpamje të kohës në të cilat panë dritën e shtypit.

Mund të konsiderohet një ndërmarrje e tillë dhe në kuadër të përpjekjeve të vijueshme për të promovuar kulturën latine dhe neolatine në

shkollat tona, korpusin e fuqishëm kulturor që ofron njohja e këtyre gjuhëve dhe horizontin e gjerë që natyrshëm zhvillohet në pikëpamje të studimit të gjuhëve të huaja.

Gjithsesi, dhe në rastet kur botimet në gjuhën tonë kanë qenë në parim thjesht shqipërime, nuk ka munguar prirja nga ana e përkthyesit të plotësojë në drejtim të dukurive që duheshin vënë në dukje në pikëpamje përkimi apo diversiteti. Ky fakt mbështetëj mirë nga formimi i shëndoshë filologjik dhe profesional i shqipëruesit, kompetent i plotë në fushë të drejtimit dhe miradministrimit të procesit të përshtatjes dhe përpilimit të doracakut në fjalë. Gjuha e përdorur nga shqipëruesi dëshmon në çdo rast pothuajse një shkallë të mirë njohjeje të përmbajtjes, por dhe të terminologjisë që hyn në lojë e duhet përdorur me saktësi në të tilla ndërmarrje. Kjo vihet re si në rastin kur në provë shqipërimi vihen manuale të mirëfillta gramatike të gjuhës latine, ashtu dhe në rastin kur duhen përshtatur për nivele shkollore dhe njohuri nga fusha e civilizimit apo e antikitetit romak.¹

Në pikëpamje të historisë së shkrimit dhe përvijimit të traditës leksikografike në gjuhën tonë, të tillë fjalorë vijnë natyrshëm çka inicioi Frang Bardhi me botimin e Dicionarit të tij në vitin 1635, duke shënuar një arritje domethënëse për letërsinë e shkruar shqipe dhe për historinë e dokumentimit shkrimor në gjuhën tonë. Dhe pse të ndryshme si iniciativa, dhe pse më afër një destinacioni të pastër shkollor, këto botime ruajnë pa dyshim një lidhje të pazgjidhshme me objektivin e qartë që patën dhe përpiluesit e veprave themelore të letërsisë së vjetër shqipe, të cilët promovuan njëkohësisht dhe kulturën e shkrimit në gjuhën tonë, pa lënë mënjana reflektimin në formimin përkatës me elemente të rëndësishme të trashëgimisë latine dhe latino-romane.

Një linjë e rëndësishme mbetet ajo e sipërpërmendura e që ka të bëjë me elementet latine në gjuhën shqipe, një komponent i përfillshëm që qe shtysë dhe për përpilime studimesh që kanë objekt të tyrin klasifikimin e këtyre elementeve; shtresëzimin kronologjik të depërtimit të tyre në gjuhën tonë; proceset fonologjike që përfshinë një pjesë të mirë të tyre; fushat semantike që ato shënojnë dhe sot e kësaj dite; praninë e tyre dhe në gjuhën e veprave të letërsisë së vjetër shqipe. Këtij argumenti i kanë kushtuar sprovat studimore gjuhëtarë, si: Bariç, Meyer, Mihaescu, Bonnet, J.Rrota, E.Çabej, M.Camaj, G.B.Pellegrini, R.Ismajli, Sh.Demiraj, K.Topalli, S.Mansaku, D.Luka etj.

⁵ *Njohuni mbi kulturën klasike të Rromakvet për klasën II e III të kursit të naltë, punue shqyp prej A.Viktor Volaj mbas Dr.Prof.N.Bianchi e S.Sciuto, Shtypshkroja "A.Gj.Fishta", Shkodër, 1941.*

Shkalla e përfshirjes së këtij argumenti ndryshon dhe sipas natyrës dhe objektit të veprës së ndërmarrë. Një studim që u kushtohet plotësisht elementeve latine në gjuhën shqipe dhe që është botuar dhe në variante të shkruara në gjuhë të huaj e mbi të gjitha mjaft i plotë në pikëpamje të shtrirjes së problematikës dhe të klasifikimit përkatës të këtyre elementeve mbetet ai i Eqrem Çabejt, botuar në revistat tona në vitet '70 të shekullit të kaluar (i referohemi në veçanti artikullit të botuar në revistën *Studime filologjike*, n.2, 1974 dhe që u kushtohet karakteristikave të huazimeve latine në shqipe).²

Eqrem Çabej u kushton një vëmendje permanente elementeve latine në gjuhën shqipe dhe në studimet etimologjike që janë botuar në vëllime të posaçme e që pasqyrojnë një pjesë të rëndësishme të veprimtarisë së tij studimore shkencore. Do të gjurmohen kësaj trajtesa në të cilat nga ana e Çabejt mbështetet qartë prejardhje latine e një fjale të caktuar, krahas mendimeve që e paraqesin të diskutueshme etimologjinë e ndonjë fjale tjetër, qoftë sa i përket faktit të prejardhjes jo të qartë të një fjale, qoftë dhe faktit që në gjuhëtarë të ndryshëm mbështetet herë origjina latine, herë origjina romane e një fjale. Vetë metoda e hulumtimit dhe e parashtrimit të Eqrem Çabejt ndihmon natyrshëm në sqarimin e ndjekjes së historisë së fjalëve të caktuara, një pjesë e mirë e të cilave trajtohen gjithashtu dhe në punime të tjera më të thukëta, përfshirë atë me titull *Shumësi i singularizuar në shqipe*.³

Në trajtesat e Martin Camajt do të gjurmojmë evidentime elementesh që kanë të bëjnë kryesisht me një kategori më specifike elementesh latine dhe që i përkasin një regjistri të veçantë, atij të liturgjisë. Në punimin e mirënjohur me titull *Il Messale di Gjon Buzuku, contributi linguistici allo studio della genesi*, Romë, 1960, këtyre elementeve specifike u kushtohen kërërë dhe radhë të caktuara, duke u trajtuar dhe në pikëpamje të kronologjisë së depërtimit në gjuhën e liturgjisë.⁸

Me të drejtë përfshirja e argumentit të trajtimit të elementeve latine në shqipe gjen vend në punime mbi historinë e gjuhës shqipe nga Shaban Demiraj. Në një vepër kaq të rëndësishme për studimet tona (*Gjuha shqipe*

⁶ Gjurmimet e Eqrem Çabejt në lidhje me këtë argument janë më të hershme, nëse u referohemi dhe artikujve të botuar në gjuhë të huaj në vitet '60 të shekullit të kaluar, ndër të cilët ai i botuar në vitin 1962 në *Revue roumaine de linguistique* 7:161-199.

⁷ Çabej E., *Shumësi i singularizuar në gjuhën shqipe*, Botime Çabej, Tiranë, 2013.

⁸ Camaj M., *Il Messale di Gjon Buzuku, contributi linguistici allo studio della genesi, Shënjzat*, Romë, 1960, f.54: *Però anche prima di Buzuku, giudicando dalla forma albanesizzata di alcuni vocaboli, questa lingua aveva già mutuato dal latino quasi tutta la terminologia liturgica, come p.es. meshë – missa, hostja – hostia, sakramend – sacramentum, peendohem – poenitet me, shëlbues – salvator ecc.*

dhe historia e saj), këto elemente rimerren së bashkë me kontekstin historik që shoqëron dhe romanizimin e Ballkanit dhe ky mbetet në fakt një komponent i rëndësishëm për këdo që ndërmerr një studim të plotë dhe gjithëpërfshirës mbi gjithë procesin që bëri të mundur dhe depërtimin e elementeve gjuhësore dhe kulturore në vetëdijen tonë gjuhësore.⁵

Të tilla studime bëjnë të mundur dhe reflektime mbi pasqyrimin e tipologjisë së klasave të caktuara të fjalëve të gjuhën tonë, gjithashtu dhe lashtësinë e ndërtimit të shkëmbimeve mes popujve dhe gjithashtu veçantinë që elemente të caktuara ruajnë në përbërje të tyre, duke u dëshmuar të ndryshme nga gjegjëset në gjuhë të tjera romane, sidomos nga rumanishtja.⁶ Veçanti të tilla vlejné dhe për elemente të cilave nuk u njihet apo dëshmohet trajta origjinare në gjuhën latine.

Në shumë pikëpamje, jo vetëm në atë të përqasjes së vijueshme në disa nënsisteme e karakteristikave konstitutive të të dyja gjuhëve, por dhe reflektimi permanent në drejtime të ngjashme mbi disa elemente të tyre bën të mundur të dalë qartë interesi i gjallë që paraqet për breza të tërë studiuesish brendësimi i gjuhës dhe i kulturës latine.

⁹ Shih Demiraj Sh., *Elementet e huaja që shqipja i ka trashëguar nga “nëna” e saj*, në *Gjuha shqipe dhe historia e saj*, (botim i dytë i ripunuar), Botime Onufri, Tiranë, 2013.

¹⁰ Janë bërë kësajsoj objekt dhe emra të cilët ruajnë qartë lidhjen me një klasë të caktuar morfologjike në gjuhën latine, por më tej i janë nënshtruar një tjetër procesi modifikimi në shqipe, duke pësuar dhe ndërrim gjinie në një fazë të mëvonë të evolucionit të gjuhës shqipe. Emra të tillë, zakonisht në gjininë femërore në tekstet e letërsisë së vjetër shqipe, përdoren sot e kësaj dite si mashkullorë.

BIBLIOGRAFI

- Barbieri G., *Leggere oggi gli autori latini*, Loescher editore, Torino, 1995.
- Benedetti M., *I composti radicali latini. Esame storico e comparativo*, në *Orientamenti linguistici*, n.22, Pisa, 1988.
- Bettini M., *Tempora et mores (tradurre il latino per capire i latini)*, La Nuova Italia, Milano 2002.
- Bonnet G., *Les mots latins de l'albanais*, L'Harmattan, 2000.
- Bruno M.G., *Il lessico agricolo latino e le sue continuazioni romanze*, Istituto Lombardo di Scienze, Milano, 1958.
- Bruno M.G., *Il lessico agricolo latino(seconda edizione)*, Adolf Hakkert publisher, Amsterdam, 1969.
- Camaj M., *Il Messale di Gjon Buzuku, contributi linguistici allo studio della genesi*, në *Shêjzat*, Romë, 1960.
- Carcopino J., *La vita quotidiana a Roma*, Laterza, Bari, 2003.
- Collart J., *Histoire de la langue latine*, Paris, 1967.
- Chantraine P., *Études sur le vocabulaire grec*, Paris, 1956.
- Çabej E., *Karakteristikat e huazimeve latine të gjuhës shqipe*, në *Studime filologjike*, n.2, 1974.
- Çabej E., *Studime shqiptare. Vepra të zgjedhura*, ASHAK, Prishtinë, 2008.
- Çabej E., *Diana dhe Zana (studime kulturhistorike)*, Botime Çabej, Tiranë, 2011.
- Çabej E., *Fonetikë historike e gjuhës shqipe*, Botime Çabej, Tiranë, 2012.
- Çabej E., *Shumësi i singularizuar në gjuhën shqipe*, Botime Çabej, Tiranë, 2013.
- Danesi G., *Guida alla lingua latina*, Carocci, Romë, 2008.
- De Meo C., *Lingue tecniche del latino, Testi e manuali per l'insegnamento universitario del latino*, Pàtron editore, Bologna, 1983.
- Demiraj Sh., *Fonologjia historike e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1996.
- Demiraj Sh., *Gjuha shqipe dhe historia e saj, (botim i dytë i ripunuar)*, Botime Onufri, Tiranë, 2013.
- De Prisco A., *Il latino tardoantico e altomedievale*, Jouvence, Romë, 1991.
- Devoto G., *Storia della lingua di Roma*, Bologna, 1983.
- Di Tillio Z., *Latinitatis palaestra*, Casa editrice Vestigium, 1997.
- Durante M., *Dal latino all'italiano moderno. Saggio di storia linguistica e culturale*, Zanichelli, Bologna, 1982.
- Eck W., *Augusto e il suo tempo*, Il Mulino, Bologna, 2010.
- Ernout A., *Morphologie historique du latin*, Éditions Klincksieck, Paris, 1974.
- Famerie É., Bodson A., Dubuisson M., *Méthode de langue latine*, Armand Colin, 2007.
- Flocchini N., Moscio M., Guidotti Bacci P., *Nuovo comprendere e tradurre*, Bompiani, Milano, 2003.
- Hofmann J.B., Szantyr A., *Stilistica latina (a cura di A.Traina)*, Pàtron, Bologna, 2002.
- Grandi N., *Fondamenti di tipologia linguistica*, Carocci, Romë, 2006.
- Heather P., *La caduta dell'impero romano(una nuova storia)*, Garzanti, Milano, 2008.
- La Penna A., *Sallustio e la "rivoluzione romana"*, Milano, 1968.
- La Penna A., *Epos e civiltà del mondo antico*, Loescher editore, Torino, 1990.

- Landi A., *Gli elementi latini nella lingua albanese*, Edizioni scientifiche italiane, Napoli, 1989.
- Lehmann W., *La linguistica indoeuropea*, Il Mulino, Bologna, 1999.
- Löfstedt E., *Il latino tardo*, Paideia editrice, Brescia, 1980.
- Mazzarino S., *Il pensiero storico classico*, Bari, 1966.
- Meillet A., *Lineamenti di storia della lingua greca*, Einaudi editore, Torino, 2003.
- Mihaescu H., *Linguistika dhe etnogjeneza e shqiptarëve*, nw *Studime filologjike*, n.3, 1982.
- Mihaescu H., *La romanité dans le Sud-Est de l'Europe*, București, Editura Academiei Române, 1993.
- Milizia P., *Le lingue indoeuropee*, Carocci, Romë, 2008.
- Monteuil P., *Éléments de phonétique et de morphologie du latin*, Dijon, 1979.
- Mori E., *Dizionario dei termini giuridici e dei brocardi latini*, CELT, Piacenza, 2008.
- Ogilvie R.M., *Le origini di Roma*, Il Mulino, Bologna, 1995.
- Oniga R., *Il latino, breve introduzione linguistica*, Franco Angeli, Milano, 2007.
- Pieri M.P., *La didattica del latino (Perché e come studiare lingua e civiltà dei Romani)*, Carocci, Roma, 2005.
- Palmer L.R. *La lingua latina*, Einaudi, Torino, 2002.
- Poccetti P., Poli D., Santini C., *Una storia della lingua latina*, Carocci, Roma, 2003.
- Polara G., *Letteratura latina tardoantica e altomedievale (con bibliografia di A.De Prisco)*, Jouvence, 1987.
- Porzio Gernia M.L., *Introduzione alla teoria dell'indoeuropeo*, Torino, 1978.
- Ramat P., Anna Giacalone, *Le lingue indoeuropee*, il Mulino, Bologna, 1996.
- Riganti E., *Lessico latino fondamentale*, Pátron editore, Bologna, 1989.
- Rrota J., *Sintaksi i shqipes*, Botime françeskane, Shkodër, 2005.
- Rrota J., *Gjuha e shkrueme ase vërejtje gramatikore*, Botime Françeskane, Shkodër, 2006.
- Scivoletto N., *Istituzioni della lingua latina*, Calzetti Mariucci editori, Perugia, 2001.
- Scheindler A., *Sintaksi i gjuhës latine, punue mbas gjermanishtjet prej P.Donat Kurtit O.F.M.*, Shtypshkroja Françeskane, Shkodër, 1940.
- Schlösser R., *Le lingue romanze*, Il Mulino, 2005.
- Schultz F., *Ushtrimet e gramatikës latine, Pjesa I, Fonologji e morfologji*, (Prof.K.Gurakuqi), Tiranë, 1938.
- Sergent B., *Les Indo-Européens. Histoire, langues, mythes*, Paris, 1995.
- Spinosa A., *Cesare, il grande giocatore*, Le Scie, Mondadori Editore, Milano, 1986.
- Spinosa A., *Augusto, il grande baro*, Mondadori Editore, Milano, 1996.
- Stolz F., Debrunner A., Schmid W.P., *Storia della lingua latina*, Pátron, Bologna, 1993.
- Strecker K., *Introduction a l'étude du latin médiéval, (troisième édition revue et augmentée)*, Genève, 1948.

- Szemerényi O., *Introduzione alla linguistica indoeuropea*, Edizioni Unicopli, Milano, 1985.
- Tagliavini C., *Fonetica e morfologia storica del latino*, Bologna, 1962.
- Tokarski G., *Dizionario indoeuropeo della lingua latina*, LAS-Roma, 2016.
- Traglia A., *La flessione verbale latina. Trattato di morfologia storica*, Torino, 1949.
- Traina A., Perini G.B., *Propedeutica al latino universitario*, Pàtron, Bologna, 1972.
- Väänänen V., *Introduzione al latino volgare*, Pàtron, Bologna, 1971.
- Varvaro A., *Linguistica romanza*, Liguori editore, Napoli 2001.
- Viezzoli L. S.I., *Kah latinishtja*, Shkodër, 1942.
- Villar F., *Gli indoeuropei e le origini dell'Europa*, Il Mulino, Bologna, 2008.
- Vineis E., *Il latino*, Il Mulino, Bologna, 2005.

A Profound Study of the Institutional Elements of the Latin Language

ABSTRACT

Latin language has been and remains one of the most important training topics in terms of concepts that can be transmitted through the teaching of the fundamental elements of phonology, morphology, syntax and the lexicon that, among other things, remains the mirror of a connection not in the least casual between this language and other languages that were influenced in the flow of history and in the process of contacts between people since an early period. The influence of Latin language and culture is recognized and dealt with by a consistent tradition of studies, which touches as traces in the field of philology and romance and historical language, as well as many trials in albanology that have been subject to the characteristics of Latin borrowings in the Albanian language, the history of their penetration in it, and the related chronological strata. The Latin elements in the Albanian language have been treated occasionally by Albanian and foreign scholars, mainly by pointing to the semantic fields in which the influence is present, as well as the possible formal and phonological modifications of words that are identified as derived from this language. This argument remains among the treated ones even in the field of historical and comparative language research, given that the relevance of these elements to areas of interest for semantic studies makes it possible for the reflections to be scarce, especially when it comes

in even for the necessary approach that throw light in the interlingual relations in a Balkan and European context. Latin grammars and related vocabularies that accompanied the emergence of their press during the first decades of the last century are a living proof of interest in making the knowledge of Latin language and culture a part of a sound individual and scientific formation in Albanian schools of time.

Erzen KOPERAJ

A NDESHIM GJURMË TË PASKAJORES TE PJESORET NË LIDHJE ME FOLJET MODALE *DO, DUHET, MUND* (*DUHET SHKUOM, DO MARRË*)?

Përcaktimi i natyrës gramatikore të lidhjeve sintagmatike *duhet (do)* + *pjesore* është një prej çështjeve më të diskutueshme në lidhje me ekzistencën e një paskajoreje sintetike në gjuhën shqipe. Një përdorim i tillë *duhet* të jetë mjaft i hershëm pasi e ndeshim që tek shqipja e shkruar e shekujve XVI-XVII.

Buzuku. *Por ajo ditë ty të duhetë shkuom endë e dashunë Tenezonë.* (Meshari, II, f.61). Nga ana tjetër format më të përdorura te Buzuku janë ata me paskajoren *me baa*, psh...*e duoj atah me shkuom* (Meshari. XLII, f. 117).

Budi. *Duhetëjo veçëse fortqërtuom e dhanëpëndesënë po ashtu ende mbaajtunë praspjaa njërij..*(SC, f.41), por përkundrejt këtij rasti te Budi, këto forma janë të radha krahasuar me përdorimet me paskajoren analitike apo me lidhoren. Në veprat e këtij autori mbizotërojnë format: *...këtyne kafshëve gjithëherë u duhet me u gjetunë* (RR.f. 9); *...duhet me folë* (RR. f.15); *Duhet me qenë shërbyem e nderunë* (RR. f.46); *S' duhetë as me i kënduomas me i kallëzuom* (SC. 16); si dhe me lidhoren *...duo të thom* (RR. f.105).

Bogdani. *Prashtu saa ma rrenë aqa ma fort për gaz e përrallë duhetë mbajtunë qish thonë turitë se dragou po përpi hanënë.* (CP. I, f. 30. 4); *Po ende për shpirt do marrë vesht, ndër sa kje shenj o shemëlltyra e t'pëganëvet si ishin për të ardhunë mbë shejtet fe e ligj të Ungjillit*(CPI, f.62. 8); *...do me thanë se shejti kungim do marrë me dëshirë e uu, e jo për zakon e dokë* (CPI, f.66. 4); *E nuk duhetë prashtu kuj me ndym keq, përse e vërtetado dashunë e mbajtunë.* (CP.II, f.108).

Edhe te Bogdani mbizotërojnë format *duhet, do + me thanë*, psh: *Përse gjithë kafshësë për arrësye duhetë me i gjetunë të zan fill ndjerë mb'atë krye qi ma mbi vetëhe tjetër nuk ka.* (CP. I. f. 1. 2)

Kuvendi i Arbënit *...vingjilleja do mbajtunë sikuur asht urdhënuem prei Kishet e jo si (i) pëlqen grykësiesë mallkuome* (K.A, f.33. 15); *...të shukonjë në monë e të paadijesë, e para se t'apnë kui testiir, ndo esapin e rrefyësit -qi veç atyne qi janë për ta duhet dhanë.* f.46.26; *... sikundërse*

vendi, moti e koha, me urtije t' atyne qi vizitonjënë, prashu nde vizitimi qi duhet baam, ka me u bam kështu. (K.A, f.71. 6). Përballë këtyre tre rasteve që ndeshet do + pjesore, në mbarë veprën mbizotërojnë format e tilla *duhet me ndalë* 11. 6; *do me krezmuem* 44. 9; *duhet të thërrisënë* 110. 17 (edhe kjo formë duhet + lidhore ndeshet vetëm dy herë).

Kazazi. Kur *duhen baam* këto kafsh? (Doct. f.15. 15); *Ato tri të parat qi jen me shqyrëtuom vet'hen me u penduom fajesh e me permetuem me mos i baam kurraj, duhen baam, përpara se të ven me u rëfyem.* (Doct. f.15. 20). Te vepra e Kazazit vetëm këto dy raste shfaqen të tilla, pasi *duhet, do + paskajore me baam* del plot 27 herë, psh. Tek ky autor ndeshim edhe formën *do + formën e pashtjelluar për të marrë*. P.sh. e qish *duhet për tuu rëfyem mir.* (Doct. f.32. 11).

Variboba... *ea na mbëso si do shërbier,* (Gj. shën Mërisë virgj. vargu 3); ... *se ajo fare së duaj martuar,* (Gj. Sh. M. V. , v. 217); ... *ti vet e dii, sido mbësuar,* (Gj. Sh. M. V. , v. 217); ... *me bondat pëstaj si nj'ëm, nëng e do thën'e mira Zonjë...* (Gj. Sh. M. V. , v. 3962);

Ndërsa tek autorët e tjerë, Bardhi, Fr. Da Lecce, nuk gjejmë ndonjë rast të tillë, por pas foljeve të tillë ndeshim vetëm paskajoren (Bardhi: *Qish do me baam ndë atë pjesë dheu?* Dict. f. 218. 22-23; *ato kafshë gjì s'të kaanë hie a s të përkasënë, s duhetë me i dëshëruem.* f. 209. 26-28)

Përcaktimi i natyrës gramatikore të kësaj lidhjeje sintagmatike është një çështje që dukshëm lidhet me ekzistencën e një paskajoreje sintetike në gjuhën shqipe. Ky tog, siç u pa, ndeshet rallë si tek autorët e vjetër, ashtu dhe në mbarë shqipen, por duke e përngjasuar me togje me lidhje të tillë morfologjike në gjuhë të ndyshme indoevropiane, kjo pjesore ka vlerën e një paskajoreje.¹¹ Në ndërtime të tilla, disa gjuhëtarë kanë parë gjurmë të paskajores sintetike¹² të shqipes së lashtë. Ndërsa gjuhëtarë të tjerë kanë

¹¹ Duke e krahasuar me gjuhë të tjera indoevropiane që kanë paskajoren sintetike në sistemin e tyre foljor, në lidhjet e foljeve të tilla modale si *duhet, mund, do*, pas tyre vjen gjithnjë një formë e pashtjelluar paskajore.

¹² Në këtë grup studiuesish që mendojnë se në një faze të hershme të saj shqipja ka pasur një paskajore pa pjesëzën *me* hyjnë: Dh. Kamarda duhet të ketë qenë i pari gramatikan që ka hedhur mendimin për një paskajore sintetike në gjuhën shqipe, paskajore e cila duhej të kish dalë me prapashtesën trajtëformuese -me, duke cilësuar si të tilla format *puhëme, shkrueme, vume* (në *Saggio di grammatologia comparata sulla lingua Albanese*, 1864, f. 270). Këtë formant ai e krahason me formantin që krijonte këtë formë të pashtjelluar në greqishten e vjetër-*men*; H. Pedersen shih këto forma dhe *pa pasur* si mbijetime të mundshme të infinitivit të shqipes së përbashkët; A. Xanoni (në *Gramatika shqyp*, 1909, f. 165) shih një paskajore pa pjesëzën me në formimet *do + baa*; N. Jokli, në Litteris IV, mendon se gjymtyra e dytë tek togu *do bërë*, por edhe tek *pa bërë*, kanë qenë paskajore. Këtu ai përfshin edhe pjesoren brenda habitores të cilën për nga ndërtimi e gjykon si një të ardhme të përmbysur paskajore + kam. Mendimi i Joklit mbështetet

menduar se në togje të tilla do ecë, duhet bâ, etj. kemi të bëjmë vetëm me një pjesore të mirëfilltë ³ jo vetëm nga forma, por edhe nga funksioni. Arsyet se pse kemi të bëjmë me një pjesore dhe jo një paskajore në togjet e mësipërme kemi një parashtrim të tillë nga Sh. Demiraj që në shembujt do+ pjesore, shihet qartë se tek gjymtyra e dytë kemi të bëjmë me një pjesore pasi:

1. te këto togfjalësha elementi i dytë, kur folja është kalimtare ka kuptim pësor, siç është vetë pjesorja e shqipes.
2. Kjo shihet qartë edhe në mospërdorimin e pjesëzës u të zgjedhimit jovepror, ashtu siç mund të bëhet me paskajoren analitike (duhet me u ba).

edhe nga K. Sandfeldi në *“Linguistique balkanique”* (f. 183); K. Kristoforidhi (*Gramatiquis tis Alvaniquis Glossis*, 1882, f. 130) në togun do kërkuar/ kërkue sheh një paskajore “të thjeshtë ose kryesisht paskajore”; Gj. Pekmezi (*Grammatik der albanesischen Sprache*, 1908, f. 78) mendon se trajta e shkurtër e pjesores brenda kohëve të përbëra të sistemit foljor të shqipes (dhe habitorja në veçanti) duhet të jenë forma të infinitivit të lashtë të shqipes, që duhet ta ketë pasur ashtu si shumica e gjuhëve simotra; A. Xhuvani (*Studime gjuhësore*, 1956, f. 257-261) dallon në ndërtimet duhet + marrë dhe do + marrë paskajoren e hershme sintetike të shqipes, duke menduar se paskajorja e shqipes duhet të ketë pasur trajtë të njëjtë me pjesoren, ashtu si në rumanishtje; S. Riza (në *Vepra të zgjedhura*, Tiranë 2009, f. 135-139, 435-437) thekson se “në shqipe infinitivi egziston edhe atëherë kur nuk gjindet i shoqnuem prej prepozicionit: me... nuk ka dyshim që trajta punue që na sod e njohim vetëm si particip do të ketë qenë në shqipen e lashtë vetëm infinitiv”. Ndërsa mbështet praninë e infinitivit në duhet punue / do punue, do gjetë, por edhe tek format e pashtjelluara analitike pa punue dhe tue punue, ai mbështet edhe mendimin e Joklit që tek habitorja kemi një paskajore dhe jo një pjesore, duke përforcuar mendimin se si paskajorja e shqipes ka dalë edhe funksionet e pjesores (në *Konferenca e Parë e Studimeve Albanologjike*, 1965, f. 357); M. Domi (*Morfologjia historike e shqipes*, 1967, f. 67) elementin e dytë tek togjet duhet shkue apo do bërë, e vlerëson si disa përdorime të tjera të pjesores që të bëjnë të mendosh për një paskajore. Pikërisht, trajta e paskajores së thjeshtë të lashtë duhet kërkuar në trajtat e sotshme të pjesores në ndërtime të tilla.

¹³ I. Bacinski (*L'infinitif et les moyens de son remplacement-Etude de syntaxe historique et compare*, Bucarest, 1946. f. 59, cituar nga B. Bokshi, *Pjesorja e shqipes*, 1998, f. 12), nuk pajtohet me N. Joklin për praninë e paskajores sintetike në gjuhën shqipe në togjet duhet folë, duhet dit, “nuk duhet të mashtrohemi nga përkthimi i këtyre lokucioneve me anë të infinitivit që është i vetmi i mundshëm në gjuhët që e kanë.... ato (duhet dit) janë vetëm pjesore që korrespondojnë plotësisht me ato që ka rumanishtja: trebuie arat, trebuie stiut”; H. Baric (*La perte de l'infinitif dans les langues balkaniques*, në *Godisnjak II*, 1961) mbron të njëjtin mendim; Sh. Demiraj (në *Rreth disa çështjeve të paskajores në gjuhën shqipe*, Stud. Filol. 1969. 1. f. 88-89, *Morfologjia historike e gjuhës shqipe*, II, 1976, f. 180, *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, 1986, f. 956) mendon se në këta togfjalësha, gjymtyra e dytë, kur folja është kalimtare, ka kuptim pësor, ashtu si pjesorja e shkuar; B. Bokshi (në *Pjesorja në gjuhën shqipe*, 1998, f. 118-123). Argumentet e dy autorëve të fundit i kemi parashtruar më sipër.

3. Gjithashtu, me ndërtimet e këtij tipi nuk mund të përdoret ndonjë kundrinor i drejtë i shprehur me anë të një emri, përemri, apo me anë të një forme të patheksuar të përemrave vetorë, siç do të ndodhte normalisht, po të ishte gjymtyra e dytë një paskajore.¹⁴

Por një argumentim i tillë nuk është i plotë, pasi tek autorët tanë të vjetër përdorimi i *duhet folë, do bam*, etj. me folje veprare nuk është i pandeshur. Pra, nuk mund të qëndrojë si një argumentim i pakundërshtueshëm mospërdorimi i këtyre togjeve me kundrinor të drejtë tek shembujt e mëposhtëm:

Te Budi. *Duhetë jo veçese fort qërtuom e dhanë pēndesēnē po ashtu ende mbaajtunē prasgjaa njërij...*(SC, f.41)

Te Bogdani... *ende gjithë vepëratë e fjalët e Krishtit ndë Ungjiillt mbii vështeri të kësaj jetë, duhetë lypunë vështerinë jetrësë jetë, me atë dritë të madhe e dy fijesh...*(CP. I, f.72); ... *do me thanë se shejti kungim do marrë me dëshirë e uu, e jo për zakon e dokë.* (CP. I, f. 66). Pikërisht, në tekstin italisht te Bogdani del me paskajore¹⁵. Edhe në disa të folme të kosovarishtes ndeshen ndërtime të tilla që tërheqin edhe kundrinor të drejtë¹⁶.

Gjymtyrën e dytë si një pjesore të mirëfilltë edhe në origjinë e mendon edhe B. Bokshi, i cili mendimin e tij e mbështet kryesisht mbi analizën e situatës sintaksore që ka krijuar një lidhje të tillë duhet + pjesore. Sipas Bokshit, “pjesorja u seleksionua vetëm nga folja modale që ishte në formën e diatezës pësore”, duke shpjeguar kështu se ishte pikërisht kjo formë pësore e foljes modale duhet faktori që bëri të mundur “relacionin me pjesoren për të krijuar një kallëzues modal”¹⁷. Pra folja modale duhet, si foljet modale në përgjithësi, ka sintaksë të ndryshme nga sintaksa kur funksionon si folje më vete me kuptim të plotë leksikor. Këto dy funksione

¹⁴ Lidhur me këtë shih Sh. Demiraj, *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1986, f. 956.

¹⁵ Në tekstin e Çetës së Profetëve, teksti në italisht jepet: “... *oltre il senso litterale semplice si deve cercare il senso spirituale...*”, po aty, f. 72, I/ 29-30.

¹⁶ Sh. Demiraj, *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1986, f. 956, në Shën. 63, ku Demiraj vë re përdorimin e togfjalëshit duhet ba edhe me një kundrinor të drejtë të shprehur nga një emër ose përemër, por jo edhe nga një trajtë e shkurtër e përemrave vetorë. Sipas Demirajt, këtu duhet të kemi të bëjmë me një risi të atyre të folmeve, që është në kundërshtim me tiparet gramatikore të të dyja pjesëve të këtij togfjalëshi.

¹⁷ B. Bokshi, *Pjesorja e shqipes*, Prishtinë, 1998, f. 122.

të ndryshme të së njëjtës folje sipas Bokshit duhet të interpretohen si folje të ndryshme homonimike. Megjithëse, të gjithë studiuesit lidhjen sintaksore të foljes me kuptim modal gjysmëndihmës *duhet thënë* e shohin si të përfutur nga relacioni i *duhet* si kallëzues me kuptim të plotë leksikor dhe i pjesores *thënë* si kundrinor a kryefjalë¹⁸, Bokshi vë re se mosndryshimi i kuptimit diatetik të pjesores tregon se në këtë rast nuk kemi të bëjmë me nominalizimin e saj, pasi ashtu do të ishte përfutur kuptimii një emri të veprimit. “Në përfuturim e kallëzuesit modal të tipit *duhet larë/la*, nuk mund të kemi pasur as nominalizim infinitival, i cili po ashtu do ta kishte kuptimin e diatezës veprorë”¹⁹. Skema e Bokshit për krijimin do + thënë, mbështetet në reduktimin e një fjalie lidhore në një pjesore, ku pjesorja nuk ishte në funksion të kryefjalës, por epitet i saj. 1. Shtëpia / që është pastruar / duhet. 2. Shtëpia pastruar / duhet. 3. Shtëpia /duhet pastruar.

Por mendimi i Bokshit, nuk del plotësisht bindës po të kemi parasysh përdorimet e mësipërme *duhet qërtuom e dhanë pendesenë*²⁰, po ashtu dhe togjet *duhet pastruar* është i barasvlershëm me formën gege me paskajore *duhet me u pastrue*, apo dhe vetë forma e ngurosur e mbarë shqipes *do me thënë*, të cilat sipas Bokshit duhet të jenë formuar edhe këto në këtë mënyrë. Por, po të formohej forma e pashtjelluar *me pastrue* nga “epitetizmi i pjesores atributive, duke nënkuptuar emrin ndaj të cilit ishte epitet apo përcaktor predikativ”²¹ do të nënkuptonte që togu parafjalë *me + pjesore* të shkonte drejt të njëjtave lidhje sintaksore si togu parafjalë *me + emër*. Diçka e tillë nuk ka ndodhur, madje përsa i përket funksioneve sintaksore këto dy sintagma janë shumë larg njëra - tjetrës²². Për më tepër karakteri pësor nuk duhet kërkuar vetëm tek pjesorja. Kategoria e diatezës është qartësisht e dallueshme tek paskajorja jo vetëm në shqipe, por edhe në

¹⁸ Sh. Demiraj, *Gramatikë historike*, Tiranë, 1986, f. 830, ku studiuesi i njohur e jep togun do thënë si istorikisht të zberthyeshme në dy gjymtyrë të një togfjalëshi me marrëdhënie kundrinore, por që me kalimin e kohës kuptimi leksikor i foljes dua ka ardhur duke u zbehur, derisa ajo është shndërruar më në fund në një mjet gramatikor, gjë që ka rezultuar në krijimin e formës së ngurosur do përsa i takon vetës së dytë dhe të tretë të njëjësit.

¹⁹ B. Bokshi, *Pjesorja e shqipes*, Prishtinë, 1998, f. 123

²⁰ Budi në SC, f. 41 dhe te Bogdani në CP, I, 72/16.

²¹ B. Bokshi, *Pjesorja e shqipes*, Prishtinë, 1998, f. 140

²² Lidhur me këtë shih funksionet sintaksore të paskajores në kapitullin mbi paskajoren.

gjuhët e tjera indoevropiane ²³. Por edhe kalimi nga *shtëpia/që është pastruar/ duhet* në lidhjen sintaksore *shtëpia duhet pastruar*, është e vështirë të ndodhë në gjuhë me karakter sintetik si shqipja, me një rend përgjithësisht të lirë në fjali. Një dukuri e tillë mund të ndodhte në gjuhët analitike, ndërsa në ato gjuhë ku mbizotëron karakteri sintetik ka shumë më pak mundësi ²⁴.

Mendimin më të mbështetur e sjell S. Mansaku ²⁵ që për natyrën morfologjike të gjymtyrës së varur në togjet *duhet punuar, do parë* etj., “një gjë është e sigurt që, cilado qoftë origjina e saj, ky përdorim hyn në sferën e përdorimeve të paskajores, jo të pjesores. Fakti që këto ndërtime gjenden që te Buzuku, tregon se janë relativisht të vjetra, por nuk provon domosdo që paskajorja dikur ka qenë pa pjesëzën *me*” ²⁶.

BIBLIOGRAFI:

- AGALLIU, Fatmir, *Pjesorja në gjuhën shqipe*. Studime Filologjike, nr. 2, 1972.
- ÇELIKU, Mehmet, *Statusi sintaksor i formave të pashtjelluara dhe i ndërtimeve të formuara me to*. Studime Filologjike, nr. 3-4, 1999.
- BOKSHI, Besim, *Pjesorja e shqipes* (vështrim diakronik). Prishtinë, 1998.
- BOKSHI, Besim, *Periodizimi i ndryshimeve mofonologjike të gjuhës shqipe*, Prishtinë, 2010.
- DEMIRAJ, Shaban, *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*. Tiranë, 1986.
- DEMIRAJ, Shaban, *Rreth disa problemeve të paskajores në gjuhën shqipe*. Studime Filologjike, nr. 1, 1969.
- DEMIRAJ, Shaban, *Rreth formave të së ardhmes në gjuhën shqipe*. Studime Filologjike, nr. 3, 1970.
- FIEDLER, Winfried, *Formes verbales analytiques de type “balkanique” dans l’histoire de la langue albanaise*. RA 2, 1985.

²³ Në greqishten e vjetër, latinisht *laudare, laudari*; italisht *adorare, essere adorato*, etj.

²⁴ J. Clark, *An introduction in Indo-european languages*, Cambridge 2007, f. 165-166

²⁵ S. Mansaku, *Paskajorja dhe kategoritë gramatikore të saj*, në Studime filologjike nr. 1, 1982, f. 143

²⁶ Gjymtyrën e dytë tek togjet *do + bërë*, Mansaku e sheh si një emër foljor asnjans të paparanyjzuar, por që nuk ishte domosdo në funksionin e një paskajoreje. “.. mund të ketë qenë fillimisht *duhet, do + punuar*, ku emri foljor ishte në funksion të kryefjalës përkatësisht të kundrinës. Për shkak të lidhjes së ngushtë të dy pjesëve përbërëse të togut, emri foljor mbeti i panyjzuar edhe atëherë kur u shfaq nyja e përparme dhe i gjithë togu i përbërë nga një gjymtyrë foljore mori vlerën e një togu foljor”, në *Paskajorja dhe kategoritë gramatikore të saj*, në Studime filologjike nr. 1, 1982, f. 144.

- FIEDLER, Winfried, *Zhvillimi i infinitivit gegë nga aspekti i ballkanologjisë*. Gjurmime Albanologjike, SSF 5, 1975.
- FIEDLER, Winfried, *Supletivizmi në sistemin foljor të gjuhës së Buzukut*. GA SSF 7, 1977.
- MANSAKU, Seit, *Ndërtimet me foljet modale mund dhe duhet te Gjon Buzuku*. Studime Filologjike, nr. 3, 1979.
- MANSAKU, Seit, *Ndërtimet me foljen kam + paskajore te autorët e vjetër*. Studime Filologjike, nr. 2, 1980.
- MANSAKU, Seit, *Paskajorja e shqipes dhe kategoritë gramatikore të saj*. Studime Filologjike, nr. 1, 1982.
- MANSAKU, Seit, *Funksionet sintaksore të paskajores te autorët e vjetër*. Studime Filologjike, nr. 2, 1983.
- TOPALLI, Kolec, *Koha e ardhme e mënyrës dëftore në gjuhën shqipe*. Studime Filologjike, nr. 4, 1980.
- TOPALLI, Kolec, *Për burimin e trajtës foljore të mënyrës dëshirore në gjuhën shqipe*. Studime Filologjike, nr. 3-4, 1998.
- TOPALLI, Kolec, *Evolucioni i sistemit foljor të gjuhës shqipe*. Tiranë, 2010.
- TOPALLI, Kolec, *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*. Tiranë, 2011.

ABSTRACT

Traces of the infinitive forms in the modal verbs *will, should, can* + participles (should i go, will take) in Albanian

Defining the grammatical nature of syntagmatic links must (do) + participle is one of the most controversial issues regarding the historical existence of the synthetic form of infinitive in Albanian. Such use should be quite early in this language. The clarification of the grammatical nature of this syntagmatic connection is an issue that is obviously related to the existence of a synthetic infinitive in Albanian. This forme is rarely encountered both by the old authors as well as throughout the Albanian language, but by plotting them with such morphological links in different Indo-European languages, this part has the value of an infinitive form. The established results of the old texts comparison are evaluated by means of a typology-based linguistic analysis in the gramatical forms modal verbs *will*,

should, can + participles. In such constructions, some linguists have seen traces of the synthetic infinitive of ancient Albanian. This article provides an initial detailed reconstruction of theThe article aims to present the use of these forms to the authors of the written Albanian of the century. XVI-XVII.

Merita HYSA

REFLEKSE TË SKEMAVE PROZODIKE NË PROCESET FJALËFORMUESE

Në shqipe, efektet më të mëdha të veprimit të proceseve fonologjike në morfologjinë e saj mund të shihen edhe në sistemin theksor. Rregullat theksore në shqipe janë të ndjeshme ndaj:

– kategorive morfologjike të fjalëve të theksuara, p.sh. emrat dhe foljet dallojnë nga skemat theksore;

– tipit të ndajshesave: disa ndajshesa e marrin theksin mbi vete, disa të tjera janë neutrale ndaj theksit.

Sistemi metrik i shqipes favorizon skema theksore, që janë të ndryshme jo vetëm për pjesë të ndryshme të ligjëratës, por edhe brenda një kategorie leksiko-gramatikore. Kështu, një pjesë e emrave dhe mbiemrave në gjuhën shqipe e marrin theksin mbi rrokjen e parafundit, me përjashtim të atyre të formuar me prapashtesa që e marrin theksin mbi vete. Ndërsa foljet dallohen për skemat e shpeshta fundore, sidomos nëse këto rrokje janë të rënda (duke përjashtuar këtu foljet që dalin në temë me grupet e zanoreve *-ye-*, *-ua-*)¹.

Përgjithësisht në fjalët që kanë më tepër se një nivel prejardhjeje, mbizotërojnë skemat theksore fundore, pasi prapashtesat fjalëformuese e bartin theksin mbi vete. Në këtë kontekst ne u referohemi formave përfaqësuese të fjalëve, leksemave, pasi shpesh ndajshesat trajtëformuese që i bashkëngjiten temës morfologjike, bëjnë që të kemi zhvendosje të skemës theksore.

Kështu, po të marrim disa nga fjalët e një çerdheje fjalëformuese, me nivele të ndryshme prejardhjeje prapashtesore, do të vërejmë disa skema theksore. Çështja ndërlikohet edhe më tepër kur u referohemi formave të ndryshme të së njëjtës fjalë, ku theksi del në pozicione të ndryshme. P.sh.:

¹ R. Memushaj, *Fonetikë e shqipes standarde*, f. 152.

<i>ëndërr</i> – theks parafundor	por <i>ëndrrave</i> – theks tejfundor
<i>ëndërr-[ó](j)</i> – theks fundor	por <i>ëndërrójmë</i> – theks parafundor
	<i>ëndërrúakam</i> – theks tejfundor
	<i>ëndërrúakemi</i> – theks në rrokjen IV
<i>ëndërr-[ím]</i> – theks fundor	por <i>ëndërrími</i> – theks parafundor
	<i>ëndërrimeve</i> – theks tejfundor
<i>ëndërr[im][-tár]</i> – theks fundor	por <i>ëndërrimtárët</i> – theks parafundor
	<i>ëndërrimtárëve</i> – theks tejfundor

Duke qenë se në fjalëformat e një lekseme theksi bie në rrokje të ndryshme, nga do të nisemi për të arritur në një përfundim lidhur me skemat theksore të fjalëve në gjuhën shqipe? Do të merren si bazë leksemat apo fjalëformat e tyre?

Lidhur me theksin e fjalës, në gjuhësinë shqiptare ka mbizotëruar mendimi se shqipja ka theks parafundor, por pa e theksuar as në mënyrë eksplicite në është fjala për formën përfaqësuese apo për fjalëformat. Është bërë madje edhe ndonjë përpjekje për ta mbështetur këtë mendim me të dhëna statistikore ².

A. Dodi, një ndër studiuesit që i kanë kushtuar më tepër vend çështjes së theksit të fjalës në shqipe, thotë se vendi i theksit “është tipar i fjalës si njësi leksikore dhe gramatikore”. dhe se ai “nuk mund të përcaktohet automatikisht për të gjitha fjalët” ³. Por, ndryshe prej tij, G. Bevingtoni është shprehur që më 1972, se “në përgjithësi, theksi bie në rrokjen fundore të temës” ⁴. duke nënkuptuar me këtë temën morfologjike të fjalës, leksemën. Ndër gjuhëtarët shqiptarë, i pari që pranon se theksi bie në rrokjen fundore të temës, është K. Topalli, por ai me temë kupton jo temën morfologjike të fjalës, po temën fjalëformuese ⁵.

Idenë e Bevingtonit se theksi bie në rrokjen fundore të temës e ka shtjelluar më hollësisht R. Memushaj, i cili ka paraqitur edhe rastet që bëjnë përjashtim nga kjo rregull, domethënë rastet kur theksi nuk bie në rrokjen fundore të temës ⁶.

² G. Hadaj, *Shpërndarja e theksave në leksikon e shqipes*, SF, 1991, Nr. 1, f. 99–106.

³ A. Dodi, *Fonetikë e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2004, f. 172–177.

⁴ G. Bevington, *Albanian Phonology*, Wiesabeden, 1974, p. 24; po ai, *Die albanische Betonung im Lichte der generativen Phonologie* në “Akten der internationalischen Albanologischen Colloquium Innsbruck 1972”, Innsbruck, 1977, pp. 405–427.

⁵ K. Topalli, *Theksi i fjalës në gjuhën shqipe*, Tiranë, 1995, f. 66.

⁶ R. Memushaj, *Theksi i fjalës në gjuhën shqipe*, Studime albanologjike, 2009, I, f. 37–49.

Përfundimisht, lidhur me pyetjen e shtruar më sipër, përgjigjja është se, kur flitet për vendin e theksit të fjalës në shqipe, duhet t'i drejtohem formës përfaqësuese të fjalës në fjalor, d.m.th. leksemës dhe jo formave të fjalës. Siç u pa edhe nga shembujt e mësipërm, duke iu referuar fjalëformave mund të dalin skema të shumta theksore, të cilat nuk do të kenë asnjë vlerë kur është puna për përgjithësime.

Nga mendimet e fonetikanëve tanë për çështjen e theksit të fjalës, vlen të përmendim ato të A. Dodit dhe të B. Becit lidhur me raportet e prapashtesave me theksin. Kështu, A. Dodi përjashton që theksi mund të bjerë në ndajshesat trajtëformuese (prapashtesa ose mbaresa). Sipas tij theksi bie mbi një rrokje ku nuk ndodhen treguesit gramatikorë⁷. Ky studiues dallon edhe tipat e temave fjalëformuese, duke theksuar që në temat e parme emërore dhe mbiemërore mbizotëron theksimi parafundor.

Ai sjell shembuj prapashtesash fjalëformuese që e bartin theksin mbi vete. P.sh., disa prapashtesa fjalëformuese emërore e mbiemërore që e bartin theksin mbi vete, janë: *-ar, -tar, -or, -ror, -tor, -ist, -isht, -(ë)si, -(ë)ri, -ro, -ri, -so, -zo, -os, -im, -ush, -ak, -ac/-acak/-acuk, -avec, -nik, -të, -it, -s(is), -llo, -al, -imisht* etj.

det – [[det]ár]]	fund – [[fund]ós]]
mal – [[mal]ór]]	mjeshtër – [[mjeshtër]i]]
punë – [[punë]tór]]	embël – [[ëmbël]sí]]
central – [[central]íst]]	dorë – [[dorë]zó-]] etj.

Po kështu, prapashtesat dyrokëshe tek të cilat theksi bie mbi rrokjen e parë, duke e bërë parafundore skemën theksore, si p.sh.: *-atë, -ore, -tore, -ishte, -ishtë, -ajë, -najë, -eshë, -icë, -izëm, -azëm, -itet* etj.:

[[lëng#]átë]]	[[mëngjes]óre]]
[[shkri#]tóre]]	[[ah]ishtë]]
[[bisht]ájë]]	[[akull]nájë]]
[[buall]ícë]]	[[rac#]ízëm]]
[[arbitrar]ízëm]]	

Ai veçon gjithashtu edhe një grup ndajshesash që nuk mund ta marrin theksin mbi vete, si p.sh.: *-më, -je, -ë, -as, -azi, -shëm* etj.

klith – [[klíth]më]]	fyt – [[fýt]as/azi]]
dal – [[dál#]je]]	nder – [[ndér]shëm]]
mbledh – [[mblédh]ës]]	flake – [[flák#]të]] etj.

⁷ A. Dodi, *Fonetikë e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2004, f. 172–173.

Dodi thekson edhe numrin e rrokjeve të prapashtesave në të cilat ngulitja e theksit në rrokjen e parë është në përputhje me prirjen e përgjithshme të shqipes për theksimin parafundor të fjalëve. Ajo që duhet të vëmë në dukje në vëzhgimet e Dodit për skemat theksore të shqipes, është pikërisht se ai nuk specifikon nëse njësia referuese që merr si bazë për përcaktimin e pozicionit të theksit është tema morfologjike apo tema e fjalës. Zbulimi i skemave theksore u referohet njërive leksikore, pasi në gjuhën shqipe fjalëformat nuk mund të merren si bazë për shpjegimin e theksit të fjalës, sepse gjatë eptimit theksi mbetet mbi temën e saj.

B. Beci, në pohimet e tij lidhur me natyrën e theksit në shqipe, ndalet në një tjetër aspekt. Rregullat që parashikojnë pozicionin e theksit në shqipe, sipas tij, lidhen me një tjetër njësi, morfemën. Ai dallon dy klasa morfemash (a) të *theksueshme*, ku përfshin prapashtesat fjalëformuese foljore dhe disa prapashtesa emërore, mbiemërore e ndajfoljore; (b) të *patheksueshme*, në të cilat përfshin disa prapashtesa fjalëformuese emërore, mbiemërore dhe ndajfoljore, si dhe ndajshitesat trajtëformuese e disa fjalë shërbyese ⁸.

Ky është një konceptim i ri jo vetëm i përcaktimit të skemave theksore, por edhe i krijimit të një elementi të ri në klasifikimin e njërive theksore. Autori nuk e përmend nocionin e temës, morfologjike apo fjalëformuese, por i sheh njësitë nga pikëpamja e rolit që kanë në caktimin e kufijve theksorë. Në këtë mënyrë, ai e sheh këtë njësi funksionale, morfemën, si një realitet fonologjik e morfologjik me funksion të ndërsjellë.

Pra, ndajshitesat fjalëformuese jo vetëm që bartin tipare semantike që modifikojnë strukturën kuptimore të fjalëve, por mund të luajnë rol edhe në strukturën theksore të temave të prejardhura prej tyre, veçori që e kanë vetëm fare pak prapashtesa trajtëformuese. Por edhe te prapashtesat fjalëformuese që formojnë klasa të ndryshme fjalësh, vëmë re se jo të gjitha e kanë këtë veçori.

Të gjitha prapashtesat foljore e bartin mbi vete theksin e fjalës së prejardhur; edhe kur janë dyrrrokëshe apo trirrokëshe, theksi bie mbi rrokjen e fundit të tyre. Meqenëse edhe temat foljore të parme janë oksitone, skema

⁸ B. Beci, *Fonetika e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2004, f. 116–117.

theksore e temave foljore është fundore. Me përjashtim të pak foljeve që dalin me tog zanor, siç mund të shihet nga kjo pasqyrë:

Folje të formuara me prapashtesa (theks fundor)	Folje me theks parafundor
<i>mësój</i>	<i>ndíej</i>
<i>anulój</i>	<i>zíej</i>
<i>argás</i>	<i>përzíej</i>
<i>pëshjtjéll</i>	<i>bíe</i>
<i>parandéj</i>	<i>shpie</i>
-ço (ndri#-çój)	<i>shtíe</i>
-akat (var-akátem)	<i>blúaj</i>
-ako (rreth-akój)	<i>lúaj</i>
-etis (tel-etís)	...
-ëco (gur- ëcój)	<i>lýej</i>
-arizo (popull-arizój)	...
etj.	

Ndër prapashtesat emërore, shumica e tyre e marrin mbi vete theksin e fjalës së prejardhur. Kur janë dy- a trirrokëshe, theksi bie mbi rrokjen e tyre të fundit, me përjashtim të prapashtesave që mbarojnë me zanoret *-ë* ose *-e* që rrëgjohen gjatë eptimit. Po një pjesë e vogël e prapashtesave që formojnë emra nuk e marrin theksin mbi vete. Të tilla janë prapashtesat njërrrokëshe *-ë* dhe *-e*; prapashtesat që kanë përpara ose pas zanoren *ë*; ato që kanë pas zanoren *e*; prapashtesat njërrrokëshe *-aj/-ej*, *-as*, *-es* (vetëm të fjala *di-es*); dhe prapashtesa dyrrrokëshe *-ëse*. Duke përfshirë emrat e formuar me këto prapashtesa që nuk e marrin theksin mbi vete, emrat e formuar me prapashtesat dy- e trirrokëshe që e marrin theksin në rrokjen e tyre të parafundit, si dhe emrat e parmë që mbarojnë me *-ël*, *-ëll*, *ër*, *-ërr*, *-ull*, *-ur* dhe një grup tjetër emrash, kryesisht të huazuar, me theks parafundor e tejfundor (si *kamerë*, *dinozaur* etj.), mund të themi se një pjesë e e mirë e emrave të shqipes kanë skemë theksore parafundore. Por pyetjes se cili është raporti i skemave theksore fundore, parafundore e tejfundore tek emrat, mund t'i jepet një përgjigje e saktë vetëm pas një studimi statistikor të leksikut emëror të shqipes.

Prapashtesa emërore që e marrin theksin mbi vete	Prapashtesa emërore që nuk e marrin theksin mbi vete
<i>-abiq</i> (shkurt-abíq)	<i>-aj/-ej</i> (Ág-aj/ Alí-aj)
<i>-ac</i> (tull#-ác)	<i>-as</i> (berát-as)
<i>-acë</i> (balt#-ácë)	<i>-cë</i> (grím#-cë)
<i>-acuk</i> (verdh#-acúk)	<i>-ckë</i> (mbërthë-ckë)

-aç/-vaç (bak#r-áč/ trazo-váč)	-çkë (budallá-çkë)
-açe (firk#-áce)	-e (punëtor-e)
-açë (bor#-áčë)	-es (dí-es)
-ajë/-najë/-tajë (dushk-ájë/ akull-nájë/ tym-tájë)	-ë (prit-ë)
-ajkë (bardh#-ájkë)	-ël (brég-ël)
-alkë (këmb#-álkë)	-ërr (bísht-ërr)
-allë (dynd-állë)	-ës (bréjt-ës)
-alle (trak-alle)	-ëse (mbájt#-ëse)
-ak/-nak (ushtar-ák/ hidh-nák)	-ëz (aníj#-ëz)
-alac/-alec (shkurt-alác/ bisht-aléc)	-je (hýr#-je)
-alak/-alaq (dredh-alák/ ngordh-aláq)	-kë ₁ /-çkë (dhél#-kë/ dashurí-çkë)
-aliq/-aliqe (barka-alíq/ pushk#-alíqe)	-më (drídh-më)
-alok ₁ (qaf#-alók)	-në (fundërrí-në)
-alos ₁ quk#-alós	-një ₁ /-nje (dre-një/ dush-nje)
-aluq (shtremb-alúq)	-r (ago-r)
-all (/gërxbh-áll/	-rë (akullsí-rë)
-ame (rrotull-áme)	-she (tráshe)
amë (cërrk-ámë)	-shë (argóshë)
-an/-ian/-jan (afrik#-án/ histor#-ían/ lezh-ján)	-të (ártë)
-anë (rreth-ánë)	-zë (qyté-zë)
-ant (figur#-ánt)	-se (újë-se)
-aq (hut-áq)	-th (fjalór-th)
-ar (argjend-ár)	-zë (qyté-zë)
-anak/-arak (fik-anák/ bredh-arák)	
-arash (dhëmb-arásh)	
-are (brez-áre)	
-ari (gdhend-arí)	
-arinë (helm-arínë)	
-arkë (qind-árkë)	
-arush ₁ (lap-arúsh)	
-aresh (flak#arësh)	
-ash (gjum#-ásh)	
-ashkë (dor#áshkë)	
-atar (sqim#atár)	
-atë (eduk#-átë)	
-atinë (helm-atínë)	
-ator (mur-ator)	
-aturë (mur-atúrë)	
-avec (grind-avéc)	
-avel (bardh#-avél)	
-azë ₁ (derdh-ázë)	
-azh/-tazh (met#r-ázh/ kano-tázh)	
-cak/-acak (anë-cák/ ardh-acák)	
-çi ₁ /-xhi/-axhi (batak-çí/aheng-xhí/ basm#-axhí)	
-çinë (kamion-çínë)	

<p>-çor (inat-çór) -dan/-adan (lavër-dán/flak#-adán) -ec (gogël-éc) -eckë (ferr#-éckë) -el (keq-él) -ell (zgjat-éll) -ellë (humb-éllë) -emë/-llemë/-ullemë/-remë/-ërremë (akull-émë/ bardhë/llémë/ bardhë-rémë/ kuq-ërrëmë) -er/-zer/-ier/-cier/-tier (dosi#-ér/ kriti#-zér/ brigad#-iér/ roman-ciér/ bufe-tiér) -ere/-erë/-tere (dushq#-ére/ krisht-érë/ qosh-tére) -es (kënd#-és) -esë (mung#-ésë) -esh (arbër-ésh) -eshë/-lleshë/-reshë/-neshë (arkond-éshë/ bobo-rëshë/burr-ëreshë/hyj-nëshë/aga- llëshë) -eshkë (arixh#-éshkë, hardhj#-éshkë) -ez (franc#-éz) -ezë (dor#-ézë) -ërto (send-értó) -i (bujar-í) -icë/ulicë/-llicë-ëllicë (buall-ícë/ furk-ulícë/ tërtë-llícë/ zhang-ëllícë) -içkë (der#-içkë) -ierë/-tierë (beton-iërë/kano#-tiërë) -ikë/-tikë/- atikë/-etikë (afrikanist-íkë/ semio-tíkë/ aksiom#-atíkë/ gjen/etikë) -im (mës#ím) -imë (oshët#-ímë) -ina₁/-rina/-sina (af#r-ína/copë-rína/ shpërta-sína) -inë (kod#r-ínë) -iot₁/-jot (kuç-iót/-delvin#-jót) -irë/-(ë)tirë (athët-irë/humb-ëtirë) -iskë (bal#-ískë) -ist (aktiv-íst) -ish (bardh#-ish) -ishte/-ishtë (fidan-íshte/ gur-íshtë) -izë (kok#rr-ízë) -izëm (social-ízëm) -it (dropull-ít) -itet (aktiv-itét) -lak/-ëllak (bobo-lák/tremb-ëllák) -li/-ali (borxh-lí/cing-alf)</p>	
--	--

<p> <i>-licë/-alicë/-ulicë</i> (moço-lícë/ gur-alícë/ furk#-ulícë) <i>-linë/-olinë</i> (cekë-línë/ gorg#-olínë) <i>-llëk</i> (budalla-llëk) <i>-man/-aman/-oman</i> (greko-mán/ breshk#-amán/shkres#-omán) <i>-men</i> (biznes-mén) <i>-nak/-anak</i> ((bri-nák/fik-anák) <i>-ni</i> (brez-ní) <i>-nik/-anik</i> (fis-ník/rreth-ánik) <i>-nicë/-anicë/-enicë</i> (bisht-nícë/ grosh- anicë/ kyç-enícë) <i>-nushë</i> (dre-núshë) <i>-njak/-anjak</i> (bosh-nják/ varf-anják) <i>-oc</i> (Bardh#-óc) <i>-oç</i> (buz#-óç) <i>-ojë</i> (rrjedh-ójë) <i>-ojcë</i> (gardh#n-ójcë) <i>-ojkë</i> (bardh-ójkë) <i>-ok</i> (bardh-ók) <i>-oke</i> (nën#-óke) <i>-ol</i> (cik-ól) <i>-ole</i> (gardh-óle) <i>-omë</i> (bar-ómë) <i>-onjë</i> (dushk-ónjë) <i>-oq</i> (marr#-óq) <i>-oqe</i> (garróqe) <i>-or</i> (kat#r-ór) <i>-ore</i> (breg-óre) <i>-orr</i> (maç-órr) <i>-osë/-oskë</i> (bretk-ósë/ guf-óskë) <i>-osh</i> (bardh-ósh) <i>-ot/-jot/-njot</i> (delvinj-ót/ mallakst#r-iót/ himar-jót) <i>-ovinë</i> (balt#-ovínë) <i>-ozë/-iozë</i> (acid-ózë/ bakter-iózë) <i>-qar</i> (grabit-qár) <i>-ri/-ëri</i> (djalë-rí/ trim-ërí) <i>-rinë₁/-urina/-arinë</i> (copë-ríinë/ qelq- urína/ plas#-arínë) <i>-si/-ësi</i> (rregull-sí/ mal-ësí) <i>-sinë/-ësinë</i> (ajkë-sínë/ lig-ësinë) <i>-sirë/-ësirë</i> (egër-sírë/ dend-ësirë) <i>-shti</i> (kundër-shtí) <i>-tar/-atar</i> (arkë-tár/gjak-átar) <i>-tan/-atan</i> (kru-tán/ llap-atán) <i>-tinë</i> (brash-tínë) <i>-tor/-ator</i> (faj-tór/ mur-atór) </p>	
--	--

-tore (fal-tóre) -tyrë (ajkë-tyrë) -ucë (bir-úcë) -ujë (belb-újë) -ujkë (mëz-újkë) -ule (bardh-úle) -ullore (trak-ullóre) -uqe (belb-úqe) -urë/-aturë (agjent-úrë/ arm-atúrë) -urinë -urina (balt-urínë/ qelq-urína) -ushe (bark-úshe) -ushkë (verdh-úshkë) -uk (bisht-úk) -ul (bardh#úl) -uliq (krap-ulíq) -un (mes-ún) -uq (that#-úq) -urinë (hal#-urínë) -ush (lepur-úsh) -xhi (boja-xhí) -zan (bori-zán) -zi/-ëzi (djall-ëzí/ marrë-zi)	
--	--

Ndër prapashtesat mbiemërore gjithashtu shumica e marrin mbi vete theksin e fjalës. Kur janë dyrrrokëshe, theksin e marrin në rrokjen e fundit, me përjashtim të rasteve kur mbarojnë me zanoret *-ë* dhe *e*; ndërsa, kur janë trirrokëshe, e marrin theksin mbi rrokjen e parafundit. Shumë të pakta në numër janë prapashtesat mbiemërore, që nuk e bartin theksin mbi vete. Edhe po t'u shtojmë atyre prapashtesat dy- e trirrokëshe që theksohen në rrokjen e parafundit, sërish numri fjalëve të formuara prej këtyre dy kategorive të prapashtesave është më i vogël se numri i fjalëve të formuara me parashtesa që e marrin theksin mbi rrokjen e fundit. Kjo të bën të besosh se te mbiemrat mbizotëron skema theksore parafundore. Megjithatë, edhe këtu si në rastin e emrave, ky pohim ka nevojë të mbështetet me të dhëna statistikore, të cilat i kemi vjelë si më poshtë:

Prapashtesa mbiemërore që e marrin theksin mbi vete	Prapashtesa mbiemërore që nuk e marrin theksin mbi vete
-ac (dor#-ác) acel ₂ (bark-acél) -acak/-acuk (rrjep-acúk rrjep-acák) -aç/-vaç (bardh-ác/ trazo-váč) -agan (lar#-agán)	-as (ballkan-ás) -ë (i fort-ë) -ëm/-më (i més-ëm/ i këtej-më) -ës (blërë-s/ bárt-ës) -ësh (dy-degë-sh/ dy-cep-ësh)

<p>-ahul (gjat#-ahul) -al/-ial (feud-ál/aktor-iál) -alac/alec (frik#-alác/ bardh#-aléc) -alak/-alaq (dredh]alák/ngordh-aláq) -alash (kuq-alásh) -alan (kuq-alán) -alosh (pik#alósh) -aluq (trash-alúq) -ak/-nak (rom#-ák/ bri-nák) -an (mjer#-án) -aq (hut#-áq) -anjos (pis-anjós) -anjoz (grind-anjóz) -ar (vjesht#-ár) -avec (mburr-avéc) -avel (jarg#-avél) -anak/-arak (fik-anák /cop#-arák) -anik (mburr-aníik) -anjar (kock#-anjár) -araq (lang#-aráq) -aruq/-arec (plak-arúq/ -aréc) -arush (gjat#-arush) -atak (rrafsh-aták) -ash/-arash (bal#-ásh/ dhëmb-arásh) -ashuk (far#-ashúk) -ativ (figur#-atív) -avik/-ovik (ndyr#-avík/ mas#-ovík) -cak/-acak (ferr#-cák/ ardh-acak) -ec (bardh#-éc) -emë (i akull-émë) -er (kësul#-ér) -esk (piktor-ésk) -ëllemë/ -ullemë/-ëremë-ërremë (i bardh-ëllémë/ verdh-ullémë/ bardh-ërémmë/ kuq-ërrémë) -ërak (hidh-ërák) -ian (hamlet-ian) -ik/-tik/-atik (acid-ík/ apokalip#-tík/a rom#-atík) -iq (bark-íq) -iv (fest#-ív) -lak/-ëlak (bubu-lák/ tremb-ëlák) -laq/-alaq (prapa-láq/ bark-aláq) -li/-ali (arap-lí/ quk#alí) -lor/-alor (pikë-lór/ pik#-alór) -losh/-alosh/-ëlosh (butë-lósh/ kuq-alósh /kuq-ëlósh) -man/-aman/-oman (greko-mán/ çal#amán/</p>	<p>-shëm (i pa-shëm) -ët/-të (i ath-ët/ i acár-të)</p>
---	---

shkres#-omán -mel/-amel (zhele-mél/ bir#-amél) -nak/-anak (bri-nák/ frik#-anáak) -noke (bri-nóke) -nik -anik (bes-#-ník/ that#-aník) -nor/-anor (amë-nór/ leck#-anór) -njak/-anjak (bosh-nják / varf-anják) -njar/-anjar/-onjar (gër-njár/ grind-anjár/ loz-onjár) -ok/-lok (bardh-ók/ babë-lók) -or/-tor (diell-ór/ faj-tór) -osh (bardh-ósh) -ovec (balt#-ovéc) -oz (acid-óz) -ot/-iot/-jot (delvinj-ót/ qipr#-iót/ kuç-jót) -rak/-ërak/-arak (shenjë-rák/dredh-arák/ hidh-ërak) -ror/-ëror (shtazë-rór/ trim-ëror) -sor/-ësor (amë-sór/ djep-ësór) -stik/-istik -astik (fanta#-stík/ oper-istik/ bomb#-astík) -shor (amë-shor) -tak/-atak (mish-ták /lesh-aták) -tan (kru#tán) -tar/-atar (agim-tár/ cop#-atár) -tik/-atik (frene-tík/ astm#-atík) -tor/-ator (faj-tór/ mur-atór) -uar/-zuar (i anëtarës-úar/ i dallgë-zúar) -uc (bark-úc) -ushe/-ushë (djall-úshe/ thart#-úshë) -uq (that#-úq) -uk (lar#-úk) -ullak (trash#-ullák) -ullor (mushk-ullór) -vec/-avec (qurra-véc/ grind-avéc) -zan/-azan (parti-zán/ llaf-azán) -zor/-ëzor (fije-zór/ djall-ëzór)	
--	--

Me prapashtesat ndajfoljore ndodh e kundërta, shumica e tyre nuk e bartin theksin mbi vete edhe kur janë dyrrokëshe; vetëm pak syresh e marrin mbi vete theksin e fjalës së prejardhur që formojnë. Rrjedhimisht, edhe te ndajfoljet e prejardhura mbizotëron skema theksore parafundore.

Prapashtesa që e marrin theksin mbi vete	Prapashtesa që nuk e marrin theksin mbi vete
-isht (vjedhur-isht) -risht/-ërisht/-arisht/-urisht (aga-isht/ çudit-	-as (bërryl-as) -ash (lúft#-ash)

ërisht/ goj-arisht/ djem-urisht)	-azi (léht#-azi)
-mísh/ -ímísh (fuqi-mísh/ shpreh-ímísh)	-çe (vénd-çe)
-sísh/ -ësísh (butë-sísh/ kthjellt-ësísh)	-ët (cék-ët)
-tí (tash-tí)	-it (mót-it)
	-mas (véaç-mas)
	-shëm (furí-shëm)
	-tas (háp-tas)
	-tazi (háp-tazi)
	-të (ftóh-të)
	-thi (kërcím-thi)
	-ur (fshéh-ur)
	-zaj/ -mëzaj (njëdítë-zaj/ tré-mëzaj)

Në këtë punim vëzhguam faktorët fonologjikë që lidhen me aftësinë që kanë prapashtesat fjalëformuese të bartin theksin mbi vete, gjë që vërehet thuajse plotësisht në këto ndajshtesa. Krahas ndryshimit të skemës prozodike, ato bartin tipare semantike që modifikojnë strukturën kuptimore të fjalëve, tipar ky që karakterizon të gjitha ndajshtesat fjalëformuese.

Nga analiza e korpusit të prapashtesave, del se pjesa më e madhe e ndajshtesave emërore, mbiemërore dhe foljore e bartin theksin mbi vete. Kurse me prapashtesat ndajfoljore ndodh e kundërta, shumica e tyre nuk e bartin theksin mbi vete edhe kur janë dyrrrokëshe; vetëm pak syresh e marrin mbi vete theksin e fjalës së prejardhur që formojnë. Rrjedhimisht, edhe te ndajfoljet e prejardhura mbizotëron skema theksore parafundore.

Vëzhgimi i skemave prozodike në funksion morfonologjik përbën një këndvështrim interesant në studimet e shqipes, kjo sepse përmes veçimit të modeleve të tilla theksore, shohim bashkërendimin e niveleve të ndryshme të përfaqësimit gjuhësor, në funksion të realizimit të njësive të reja leksikore.

BIBLIOGRAFIA:

- Aronoff, M., *Word formation in generative grammar*, The MIT Press, Massachusetts, 1976.
- Beci, B., *Fonetika e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2004.
- Blevins, J., *Stems and paradigms*, *Language*, 79(4), 2003.
- Booij, G., *Lexical phonology and morphology*, Amsterdam, Linguistic Inquiry, 2006.
- Buxheli, L., *Formimi i foljeve në gjuhën e sotme shqipe*, Neraida, Tiranë, 2008.
- Carstairs, A., *Allomorphy in Inflection*, Croom Helm, London, 1988.
- Dodi, A., *Fonetika dhe fonologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2004.
- Dodi, A., *Ë-ja mbështetëse dhe problemet e drejtshkrimit të saj*, SF, 1981, nr. 3. *Drejtshkrimi i gjuhës shqipe*, Tiranë, 1973.
- Dhrimo, A., *Për shqipen dhe shqiptarët*, I, II Tiranë, 2008.
- Dhrimo, A., Memushaj, R., *Fjalor drejtshkrimor i gjuhës shqipe*, Infbotues, Tiranë, 2011.
- *Fjalor i gjuhës së sotme shqipe*, Tiranë, 1980.
- *Fjalor i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006.
- Goldsmith, J., *Autosegmental and metrical phonology*, Cambridge, 1990.
- Hadaj, G., *Shpërndarja e theksave në leksikon e shqipes*, SF, 1991, Nr. 1, f. 99–106.
- Harris, J., *Syllable structure and stress in Spanish*, London, 1983.
- Hysa, E., *Formimi i emrave me ndajshitesa në gjuhën shqipe*, Tiranë, 2004.
- Kager, R., *The metrical theory of word stress*, 1993.
- Kager, R., *On a allomorphy and syllable counting*, in U. Kleinhenz (ed.) “Interfaces in phonology”, *Studia grammatica*, 41, 1996.
- Memushaj, R., *Fonetikë e shqipes standarde*, Tiranë, 2014.
- Memushaj, R., *Theksi i fjalës në gjuhën shqipe*, Studime albanologjike, 2009, I.
- Topalli, K., *Theksi i fjalës në gjuhën shqipe*, Tiranë, 1995.

Reflexes of prosodic schemes in word formation processes**ABSTRACT**

The aim of this paper is to observe the phonological features that influence the word processes. The observation of the stressing features during the process of the suffixing origin is an interesting look at Albanian studies especially when referring to shifting or not of the stress during the formation of different parts of the speech.

An important part of the work is the morphologic examination of all noun, adjective and adverb suffixes specifying those that carry the emphasis/stress and those that do not bring the stress scheme shift.

Anisa KOSTERI

FJALËSI KRAHINOR I VERIUT NË FJALORTHIN E NIKOLLË GAZULLIT

Dom Nikollë Gazulli (1891-1946), klerik, por edhe gjuhëtar, rreshtohet ndër dijetarët me emër të gjysmës së parë të këtij shekulli. Lindi në Dajç të Zadrimës. Kreu seminarin Papnor të Shkodrës dhe studimet e larta teologjike në Istbruk (Austri).

Shërbeu për shumë vite në zonën e Malësisë së Madhe (në famullinë e Shkrelit), ku gjurmoi dhe mbledhi lëndë të pasur leksikore, frazeologjike, onomastike dhe etnografike. Botoi dy vepra gjuhësore: “Fjalorth i ri” (fjalë të rralla të mbledhuna në Veri të Shqipnisë) me mbi 5000 fjalë, që doli si vëllim XI i serisë “Visaret e Kombit” (Tiranë, 1941), dhe “Fjalori onomastik”, botuar pjesë – pjesë në “Hylli i Dritës” me 22 numra (1939-1943) nën pseudonimin Gelasius.

Ndonëse, Dom Nikollë Gazulli shërbesat e tij fetare i kryente në Shkrel dhe Rrjoll të Malësisë së Madhe, ndalesa e tij kryesore ishte Biblioteka Françeskane në Shkodër. Ai, edhe pse bashkëpunonte me Mjedën a Fishtë, gjendej kryesisht në shoqërinë e At Benedikt Demës.

Porsi bleta mbledh nektarin e luleve, ai mbledhi prej popullit të maleve tona mijëra fjalë të rralla, shprehje frazeologjike, onomastikë e toponomastikë, materiale etnologjike e deri harta të vjetra, mbi të cilat bëri analiza shkencore.

Nikollë Gazulli me zellin e tij të paepur, mbledhi fjalë e shprehje popullore nga zona e Malësisë së Madhe. Gjeografikisht dhe nga ana dialektologjike, Malësia e Madhe dhe Shkodra janë shumë afër njëra-tjetrës, kështu që duhet theksuar, se Gazulli pasqyroi më së miri të folmen e gegërishtes veriperëndimore.

Fjalësi i Fjalorit përmban rreth pesë mijë lema. Kjo shifër s’do të thotë se Fjalori nuk përmbush parametrat kryesorë, përkundrazi, sasia është ajo që nuk duhet të vërehet, e rëndësishme është cilësia e këtij Fjalori.

Duke marrë parasysh shtrirjen dialektore të fjalësit të Fjalorit, vërejmë se, përveç zonave të Malësisë së Madhe, të cilat përbëjnë edhe themelin e fjalësit të Fjalorit, janë përfshirë fjalë edhe nga Puka, Dukagjini, Mirdita, Ulqini, Malësia e Lezhës, Bregu i Bunës, por ka lëndë edhe nga Tirana etj., (ku herë e thekson, dhe herë e shpjegon me “fjalë në rrethe”).

Në këtë artikull, do të trajtohet leksiku, i cili është shtrirë përtej zonave të Malësisë së Madhe dhe qytetit të Shkodrës.

Fjalësi i Pukës, i cili zë edhe hapësirën më të madhe, përfshin zonat e Berishës, Blinishtit, Behotit, Buzhalës, Qelëzës, Çerretit të Poshtëm, Dardhës, Kabashit, Këcirës, Komanit, Midhës, Milskaut, Ukthit.

Jemi munduar të bëjmë një përfaqje me leksikun e trevave veriperëndimore të nxjerrë nga Gj. Shkurtaç, B. Beci, Xhabir Topalli, Jorgji Gjinari dhe të paraqesim sa është i pranishëm Fjalori i Gazullit me lemat përkatëse, duke i shënuar thuajse të gjitha rastet.

Pukë:

arç-i – *argësh –i, argësht – i; trinë thuprash e mbajtur mbi uj me rrëshiqat të frymë e e shtëmë prej notarësh për me kalie ujnate* (G. f.48). Gj. Shkurtaç jep dy kuptime të tjera të kësaj fjale, **arç-i**- *dosëz, klysh dheu, dhe arç-i – arrëza e qafës*.³⁵

balishë-a – *ballushë-a, flokët e lanun të gjatë në ball*. (G. f.53). Tek Xh. Topalli e kemi, **balash-i** – *kalë me baloshë në ballë*.³⁶ Kemi ndërrimin fonetik nga *i:a*.

boça e fytit – 1. *arçi i fytit; ashti në gërgilac të fytit: a a njëti thojt në boçë të fytit; molla e Adamit*. 2. *boçë pishë: kabllësh, pëpërllëshkë: kokrra qi bân pisha*. 3. *boçë kollomboqi të fshëm* (G. f.65). Xh. Topalli e ka, **boç-a** – *koçani i misrit mbasi i hiqen kokrrat (Ib) bokla; në Qelez: katue*.³⁷ Të njëjtin kuptim jep edhe B. Beci për Shkrelin, **bo:ç-a** -*koçan*.³⁸ Gjithashtu edhe tek e folmja e Mirditës kemi, **boç-a** – *koçan misri*.³⁹

bukuritue – *me i dhanë një sendit bukuri, zbukurue* (G. f.74). B. Beci për të folmen e Mirditës e përdor, **bukuru (me)** – *zbukuroj*.⁴⁰

burrim-i – *koha qi mbërrin djali i ri me marrë hije burri; për varza: m'u gruenuë* (G. f.77). Malësia e Madhe e ka **burrimohet**.

bushtë-r-a – 1. *shakë-a*. 2. *kulshedër-a*. (G. f.77). Gj. Shkurtaç jep trajtën, **bushtërr-a** – *femra e qenit, del edhe në vështrimin: grua e keqe, idhnake*.⁴¹ B. Beci na jep trajtën, **bushtë-r-a** – *femëra e qenit*.⁴²

³⁵ Gj. Shkurtaç, *E folmja e Kelmendit*, “Dialektologjia shqiptare” III, Tiranë, 1975, f. 94.

³⁶ Xh. Topalli, *Disa vërejtje për të folmen e krahinës së Pukës*, “Dialektologjia Shqiptare” II, Tiranë, 1974, f. 325.

³⁷ Xh. Topalli, *Disa vërejtje për të folmen e krahinës së Pukës*, “Dialektologjia Shqiptare” II, Tiranë, 1974, f. 325.

³⁸ B. Beci, *E folmja e Shkrelit*, “Dialektologjia shqiptare” I, Tiranë, 1971, f. 310.

³⁹ B. Beci, *E folmja e Mirditës*, “Dialektologjia Shqiptare” IV, Tiranë, 1982, f. 95.

⁴⁰ B. Beci, *E folmja e Mirditës*, “Dialektologjia Shqiptare” IV, Tiranë, 1982, f. 96.

⁴¹ Gj. Shkurtaç, *E folmja e Kelmendit*, “Dialektologjia Shqiptare”, III, Tiranë, 1975, f. 91.

⁴² B. Beci, *E folmja e Mirditës*, “Dialektologjia Shqiptare” IV, Tiranë, 1982, f. 96.

buzhel-i – *kjenës i sendërgjuem me trembë fëmijt, krh. gogol-i, bubazhel-i* (G. f.78). Edhe në Shkodër gjen përdorim, **bubazhel-i**.

cubak-e – *cub-e, bishtshkurtën: orë cubake; kishem me pasë le me orë cubake: me orë tëpreme, me fat të lig* (G.f.86). B.Beci në të folmen e Mirditës e ka, **cub-dele me bisht të shkurtër**.⁴³

cukël-a – 1. *pakicë: mbetën do cukla*. 2. *pakicë teshash* (G. f.86). Malësia e Madhe e ka **cokël-a**.

cûmër-a – 1. *nënkrejçë, cënuq, jestek*. 2. *kambalec-i: m'u ka thye një cûmër shtrati, kambcë-a* (G. f.86). Malësia e madhe përdor trajtën **cumrrak-e** – *i/e vogël me trup*.

curakzue – *curakë (me)* (G. f.87). Tek e folmja e Rranxave të Mbishkodrës e gjejmë, **curakis** – *pres, shkurtoj degët e një peme ose flokët e një fëmije etj.*⁴⁴

curan-e – *njeri a shtazë veshcure* (G. f.87). Tek e folmja e Kelmendit e kemi, **cur-a** – *dhi që i ka veshët shumë të vegjël*.⁴⁵ Tek B.Beci e gjejmë, **curre-ja** – *dele me veshët të shkurtër, quhet delja pa veshë*.⁴⁶

curran-e – *njeri i fortë si curri* (G. f.88). Xh. Topalli e ka, **curr-i** – *shkëmb i thepisur*⁴⁷. Gazulli e ka përdorur si mbiemër në mënyrë figurative. Edhe tek B.Beci kemi, **curr-i** – *shkëmb*.⁴⁸

danik-u – *odë e veçue me për ndonji qëllim* (G. f.105). Në Mirditë, B.Beci na jep trajtën, **daneik, danisë** – *me danue, me e da menden, me vendue, me këputë: kam danisë me shkue, e kemi danisë këtë gjâ* (G. f.104). Në Mirditë kemi trajtën, **daneit (me)** – *ndaq*.⁴⁹

dënue, dinue – *m'u pakue; u dënue vëna në vozgë, dënoe pak ata lang mos të derdhet* (G. f.108). Gj,Shkurtaç jep trajtën, **dnoj,-ova,-ua** – *pakësoj, mbaroj diçka*.⁵⁰

Qelëza

Qelëza është një fshat në rrethin e Pukës.

currî-ni – *çurril, çurrel, çurg-u; fraz. me mbajtë menden currî në Zoti:*

⁴³ B.Beci, *E folmja e Mirditës*, “Dialektologjia Shqiptare” IV, Tiranë, 1982, f. 97.

⁴⁴ Gj.Shkurtaç, *E folmja e Rranxave të Mbishkodrës*, “Dialektologjia shqiptare” IV, Tiranë 1982, f.237.

⁴⁵ Gj.Shkurtaç, *E folmja e Kelmendit*, “Dialektologjia Shqiptare”, III, Tiranë, 1975, f. 71.

⁴⁶ B.Beci, *E folmja e Mirditës*, “Dialektologjia Shqiptare” IV, Tiranë, 1982, f. 97.

⁴⁷ Xh. Topalli, *Disa vërejtje për të folmen e krahinës së Pukës*, “Dialektologjia Shqiptare” II, Tiranë, 1974, f.325.

⁴⁸ B. Beci, *E folmja e Mirditës*, “Dialektologjia Shqiptare” IV, Tiranë, 1982, f. 97.

⁴⁹ B.Beci, *E folmja e Mirditës*, “Dialektologjia Shqiptare” IV, Tiranë, 1982, f.99.

⁵⁰ Gj.Shkurtaç, *E folmja e Rranxave të Mbishkodrës*, “Dialektologjia shqiptare” IV, Tiranë, 1982, f. 238.

drejtë, fill, fillak (G. f.88). Në Mirditë kemi **curril-i** – *rrjedha e ujit të çezmes*.⁵¹

quherdhe-ja – *çerdhe-ja* (G. f.95). Xh.Topalli, **çuherdhe-ja** – *çerdhe, fole*.⁵²

Komani: foskë-a – *gropë e vogël, fosë-a: fos-i, gropçel-i; ishte ba vendi foska-foska* (G.f.137). B.Beci na jep trajtën **fos** – *kanal që bëhet në shpate malesh për të pritë rrëketë që formohen mbasi bie shi*.⁵³

Fjalësi i Dukagjinit përfshin zonat e Dushmanit, Pultit, Shllakut.

Pulti: lodhënim – *djergënim* (G. f.237).B. Beci jep trajtën, **lollonim-i** – *llahusë, lëhonë*.⁵⁴

Fjalësi i Mirditës përfshin zonat e Fandit, Këthellës, Kryeziut, Oroshit.

Mirditë

kuq-i – *vegsh i math, i pa vegë, zen shum okë: vorba asht ma e vogël se vegshi, por me vegë, cinga ma e vogël se vorba, herë me vegë e herë pa të. Kur kush mbas buke epet në kuvend, thonë se: është ngishëm tash me mish prej kuqi e me raki prej kotrove* (G. f.222). Gjithashtu edhe tek B.Beci për të folmen e Mirditës kemi, **kuç-i** – *enë dheu si vorbë po pa veriga, përdoret për të zier mish*.⁵⁵

nrâte-ja – *nade-ja: u zgjova nrâte heret(ne nrâte heret) dje në nrâte; ndrâte-ja* (G.f. 280). B.Beci e paraqet **nate-ja** – *nade, mëngjes: “ tash nate nuk ke pse m’pret”*.⁵⁶

ofshë – *thirrje dhimbe: ofshë për mue: medet (turq), kej neshtrasha! kej!* (G.f.293). Gjithashtu tek e folmja e Mirditës kemi, **nrôte-ja** – *mëngjes*.⁵⁷

Siç vërehet, ky fjalor është një thesar më shumë për leksikografinë shqipe, i cili nxjerr në pah se sa e gjerë është gjuha e sa e thellë dhe me zona të panjohura na del ajo.

⁵¹B.Beci, *E folmja e Mirditës*, “Dialektologjia Shqiptare” IV, Tiranë, 1982, f. 97.

⁵²Xh. Topalli, *Disa vërejtje për të folmen e krahinës së Pukës*, “Dialektologjia Shqiptare” II, Tiranë, 1974, f. 326.

⁵³B.Beci, *E folmja e Mirditës*, “Dialektologjia shqiptare” IV, Tiranë, 1982, f. 101.

⁵⁴B.Beci, *E folmja e Shkrelit*, “Dialektologjia shqiptare” I, Tiranë, 1971, f. 316.

⁵⁵B.Beci, *E folmja e Mirditës*, “Dialektologjia shqiptare” IV, Tiranë, 1982, f. 109.

⁵⁶B.Beci, *E folmja e Shkrelit*, “Dialektologjia shqiptare” I, Tiranë, 1971, f. 317.

⁵⁷B.Beci, *E folmja e Mirditës*, “Dialektologjia shqiptare” IV, Tiranë, 1982, f. 113.

Por, në vazhden e fjalëve të Fjalorit të Gazullit, vërejmë edhe mjaft leksema të cilat, nuk i kemi gjetur në Fjalorët normativë dhe dialektorë të shqipes. Mirëfilli dihet, se rrugët për pasurimin e leksikut të gjuhës shqipe janë lindja dhe formimi i fjalëve të reja në gjuhë, ruajtja e kuptimit të fjalëve dhe shprehjeve ekzistuese, por mbi të gjitha edhe hyrja në leksikun e gjuhës standarde të fjalëve dhe shprehjeve që rrojnë në ligjërimin popullor. Rigjallërimi i këtij leksiku krahinor është aq frytdhënës, sepse, jo vetëm sjell leksema të reja të panjohura ose pak të njohura për mbarë shqipen, por duke qenë ekzistuese, të pranishme në fondin leksikor të shqipes, ato ngërthejnë në vetvete dy elemente.

Së pari, ajo që është e domosdoshme, pasurimin e gjuhës, rritjen e mënyrave shprehëse dhe komunikuese, përderisa ne vetë pranojmë, se gjuha është një mjet komunikimi, mbi çdo gjë tjetër. Së dyti, pasqyron dhe elemente të panjohura të prejardhjes fjalëformuese e kuptimore.

Këto fjalë, të cilat janë të pranishme në Fjalorthin e Gazullit, nëse përdoren në ligjërimin e përditshëm, do të zgjeronin edhe semantikën e vetë kësaj, pasi duhet theksuar, se edhe vetë gjuha standarde ndikon thellë edhe në fondin leksikor të secilit individ folës. Si rrjedhojë e kësaj, vetë individi konturohet në një numër fjalësh të kufizuara, duke lënë mënjanë këtë fond të pasur leksikor e semantik, të cilin vetë shqipja e ka të sajën. Duke u nisur nga ky numër fjalësh, ndeshen 60 emra, 29 folje, ndërsa mbiemrat dhe ndajfoljet janë në numër më të vogël, përkatësisht 7 mbiemra dhe 4 ndajfolje. Këto fjalë shënojnë nocione të ndryshme nga jeta e përditshme shoqërore e kulturore dhe do të ishte me vlerë që të lëvroheshin edhe në ligjërimin e përditshëm, dhe pse jo, edhe në mbarë shqipen, qoftë edhe për zgjerimin semantik të fjalës. Për të dhënë një kuptim të ri ose një nuancë kuptimore të re, mund të rigjallërohen fjalë si: **drasue** – *me shtrue, me veshë me drasa* (G. f.110); **me bukëzue** – (Ber. PK) *me hangër një grimë bukë* (G. f.74); **derdhoshë** – *me rrahue, me shtrue për tokë: i ka derdhoshë bora degët e mandavet* (G. f.108); **krahol-i** – *jelek-u (tyrq)* (G. f. 214); **vendçuer-ore** – *1.banuer i ngulun, toprakli (turq.). 2. tokë vendçore: me një pozicjon të mirë* (G. F.452) etj.

Po i rendisim më poshtë:

Pukë

dega-ja – 1. *dava, davi*. 2. *shamatë* (G.f.106).

degatë – *m'u degatë për punë të kota* (G. f.106).

dejprapët – 1. *dejprapë, mbë shpinë, mbë kokërr të shpinës, ra dejprapët.*
2. *i dejprapët: mbë shpinë: vënë gotën dejprapët e jo grahuq = vënë me grykë përpjetë e jo me grykë teposhtë (G. f.107).*

delmerja – *në toponym, curri i delmeres: çobaneshë, blegë-a (Shestani, ndër kangë) edhe, bleg-u (?) (G. f.107).*

*dënue, dinue – m'u pakue; u dënue vëna në vozgë, dënoe pak ata lang mos të derdhet (G. f.108). Gj,Shkurtaj jep trajtën, **dnoj-,ova,-ua** – pakësoj, mbaroj diçka.⁵⁸*

drrasue – *me shtrue, me veshë me drrasa (G. f.110).*

drrasim-i – 1. *shtrojë, e veshme drrasash.* 2. *vend i nalcuem me drrasa; kishte hypë mbî një drrasim e po kuvendëte të madhe (G. f.110).*

detuer-ore – 1. *qi vjen prej deti, borë detore, poç detuer: kungull-pijës.* 2. *qi rritet në det a afër deti: peshk detuer (G. f.110).*

përlim-i – *detyrë, me zbatue përlimin: me la borxhin (G. f.311).*

Berishë

me bukëzue – (Ber. PK) *me hangër një grimë bukë (G. f.74).*

bungvogli – (Ber. PK) *një farë bunge (G. f.75).*

fërshlye – *fëshëllye, shëllye (G. f.128).*

karsh-i – *vend karsh, a kërh; gerdhaië, mbushë me gurë e shkambij (G. f.193).*

knarë – *m'u gëmushë, gërmucë: me i u knarë kuj: knarrë (G. f.205).*

pândë-a – *panda e shpisë: ngreha me gjithëshka ka: fryni një erë natën me tërbim e i a hodh pândën e shpisë në breg të Drinit (G. f.298).*

përmjetue – *me plotsue dishka djerë në mjet (mjedis); e përmjetova gotën së mbushëmi (G. f.313).*

rrem-i – *mend-i, e mora mbë një vrem, ças-i (G. f.462).*

Blinisht

ashemb-i – *mallkim-i, e ke me ashemb m'e bâ këtë punë (G. f.50).*

torrec-i – *pergjel-i, kompas-i (G. f.428).*

vraçue – *me vrá mizorisht e me shumicë, me ba kërdi (G. f.461).*

Behot

sarushtë- a – *bimë, Scrofularia (G. f.366).*

⁵⁸ Gj.Shkurtaj, *E folmja e Rranxave të Mbishkodrës*, "Dialektologjia shqiptare" IV, Tiranë, 1982, f. 238.

shajkë-a – *është quejtë (gabimisht) sheka e mullinit, si ni bucjelë qerri me fletë të ngulme vrangull, me të ndeshun në rrymë t'ujit sillet e bân me luejtë të gjitha veglat e mullinit. Këjo vegël parake kje zbatue edhe ndër sendërgjime të reja.*(G. f.385).

thuk-u – *shterë-a, havan-i, kupë guri, drûni, metali për me shtypë mbrendë shka do: je shëndoshë e bâ si thuk* (G. f.440).

Qelëza

baltik-e – *vend, tokë baltike: tokë me lagështinë* (G. f.53).

bërbâ-ni – *mashkulli i bletës* (G. f.59).

biterr – 1. ? 2. *mârrë mendsh: jam bâ biterr e s'dij kah i a mbaj* (G. f.63).

brrokë – **a** – 1. *kërroqe, kaçie bâ me lëvore blini*. 2. *rreth i gjânë lëvoresh, qi u a vëjnë dhijvet në qafë mos me thithë vedin* (G. f.72).

buhnajë-a – 1. *pluhnajë-a: u çue buhnajë prej ere e na i muer sytë; pluhun i madh; krh. djalekt. ital. shqipëtar. buhnë-a: puhun-i (de Rada): çtiei te kjelkji kë buhna: shtije ndë kelq ktê pluhun! dhe molinë, tokë molinë* (G. f.74).

cecinë-a – *cegëm-i; mot acar, acari e madhe; është cecinë e madhe* (G.f. 82).

currîtë – *i drejtë, fill, fillak; mende e currîtë, mende e drejtueme fill mbas nji sendi* (G. f.88).

qokë-a – 1. *birë, vrimë në drû a gur, rrumbullake a e gjatë; vi, ku hyn shtërngueshëm nji copë tjetër e përputhme; germ. Nut, fjalë landëtarësh, edhe: fëmën – a. sh. këthîc-i. Fraz. Me kë në qokë, me i pasë mend mbëtë, tëpërmbledhme. Me ira në qokë fjalës, kuvendit, pûnës, me i ra mbë të, m'e diktue; krh. djalekt. friulan divenire cioc: m'u dejë, m'u bâ në qëf* (G. f.94).

derdhoshë – *me rrahue, me shtrûe për tokë: i ka derdhoshë bora degët e mandavet*(G. f.108).

drang-u – 1. *shul i trashë qi i vehet derës për tërthuer m'e shtërngue*. 2. *hû i math e i gjatë me shty barkën* (G. f.113).

dulltak-u – *granit-i, gur vulkanik me kokrriza të gastarta të krypësorrës, të gurgacit e mikës* (G.f.116). etj.

Çerreti i Poshtë

frymue – **frymnue** 1. *me mbushë me frymë, me idhnue*. 2. *jam frymue në N.N: jam mbushë me frymë, idhnue* (G. f.138).

Dardha

ndërlisë – *ndërkue (ndërlikue: me qitënë një lik tjetër; kush din se ku jemi ndërkulisë e s'mund u ndeshëm) (G. f.283).*

teshue – *hakrrue, janë teshue dosat: mbarsë (G. f.425).*

Kabashi

bashkari-ja - *merá, hali: motit edhe frati-ja (G. f.57).*

hijenue – *me ndejë nën hije, me kalie nën hije zhegun e ditës: ç'po ban këtu? Po hijenoi (G. f.176).*

ndrijue – *m'u mbledhë në vedi, thuhet sidomos për misa të trupit që ndrijohen, ngrihen tue u mbledhë, shtangohen (G.f. 287).*

përf tue – 1. *këjo lopë ka përf tue njat viç. 2. përtri (G.f.308).*

stihë – *me ngucë, stihue, idhnue: njaj më stihon (G. f.379).*

Këçira

drobe-ja – *shpend liqejsh e ujnash; fraz. s'mund lozë vendit me sa një drobe, trobe, trope (G. f.114).*

fetak-e – *njeri fetar tek s've, fanatik-e (G. f.129).*

shtâng -u – 1. *maje heshte, shgjetë? 2. çmim i kputun: i kanë vû shtangun okës së kollomboqit (G. f.411).*

Komani

allçëniku – *nji farë guri njeje së rubinit që në katund të Komanit gjindet edhe mbi dhe, në zjarm digjet; përdoret me shkrymbë varrët (G. f.45).*

bibrak-e – *lakur (i-e), blec-e, curak-e (G. f.61).*

bonjake (tokë) – *tokë e trashë e me ujcinë, vruinë (G. f.66).*

qallë-a – 1. *varra që bânjë veglat prese tue u mbëshue me tef (jo me maje). 2. varrë, vizë që u bâhen në kambë disavet, pse ecin zbathun, a prej ndonji lëgate: mëjanë bâ kambët qalla-qalla (G.f.89).*

flâmër-i – *flâmra, t. 1. flamur-i, flamujt, t: me luejtë flamrash; natën e shën Gjinit lidhin me kurpna vandakë byku e i djegin tue i sjellë rrokull me duer. 2. bajrak-u (G. f.134).*

Midha

bângëc-i – *nji bangëc bore: top bore (G. f.55).*

bokërr-a – *mî fushe në njeje të ndryshkut, rrenon bimët e biron bagtin, sidomos n'eshke e në të leth* (G. f. 66).

carde-ja – *ngarkicë, ngarkesë e vogël. 1. sh. Bashk. fq.477, pjesë, grup-i* (G. f.80).

cijue – 1. *me tingllue veshët. 2. me kjenë prekë a gjetë prej ndonji rreziku: në mos të ndigjofhtë, ka me i cijue në vesht!* (G. f.82).

çup-i – 1. *mos më ndigjofhtë, po e hjedh në çup tëarmit: në truell, votër të zjarmit. 2. burr me flokë të shkurtën; çupë-a, fëmën flokëshkurtë, prandej: çupë-a, vajzë-a pse s'i ka flokët e gjatë si të martuemet* (G.f.103).

gërmë-i – *gjâ e vogël e pa fuqi, p.sh. dritë e gërmë* (G.f.147).

Miliskau

zhÿm-i – *pluhuni, hîni qi len duhani i djegun: zhÿm pilave: zhÿm cigare* (G. f.476).

Ukthi

andaq- e – *andaq pune, mësimi* (G. f.45).

bakalimth-e – *i vocërr me vjetë: fëmi bakalimth* (G. f.52).

pjerzë-a – *bimë, Cenopium bonusenricus* (G. f.32).

Dukagjini

krahol-i – *jelek-u (tyrq)* (G. f. 214).

krrokullë-a – *mbërrokullë-a, gjymtyrë qi bashkon ashtin e kofshës (koçallakun me kopaç* (G.f. 221).

lasë-a – *të lamë: shala prin në lasë të duerëvet(në kanû të lekës kurse bahen çabulle)*, (G.f. 230).

llokatiq-i – *tambël i tundun qi asht hjekë tlyeni* (G. f.245).

mârrtas – *difton mungesën e dishkahit, p.sh.: mârrtas dielli kûênka çue! (prej rêsh qi e mbulojnë, i mârrun drite)* (G.f. 250).

mbëzuçkë-a – *tureçkë-a, turini (krh. floçkë, prej flokëç, mbëzukeç = buzë)*,(G.f.256).

mtue – *krratë, s' të mton kush për gjâ, mtoi me mârrë diç* (G. f. 271).

ndërshejçë-a – *pikëzore, drrasë tjegulle kalore* (G.f.284). Tek B.Beci kemi foljen **nërshej** – *në mes: “vin e u hin nërshej Shkrelit e Lohes”, “u prishen nërshe vedit”*.⁵⁹

⁵⁹ B. Beci, *E folmja e Shkrelit*, “Dialektologjia shqiptare” I, Tiranë, 1971, f. 317.

pit – *dola pit në maje: përjetë në maje: pjet' e në mâje* (G. f.325).

rupë-a – *përjetëz, bjeshke, faqe mali me pak shkrepë e me kullosë* (G. f.347).

Dushmani

ryzue- *m'u dalë përjetë petkavet, m'u vjetruet petkat; si eryzove kështu brezën!*(G.f.348).

Pulti

logue – *rrafshue* (G.f.238).

lpâ – *me bâ në të prirun, në të lam; me lpâ gurin: m'e latue në të lam* (G.f.239).

lpatë – *në prrike, me prrike: ngruhe gurin lpatë e jo thik* (G.f.239).

lugë llaçi – *mistri-ja, vegël këthistarësh, me marrë llaçin me i a vum gurit* (G. f.240).

llakë – **a** – *llakë bore: skllotëre, flok (flug) bore qi shkrihet sa të bie në tokë*(G.f. 244).

maranaje-t – *rrëshajët, pse ndër të kreme të Rrëshajvet dilej në mâje të Malit të Maranajit, ku duket kje ndonji kishë në zâ* (G.f.249).

megue – *me megue drita: me ague* (G. f.258).

përmjet – **i** – *qendra, mjedisi: këtu është përmjeti i katundit* (G. f.313).

spajni-a – *dukë, të dukun, vegim* (G. f.384).

tângë-a – *dâm, paragjykim; me i a lâë, me i mbetë kuj tângë, një fjalë, një punë* (G.f. 420).

Shllaku

orrlë-a – 1. *urrlë-a, velgjë i pa rrëshinë*. 2. *molikë-a*. (krh. fj. urrë-a). 3. *sbardhulinë-a një rreth i ri prej së bardhi qi i shtohet për gjithëjetë lisit* (G.f.294).

vendçuer-ore – 1. *banuer i ngulun, toprakli (turq.)*. 2. *tokë vendçore: me një pozicion të mirë* (G. F.452).

Mirditë

krratë – *me kqyrë kendin për një send, me mtue. Nuk u ba pleqnija me të drejtëpse pleqt krratshin me hangër pare* (G. f.220).

krrokë – *thohet për brimë qi lëshojnë korbat, bretkocat; korbi, krrokë, u*

ndie nji korb tue krrokë (G. f.221).

kylë – *me mbushë: ç'i paska kylë Zoti zgjojt me mjaltë* (G. f.226).

lapë-i-ë-a – *i venduem përfundi, i pëfundë, i poshtër; përk. i popë, i venduem për sipri, i epërm. ? krh. top. në bjeshkë të Mundellës: livadhi i lapë, e liv. i popë* (G.f. 228).

latrac-i – *planc, bark bagëtije me zgrof e zorrë* (G.f. 231).

mështekën-a – *mushtekën-a* (G.f.262).

përgjegjë – *përgjakë, lëvyrë, gjaknue: jam përgjegjë, luftë e përgjegjëme; më duelën thijat e përgjegjëme* (G.f.309).

taritik-u- *djál i burrëzuem, tarabak, taraman* (G.f.421).

Fandi

lezmue – *me ikë; lezmo, lezmuen të gjith* (G.f.235).

milcue – *me i hjekë drrasës, para se m'e vû në sdrug, lyerthat (mullâjt) qi ka, me ûntue* (G. f.264).

popeç-i – *popel (Bashk. 358), papëhok-u, kokërdhak guri* (G.f.331).

Këthellë

parrî –ni – *shpirt i keq, i lig, damtuer* (G.f.300).

satullue- *jam satullue së ftofti: jam ngrucë, ngrrucë, mbëledhë trupit prej së ftofti* (G. f.382).

shtëjkë-a – *të therun, dhimbë e fortë, më ka kapënji shtëjkë e fortë ndër brî, qëndër-a* (G.f.410).

Kryezi

krrâe-ja – 1. *e drejtë a arsye qi mund të et a qi kujtohet se asht mbi nji send, a me veprue a me ndejë dorëjashtë a mos me e ba nji punë; mtesë-a: m'erdh te dera me shum krrâme, s'qitet me krrâme të tija!* 2. *shbajtë: ligështina, lëngatë të vijue me në trup; halle: si po je, me krrâme shum!* (G.f. 220).

kusuferr-e – 1. *njeri qi tinëz mundohet me shti keq.* 2. *njeri qi punon tinëz (mbas ferrash?)* (G.f.226).

lauricë-a – *grue e pambarre, kalore-ja* (G.f.232).

mestitë – *me majë bagëtin, p.sh. thitë* (G.f.261).

mjerthi – *mjerthin, dernathi* (G.f.265).

preq-i – *bigëz-a, drû e bigzue me qi ngulet në majë të mullarit të sanës*

(*kashtës*) për mos me marrë era kapliqin, pâmën, duokun (G.f.334).

Fjalësi i Ulqinit

majere- ja – *vesha e drùjtë e fluskës (përjashta)*(G. f.247).

vërzën-a – *verëzën-a, e veshëmja e përmbrendëhme e fëluskës,përk.Majere* (G.f.453).

zym-i – *hekur qi nën uj lidhë presin e fëluskës me ballpresin* (G.f.472).

âni i dorës – *nëni i dorës* (G.f.47).

fagû-ni – *zjarmishta, gjelltorja n'ani, sh. fogû* (G.f.125).

Bregu i Buenës

mângël-a – *makinë-a: manglat e vaporrit* (G.f.248).

plêngë-a- *bahe, békë* (G. f.328).

Të gjitha fjalët e mësipërme mund të përdoren sipas rastit për të pasuruar thesarin leksikor të gjuhës shqipe, ose pse jo, për të zëvendësuar fjalët e huaja.

Një tjetër çështje me interes për t'u trajtuar në Fjalorin e Gazullit, është se shumë fjalëve u jep sinonimin përkatëse në gjuhën letrare ose të folmen dialektore, por ka nga ato, të cilave ai u jep vetëm një shpjegim me fjali. Kjo na lë të kuptojmë se Gazulli nuk gjente përgjegjëset e lemave krahinore në gjuhën e mbarë shqipes ose edhe në dialekt, për këtë arsye, ai jepte kuptimin e fjalës duke e shoqëruar me fjali.

Po i vërejmë duke i radhitur si më poshtë:

Fjalë krahinore që i ka vënë sinonimin në gjuhën letrare / dialektore.

Në këtë rast, autori pasuron leksikun e shqipes me sinonime stilistikore ose semantike, ngaqë fjalët me burim popullor mund të hyjnë në marrëdhënie sinonimike me fjalë të tjera të leksikut të gjuhës standarde, por edhe të folmeve krahinore e dialektore. Kjo ndikon edhe në rritjen e fuqisë shprehëse të fjalëve përkatëse. Vërejmë, pra, se edhe në këtë pikë autori ka treguar se është një njohës i thellë i fjalës shqipe, duke e gjurmuar atë deri në gjetjen e sinonimit përkatës.

abulli-i – *avull-i*(G.f.43).

acar-e – *grue acarë= e dliirët, veshëacare; mot acar = i ftofët* (G. f.43).

aft-i – *afti i borës bjen të ftofët; ajri, tafti* (G. f.43).

- aktund-i** – *rend, kurá (tyrq.): kur i erdh aktundi me shkue ushtar (G.f.44).*
- âmë-a** – *ka âmë vojquri, buka paska âmë të randë: âmë e mirë: shije, a (G.f.45).*
- andshëm-** *i kandshëm(âtcëm:ândë, âtë) (G.f.46).*
- âng-u** – *ângth, ânkth (G.f.47).*
- anvishë-a** – *amvizë = zojë shpije, zojnore (G.f.48).*
- babarrun-e** – *i fortë, trimaloç-e: i fuqishëm shtatit (G.f.51).*
- balc-i** – *ushkur-uri (G.f.53).*
- ballahû** – *kundruell, ndër sy: s'mund i thom ballahû: s'mund i a përplasi ndër sy, s'mund i thâm kokërdhak. M'a bâni njatë punë ballahû, më foli, i ndëja (ballahû- kokërr) (G.f.54).*
- buhnajë-a** – 1. *pluhnajë-a: u çue buhnajë prej ere a na i muer sýtë: pluhun i math;krh. djalekt. ital. shqipëtar. buhnë-a: pluhun-i (de Rada): çtiei te kjelkji ktëbhna: shtije ndë kelq ktë pluhun! 2. dhë molinë, tokë molinë (G.f.74).*
- cahë** – *me pague: nuk të lëshoj pa m'i cahë paret e mija (G.f.79).*
- qas!** – *largo! Kështu u thërrasin bagëtitet pëlleja, kur i mjelin; qase kambën: largoe! (G.f.89).*
- qasue** – *me sajue, me bâ sajimin e shtëpis: me qasue shpin (G.f.89).*
- qëmër-a** – 1. *gjarpnim-i, të sjellunat qi bâ gjarpni tue u hjekë rrëshqânë. 2. shtrëmbënim-i, shtrëmbë-a - ; e ka ba murin qëmra qëmra: leqe leqe (G.f.90).*
- çafodhe-ja** – 1. *krahnoshe, krahnorcë. 2. çantë lëkure a tjetër sehit, valigje (G.f.97).*
- çakraman – e** – *shakllaban- e(tyrq); vagabond (it.) (G.f. 97).*
- çamër-a** – *çamër buke: grimcë, dromcë buke (G. f.98).*
- çeftuz-e** – *çehresuz, me fytyrë të keqe; s'ka mâ burr çeftuz se ishte (G. f.99).*
- dak-u** – 1. *dash-i. 2. êmën kombtar (G. f.104).*
- danik-u** – *odë e veçueme për ndonji qëllim (G. f.104).*
- dritës-a** – *kandil-i (G.f.114)*
- ëndë-a** – *të luluem, t; koha qi êndin lulet, qi nisin me çilë. 2. e diellja e êndës(PK): e diellja e Larit (G.f.122).*
- fajkore-ja** – *take-ja, lundër e madhe (G.f.125).*
- gjakim-i** – *dëshir i flakët, i ndezun; lakmi (G.f.162)*
- pi** – *mbi shpi, mbi rrugë, sipri, sipër (G.f.319).*
- rime-ja** – *rrême, karrême, rrajzë-a për bubës-it, fraz. ishte si rime (G. f. 357).*

Fjalë krahinore që i ka shpjeguar me fjali: Këto fjalë me burim popullor, të cilat rrojnë të gjalla në krijimtarinë gojore, por edhe në gjuhën e folur,

munden mirëfilli të zëvendësojnë huazimet e panevojshme që hyjnë edhe sot në gjuhën shqipe. Kështu mund të zënë vendin përkatës fjalë të tilla, si:

emra:

balishan-e – *kush lë balishën* (G. f.53).

baltimë,t – *me hangër sa me hjekë baltimën e gojës: të keqt qi merr goja prej së pa ngrânmi; të baltimët* (G.f. 53).

ballafaçkë – *të ramë të fyeshëm, e bjerrme me zhurmë; e muer e fitoi një ballafaçkë* (G.f.53).

bastarr-i – *kacafit-i, kësoll' e vogël sa me xânë një a dy vetë, ngrehër me ruejtë bastanin, berret, etj.* (G.f.56).

bucak-u – *ênë uji prej drûni, me çep a lëfyt si jebriku* (G.f.73).

capë-a – *dhe a shtrat dheu i forcuem prej motesh si çemento, i gurzuem, peqinë (slav), harasan (tyrq)* (G. f.80).

qeradhyke-ja – *copë drûje qi s'âsht bâ thingjill (qymyr) qerradhyk, qerradhyke-ja* (G.f.92).

çallapinë-a – 1. *grue e shkatrrueme ndër rângë, e lânun fare.* 2. *shpi e vjetrueme* (G. f.98).

çapell-i – *dy fiq të thatë të hapun dysh a të çam e të lidhun bashkë, të përputhun; përkundra: fik njëjës; fik i vetëm, i that e i vûm nëpë varg me tjerë* (G.f.98).

çojë-a – 1. *të çuemit, kur dyndën prej fushe në bjeshkë, e prej bjeshke në fushë; kohë e çojës, kur të vijë çoja.* 2. *në poezi kishte me kjenë: arsis (çojë zâni)* (G.f.101).

esull-i – *agjinesë e shtërngushëme, kur s'shtihet gjatë në gojë, me kënë nd'esull(a t'esull) me ndëjë nd'esull, krh. n'ujë, e t'ujë* (G.f.125).

petanuer-ore – 1. *tokë a mal si pet shkalle.* 2. *i bâm në trajtë të shkallës: tokë petanore.* 3. *qetë e naltë a shkambij ndër brigje t'ujit me patalok përsipri a strehë përfundi* (G.f. 318).

êmnesë – *ngjarje në shêj, qi s'harrohet; frz. u bâ një emnesë e motit, një e ngjame m'u pëmendë për mot e mot* (G. f.121).

mbiemra:

akulltar-e – *njeri qi e ka menden akull, qi i peshon fjalët* (G.f.44).

ardhshëm- *njeri i ardhshëm: qi i vjen punës, arsyes: i ndigjueshëm, i shoqnueshëm; punë e ardhshme, qi vjen për doresh, njeri i ardhshëm me kuvend: qi i vjen arsyes* (G.f.48).

dêjun – 1. *tokë e dêjun, ku âsht shkri a ulë bora, tokë e vûtë, e plantë.* 2. *horizontale: m'e vû një send në të dêjun* (G.f.106).

folje:

cacë – *ka nisë fëmija me cacë* (G.f.79).

qepue – *m'u shkri e m'u baâ nji; guri i shkrim qepohet për gur të shkrîm* (G.f.92).

qesllue – *me i dhânë frymës jashtë tue u kullë lehtë; sh. qellëxue* (G.f.92).

dendë – *me mbushë barkun e m'u dendë = tendë* (G.f.108).

derdÿ – *me ngurrue tue mbetë ndërdyzash, me kjenë ndërzyzash; njaj njeri derdÿhet m'e ngrehë nji shpi* (G.f.108).

derdhë – *me derdhë kollin, lin etr. thohet për kangë a lëngatë qi s'kthejnë mâ, mbassi të shndoshemi nji herë* (G. f.108).

êgjue - *më janë êgjue do delme, më kanë mbetë êgja do delme; êgjë,êjë, i thonë delmes a dhis pse u mbahet nji kingj a edh i huej në të mjelun, kurse u ka cofë i veti.* (G.f.121).

gjelbëzue – *m'e shijue haen me dishka: gjelbëzo me djathë se t'a smilon haen !* (G.f. 165).

ndajfolje: afërmendësh – *mos fol afërmendësh: mos fol nëpër të, dishka atypari, jo gjâ të njimendët- kjo punë âsht afërmendësh* (G.f. 43).

Këto fjalë të rralla që i vërejmë në këtë fjalor, janë fjalë që përdoren në ligjërimin popullor në zona të ndryshme të Veriut të Shqipërisë. Ato dëshmojnë për një gurrë të çmuar leksikore të fondit shqip dhe na japin larminë e shumëkuptimësinë e përdorimit të fjalës shqipe me ngjyrimë e përftesa që vetëm një filolog si Nikollë Gazulli ka ditur t'i mbledhë e të na i pasqyrojë në këtë Fjalorth, siç e quan ai. I marrë në tërësi, fjalësi i Gazullit, pasqyron qëllimin e mirë për të nxjerrë në pah pasurinë leksikore të shqipes dhe punën e kujdesshme për të ruajtur pastërtinë e gjuhës dhe për ta mbrojtur atë nga huazimet e tepërta.

Ledi Shamku shkruan “*Nxjerrja e gegnishtes nga hiesina dhe reshtja e ftohtësisë ndaj saj kërkon dritë; dritë që ende nuk është ndezur, porse mund të ndizet në çdo rast. Fjalori i Gazullit është një pjesë rëndësishme e kësaj drite*”.⁶⁰

⁶⁰ L.Shamku - Shkreli, *Parathënie e botimit anastatik*, “Fjalori i Gazullit”, Tiranë, 2005, f.16.

BIBLIOGRAFIA:

- N.Gazulli, *Fjalorth i ri*, Shkodër, 1941.
- Gjovalin Shkurtaç, *E folmja e Hotit*, “Dialektologjia shqiptare” II, Tiranë, 1974.
- B. Beci, *E folmja e Shkrelit*, “Dialektologjia shqiptare” I, Tiranë, 1971.
- B. Beci, *E folmja e Mirditës*, “Dialektologjia Shqiptare” IV, Tiranë, 1982.
- Gj. Shkurtaç, *E folmja e Rranxave të Mbishkodrës*, “Dialektologjia shqiptare” IV, Tiranë, 1982.
- Gj. Shkurtaç, *E folmja e Kelmendit*, “Dialektologjia shqiptare” III, Tiranë, 1975.
- L. Shamku - Shkreli, *Parathënie e botimit anastatik*, “Fjalori i Gazullit”, Tiranë, 2005
- Xh. Topalli, *Disa vërejtje për të folmen e krahinës së Pukës*, “Dialektologjia Shqiptare” II, Tiranë, 1974.

**The Northern Provincial Dictionary in the Glossary
of Nikollë Gazulli**

ABSTRACT

Nikollë Gazulli, with his impatient work, gathered words and popular expressions from the area of Malesi e Madhe. Geographically and dialectologically, Malësia e Madhe and Shkodra are very close to each other, so it should be noted that Gazulli has reflected the northwestern speech. In this article, we will treat the lexicon, which is extending beyond the areas of Malesia e Madhe and the city of Shkodra.

In the words of Gazulli glossary, we also notice a lot of lexeme which we have not found in the normative dictionaries and dialects of Albanian language.

These words, which are present in this Glossary, if used in day-to-day discourse, would also broaden the semantics of this, as it should be noted that the standard language itself also has a profound impact on the lexical fund of each individual speaker. As a result, the individual is contradicted in a number of limited words, leaving aside this rich lexical and semantic fund, which Albanian language has.

These words mark different notions from everyday social and cultural life, and it would be worthwhile to spread them even in the daily lecture, and why not, even in the whole of Albania, or even for the semantic expansion of the word.

Arjola HOTI, Afërdita ANAMALI

VËZHGIME MBI DISA DUKURI GJUHËSORE NË VEPRAT E ËNGJËLL RADOJËS DHE PASHKO BABIT

Vendin e parë, përsa i përket prodhimtarisë letrare, e zë letërsia e lëvruar nga shkrimtarët e veriut. E iniciuar në shekullin XV, ku shkrimtarët kryesorë janë: Buzuku, Budi, Bardhi, Bogdani, Kazazi, arrin e kompletuar gjer në shekullin XIX me shkrimtarë: *Pjetër Zarishi, Ëngjëll Radoja, Dario Buçareli, Leonardo De Martino, Ndue Bytyçi, Pashko Babi, Preng Doçi, dhe Zef Jubani (Ndokillija)*.⁶¹

Ky prodhim letrar u zhvillua nga pena e atyre shkrimtarëve, shumica e të cilëve, botuan shkrimet e tyre nga Propaganda Fide dhe ishin nën patronazhin e kishës katolike që ishte e orientuar nga Italia. Katolikët e Shkodrës, në mesin e shekullit XIX, ishin edhe nën mbrojtjen e Austrisë, e cila nëpërmjet një pakti traktatesh me portën e lartë kishte fituar të drejtën e mbrojtjes së popullsisë katolike në Ballkan, ku ishte e përfshirë dhe Shqipëria. Nga ky grup shkrimtarësh, për arsye studimi, veçuam Ëngjëll Radojën me “Doctrina e kerscten me msime e scpiegime” dhe Pashko Babi me “Vakinat e t’ligs herscme e t’ligs ree” që me origjinalitetin e tyre dhe realizimin e veçantë gjuhësor, më inkurajuan për të iniciuar këtë studim, i cili ka si qëllim të listojë e inkuadrojë disa prej dukurive gjuhësore të veprave.

Nga jeta dhe veprimtaria e autorëve.

Ëngjëll Radoja (1820-1880)

Jeta.

Klerik, mësues dhe shkrimtar i gjysmës së dytë të shekullit të nëntëmbëdhjetë, Ëngjëll Radoja lindi në vitin 1820 në qytetin e Shkodrës dhe vdiq në vitin 1880 në Venecia. Njihet ndryshe me emrin dom Angelo Radoja, iniciuar nga shërbimi i tij si prift katolik. Studimet i kreu në kolegjin e Propoganda Fides në Romë. Pas përfundimit të studimeve do të kthehet në Shqipëri dhe do të shërbejë me devotshmëri si famulltar në

⁶¹ Robert Elsie, *Histori e letërsisë shqiptare*, Tiranë, 1997, f. 164.

qytetin e Shkodrës dhe më vonë si vikar i përgjithshëm i dijoqezës po në Shkodër.

Radoja ishte një njeri me kulturë të gjerë, njohës i shkëlqyer i latinishtes dhe i shqipes, patriot i dalluar, e mbi të gjitha ai vlerësohet për përpjekjet për t'i dhënë një karakter letrar veprës së tij duke u afirmuar edhe në krah të autorëve të tjerë bashkëkohës të cilët shfaqën shqetësimin e tyre për përdorimin pa kriter të arabizmave e turqizmave.

Veprimtaria letrare.

Ai është i pari shqiptar i asaj periudhe që botoi në Romë, më 1862, librin shqip “Jezu Krishti n’zemër t’Meshtarit “(kujtime t’shpirtit ç’do t’ket meshtari për gjithsecilin dit t’motit).

Më pas boton librin e dytë, “Konçilli i Dheut të Shqypnis” bamun n’viet 1703 n’koh t’Paps Shqyptarit, Klementit t’Njimdhetit, Botim i tretë KA 1706 (ripërkthim i variantit origjinal latinisht). Ky do të jetë rrugëtimi që do të marrë më pas ky shkrimtar, pasi botimet e mëpastajme i shkruan në shkodranishte, dialekt që kishte traditë të gjatë shkrimi.

Me 1876 në Shkodër, do të botojë “Doctrina e kerscten me msime e me scpiegime”.

Dy ishin shtysat kryesore që e nxitën të shkruante, së pari edukimi fetar dhe së dyti angazhimi në çështje kombëtare. Në veprat e tij spikat *pikëpamja e tij patriotike*⁶², sidomos mendim që e shpreh hapur tek “Kuvendi i Arbnit”, pasi “Doktrina e kershten “mbështetet sidomos në subjekt laik. Do jetë pikërisht ky angazhim me qëndrimin e tij antiaustriak, por mbi të gjitha qëndrimi antiturk, i cili do t’i marrë jetën në vitin 1880 nga një helmim i rëndë⁶³.

Pashko Babi(1843-1905)

Jeta.

Pashko Babi lindur dhe rritur në qytetin e Shkodrës në vitin 1843, reflektonte sjelljen dhe bujarinë e një shkodrani. Hyri në shkollë në moshën tetëmbëdhjetë vjeçare dhe për pesë vjet kreu studimet në Kolegjin Papnor Shqyptar. Gjithë jetën e kaloi si famulltar nëpër katunde të ndryshme e sidomos në Sheldi. Për një kohë, Babi shërbeu në famulli, ku radhiste regjistra famulltarë të Sheldis, ku mbante shënim kronikë të ndodhive të vendit. Më pas shërbeu si famulltar në vende të ndryshme të Shqipërisë.

⁶² Ismajli, Rexhep *Gjuha shqipe e Kuvendit të Arbënit / 1706*, Prishtinë, 1985, f. 39.

⁶³ Shuteriqi, Dhimitër *Nëpër shekujt letrarë*, Studime letrare, Tiranë, 1973.
Shkrimtarët shqiptarë, Tiranë, 1941, f. 152.

Letrat që shkruante Babi patën një vlerë gjuhësore për historinë e gjuhës shqipe.

Veprimtaria letrare.

Por botimi i parë i plotë është vepra “Vakinat e lig’s hershme dhe lig’s ree”, botuar më 1882. Ky libër realisht ishte shkruar me qëllim që të shërbente si teks shkollor. Babi shkroi dhe dramën “I biri i çifutit”, duke e emëruar atë si një ndër dramaturgët e parë shqiptarë. Pasuria e mrekullueshme e gjuhës, me një frazë “plot gjallëri ngjyrash”, është strukturuar mbi bazën e një rrëfimi (kallzimi) shpesh edhe me subjekt bashkëbisedimi. Mbizotëron një ndërthurje klasike mes një rrëfimi klasik e popullor njëherë, duke e bërë veprën e tij mjaft tërheqëse dhe të naltueshme.

Me dëshirë dhe interes të madh lexohet vepra e Babit, por fatkeqsisht për shumë kohë ky autor kishte mbetur nën hijen e territ dhe nuk u vlerësua me kohën, pavarësisht faktit, se shpesh thuhet që ky shkrimtar ishte pararojës i shkrimeve të mëvonshme. Gjithsesi Pashko Babi është dhe mbetet një ndër ata letrarë që denjësisht përfaqësuan letërsinë shkodrane të shekullit XIX.

Dukuri gjuhësore.

1.Gjinia e emrit.

Krahas shembujve që kemi identifikuar gjatë studimit të veprave dhe që janë në pajtim me formimin e gjinisë sipas rregullave gramatikore, veçojmë disa emra që nuk dalin në vepër në të njëjtën gjini që janë sot. Kështu emri i gjinsë mashkullore lig-i në veprën e Pashko Babit nuk e formon trajtën e emrit me mbaresën –i, por me mbaresën –a p.sh. ... po *ligia* si thot? (Vakinat 229) \ ... nee *ligia* jon nuk na ep... (Vakinat 160)

Ndërsa tek Ëngjëll Radoja e ndeshim të përdorur vetëm në rasën kallëzore, si një emër të përveçëm, në trajtën... nuk e ruin sceiten *Ligen* e tii... (D.C.f.23) \ ...ci discmoïn gith-ugniï Feen e *Ligen* ... (D.C.f.33)

Po kështu me trajtat e gjinisë femërore del edhe emri lot-i me formën lodja p.sh.:

... e kriscti i sckoi *lodja* ... (Vakinat 244) \ ...Mannei ja lscõi duert gïafs Beniaminit e e mor n’gryk e sckoi *lodja* per ... (Vakinat 47)

Në analogji me emrat e mësipërm edhe emri profeti del në formën profeta... asct ai *profeta* qi ka paas per t’arç... (Vakinat 217)

Shembuj të tjerë listojmë: ... aty nuk dihei scka asct *dergia*... (Vakinatn 10)

\ ... me i ba vennit sceit hysmetin... si t’ju bite *scordja* ... (Vakinat 96) \ ...

sikur ban giymyri prusc e *druja* zierm (Vakinat 105) \ ...ka pak, ka pak u myç *cila* e mannei derçi sci. (Vakina f.114) Mos t’ju marre *droja* (Vakinat f. 47) ... perse n’ciel ka per t’keen e maçe *scperblesa* gi keni per t’giet (Vakinat f. 146)

Persa i përket emrit pyll, po tek shkrimtari Babi, vëmë re se pavarësisht faktit që ai përdoret në gjininë mashkullore, përcaktuesit e saj i merr në gjininë femërore. Mendojmë se kjo mund të ketë ndodhur në një pikë të zhvillimit historik kur në gjuhën shqipe po ndodhte procesi i kalimit të këtyre emrave nga gjinia femërore në atë mashkullore.

(Babi): Lufta u zuu n'gni *γγλ t'madhe*, asgjerit Assalonit ju ça mrapscta e u ξξye. (100)

Emri pushteti, i cili në një pikë të zhvillimit historik ishte përdorur si emër i gjinisë femërore, tek Babi e gjejmë të standardizuar në trajtën: ...e ja ka çan *pusctedin* me ba giγgin m'si Biri i nierit asct (ka niersia).

2.Dygjinisia.

Duke ndjekur këtë dukuri në veprat, vëmë re se ajo është shtrirë tek të gjithë emrat e gjinisë mashkullore, por edhe tek disa emra të gjinisë asnjane që e duan patjetër përcaktorin mbiemër përemër a numëror të gjinisë femërore.

Pra, karakteristikë është, se këta emra kur ndërrojnë numrin nga njëjësi në shumës ndërron edhe gjinia nga mashkullore në femërore.

Kështu formohet një grup i veçantë emrash të dygjinishëm, që qëndron midis gjinisë femërore dhe mashkullore. Dukuria e ndërrimit të gjinisë së këtyre emrave në numrin shumës është e vjetër, ajo është përgjithësuar në gjuhën letrare dhe është bërë e detyrueshme nga norma.⁶⁴

Përdorimi i këtyre emrave të dygjinishëm në vepër, vërteton edhe një herë faktin se këta autorë tentojnë t'i afrohen standardit të gjuhës shqipe.

Këtë dukuri e bën të dukshme mbaresa –e që marin këto emra në shumës, por edhe përcaktuesit që ato marrin, si:

Duke u mbështetur në klasifikimin që bëhet në Gramatikën e Gjuhës shqipe emrat me përdorim të dygjinishëm i klasifikuam:

- a) Emra mashkullorë që e formojnë temën e shumësit me prapashtesën trajtëformuese –e, në numrin shumës e duan përcaktorin të gjinisë femërore.*

Radoja:

...me tiera fial *çet temelet* e sceites Fee? (D.C.f.14) \ ...as s'ka me gabue *n'essapetiera* t'sceites Fee ... (D.C.f.137) \ ...Kriscti i ka dhan *dy pusctete* fort t'nalta.(D.C.f.37)

Babi:

⁶⁴ Gramatika e Gjuhës Shqipe 1, Akademia e Shkencave, Tiranë, 1995.

... I pari atyne gi kiscin n'dor *essapet* e sarajit ja cioi perpara Nabucodonosorit. \ ...scoiscin tuk ai eçee dy veet gi kgiyrscin *ankimete sai* gi kiscite... (Vakinat f. 142)

b) Ndërrimi i gjinisë dëshmohet edhe me shumësin e disa emrave të lëndës me prapashtesën –na.

Këtu duhet vënë në dukje se autoret veriorë, ashtu si edhe te shkrimtarët e tjerë të gegërishtes, emrat e kësaj kategorie shënohen me –n ndërzanore. Më poshtë janë listuar disa shembuj:

... faroi me *uina* t'mç'a gith çeen maar. (D.C.f.137) / ... t'giçç'a vennet e *uinave* cie λ e derçç'i...(Vakinatf.16); / ...Jan ata ci bain e apin *barna*(D.C.f. 127) ...u stolis me petka e icgii t'mira sikur eogn e rann...(Vakinat f. 137) \

...me dal prei s'rahunasc gi ja rannuene tepri *n'esctna* t'tija. (Vakinat f. 160) ...kan per t'meet *esctnat* tueja. (Vakinat. f.71) / ...e fryyn *ernat* e ju rescne si kie maa mrapsct. (Vakinat. f. 200)

Por gjendet edhe shumësi me prapashtesën –a, ndonëse nuk është konsekuent si petka të reja.

Me shembujt e cituar u vërtetua një çështje tjetër me rëndësi me të cilën disa emra në gjuhën shqipe e kanë ndërruar gjininë në numrin njëjës duke kaluar nga gjinia e tyre mashkullore në gjininë femërore. Kështu emra të tillë që listuam më sipër, si: pushtetja, nderja, druja, ligia etj., na dokumentohen në veprën si emra femërorë. Karakterin gjinor të këtyre emrave e vërtetojnë në ndonjë rast edhe fjalët përcaktuese që ato marrin. Këto emra gjatë zhvillimit historik të gjuhës shqipe kanë kaluar sot në emra mashkullore.

3. Shumësi i emrave.

Përveç emrave që e kanë formuar shumësin në përputhje me ligjërimin e sotëm si: me prapshtesat –a, –e, –j; me palatalizimin e tingujve ll>j; me ndërrim tingujsh g, k përkatësisht në gj, q etj, është me interes të vëmë në dukje se në veprën e Pashko Babit dhe Ëngjëll Radojës ndeshim edhe ata emra që në mënyrën e formimit i kanë devijuar këto rregulla.

Emri *ishull-i* i cili në pajtim me fenomenin fonetik duhet ta formojnë shumësin me palatalizimin e ll-së në –j ashtu siç e formojnë këtë shumës një grup emrash, si: shekull-shekuj; mashkull-mashkuj; grumbull-grumbuj etj. në veprën e Pashko Babit ky emër e formon shumësin me prapashtesën –a vetëm në një rast tek shembulli:

...*e i sh u λ a t* atii kan per t'i ciue t'falunat e veta...(Vakinat. f.97)

Po kështu edhe emri **giell** e formon shumësin në ndonjë rast,⁶⁵ me këtë prapashtesë si: ...N'at cias u cline *c i e A a t*. (Vakinat f.182) / ...kur *c i e A a t* nuk munnen me i paa... (Vakinat, f. 106)

Edhe shumësi i emrit **det-i** dëshmohej i formuar me prapashtesën –a, pra det-a.

Babi... e t'mbleçunat e uinave i emnoi *Deeta*. (Vakinat.f.8)

Emri **Zot-i** që klasifikohet zakonisht si emër i përveçëm e gjejmë në formën shumës me trajtën *Zot-a*.

Radoja... sceitnit nuk i besuam, se jan *εota* por micct e εotit... (D.C.f. 104) / ...o disa niere t'dekun pors *εota*... (D.C.f.102)

Babi... me aso for dhunsc nneeroiscin *εota*... (Vakinat f.19) / ciou e ghoditna *εota* sikurse i kan. (Vakinat, f. 65)

* * *

Te veprat e autorëve në shqyrtim ndeshim shumësin e emrit *petku* të formuar me prapashtesën trajtëformuese –a *petka* p.sh.

Radoja... rrobet e kisc, *petkat* e mescs. (D.C. f 102) / ...dy egnei *petka* t'bardha. (D.C. f.225)

Babi... ka dy paar *petka* t'mira... (Vakinat.f48) \ ...zpto *petkat* e vuu në eεga vedin... (Vakinat.f.37)

Ky emër në gramatikat e sotme klasifikohet si një emër i gjinisë mashkullore, ndërsa në gramatikat e vjetra është klasifikuar si emër i gjinisë asnjëse. Kjo bën që ky emër të trajtohet si një emër i dygjinishëm që vepron te një grup emrash të gjinisë mashkullore që marrin në shumës prapashtesën –a. Sipas Shaban Demirajt: "... kjo dukuri duhet kërkuar në prirjen e përgjithshme të shqipes për të zhdukur vijën e kufirit midis gjinive tek emrat e jofrymorëve sidomos në këtë numër".⁶⁶

Ndërsa përse i përket emrit **nip-i** i cili shumësin e formon me prapashtesën –a, vëmë re se në vepër nuk gjendet asnjëherë në këtë trajtë, por përkundrazi autori Pashko Babi përdor format t'nip\ nipniin p.sh. ...Giakobbi i puççi t'*nip* e vet... (Vakinat f. 49) \ ...e *nipniin* e vet... (Vakinat f.49);

Përse i përket emrit **figurëla** t të gjinisë femërore, që në përputhje me normën drejtshkrimore e formon shumësin me mbaresën –a, tek Ëngjëll Radoja e ndeshim këtë shumës të ndërtuar me mbaresën –e si:

... pse biim n'ghiui perpara *fugureve*... me i nneerue *fuguret*. (D.C.f 104)

Edhe emrin **rroba-t** e gjejmë të formuar me mbaresën –e: ...giaan e viedhun e *rrobet* e takam... (D.C. f.146)

⁶⁵ Theksojmë se ky emër e formon shumësin edhe në formën ciellt.

⁶⁶ Sh. Demiraj, *Gramatika historike*, Tiranë, 1986, f. 206.

4. Shumësi i parregullt.

Nuk mund të lëmë jashtë këtij studimi pa përmendur një element të rëndësishëm rreth shumësit të emrave në veprat e cituara. Ndeshim në këto shkrime edhe disa emra të cilët e formojnë shumësin duke ndërruar temën e njëjësit dhe që Kristaq Cipo ndryshe e quan edhe shumësi i thyer⁶⁷. Veçojmë mes tyre emrat kalë, dorë, dyer të cilët e formojnë shumësin me zberthimin e zanoreve -a, -o, -e të temave të fjalëve në togun zanor: ua, ue\ye si:

Emri **kalë-i**, tek autori shkodran Babi, ky emër shumësin e formon me zberthimin e zanores a në togun ua, por pa palatalizimin e l-së në j, pra kemi formën *kuallt*. psh...*kuallt* e sckelne, egieit i haghne miscin.(Vakinat. f.116)

Shumësi kuaj nuk ndeshet asnjëherë në vepra dhe me të drejtë Shaban Demiraj thekson se kjo mund të jetë një trajtë e re përftuar në kohë më të vona të shqipes.⁶⁸

Emri **der|ë** e formon shumësin duke zberthyer zanoren e në togun zanor ye psh: ...*dyyert* e ferri, tha kriscti n'ungniill. (D.C.f. 37) / ...*dyert* e tija jan ciaart. (Vakinat, f.140)

Ndërsa emri **dor|ë** zberthen zanoren o në togun zanor ue në shumës p.sh.: ...me i la *duert* e veta n'giak t'tii. (D.C.f.19) / nuk munn ju psctoi *duerve* tuja... (Vakinat f.142)

Tek autorët gjejmë edhe rastin tjetër kur tek fjala dorë nuk kemi zberthimin e zanores o ne ue por në u si: ... jan porsi dyy *duur*...(D.C. f .54) / ...ather ja gnitne *duurt* e e zuun.(Vakinatf. 264)

Mes të tjerave, këtu do të veçojmë trajtën e shumësit të emrit **grua** që formohet me mbledhjen e togut zanor ua në a, formë si e mbarë shqipes, por që nga ana grafike shënohet me dyfishimin e zanores a.

...parsia tieter si *ghraat*... (Vakinat.f.145) / ... e *ghraat* e dielmve tuu (Vakinat. f. 15)

5. Mbiemri.

Autorët shkodranë përdorin në veprat e tyre edhe mbiemra të nyjshëm edhe të panyjshëm. Mbiemrat me nyje të përparme janë përdorur më shpesh në veprat e studiuara.

Sipas albanologut Shaban Demiraj⁶⁹, *mbiemrat me forma të këtilla dypalëshe (të nyjshëm dhe të panyjshëm) të shqipes nuk kanë analogji me*

⁶⁷ Cipo, Kristaq, *Morfologjia*, 1949.

⁶⁸ Demiraj, Shaban, vep.cit. f. 203

⁶⁹ Demiraj, Shaban, *Gramatika historike e gjuhës shqipe*, Prishtinë, 1988, f. 417.

asnjërën nga gjuhët e tjera të familjes indoevropiane, prandaj këta të gjuhës sonë konsiderohen se janë zhvilluar brendapërbrenda gjuhës sonë.

Mbiemrat e nyjshëm, shkrimtarët veriorë të shekullit nëntëmbëdhjetë, i kanë shënuar shpeshherë përpara emrave, siç duket kjo dukuri e ndikuar nga latinishtja. Autorët ishin të detyruar, që si kusht për t'i botuar librat e tyre, duhet t'i përkthenin nga latinishtja në shqip dhe anasjelltas.

Radoja: **I maçi Perennii**, Çotyn kriuesi I cieλs...(f.7)...o e **amla Virgini** Mrii (f 80)...Permii gniat **t'maξξ urçnim** (f 89) \ **t'kcia** scium **t'scirtit** e t'korpit. (f 96)...**T'mira scum t'scirtit** e korpit (f.96) \ Çotyn a s'e difton **t'maξξenn mniin** e vet (f 138)

Një dukuri tjetër është përdorimi në gegërisht i gjinisë asnjënjëse të mbiemrave foljorë në vend të emrit abstrakt, si: të ardhunit tand, të dashtunit Jezus etj.

Radoja:...t'biirt e Teneot, e basc t'dasctunit e Jeeu Krisctit. (f .27) \ ...cundra dy t'parave e jam peemetimet e scirtit e t'vsctirat e korpit (f.67)...e tu' e ankue t'bierrunit e tynve. (f.92)

Babi: Emnat e nniereve e t'perbueunit e vogliis (f.97) \ ...pa fye kurr gni her to memneer t'foort t'tyne, e me t'plast t'eemers kur ja mrrine (f. 135) \ Enmiku gi I múeç asct Diali...eamani i malkuem i epte eoori e eelnen t'foort t'mierit Saul. 9f 88)

PËRFUNDIME

Ëngjëll Radoja dhe Pashko Babi ilustrohen si model gjuhësor e pasqyrim i gjuhës së përdorur në shekullin XIX në trevat veriore, konkretisht në qytetin e Shkodrës. Në këtë punim objektivi kryesor ishte njohja dhe analizimi i disa prej formave dhe kuptimeve gramatikore, zhvillimet e tyre të brendshme, sikurse paraqiten në veprat e autorëve. Konkludua disa nga rastet më të veçanta, duke i paraqitur në një përmbledhje me dukuri gjuhësore pikërisht raste që i shmangen normës gjuhësore në çështjet: gjinia e emrit, dygjinitia, shumësi i emrave, shumësi i parregullt, mbiemri. Duke shfaqur admirimin dhe vlerësimin maksimal për këta autorë dhe veprat e tyre, shpresoj që studimi ynë të ofrohet edhe si një thirrje që gjuha e këtyre shkrimtarëve të mos lihet në harresë.

BIBLIOGRAFIA:

1. Akademia e shkencave, *Drejtshkrimi i gjuhës shqipe*, Tiranë, 1972.
2. Akademia e shkencave, *Gramatika e gjuhës shqipe I*, Tiranë, 1995.
3. Akademia e shkencave, *Gramatika e gjuhës shqipe I*, Tiranë, 2002.
4. Akademia e shkencave, *Gjuha letrare shqipe për të gjithë*, Tiranë 1976.
5. Beci, Bahri, *Gjuha letrare shqipe dhe baza e saj dialektore*, “Seminari XVII ndërkombëtar për gjuhën letërsinë dhe kulturën shqiptare”, Tiranë, 1995.
6. Cipo, Kristaq, *Gramatika shqipe*, Tiranë, 1949.
7. Çabej, Eqrem, *Studime gjuhësore III, IV, VI*, Prishtinë, 1976, 1977.
8. Çeliku, Mehmet, *Gramatika praktike e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2004.
9. Demiraj, Shaban, *Gramatika e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1962.
10. Demiraj, Shaban, *Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe, II*, Tiranë, 1961.
11. Dhrimi, Ali, *Formimi i mbiemrave në gjuhën shqipe*, “Çështje të gramatikës së shqipes së sotme” II, Tiranë, 1975.
12. Dhrimi, Ali, *Mbi disa çështje të klasifikimit morfologjik të mbiemrave në shqipen e sotme letrare në “Çështje të fonetikës dhe gramatikës së shqipes së sotme” I*, Tiranë, 1972.
13. Elsie, Robert, *Historia e letërsisë shqiptare*, Pejë-Dukagjin, 1997.
14. Gjinari, Jorgji, *Historia e letërsisë shqiptare I*, 1959.
15. Gjinari, Jorgji, *Historia e letërsisë shqiptare I*, 1971.
16. Gjinari, Jorgji, *Historia e letërsisë shqiptare*, 1983.
17. Likaj, Ethem, *Analogjia gramatikore në strukturën morfologjike të gjuhës shqipe*, Tiranë, 1984.
18. Lika, Ethem, *Mbi format analitike në gjuhën shqipe*, SF Nr.3, 1978.
19. Osmani, Tomor, *Shoqëria e të Shtypurit shkronja shqip*, “Gjuha Jonë”, Nr.4, 1989.
20. Osmani, Tomor, *Vëzhgime për gjuhën e veprës së Pashko Vasës*, “Gjuha jonë”, Nr.3-4, 1992.
21. Shuteriqi, Dhimitër, *Shkrimet shqipe në vitet 1332-1850*, Tiranë, 1956.
22. Shuteriqi, Dhimitër, *Humanistët dhe shkrimtarët e letërsisë së vjetër*, Zëri i popullit, 10 nëntor 1983.

Survey about the linguistic structures in Ëngjëll Radoja and Pashko Babiworks***ABSTRACT***

The main objective of this work is the presentation and analysis of some of the forms of be and the grammatical meanings their internal developments just like they appear in those works. We concluded in some special occasions presenting them in a summary of linguistic structures just like the noun gender, the two genders the plural of nouns the irregular plural the adjective.

Expressing great admiration and appreciation about these authors and their works. I hope that our study is offered as a means of remembrance of the specific language structures used by them.

Bora LOGU

ELEMENTE TË STILIT GJUHËSOR TË IMZOT VINÇENS PRENNUSHIT, NË REVISTËN “ZÂNI I SHNA NDOUT”

Imzot Vinçens Prennushi me brezin e njohur të fretërve të përndritur shqiptarë, me qendër në Kuvendin Françeskan, në Shkodër, themeluan revistën zëmadhe “Zâni i Shna Ndout”, ndërmjet viteve 1913-1914.

At Benedikt Dema shkruante:

“ Pse popujt e qytetnuem t' Europës kryen punë aq të mëdha, sa me mrekullue mbarë botën? Nji ndër faktorë mâ të parë në lidhni e trajtim të këtyre popujve e në veprim të lumnueshëm të tyne kje shtypi⁷⁰”

Revista pati një ecje të vështirë. Pas heshtjes së dhimbshme për 25 vjet me radhë, merr zë pas viteve '70, pranë Kuvendit Françeskan shqiptar në Tuz, në Mal të Zi, nën kujdesin e padër Gjergj Marstepaj, por duke u përdorur vetëm brenda qarqeve kishtarë. Pas vitit 2000, revista merr rrugën kudo ku ka shqipfolës, me qëllimin e lavdërueshëm, që gjuha shqipe e lëvruar mjeshtërisht nga etërit e Kishës, të mbahej gjallë. Ky rrugëtim nis përsëri nga etërit françeskanë shqiptarë, në Mal të Zi, këtë herë nën kujdesin e posaçëm të padër Pashko Gojçaj. Revista Zâni i Shna Ndout është një prej dëshmimeve të shtypit të shkruar, ku ofroheshin bujarisht idetë e një mendimi të dliirë, nga personalitete të shpirtit, të mendjes e të penës për kohën.

“Zâni i Shna Ndout”, u botua në janar të vitit 1913 me emnin “Shna Ndue i Padovës”. Pas gati një viti, në vitin 1914, mori emrin “Zâni i Shna Ndout”. Pas vëllezërve të përndritur at Ndue Harapi e at Anton Harapi, drejtimin e së Përkohshmes e mori Imzot Vinçens Prennushi, i cili në vitin 1920, krahas pjesës fetare, i shtoi edhe pjesën letrare. Rrugën e bukur në shërbim të njerëzve vullnetmirë “Zâni i Shna Ndout”, e përshkoi deri më 1944, vitin e mbrapshtë, që hyri si një dhimbje në votrat shqiptare. Më 1970, Zâni i Shna Ndout rifilloi rrugëtimin e saj, nën kujdesin e etërve françeskanë në Tuz, në Mal të Zi. Në faqet e s'Përkohshmes ka shkruar rregullisht poeti i ëmbël imzot Vinçens Prennushi.

⁷⁰ At Viktor Volaj, Jubileu i Zânit të Shna Ndout, 1913-2013, në “Hylli i Dritës”, 2013, f.36.

Kontributi i imzot Prennushit në këtë revistë, është fryt i rastit kur te njeriu piqet mirë dashuria për Atdhe me shijen për gjuhën e popullit të tij, ushqyer në gurrën e pashtershme të besimit në Hyjin.

Në këtë pikë këndvështrimi, ndihmesa e imzot Prennushit, në shkrimin e kultivimin e gegërishtes letrare ishte dhe është një pjesë shumë e rëndësishme e zhvillimit të gjuhës sonë sot e gjithherës.

Në faqet e kësaj reviste, kanë publikuar fretnit e ditur që krijuan “Hyllin e Diritës”, e që janë themelartët e kulturës shqiptare, sepse:

*“ Përveç mësimëve të një morali të shëndoshë, kjo e përkohshme ka dijtë me përhapë përnjiheri edhe dashtnin për gjuhë, për atdhe e për komb. Me të drejtë mund të thomi, pra se i ka bâ shërbim të madh edhe gjuhës e letratyrës kombëtare”*⁷¹

Vëzhgimi ynë analizues është munduar të ndalet te të veçantat e stilit gjuhësor. Deri sot, kjo ndihmesë ende pak e studiuar. Jemi ndalur në rubrikën me titull “*Nuk âsht si thonë*”, të cilën e kuronte me shumë dashuri, thjeshtësi e profesionalizëm i përndrituri imzot Prennushi. Është një sprovë gjuhësore për studiuesin e shqipes të analizojë rast për rast fjalën në nuancat e saj më të holla fonetike e leksikore, të njohin e të studiojnë e të përdorin në situata të duhura pasurinë që mban në vetvete gjuha jonë, e në mënyrë të veçantë gegërishtja letrare.

Me të drejtë, në një artikull të tij, ku trajton disa probleme që duhen rishikuar në Drejtshkrimin e shqipes, të vitit 1972, profesor Mehmet Çeliku, shkruan: “...duhen rishqyrtuar kufijtë e normës letrare që elemente të nevojshme të gegërishtes letrare, para pak vitesh tabu, të gjejnë vendin që u takon. Nuk mund të funksionojnë siç duhet rregullat e drejtshkrimit pa bashkëfunksionimin e fushave kufitare: pa formulimin e Rregullave të drejtshqiptimit (duke i dhënë këto fillimisht në një variant joshterues), apo pa të ashtuquajturin drejtshkrim sintaksor...”⁷²

Duke ndjekur veshjen fonetike të fjalës shqipe në penën e Prennushit, gjen të shprehur qartazi në shkrimin e gjuhës sonë se dallimet fonetike në format e fjalëve në mes gegërishtes e gjuhës letrare, janë pasqyrë e strukturës fonologjike të dialektit geg, punuar me pasion nga pena të lavruara të gjuhës sonë.

Në një studim të tij, “*Rreth sistemit vokalik të shqipes*”, profesor Anastas Dodi, në mes tjerash, thotë: “... Sistemi vokalik (sistemi zanor - shënimi B. L) i gegërishtes ka katër koordinata të tipareve vokalike:

⁷¹ K. K “Zâni i Shna Ndout në lamë të kulturës”, f. 171.

⁷² Mehmet Çeliku, “Çështje të shqipes standarde”, botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Tiranë, 2001, f. 108.

- 1) *Tiparet e lokalizimit*
- 2) *Tiparet e shkallës së hapjes*
- 3) *Tiparet e rezonancës hundore*
- 4) *Tiparet prozadike të gjatësisë.*⁷³

Analiza e profesor Dodit vazhdon, duke krahasuar si i gjejmë këto koordinata në dy dialektet e shqipes. Në mes tjerash, ai shkruan “... korelacioni nazal është karakteristik vetëm për gegërishten. Në këtë dialekt kundërvëniet midis zanoreve hundore e johundore janë të rëndomta, prandaj edhe të rëndësishme nga pikëpamja funksionale. Çifte fjalësh, kuazihomonime, që dallohen vetëm në këtë dialekt, mund të gjesh me lehtësi në të folmet e gegërishtes...”⁷⁴

Ky fakt teorik i konstatuar e analizuar si më sipër, gjen shprehje në shkrimet e analizuara në këtë frymë të mjeshtrit të fjalës Prensushit. Pena e tij ka stolitur mjeshtërisht shqipen në sistemin e nënsistemet e saj, si p.sh., atë fonetik, ku bie në sy, lëvrimi mjeshtëror i theksit, si një element me vlerë të posaçme fonologjike në strukturën e fjalës, duke i dhënë nuancat më të holla shprehëse të gegërishtes, p.sh., zanoret me vlerë hundore, si: *zâni i Shna Ndout; vûni; feja shêjte; pûnë; lypë; zêmër; etj.*, raste të shquarjes në shqiptim, në mënyrë të posaçme, por edhe grafikisht të theksit hundor, i cili u jep zanoreve të gjuhës sonë vlerën e hundorësisë, veçanërisht para bashkëtingëlloreve, si: m, n, j, p. Në shembujt e mësipërm, vërejmë se hundorësia prek të gjitha zanoret e të gjitha ngritjeve, jo vetëm zanoren **a**. Fonetiksht vihet re se zanoret hundore të ngritjes së lartë e të mesme bëhen më të hapura, kurse zanorja e ngritjes më të ulët bëhet zakonisht më e mbyllur dhe disi e labializuar.

Duke arsyetuar mbi këto raste, mendojmë se forma të tilla shkrimi dhe shqiptimi të alfabetit tonë e të fjalës shqipe, ndihmojnë në përsosjen e sistemit fonetiko-fonologjik. Autori është njohës dhe gdhendës i tingullit e shkronjës shqipe; ky raport në penën e Prensushit përimtohet deri në nuancat më të holla të tingullit, i ilustruar saktë në shumë raste përmes shkrimit të theksit, që bart ky tingull në fjalën e dhënë, si p.sh., *m' lë; tue këne; i pënduem; Sakramëndet; dhânun; jânë; etj.*

Një element fonetik i dallueshëm qartë në shkrimet e tij, është përsëritja e zanoreve në trup të fjalës, ose në fund, duke realizuar qartë e

⁷³ A.Dodi, *Çështje të Fonetikës e Gramatikës së shqipes së sotme*, Tiranë, 1972, f.25.

⁷⁴ Universiteti Shtetëror i Tiranës, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Sektori i Gramatikës, “Çështje të Fonetikës dhe të Gramatikës së Shqipes së sotme, Tiranë, 1972, f. 25-27.

pastër më- se - gjatësinë e zanoreve, karakteristikë me vlerë të veçantë fonologjike, si p.sh: *O saa me zëmër; Nji zyrtar maa të madh; Saa dite e bukur; shyt e tyne; n' vaaj u shgrehnë; dyy vjet; kitii* (këtij, zëvendësimi i i-së së gjatë me bashkëtingëlloren j, në formën e sotme), që në rastin e gjuhës sonë, te folësi apo përdoruesi nuk janë ende të shpjeguara qartësisht. Sa i takon rëndësisë së këtij fakti fonetik në shkrimin e fjalës shqipe, e jo vetëm, por edhe në semantikën që mbart ajo, mjafton të ofrojmë vlerësimin e foneticienit Dodi, i cili në njëtin studim shkruan “... kundërvëniet e zanoreve sipas tiparit të gjatësisë përbëjnë një nga veçoritë themelore të sistemit vokalik të gegërishtes, dhe kanë një ngarkesë funksionale të madhe.”⁷⁵

Studiuesi i shqipes Dodi shkon edhe më tutje në analizën e tij, kur shkruan: “... N.S. Trubetzkoy, duke u referuar tek Lowman, thotë se gegërishtja njeh zakonisht tri shkallë gjatësie dhe shton se në të vërtetë “gjatësia” dhe “më- se- gjatësia” i kundërvihen njëra-tjetrës si gjymtyrë të opozicionit melodik, të cilin duhet ta shikojmë si të vetmin të rëndësishëm nga pikëpamja fonologjike...”⁷⁶

Një shpjegim i tillë na shtyn të vjelim, të analizojmë dhe të sjellim para nxënësit dhe studentit vlera të tilla gjuhësore, që penat geqe, kanë skalitur me kujdes e dashuri, e që mjerisht “stuhia e kuqe”, ka ngulmuar të zhdrukë nga struktura e gjuhës sonë. Sigurisht, duke ngulmuar pikësëpari të fshijë vepra të tilla nga ndërgjegjja jonë njerëzore e kombëtare. Mendojmë se janë e mbartin një pasuri pafund, fjalët e shquara në shkrim e shqiptim në mënyrë të veçantë në artikujt e tij, për foneticienin shqiptar, si p.sh.: krahasimi i formave të tilla të zanores a:

Âsht si thonë...(a hundore)

Âsht i mirë...

Ât Vinçens (kur është fjala për titullin meshtarisë, e rregulltarisë, autori përdor theksin e rrëzuar).

Aat i dashtun po shkoj...(kur është fjala në dialogun personal me Hyjin, përdoret zanorja më- se e gjatë).

Mjer për at njeri... ... (zanore të gjata; vërejmë se gjatësia në disa raste nuk shënohet grafikisht, por shquhet lehtë në të shqiptuar).

Në gjatësinë e vokaleve të shqipes një rol të veçantë luan edhe rrethimi fonetik, kryesisht i së njëjtës zanore; si dhe fonema e fjalës që ndjek fjalën në fjalinë e dhënë. Dukuri që dëshmon vlerën e të analizuarit, e të

⁷⁵ A.Dodi, “Çështje të Fonetikës e Gramatikës së shqipes së sotme”, Tiranë, 1972, f. 29.

⁷⁶ A.Dodi, “Çështje të Fonetikës e Gramatikës së shqipes së sotme”, Tiranë, 1972, f. 31.

përdorimit të drejtë, jo vetëm në drejtshkrim, por edhe drejtshqiptim të fjalëve. Të tillë shembuj, të cilët janë të shumtë na ndihmojnë të plotësojmë më mirë tablonë e kuantitetit të zanoreve në gegërisht, duke evidentuar tipin bifonematik të gjatësisë.

Forma të tilla janë pasqyrë e vlerës së veçantë që ka fonetika në strukturën e fjalës, e jo vetëm, por edhe të fjalisë, duke i bërë ato gjithmonë e më të stërholluara për përdoruesin, e sidomos për studiuesin. Dëshmi të tilla i gjejmë pa kursim në shkrimet e tij, të cilat dëshmojnë ndikimin e rolin që elemente të tillë luajnë në sematikën e gjuhës.

Përdorimi i apostrofit, në vend të gjysmëzanores ë para fjalës që fillon me bashkëtingëllore, është një tjetër karakteristikë e stilit gjuhësor të Prennushit, si p.sh: *t'mramen; m'thotë; t'lum e ndjeva; m'kujtue; s'mund të merret*; etj.

Diftongu **ue** në vend të diftongut **ua** të formës letrare, është një pasuri fonetike e gegërishtes, të cilën autori e përdor si përfaqësues e kultivues i spikatur i saj, duke i mbishtuar bashkëtingëlloren **j**, në ndërgjegjen e tij e pandashme në formën e përcjellores.

Fjalë të tilla, si: *tuj shndrrue, tuj kujtue, tuj mkatnue, tuj pajtue, tuj diftue* etj. Në këtë format gjejmë edhe shmangie të tilla si: *tuej lexue*, etj. Format e pashtjelluara të foljes, veçojmë si në rastet e mësipërme, përcjellorja ndërtohet me pjesëzën **tuj (tue, ose tuej)** + pjesorja e foljeve, e cila në çdo rast mbaron me togun **ue**.

Në tekstet e morfologjisë së shqipes së njësuar, mësojmë se “... *tema foljore, nga e cila formohet pjesorja, mund të përkojë me atë të së kryerës së thjeshtë ose të kohës së tashme, ose mud të jetë e ndryshme prej temave të këtyre foljeve...*”⁷⁷

Kujtojmë se përcjellorja geqe ndërtohet me pjesëzën **tue (tuj ose tuej-** siç e hasim në shkrimet e analizuara- shënimi B.L), në vend të pjesëzës duke, me të cilën formohet e përdoret përcjellorja e normës letrare.

*Dukuri të tilla që spikasin në shkrimet e Prennushit, mendojmë se dëshmojnë më së miri konstatimin e të përndriturit Kostandin Kristoforidhi, se “... gegërishtja si dialekt prototip i shqipes, është më origjinale, më e pastër dhe më e pasur se të tjerat.”*⁷⁸

Në rrugën tonë për njohjen e përshkrimit e penës prennushiane, jemi ndalur në pasurinë morfo-sintaksore të shqipes. Si lëmues i palodhur i fjalës e njohës i talentuar i shpirtit të popullit tonë, prurjet e tij janë të bollshme si në fushë të sintaksës, ku fjalia ka shpesh rend të përmbysur,

⁷⁷ ASHRSH, IGJL, Tiranë, 1995, f. 301.

⁷⁸ Mehmet Çeliku, “Çështje të shqipes standarde”, Tiranë, 2001, f. 60.

duke ndërtuar shpesh edhe stilema me peshë të veçantë stilistikore, si p.sh.:
 “*I penduem ky me zemër për çka kishte bâa, pëlqej paa kundërshtim, çka i lypej me pajtue me Zotin...*”

Ofrojmë një analizë të shkurtër sintaksore të pjesës së parë të kësaj periudhe ose fjalisë të përbërë:

- a) Në shqipen standarde kjo pjesë do të ndërtohej:

Ky njeri i penduar për atë që kishte bërë...

Ose

Ky njeri i penduar që kishte bërë atë gabim...

- b) *I penduem* = përcaktor me përshtatje, i shprehur me mbiemër të nyjshëm.

Ky = kryefjalë, e shprehur me përemër dëftor (për arsye stilistike nuk përdoret, por kuptohet qartazi, mungesa e emrit “njeri” - “ky njeri”):

Mospërdorimi i grupit emëror në funksion të kryefjalës, e bën më të përgjithësuar mesazhin, se i penduar mund të ishte cilido njeri.

Me zemër = përcaktor me drejtim, i shprehur me emër të rasës kallëzore, trajta e pashquar

Kishte baa = kallëzues i thjeshtë foljor, i shprehur me kohë të përbërë

Për çka = përcaktor me përshtatje, i shprehur me përemër lidhor (ndërtim morfo - sintaksor i gegërishtes)

Mendojmë, se edhe në raste të tilla, jemi përpara një përpjekjeje për të formësuar në variantin më të drejtë shkrimin e përdorimit të fjalës shqipe, duke mos harruar se pena të tilla ishin mbi të gjitha shijues plot sqimë të saj.

“... Krishti ka lé: po i dishruemi i shekujve ka lé e ka lé për në. Sot vertetohet vegimi qi pau Jakobi tuej dekë, profecit e Danielit, t’Ageut, e të Malakis..... Të falem pra, o Foshnje e kandshme, Foshnje e hyjnueshme, të falem ty, qi deshte me pertri një gzim aq të madh nder zemrat tona...”⁷⁹

Në gramatikën shqipe sa i takon rendit të fjalëve, thuhet: “Vendi i gjymtyrëve në fjalinë dëftore përcaktohet nga faktorë të ndryshëm; kryesisht nga gjymtyrëzimi aktual, nga arsyet stilistike, dhe, më rrallë, nga funksioni i tyre sintaksor.”⁸⁰

Shembujt e përvjelur nga teksti shumë i pasur, dëshmojnë se parime e rregulla të tilla gramatikore janë mishëruar në penën e autorit tonë.

Siç mësojmë në sintaksën shqipe: “*Përveç rendit të fjalëve, tregues*

⁷⁹ Zâni i Shna Ndout”, Vjeti, VIII, Kah Betlemi, 25 Dhetuer, Dhetuer, 1920.

⁸⁰ Akademia e Shkencave Republikës së Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Gramatika e Gjuhës Shqipe, II, Tiranë, 1996, f. 415.

*i gjymtyrëzimit aktual është edhe theksi logjik, që bie gjithmonë mbi remën dhe ëshë shenjues i saj...*⁸¹

Në këtë rast gjejmë të përdorur edhe gjymtyrë, të cilat kanë rend të ngulitur, i cili është i përcaktuar nga forma gjuhësore, si dhe qëllimi i të kumtuarit. Topika e këtyre gjymtyrëve është zbatuar me përpikmëri, si për shembull, pozicioni i thirrimit, pozicioni i llojeve të ndryshme të përcaktorit, etj.

Karakteristikë në ndërtimin e tekstit është përdorimi i rendit emfatik afektiv (remë + temë), si dhe përdorimi i theksit logjik, i cili tërheq vëmendjen e lexuesit ose të dëgjuesit të rema. Nënvizojmë se rema përmban synimin e kumtimit, është pjesa më e rëndësishme e thënieve. Në tekstin që kemi analizuar, si tema edhe rema përbëhen nga një gjymtyrë e vetme, por edhe me një tog gjymtyrësh. Veçori e mjeshtrit tonë, njohës i shpirtit dhe i gjuhës së popullit tonë. Në gramatikën shqipe, kur analizohet rendi i gjymtyrëve në fjali, flitet edhe për rendin e fjalëve. Në mes tjerash thuhet: “... disa fjalë kanë rend të ngulitur, i cili është i përcaktuar nga forma gjuhësore. Topika e këtyre fjalëve duhet njohur, rregullat e vendosjes së tyre duhen zbatuar; përndryshe shkelet norma gjuhësore, duke sjellë si pasojë pamundësinë ose vështirësimin e marrëveshjes ligjërimore..., si për shembull, pozicioni i pjesëz mohuese s’ nuk para shumicës së trajtave foljore; pozicioni i trajtës së shkurtër të përemrave vetorë në kallëzore e dhanore; bashkime të ndryshme të këtyre trajtave; pozicioni i parafjalëve para emrave; etj”⁸².

Një parim i tillë ruhet pastër në rastet e analizuara. Ky argument përforcon mundësinë e ruajtjes përmes vjeljes, studimit, analizimit e mbarë përdorimit nga nxënësi e studenti ynë i teksteve në gegnisht, të cilat duhet të jenë objekt i analizës sintaksore.

Duke u munduar të shijojmë përmes njohjes së kujdesshme shkrimet e të Lumit imzot Prennushi, vlerësojmë se vlerat e penës së tij janë në leksik, fonologji, fonetikë, morfologji e sintaksë.

⁸¹ Akademia e Shkencave Republikës së Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Gramatika e Gjuhës Shqipe, II, Tiranë, 1996, f. 414.

⁸² Akademia e Shkencave Republikës së Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Gramatika e Gjuhës Shqipe, II, Tiranë, 1996, f. 415.

BIBLIOGRAFI:

- A.Dodi, “Çështje të Fonetikës dhe të Gramatikës së shqipes së sotme”, Tiranë, 1972.
- ASHRSH, IGJL, “Gramatika e gjuhës shqipe”, I, Tiranë, 1995.
- ASHRSH, IGJL, “Gramatika e gjuhës shqipe”, II, Tiranë, 1997.
- At Viktor Volaj, Jubileu i Zânit të Shna Ndout, 1913-2013, në “Hylli i Dritës”, 2013.
- Mehmet Çeliku, “Çështje të shqipes standarde”, Tiranë, 2001.
- “Zâni i Shna Ndout”, Fletë e përmuejshme, 1920, rubrika “Nuk është si thonë”.

Stylistic Elements of Monsignor Vincent Prennushi’s Lexicon, in the Magazine "Zâni i Shna Ndout" (St. Antony’s Voice)

ABSTRACT

This article is written in honor of Professor Kol Ashta whose work on the orthography and use of the Albanian language in the course of centuries is permeated by the motto of the pure love for the Albanian language and its predecessor. It is probably this motto that inspired J. Ritter von Xylander and other Albanian language scholars, who have left us the legacy of writings and accurate analyzes on the Albanian language in centuries. This article analyses language and grammatical issues on the Albanian language treated by Xylander with scrutiny. Xylander presents a summary of the most important opinions on the origins of the Albanian language and its proximity to other languages. These opinions were supplemented by his careful research on the grammatical forms of the words of the Albanian language. This article devotes a chapter to morphology where certain grammatical issues such as the noun and the article, the declension of definite forms, the declension of the indefinite forms, the adjective, the pronoun, the personal pronoun, the verb, the active and passive forms, the mood, and the indicative mood are treated. The document selected for analysis is made available 200 years after its publication, thanks to the work of the translators Mr. Albert Gjoka, and Mrs. Frida Vokopola. Through analysis and argumentation, this article provides a modest contribution to the recognition of the Albanian language as an elaborated one through centuries.

Key words: language, origin, morphology, analysis, word forms.

Dorentina SHPANI (XHAFI)

MËNYRA LIDHORE NË *DICTIONARIUM LATINO-EPIROTICUM* TË FRANG BARDHIT

Fjalori *Dictionary latino-epiroticum* i vitit 1635 i Frang Bardhit paraqet një rëndësi shumë të madhe për historinë e gjuhës shqipe dhe për rrugën e zhvillimit historik të saj. Ky fjalor, jo vetëm që është një ndër tekstet më të vjetra të shkruara në gjuhën shqipe, por, pikë së pari, ka një rëndësi të veçantë, sepse me të zë fill edhe leksikografia shqipe.

Në fushën e gjuhësisë, ky libër është bërë objekt i studimeve të ndryshme, sidomos për pasurinë e fjalëve që përfshin në të. Në këtë punim me karakter morfonologjik kemi zgjedhur që të paraqesim përdorimin e njërës prej mënyrave të foljes, mënyrës lidhore, e cila edhe pse me forma të pakta, ka vlerë të veçantë studimore

Mënyra lidhore në gjuhën shqipe shpreh veprime të mundshme, të dëshiruara, të supozuara apo irrealë. Ajo mund të shprehë edhe urdhra, lutje, urime etj., duke zëvendësuar në këto kuptime mënyrën urdhërore dhe dëshiroren. Pjesëza *të* që është karakteristike e lidhores, sipas Çabejt në krye të herës do të ketë qenë një lidhëz. Ajo ka shprehur një supozim dhe e krahason me lidhëzën *tai* “sikur” të lituanishtes, por ajo mund të ketë shërbyer edhe për të bashkuar foljen e mënyrës dëftore me atë të mënyrës lidhore, thujse siç përdoret sot lidhëza *që*.⁸³ Edhe Demiraj thotë se pjesëza /*të*/ ka qenë burimisht një lidhëz nënrenditëse, që shërbente për të lidhur një fjali të nënrenditur, ku folja ishte në mënyrën lidhore.⁸⁴

Mënyra lidhore te Bardhi na del kryesisht në kohën e tashme, por format foljore në këtë mënyrë nuk janë të shumta, duke e krahasuar me të tashmen, por edhe me Buzukun, i cili ka një numër të madh foljesh që dalin në mënyrën lidhore.

A. Koha e tashme

Format foljore të së tashmes së lidhores te Bardhi janë:

Mbasi të *vinj* u (103 13); ndierë të *vinj* u (119 12); e mā udob t u *vinjë* (IV/1 2); e [të] mos u *vinjë* fështir (V/2 12); parë se *tëvinjë* (109 25); *Tëbaish*

⁸³ Çabej, E., *Sudime rreth etimologjisë së gjuhës shqipe*, BUST SSS 3, 1963, f. 76.

⁸⁴ Demiraj, Sh., *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Tiranë, 2002, f. 372.

(207 17; 207 24; 216 6); Ai gji s unë *dalë* për vetëhe (161 10); *Të dini* (IV/2 27); *Të mos flasënë* (96 8); *Të mos e lëshoni* n doret (IV/2 23); *Ta merrni* vesht (IV/1 24); *ta marrënë* me e xgiedhunë (III/1 2); Me atë masë qi *të matëni* (216 17); Gjithëkush duhetë *të mbae* pajë mieshtrës së vet (209 18); Me e lëshuem e me e lanë *të jesë* (154 4); Si *të ndërnjësh*, ashtu kë me kenë ndërunë (212 4); U lus gjithëve me të prunjëtë *të më ndëjeni* (V/1 22); Munë *njifenë* (69 3); Kush *të shofshë* veshtë veti, athere kie me e pām (213 21); *Të kesh* (208 17); Munë *pihetë* (100 25); *Të më skuzoni* (V/1 22); Ndierë *të sosnjësh* (121 1); Pā të sijet askush s *munëshërbenjë* (III/1 18); Ka munë *shkohetë* (96 24); Gji *të shtamponetë* (V/1 10); S dī qish të rī dëshëron me ditunë, gji të *të thom* (219 3); Po bastardhohetë sā mā parë *të ve* (III/1 14); kinëse *të veni* (188 1); Gji *t i vini* kryetë e menttë me gjithë zemërë (IV/1 22); ... e *të xini* gjith thotë ... (IV/1 24); Të vobegunë, ku *ta zanë* nata, aty ashtë pëllasi i tī (212 22).

Siç shihet, tema e disa foljeve në lidhore nuk ndryshon nga dëftorja, si: *vinj, dini, lëshoni, merrni, matëni, skuzoni, thom, veni, vini, zanë*.

Një grup foljesh dalin me mbaresën -ë si: *dalë, jesë*; ku folja *dal* ~ *del*, e cila paraqet ndryshime fonetike në zanore ndërmjet vetës së parë dhe dy vetave të tjera të numrit njëjës e ndërtojnë lidhoren duke u mbështetur në temën e vetës së parë *dal*.⁸⁵

Demiraj (*gram. hist. f. 375*) thekson se mbaresa vetore /-ë-/ në disa raste del e zgjeruar në trajtën -një dhe se kemi të bëjmë me zgjerimin e mbaresës /-ë/ me /-nj-/ , e cila e ka burimin te koha e tashme e foljeve me temë në */n/ të tipit të zgjedhimt më */-iō/; kështu kemi te Bardhi: *vinjë, shërbenjë*.

Folja *kam* e ndërton lidhoren duke u mbështetur në temën me zanoren -e të vetës së dytë: *të kesh*, ashtu si edhe folja *jam*, por që te Bardhi nuk na del në lidhore.

Një mbaresë e veçantë që na del te Bardhi është mbaresa -e (Topalli, *Sis. fol.*, f. 181) që del te folja *mbae* (*të mbae*), e cila del edhe te Buzuku (*ai të nbae* 356 83). Kjo mbaresë shfaqet vetëm te foljet me temë në zanore. Kështu, te folja vete, që prisnim të kishim në lidhore të vejë, është pikërisht zanorja e temës, së cilës i është prapangjitur drejtpërdrejt mbaresa -e dhe kështu kemi: $e + e = \bar{e}$. Këtë \bar{e} e gjemë edhe te Buzuku.

Mbaresa -sh e vetës së dytë (*të kesh, të sosnjësh, të ndërnjësh*) dhe -të e vetës së tretë, që del në lidhore, janë të trashëguara (Topalli, *Sis. fol.*, f. 180). Te foljet si *ndërnjësh, sosnjësh*, lidhja e temës me mbaresën -sh është bërë duke futur zanoren -ë- që te Buzuku del edhe -i- (*të nderish* 21/2a);

⁸⁵ Topalli, K., *Sistemi foljor i gjuhës shqipe*, Plejad, Tiranë, 2010, f. 179.

por vëmë re edhe një kalim të mbaresës së zgjedhimit të tretë *-nj*.

Te folja *banj* te Bardhi, në lidhore, në vetën e tretë njëjës del *baish*. Kjo ndodh edhe tek autorë të tjerë të vjetër. Topalli e ka shpjeguar këtë duke thënë se, ku mbaresa e lidhores u është ngjitur drejtpërdrejt formave të vetës së parë, bashkëtingëllorja *-nj*, nga ndeshja me fërkimoren e mbaresës vetore *-sh* është shndërruar në *-j* për lehtësi shqiptimi, që te Bardhi e gjejmë *-i*.⁸⁶

Një dukuri me interes na del edhe kur folja *mund* shoqërohet me lidhoren. Kështu kemi te Bardhi: munë *njifenë*, munë *pihetë*, *munëshërbenjë*, munë *shkohetë*.

Këtu, folja *mund* është shkrirë me pjesëzën *të* të lidhores⁸⁷, sepse njihen rastet kur njëra nga bashkëtingëlloret është e shurdhët dhe tjetra e zëshme dhe ndodhin shkrirje të tyre. Kështu kemi edhe te Buzuku (*se atë munda sillnje* 60 3). Pra evolucioni ka kaluar këto shkallë: *mund + të > munttë > muntë > munë*.

Për foljen *sheh* kemi në lidhore formën *tëshofshë*. Duket sikur kemi një *-fsh-* të dëshirores, por në të vërtetë */-f/-ja* është e vetë temës *shoh* që te Bardhi del me trajtë dialektore *shof*, ndërsa *-sh-ja* është mbaresa e vetës së dytë njëjës.

B. Koha e pakryer

Koha e pakryer e mënyrës lidhore del: *t u diste* (IV/2 9); të flite (V/1 5); gji *t u diste*, *t u vrit* kush kallauzinë(IV/22 9).

Foljet që në të tashmen dalin me dy bashkëtingëllore *-s*, *-t* kanë prirje që vetën e tretë njëjës të përdorin më shumë formën me fërkimore *-s* (*fliste*, *vdiste*) për të mos krijuar bashkëtingëllore dyfishe me mbaresën *te*⁸⁸, që te Bardhi, në rastin e foljes *flas* është përdorur forma me bashkëtingëlloren *-t* që më pas ka kaluar: *flitte > flite*; ndërsa te folja *vras*, përveç kësaj dukurie ka rënë edhe mbaresa *-e*.

C. Koha e kryer

Te Bardhi gjendet vetë një folje në këtë kohë të lidhores:

Mbasi *të kesh xanë*, ani mbso! (208 17)

Ky ndërtim nuk paraqet ndonjë ndryshim nga shqipja e sotme.

⁸⁶ Topalli, K., *Sistemi foljor i gjuhës shqipe*, Plejad, Tiranë, 2010, f. 390.

⁸⁷ Topalli, K., *Fonetika historike e gjuhës shqipe*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Tiranë, 2007, f. 380; Mansaku, S. *Ndërtimet me foljet modale mund dhe duhet te Gjon Buzuku*, SF 3, 1979, f. 146.

⁸⁸ Topalli, K., *Sistemi foljor i gjuhës shqipe*, Plejad, Tiranë, 2010, f. 363.

Mënyra lidhore: tabelë përmbledhëse

Folja	E tashme	E pakryer	E kryer	Më se e kryer
Ardhunë (vinj) fol supl.	Mbasi të <i>vinj</i> u (103 13); ndierë të <i>vinj</i> u (119 12); e mā udob t u <i>vinjë</i> (IV/1 2); e [të] mos u <i>vinjë</i> fështir (V/2 12); parë se <i>tëvinjë</i> (109 25)			
Bām fol.	<i>Tëbaish</i> (207 17; 207 24; 216 6)			
Dalunë fol.	Ai gji s unë <i>dalë</i> për vetëhe (161 10)			
Dekunë fol.		<i>T u diste</i> (IV/2 9)		
Ditunë – ditunë fol.	<i>Të dini</i> (IV/2 27)			
Folë fol.	<i>Të mos flasënë</i> (96 8)	Të flite (V/1 5)		
Lëshuem fol.	<i>Të mos e lëshoni</i> n doret (IV/2 23)			
Marrë fol.	<i>Ta merrni</i> vesht (IV/1 24); <i>ta marrënë</i> me e xgiedhunë (III/1 2)			
Matunë fol.	Me atë masë qi <i>të matëni</i> (216 17)			
Mbaitunë ~ bāitunë fol.	Gjithëkush duhe të <i>të mbae</i> pajë mieshtrīs së vet (209 18)			
Mbetunë ~ betunë (← jes) fol.	Me e lëshuem e me e lanë <i>të jesë</i> (154 4)			
Nđerunë ~ nderunë fol.	<i>Si të ndërnyësh</i> , ashtu kē me kenë <i>ndërunë</i> (212 4)			

Ndëjyem fol.	U lus gjithëve me të prunjëtë të më <i>ndëjeni</i> (V/1 22)			
Njefunë fol.	Munë <i>njifenë</i> (69 3)			.
Pām (← shof) fol. supl.	Kushtë <i>shofshë</i> veshtë veti, athere kie me e pām (213 21)			
Pasunë ← kam fol. supl.	<i>Të kesh</i> (208 17)			
Pim fol.	Munë <i>pihetë</i> (100 25)			
Skuzuem fol.	<i>Të më skuzoni</i> (V/1 22)			
Sosunë fol.	Ndierë të <i>sosnjësh</i> (121 1)			
Shërbyem fol.	Pā të sijet askush s <i>munë</i> shërbenjë (III/1 18);			
Shkuem fol.	Ka munë <i>shkohetë</i> (96 24)			
Shtampuem fol.	Gji të <i>shtamponetë</i> (V/1 10)			
Thanë fol.	S dī qish të rī dëshëron me ditunë, gji të të <i>thom</i> (219 3)			
Votë fol.	Po bastardhohetë sā mā parë të ve (III/1 14); kinëse të <i>veni</i> (188 1)			
Vrām ~ vurām fol.		Gji t u diste, t u <i>vrit</i> kush kallauzinë(IV/22 9)		
Vūm ~ vum fol.	Gji t i <i>vini</i> kryetë e menttë me gjithë zemërë (IV/1 22)			

Xanë ~ nxanë fol.	... e të xini gjith thotë ... (IV/1 24)		Mbasi të kesh xanë, ani mbso! (208 17)	
Zanë fol.	Të vobegunë, ku ta zanë nata, aty ashtë pëllasi i tī (212 22)			

LITERATURË:

- Bardhi, F., *Dictionarium Latino-Epiroticum (Romae 1635) per R.D. Franciscum Blanchum*, (botim kritik nga Bardhyl Demiraj), Botime Françeskane, Shkodër, 2008.
- Çabej, E., *Studime rreth etimologjisë së gjuhës shqipe X*, BUSHT SSHSH 1, 1958; II, III, 1963.
- Demiraj, Sh., *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Tiranë, 2002.
- Mansaku, S., *Ndërtimet me foljet modale mund dhe duhet te Gjon Buzuku*, SF 3, 1979.
- Topalli, K., *Fonetika historike e gjuhës shqipe*, Dituria, Tiranë 2007.
- Topalli, K., *Sistemi foljor i gjuhës shqipe*, Plejad, Tiranë, 2010.

**The Potential Indicative Mood in the Frang Bardh's
Latino-Epiroticum Dictionarium**

ABSTRACT

The vocabulary *Dictionarium latino-epiroticum* of 1635 of Frang Bardhi has a great importance for the history of Albanian language and for her historic evolution. It is object of different studies, especially as a word's resource. In our morpho-phonologic article we give a presentation of the Subjunctive mood. This mood has a special study value.

In Albanian, the Subjunctive mood expresses possible, desired, supposed or unreal actions, but it may also express orders, prayer, wishes etc., often substituting the Imperative or Optative mood.

Main Subjunctive forms of the *Dictionarium* are in the Present Simple Tense, but in comparison to Indicative, there are less in number. However, in the perspective of evolution this mood has its special importance.

Aimir OSMANI

RRETH KONTRIBUTIT TË VEPRËS SË FILIP NDOCAJT NË RRAFSHIN LEKSIKOR

Pak nga jeta...

Shkrimtari Filip Ndocaj lindi në Gjakovë më 2 tetor 1914 dhe vdiq në Tiranë në moshën 69- vjeçare, në shtatorin e vitit 1983, i paralizuar prej më shumë se 6 vjetësh.

Të dy prindërit, e ëma Domenika dhe i jati Ëngjëlli që njihej me shkurtimin Nushi ishin prej Shkodrës. Engjëlli që mësues në Gjakovë, por shpejt u transferua në Shkup, kur Filipi ishte 5 vjeç. Mësimet e para i mori nga i ati. Në Shkup qëndroi rreth 5 vjet, pasi në vitin 1925 familja Ndocaj vendoset në Shkodër, një qytet me tradita kulturore dhe arsimore. Filipi këtu ndoqi gjimnazin klasik të vendlindjes së prindërve, të cilin e kreu në vitin 1933, por pa pasur mundësi të vazhdojë studimet e larta në ndonjë universitet të huaj. Kështu detyrohet të ndjekë rrugën e të jatit dhe të ushtrisë profesionale të mësuesit. Fillimisht shërbeu si mësues në Krumë të Hasit dhe më pas në Pukë, në fshatin Dardhë ku ka pasur kryemësues Migjenin, i cili e orientoi të merrej me poezi, pasi Filipi kishte prirje letrare. Që në atë kohë e adhuronte poetin e rinisë, Migjenin dhe lirikun Gaspër Pali.

Ndonëse vazhdonte detyrën e mësuesit, në vitin 1935 u regjistrua për të ndjekur studimet universitare në Fakultetin e Letërsisë dhe të Filozofisë në Universitetin e Firencës. Por në muajin mars të vitit 1937 e pa të nevojshme për të ndërprerë punën si mësues dhe për të vazhduar studimet e larta, të cilat i përfundoi në vitin 1939. Kthehet në Shqipëri dhe vendoset në Shkodër ku caktohet si mësues i letërsisë në gjimnazin e qytetit të Shkodrës. Aktivizohet në veprimtaritë kulturore të këtij institucioni, duke përgatitur dhe dhënë shfaqje të ndryshme teatrore me studentët e këtij gjimnazi, por duke aktivizuar edhe aktorë të tjerë. Vuri në skenë dramën e H. Ibsenit "*Armiku i Popullit*" dhe më vonë dramën e Fishtës "*Juda Makabeu*", ndërsa më pas, së bashku me Qemal Draçinin dramën e M.Gorkit "*Bujtina e të Varfërve*". Gjithashtu shkroi dhe vuri në skenë dramën "*Dje dhe sot*", të interpretuar nga nxënësit e gjimnazit të Shkodrës.

Në vitin 1941 Filip Ndocaj do të emërohet si mësues letërsie në gjimnazin e Prishtinës. Pa përfunduar Lufta e Dytë Botërore kthehet në Shkodër. Punon 2-3 vjet në gjimnazin e Shkodrës, por në vitin 1948 transferohet në Berat, pasi regjimi i kohës vëren tek shkrimtari Filip Ndocaj prirjet për liberalizëm në letërsi.

Në vitin 1951 Filip Ndocaj transferohet në Tiranë, ku shërbeu si mësues i letërsisë në disa shkolla të kryeqytetit.

Në vitin 1961 pranohet si anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe të Artistëve të Shqipërisë, duke qenë një ndër autorët e parë të kësaj organizate.

Filip Ndocaj punoi në heshtje për aq kohë sa jetoi. Në vitin 1971 në moshë jo të thyer, 57 vjeç, pa dëshirën e tij, e nxjerrin në pension. Ndoshta kjo ndikoi që pas pak kohësh shëndeti i tij të përkeqësohej aq sa vitet e fundit u paralizua.

Vdiq në vitin 1983 në një shtëpi të vjetër pranë Shkollës së Kuqe në Tiranë, duke lënë edhe një arkiv personal.

Në vitin 1962 Filip Ndocajt i jepet urdhri "*Naim Frashëri*" i kl.III dhe me rastin e 50-vjetorit të lindjes mësuesit dhe nxënësit e gjimnazit "*Çajupi*" në Tiranë i kremtojnë këtë përvjetor jubileut.

Veprimtaria botuese

Filip Ndocaj ka lënë trashëgim disa vepra letrare, studime, etj. Së bashku me studiuesin Nasho Jorgaqi mbledhën dhe redaktuan poezinë e poetit Gaspër Pali me titull "*Hyjt mbi greminë*", vjersha, Tiranë, 1959.

Në vitin 1960 ai mbledhi dhe redaktoi veprën e Hil Mosit që e titulloi "*Zani i atdheut*". Kësaj përmbledhjeje i parapriu një parathënie e gjatë për jetën dhe veprën e Hil Mosit shkruar nga Filip Ndocaj që u botua nga shtëpia botuese "*Naim Frashëri*".

Një vit më vonë, më 1961, po kjo shtëpi botuese botoi vëllimin e parë të tij me poezi dhe poema, "*Në sytë e Rinisë*" prej 96 faqesh. Vepra tjetër letrare titullohet "*Dashuri dhe urrejtje*" një përmbledhje më novela e botuar 3 vjet më vonë po nga shtëpia botuese "*Naim Frashëri*".

Në vitin 1968 botoi romanin e parë "*Vlaga e dheut*".

Autori shkroi një metodë për të mësuar italishten që u përdor gjatë viteve 70' të shekullit të kaluar.

Në vitin 1971 qarkulloi edhe romani tjetër në dy vëllime "*Diell nën kreshta*" që u kushtohet jetës dhe malësorëve pukjan nga cikli "*Nikë-Bujqajt e apripes së keqe*".

Romani është ndarë në tri pjesë. Filip Ndocaj ruajti një dashuri dhe respekt për banorët pukjanë, pasi aty kaloi disa vite te rinisë së hershme.

Ashtu i sëmurë, i shtrirë në një krevat, priste shokët dhe miqtë e tij. Pak ditë para vdekjes, siç dëshmon A. Zholi, në bisedat me shkrimtarin Agim Cerkaajn, i thoshte: "*Më vjen keq, o Gim si nuk u shërova, të paktën vetëm për disa ditë që të shkoja edhe një herë në Pukë, të shihja atë vend e atë njerëz... më ka marrë malli*".

Dhe vepra e tij karakterizohet nga një galeri personazhesh: fshatarë, malësorë, druvarë, sharrexhinj, mësues, nxënës, etj.

Në vitin 1978 shkrimtari ynë botoi tregimin "*Duke kërkuar lumturinë*".

Filip Ndocaj ka botuar edhe disa shkrime me karakter gjuhësor, si: "*Veçantia e gjuhës dhe Fjalori i Institutit të Shkencave (1954)*" botuar në BISH, Tiranë, 1958, nr. 2 dhe, 1961, nr.1, dhe nr.2..

Kostandin Kristoforidhi, "Luftëtari", Tiranë, 4 mars, 1962;

"*Problem që kërkon zgjidhje të shpejtë*" (diskutim rreth artikullit "*Mbi disa antroponime dhe toponime tona*" të A.Varfit, "*Mësuesi*", Tiranë, 22 shkurt 1963.

Giuseppe Gradilone, *Studi di letteratura Albanese*, Roma, 1960, Etudes sur litteratura Albanese, 1968, II.

Mbi fondin e fjalëve dhe kuptimet e tyre në "Fjalorin e gjuhës shqipe" në "*Studime mbi leksikon dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe*" , II, Tiranë, 1972, f. 167 - 181.

Disa veçori gjuhësore të krijimtarisë letrare të Filip Ndocajt

Krijimtaria letrare dhe botuese e shkrimtarit Filip Ndocajt përfshin një periudhë afërsisht 25-vjeçare prej vitit 1961 kur botoi vëllimin e parë me poezi dhe poema "*Në sytë e rinisë*" deri në vitin 1978 kur autori ynë botoi tregimin "*Duke kërkuar lumturinë*". Duke e parë veprimtarinë e tij botuese në rrafshin gjuhësor, do ta ndajmë në dy periudha: e para fillon me krijimtarinë e botuar para Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe (1972), kur ai i botoi veprat në gegërisht, si "*Në sytë e rinisë*" (1961), "*Dashuri dhe urrejtje*"(1964), "*Vlaga e dheut*" (1968) "*Diell nën kreshta*"(1971) dhe periudha e dytë pas Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe, ku autori në veprat që shkroi dhe botoi do të zbatojë vendimet e këtij kongresi.

Është për t'u theksuar se Filip Ndocaj nga veprat e para dhe në vazhdim ka ardhur gjithnjë duke e përpunuar dhe zgjedhur për ta bërë sa më gjithëpërfshirëse, ndonëse e shkruar në gegërisht, por gjithnjë e evoluar, duke iu larguar gjithnjë e më shumë tajtave të ngushta dialektore. Vërejmë

se F.Ndocaj nuk i ka anashkaluar disa veçori gjuhësore të projektit të drejtshkrimit të vitit 1967, ndonëse nuk kishin marrë formë ligjore.

Duke qenë se tema jonë lidhet me gegërishten, do të mbështetemi në veprat që janë shkruar në këtë dialekt.

Filip Ndocaj ishte nga Veriu dhe një pjesë të jetës së tij i kaloi në fshatrat e Veriut, kështu që në veprat e para vërehet një ndikim dhe përdorim i gjuhës së këtyre zonave, sigurisht e përpunuar, por me një leksik krahinor që nga vepra në vepër vjen e ngushtohet.

Për këtë qëllim ne jemi mbështetur dhe kemi vjelë material nga dy vepra të Filip Ndocajt: e para i përket rinisë së hershme të autorit “*Në sytë e rinisë*” e cila është e ndarë në dy pjesë: e para titullohet “*Ngashërimi*” dhe përfshin 7 poezi të shkruara gjatë viteve 1940-1943 dhe pjesa e dytë titullohet “*Sulme dhe andrim*” që përfshin 17 poezi dhe dy poema të shkruara gjatë viteve 1945-1960 dhe vepra e dytë “*Vlaga e dheut*”, botuar më 1968, gjithnjë para se të mbledhë Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe dhe një vit pasi ishte botuar projekti i Djejtshkrimit të Gjuhës Shqipe.

Autori, siç e kemi përmendur më sipër, shkroi dhe botoi vepra dhe studime deri në fund të jetës së tij, por materiali gjuhësor është vjelë nga dy vepra.

* * *

Theksojmë se gegërishtja e autorit është mjaft e standardizuar, me ndonjë përjashtim të rrallë. Ajo është e thjeshtë, e qartë dhe e kuptueshme edhe nga lexuesi jugor. Kjo vërehet gjithandej në krijimtarinë e tij.

Filip Ndocaj shkruan në dy dialekte: fillimisht gegërisht e pastaj në standard. Një veçori e gjuhës së autorit është se nga vepra në vepër ka pasur ngritje, duke iu larguar gjithnjë e më shumë trajtave dialektore. Duke qenë se autori një pjesë të jetës së tij e kaloi në veri, do të vërejmë se në veprat e para vihet re ndikimi i të folmes ku ai ka punuar, por nga vepra në vepër dialektalizmat gjithnjë e më shumë qoftë në leksik, por edhe në rrafshet tjera, vijnë duke u ngushtuar.

Leksiku i veprës “Në sytë e rinisë”(1961) dhe “Vlaga e dheut” (1968)

Autori Filip Ndocaj gjithnjë kërkon të përdorë në veprën e tij një leksik sa më të pasur që përveç fondit të përgjithshëm, të përfshijë edhe dialektalizma dhe krahinorizma, disa prej të cilave kanë hyrë edhe në fondin aktiv të gjuhës, ndërsa të tjera kanë një shtrirje të kufizuar territoriale.

Dialektalizma-krahinorizma të Filip Ndocajt që i ndeshim edhe në Fjalorin e gjuhës shqipe të vitit 2006 disa prej tyre me ndonjë ndryshim fonetik

A

Amshi = amshim, përjetim ...*jeta kur m'dukej amshi'...ulem tash heret n'agim...* (SR. 27)

Argjentore = i argjentë...*kur përmbi vesën argjentore bje të drandofillit...*(SR.20)

B

Bardhoke = me qime të bardha...*kur më kujtoheshin bardhoket tona kullosave...*(V.62). E ka edhe M.Elezi.

Behi = erdhi pa pritë, pa kujtuar, befaz ...*por ia behi Bardhi dhe u larguene...*SR.43

Binish = pallto e mirë...*ti shko pa frikë, shko pa binish mkatar!* (SR.32)

Bisedar = kuvendar... *Tashti Pal Delia ishte ba një bisedar që me ta pasë anda ta ndigjoje.*(V.100). E ka edhe B.Dema.

Bukurezë = xixillonjë ...*Jo për ndriçime bukureze në maj ...* (SR.32)

Buqari = bujk...*Kujtova se dikur do të pushojshe, porsì buqari në muzg të ditës...*(SR. 17)

Buzëthatë = buzëtharë...*për t'ja marra nderin nga inatise ai i la buzëthatë* (V,106)

C

Cegëm = acar ...*dimnit që shkoi nëpër cegëm të dhetorit* (V.61). E ka M.Elezi.

Cok = shprehje pohimi, nuk pranon mohim...*s'jena me të lanë me shkue cok...*(V.24)

Cuckë = vashëzë...*mirë ke folë, goja të lumtë cucke...*(SR.46)

Cullakoj = zhvesh lakuriq..*se bijnë fletët e pemët e cullakueme ...*(SR.8). E ka edhe M.Elezi.

Cungoj = pres degët e një druri dhe lë trungun...*cungoje rremash e nesër shpërthen...*(V.30). E ka edhe N.Gazulli.

Ç

Çalltis = rropatëm, përpiqem...*Kush s'çalltis për lumtuninë e vet?!* (SR.45)

Çip = bisht, cep...*E mbasi n'atë çip t'malcisë* (SR.49)

Çobani =mjeshtria e çobanit...*nisja kangve t'çobanisë!*(SR.24).

E

Etshoj = i etur...*mashinkat e t'huejit etëshue për gjak !*(SR.7). E ka edhe "Bashkimi"

F

Fanitet = **përhihet...të shikojnë, të faniten si hije e të afrohen...**(V.52). E ka “Bashkimi”

Flaurí = **fluturimthi ... duhia i merr flaurí ...** (SR. 8). Eanë “Bashkimi”, N.Gazulli dhe M.Elezi.

G

Gacëllue = **xixëlloj... Marashi tue gacëllue sytë...** (V.74)

Galdim = **gëzim i madh, gazëllim...i dukej se gjithë jeta ish valle e zjarhtë galdimi...** (SR.53).E ka edhe B.Dema.

?**Gdhej** = **njeri i trashë...lart n’atë qiell që del mes gdhëjve** (SR.27). E ka “Bashkimi”

Golle = **gropë, boshllëk, vrimë e madhe...N’aq terr jeta për ju do kish prap golle...** (SR.60)

GJ

Gjakësi = **armiqësi midis dy familjeve...me jetue me fitme e gjakësi...** (V.10)

Gjakhuptë = **gjakhupës... e kishin vra “me moh” dhe shkoi “gjakhuptë”si thuhej...**(V.51). E përdor Fishta.

E ka M.Elezi.

H

Hajnisht = **hajdutërisht...që kaq hajnisht të la!**(SR.18)

Hurba = **gëllenkë...dhe nisi ta pinte me hurba...**(V.25)

K

Kafshore = **kafshatë buke.., Dy miqtë që vuejshin veç për një kafshore...** (SR.91)

Kaploj = **pushtoj...i mërztun nga kjo lodhje e madhe që e kishte kaplue...**(V.17)

Karmë = **mriz, rrëpirë...n’ato karme rreshkë thatsisë...** (SR.49)

Kërcellej = **kanoset, kërcet...që renkon llogoresh tue kërcëllye dhambët...**(SR.4)

Kobe = **mallkim ... ai mendjet i largon si kobe të harrueme...** (SR. 90)

Kotni = **kotësi, diçka pa vlerë...kotninë kërkuen të giorët e jeta mbrapa i la...** (SR.68)

Kukat = **vë kujë... Dilni e mos më kukatni kështu si qyqe...**(V.135)

L

Lazdroj = **përkëdhel ...Si ke nisë me e lazdrue ti, ai s’ka me dalë gja...** (V.28).E ka N.Gazulli

Luloj = **lulëzon...nga deg’ t e pemve që lulojnë petalet bijnë...**(SR. 23)

M

Mahí = shaka, tallje...*Po, more, s'á mahí me partinë tone...* (V.14)

Meroj = tmerroj...*boll m'i merove këta bylbylat e mi!*(V.29). E ka M.Elezi.

N

Nusnore = nuserisht, si për nuse ...*natyren krejt stolisë n' rroba nusnore...* (SR. 22)

O

Ofshama = rënkim i thellë...*Ai nxori një ofshamë të thellë...* (V.75). E ka B.Dema.

Orëpreme = orëprerë,fatkeq...*ato orëpreme dhish s'janë kah më shkojnë...* (V.73)

P

Pamort(i) = i pavdekshëm...*gzo Atdhe, gzo se pranvera e pamort lulzon mbi ty!* (SR.95)

Përvidhem = largohem nga një vend fshehurazi...*përvidhem nga sheshi n'terr mortise...* (SR. 79)

Pingron = cicëron...*zani i saj pingron si zana* (SR.92). E ka "Bashkimi"

Plandos = përplas ...*dersa i plandos m'ndoj vi..*(SR. 8). E ka M.Elezi

Plima = tufë,varg...*Shqiponja çeliku n'ajri me plima t'argjenta fluturojnë...*(SR. 77). E ka M.Elezi.

R

Rangë = punët e përditshme të shtëpisë, detyra...*e mbyllën çikën në rangët e shtëpisë...* (V.105)

Rr

Rrezim = shkëlqim...*si ban rrezitja e parë e diellit.*(SR, 20)

Rropos = rrafshoj, përmbys...*me një të luejtun qerpiku rropos qiell e dhë...*(V.134). E ka "Bashkimi"

Sh

Shaterkaz = kazmë...*që n'cep t'krahut ka vu një shaterkaz.* (SR.84).E ka "Bashkimi"

Shestoj = shestoj, përcaktoj...*duhen shestue e mendue mirë e mirë...* (V.46)

T

Taravole = që ka karakter të fortë, që s'di ç'është frika... *t'gjith azgane e taravola shkambin shpejt me e dërmue*(SR.48). E ka "Bashkimi"

Trova = thërmija të mëdha, trashë...*ku dashtnisë s parit iu trova..*(SR.27)

Turrem = versulem...*E atëherë Pjetri i ishte turrë atij...* (V.10). E ka "Bashkimi"

Tyt = largimi i qenve...*Tyt, more teveqel...*(V.32)

V

Vashnore = vajzërore...*ruej pra njomsinë vashnore der n'pleqni!* (SR.32)

Vdeksore = mortore...*Ti larg shtëpisë n'nji dhomë vdeksore...* (SR. 18). E ka M.Elezi.

Vegim = agon, mezi e shquaj...*si kujton ti nsa si n'vegim, n'pasqyrë...* (SR.34). E ka N.Gazulli.

Vigmë = britmë...*n'vigmen e jetës...* (SR. 4)

Vlagë = lagështirë...*Toka dalë vlagë...*(V.151)

Vrik = shpejt e shpejt...*sa ma parë, që vrik me çue skavatorë...*(SR. 48)

Vrriet = kullotë dimërore ...*këndojnë brigjet. edhe vrriet edhe ugaret nisin vallet* (SR.95)

Z

Zulma = lavdi, famë...*zulma mori detin...* (SR. 77)

ZH

Zhegit = kam vapë, digjem nga zhegu...*e mos me u zhegitë nëpër Tiranë.* (V.130)

2 Dialektalizma dhe krahinorizma që nuk i ndeshim në fjalorin e shqipes së sotme, por në veprën e F.Ndocajt

A

Agmia = dritë e lehtë...*kur ze çohet agmia që feskton mbi katund t'fjetun.*(SR.60). E ka edhe B.Dema

Anaku = guri anësor i oxhakut...*koka e tij mbështetej në anakun e maj të të oxhakut..*(V.17). E ka Elezi.

Avizore = humnera...*se nis n'teposhtë rrokollesh avizore.* (SR.32)

B

Berbjekthë = fëmijë të vegjël...*por gjithë këta berbjekthë duen bukë e ushqim me u rritë...*(V.69)

Bezerë = gjigant, përbindëshskavatorë e buldozerë, për me e nisë pendën...*bezerë!*

Brazni = boshllëk...*mbi kep të majës së zbulueme shastisen sytë n'pamatuni brazniet.* (SR. 86)

Bun = banesë njëkatëshe me gur...*Ma vonë ai ndertoi bun si ai që kemi sot në bjeshkë...*(V. 124). E ka N.Gazulli.

C

Calina = pushkë të vogla, pisqolla...*mbante një depo armësh: dy kobure, dy tri calina...*V.22)

Cemtë(i) = i kulluar...*Po lumi... ishte ba si ujët e burimeve, i cemtë si zakonisht...*(V.204)

Cergat = qilim, punuar me lesh dhije...ujdisi postiqet e cergat që mbulojshin ...anët e dhomës... (V.24)

Cukatë = me e prekë me sqep...ajo po i largonte pulat që vjedhtas vinin me cukatë kokrrat...(V.26)

Cytë = ngacmoj... tri orë rrugë mali larg nga friga cytë! (SR.59)

Ç

Çurma = ushtri kusarësh deti...tufane, dallgë e çurma n'luftë prallore... (SR. 87)

D

Daj = gjithmonë, vazhdimisht...pat qenë msue ta ketë daj ngiet... (SR. 41)

Dalldis = shastisem pas diçkaje , shpërthen...e atë bylbyl që kangësh ka dalldisë mbi krena t'njerzve ... (SR. 79). E ka "Bashkimi".

Drau = zhul, ...do të pastroheshim nga ai drau shekullor I zakoneve... (V.235)

F

Falanikët = argat pa pagesë...Kishin ardhun falanikët e vargu i shataxhinjve...(V.73). E ka N.Gazulli.

Fang = shesh...e tok me ta u nis për te fangu i çardakut...(V.29)

Fejtë = Këndej? ...kanë dalë n'mal me luftue e fejtë ma s'janë tue ra... (SR. 12)

Fekson = agon, shkëlqen...kur ze çohet agmia që fekson mbi katund t'fjetun... (SR. 60)

Ferk = sapo ka dalë drita, agon...ndriste syni i etun si shejzat n'atë ferk drite... (SR. 60)

Fjugë = furi, vrull pune...do rrëxojshin shkamb e gurë me atë fjugë të plot zhumhurë...(SR. 47)

Flegrue = drite kishte pre hollë...Leka kishte flegrue një vandak pishash. (V.187). E ka N.Gazulli.

Fluret = fluturon? ...lart edhe ma lart po fluret si sputnik... (SR.55)

G

Gujë = lloj gune...Kishte veshë një gujë të zezë, të shkurtën si gujë çobaneshash...(V.223)

H

Hjekakeq = ai që heq keq...Jena msue hjekakeqë ne por hapni sytë... (V.11). E ka N.Gazulli.

Hutrojë = e humbur...bash si plakë hutrojë na u duk ... (V.271). E ka "Bashkimi".

K

Kah = këtu...Po ti, çka orën e ligë lyp kah nalt, Zogë... (V.23)

Kajitja = gajasje...*Fill mbas kësaj u ndigjue kajitja gazmore...* (V.34)

Kalinë = kone, këlysh qeni...*duket se ungron kobshëm një kalinë e mërdhime.* (SR. 3)

Kaltërsiplote = plotësisht e kaltër...*ajo ditë kaltërsiplote...*(V.207)

Kersh = shkëmb...*Janë bij t'atyneve, robnisë që kurr nuk iu përkulën ndër ato kersha e ju*(SR.91)

Kërthnesë = gjithë gjelbërim e degëzim të dendur..*t'jesh e kërthnestë që stuhive...* (SR.30). E ka Gazulli.

Kohanike = moshatare...*shoqet e mia që i kam kohanike s'po ma venë veshin.*(V.247). E ka "Bashkimi".

Kokola = misra të vegjël...*me gështeja e copa patatesh e me kokola misri e me çmos.*(V.181)

Kotnishë = Kotsisë?*... largou kotnishë nën hijen e ndo'i tande!* (SR.31)

Kushdohi = kushdo ...*se edhe bujku e kushdohi duhet të marrë vesh...*(V.,128)

L

Lmek =t'u shua?*Por jeta që aq fort ti e dojshe, befaz t'u lmek...* (SR.17). E ka "Bashkimi".

Lumnoj = lumturoj...*larg familjes e larg fisit s'ka si lumnon malësori...* (V.38)

Lupanar =njeriu që frekuenton vendet e padëshirueme keq...*lupanar ku knaqen epshet që t'lanë neveri...* (SR.32)

Ll

Llomajë =llomishtë...*zhagitet hapi i saj krejt pa kujdes mje nëpër llomajë...*(SR.16)

M

Maçukaj = shprehje ledhatuese për,fëmijë, buçko,...*Anima , maçukajt e mi as në oborr ...nuk duan me ju lane...*(V.31)

Mertuku (sh') = namë për shaka...*Mbyllnie gojën he ua mbylltë sh'mertuku.* (V.18)

Motnuem(i)= i vjetër...*Ç'janë ata dy si lisa të motnuem...*(SR. 39)

Mungulloj =terratis...*bri tij filizat zanë me mungulluem* (SR. 67). E ka N.Gazulli

Murtar = murator...*arqitekt t'ri me bashkëshatarë murtarë kah gjithë ndërtojnë...*(SR.89)

Murrinë = errësirë muzgu...*me dalë murrinave të mbramjes për me shfrye dufet ...* (SR.14)

N

Nëntrasha = peripeci...*kur të jesh i zoti i punës s'i mërzitësh nëntrashave të jetës...* (V.36)

P

Paana (të) = të mbathura ...*S'ka nji javë që ja preva të reja këmishë e të paana...*(V.31)

Përqyrran = qyrravec...*ju...me i kthye fjalën shpijakut tuej, ju përqyrranat e orës së ligë!* (V.65)

Pijanik = pijanec...*Pjetri nuk ishte i dhanë , bile i kishte inat pijanikët.* (V.88)

Poravas = banor të lagjes Porav- *Këta poravas nuk dolën haptas kundër Pjetër Ukës...* (V.10)

Poteraxhi = zhurmexhi, shamatar... *Më në fund u ndigjue zani i....që u gërmushej poteraxhinjve* (V.18)

Praksoj = trembem, nuk më zë vendi...*Grigjen tande ku e paske qitë, se mue krejt për besë m'u ka praksue* (SR.44)

Priftimi = verdhëza...*Uh, daltë dreqi e ju shiloftë si më jeni ba bash si me pasë priftimin!*(V.152)

Prishje = grënia e parë e malësorëve...*s'po di me u ulë këtu me ne për prishje* (V,68).

Prrallet = defrehet...*Paj asht kah prrallet me Masjanin e vogël...* (V.69)

R

Rajçuer = banor i Rajçës...*s'mbet rajçuer pa e vu në tallje* (V.201)

Roga =suka mali...*ishte rritë bareshë, tue kullotë grigjen e vet rogave të Strames...* (V.18). E ka N.Gazulli.

Rr

Rrebe = trill,teke...*shko,Pan , e mos qit rrebe ma knell, ma josh n'vallzime!* (SR.10)

Rrgalle = tokë që i ka ikur dheu nga eruzioni...*shumica e tokëve të kësaj malësie genë tue u ba rrgalle e rmore mali...*(V.43)

Rrmore = tokë e shkarë...*ishin rrokullisë si bien ata gurët e rrmores së malit, pa i shtye kush...*(V.178).

Rrozbitë = shkallmim...*Aq qe rrozbitë kësaj herës së fundit, sa ishin dy mendjesh...*(V.36)

Rrufçoj = tërheq barin me dhëmbë...*Lopët ishin shpërnda bregut tue rrufçue tufa bari...* (V.206)

S

Sallahan = sorollatem...*por endem sallahan edhe këto ditë...* (V.111)

Sogje = rojë ...*që na shoqnojnë gjatë gjithë jetës...që na rrinë sogje katundeve tona!*(V.130)

Sutë = vajzë e urtë, drenushë...*O Pan pse lshohe sutave npër pyje pa diell...*(SR.10). E ka "Bashkimi".

Sh

Shkrroje = **zhigat**...*plaka e re nuk bahet sado që të lyhet e të shkryhet*...(V.36)

Shmarrabe = **betim tallje**...*Pasha të shmarrabenë, o ti plaku i Nik-Buqajve*...(V.28)

Shpijanik = **I zoti i shtëpisë**...*fundi ai ishte shpijaniku Nik Buqajve*...(V.16)

T

Tehri = **shirit**...*dukej që andej si një tehri argjendi që thurte fundin e një xhublete*...(V.219). E ka “Bashkimi”.

Torishta = **vath**...*gjithë kohën e kalonin ndër stane, e sidomos pse torishtat e bagëtive*... (V.254)

Trosha(të) = **thërmim**...*barku i tij ja kishte nisë të troshavet bash si ajo stena e motnueme*.. (V.65)

Trille = **cicërima të ndryshme**...*kangës ja nis bylbyli n’trille shkrue*. (SR.78)

Trupoj = **Kalon rrugë pa rrugë**...*morën autobusin për në Korçë, por trupuen mal në mal*...(V. 241). E ka “Bashkimi”.

Tutët = **frika**...*Qysh lyp besë burri tutësh të njaj baxhie plakë*...(V.28)

U

Unë = **urë zjarri**...*Ashtu të pagojë, si unë e zezë që ka rrëshqitë nga stave e druve*...(V.190)

Unji = **tërësisht**... *Shiko: ia gjasojnë kokës sate ba tullac unji!* (SR. 8)

V

Valige = **tokë me lagështirë**...*Toka mund të jetë valige sa të thuesh e rrasfshi bash si tepsi* ... (V.44)

Valloi = **I rrethoi rreth e qark**...*çeli tokë buke e livadhe, e valoi me ledhe, i vu muranat*..(V.124)

Vilagë = **llastar**...*filiza e filiza të njomë, vilagë që ngjien llastar kah qielli*... (V.25). E ka “Bashkimi”.

Vrugue = **i nximë nga mendimet**...*Nuk kuptoj ç’ mendojnë kështu fytyrë – vrugue!*... (SR.79)

Z

Zanamare = **nga zamare vegël muzikore**...*se pa ty, moj zanamare nuk m’josh jeta si dëshroj*(SR.27)

Zguer = **bosh, zgavër lisi**...*Rrfeja kur bjen mbi trungun e vjetruem e zguer i zi ai mbetet*...(SR. 67)

Zyl-hava = **këngë e kënduar më zërin më të lartë**...*e dëgjon dhe kështu nis zyl-hava*...(SR.94)

Zh

Zhagit = **zvarit** ... - zhagitet hapi i saj krejt pa kujdes mje ndër lloj... (SR.16). E ka B.Dema.

Zhagmitë = **hiqem zvarë**... ishin rritë kot, zhagmitë periferishë (SR,72)

Zhgote = **e kontrollonte me kujdes** ... *Bardhi punën pa fillue, mjetin zhgote e furnizonte...* (SR. 52)

Zhgjeton = **shigjeton** ... *E gjaku që vërshon e mnia që zhgjeton në shekullin tonë...* (SR 80)

3. Fjalë të huaja

Duke qenë se subjekti i krijimeve të F. Ndocaj është marrë nga jeta e fshatarëve në veri të Shqipërisë, vërehet edhe një ndikim i leksikut të atyre anëve dhe përdorimi i fjalëve të huaja, kryesisht të turqizimeve, pasi i përkasin ligjërit të folur, siç do të shihet më poshtë.

A

Amanetqar = **e kryen porosinë** (ballkanizëm)...*Jam amanetqar I mallit të shetit.* (V.84)

B

Baxhi = **plakë, amvise** (Orientalizëm)...*qysh lyp besë burri tutësh të njaj baxhie plakë ...*(V.28)

Bidat = **shpikje(turq)**... *S'ke si qet bidat të ri në katund të vjetër* (V,14)

Ç

Çajre = **mënyrë, mjet(turq)**...*po na mbulojnë mizat e s'i gjejma çarje vetes!*(V.29)

D

Dallash = **ters, i keqkupton, gabim** (turq.)...*megjithëse nisej nga interesi... gjithkund nuk e kishte dallash!* (V.210).

G

Gavadare = **çobaneshë**...*o moj çika gavadare...* (SR.25).

L

Log = **shesh**...*Log pune asht, rrugë nderi e shteg i brishtë...* (SR. 34).E ka N.Gazulli.

F

Frengji = **Vrimë të hapura nëpër bedena** (turq.)... *e mbaj mend , s'ishte porse frengjia same nxjerrë jashtë tytat e pushkëve...*(V.125).

G

Grazhd = **vend në stallë ku i hidht ushqimi bagëtives** (sllav)...*ma japin gja me I shujtue e as grazhdin me ua ndrurrue...*(V.25).

GJ

Gjytrim = **I gjymtua, ulok** (turq.)... *se edhe gjytrimit jeta i duket e kandshme.* (V. 23)

H

Hoka = **shaka** (turq.)...*nuk I pëlqente ajo pritja gjithë buzëqeshje dhe hoka*

Hise = **pjesë** (turq.)...*prandaj edhe ju ka pasë në hise parësia juve.* (V.11)

Hasmi = **armiku** (turq.)... *pasha sytë e tu, rini, hasmit kurr s'ja ndajmë poterën* (SR. 94)

I

Ispatë = **dëshmitar** (turq.) ...*se nata s'ka ispatë e ajo si e ka bojën, ka edhe nafakën.* (V.82)

K

Kapaklia = **pushkë e hershme** (turq.)...*mandej te huta e te kapaklia, te calina e r rakelja!* (V.162)

M

Mahi = **shaka tallje** (turq.). *Po more, s'â mahi me partinë tone, se çka tha e ban...*(V.14)

P

Pojatë = **shtëpi banimi verore në kollotat** (sllav.)...*vazhdojnë të jetojnë në ato pojjatat stëgjyshore* (V.13)

Poteraxhi = **zhurmaxhi, shamator** (sllav.)...*që u gërmushej poterexhinjve...*(V.18)

Prozhmë = **pyll I vogël** (sllav.) *Zogë Maxhunia zbriti kah prozhmi për një krah dega të njoma.* (V. 29)

R

Rixha = **lutje** (turq.)... *thaju, mbushu gjelbërime këndo me mue, të kam rixha.* (SR.93)

Rudë = **racë delesh me lesh të butë e të shkurtër** (sllav.)...*me grigje ruda do e kish çue në malci...*(SR. 85)

S

Sabah = **mëngjes** (turq.)...*se sot nadje shkuen për dru pa ba ferk sabahu e besa do të jenë këputë.*(29)

Sojnikë = **e fisme**.(turq.) *Moj Margjelë, mori sojnikë çika e malcisë kreshnike...*SR.24

Stom = **bregore, ledh** (sllav.)...*çka m'ke ndejë, çikë, n'atë stom are...*(SR. 24)

Sputnik = **satelit** (rus.)...*lart e ma lart po floret si sputnik...*(SR. 55)

T

Teveqel = **mendjehtë, budalla**(ballkanizëm). *Mos u vë veshin fjalëve të teveqelave...*(V.11)

U

Uzdajë = shpresë (turq.) *Kam uzdajë se po, shko e thuej gjyshes Rutë të vijë!* (V.138).

4. Disa krijime të autorit (Neologjizma)

Është vështirë të përcaktohet disa krijime a janë të F.Ndocajt apo krijime popullore. Në fillim të krijimtarisë së autorit, pa pasur përvojën e duhur si shkrimtar, vërehen krijimi i disa fjalëve të përbëra, që nuk i ndeshim tek autorët e tjerë dhe as në krijime popullore. Një dukuri e tillë më këto përmasa bie në veprat e mëvonshme.

Po shënojmë ato fjalë që mendojmë se janë krijime të F.Ndocajt:

Flamore = flamur ...*si lufta pa zhaurima, pa vigma e pa flamore...*(SR. 5)

Gjelberoshe=të gjelbërta...*po i ktheheshin në ara gjelbëroshe...*(V.165)

Kafshore=kafshatë ...*Dy miqtë që vuejshin veç për një kafshore...*(SR.91)

Kohanik=moshatare...*shoqet e mia që i kam kohanike...*(V.247)

Lumnon= të jetë i lumtur...*se larg...familjes...s'ka si lumnonm malësori...*(V.38)

Meroj= tmerroj...*O Zogë...se boll m'i merove klëta bylbylat e mi!* (V. 29)

Murtar=murator...*me bashkfshatarë murtarë kah gjith ndërtojnë...*(SR.89)

Nusnore=veshje të nuseve... *krejt stolisë n'rroba nusnore...* (SR. 22).

Pijanik= pijanec...*Pjetri nuk ishte i dhanë pas pijes, bile i kishte inat pijanikët...*(V. 88)
Pishare=pishtar...*t'bahen pishare n'ballë t'jetës t'ndriçojnë...* (SR. 7)

Valloi= I rrethoi rreth e qark...*çeli tokë buke e livadhee valloi me ledhe...* (V.124)

Virgjinta = të virgjërta, të pastra...*o qenje të virgjinta...*(SR. 60)

Zjarmori= nxehet shpejt, fig. merr zjarr "*Bile Lulashit... që ishte ma zjarmori i të katërve...*(V. 34)

* * *

Filip Ndocaj përse i përket leksikut ka veçoritë e veta, pasi krijimtaria e tij është shkruar dhe botuar në Shqipëri. Gjithashtu ai ka botuar vepra si para Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe dhe pas Kongresit.

Një veçori tjetër e leksikut të Ndocajt është se ai është ndikuar nga ligjërimi i folur, por i përpunuar të atyre zonave ku ai ka punuar.

Gjithashtu Filip Ndocaj ka qenë gjithnjë në kërkim për të përdorur një leksik gjithëpërfshirës, ndonëse mbështetet në leksikun krahinor të zonës që përfaqëson.

Autori duke njohur realitetin shqiptar edhe në fushën e zhvillimit të gjuhës shqipe, nuk ka dashur të jetë konservator në dialektin e përdorur, por është përpjekur që edhe në leksik të mos përdorë pa kriter fjalët krahinore, gjë që vërehet se ai leksik vjen e kufizohet nga vepra në vepër.

Ndonëse ndeshim edhe krahinorizma, përsëri leksiku i veprës së autorit ka fjalë të rralla me vlerë, të cilat mund të zgjidhen dhe disa prej tyre mund të përfshihen në fjalorin e gjuhës shqipe.

Duke qenë se autori është mbështetur edhe në ligjërimin e personazheve, që është një galeri e tërë e pasqyruar në krijimtarinë e tij, ka gjetur vend të zgjedhë atë leksik të pranueshëm edhe nga lexuesi, që vepra të lexohet pa vështirësi.

* * *

Leksiku i përdorur në veprat e autorit (kryesisht gegizmat) i përket gegërishtes letrare që ka vlera, mbasi mund të shfrytëzohet në të mirë të pasurimit të fjalorit dhe të gjuhës shqipe në përgjithësi.

BIBLIOGRAFI

- F.Ndocaj, *Në sytë e Rinisë*, Tiranë, 1961, (Më pas: SR).
- F. Ndocaj, *Vlaga e dheut*, Tiranë, 1968, (Më pas:V).
- *Fjalori i "Bashkimit"*, Shkodër, 1908.
- D. N. Gazulli, *Fjalorth i ri fjalë të rralla të përdoruna në Veri të Shqipnisë*, Tiranë, 1941.
- Instituti i Shkencave, *Fjalor i gjuhës shqipe*, Tiranë, 1954.
- J. Thomai, *Leksiku dialektor e krahinor në shqipen e sotme*, Tiranë, 2001.
- ASH, *Fjalor sinonimik i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2005.
- B. Dema, *Fjalor fjalësh të rralla të gjuhës shqipe*, Tiranë, 2005.
- T.N.Dizdari, *Fjalor i orientalizmave në gjuhën shqipe*, Tiranë, 2005.
- Th. Feka, *Rreth fjalorëve krahinorë të gjuhës shqipe*, në "Leksikografia shqipe - trashëgimi e perspektivë", Tiranë, 2005.
- ASH, *Fjalor i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006.
- M.Elezi, *Fjalor i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2007.

**About the contribution of the work of
Filip Ndocaj to the lexical plain**

ABSTRACT

The author at the beginning of the article states that the author's Gheg is quite standardized with a rare exception. Filip Ndocaj writes in two dialects: starting in Gheg and then in standard.

The lexicon of the work "Në sytë e rinisë", (1961) and "Vlaga e dheut" (1968) is analyzed.

Filip Ndocaj regarding the lexicon has its own features, because his creativity has been written and published in Albania. He also published works before and after the Albanian Language Spelling Congress.

Another feature of Ndocaj's lexicon is that he has been influenced by spoken lectures of those areas where he worked.

Filip Ndocaj has always been in search of using a comprehensive lexicon, however he is based on the provincial lexicon of the area he represents.

Although we also encounter provincial words, the author's lexicon has some valuable words that can be selected and some of them can be included in the Albanian Language dictionary.

Since the author is also based on the lecture of the characteres, which is a whole gallery reflected in his creativity, he has found a place to choose the acceptable lexical from the reader, in order that the reader can read the author's work without difficulty.

Alfred ÇAPALIKU

BOTA FEMËRORE E KOKALARIT TEK
“SIÇ MË THOTË NËNUA PLAKË”

“... *Provë shkrimi femëror shqiptar?*”

Lasgush Poradeci

Hyrje

Musine Kokalari (Adana, 1917 – Rrëshen, 1983) është e para femër në historinë e letërsisë shqipe e cila boton një libër artistik. Në vëllimin me skica e tregime “Siç më thotë nënuja plakë”, Tiranë, 1939, shkrimtarja e re 22- vjeçare arrin të realizojë të shkruarit gjinor. Dallimi i stilit të Musines, tek 80 faqet e veprës, me mbarë teksturën artistike të autorëve shqiptarë më në zë të viteve ’30 lind nga të shprehurit e veçantë gjuhësor. Është një modalitet depërtues, një pikë shikimi e dalluar mes grave dhe burrave, shprehur gjer në limitet e të shkruarit. Timbri polifonik i gjyshes, imesogruas, i nënës, i nuses dhe i vajzës gjirokastrite del me korda të holla nga trupi i femrës. Në prozën e shkurtër të Kokalarit me fare pak penelata realizohet portreti moshor i protagonistëve mëma e vjehrra. Personazhet mashkullorë mungojnë, por ata nënkuptohen përgjatë rrotullimit të ngjarjeve. Siluetat burrërore shërbejnë vetëm si sfond. Urdhrat e tyre artikuloohen në ligjëratë të zhdrejtë nga vokali i femrave, që i kthen zotërinjtë hijerëndë në pika të tërthorta referimi. Zonjat me thesarius aq të pasur përdorin në kuvendimin mes tyre fjalë formuleske të toskërishtes jugore, lutje, porosi, urime, mallkime: si perpetuum mobile për ta mbajtur gjallë bisedën. Dhjetë skenat e mikrotregimeve etnografike, skicave portretizuese, vizatimeve profilizuese, ndodhive fragmentare, kallëzimeve minimaliste, rrëfenjave intriguese, rrëfimeve apologjike, kujtimeve të sakta, përshkrimeve të imëta, thashethemeve flu kanë në qerthullin e tyre veç dy figura femërore. Ato gra të ndrojtura e vajza të heshtura ndodhen në një mjedis të mbyllur familjar: brenda një shtëpie prej guri apo këndeje një dritareje prej qelqi, në një odë pritjeje apo në një kuzhinë karakteristike,

poshtë një shkalle mbi rrugë apo rreth një oborri me avlli, te një prag porte prej druri të gdhendur apo te një cep mëhalle të shtruar me kalldrëm. Femrat zhvillojnë më shumë monolog ekspresiv sesa shkëmbejnë dialog fiktiv, mbasi njëra flet pa pushim e tjetra pohon– mohon me gjestikulacion dhe mimikë. Në fabulat, shoqëruar rrallë me përshkrim e peizazh, personazhet janë çift: gjyshja me mbesën, dy fqinjët inatçore, dy kunatat, dy gratë e reja, dy mëhallalijet, vjehrra me nusen, nëna me të bijën, dy shoqet, dy motrat e martuara, dy qytetaret gjirokastrite. Galeria e miniaturave të saj origjinale, nga gruaja tek gruaja, befasoi lexuesin e zakonshëm dhe tërhoqi vëmendjen e kritikëve letrarë të gjysmës së parë të shekullit XX, si: Filip Fishta, Vangjel Koça, Petro Marko, Andrea Varfi, Nexhat Hakiu, etj.

Siç më thotë nënua plakë

Pyetja kurioze e mbesës ndaj gjyshes, sesi jetonte ajo kur ishte çupë, vërtit përqeshjen e nënos plakë ndaj vajzave e nuseve të kohëve të reja. Kundërvënia e gjyshes ndaj femrave të ditës është i plotë. Ai përfshin çdo veprim të qortueshëm: si vishen, si ecin, si zbaviten, sa janë vajza. Dhe kur martohen, nënua plakë u numëron nuseve vargun e të metave: si rrinë gjithë ditën e ditës shtrirë, si nuk zënë punë me dorë, si nuk e vrasin mënden fare, si s' ngrenë qimen nga qulli. Për të gjitha këto fajin e kanë jo vetëm zivogavot e shkollës, por edhe burrat që u bënë gra. Si kritizere e pandreqshme gjyshja s'kursen as mbesën e saj, që gjatë ngjarjes pa lëvizje e dëgjon të moshuarën në heshtje të plotë. Portreti i nënos, fiksuar pas të shkuarës, u projektua si filmi në ekran tre vite më pas, më 1942, tek poema satirike "Hanko Halla" e Ali Asllanit, ku shohim sozien e saj: hankon e rënë nga vakti, mbajtur pas derës së madhe. Dallimet mes profileve të dy plakave spikasin jo vetëm nga teknikat e ndryshme të aktshkrimit: në rreshta apo në vargje, por edhe në aspektet e ndryshme të letërsisë gjinore. Prozatorja Musine Kokalari paraqet këndvështrim femëror në personazhen stoike të Nënos: "*Pse më dridhen ashtu, ç'janë ato roba që më bëjnë pas trupit, sikur do t'u çahen veshur. Ç'janë ato nisëla, ata të kuq e të bardhë që më vënë, po për nusëri çdo të lënë ... Të thom, u-bëra kaqë, nuk di se si është të thënit e emërit të burrit. U-bëra me gjashtë fëmilë, nuk thaçë di fjalë radha me të ndjerin: na, ama, merre, jepe, atë, këtë, këto qenë fjalët t'ona*". Nga ana e tij poeti Ali Asllani shpalos këndvështrim mashkullor në figurën komplekse të Hallës: "*... Nuk më mbushet syri, nuk më mbushet zemra, / Nuk më piqet ylli me të tilla femra!*".(1)

Për mustaqet e Çelos

Fqinjet grindavece, zonja Hava dhe Merushja, zhurmojnë në faqet e tregimit si dallgë. Qetësia vjen kur ndërhyjnë me takt plaka e urtë, teto Shekua, të cilën e dëgjojnë të mëdhenj e të vegjël: “... dhe jeni gra të shkuara edhe na muartë mënden me marrëzitë t’uaja”. Por vetëm pas një çasti ngatërresa midis tyre vazhdon si tallaz. Të dyja s’mund të rrinë pa folur, ngaqë llafazanllëkun e kanë ves dhe zënkën e kanë mënyrë jetese. Avazi i tyre është gërryes e me hedhje të shpeshta degë më degë. Ndërprerja e fjalëve të njëra - tjetrës sjell devijim të bisedës gjer në absurditet... Atëherë e moshuara plot mend, por e privuar nga fuqia fizike, thërret në ndihmë shoqet e saj Paqon e Huznon, dhe të trija bashkë i fusin me zor brenda dyerve të rënda dy shamataxheshat. Tregimi ngrihet mbi antitezën e goditur mes grave të urta fjalëpakta dhe atyre bjerraditëse fjalëshumta, që zihen në sokak:

“... gjithënjë po ato dhe përse?”.

Poeti Lasgush Poradeci e analizoi tregimin në kuadrin e përmbledhjes me prozë të shkurtër:

“Gruaja e lagjes, e dyerve dhe e portave, vizitonjësja e vatrës dhe oborrit, fjalmania tradicionale, që përfaqëson tipin e përbashkët dhe të përditshëm të intrigonjësës... që fut fitila, që shtje spica, që shan dhe hedh në sherr dhe shtyn në ndarje – kjo: mëhallaxhesha shqiptare e pavdekur për gjithë herën dhe për gjithë kohën, përbën fondin e inspirimit të librës ...”.(2)

Burri shoku qenit

Martesa e një vejani në qytet as dyzet ditë pas vdekjes së të shoqes ndesh në kundërshtimin moral të dy kunatave, meqë në ritualin e mortit ai ishte betuar me qarje: “... do të rrit fëmilën vetë”. Tre fëmijët shpërndahen si zogjtë e korbit tek nënëdajua dhe tek xhaxhesha. Ndërsa vajza e madhe e mbahet në shtëpi vetëm për t’u shtruar në punë nga njerka dërdëllitëse:

“... jam e re dhe s’kam gëzuar të rit’ e mi, do të bëj qejf’ si shoqet e mija”.

Dhimbja e thellë e kunatave për nënën fatzezë e jetëshkurtër përzihet me

qesëndisjen e talljen ndaj burrave me dy fytyra:

“Sa i zihet besë gjarpërit, aqë i zihet dhe burrit. Ngreje nga mendja, sa pa kthier krahat, pa u mbillur ndënë dhe, se u harove. Mirë thoshin të parët, flori e kishin fjalën: burri shoku qenit”.

Letërsia gjinore e Musine Kokalarit përmes ironisë, sarkazmës, satirës dhe humorit të zi arrin gjer në një mohim ekstrem të elementit mashkull, shprehur tepër rrallë më parë artistikisht në traditën tonë; si me regjistra të tjerë te poezia “Fshati im” e Çajupit:

“Moj e mjera grua, / ç’e do burrë zinë...”. (3)

Është e thellë

Gruaja e re Bedo rrëfimin e saj në formë diptiku ia bën një shoqeje të ardhur për vizitë në shtëpi. Në fillim i ankohet për kumatën e pamartuar që *“vënd s’lë pa futur turitë”* dhe që *“shpon ndënë dhe”* kundër saj tek i vëllai. Në fund ajo i përshkruan asaj dhunën në familje nga i shoqi, të cilin e përmend me përemrat “ai” dhe “ki”:

“S’e hapa golën, erdha e mbeta, dhe zura ta veshtronja ... kur fiu ...sahanin që kish përpara, të mos kisha ulur kokën do t’më kish bërë suratin çikë – çikë, pormë ra nëdorë ...Për atë kohë si s’lëshova zënë, por mendova se do t’na dëgjonin jashtë”.

Në këtë mizanskenë të pabarazisë gjinore gruaja hyn e del si figurante, mbasi aktor kryesor është burri i xhindosur nga shpifja dhe nga pija. Kritiku Dalan Shaplllo e ka profilizuar kështu shkrimtaren:

“... mënyra e të treguarit, atmosfera janë veshur me një endje artistike, emocionale, me qëndrimin e fshehur e të përmbajtur hera-herës të autores, çka dëshmon për një art të mirëfilltë të shkallës së lartë... letrare e shquar, e cila iu përkushtua anëve të jetës që njihite më mirë, duke ndjerë se këto mjedise dhe kjo atmosferë i mungonin letërsisë shqipe”. (4)

Paç fatin e së ligavet

Kjo skicë monologuese është e mbushur me ankthin e teto Behijes për vajzën që s’i del fati dhe me shqetësimin se *“... atje ku e kishin sinë ja rëmbien nëpër duar”.*

Mëhallallia më e re, Firuzeja, e dëgjon e hesht, mbasi nëna e nxehur, për shkak të vajzës që i ka mbetur brenda, nuk i lë radhë të flasë. Mllefte te magjitetë, mallkimet e pakënaqësitë, sharjet e talljet, ankimet e qarjet, netët pa gjumë dhe ditët e shprishura, inatet e shpeshta dhe mburrjet e pafund të Behijes bëjnë që ajo ta shohë botën të përmbysur vetëm ngaqë vajzës i humbi një rast i artë për fejesë:

“Ç’e do, kush ma prishi punën e vajzës s’ime mos pastë hair në shtëpi, e gjeftë nga mos pandehtë...Mirë thoshte rahmet pastë nëna, paç fatin e së ligave”.

Studiuesi Ali Xhiku vëren:

“E ndërjegjshme... se psikologjia e gruas gjirokastrite mund të pasqyrohej më mirë prej një shkrimtareve, që vërente me vëmendje e me këmbëngulje sjelljen e saj të përditshme, Musine Kokalari i ndërtonte tregimet e saj mbi një ngjarje të rëndomtë që nuk ishte veçse një shkas për dialogun dhe më rrallë monologun, të cilët ajo i sillte si të regjistruar, pa i shoqëruar thujtë fare me shpjegime autoriale”.(5)

Udhën e mbarë pastë

Në rrëfimin e vjehrrës ndaj të resë së saj luhet akti i parë i dramës së dhimbshme të mërgimit; ai i përcjelljes së kurbetçiuat një natë para nisjes. Tendosjen e nënës nga ikja e djalit, të nuses nga vetmia e burrit, të fëmijëve nga mungesa e prindit e fashit ceremoniali i përcjelljes në odën e madhe: sjellja e llokumeve nga gratë vizitore, sofrat e mbushura plot lloje gjellësh, vallet e gëzueshme të vajzave, këngët prekëse të nuseve... Trokitja në të gdhirë e qiraxhiut në portë ndërpret çdo tingull muzike. Por mes përqaimit të fundit me nënën, gruan, djemtë s’ ndalet dot kënga popullore:

*“U nis Serveti për udhë
Udh’e tij margaritar, udh’e tij margaritar
Tek të shkeli këmb’e kalit
U-bëftë flori e ar, u-bëftë flori e ar”*.

Sapo kali zhduket pas kodrës me diell, hidhërimi i fshehur gjer në atë çast kthehet në lot e në vaj. Musine Kokalari është mjeshtre në dhënien e luhatjeve kontrastuese të zemrës femërore. Studiuesi Sabri Hamiti shprehet kështu:

“*“Muza shqiptare”, siç u paraqit në fillim me pseudonim, krijon një tip tregimi të veçantë, ku zotëron rrëfimi popullor dhe një ndjeshmëri për ambientin e një emocion i krahasueshëm me emocionin poetik”*. (6)

Kulloi odaja

Përmes të folurit të gjallë mes plakës që s’del dot nga shtëpia me vajzën e sapokthyer nga një ceremoni varrimi fiksohet një pjesë tipike e antropologjisë kulturore femërore: vajtimet mortore. Vdekja e vëllait të vetëm ndër gjashtë motra e tejkalon çdo mbajtje zi. Nëna e tij e qan me zë tri herë duke i thënë fjalët me radhë dhe gratë e farefisit ia shoqërojnë këngën e trishtuar. Nga lotët e nga vaji i përzishëm kullojnë muret e odës. Kjo hiperbolë e goditur e Musine Kokalarit i afrohet realitetit përmes imazhit të fuqishëm artistik që krijon:

*“Ç’u-këput ili nga hëna,
Djali seç u-nda nga nëna...
Ç’u-këput ili e rà,
Mbeti babai pa kra...
Hamdidashi me kumborë,
Të zgjodhi Zoti me dorë...”*

Shkrimtarja e talentuar dhimbjen e nënës nga njerëzore, tokësore e bën hyjnore, kozmike. Kumbimin e vargjeve folk ajo e shkrin me ritmin e prozës poetike. Për të gjitha këto albanologu italian profesor Carlo Tagliavini e motivon:

“Mua si linguist më intereson në mënyrë të veçantë përmbajtja dhe forma e veçantë që paraqet libri në gjuhën popullore të dialektit gjirokastrit. Mund t’ju them se ju jeni bërë prej kohësh një zë i veçantë në letërsi.” (7)

Një qen që hamulit nuk ha

Prozatorja origjinale Musine Kokalari në këtë skicë ka arritur të krijojë rrethin vicioz të bisedave boshe përmes gojës së fjalamaneve. Vizita e plakës Xhevro te shoqja e femënisë Razo bëhet vetëm për të vrarë kohën. Pyetjet e saj me ngjyresa femërore, për again (burrin), djalin, vajzën, nusen, fëmijët, motrën dhe nipin mbyllen me hatërmbetjet pa shkak nga Nazua, një tjetër muhabetçare si ato. Pasi kryejnë edhe bisedat mbi sëmundjet e të afërmeve, dy fjalëshumtat ia zënë derën për kryeshëndosh shtëpisë së xha Ivziut, jo më me llafe për të gjallët, po për meitët. E përditshmja e tipizuar. Kjo është arsyeja që albanologu austriak Maximilian Lambertz e çmoi përmbledhjen “*Siç më thotë nënua plakë*” si letërsi dhe veçanërisht për gjuhën e saj. (8)

Mos qofshin vjehrrat e zeza

Motivi i këtij tregimi është përgjithësues. Nusja e repret ardhjen e motrës së martuar për t’iu ankuar për vjehrrën plakë. Grindjet seriale, moskuptimet e vazhdueshme, fjalët e hedhura pa pushim kundër njëra – tjetrës, krijojnë acarimin nuse - vjehërr, të pazbutur dot as nga vjehërrin, as nga djali. Plaka gjen zgjidhje me ikjen për pak kohë tek shtëpia e vajzës. Ndërsa nusja e zemëruar mburr veten “... një këmbë te djepi, një këmbë te puna”, viktimizon vjehërrin “... pse më prishi gjakun pse më bëri gjismë njeri?” dhe proteston ndaj normave tabu “... këto mure nuk më mbajnë brenda”. Albanologu profesor Angelo Leotti, në letrën nga Bolonja të 27 korrikut 1940, e vlerësoi zonjushën Musine Kokalari me entuziazëm të lartë:

“*Kam lexuar e rilexuar librin tuaj të mrekullueshëm “Siç më thotë nënua plakë”. Është shkruar shumë mirë dhe unë ju përgëzoj me gjithë zemër.*”
(9)

Ulurima e qenit

Një kronikë e zezë, ku bestytnia bëhet realitet. Lehja e qenit tërë natën, shenjë e moçme se dikush do të ikë nga kjo botë, shqetëson gjithë mëngjesin teto Hasifen dhe sidomos teto Nafisen, mbasi të afërmit i ka larg: “*As në derën e hasmit mos të dëgjoj të ligën*”. Në drekë parandjenja fatkeqe kthehet në lajm: djali i xha Hasanit po jep shpirt. Në darkë kobi përhapet me ulurimën tashmë të familjarëve. Menjëherë dy fqinjët nisen në ksojll për të ndenjtur atje gjer në mëngjes, kur: “*Erdhën njerëzija si miz’ e lisit. Në mes të kujove muarnë xhenazenë*”. Kështu jeta e vështirë e grave bëhet edhe më e rëndë nga pllakosja e vdekjes, me ritet e ngurta të saj. Ndaj autorja e sintetizoi librin e saj të parë:

“... pasqyrë e një bote të perënduar, shtegu i kapërcimit nga vajzëria midis këngëve, një nusëri për ta hedhur gruan prapë në vargonjtë e rëndë të robërisë e të fanatizmit.” (10)

Mbyllje

Në vitin 1944, kur autorja nxori në dritë dy librat e tjerë: “Sa u tunt jeta” dhe “Reth vatrës”, kulturologu Mitrush Kuteli vuri në dukje tek një revistë artistike në Tiranë:

“*Musine Kokalari afirmohet vendimtarisht në vijën e mirë të letërsisë shqipe, jo si relativitet femëror, si mund ta shohë dikush, por si vlerë absolute*”.(11)

Më 1984, të përjashtuarës nga sistemi i letrave shqipe i doli nga shtypi në Livonia, Miçigan, SHBA, përmbledhja më e suksesshme: “*Siç më thotë nënua plakë*”.

Në vitin 1995, shkrimtarja Eglantina Mandia nxori në qarkullim në kryeqytet rrëfimin letrar “Sonata e hënës”, kushtuar personalitetit të Musine Kokalarit.

Më 2004, në Prishtinë, prozatores së spikatur iu ribotuan të tri librat artistikë tek përmbledhja “Vepra”.

Në vitin 2009, në Tiranë, asaj iu publikuan në dy vëllime, krijimtaria e njohur dhe dorëshkrimet e çmuara.

Bota femërore e Kokalarit vazhdon rrotullimin ...

REFERENCA:

1. Ali Asllani. Hako Halla. Poemë. Tiranë, 1999, f. 72.
2. Lasgush Poradeci. “Siç më thotë nënua plakë”. Gaz. “Bota e re”. Tiranë, nr. 1, 30 korrik 1940, f. 6.
3. Çajupi. “Fshati im”. Baba Tomori. Tiranë, 1997, f. 48.
4. Dalan Shaplllo. “Vrojtuese e thellë e jetës”. Musine Kokalari. Vepra. Prishtinë, 2004, f. 8.
5. Ali Xhiku: *Letërsia shqipe si polifoni*. Tiranë, 2004, f. 253.
6. Sabri Hamiti. Vepra letrare 8. Letërsia moderne. Prishtinë, 2002, f. 726.
7. Novruz Xh. Shehu. “Parathënie”. Musine Kokalari. Vepra. Vëllimi i parë. Tiranë, 2009, f. 50.
8. Dalan Shaplllo. Idem, f. 10.
9. Novruz Xh. Shehu. Idem, f. 49.
10. Robert Elsie. *Histori e letërsisë shqiptare*. Tiranë – Pejë, 1997, f. 348.
11. M. K. (Akronim i Mitrush Kutelit). “Gjashtë muaj letërsi”. Rev. “Revista letrare”. Tiranë, nr. 11, 15 korrik 1944, f. 2.

Women’s World in Kokalari’s Work**ABSTRACT**

Musine Kokalari (Adana, 1917- Rrëshen 1983) was the first woman in the history of the Albanian literature who published an artistic work. Her Work “As my Grandmother told me”, published in Tirana in 1939, testifies to the emergence of the Albanian gender writings accomplished by a twenty two year old woman.

Her style and way of expression are particularly different from those of the other well-known authors of 1930-ies. She offers a new penetrating modality, a womanly perspective that is very different from a man’s point of view. Her work echoes her grandmother’s polyphonic voice which comes off the thin female cords of a middle aged woman, a mother, a bride, a gjirokastra woman.

The authoress does not portray men, but men’s silhouettes appear in the background as events take place. Their orders are never in direct speech; they are voiced by women, whose obedience depicts men’s imposing position.

The authoress gallery of original female characters took the readers by surprise and attracted the attention of the literary critics of the first half of the XX-th century, such as Filip Fishta, Vangjel Koça, Petro Marko, Andrea Varfi and Nexhat Hakiu.

Alma HAFIZI

DIMENSIONI HISTORIK DHE KULTUROR I NOCIONIT TË BIBLIOTEKËS BIBLIOTEKA E FINZI-KONTINËVE

1. Hyrje

Viti 2016 u shpall viti basanian pasi përkonte me njëqind vjetorin e lindjes së shkrimtarit të famshëm italian Xhorxho Basani⁸⁹. Personaliteti shumëdimensional i tij si shkrimtar, publicist, skenograf, profesor

⁸⁹ Romancier, poet, publicist. Bashkëpunëtor i të përditshmeve dhe revistave (*Letteratura, Il Mondo, Lo spettatore italiano*), nga 1953 deri më 1971, redaktor i revistës fiorentine *Paragone*; nga 1958 deri më 1963 ka drejtuar *Biblioteca di letteratura* të shtëpisë botuese Feltrinelli, ku pa dritën e botimit, ndër të tjera, *Il Gattopardo* e G. Tomasi di Lampedusa. Ka qenë zëvendës-president i RAI (1964-66) dhe president i shoqatës *Italia nostra* (1966-80).

Gjithnjë i nxitur nga interesa historike e psikologjike dhe duke vepruar në dy plane paralele – social dhe individual – Basani ka shkruar romanet *Gli occhiali d'oro* (1958) dhe *Il giardino dei Finzi-Contini* (çmimi Viareggio 1962), përshkrim origjinal i qytetit të Ferrarës dhe njëherësh i komunitetit hebraik gjatë fashizmit. Pasant romanet *Dietro la porta* (1964) e *L'airone* (1968), si edhe përmbledhja me tregime *L'odore del fieno* (1972), në të cilët detajohen motivet që qëndrojnë në themel të veprës basaniane: kujtesa, vetmia, tepër e theksuar nga armiqësia e një shoqërie të mbyllur ndaj kujtudo që shfaqet ndryshe, qoftë ai hebraik apo homoseksual, rezistencë fundja, por edhe nyja e koklavitur mes jetës dhe vdekjes, mes realitetit dhe iluzionit. Me kalimin e viteve, jo pa një punë të gjatë artistike, Basani ka ripunuar pa reshtur veprat e tij me qëllim “transferimin e prozës nga plani interpretues lirik i realitetit në atë instinktiv të realizmit të përditshëm” (Baldelli 1974). Pasi kishte rikonceptuar *Cinque storie ferraresi* me titullin *Il romanzo di Ferrara, Dentro le mura* (1973), Basani ka unifikuar tërë veprën e tij, thellësisht të reformuar në stil, në vëllimin *Il romanzo di Ferrara* (1980), e botuar pjesërisht në 1974.

Temat dhe motivet e narrativës së tij lëvrohen edhe vëllimet lirike: *L'alba ai vetri* (1963), ku janë përfshirë vëllimet e mëparshme *Epitaffio* (1974); *In gran segreto* (1978); vëllimin e plotë *In rima e senza* (1982), që zbulon tërë rrugëtimin poetik të autorit. Ka publikuar gjithashtu edhe vëllimet publicistike *Le parole preparate* (1966) e *Di là dal cuore* (1984). Nga romanet dhe tregimet e tij janë realizuar filma të ndryshëm. E tërë prodhimtaria e tij narrative, publicistike dhe poetike është përmbledhur në vëllimin *Opere* (e kuruar nga R. Cotroneo, 1998), në indeksin e të cilit përfshihet *Una città di pianura*, libri i parë i botuar (me pseudonimin Giacomo Marchi, 1940), dhe edicioni i parë i *Cinque storie ferraresi*.

universitar, një ndër themeluesit kryesorë të fondacionit “Italia Nostra”⁹⁰, ka bërë së bashku, pa asnjë komandë apo urdhër, institucionet shtetërore, qendrat studimore dhe të kulturës, universitetet anembanë botës, në një seri veprimtarish dhe ngjarjesh, si konferenca shkencore, ekspozita fotografike, si dhe në dhurimin e dorëshkrimit të kryeveprës së tij, apo në shpalljen e çmimit letrar Basani. E përfshirë nga atmosfera *in memoriam* e jetës dhe veprës së Basanit, mendova të sjell një kontribut modest për të rifreskuar dhe rindërtuar veprimtarinë intelektuale dhe kulturore të këtij shkrimtari për ata që e njohin, apo për të zbuluar dhe afruar këtë personalitet të kulturës italiane me lexuesin shqiptar që pak e njeh. Mbase Basani dinte pak, ose aspak, për Shqipërinë, por mes tyre ka një pikë të dallueshme takimi, ndjeshmëria ndaj çështjes së komunitetit izraelit, zëdhënese e së cilës është çdo vepër e tij. Xhorxho Basani, pasardhës i një tradite letrare, e njohur si “dhimbja e jetës”, përfaqësues dinjitoz i së cilës ishte poeti i madh italian Eugenio Montale, nuk mund të qëndrojë larg poetikës që mbizotëron gjysmën e parë të shekullit të kaluar, e përqendruar tek vlerat universale të ekzistencës.

I konsideruar si shkrimtari me numrin më të madh të referencave letrare, do të përpiqem të sjell në këtë punim bibliotekën e Basanit, reale apo imagjinare, dhe bibliotekat letrare që përmes tij risillen në kujtesë. Ata ngjajnë me hapësira të vogla, mikrokozmos, ku personazhet mundet të pushojnë apo të lexojnë, ndërsa rrëfimtari i tregon lexuesit këndvështrimin e autorit mbi kulturën. Për të mos e shpërqendruar vizitën nëpër sitin bibliotekar që krijon leximi i veprës së Basanit, çdo informacion që lidhet me biblioteka të veçanta është vënë në fund të këtij punimi.

2. *Kopshti i Finci – Kontinëve*

Vdekja, përherë e pranishme, ankthi i katastrofave të mundshme, mosbesimi në të ardhmen, përbëjnë fillin pesimist që vendos në një emërues të përbashkët njerëzit, ngjarjet, në të kaluarën e protagonistit, në të njëjtën kohë edhe *uni*-n rrëfimtari në romanin *Kopshti i Finci – Kontinëve*.⁹¹

⁹⁰ Shoqata për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, artistike dhe natyrore të Italisë, e themeluar me iniciativën e një grupi intelektualësh italianë në vitin 1955, në Romë, një ndër presidentët e së cilës ishte edhe Basani, që në 1965 do të shkruante: “Të ngrihet edhe më lart energjia dhe pasioni i *Italia Nostra*, elementë që i kanë dhënë nervin shpirtit të protestës që ende sot e dallon”. (Giorgio Bassani, *Bollettino di Italia Nostra* n. 45, 1965, fq.3-6).

⁹¹ Bassani, Giorgio, *Il giardino dei Finzi-Contini*, Mondadori, 1980, përkthyer në shqip; *Kopshti i Finci-Kontinëve*, Botimet IDK, 2015.

Romani tregon historinë e një familje të pasur hebraike ferrareze, e përfshirë dhe e zhdukur në ngjarjet tragjike që shkaktuan ligjet raciale në Italinë fashiste, pa u përqendruar tek deportimet apo kampet shfarosëse të hebrenjve si histori më vete. Përjetimi që provon lexuesi i kësaj historie është ai i një ngjarjeje realisht të jetuar, sepse, pranë Finci-Kontinëve, një vend të dukshëm zë rrëfimtari, me të cilët ndan prejardhjen e njëjtë hebraike, protagonist pa emër, pas të cilit është lehtësisht e kuptueshme se qëndron vetë autori, disa episode të jetës së tij.

Pika nxitëse për këtë kthim në të shkuarën është një vizitë në Nekropolin antik në qytezën e Cerveterit, që për nga ngjashmëria kthen në kujtesë varrezën izraelite të Ferrarës, ku bie në sy varri monumental, me shije të përziera mes antikitetit dhe Lindjes, i familjes Finzi-Kontini. Edhe pse në dukje ngjan sikur romani i kushtohet një historie familjare, në brendësi, mes rreshtave të tij, vërehet se ka diçka më shumë. Është historia e dashurisë mes Mikolës dhe rrëfimtari, historia e një komuniteti të tërë e parë nga këndvështrime të ndryshme dhe e vendosur në një larmi rrethanash, falë një stili gërshetimi mes ngjarjeve private dhe atyre publike, falë përzgjedhjes së personazheve, që edhe pse i përkasin botës hebraike borgjeze, kanë një veçori ndryshe, janë të prirur të pëlqejnë vetminë. Nuk dihet saktësisht se për çfarë arsyeje Finci-Kontinët jetojnë në një shtëpi aq të madhe, të rrethuar me një kopsht të stërmadh, nuk shoqërohen me të tjerët, nuk presin vizita, nuk i dërgojnë fëmijët në shkollë, veçse për provimet e fundvitit dhe në sinagogë qëndrojnë të veçuar. Madje në një periudhë të vështirë për komunitetin izraelit të Ferrarës, familja restauron sinagogën e vogël antike spanjolle për përdorimin e tyre familjar ose të ndonjë të interesuari tjetër. Diçka e tillë askujt s'do t'i shkonte në mendje, sidomos izraelitëve, zëdhënës i të cilëve është babai i rrëfimtari, në optikën e të cilit, ajo që duhej të shqetësonte tërë komunitetin izraelit në ato momente ishte vëllazërimi, lidhja, origjina e tyre.

Afërsinë me komunitetin, Finci-Kontinët fillojnë ta ndiejnë kur, si pasojë e ligjeve raciale, hebrenjtë janë të ndaluar të frekuentojnë vendet dhe institucionet publike. Është pikërisht momenti kur Alberto Finzi-Kontini, në emër edhe të motrës, telefonon të gjithë miqtë, duke i ftuar të luanin të

Botohet për herë të parë nga Einaudi, me 1962, vit në të cilin fiton çmimin "Viareggio". Që në botimin e parë pati sukses të jashtëzakonshëm dhe u përkthye në disa gjuhë të botës. Pak vite më vonë, regjisori Vittorio de Sica, realizoi prej tij filmin me të njëjtin titull, që u mohua nga Basani me pretendimet se kishte tradhtuar atmosferën e romanit dhe kishte ndryshuar karakterin e disa personazheve, veçanërisht të Mikolës. Filmi fitoi çmimin Oscar, si filmi më i mirë i huaj.

gjithë së bashku në fushën e tyre të tenisit, kur ata fillojnë të kryejnë ritet fetare në sinagogën italiane, pasi siç shprehej Mikola “*tashmë ndodhemi të gjithë në të njëjtën barkë*”.

Mikola karakterizohet nga logjika e kthjellët, nga vlerësimi objektiv, falë të cilit mohon dashurinë, pasi në atë pak jetë që i ka mbetur për ta jetuar nuk ka vend për dashurinë, veçse për të kujtuar të shkuarën që mbush boshllëkun e të tashmes e sidomos të së ardhmes. Basani ka ndërtuar me mjeshtëri mënyrën sesi ajo e injoron të ardhmen, duke pritur në heshtje fundin e pashmangshëm, pasi është e para që e ka nuhatuar tragjedinë, ndërsa të tjerët as nuk e mendonin. Për këtë arsye libri nuk është thjesht një roman *fin de siècle* i borgjezisë hebraike, por një kritikë ndaj vetë hebraizmit “*i mbarsur me qytetërim dhe kulturë, që lëshohej pa kurrfarë rezistence në krahët e fatit të tij*”⁹².

Pavarësisë së Mikolës i qëndron në polin antipod Alberto, figura e të cilit merr dritë nga e motra apo Malanate, kimist lombard, me ide komuniste, i transferuar në Ferrarë, dhe të cilin e adhuron, megjithëse për lexuesin është një personazh pak bindës. Portreti i Albertos është projeksion kundër dritës, i destinuar të errësohet, derisa të zhduket tërësisht, për shkak të sëmundjes së pashërueshme që i merr jetën para se të ndodhë tragjedia kolektive.

Tablloja plotësohet me të tjerë anëtarë të familjes, që si hije përshkojnë skenën, teksa i drejtohen fatit mizor; zonja Ollga, gjithnjë e veshur me të zeza, për shkak të humbjes së djalit Guido në moshë të re, zoti Ermano, i kënduar, i rafinuar, i dashur, bujar, studiues i vërtetë, por që jeton jashtë realitetit, i zhytur në studimet letrare të viteve Gjashtëqind dhe i magjepsur nga një poeteshë hebraike e asaj kohe që tashmë askush nuk e njeh veç tij.

Basani me këtë roman vihet në gjurmët e Prustit, të veprës së tij (*Në kërkim të kohës së humbur*), ku autori, nën petkun e rrëfimitarit, krijon ndjesinë e të treguarit të ditëve të jetës së tij, por të përfshira në një histori më të përgjithshme, duke ndërtuar një përvojë jetësore tjetër, që nuk është e tija.

3. Biblioteka, vend i mbyllur.

Procesi i maturimit të protagonistit ndjek një trajektore në ngjitje që piketohet nga një seri *vendesh të mbyllura*⁹³ dhe mbarset me dialogje që

⁹² Lungu, Gabriella, *Le invalidabili distanze. La narrativa di Giorgio Bassani*, Casa Cărtii de Știință, 2007, fq. 69.

⁹³ SCHNEIDER, Marilyn, *Dimensioni mitiche di Micòl Finzi-Contini*, në BON, Adriano,

pasojnë njëri - tjetrin. *Vend i mbyllur* është oborri i mrekullueshëm, i paanë i Finci-Kontinëve, që hap dyert për të gjithë ato bashkëqytetarë të diskriminuar përditë e më shumë nga regjimi fashist, nga ligjet raciale. *Vende të mbyllura, Hütte*, shtëpiza në fund të oborrit, dhoma e Albertos, ajo e Mikolës. Janë pikërisht këto vende, ku i riu protagonist përfshihet në biseda që, edhe pse nuk krijojnë gjithnjë afërsi mes bashkëbiseduesve, bëhen burim simpatie, në kuptimin e vërtetë të fjalës, në ndjeshmërinë reciproke ndaj vuajtjeve dhe dhimbjeve shpirtërore të tjetrit. Nga të gjitha raportet njerëzore që krijon protagonist, ai me Mikolën zë një vend të dukshëm në roman, është i tëri i zotëruar nga parandjenja e një tragjedie. Është metaforë e përvojës dyfishe në kërkim të së vërtetës dhe të së bukurës, që të dyja thelbësore për ekzistencën e njeriut dhe mbrojtjen e tij, dhe gjejnë një pikë takimi të përshtatshme vetëm në varr. Mjafton të sillen në vëmendje mendimet që shprehin në letërkëmbimet e tyre ai dhe Mikola, lidhur me poezinë e Emili Dikinson, *Për bukurinë vdiq (I died for beauty)*⁹⁴, që Mikol e kishte përkthyer në italisht gjatë studimeve të ndjekura në Venecie, e që ngjan, as më pak e as më tepër, me një dialog të vdekurish.

I fundmi *vend i mbyllur*, por jo më pak i rëndësishëm në kontekstin kulturor e psikologjik të romanit, ku përvijohen dialogje të tjera, ku vendi dhe dialogjet favorizojnë mbështetjen e skenave basaniane mbi një tematikë tradicionale, ku vështrimi analitik mund të rrokë rrafshin krahasues, është biblioteka private e Vilës Finci-Kontini. Është vendi më i goditur i bashkëbisedimeve mes profesor Ermanos dhe protagonistit, student doktorant në Letërsi, i përjashtuar nga Biblioteka Publike për shkak të ligjeve raciale. Kjo e fundit nga një vend publik kthehet në vend jopublik, në mollë të ndaluar për një kategori personash, teksa ndodh e kundërta me bibliotekën e Vilës Finci-Kontini. Ajo merr tiparet e një *vendi*, i mbyllur dhe i hapur njëherësh për një shtresë sociale të caktuar, që kurse dominohet nga një klimë besimi mes dy bashkëbiseduesve, e lindur më herët në fushën e tenisit, kur profesori e kishte ftuar studentin, ish-nxënës të tij, në biseda

Come leggere Il giardino dei Finzi-Contini di Giorgio Bassani, Milano, Mursia, 1979, fq.344.

⁹⁴ *Kopshti i Finci-Kontinëve*, vep.cit., fq.158, përkthyer nga Arben Dedja.

Për bukurinë vdiq/ por ç'u ndreqa mu në varr,/ një që vdiq për të vërtetën/ dergjet në odën aty pranë.

Më pëshpëriti pse u treta?/ I thashë "për bukurinë"/ "Unë për të vërtetën"- një gjë janë;/ Jemi, vëllamë, ma kthen.

Dhe, si të afërm natës tokur,/ folëm odash përmes,/ gjersa bari na i ceku buzët,/ dhe emrat tanë mveshi.

me interes të përbashkët.⁹⁵ Në bibliotekë protagonisti penetron në botën kulturore dhe familjare të Ermanos, gati kemi të bëjmë me një lloj adoptimi intelektual, pavarësisht ecurisë që ka raporti i tij me Mikolën.

4. Nocioni i bibliotekës në letërsi

Biblioteka zgjeron këndin analitik dhe hap një dimension krahasues të subjektit. Bibliotekën, si koncept të vendit ku bëhen kërkime individuale, ku pllakos heshtja, por edhe vend të bisedave tërheqëse, e gjejmë më parë dhe më vonë letërsisë basaniane. Biblioteka (apo libraria), si vend me dimensione historike, oazë paqeje, tempull leximi, shkëmbimi idesh mes intelektualëve apo miqve, shfaqet që herët si *topos* në traditën letrare. Kujtojmë bibliotekën si *elementin kyç* në tekstet letrare *Të fejuarit*, i Aleksandër Manxonit, *I ndjeri Matia Paskal*, *Të moshuar dhe të rinj*, të Luixhi Pirandelos, *Tre kryqet*, i Ipolito Nievos, *Baroni i Nikastro* i Federiko Tocit. Nuk është vështirë të kuptohet se sa familjare ishte një studio e vogël për Nievon ose një bibliotekë për Pirandelon, duke mbajtur parasysh faktin se disa nga bibliotekat në tekstet letrare në fjalë kanë në gjenezë të tyre realitetin, siç është rasti i bibliotekës Lukeziana në *I ndjeri Matia Paskal* dhe *Të moshuar dhe të rinj*. Matia Paskal është punonjësi i përkushtuar i bibliotekës, ku vetë autori ka kontribuar, ndërsa Vinçente de Vinçentis kishte dërrmuar veten me studime të tepruara, ashtu sikundër Pirandelo sfilitej të shkruante për periodikët letrarë nga nevoja për t'i

⁹⁵ Bassani, Giorgio, *Il giardino dei Finzi - Contini*, vep.cit., fq.78-82, *Kopshti i Finci-Kontinëve*, vep.cit., fq. 101-106.

Pasi përshëndeten me babain e Mikolës, protagonistin i ftuar në bisedë nga ai, teksa ecin krah njëri - tjetrit përbri fushës së tenisit, ndjen për herë të parë afërsi me ish-mësuesin, megjithëse e sforcuar. Ndërsa Ermano interesohej për familjen e tij, duke treguar respekt dhe sinqeritet, si për të dhënë sinjale të një ngushtimi distance mes dy bashkëbiseduesve, nga ana tjetër shfaqte vështirësi të zhvendoste bisedën në regjistër informal. Komunikimi papritmas i ngrohtë është i destinuar të mos zgjasë për shumë kohë për shkaqe që lindin jashtë raportit të tyre. Kambanë alarmi e jetëshkurtësisë është argumenti i diskutimit mes profesorit dhe ish-nxënësit, varreza hebraike ferrareze dhe dëshira për t'i dhënë asaj dinjitetin e San Nikolosë në Venecia, sipas profesorit monument kombëtar, vend i kujtesës historike dhe letrare. Si interes dytësor shfaqet ai i profesorit për temën e diplomës së protagonistit, si metaforë e së ardhmes. Përqendrimi i tij tek shkrimtari i kohës Pancaki, metaforë e të tashmes, e dëshirës për jetë, shkon në drejtim të kundërt me sugjerimin e profesorit për letërsinë e traditës, madje orientimin drejt të shkuarës e përforcon me rrëfimin e një sekretit, sipas të cilit ai dispononte 15 letra të shkruara nga vetë mjeshtri i poezisë Karduçi, drejtuar nënës së ndjerë të profesorit. Biseda është e gjitha e fokusuar në personazhe pa jetë, koncepti i vdekjes është udhërrëfyesi i saj.

mbijetuar dramës familjare që i shkaktonte sëmundja mendore e bashkëshortes. Ndodh që nga një lajm gazete të marrë udhë një roman i tërë (*I ndjeri Matia Paskal, Tre kryqet*) dhe në një mjedis librash të shtjellohet i gjithë subjekti. Bibliotekat e fantazisë kanë në themel të tyre imazhe të përvojës, të ruajtura në kujtesën e lexuesit, studiuesit, shkrimtarit, intelektualit, që shndërrojnë ngjarjet apo situatat e përjetuara në letërsi.

Sesa rëndësi merr biblioteka për një shkrimtar të dhënë pas librave, e dëshmojnë tekstet autobiografike, si *Fjalët* e Sartrit, nga ku autori shpalos një e nga një kujtimet e fëmijërisë.⁹⁶

Lala Romana, gjithashtu, kujton përvojat e saj si intelektuale e re. Biblioteka është eksperiencia që ndërtojnë së bashku autorët dhe lexuesit. Në romanin *Një rini e imagjinuar*⁹⁷, një numër bibliotekash, reale dhe imagjinare si, universiteti, Shoqata kulturore, bibliotekat, teatrot, atelietë, ekspozitat, udhëtimet drejt Parisit, pensioni për studentët, shoqërojnë formimin intelektual të protagonistes. Nëse nuk konsiderohet si *topos* letrar, padyshim që është e pranishme si *arketip* në memorien kolektive.

Lidhja mes romaneve ku shfaqet imazhi i bibliotekës dëshmon se ajo është shprehje e kulturës dhe e stilit të jetës intelektuale. Ajo mund të funksionojë si temë më vete apo si pjesë përbërëse e një makroteme. Edhe nëse shfaqet në hapësira periferike të teksteve narrative (*Një jetë* e Svevos, *Një botë letrash* e Pirandelos, *Mrekullia* e Tocit), biblioteka është elementi që plotëson portretin e personazhit. Por, jo rallë herë është vendi i bisedave të këndshme në kohë historike dhe ideologjike të vështira, (*Revolta e engjëjve*⁹⁸ e Anatol France, *Sosii fratres bibliopolae*⁹⁹ i Paskolit, *Fosfori*¹⁰⁰ i

⁹⁶ Sartre, J-P, *Les Mots*, Paris, Gallimard, 1964, fq.41.

⁹⁷ Romano, Lalla, *Una giovinezza inventata*, Mondadori, Milano, 1992.

Është roman formimi, me protagoniste një vajzë borgjeze, autore, shkrimtare, e rrëmbyer nga pasioni përvëlues për të bukurën dhe të vërtetën, të konceptuara si një e tërë. Mjediset që ajo frekuenton kanë shëmbëlltyrën e bibliotekave. Flinte në një dhomë të zymtë që ndriçohet nga baxha në një qoshkë të tavanit, në muret e së cilës deri në gjysmë lartësie mbështeteshin grumbuj librash, korridori i shtëpisë ishte i mbushur me ekstrakte e revista, në sallën e ngrënies raftet prej xhami, në vend të serviseve të ngrënies, mbanin libra të vëllimshëm, fjalorë e enciklopedi, studioja e profesorit ishte e gjitha një turrnajë librash, fashikujsh, mbi karrige, mbi dysheme. Ngado dhoma të errësuar nga raftet e librave, biblioteka e fakultetit, një salon që ndriçohet nga dritare të larta, Biblioteka Mbretërore, një sallë shumë e gjatë dhe e lartë, me dritare të larta vetëm nga njëra anë dhe e tëra e mbuluar me rafte të rënduar nga pesha e librave.

⁹⁸ France, Anatole, *La rivolta degli angeli*, përkthim në italisht nga L.De Mauri, Meridiano Zero, 2009.

Në prag të Luftës së Parë Botërore, Anatol France vendosi të frenojë, së paku “*në perimetrin e letrës, idiotësinë ushtarake dhe nacionaliste, të përfshijë përmes shkrimit të tij rregullin e plotë universal të gjërave*”. E tërë forca centripete e romanit sillet rreth

Primo Levit), ku ajo merr dimension politik dhe historik, i rrëfimeve, i miqësive (*Për dashurinë dhe demonët e tjerë*¹⁰¹ të Gabriel Garcia Markezit *Dyer të hapura*¹⁰² i Leonardo Shashës), por edhe i simpatie, nëse kemi parasysh se në librari dashurohet edhe çifti i lexuesve të Kalvinos në romanin *Nëse një natë dimri një udhëtar...*

5. Në bibliotekën Finzi-Kontini

“*Fashizmi dukej se po shkonte larg*”; është ky konstatim që na sjell në bibliotekën e vilës Finzi-Kontini. Simpatia mes profesorit dhe studentit diplomant nxjerr në dukje dinamizmin e gjesteve dhe të lëvizjeve, pothuajse një lloj koreografie që, duke i vënë në veprim ose jo dy protagonistët, prodhon dialogje.

Librat e bibliotekës janë të sistemuar në dy salla; në sallën e madhe, të ngrohtë dhe të qetë, Xhorxho gjen kushtet e përsosura për të realizuar tezën e diplomës mbi Pancakin. Profesori vjen hera - herës ta shikojë, vetëm për pak minuta pa dashur t'i shkaktojë bezdisje.

bibliotekës Esparvieu të Parisit, ku ndeshen dy ushtritë, ajo e engjëjve të Zotit dhe e rebelëve të Djallit.

⁹⁹ Ortiz, V., “I sosii fratres bibliopolae”, në *I poemetti latini del Pascoli*, tipografia Cimatura, Napoli 1919, fq. 38-47.

Në *taberna libraia*, dyqanin e vogël të librave, vëllezrit Sosii takojnë poetin antik Horacin dhe shokun e tij të luftës Popeo Varon, me të cilët, ndërsa kujtojnë ditën e vështirë të “betejës së llahtarshme të Filipit”, i kaplon një dëshirë paqeje.

¹⁰⁰ Levi, P., “Fosforo”, në *Il Sistema periodico*, Einaudi, 1975.

Biblioteka shfaqet si streha e një jete të fshehtë dhe misterioze, metaforë e regjimit fashist.

¹⁰¹ Marquez, G. Garcia, *Dell'amore e di altri demoni*, përkthyer në italisht nga Giovanna Granato, Mondadori, 1987.

Prifti i ri Delaura, i dashuruar me “shtrigën” dymbëdhjetë vjeçare, për dënimin e së cilës ishte ngarkuar nga inkuizicioni, gjen ngushëllim në bibliotekën e Abrenuncios, mjekut me origjinë hebraike, i ikur nga Madridi. Ata i bashkon interesi për Volterin dhe autorë të tjerë të ndaluar, në Kartagjenën e viteve Shtatëqind.

¹⁰² Sciascia, L., *Porte aperte*, Adelphi edizioni, 1987.

Sipas Shashës, përndjekja është bashkudhëtare e çdo ideologjie. Romani i vendos ngjarjet rreth viteve 1930. Mes dy protagonistëve, kundërshtarë të regjimit fashist, lind një lloj simpatie, në bibliotekën e avokatit:

... mundohen që të dy që të mos flasin për procesin. Flasin për luftën, pikërisht për kujtimet e tyre. Pastaj për librat, në mjedisin e bibliotekës; është e madhe, e lezetshme, e ngrohtë ngase rrethohet me raftë dhe tepër e hijshme [fq.94] Vazhdojnë të flasin lehtë, me zell, për Francën, për disa shkrimtarë, për disa libra. Dhe për fashizmin. Por, duke folur për të në atë mënyrë, fashizmi dukej se shkonte larg, si të ishte shënuar në një hartë imagjinare të budallallekut njerëzor... [fq.100]

[...]Më vështronte me ca sy flakërues, të shndritshëm; a thua se nga unë, nga e ardhmja ime letrare, pritej kushedi çfarë, a thua se i kishte varur tek mua shpresat për ndonjë ambicjen e tij të fshehtë që ishte jo vetëm mbi të, por edhe mbi vetë mua.. [K.fq.182].

Ndërsa salla tjetër është ajo personale e profesorit, “një dhomë pak më e vogël se salloni i bilardos, por e zvogëluar, madje e ngushtuar nga një mori gjërash të llojllojshme” [K.fq.183]. Orendi nga më të ndryshmet, libra, por edhe mjete mjekësore, muzikore e të tjera, që i jepnin pamjen e një “dhome pune faustiane”.

[...]me libra, sa për t’ia nisur,[...]kishte nga ata artistikë të përzierë me librat shkencore[.]libra që kishin të bënin me historinë e Italisë,[.]ata për “lashtësinë judaike”, [...]Një hartë e madhe e botës, mandej një pult leximi, një mikroskop, një gjysmë duzinë barometrash, një kasafortë çeliku, [...]një shtrat i vogël i bardhë borë si ato të një ambulatori, klepsidra të shumëllojshme të madhësive të ndryshme, një daulle tunxhi, një piano e vogël e drejtë gjermane mbi të cilën qenë vendosur dy metronomë të mbyllur në kutitë e tyre në formë piramide.. [K.fq.183].

Një enciklopedi, në pamje të parë kaotike, por mbase në harmoni me *enciklopedinë botanike* të kopshtit, hapësirë më e gjerë, që në optikën e profesorit, të vëllezërve Finci-Kontini, është vendi që ka sipërmarrë misionin të mbrojë këdo që e mikëpret.

Pikërisht në këtë studio profesor Ermano shpalos përkujdesjen e tij thuajse atërore. Pikërisht këtu i dhuron djaloshit, me bindje të plotë, botimet e tij, njëri prej të cilëve një përmbledhje e mbishkrimeve në varrezën izraelite në Lido të Venecies, si për të dhënë një tjetër sinjal të lajtmotivit të vdekjes, të cilin e sollëm në vëmendje në fillim, por edhe për faktin se Ermano i ri kishte shpallur fejesën me Ollgën pikërisht aty. Pra një jetë, që është e destinuar të shuhet shpejt. Po këtu, profesori i tregon reliket e bibliotekës. Janë letrat e pabotuara që Karduçi i pati shkruar nënës së tij. Studioja është strofkulla që nxit procesin e të rrëfyerit. Më tutje profesori vendos të flasë pa dorashka për monografinë e tij mbi Sara Enrikez Avigdor, shtëpia e së cilës që kthyer për dekada radhazi në sallonin letrar më të frekuentuar nga shkrimtarë italianë (dhe jo vetëm) të dorës së parë, poetja që kishte mbajtur letërkëmbimin e shkëlqyer me të famshmin, fisnikun gjenovez Ansaldo Çeba, një goxha grua, nderi dhe krenaria e hebraizmit italian në mesin e kundër-reformës. Ajo, gjithashtu që bërë objekt sulmi i shpifësve që grafullonin nga zilia dhe antisemizmi, sipas të cilëve jo gjithçka mbante emrin e saj, ishte krijim i saj. Dhe, profesori duket se depërton në vetën e protagonistit kur e këshillon se, po të

vazhdonte studimin më tej të figurës së saj, duhej domosdoshmërisht të përballej edhe me këto ligësi.

Nga biseda thellësisht e ngrohtë, intime, konfidenciale, profesori zhvendoset në rrafshin historik, në trajtime teorike të përgjegjshmërisë së lartë që duhet të ketë një historian i mirë.

[...] *Fundja, çfarë duhet të bëjë një historian i dorës së parë? Natyrisht, të përqafojë si ideal, mbërritjen tek e vërteta, por në çdo rast, pa e humbur kurrësi gjatë udhës ndjenjën e mirësjelljes dhe të drejtësisë.* [fq.186].

Pas këtij dialogu dera mes dy sallave, pra mes atyre të dyve, mbetet përherë e hapur, dhe gjithashtu ata komunikojnë; “*si po ecën puna?*”, “*sa është ora?*”. E vërteta e takimeve të tyre nuk ka nevojë për hulumtim. Protagonisti, njëherësh rrëfimtari, ndërpret brutalisht sekuencën e atyre takimeve, pa kthim pas, duke u përqendruar tek kujtimet e burgut të vitit 1943. Sikundër është hedhur një hipotezë nga studiues të Basanit, ky fund enigmatik i bashkëngjitet refrenit që shkiste shpesh nga goja e Mikolës, “*Është kaq e padobishme*”¹⁰³, sa herë që ajo shfaqej e zhytur thellë në mendime. Finci-Kontinët dëbohen nga Ferrara, përfundojnë të ndarë në kampet shfarosëse, ashtu sikundër thuajse i gjithë komuniteti i tyre. Protagonisti i mbijeton tragjedisë. Ai mund të tregojë, por “*vetëm ato pak kujtime që zemra ka dashur t’i shpëtojë*”.

Pavarësisht vendit qendror që zë Mikola në roman, ai ndërton raporte të barabarta si me profesorin, ashtu edhe me të bijën. Me të parin në rrafsh intelektual, historik e kulturor, me të dytën në rrafsh sentimental. Autori është dëshmitari i mbijetuar i bisedave mes tyre, ashtu sikundër Karl Jakob Burkard, në tregimin “*Një mëngjes tek librashitësi*”¹⁰⁴, që kujton takimin e rastësishëm mes poetit pragez Rilke dhe punonjësit të bibliotekës së Shkollës Normale Lysien Herr, mësues e filozof shumë i njohur për kulturën e gjerë, ndërsa të tre së toku flasin për poetët e mëdhenj në gjuhët respektive dhe mbi mundësinë e përkthimit, të transmetimit të disa ngjyrymeve letrare në vargjet e Ronsardit dhe të La Fontenit. Një bisedë

¹⁰³ Bassani, G., *Kopshti i Finci-Kontinëve*, vep.cit...

¹⁰⁴ Bunckhardt, Carl Jakob, *Ein Vormittag beim Buchhändler*, Hermann Rinn, München, s.a, 1943, përkthyer në italisht: Pocar, Ervino, *Incontro con Rilke*, sellerio Editore Palermo, 1948. Titulli origjinal i tregimit publicistik është *Një mëngjes tek librashitësi*.

intensive, e cila bëhet një ekuilibër i jetës dhe i mendimit, ndërsa një paralajmërim i çuditshëm i vdekjes rri pezull rreth dy personazheve, që pak kohë më pas largohen nga kjo jetë.

Në përmbyllje të këtij shtjellimi, mund të konstatojmë se romani i Basanit është nga librat me më shumë referenca letrare, falë gjetjeve stilistikore të shkrimtarit. Biblioteka reale dhe ato imagjinare në veprën e Basanit mund të lexohen, si: *kronotope*, koordinata hapësinore, kohore dhe kulturore, që lidhin ngjarje dhe vende, njerëz dhe kultura, të ngjashme dhe të ndryshme mes tyre, edhe pse në plane paralele apo të zhvendosura.

The Historical and Cultural Dimensions of the Notion of Count Finzi's Library

ABSTRACT

After having been excluded from Ferrara's Public Library, the young protagonist is hospitably invited by the professor Finzi-Contini into his private library. The dialogues which are taking place in this peaceful atmosphere can be seen in the tradition of a literary theme existing ever since the early 19th century: the topic of the library as hortus conclusus for intellectual sympathies in times of political threat.

The library expands the analytical angle and opens up a comparative dimension of the subject. The library, as a concept of the place where individual research is conducted, where the silence is plagued, but also the place of attractive conversations, is found in Basan literature and later. The connection between the novels where the library image emerges, proves that it is an expression of culture and the intellectual life style. It can function as a theme aside or as an integral part of a macrotheme. Even if it appears in the peripheral spaces of narrative texts, the library is the element that complements the character portrait. But, rarely, it is the place of pleasant conversations in times of historical and difficult ideologies, where it takes political and historical dimension, confessions, and friendships.

Real and imaginary libraries in Basan's work can be read as chronotope, spatial, temporal and cultural coordinates that link events and

places, people, and cultures, similar and diverse between them, though in parallel or displaced plans.

Keywords: protagonist, intellectual, antifascism, library, sympathy.

Dhurata HOXHA, Drita BRAHIMI

REFLEKTIM MBI FIGURËN E SKËNDERBEUT NË SHKRIMET NË GJUHËN FRËNGE

Pikëtakimet midis kulturës shqiptare dhe asaj franceze janë të hershme. Shqipëria dhe shqiptarët kanë ngjallur interes tek një varg personalitetesh franceze, diplomatë e misionarë, udhëtarë e ushtarakë, studiues e historianë, poetë e romancierë, duke bërë që veprat e tyre të përbejnë një fond të çmuar të shkencave albanologjike. Nuk mund të mungojë në këtë fond figura e heroit tonë kombëtar Skënderbeut, madhështia e të cilit u admirua dhe u vlerësua në vepra të shumta, të cilat kanë arritur deri më ditët tona.

Qëllimi i këtij artikulli është të sjellë jo vetëm për një publik frankofon dhe frankofil, por dhe më gjerë, aktualitetin shqiptar të vitit, figurën e Skënderbeut, por të trajtuar në optikën e kontributit të shkollës franceze të albanologjisë. Nuk bëhet fjalë për një studim të mirëfilltë shkencor apo shterues, pasi janë cituar burime arkivore të njohura, por synohet të theksohet larmia e shkrimeve të autorëve francezë mbi jetën dhe veprën e Skënderbeut si vepra me karakter historik, artistiko-letrar apo përkthime, duke sjellë edhe fragmente ku flitet për figurën e Skënderbeut, bëhen krahasime me personazhe historike franceze apo vlerësime të qëndrueshme dhe luftës së shqiptarëve të kryesuar nga Skënderbeu, si dhe rëndësia e studimit të gjuhës së këtyre veprave, nga studiuesit e rinj dhe studentët.

Vepra më e hershme e shkruar nga një autor francez daton në 1576. Është një përkthim i veprës së Marin Barletit, me titull "*Historia e Gjergj Kastriotit, të quajtur Skenderbe, mbret i Shqipërisë....*" nga Zhak de Lavardin (Jacques de Lavardin), e cila u bë edhe vepra bazë për përkthimin e Barletit në disa nga gjuhët evropiane dhe shërbeu si burim frymëzimi për një letërsi dhe art të mirëfilltë të epopesë së Skënderbeut duke u ribotuar gjashtë herë deri në vitin 1621.¹⁰⁵

Parathënia drejtuar fisnikërisë franceze shpjegon zgjedhjen e autorit për të sjellë këtë vepër, burimet e shfrytëzuara si dhe vlerësimin për figurën e Skenderbeut:

¹⁰⁵ Jaka.Y, *Skenderbeu në historiografinë frënge*, Instituti albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 2001, f. 45.

“Gjergj Kastrioti Skënderbeu, emër i pavdekshëm, shenjtëruar në tempullin e Kujtesës. Do hasni këtu një Princ fetar, zemërbardhë, luftarak, armatosur me besë e zell të pabesueshëm, një ushtar besnik, unanim, i bindur. Do vëreni një bindje aq të përkryer të disiplinës ushtarake, sa fitoret e papërfillshme dhe bëmat e të tjerëve do t’ju duken më pak të denja për adhurim. Është këtu jeta e Gjergj Kastriotit, i mbiquajtur nga turqit Skënderbe, Mbret i Shqipërisë, emri i pavdekshëm i të cilit është i denjë, pa kurrfarë kundërshtimi, për t’u shenjtëruar në tempullin e Kujtesës, përmbi, rastësisht, të gjithë të tjerët të rekomanduar kalorës e kampionë të Jezu Krishtit, prej tij gjallëruar në do vise të Levantit përballë sektit të Mehmetit, ku ai, më se një herë ka shfaqur krejt cilësitë dhe prerogativat e lëndueshme, sikurse janë besimi, forca, zhdërvjelltësia trupore, shkathtësia mendore dhe praktikimi i armëve, zbatuar me një këmbëngulje aq të pazakontë sa bëmat e tij i tejkaluan meritueshëm, mund të thuhet, vetë misionet e paracaktuara; dhe prej tyre, unë nxora e mora, sipas historisë së vërtetë, shkrime nga ata që kanë folur; në mënyrë të veçantë nga Marin Barleci, Prift, lindur në Skutari të Shqipërisë, që mendova ta kem si ekzemplar e patron kryesor, si autor që, tek njihet për shumë zotësi e vërtetësi, për shumë seriozitet e gojëtar, meriton vend ndër Historianët latinë më në zë të shekujve të shkuar. [...]”¹⁰⁶

Gjejmë po këtu edhe një sonet për Skënderbeun shkruar nga poeti dhe humanisti i madh francez Pier Ronsar (Pierre de Ronsard) në vitet e fundit të jetës së tij, si dhe një poemth të Floran Kretien (Florent Chrétien), fakt që tregon se kjo vepër u përshëndet që në fillim nga poetë me emër të kohës, të cilët ishin njëkohësisht edhe humanistë të shquar të Rilindjes evropiane, latinistë, profesorë, specialistë të retorikës dhe oratorë.

O nder i shekullit tënd!

O nder i shekullit tënd! O shqiptar prej fatit sjellë !

Dora tënde, turqit mundi plot njëzet e dyherë,

Tmerr i radhëve të tyre, llahtarë e këshjtjellave të tyre;

Dhe prapë, i vdekur do ishe, prej fatit përpirë,

Sikur vepër fort e zgjuar e të diçmit Lavardin,

S’do kish ringritur bëmat e tua, vdekjen tek ta mposhti.”¹⁰⁷

¹⁰⁶ J aka. Ymer, *Skenderbeu në historiografinë frënge*, Instituti albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 2001, f. 47 (Fragment nga soneti i Ronsarit)

¹⁰⁷ <http://www.javanews.al/njembedhete-poema-per-skenderbeun-nga-autore-te-shquar-boterore/>

Francez, imito Skënderbeun!*Nuk mundem, Lavardin, të rri –**Para bëmave lavdi plotë, të trimit Epirot,**Para virtytit të tij famëmadh,**Që ti na e dhe plot shkëlqim me këtë Histori,**Të bukur e të dëlirë -,**Pa qortuar më parë frëngjit tanë,**Trima të tërbuar;**Pa hequr thellë në shpirt për atë çka mund të kishim bërë ne më mirë,**A të paktën mos të harrojmë**Që sadopak territore do mund të kishim liru**Nga i huaji Barbar, i fuqishëm e ngadhënjimtar.**I mjeri ti francez, në këtë liri servile,**Që këmbëngulethshëm në luftën civile,**Shndërroje mjerimin tënd**Me anë të kësaj Historie;**Imito Skënderbeun dhe turp të të vijë**Që pabesi e Barbarëve**Të la në prapavijë,**Veprë në të kundërt, në qofsh**i Krishterë,**Dhe me sadopak vlerë.[...] ¹⁰⁸*

Në shkrimet historike nga autorë francezë zbulojmë se Skënderbeu krahasohet edhe me personalitete të shquara franceze si p.sh., Charl Martel, një figurë shumë e spikatur dhe popullore e historisë mesjetare franceze, i cili më 732 kishte shpëtuar qytetin Puatie (Poitiers) nga pushtimi arab. Një paralelizëm të tillë e gjejmë në veprën e Aleksandër Kampion (Alexandre Champion) “Burrat e shquar” (1657) duke i dhënë një vlerë të veçantë këtij përshkrimi, pasi gjendet në një vepër me dimension mjaft të gjerë.

Ja çfarë shkruhet në vepër: “Midis të krishterëve kam gjetur vetëm Skënderbeun, të cilin mund ta krahasoj me të drejtë me Charl Martelin; jo pse e pëlqej më shumë se Konstandinin, Karlin e madh, Teodosin, Belizierin dhe aq shumë kapedanë të tjerë të shkëlqyeshëm, për të cilët e le lexuesin të

¹⁰⁸ [http://www.gazetama.net/2018/01/14/viti-i-skenderbeut-poete-boterore-per-heroine-kombit-shqiptar/\(Fragment ngapoemthi i Floran Kretien\)](http://www.gazetama.net/2018/01/14/viti-i-skenderbeut-poete-boterore-per-heroine-kombit-shqiptar/(Fragment%20ngapoemthi%20i%20Floran%20Kretien))

mendojë lirisht, por pranoj se po të shikohen rinia dhe vdekja e tij, ka diçka të posaçme në jetën e tij. (...) Tek e fundit, pasi të shqyrtohen biografite e të gjithë tyrëve, e gjeta vetëm Skënderbeun të përshtatshëm që të krahasohet me të (Sharl Martelin)”.¹⁰⁹

Autori shpjegon arsyet pse bën një paralelizëm të tillë si p.sh., rininë e tyre fatkeqe, virtytet e jashtëzakonshme që i bënë ata prijës të mëdhenj si dhe rezultatet e luftës së tyre: Skënderbeu e çliroi vendin e tij nga robëria osmane, ndërsa Marteli e çliroi Evropën nga arabët. Nuk mungojnë edhe dallimet si p.sh., Skënderbeu paraqitet si fitues i pamposhtur në dyluftime në sajë të forcës së tij të krahut, ndërsa Martel si ngadhënjimtar i betejave të mëdha historike që përcaktuan fatin e Evropës.

Vepra tjetër franceze me rëndësi historike është një monografi mbi Skënderbeun e vitit 1855 “*Historia e Skënderbeut ose turqit dhe të krishterët në shekullin XV*” që kishte për autor Kamij Paganel (Camille Paganel), diplomat, politikan, por edhe me ambicie si historian.

Kjo vepër ka tërhequr vëmendjen e studiuesve për disa arsye:

Së pari, për pasurinë e ngjarjeve dhe bibliografinë shumë të pasur, që shpjegon faktin se për të shkruar këtë monografi, Paganeli lexoi pothuajse të gjitha veprat e botuara deri në atë kohë mbi Skënderbeun, por edhe veprat e tjera historike mbi fqinjët, aleatët apo kundërshtarët e Skënderbeut.

Së dyti, sepse Paganeli nuk mjaftohet vetëm me një përshkrim të thjeshtë të jetës dhe veprës së Skënderbeut, por bën një trajtim më të plotë të historisë së lashtë të Shqipërisë: prejardhjen dhe karakterin e shqiptarëve, dashurinë e paepur për liri, marrëdhënien me fqinjët, apo pozitën strategjike të Shqipërisë.

Së treti, kjo monografi, duke bërë dallimin me veprat e tjera për Skënderbeun të shkruara deri në atë kohë, të cilat ishin pothuajse përkthime të Barletit, faktet kryesore mbi jetën dhe luftërat e Skënderbeut i ka përshtatur në një mënyrë më intriguese dhe të kuptueshme për lexuesin.

Së katërti, sepse Paganeli thekson karakterin evropian të luftës shqiptare ndaj pushtuesit osman, pavarësisht se shpeshherë i jep nota më fetare. Kjo qëndresë nuk kishte si qëllim vetëm lirinë e popullit shqiptar, por edhe që ta çlironte Evropën nga një zgjedhë gjithnjë e më kërcënuese. Gjithashtu Paganeli kritikon edhe qëndrimin e sundimtarëve të tjerë evropianë, të cilët i lanë vetëm shqiptarët në luftën përballë perandorisë osmane.

¹⁰⁹ Jaka.Y, *Skënderbeu në historiografinë frënge*, Instituti albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 2001, f. 45

Për këto arsye thuhet se autori u mundua të shkruante një histori mbi baza shkencore për Skënderbeun. Është përpjekja e parë e këtij lloji në Francë, por edhe në historikun e studimeve Skënderbejane deri në shekullin XX në tërësi.¹¹⁰

Figura e Skënderbeut është e pranishme edhe në shumë vepra të trillimit tregimtar ndër të cilat do të veçonim “Skënderbeu“ me autor Yrben Shëvrou (Urbain Chevreau), botuar në vitin 1644. Rrëfimet dhe përjetimet e vetë heroit mbi familjen e Kastriotëve dhe konfliktin shqiptaro-turk i japin kësaj vepre përmasa të karakterit historik, por autori tregohet mjaft i kujdesshëm për të mos rënë në kurthin e një vepre të mirëfilltë historike, duke u shkëputur në këtë mënyrë nga historiku i origjinës së formimit dhe zhvillimit të Perandorisë Osmane.¹¹¹

Me penën e tij, ai arrin të tërheqë lexuesin duke përdorur “*teknika romaneske origjinale të një tregimi aventurash që ndërpriten apo rimerren herë pas here nga dialogje me anë të cilave shpaloset portreti i një strategu, i një njeriu të ditur, i cili me një qetësi shpirtërore që të mahnit, tregon forcën, guximin dhe jep madje këshilla e mësimi.*”¹¹² Shpeshherë skena të ndryshme luftimi i kalojnë caqet e reales për të shpalosur madhështinë e një heroit legjendar. Edhe pse skenat lirike të dashurisë së heroit me Arianitën janë të pakta, ato ia shtojnë bukurinë veprës, pasi thyejnë monotoninë.

Në veprën tjetër “*Skënderbeu ose aventurat e princit të Shqipërisë*“ (*Scanderbeg ou les aventures du prince d’Albanie*), botuar në 1732, nga Sheviji (Chevilly), Skënderbeu portretizohet si një njeri i cili i propozon sulltanit të trajtojë kalorësit në mënyrë të barabartë, gjë që të kujton mbretin Artur të traditës kalorsiake. Nga ana tjetër, ai nuk e duron zgjedhën e huaj e për këtë, është i gatshëm të luftojë që vendi i tij të jetë i pavarur.

Lindur princ, dhe i pavarur nga të gjitha fuqitë e huaja, ti nuk duhet të habitesh aspak se dashuria për lirinë më ka bërë të shkund një zgjedhë për të cilën nuk do të kisha lindur. Prandaj mos i jep aspak poshtërsisë atë që keni bërë ashtu si bëra, nëse Zoti do të sillte në jetë në vendin tim. Po ia lë virtytit tënd të më justifikojë në zemrën tënde.”¹¹³ (Fragment nga një letër drejtuar Sulltanit)

¹¹⁰ Jaka.Y, *Skënderbeu në historiografinë frënge*, Instituti albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 2001, f. 165-167

¹¹¹ *La figure de Scanderbeg dans les lettres francaises de la Renaissance à l’Age Classique. Éléments d’une bibliographie critique*, f.10 në <https://ojs.lib.uom.gr/index.php/BalkanStudies/article/viewFile/2794/2818>

¹¹² Po aty, f. 11.

¹¹³ Po aty, f. 20.

Skënderbeu është gjithashtu heroi i gjinive të tjera letrare si dramave të Lilo (G. Lillo) (1735) apo Udar të la Mot (Hudar d'La Motte) (1735), tragjedisë neoklasike "Skënderbeu" të Pol Ulrik Dubyison (*Scanderbeg*, Paul Ulric Dubuisson) (1786), drama që frymëzuan edhe kompozitorët e njohur dhe shumë të suksesshëm Fransua Rebel dhe Fransua Franker (François Rebelet, François Franker) për operën "Skënderbeg". Opera pati aq sukses sa që u interpretua tridhjetë e tri herë në Paris nga Akademia Mbretërore e Muzikës para mbretit dhe aristokracisë franceze. Në Bibliotekën Kombëtare dhe në Operën e Parisit ruhen partiturat e disa publikimeve të epokës, disa botime të libretit, shumë shënime për interpretimin si dhe skicat e disa kostumeve.

Por gjithashtu shumë intriguese është fabula. Në tingujt e muzikës, në një dekor oriental shfaqet një shpellë në kopshtet e pallatit të sulltanit, në të cilin zhvillohet një luftim ndërmjet Skënderbeut dhe sulltanit, ku heroi ynë del fitimtar. Lavdia dhe fitorja e heroit përshkojnë fragmentin e mëposhtëm, në të cilin fusha leksikore e tyre shoqërohet me figura letrare të goditura, të tilla, si: metaforë *Lavdia ... ka karreme të shkëlqyer, fitorja fluturon rreth saj, Pëshpëritja mikluese Shpresë që më ka mikluar, (La gloire... a de brilliants appâts, la victoire vole autour d'elle, Le murmure flatteur L'espoir qui m'a flatté, hiperbolë Unë do të guxojnjë mijë vdekje, të kënaqem me flakën time E shoh famën të bashkuar me gjurmët e tij. J'irai braver mille trépas, flatter ma flamme je vois la renommée attachée à ses pas)*. Përballë ngadhnjimitarit në strofën e parë Skënderbeu shfaqet edhe si hero i cili triumfon edhe në dashuri, çka autori e ka realizuar përmes paralelizmave, të tillë si:

« Qetësia kthehet në shpirtin tim,
Sa e këndshme është kjo ditë sa të bukura janë këto vende!
Kënga e zogjve të dashuruar,
Freskia e zefirëve, lulet që ata nxjerrin,
Pëshpëritja mikluese e këtyre ujërave të qeshura,
Gjithçka duket se i paguan haraçin Agimit... »¹¹⁴

Një vepër tjetër e rëndësishmenë të cilën lartësohet figura e Skënderbeut konsiderohet edhe « *Ese mbi zakonet dhe shpirtin e kombeve* » e shkrimtarit të madh francez Volteri cili i kushton një kapitull të shkurtër heroit tonë kombëtar Skënderbeu, të cilin e vlerëson aq shumë sa që

¹¹⁴ Luan Rama, *Pont entre deux rives Albanie- France, essai*, éditions SDE, 2005, ISBN 2-7480-1908-3, f. 31.

mendon se perandoria bizantine do të kishte mbijetuar nëse do të kishte në krye një udhëheqës të këtij kalibri.

« *Një luftëtar tjetër i famshëm, të cilin nuk di si ta quaj, osmanlli apo të krishterë, pengoi përparimin e Muratit dhe prej kohësh u bë ledhi i të krishterëve kundër fitoreve të Muhametit II: flas për Skënderbeun, lindur në Shqipëri [...] Gjergj Kastrioti ishte ende fëmijë kur Murati e mori prej Shqipërisë pas vdekjes së të atit. [...] ai e sajdiste atë dhe e mbante pranë tij gjatë betejave [...]. Gjergj Kastrioti u dallua aq tepër sa sulltani dhe jeniçerët i shanë emrin Scanderbeg., që do të thotë Aleksandri i Madh. [...] Ai e shtrëngoi sekretarin e sulltanit i cili mbante vulën e tij që të shkruante e të vuloste një urdhër për sundimtarin e Krujës, kryeqyteti i Epirit, që t'ia dorëzonte qytetin dhe kështjellën Skënderbeut. [...] Më 1443, ai marshoi mbi Krujë; sundimtari ia lëshoi postin pa vështirësi. Me [...] luftëtarët e vet ai e fitoi gjithë Shqipërinë. Shqiptarët mbahen si luftëtarët më të mirë të këtij vendi. Skënderbeu i udhëhoqi me zotësi dhe diti të krijonte avantazhe nga terreni i thyer dhe malor, aq sa me pak trupa ia doli të ndalonte çdo herë ushtritë e shumta turke. Myslimanët e shihnin si besëthyes; të krishterët e adhuronin si hero, i cili duke mashtruar armiqtë dhe zotërit e tij, rimori kurorën e babait të vet, ç'ka e meritoi me guximin e tij.*¹¹⁵

Është për t'u theksuar se komuniteti ndërkombëtar frankofon u njoh me veprën e Skënderbeut edhe nga autorët shqiptarë të cilët shkruan në gjuhën frënge. Mjafton të përmendim Fan Nolin, Naim Frashërin, Ndre Mjedën, Sabri Godon, Kristo Frashërin, Aurel Plasarin, etc. Megjithatë, në këtë punim kemi përzgjedhur romanin *Kështjella* të Ismail Kadarese, botuar në vitin 1970 dhe përkthyer në frëngjisht me titullin *Les Tambours de la pluie* nga përkthyesi i shquar Jusuf Vrioni në vitin 1985.

Në romanin *Kështjella* Skënderbeu është i gjithëpranishëm, por askush nuk e sheh asnjëherë, çka shënon një risi në fushën e narratologjisë, duke i sjellë lexuesit një roman shumëdimensional, të fuqishëm, të një fuqie që mbështetet në një teknikë shumë të thjeshtë. Përmes fjalëve të një prej personazheve shqiptare Kadare sjell këndvështrimin shqiptar të figurës së Skënderbeut. Ky personazh, një nga rojat e kullave e lartëson aq shumë si figurë saqë edhe vazhdimisht lutet për Gjergjin, duke u dhënë këtyre lutjeve edhe përmasa mistike. Ndërsa këndvështrimi osman pasqyrohet në vepër nga personazhe të ndryshme osmane të cilët e mallkojnë Skënderbeun, sulmet rrufe të të cilit ua kallin frikën deri në palcë. Me madhështinë e një heroi të përmasave mitike, i cili edhe pse i padukshëm, por i

¹¹⁵Skënderbeu në këndvështrimin e filozofit francez Voltaire në <http://www.javanews.al/skenderbeu-ne-kendveshtrimin-e-filozofit-francez-voltaire-myslimanet-e-shihnin-si-besethyes-te-krishteret-si-hero/>

gjithëpranishëm, Kadare ka krijuar një hero kombëtar që përjetësisht është kthyer në symbol të legjendës shqiptare.

Lavdia e Skënderbeut është përjetësuar në një nga kështjellat e Bobur-it (Beaubourg) ku portreti i Tij radhitet mes figurave të famshme historike të Anglisë, Spanjës, Napolit, Turqisë, Hungarisë, Francës etj; apo emërtimin e një sheshi “Sheshi Skënderbeg” (la place Scanderbeg) në shëtitoren Porte d’Aubervilliers të Parisit. Kjo e fundit, lidhet me festimet 500 - vjetorit të vdekjes së Skënderbeut, kur një grup emigrantësh shqiptarë këmbëngulën pranë kryebashkiakut Zhak Shirak (Jacques Chirac) që një nga shëtitoret apo sheshet e Parisit të mbante emrin e tij. Pikërisht në maj të 1980-s emigrantët shqiptarë jo vetëm nga Franca, por edhe nga SHBA, Belgjika, Italia u mblodhën për inaugurimin e këtij sheshi. Në meshën që u mbajt për nder të heroit tone kombëtar në katedralen Notre-Dame kënduan edhe vajza arbëreshe të veshura me kostume tradicionale, cilat kishin ardhur nga jugu i Italisë. Ndërsa që nga viti 1968 në Belgjikë në sheshin Prevost - Delaunay në një lulishte ngrihet madhështore statuja prej bronxi e Skënderbeut dhe në parkun OMC në Gjenevë të Zvicrës busti prej bronzi.

Në të gjitha shkrimet e sipërpërmendura, ne kemi zgjedhur një portretizim të figurës së Skënderbeut të cilin e kemi përpiluar si:

- burim frymëzimi për historianët dhe artistët;
- shembull i vyer i qëndresës heroike për shqiptarët dhe për të huajt;
- strateg gjenial, kalorës i krishtërimt;
- simboli i një njeriu që di të luftojë dhe të dashurojë.

Sqarojmë se disa nga këto vepra që janë shkruar në frëngjishten e vjetër, i kemi gjetur në variantin origjinal dhe të sjellë në frëngjishten e sotme. Prandaj i propozojmë për studime më të thelluara edhe të fenomeneve gjuhësore për studiuesit e rinj dhe studentët e gjuhës frënge.

Është një shembull i shkëlqyer i ndërlidhjes së aspekteve gjuhësore me ato kulturore e historike.

Për ta përmbyllur punimin tonë, më poshtë po paraqesim disa vepra apo shkrime të autorëve francezë mbi Skënderbeun:

1. M.E. de Montagne, 1588, Scanderbeg et son soldat.
2. Jacques de Lavardin 1576(1621), Histoire de Georges Castriot surnommé Scanderbeg, Roy d’Albanie. Contenant ses illustres faits d’armes, mémorable victoire à l’encontre de Turc.
3. Th. A. D’Aubugne, 1616, les « Tragiques » - sur Scanderbeg.
4. Pierre de Ronsard, 1621, Sonnet sur Scanderbeg.
5. Urbain Chevreau, 1644, Scanderbeg. Avec Privilège du Roy.
6. L’abbé C. Guenot, 1862, Le serment (de Scanderbeg).

7. Anne de La Roche-Guilhem, 1688, Scanderbeg aimé.
8. Guilhem La Roche, 1692, Le grand Scanderbeg.
9. Jean Nicolas Duponcet, 1709, Histoire de Scanderbeg, Roy d'Albanie.
10. Chevilly, 1732, Scanderbeg, les aventures du Prince d'Albanie, tome 1-2.
11. La Motte, Antoine Houdart, 1735, Scanderbeg. Tragédie représentée par l'Académie Royale de Musique.
12. Voltaire, 1756, De Scanderbeg.
13. Paganel Camillo, 1856, Histoire de Scanderbeg ou turks et chrétiens au XVsiècle.
14. Guénot C, 1862, Scanderbeg ou le héros chrétien.
15. Pertus, Casimir, 1870, Scanderbeg, Tragédie en cinq actes.
16. Gijom Deping, 1886, Scanderbeg.
17. Anonymes, Portraits de Scanderbeg, 1899.
18. Léon Charpentier, 1910, Fête des fleurs pour le Héro National, 1910.
19. Levèvre-Pontalis, 1913, Un héros albanais-Scanderbeg in Revu hebdomadaire, 2août.
20. 1951, Scanderbeg, Le Héros de l'Albanie.

BIBLIOGRAFIA:

- ANDREA F, *Livres d'or d'auteurs français sur les albanais*, Anthologie illustrée (1332-2007).
- JAKA, Y, *Skënderbeu në historiografinë frënge*, Prishtinë 2001.
- RAMA L, *Pont entre deux rives*, Albanie-France, essai, éditions SDE, 2005.

Sitografia

<http://www.javanews.al/skenderbeu-ne-kendveshtrimin-e-filozofit-francez-voltaire-myslimanet-e-shihnin-si-besethyes-te-krishteret-si-hero/>
<http://www.javanews.al/njembedhjetepoema-per-skenderbeun-nga-autore-te-shquar-boterore/>
<http://www.gazetatema.net/2018/01/14/viti-i-skenderbeut-poete-boterore-per-heroine-e-kombit-shqiptar/>
<https://ojs.lib.uom.gr/index.php/BalkanStudies/article/viewFile/2794/2818>

Reflection on Scanderbeg's image in French language writings***ABSTRACT***

Through this article we aim at presenting the Albanian reality of the year, Skanderbeg's figure, but treated in the context of the contribution of Albanology French school. It does not deal with a genuine scientific or exhaustive study, since we have exploited archives sources. However, it is intended to emphasize the variety of French writers' writings on Scanderbeg's life and works, such as works of historical, artistic, literary or translational character, by presenting fragments referring to Scanderbeg's figure. He is compared to historical French characters and there are also reviews about Albanians resistance and struggle which had been led by Scanderbeg. By means of this article we focus on the importance of these works' language study by young researchers and French language students of French Department.

Key words: Albanological studies, historical and literary writings on scanderbeg's figure, history of French language.

Fatos DIBRA

E KUJT ËSHTË URTËSIA E PROVERBAVE TEK FJALORI I FRANG BARDHIT? (OSE: NJË LEXIM I PROVERBAVE TË FJALORIT TË BARDHIT)

Hyrje

Në këtë punim do të bëjmë një shqyrtim të fjalëve të urta dhe proverbave në gjuhën shqipe që jepen në fjalorin e Frang Bardhit (1635) duke pasur parasysh fjalët e urta dhe proverbat (sidomos ato në gjuhën turke) që jepen në gramatikën e gjuhës turke të Hieronymos Megiser-it *Institutionum linguae Turcicae libri quatuor* (1612).¹¹⁶Në gramatikën e Megiser-it dhe në fjalorin e Bardhit fjalët e urta dhe proverbat janë dhënë në formë liste në kapitujt përkatës të veprave: në pjesën e tretë të gramatikës së Megiser-it dhe në kapitullin e shtatë të pjesës së dytë (f. 207-217) të veprës së Bardhit. Proverbat e shprehjet e tjera tek Megiser-i janë dhënë në origjinalin turqisht me gjegjëset (përkthime ose variante të proverbit a shprehjes) në gjuhën latine, italiane ose gjermane, në dy gjuhë apo në të tria; nganjëhere pjesa turqisht shoqërohet edhe me ndonjë proverb a shprehje në gjuhën arabe ose perse. Proverbat e shprehjet e tjera shqipe të Bardhit janë dhënë kryesisht me gjegjëset latinisht, italisht ose në të dy gjuhët; në pak raste shoqërohen nga proverbat/shprehjet turqisht, që janë dhënë në variantin e Megiser-it.

Dy janë arsyet kryesore pse i krahasojmë këtu proverbat dhe fjalët e urta të këtyre veprave. Së pari, se Bardhi, për përgatitjen e fjalorit të tij është mbështetur kryesisht në veprën e Megiser-it (Dibra, 2016).¹¹⁷Së dyti, pasi mendojmë që të dy këto vepra – *Dictionarium*-i i Bardhit për gjuhën shqipe dhe *Institutionum*-i i Megiser-it për gjuhën turke – janë dy burime që mund të konsiderohen, pa mëdyshje, themelore. Megjithatë, për shkak të hapësirës, nuk do të japim këtu listën e plotë të gjithë proverbave që ka

¹¹⁶ Shprehjet e fjalorëve të Bardhit dhe Megiser-it nuk janë të gjitha proverba. Këtu të gjitha këto shprehje në disa raste do t'i quajmë në mënyrë konvencionale 'proverba', duke mbajtur parasysh natyrën dhe dallimet e secilës shprehje, d.m.th., të proverbit, fjalës së urtë dhe shprehjeve të tjera.

¹¹⁷Në këtë punim mendojmë se kemi zgjidhur një problem themelor siç është ai i burimit që ka përdorur Frang Bardhi për hartimin e *Dictionarium*it. Këtu, pa hyrë në hollësi, kemi cekur edhe çështjen e proverbave (Dibra, 2016, fv. 83-85).

Bardhi dhe të gjegjëseve të tyre turqisht tek Megiser-i dhe as gjegjësen turke të të gjitha proverbave të Bardhit që do të përfshihet këtu.

Në dijeninë tonë, lista e proverbave të Bardhit nuk është trajtuar ndonjëherë në një punim të posaçëm. Rreth këtyre proverbave këtu do të diskutojmë kryesisht duke pasur parasysh proverbat në gjuhën turke që jep Megiser-i. Në këtë mënyrë do të kemi mundësi të zgjidhim disa probleme që mendojmë se duhen shtruar dhe duhen marrë në konsideratë kur trajtohet një material i tillë shumë i rëndësishëm, sadoqë në pamje të parë modest për nga vëllimi (shih më poshtë). Në shtrimin e problematikës këtu kemi parasysh edhe parashtrimin që bën Shaban Demiraj (2003, fv. 174-175).¹¹⁸

Këtu do të kemi parasysh kryesisht kuadrin teorik mbi proverbat që paraqesin Mieder (2004; 2015) dhe Norrick (2015), si dhe atë që jepet në përgjithësi tek Hrisztova-Gotthart dhe Varga (2015); por do t'i referohemi edhe autorëve shqiptarë, si Sako, etj. (1984; 1984) dhe Tuda (1995; 1996). Një qasje të vlefshme, që për mendimin tonë plotëson Sakon, Tudën etj., bën edhe Kamsi (1943, fv. 3-7) në parathënien e përmbledhjes së tij të proverbave.

Në qasjen krahasuese të proverbave shqipe me ato turqishte, si pikënisje marrim punimet e Sanfeld-it (1968) dhe Kazazis-it, duke pasur parasysh sidomos diskutimin e Kazazis-it mbi llojet e huazimeve nga turqishtja (1972, fv. 96-98 në veçanti); megjithëse krahasime praktike të sintagmave e shprehjeve të cilësuar si huazime nga turqishtja mund të jenë bërë nga studiuesit njohës të të dy gjuhëve edhe më parë, p.sh. Kaleshi (Kaleşi, 1964, fv. 71-72), Dizdari (2005, fv. 73, 85, si dhe passim),¹¹⁹ apo

¹¹⁸ Shkruan Demiraj: “Proverbat dhe fjalët e urta të botuara nga Bardhi paraqitin një interes të shumanshëm. Në radhë të parë, del si detyrë që të veçohen ato që janë të gurrës popullore shqiptare dhe këto pa dyshim përbëjnë pjesën më të madhe. Pastaj mbetet për të përcaktuar se cilat nga proverbat dhe fjalët e urta të botuara në këtë Fjalor gjëllinjnë ende, qoftë edhe në forma disi të ndryshme, në kohën tonë dhe në cilat treva të Shqipërisë. Gjithashtu mbetet për të bërë edhe njëfarë shtresimi kronologjik të tyre, duke vënë në dukje sidomos ato që përfaqësojnë një shtresë më të vjetër dhe që si të tilla kanë ruajtur edhe disa elemente gjuhësore arkaike, siç është p.sh. proverbi “Ende deleshit së njejunash ha uku”, që duket qartë se ka lindur në një mjedis tipik shqiptar.”

¹¹⁹ P.sh. tek zëri **bash** “Peshku qelbet prej krejet = *tur.* Balık baştan kokar” (Dizdari, 2005, f. 73), **behar** “S’vjen behari me një lule = *tur.* Bir çiçekle behar olmaz” (f. 85). Dizdari jep po ashtu edhe një numër të madh proverbash ku fjala kryesore a një një prej fjalëve kryesore është turqizëm, p.sh. “Më mirë gomar i gjallë se asllan i ngordhur” (fv. 39-40), “Zot na ruaj nga zabiti axhami, nga dimëri kërthi dhe fukarallëku në pleqëri” (f. 47), “Fukarajt ditën e bajramit i dhemb barku” (f. 61), “Nuk hollohet bakllava me miell theknet” (f. 63). Një pjesë e tyre kanë gjegjëse në turqishte, që Dizdari nuk e ka dhënë, për arsye të thjeshtë se qëllimi kryesor nuk është dhënia e gjegjëses turqisht të çdo proverbi që ka përfshirë në veprën e tij, ku përndryshe hasim hollësi që, për mendimin

edhe më vonë, p.sh. Luboteni (Lyuboteni, 1987).

Arsyeja për një qasje të tillë është se kemi një ngjashmëri mjaft të madhe të proverbave të kulturave të ndryshme, mes tjerash, edhe për shkak të huazimeve të proverbave nga një gjuhë / kulturë në një tjetër.

Në parathënien e *Dictionarium-it* Bardhi thotë se “[E] këtheva n si gjithë gjith sa muita e, mbasi e sosa, m u duk i pakë e i vogëlë; prashtu hina tue kuituem e shkrova mbë gjuhët tanë [...] ashtu ende do proverbialia o të thana, n cë sijashit disa kanë zakon e i thonë latinjtë e disa taliantë [...]” [DLE, IIIv]. Cilado të ketë qenë arsyeja që Bardhi i ka përfshirë në veprën e vet proverbat e thëniet e tjera, asgjë nuk e ndryshon faktin që ai këtë material që ka përkthyer në gjuhën shqipe, përgjithësisht e ka marrë të gatshëm nga burimi që kemi përmendur. Megjithëse ai duhet të ketë pasur njohuri mbi kulturën paremiologjike të klasikëve të antikitetit. Katoni [Catoni], të cilit i referohet në parathënien e fjalorit: “[p]osi thotë Catoni: *legere et non intelligere negligere est, sikur me thanë xgidh, e mos ndëgo, mos merr vesht gjith xgiedh, të pādītunë ashtë.*” (DLE, IVr), me veprat e tij, e tij, ndër ta *Distikët*, – prej nga është marrë edhe shprehja e mësipërme – ka qenë një prej klasikëve më të përdorur për mësimin e gjuhës latine në Evropën e mesjetës.¹²⁰ Në këtë mënyrë ato “*proverbialia o të thana, n cë sijashit disa kanë zakon e i thonë latinjtë e disa taliantë*” (DLE, IIIv) në mjaft raste mund të mos jenë gjë tjetër veçse përkthimi në gjuhën latine e italiane i proverbave e thënieve turke të listës së Megiser-it.

tonë, e tejkalojnë ambicien e shumë veprave enciklopedike të përgatitura jo veç nga një autor i vetëm, por edhe nga grupe autorësh. Një shembull i këtyre proverbave është “Nuk thotë qysh falemi fis, po falemi binish”, që, sipas fjalorit, e përcjell nga *Valët e detit* të S. Dines (Dizdari, 2005, f. 105), Kamsi jep “Nuk thotë kush: Falemi fis, por falemi binish” si shprehje të Shkodrës (1943, f. 108); si variante kemi “Ha binish mish”, “Ha kondosh e pi kondosh” si dhe “Ha dallamë e pi dallamë se jam miku qi kjeçë mbramë” që e jep Kamsi, bashkë më rrëfenjën përkatëse, që i atribuohet Nastradinit (1943, fv. 108, 180). Në Shkodër edhe shprehja “Vesha kopileshta”. Rrota jep “Nieri petkash e shpirti veprash” [Nr. 524] dhe “Nierin e bājnë petkat” [Nr. 525] (Rotta, 1914, fv. 38-39), që mendojmë se përcjellin një frymë të ngjashme a të përafërt.

Në gjuhën turke jo si proverb, por si shprehje frazeologjike [shih edhe §**Error! Reference source not found.** këtu], “Ye kürküm ye”, e përdorimit të përgjithshëm; nga referencat e shumta po japim Boratav-in, ku jepet me gjithë rrëfenjën apo anekdotën përkatëse (Boratav, 2007, fv. 36, 168). Anekdota turqisht haset qysh në dorëshkrime të shek. XVI. Për burimet e shkruara me anekdota e tregime të Nastradinit (tur. Nasreddin Hoca) shih Boratav (2007, fv. 85-89). Në shqipe ka kaluar edhe shprehja, edhe anekdota.

¹²⁰ Shih për këtë hyrjen që bën Chase (1922, fv. 1-11, për thënien f. 12). Gjithashtu, duhet mbajtur parasysh se figura mbase më e rëndësishme që ka luajtur rol kyç në përhapjen e urtësisë së antikitetit grek e romak është Erazmi i Roterdamit me veprën e tij *Adagia* (Mieder, 2015, fv. 33, me bibliografi).

Këtu do të bëjmë (1) një parashtrim të shkurtër teorik mbi proverbat, (2) një diskutim mbi burimet e ndryshme dhe ndikimet e ndërsjellta mes tyre në traditën shkrimore (që cek punimi ynë) dhe (3) në fund një shqyrtim të proverbove të Bardhit.

Një parashtrim teorik (mbi proverbat)

Shumica e fjalëve të urta që gjenden te Bardhi mund të konsiderohen proverb (Sako, Harito, & Haxhihasani, 1984, fv. 266 - 267). Në këtë rast, për ta kuptuar më mirë këtë cilësim që i bëhet këtyre shprehjeve, mendojmë se është me vend të bëhet një parashtrim i shkurtër se çfarë është një proverb. Sako proverbat i përkufizon në këtë mënyrë:

“Janë të thëna të shkurtra, ku është fiksuar e përgjithësuar përvoja e jetës së shumë brezave. [...] që shprehin një gjykim të plotë.” (1984, f. 43)

Sipas fjalorit të gjuhës shqipe [= Fjalori i Gjuhës së Sotme Shqipe, 1980] proverbi përkufizohet si:

*“Fjali e shkurtër, që shpreh një mendim të plotë, të figurshëm e të mprehtë, i cili përgjithëson përvojën e shumë brezave dhe zakonisht përmban një mësim të urtësisë popullore për jetën e për dukuritë e ndryshme të saj; fjalë e urtë.”*¹²¹

Përveç cilësive që përmenden në përkufizimet më sipër, duhet të mbahen parasysh edhe veçori të tjera të proverbove, që mund të ndryshojnë sipas përkufizimeve që jepen nga autorë (të ndryshëm)¹²² të cilët merren me aspektin teorik të tyre. Këtu kemi gjykuar të japim mendimin e Norrick-ut; veçori të proverbove sipas tij janë: 1. polisemia, 2. loja e fjalëve, 3. hiperbola, 4. ironia, 5. tautologjia, 6. paradoksi, 7. konotacioni / ngjyrimi (gjuhësor), 8. imazheria, 9. veçoritë sintaksore dhe 10. veçoritë e diskursit / ligjërimin (2015, fv. 17-24). Megjithatë, jo të gjitha këto veçori mund (dhe duhet) të gjenden patjetër tek çdo proverb i dhënë (Norrick, 2015). Nga proverbat e Bardhit, që ngërthen mjaft prej veçorive të përmendura mund të jepen p.sh. *Kush dro zjarrë, n' timit ikën* [72], *Merr penë ndë do me gjetunë lamshinë* [73], etj.

Një çështje tjetër shumë e rëndësishme është ajo e burimit të proverbove. Sigurisht që në fazën kur janë bërë mirëfilli ‘proverba’, ato mund të konsiderohen pjesë e pasurisë kulturore e folklorike të një populli. Gjithashtu proverbat mund huazohen apo kopjohen, proces që për shumë syresh mund të jetë mjaft i koklavitur për t’u ftilluar. Madje ato mund edhe

¹²¹ Në *Fjalorin e shqipes së sotme* (Thomai, etj., 2002, f. 1046) është hequr vetëm mbiemri “të mprehtë” i përkufizimit të mësipërm.

¹²² Shih p.sh. Tuda (1995, fv. 20-22; 1996, f. 713), Sako etj. (1984).

“të vdesin”, pra të mos përdoren më nga një komunitet i caktuar gjuhësor e kulturor. Por sidoqoftë, në “lindje”, siç thotë Mieder-i (2004, f. 9; 2015, f. 28) “Proverbat, (ashtu) si gjëgjëzat, lojërat (jokes) apo përrallat, nuk bien nga qielli dhe as nuk janë produkt i një shpirti mitik të popullit. Përkundrazi, ato janë gjithmonë të sajuara / krijuara, me ose pa dashje, nga një inivid. // Të gjithë proverbat zënë fill nga një individ mendjemprehtësia e të cilit pranohet e merret/përvetësohet si pjesë e urtësisë proverbiale të njerëzve të të gjitha shtresave.” Mieder-i procesin e krijimit të proverbave nuk e shikon ‘të përfunduar’ as në ditët e sotme (1993; 2015). Megjithatë ai tërheq vëmendjen se duhet pasur kujdes kur vjen puna te përcaktimi i burimit të një proverbi, duke sjellë në vëmendje edhe problematikën dhe diskutimet mbi origjinën e proverbave, përkatësisht mendimet kryesore të monogjenezës (origjinës nga një burim i vetëm për të gjitha variantet dhe motërzimet) dhe poligjenezës (origjinës nga burime të ndryshme të varianteve të ndryshme apo edhe të ngjashme) (Mieder, 2015, fv. 34, shih edhe 32v., me bibliografi).

Që proverbat, apo shprehjet që janë trajtuar si proverba në përmbledhjet paremiografike mund të kenë moshë të re, si dhe një referencë mjaft lokale, mund ta shikojmë, midis tjerash, edhe në përmbledhjen e Kamsit. Një shembull i një shprehjeje mjaft të re, kur marrim parasysh proverbat që u atribuohet një moshë relativisht e vjetër, është “Qyshë se ra termeku na u-muer bereqeti”, që patjetër lidhet me tërmetin fuqishëm të vitit 1905 në Shkodër; ose “Vajzë Rusit e ujë pusit”(Kamsi, 1943, fv. 16, 56), që i referohet një lagjeje të Shkodrës të krijuar në kohën osmane, pasi qyteti ka filluar të shtrihet gjerësisht drejt veriut në pjesën fushore. Në lidhje me shprehjen e dytë duhet të sjellim në vëmendje edhe versionin “Ujë Rusit e vajzë Dudasit” – varianti më i njohur dhe i përhapur, në fakt, i kësaj shprehjeje, apo varianti ‘zyrtar’ – duke vërejtur edhe ndryshimin e hasur te Kamsi. Shprehje si këto janë pjesë e kodit të komunikimit të banorëve të Shkodrës. Është mjaft me interes këtu të përmendet modifikimi që i bëri Kamsi (1943, f. 56) shprehjes së dytë, duke e kaluar “primatin e (virtytit dhe) bukurisë së vajzave” nga Dudasit në Rus – mbase e lidhur kjo, pa dashur të spekulojmë, me ndonjë përjetim vetiak të autorit – gjë që mund të konsiderohet edhe njëfarë inxhinierie e memories kolektive në lidhje me fenomene të ndryshme, përcjellëse dhe treguese të të cilave janë edhe proverbat dhe shprehjet e tjera popullore. Sidomos kur kemi parasysh që përmbledhja e Kamsit është ndër të rrallat përmbledhje dhe për kohën e vetmja e llojit të vet e (ri)botuar edhe me mbështetje institucionale shtetërore, përkatësisht të Ministrisë së Arsimit. Në përmbledhjen e Rrotës (1914), nga këta dy shembuj nuk kemi hasur

asnjërin. Nga këto shprehje (apo proverba) e para, “Qyshë se ra termeku na u-muer bereqeti”,¹²³ nëse ka qenë ndonjëherë e përhapur gjerësisht, ka dalë nga përdorimi për shkak të transformimit që qyteti i Shkodrës ka pësuar në shumë aspekte. Ndoshta është drejt harrimit edhe shprehja e dytë, “Ujë Rusit e vajzë Dudasit”.

Në këtë mënyrë kushti i “tradicionalitetit” (për mendimin tonë) resht së qeni kusht i domosdoshëm për çdo proverb shqip që mund të hasim në përmbledhjen e Bardhit. Për ne është i rëndësishëm ky vështrim, pasi nuk na detyron të vendosim si parakusht vjetërsinë e çdo proverbi të Bardhit në kohën kur përgatiti fjalorin, por mund të marrim a mendojmë si pikënisje edhe vetë Bardhin.¹²⁴

Proverbat, sado që kanë një variant që mund të jetë më i përhapur se variantet e tjerë, nuk janë ndërtime të ngurtësuara – trajta e ngurtësuar në fakt gjendet vetëm në përmbledhjet me proverba dhe ngurtësimi vjen si rezultat i regjistrimit me shkrim – (por) janë ndërtimë më një përqindje variacioni, duke u ndarë këtu nga shprehjet frazeologjike, që janë të ngurtësuara. Këtë veçori e mbajmë parasysh kur analizojmë vjetërsinë dhe vazhdimësinë e proverbave që hasen qysh te Bardhi.

Burimet dhe ndikimet

Sipas njohurive që kemi deri sot, Bardhi është i pari autor që bën një listë të mirëfilltë të proverbave / fjalëve të urta e shprehjeve të tjera të shkruara në gjuhën shqipe (Sako, Harito, & Haxhihasani, 1984, f. 266v.; Tuda, 1995, fv. 13-14).

M’anë tjetër, para *Institutionum*-it Megiser-i ka përgatitur një vepër tjetër me titull *Paroemiologia polyglottos...*, që është një përmbledhje e proverbave, fjalëve të urta dhe shprehjeve të tjera në disa gjuhë (Megiser, *Paroemiologia poliglotta*, hoc est: *Proversia et Sententia complurium linguarum*, 1605; Płaskowicka-Rymkiewicz, 1965, f. 63) dhe ku janë përfshirë edhe disa fjalë të urta në gjuhën turke.¹²⁵ Në këtë mënyrë, për

¹²³ Në të vërtetë nuk e dimë me siguri se sa ka qenë e përhapur në Shkodër kjo shprehje, përveç faktit që ka marrë një pasaportë nga përfshirja në përmbledhjen e Kamsit. Mbase do të ishte me interes të shqyrtohen edhe shprehje të tilla bashkë me kontekstin dhe zhvillimin e tyre.

¹²⁴ Sako etj., janë të mendimit se vepra e Bardhit “[n]a ndihmon për ta vendosë ekzistencën e fjalëve të urta që gjejmë në të, të paktën para kësaj date.” (Sako, Harito, & Haxhihasani, 1984, f. 278).

¹²⁵ Fjalët e urta këtu janë përmbledhur në 100 kaptina/tema (a çështje), e para e të cilave është *Deus* (Zoti). Bashkë me përsëritjet në nja dy vende, proverbat turke gjenden në 98 vende; numri i kaptinave ku janë përfshirë është më i vogël, shih Megiser (1605) dhe Dibra (2016, fv. 83-85).

kohën e vet Megiser-i mund të konsiderohet një autoritet i proverbave e fjalëve të urta apo së paku njohës i tyre në disa gjuhë klasike dhe bashkëkohore të kohës së tij. Një pjesë e proverbave dhe fjalëve të urta të *Institutionum*-it duket se janë përcjellë nga *Paroemiologia*. Por nuk është e mundur të thuhet me saktësi se nga i ka mbledhur Megiser-i këto proverba në gjuhën turke. Sipas Stein-it, e cila i ka kushtuar edhe një artikull të posaçëm fjalëve të urta të *Institutionum*-it:

“Lëvizja e Reformës në Gjermani kishte një interes të madh për gjuhën dhe letërsinë popullore. Nën këtë ndikim edhe Megiser-i duke zgjedhur fjalët e urta ilustruese për tekstin të përmbledhjes *Institutionum...* (Fashikulli III: ...*diversa linguae Turcicae Exertia...*) i është përshtatur shijes së kohës. Por, për fat të keq, për burimin e këtyre proverbave dhe njohurinë e turqishtes së Megiser-it mund të bëjmë vetëm supozime. E sigurt është që njihje turqishten e folur. Këtë e tregojnë edhe disa shënime të tijat. Por ai nuk thotë se si është njohur me këtë gjuhë/ si e ka njohur / mësuar këtë gjuhë, gjë që nuk e tregon/ndriçon as biografia e tij. Ai ka huazuar/marrë edhe pjesë nga veprat e autorëve të tjerë evropianë që janë marrë me turqishten (si p.sh.: B. Georgievits, J. Löwenklau, G. Postel). Por kjo shihet më fort në pjesën e fjalorit (Fashikulli IV: *Dictionarium ... latinu-Turcicum et ... Turcicu-Latinum*). Vetëm një proverb (nr. 5) i përket Georgievits-it. Mund të ketë pasur edhe shembuj nga manuskripte origjinale turqisht, por kjo nuk është e vërtetueshme plotësisht.” (Stein, 1984, fv. 55-56).

Fjalët e urta të Megiser-it gjenden edhe në veprat e autorëve të tjerë bashkëkohës, si Montalbano (1633) (Gallotta, 1986) e Maggio (1643). Është interesante lidhja mes këtyre veprave, përkatësisht listës me proverba e fjalë të urta që përmbajnë. Fillimisht është menduar që burimi i proverbave tek Montalbano është vepra e Megiser-it, por Stein (1994, fv. 211-212), duke pasur parasysh edhe veprën e Maggio-s, që proverbat turke i jep përgjithësisht më ortografi arabe-osmane, me pak shembuj të shoqëruar edhe me transkriptimin latin, si dhe divergjencat në ortografinë latine të Megiser-it e Montalbano-s, mendon këta autorë kanë përdorur një dorëshkrim origjinal turqisht, i cili sot për sot është i panjohur. Sidoqoftë, diskutimi rreth burimit të këtyre proverbave/shprehjeve është ende i hapur.¹²⁶

Për ne, kjo marrëdhënie e kësaj kohe (midis veprave të ndryshme) është e rëndësishme, kur marrin parasysh burimet e përgatitura për prezantimin a njohjen e gjuhës shqipe, nën kujdesin (apo me porosinë a direktivën) e Kongregacionit për Propagandën e Fesë dhe institucioneve të

¹²⁶ Stein, në dijeninë tonë, nuk i referohet kund *Paroemiologia*-s.

tjera për llogari të të cilave u përpiluan vepra kësodore. Karakteri i përgjithshëm i përmbajtjes së këtyre veprave i bën shembujt ilustrues, në rastin tonë proverbat në fjalë, mjaft të volitshëm për të bërë studime krahasuese e kontrastive. Duam të sjellim në vëmendje këtu veprën e mbetur në dorëshkrim të Da Monte Giove-s (1848) dhe proverbat e shprehjet/fjalët e urta që përmban, që i prezanton Dushi (2016, p. 117-119). Ky autor, megjithëse ka qëndruar në trojet shqiptare për një kohë të konsiderueshme, – 19 vjet – dhe më pas ka qenë profesor i gjuhës shqipe,¹²⁷ kur vjen fjala për përzgjedhjen e materialit ilustrues, në rastin tonë të proverbave, jep një listë që i përgjan shumë proverba e shprehjeve të tjera që ka lënë Bardhi në fjalorin e tij.

Në këtë rast ose kemi të bëjmë me një rastësi, ose me një zgjedhje të Da Monte Giove-s për t'i qëndruar besnik materialit të Bardhit (si folës i lindur i shqipes, si paraardhës në detyrë etj.), ose me një traditë a mode që diktonte përdorimin e burimeve të shkruara dhe përsëritjen e materialit të botuar apo përgatitur më parë, duke mos lënë shumë vend për shumë risi (mbase edhe për shkak se materialet paraardhëse kishin marrë miratimin e institucioneve përkatëse dhe ishin referenca të volitshme për ta bërë veprën e re njësoj të lejuar e të pranueshme). Dy mundësitë e fundit sugjerojnë që Da Monte Giove ta ketë njohur personalisht fjalorin e Bardhit, apo edhe të ketë përdorur një burim të ndërmjetëm që është mbështetur te Bardhi.

Fjalori i Bardhit, megjithëse gjerësisht është studiuar pas ribotimit të Roques-ut (1932), ka qenë i njohur edhe më parë. Një prezantim i tij të shkurtër, si një prej burimeve të gjuhës shqipe që ka përdorur në studimet e veta, ia bën Xylander-i (1835, f. V) e pas tij Miklošič-i, i cili jep edhe titujt të kapitujve të fjalorit, duke bërë në këtë rast ndreqjen e numërimit të kapitujve në pjesën e dytë, ku kapitulli VII është shkruar gabimisht VIII (1870, f. 3; 2007, f. 38). Meyer-i e përdor gjerësisht (Meyer, 1883; 2007). Një prezantim i bën edhe Mid'hat Frashëri (Skëndo, 1909, fv. 1-2).

Ka mundësi që ta ketë njohur edhe Nikollë Rrota në kohën kur ka përgatitur përmbledhjen me proverba e fjalë të urta shqipe, që botohet nga Gjergj Pekmezi në 1914-n në Vienë (Rotta, 1914). Vetë Pekmezi e ka njohur *Dictionarium*-in, po ashtu edhe vepra të tjera, ku janë mbledhur materiale folklorike, ndër to edhe proverba e fjalë të urta, si p.sh. veprën e Mitkos, etj. (Pekmezi, 1908, fv. 3-5; Manek, Pekmezi, & Stotz, 2010).

Proverbat e Bardhit i ka përdorur në veprën e tij edhe Kolë Kamsi (1943), duke shënuar edhe burimin. Por me sa kemi parë, jo të gjitha proverbat që mund t'i ketë marrë (edhe) nga Bardhi i paraqet si të këtij

¹²⁷ Shih Gega (1931, f. 222) dhe Roques (1932, fv. 6, shën. 6).

burimi, si p.sh., proverbin “Njëna dorë lanë tjetrën e të dyja lajnë faqet” (Shkodër) [B21: “Njana dorë lān tietërënë e të d̄yja lānjënë faqenē”], proverb që, të paktën prej rreth një shekulli e gjysmë është dokumentuar në disa burime dhe sot konsiderohet i mbarë shqipes.¹²⁸ Në botimin e parë që i bën përmbledhjes së proverbave në serinë e shkrimeve në revistën *Leka*, Kamsi nuk i ka përfshirë proverbat e Bardhit.¹²⁹ Ka mundësi që në këtë kohë të mos e ketë njohur ende me hollësi përmbajtjen e Fjalorit.

M’anë tjetër, duket se mbledhësit toskë të folklorit, si p.sh., Mitko, apostudiuesit e huaj si Dozon, etj., nuk e kanë njohur veprën e Bardhit.¹³⁰

Element i rëndësishëm në krahasimin e dy “korpuseve” me proverba/fjalë të urta/shprehje është varianti i tyre ‘i ndërmjetëm’ në gjuhën italiane e latine, që është thujse i njëjtë në të dy veprat (për shumicën e proverbave).

Bardhi nuk ka përdorur shprehjet e listës së Megiser-it që kanë gjegjëse vetëm në gjuhën gjermane. Kjo tregon që nuk e ka njohur këtë gjuhë. Por gjithashtu, mund të jetë një tregues që nuk e ka njohur fort mirë as gjuhën turke, edhe pse, siç e përmendëm më sipër, në disa shembuj të listës së vet, ne na duket se është mbështetur më shumë në variantin turqisht të shprehjeve që jep Megiser-i (shih më poshtë). Sidoqoftë, fjala e fundit për këtë çështje nuk duhet thënë vetëm duke u mbështetur në këtë tablo që paraqet *Dictionarium*-i, pasi ka një sërë faktorësh të tjerë që e bëjnë Bardhin të mbështetet më shumë në variantin latinisht e italisht se në atë turqisht, siç mund të jetë p.sh., afiniteti kulturor (shih edhe Dibra (2016, fv. 80, 83-84)).

Një prej diskutimeve rreth proverbave, por edhe frazeologjizmave, është çështja e huazimit të tyre. Konkretisht, në gjuhën shqipe dhe gjuhët e tjera të Ballkanit diskutohet huazimi i proverbave dhe frazeologjizmave edhe nga gjuha turke, apo diskutohen paralelizmat mes proverbave të gjuhës turke dhe atyre të gjuhëve të tjera të Ballkanit.¹³¹ Ndikimi i gjuhës dhe i

¹²⁸ Shih p.sh., FGJSSH, zëri ‘Dorë’; Mitko “Njëna dorë lan tjetrën, të dyja lajnë faqetë” (1878, f. 9); Dozon “Një dor’ lan tjetrën, të dya surranë” (1879, f. 122); Rrota “Njana dorë lanë tjetrën e të dyja lajnë faqet” (Rotta, 1914, f. 40).

¹²⁹ Për artikujt e Kamsit te *Leka* shih bibliografinë këtu.

¹³⁰ Dozon, duke iu referuar *Manualit...* të tij, ka njohur veprën e autorëve katolikë të Veriut dhe përmend Pjetër Bogdanin dhe *Cuneus prophetarum...* (1685), si dhe një përkthim të *Doktrinës së Krishterë* të vitit 1644, si veprat më të vjetra të gjuhës shqipe (1879, fv. 170, shën. 3).

¹³¹ Shih p.sh. Sandfeld (1968, fv. 159-162), i cili është ndër nismëtarët e qasjeve krahasuese që marrin në konsideratë edhe elementet e burimit turk, Kazazis (1972), Dizdari (2005), Kaleshi (Kaleshi, 1964) etj. Lloshi & Thomaj, në punimin e tyre mënjanojnë elementet e burimit turk, ose më saktë, me gjithë praninë e elementeve

kulturës turke mbi gjuhët dhe kulturën e popujve të Ballkanit ka ardhur si rezultat i shumë faktorëve (Kazazis, 1972, fv. 89-91). Një prej tyre është prestigji (prestigji gjuhësor dhe kulturor). Prestigji kulturor është, në fakt, faktor universal që ndikon në kopjimin e elementeve dhe veçorive të ndryshme nga një gjuhë në tjetrën, shih (Mieder, 2015).¹³²

Studime të folkloristëve dhe gjuhëtarëve të ndryshëm të trevave ballkanike janë përqendruar në ngjashmërinë e proverbave (dhe të frazeologjizmave) të gjuhëve të Ballkanit me ato në gjuhën turke, duke marrë në konsideratë edhe një ndikim të turqishtes mbi gjuhët e tjera.¹³³ Në disa raste huazimi bëhet duke e kalkuar shprehjen, në këtë rast proverbin, në disa raste kemi *kalkim të pjesshëm + huazim* (ose *huazim/kopjim + kalkim*) duke ruajtur një pjesë të elementeve në gjuhën dhënëse, në raste të tjera kemi marrje të plotë të shprehjes siç është në gjuhën dhënëse.¹³⁴ Përgjithësisht huazimet janë të evientueshme më me lehtësi, kur kemi kalkim dhe një element të gjuhës dhënëse, pasi huazimi është në mjaft raste një referencë e burimit të mundshëm. Ndërsa në rastet kur kjo referencë mungon, mund të mos merret vesh ndoshta aspak, që kemi të bëjmë me huazim (Kazazis, 1972). Në terminologjinë e Kazazis-it këto forma të huazimit / këto lloj huazimesh, që ai i merr në shqyrtim si *kalke*, quhen të dukshme / dallueshme (*overt*) dhe të padukshme / padallueshme

leksikore turke në frazeologjinë e shqipes, mendojnë se ndikimi i turqishtes ka qenë i kufizuar; por nga ana tjetër bëjnë konstatime me interes për mënyrën se si duhet bërë në përgjithësi qasja ndaj njërive paremiologjike në përgjithësi dhe atyre frazeologjike në veçanti (Lloshi & Thomaj, 1967, fv. 99-100 mund të shihet veçan për proverbat; diskutimi në lidhje me elementet turke 107-108). Ne mendojmë që burimi i këtyre ndërtimeve të tipit “folje shqipe + emër turk” (p.sh.: bëj qef, bëj sehir, bëj gajret, bëhem pishman, bëhem teslim, bëhem telef, të qoftë hallall etj.) që përmendin Lloshi e Thomaj (1967, fv. 107-108), është kryekëput nga gjuha turke, duke vajtur me mendimin e Berberit (1964, fv. 218-219), Kaleshit (1971, fv. 290-292) dhe për kalket në përgjithësi të Kazazis-it (1972, fv. 96-98), mendim që e shpreh edhe Sandfeld-i (shih në krye të shënimit).

¹³²Mieder, mes tjerash, shqyrton huazimin / kopjimin e proverbave amerikane nga gjermanët – dhe popullarizimin e tyre – nëpërmjet / në sajë të lehtësive që mundëson teknologjia, pra edhe ndikimin kulturor që vjen prej prestigjit të kulturës, në rastin tonë asaj amerikane (Mieder, 2015, f. 36).

¹³³ Shih për bullgarishten (Baklaciëv, 1982), rumanishten (Mehmet, 1982), serbishten (Oy, 1982), për gjuhët sllave (Eren, 1982; 1986), për gjuhët e Ballkanit në përgjithësi (Mahmut, 1976). Për paralele të proverbave shqipe me ato turke shih punimin e Hasan Kaleshit (Kaleshi, 1964, fv. 71-72) dhe të Gani Lyubotenit (Lyuboteni, 1987). Punimi i Lyubotenit përveç një qasjeje teorike, përmban edhe një listë prej 77 shembujsh me proverba e shprehje të tjera në turqisht e shqip (Lyuboteni, 1987, fv. 120-123).

¹³⁴ Këtë çështje e diskutojnë Kazazis (1972), Kaleshi (1964), Lory (2011), Baklaciëv (1982) etj.

(*covert*) (Kazazis, 1972, f. 96).¹³⁵

Urtësia e Bardhit

Kur marrin në shqyrtim proverbat e shprehjet e tjera të fjalorit të Bardhit, ne kemi parasysh së pari faktin që ai kryesisht është mbështetur në një përmbledhje të gatshme, të përgatitur nga një autor tjetër. Kur themi më sipër proverbat/shprehjet shqipe dhe gjegjëset e tyre në gjuhët përkatëse, për mjaft shembuj mendojmë duhet të kuptojmë në fakt të kundërtën, që proverbat/shprehjet shqipe janë gjegjëset e proverbave/shprehjeve në gjuhën latine, italiane e turke; së paku në aspektin kronologjik të prodhimit të veprave përkatëse. Vetëm për një numër të vogël proverbash/shprehjesh të Bardhit nuk kemi arritur të pikasim një gjegjëse në listën e Megiser-it: proverbat/shprehjet nr. 14, 75, 76, 77, 78, 79, 103 dhe 111 sipas listës së Bardhit. Këto proverba, në raport me pjesën tjetër të tekstit, meritojnë një diskutim më vete (shih më poshtë).

Duke pasur parasysh këtë fakt, natyrshëm lind pyetja se nga e mori Bardhi materialin në gjuhën shqipe që ka futur në listën e proverbave. Mundësitë duket se janë dy: 1. Ka përdorur materialin folklorik të shqipes, që do të thotë edhe se proverbat në fjalë kanë qenë tashmë ‘proverba’ qysh në atë kohë. 2. Ka bërë një përkthim a përshtatje të proverbave përkatës në gjuhë të huaj –italisht, latinisht ose turqisht – duke sajuar shprehje që kanë arritur më vonë stadin e proverbit, pasi ngadalë kanë gjetur pranim nga përdoruesit e shqipes / shqiptarët, apo edhe të tilla që nuk kanë “ngjitur” e që kanë rezultuar të pasuksesshme / “të pafat(a)” në këtë drejtim. Për rastin e dytë është mjaft me rëndësi të merret parasysh edhe mekanizmi i përhapjes së këtyre *shprehjeve të reja* në masën e folësve. Dimë se Bardhi, pasi kreu shkollimin në institucionet fetare përtej detit, u kthye në vendlindjen e vet, ku filloi të ushtronte detyrën e klerikut. Afërmendsh, si pinjoll i një familjeje të spikatur të zonës, por përveç kësaj, edhe si klerik katolik, mund ta mendojmë si një personazh me një staturë sociale, i cili merrte pjesë dhe i dëgjohej fjala në kuvendet (kuvendimet) lokale. Këto tubime mund të konsiderohen edhe si vendet ku janë bërë diskutimet më të rëndësishme e ku është përcjellë gjithashtu dija e brezave të mëparshëm dhe ajo e fituar rishtas prej brezave të mëvonshëm; gjithnjë në funksion të debatit, diskutimit apo edhe sfidës mes pjesëmarrësve. Këtu Bardhi e ka

¹³⁵ Shkruan Kazazis: “Until now we have been using the term ‘Turkism’ almost as if it referred exclusively to loanwords. Although the influence of Turkish on the Balkan languages has indeed been particularly strong in the domain of the lexicon, it was far from restricted to it. In fact, one could almost speak of ‘overt’ and ‘covert’ Turkisms, even though there is obviously no well-defined boundary between the two types.”

ilustruar mendimin e vet edhe me shprehjet e proverbat e huaja qe ka nxënë dhe madje i ka njohur mirë– proverbat janë shprehje që kanë nevojë për kontekste të tilla për t’u përdorur, nuk mund të përdoren siç tregohet, p.sh., një përrallë, por i shkojnë për shtat kontekstit të tyre¹³⁶. Këto shprehje janë pëlqyer e janë përhapur. Sigurisht, kjo është një skemë hipotetike e përhapjes së mundshme të proverbove, që mund të jetë kryekëput e pasaktë. Duke hamendësuar se sa ‘popullore’ kanë qenë proverbat e Bardhit, – d.m.th. sa janë njohur nga njerëzit e thjeshtë – ne marrin në konsideratë edhe përpjekjen e Bardhit për të sjellë në shqip këtë lloj materiali. Në disa raste kemi paraqitje mjaft të suksesshme të proverbove... Në raste të tjera një përcjellje pak më modeste të përmbajtjes proverbiale në gjuhën shqipe. Mjaft me rëndësi këtu është edhe struktura sintaksore e proverbove.

Një vështrim mbi proverbat

Për shkak të hapësirës së lejuar, këtu nuk mund të trajtojmë me hollësi të gjithë problematikën që lidhet me proverbat e Fjalorit të Bardhit. Do të mjaftohemi me cekjen e disa çështjeve që mendojmë se duhen marrë parasysh në mënyrë të veçantë.

Siç përmendëm më sipër (shih edhe Sh. Demiraj(2003), shënimi nr.118 këtu), me rëndësi është të bëhet një ndarje e materialit anas shqiptar nga ai i huazuar. Kjo detyrë nuk është krejt e thjeshtë, pasi për shumë proverba, origjina e hershme është mjaft e vështirë të përcaktohet.

Duke pasur parasysh listën e Bardhit dhe gjegjëset e Megiser-it, kemi veçuar disa proverba të Bardhit që te Megiser-i nuk kemi arritur t’i gjejmë: proverbat nr. 14, 75, 76, 77, 78, 79, 103, 111. Këto proverba mendojmë se duhen veçuar edhe për shkak të imazherisë që përdorin. *E dogj langu bushtërrë*. [14]; *Kur të shofshë veshtë veti, atëherë ke me e paam*. [75]; *Mos të mundoftë i munduemi*. [103] mund të konsiderohen edhe të kahershme. Imazheri të veçantë, që mund të konsiderohet popullore mendojmë se ka edhe tek *Tuk i dieg plakësë aty përket*. [113]; ky proverb për nga mesazhi mund të konsiderohet i njëjtë me proverbin “Ku dhemb dhëmbi vete gjuha”, të cilin e ka edhe Megiser-i (turq.)*Nerede diş ağırur onda dil dokunur*. [M127], por mjetet e përdorura për shprehjen e tij janë krejt të tjera (d.m.th., imazheria është tjetër).

Një grup tjetër proverbash janë ato që mund t’i konsiderojmë pa dyshim kopjime nga turqishtja. Në këta shembuj na ndihmojnë sidomos huazimet turke; por edhe konteksti kulturor që na e tregojnë objektet e proverbit. Prania e një fjalë të huazuar nuk duhet marrë doemos si shenjë a

¹³⁶ Shih për këtë Boratav (1969, fv. 128-129).

provë e huazimit edhe të njësisë paramiologjike.¹³⁷ Por në rastet kur e njëjta njësi gjendet edhe në gjuhën burim dhe nuk ka të dhëna të një huazimi të ndërsjellë, thënë ndryshe njëra gjuhë ka marrë njësinë leksikore nga një gjuhë tjetër dhe i ka dhënë kësaj njësinë paremiologjike, besojmë se nuk duhet ngurruar shumë në përcaktimin e kahjes së huazimit apo të kopjimit. Në rastin tonë, në shembullin e mëposhtëm kemi huazim të dyfishtë: edhe njësi leksikore, edhe njësi paremiologjike.

Në shembullin: *Maimuni nukë të zihetë mb lak*. Simia non capitur laqueo. [18] ↔ *Maynon (Maymun) tuzaga tutulmaz*. Simia non capitur laqueo. [M24], kemi edhe huazim edhe objekt që tregon kontekst kulturor jo anas në raport me kulturën shqiptare, pasi, afërmendsh, majmuni nuk është një kafshë e trevave të Ballkanit, ku jetojnë më së shumti dhe si anas shqiptarët. Nga ana tjetër, shqipja nuk ka huazuar një fjalë gjegjëse nga një gjuhë tjetër, po fjalën turke ‘majmun’, që ka pasuruar si standardin, ashtu edhe ligjërimin bisedor. Fjalori i Bardhit, në këtë rast, na ndihmon të përcaktojmë një kronologji (relative) të këtij huazimi.

Tek: *Vai aso shtëpie ku këndon pula e gjeli heshtën*. Guai à quella casa, dove la gallina canta el gallo tace. Turcicé. *Turghift. Vai a le fe handa taukuter horos dingler*. [106] ↔ *Vay ol efe handa tavik üter, horoz diñler*. Guaj à quella casa, dove la gallina canta e'l gallo tace. [M194], Bardhi ka përkthyer duke u mbështetur më shumë në variantin italisht. Në proverbin turqisht kemi ‘horos dingler’ [gjeli dëgjon], kurse në përkthimin italisht ‘e'l gallo tace’ [gjeli hesht], pra njësoj si në gjuhën shqipe, por nga ana tjetër elementet e tjera të proverbit, imazheria dhe mesazhi, janë identike. Një element tjetër i përbashkët i proverbit shqip dhe atij turqisht është pashirra ‘vaj’, e cila tek Dizdari (2005, fv. 1073-1074) jepet si turqizëm. Një grup tjetër proverbash janë ato mbi imazhin e ‘turkut’:

S duhetë me zanë besë as ujit, as turkut. Non bisogna fidarsi dell'acqua, ne manco, creder al Turcho. Turcicé. *Turghift. Sua daianana, otmanie inanana*. [96] ↔ *Suya dayanma, Otmanli'einanma*. Non bisogna fidarsi dell'acqua, ne manco credere a'Turchi. [M166];

Ku turku ve kambënë, aty s del bār. Doue il turcho pone il piede non nasce herba. [97] ↔ *Otmanlı bastuği yerde ot bitmez*. Dove il Turco pone il piede, non nasce herba. [M167]

Ndryshe nga ç'mund të mendohet, burimi i këtyre proverbave duhet kërkuar në vetë burimet turke. Siç u përmend më sipër, Stein mendon që Megiser-i, Montalbano dhe Maggio duhet të jenë mbështetur të e njëjta

¹³⁷ Shih diskutimin e Lloshit & Thomajt mbi këtë çështje, por duke pasur parasysh frazeologjizmat (1967, f. 102), për mendimin e këtyre autorëve mbi turqizmat dhe implikimin e tyre në frazeologji shih (1967, fv. 107-108), si dhe këtu shënimin nr. 131.

përmbledhje proverbash në gjuhën turke, e cila ende është e panjohur për ne. Por ky burim që përmend Stein-i është vetëm një prej përmbledhjeve të hershme. Një tjetër përmbledhje është një dorëshkrim i përfunduar në vitin 1480 (në Turqinë e sotme), nga një autor i panjohur për ne, dhe është botuar në vitin 1936 nga studiuesi turk Veled İzbudak (Başgöz, 1993, f. 130). Në këtë përmbledhje kemi disa proverba mbi ‘turkun’, që as në fillimet e shtetit osman, si koncept / fjalë nuk kishte gjithnjë të njëjtin kuptim, por ndryshonte në bazë të kontekstit, shih p.sh. Kalpaklı (2003) dhe Erdem (2005).

Në një grup tjetër mund të futen proverbat të cilave Bardhi ia ka modifikuar objektet (apo detaje të imazherisë, me gjasë duke pasur në mendje ekonominë shtëpiake të vendlindjes së vet), po ku imazhi dhe mesazhi janë të njëjtë me ato të proverbit turqisht.

P.sh.: *S ashtë i urtë ai gji mbërshel derënë e oborrit mbasi i vodhnë kënë o dhitë*. Non mostra prudenza colui, che serra la stalla doppo che é rubbato il cavallo. [108] ↔ *At oğurlanduktan sora ahur kapısını kaparsen*.¹³⁸ Doppo che é rubbato il cavallo, tu ferri la stalla. Nil juvat amisso claudere septa grege. (Gjerm.) [...]. [M202]. ‘Kali’ i proverbit turqisht në proverbin shqip të Bardhit është kthyer në ‘kanë o dhitë’, kurse ‘ahur’-i në ‘oborr’. Këto objekte lidhen me mënyrën e jetesës së kohës; kali në ekonominë shtëpiake të fshatit shqiptar ka qenë jo fort i përhapur, kryesisht për shkak të kostos së lartë; edhe Bardhi, kur ka bërë përkthimin në gjuhën amtare, me gjasë ka pasur në mendje ekonominë shtëpiake të vendlindjes së vet. Nga ana tjetër mesazhi dhe imazheria janë të njëjtat.¹³⁹

Një pjesë e proverbave turqisht të Megiser-it në përkthimin e Bardhit i kanë humbur tiparet e proverbit, gjë që e shohim edhe në përkthimin e ndërmjetëm në gjuhën italiane. Ndërkohë që në gjuhën turke, shprehja konsiderohet / është proverb i mirëfilltë.

P.sh.: *Shogji kã shumë arësye* [6] burimin e ka tek fjala e urtë / proverbi në gjuhën turke *Kumşu hakkı çoktur* [M8]¹⁴⁰, të cilën Megiser-i e përkthen *Il vicino ha molta ragione*, duke marrë fjalën turqishte *hak* me kuptimin “e drejtë, arsye”; kuptim të cilin kjo fjalë e ka edhe në gjuhën

¹³⁸ “Mbyll derën e ahurit mbasi është përcjellë kali / mbasi i ke dhënë lamturën, i ke lënë shëndenë kalit”. Sot më shumë në formën *At çalınduktan sonra ahırın kapısını kapamak* “Me mbyllë derën e ahurit mbasi është vjedhur kali”.

¹³⁹ Kjo nuk do të thotë që burimi i parë i këtij proverbi duhet të jetë patjetër varianti turqisht. Marvin-i origjinën e këtij proverbi e lidh me urtësinë greke të lashtë, që gjendet në rrëfimet (fabulat) e Ezopit (Marvin, 1922, fv. 182-183), për ne, sidoqoftë, jo fort bindës, pasi asnjë prej shembujve të dhënë nuk ka një njëjtën imazheri me “kalë”, “vjedhje” dhe “derë ahuri” / “derë oborri”, si në proverbin që diskutohet këtu.

¹⁴⁰ Tek Aksoy (1988, f. 367): *Komşu hakkı, Tanrı hakkı(-dır)*.

shqipe. Por te kjo fjalë e urtë / te ky proverb *hak* ka kuptimin (sipas kuptimeve që jep FGJSH) “e drejtë që më takon, ajo që meritoj”, njësoj si në gjuhën turke¹⁴¹; një variant përkthimi më i saktë do të ishte “E drejta e fqinjit (është) e drejta e Zotit” apo “Haku i fqinjit (është) haku i Zotit”.¹⁴² Marrëdhënia e mirë me fqinjin është teme që e trajtojnë edhe proverba të tjera me të hershmë në gjuhën turke., Në *Përmbledhjen e gjuhëve / dialekteve turkike* (1077) Mahmud Kashgari jep proverbin turk “*böri qoşnîsin yēmâs* “The wolf does not eat his neighbor (out of respect of his being a neighbor).” This is coined to advise someone to show respect for his neighbours.” [përkthimi sipas Dankoff dhe Kelly](Kashgari, 1984, f. 264).

Por tek Bardhi kemi edhe një variant më të plotë, me trajtë të mirëfilltë proverbi: *Ata të mirë gjë të baish fgjinjësë, Tinëzot ia ban.* Quel bene che fai al prossimo à Dio fai. [5]; Megiser-i e ka *Kumşu hakkı, Tanrı hakkı.* Quel bene che fai al vicino (al prossimo) a Dio fai. [M7] (shih më sipër).

Për një pjesë të proverbave është shumë e vështirë, shpeshherë e pamundur – të paktën për ne – të përcaktohet origjina, për shkak se këto proverba janë shumë të përhapura në kohë dhe hapësirë. Një shembull është “Peshku qelbet nga koka”. Këtë proverb e gjejmë si në burimet tona (Megiser nr. 59, Bardhi nr. 39), ashtu edhe në përmbledhjet me proverba në gjuhët shqipe, turke, gjuhët e tjera të Ballkanit, gjuhë të tjera të Evropës etj. Kaleshi (Kaleshi, 1964, f. 72) këtë proverb e sjell si huazim nga gjuha turke. Ne do të thoshim se aq sa është e mundur që mendimi i tij të jetë i saktë, po aq është e mundur që burimi i këtij proverbi në gjuhën shqipe të jetë krejt tjetër. Sidoqoftë, në asnjë gjuhë të Evropës ky proverb nuk duket se ka një histori shumë të hershme. Megiser-i në përmbledhjen e tij paremiografike, në pjesën mbi shembullin e udhëheqësit etj., [XXXI. Exemplum.] (1605, fv. 67-69) të ngjashëm me proverbin e mësipërm jep vetëm proverbin turqisht me përkthimin në gjuhën latine dhe një proverb italisht (f. 68): <*Turc.* Baluck balchdan kokar. i. | *Piscis primùm à capite putet* | *Ita.l* Il peſce comincia à putir dal capo.>.

Në analiza që kanë për synim të përcaktojnë kahet e ndikimeve gjuhësore, kulturore, etj., si në rastin e proverbit të mësipërm, por edhe të

¹⁴¹ Për këtë fjalë shih edhe shqyrtimin shterues që jep Dizdari (2005, fv. 333-335).

¹⁴² Këtu ka referencë te shumë *hadithe* (thënie profetike) të profetit Muhamed, në të cilët jepet e frymëzohet modeli islam i marrëdhënieve mes fqinjëve. Në një syresh profeti Muhamed thotë që “kaq shumë më ka këshilluar [engjëlli i shpalljes] Xhebraili/Gabrieli për fqinjin, sa që kujtova se fqinji do të bëhej edhe pjesëtar në trashëgiminë e pronës [familjare]”.

shumë shembujve të tjerë, duhet të merren parasysh shumë faktorë. Ndër ‘to, edhe klima e faktorët që lidhën më të, kur merret parasysh habitati i shoqërive që shqyrtohen; mënyra e jetesës dhe zakonet e këtyre shoqërive; pastaj historia e tyre, shqyrtimi i së cilës na mundëson të ndiqen kontaktet e subjektit nën shqyrtim me popuj/grupe të tjera.

Megjithatë duhet shtuar se ndonjë argument apo qëndrim të prerë kundër mendimit që mbështet Kalesshi nuk është dhënë në punimet që kemi pasur mundësi të shqyrtojmë.¹⁴³ Në disa raste, mendimet e dhëna në mënyrë të tërthortë dalin në argumentin e Kalesshit. Kemi parasysh këtu diskutimin e Grannes-it mbi një ndikim të mundshëm të proverbave të turqishtes mbi sintaksën e proverbave bullgare, ku si shembull jepet proverbi që po diskutojmë këtu “Balik baştan kokar” (Peshku qelbet nga koka) (Grannes, 1996, f. 24).¹⁴⁴

Shqyrtimi që jemi përpjekur të bëjmë na tregon se proverbat e kulturave të ndryshme, por sidomos atyre që kanë përkimë e ngjashmëri të konsiderueshme siç mendojmë se është në rastin e kulturës shqiptare dhe turke, por edhe asaj italiane me të dyja të parat, paraqesin ngjashmëri të mëdha në pjesën më të madhe të veçorive të proverbave. Kjo mund të vijë edhe prej universalitetit të mesazhit që përcjellin proverbat, që në fund të fundit, lidhen me perceptimin dhe përjetimin njerëzor mbi ato çka i ndodhin njerëzve përditë, shih më sipër §0, si dhe Mieder (2015, f. 32v.).

Ngjashmëritë në këtë fushë mund të jenë sa rezultat i ndikimeve të jashtme, po aq edhe i zhvillimeve të ngjashme paralele, apo edhe krejt të pavarura nga njëra-tjetra, në kohë e hapësira krejt të ndryshme (Mieder,

¹⁴³ Një trajtim interesant mbi këtë proverb e gjejmë tek Arora (1989), e cila, mes tjerash, diskuton edhe çështjen e vjetërsisë së proverbit “Peshku qelbet nga koka” në gjuhën greke, e përdorur në një kontekst debati politik në SH.B.A. Thotë Arora: “[But] a search through published sources assures us that there is indeed a Greek saying variously rendered into English as *Fish begin to stink at the head* or *Where does the fish begin to rot? At the head*. It is not clear precisely how “old” the saying is in Greek, but it is found in Latin in medieval times, with the same two variantions. It is also widely recored in Italian and its dialects, as well as in German, Hungarian, Albanian, Slovenian, Turkish, Persian, an among Arabic-speaking Jews in Tunisia. Although it seems in Spanish to have virtually diassapeared from modern tradition, it is preserved among Spanish-speaking Jews in Salonica, Budapest, Belgrade, and Istanbul [...]” (1989, f. 274)

¹⁴⁴ Kostov argues convincingly that the final position of the verb in Turkish neutral sentences and also in proverbs (balik baştan kokar ‘the fish rots from the head’), might have contributed to a more extensive use of the verb in this position also in Bulgarian proverbs, e.g. ribata ot glavata vonee (a literal translation of the Turkish proverb cite above). Kostov is well aware of the fact that the final position of the verb is also a feature of Slavic and other Indoeuropean languages [...]. (Grannes, 1996, f. 24), shih me bibliografi.

2015, f. 34). Për shumë shembuj proverbash sot është e pamundur të përcaktohet burimi. Fakti që një proverb në një gjuhë është dokumentuar me shkrim qysh hërët, nuk është patjetër argument që burimi i këtij proverb është ajo gjuhë. Megjithatë, dokumentimi i hershëm mundet në mjaft raste të jetë tregues i vjetërsisë dhe i origjinës; me mundësinë tonë të kufizuar për të ndriçuar fazat më të hershme të jetës njerëzore, nuk mund të bëjmë gjë tjetër veçse të pranojmë, të vetëdijshëm se mund të mos jetë patjetër e saktë, një kronologji relative që lidhet me dokumentimin që njohim, shih Marvin (1922, f. 3) dhe Mieder (2015) me bibliografi.

Një klasifikim i proverbave të Bardhit (sipas përdorimit)

Nëse shtrojmë një pyetje alternative të pyetjes që bejmë në titull: “A ka Bardhi ndonjë proverb origjinal shqiptar?”, mendojmë se përgjigja duhet të jepet duke pasur parasysh kriteret që marrim për bazë kur klasifikojmë materialin paremiologjik.

Përveç kriterëve kulturologjike, një rëndësi të veçantë kanë edhe kriteret gjuhësore dhe shprehëse (prozodike), ku mund të futen: ekonomia e shprehjes, sintaksa e fjalisë, stili, prozodia, prezenca apo jo e huazimeve dhe kalkeve nga një gjuhë që mund të konsiderohet si burimi i një proverbij etj. Në rastin e burimeve historike, siç është rasti i proverbave të Bardhit, ka rëndësi edhe përdorimi apo jo në ditët e sotme i proverbave që jepen në fjalor. Në fund të fundit çdo proverb që përdoret në gjuhën shqipe, cilido qoftë burimi, i përket shqipes, ashtu siç i përkasin huazimet leksikore e strukturore nga gjuhë të tjera. Sipas Mieder-it (2015, fv. 33-34):

“Every paremiographer putting together a national or regional proverb collection is faced with this troubling phenomenon. For example, the *Dictionary of American Proverbs* includes many proverbs originated in North America, but also lists British proverbs and many other proverbs that have been loan translated during past centuries. The title of this large compendium should more appropriately have been *A Dictionary of Proverbs Current or Found in America*, and the little book of *Vermont Proverbs* should have been called more precisely *Proverb Used and Registered in Vermont* that is not to say that an attempt was not made to record as many indigenous proverbs from the United States or from the small state of Vermont as possible. But as the proverb says, *Don't judge a book by its cover [or title]*, as it must simply be realized that the important matter is whether a proverb, no matter what its origin or date, is in fact known and used in a particular language. Naturally this also indicates the anger of trying to determine something like a national character or worldview by a set of proverbs, especially if that set

includes proverbs that are of general European or even global prominence.”

Një element që nuk mund ta përcaktojmë dot për proverbat e kohës së Bardhit është minimumi paremiologjik, ose minimumi i proverbave që njih një i rritur i zakonshëm.¹⁴⁵ Ky minimum është i ndryshueshëm edhe brenda një gjuhe, gjë që e shohim me proverba e shprehje të tjera që mund të jenë shumë lokale, të njohura e të përhapura vetëm në një zonë, kurse jashtë kësaj zone mbase krejt të panjohura ose të njohura me variante të tjera. Me një fjalë, duke pasur parasysh edhe sa u tha më sipër mbi mënyrën si mendojmë se duhet t'i qasemi proverbave, nuk mund të themi dot me siguri nëse edhe proverba që i mendojmë mjaft të njohura sot, kanë qenë të panjohura në atë kohë, ose proverba që nuk na kanë ardhur me një përdorim konsistent deri sot, kanë qenë edhe atëherë me përdorim fragmentar.

Shpeshherë ndodh që mbledhës të ndryshëm të folklorit një proverb ta kenë dhënë si të burimeve të ndryshme. Kjo është krejt normale, pasi mbledhësi shkruan vendin ku e ka mbledhur ose ku e ka marrë (shih edhe shembujt në shënimin nr.119). Ky fenomen ndodh më shumë me ato proverba që kanë mesazhe të urtësisë mbarënjerezore, mjaft të vështira për t'ia atribuar vetëm një kulture dhe gjuhe. Pjesë e këtij grupi proverbash janë në më të shumtën e rasteve edhe proverbat e Bardhit.

Proverbat e Bardhit mund të ndahen në tri grupe: 1. Proverba që përdoren edhe sot. 2. Proverba që i gjejmë në përmbledhje si ato të Rrotës (Rotta, 1914) dhe Kamsit (1943), por që nuk na rezulton të kenë një përdorim sot.¹⁴⁶ 3. Proverba që nuk përdoren më, ose me saktë, që nuk i kemi hasur në përmbledhje të ndryshme me proverba.

Këtu hasim një vështirësi, pasi nuk është shumë e lehtë të dallohet një proverb që përdoret ende nga një proverb që është përfshirë në antologji proverbash, por nuk përdoret më si dikur ose ka dalë nga përdorimi. Kjo vjen edhe se përmbajta e një minimumi paremiologjik sot mund të jetë shumë i ndryshëm nga përmbajtja e minimumit paremiologjik që mund të hamendësohet për kohën kur janë hartuar përmbledhjet. Sot rolin kryesor në edukimin e njerëzve e luan sistemi arsimor i njësuar, që në shumë

¹⁴⁵ Për 'minimumin paremiologjik' shih (Đurčo, 2015).

¹⁴⁶ Kjo mund të konsiderohet edhe e pamundur, sepse mospërdorimi, pasi kemi gjetur një shembull, është i pavërtetueshëm, ne mund të vërtetojmë vetëm rastet e përdorimit. Më këtë duam të vëmë theksin në një problem tjetër: atë të konsiderimit popullor të shqipes të një proverbi që e ka vetëm Bardhi dhe pa vërtetuar që dëshmohet prej burimesh të tjera, qoftë edhe nëpërmjet përdorimit sot.

aspekte duket se ndjek kahe njësuere madje edhe internacionaliste dhe njëfarësoj refuzon traditën vendore, që në raport me programet zyrtare arsimore mbahet në këmbë në një mënyrë disi “informale”. Librat me të cilët edukohen fëmijët, janë pjesë e programit gjuhësor, intelektual dhe kulturor që dëshiron të zbatojë shteti nëpërmjet institucioneve të veta; ato nuk kanë apo mund të mos kenë përmbajtje dhe kode të njëjta me mënyrën tradicionale të edukimit, që është zhvilluar në kontekste më pragmatike, që mund të lidheshin edhe me mbijetesën e komunitetit, dhe në një proces më të avashtë, ku ndoshta ka pasur më shumë përsëritje, duke mundësuar një asimilim më të plotë të dijes dhe të urtësisë që shoqëria pretendonte të zbatonte.¹⁴⁷ Po ashtu, edhe mënyrat a argëtimit dhe e kalimit të kohës së lirë, ashtu si mënyra e sigurimit të të mirave materiale, festimet e përvitshme, rastet e veçanta, si: lindja, martesja dhe vdekja, dikur kanë pasur më shumë material që po e quajmë tradicional folklorik. Sot janë futur në përdorim shprehje të tjera, të reja, që diktohen nga kultura e komunikimit dhe e përçimit të mesazhit me mjetet e teknologjisë bashkëkohore: kryesisht televizioni, rrjetet sociale, etj. mundësi të shkëmbimit të informacionit që krijohen nëpërmjet përdorimit të internetit.

Po japim këtu një shembull nga një përmbledhje proverbash të periudhës së socializmit, për mendimin tonë mjaft kuptimplotë: *Lenini është diell e hënë*; një shprehje që nuk futet fort lehtë në klasën e proverbave.¹⁴⁸ Një pasqyrë sado që të shkurtër – por duke pasur parasysh kohën kur është shkruar njëkohësisht një pikë reference inretesante – bën edhe shkrimi i Roucek-ut (1958); po ashtu sjellim në vëmendje edhe artikullin e Bowers-it (1989).

Nga proverbat që jep Bardhi disa syresh që mund të themi se përdoren edhe sot janë:¹⁴⁹

Të këq[hi]atë mbësonjënë. [15],¹⁵⁰Me mijtë ha e pi e treg mos ban. [20], Njana dorë lān tietërënë e të dÿja lānjënë faqenë. [21], Anëmiku plak s të bahetë kÿrrë mik; e ndë t u baftë, s bahetë i dëreitë. [22], Ma mirë me heshtunë, se shumë me folë. [24], Peshku mā parë qelbetë ndë kryet. [39], Kush ve ndë mulli doemos do përmielletë. [36], Dita e mirë njifetë ndënatënet. [41], Gjithë kafshënë me mot. [43], Kush ve kādalë, ve

¹⁴⁷ Nga literatura mjaft e gjerë sugjerojmë për këtë çështje Althusser (1971).

¹⁴⁸ Panajoti, Jorgo & Xhagolli, Agron (1983). *Fjalë të urta të popullit shqiptar*. Tiranë, cituar nga Friedman (1999, f. 139)

¹⁴⁹ Këtu si kriter për disa shembuj është marrë edhe përfshirja në fjalorin normativ të gjuhës shqipe. Përveç fjalorëve kemi përdorur edhe punimin e Spahiut (2008).

¹⁵⁰ Një variant më bashkëkohor: Pësimi bëhet mësim.

shëndosh. [46] (!), *Kush lën këmbiem, këmbiem des*. [49],¹⁵¹ *Duhetë me shtrëm kambëtë, sã kē të mbuluemitë*. [53], *Një gjind të kuituem, s pagunjënë një të pagueme*. [60],¹⁵² *Ku gjã s ashtë, gjã s gjindetë*. [63], *Dheu i zĩ e ban bukënë e bardhë*. [67], *Mialtëtë shumë herë ban me lëp̄m gishtatë*. [69], *Nja gūr s ban mūr*. [66], *Kush ban fosënë shogjit, vetë bie ndënëta*. [70], *Merr pënë ndë do me gjetunë lamshinë*. [73], *Ri shtremënë, e flet dëreit*. [74], *Uku gjimenë e ndërron, ma vesnë s e harron*. [93], *Digjetë bari i njomë ndëpër të thātët*. [95].

Proverba që i gjejmë në përmbledhje, përkatësisht te Rrota e Kamsi, por që duket se nuk përdoren më, të paktën me këtë variant apo me këto fjalë:

Njeri mbëledh e Zotynë përderdh. [3],¹⁵³ *Fialëtë janë grã, mã të bametë burra*. [28],¹⁵⁴ *Dëti, zijarmi, grueja, trĩ të këqia të mëdhã*. [58],¹⁵⁵ *Të dashunitë prei sã pãmit vien*. [84],¹⁵⁶ *I këmbiyemi gjithëherë ban darsmë*. [98],¹⁵⁷ *Shëgjeta e shtëme s këthen*. [102].¹⁵⁸

Proverba që nuk përdoren më; apo më saktë, që i kemi hasur në ndonjë burim dhe as nuk i kemi dëgjuar të përdoren. Këtu, në mënyrë pak subjektive, bëhet pjesë e vlerësimit edhe minimumi paremiologjik apo edhe bagazhi paremiologjik personal i autorit të këtij punimi. Mendojmë se do të ishte mirë të bëheshin punime me qasje statistikore edhe për të përcaktuar realisht sa vazhdojnë të njihen dhe ku, në cilat zona, qytete, nga cilat

¹⁵¹ E jep si të Bardhit edhe Kamsi (1943, f. 93), që jep si proverb të Toskërisë “Kush u lint i lenë ment s’mund i vënë” (f. 92); në këtë pjesë të përmbledhjes, me temë *Mendja, dija, pasija e marrija* (fv. 90-94), ku gjenden edhe proverbat e mësipërme Kamsi ka mbledhur mjaft proverba.

¹⁵² Rrota e ka “Nji qind qerr kasavet nuk i lajnë dy pare boxh” (sic!) (Rotta, 1914, fv. 40, nr. 554), njësoj edhe Kamsi “Nji qind qerr kasavet nuk i lajnë dy pare boxh” që e jep si proverb të Shkodrës (1943, f. 13).

¹⁵³ E kanë Rrota (Rotta, 1914, f. 38) dhe Kamsi (1943, f. 44) si fjalë të Shkodrës “Nieri mbledhë, Zotynë perderdhë”; te *Leka* Kamsi jep “Nieri mbledhë, Zotynë perdhredhë” (1938, f. 282).

¹⁵⁴ Kamsi (1943, f. 24) e jep si proverb të Bardhit.

¹⁵⁵ Kamsi (1943, f. 63), nga Bardhi.

¹⁵⁶ Kamsi (1943, f. 18), nga Bardhi. Në shqipe kemi proverba që kanë një logjikë të ngjashme: “Kur të pashë me sy, më ra në mend për ty”; Kamsi jep edhe “Hin e del e duku e mos u-ban i pa dashtun”, “Syt që s’shihen shpejt harrohen”, “Larg syvet, larg zëmret” (1943, fv. 18-19).

¹⁵⁷ Kamsi (1943, f. 93), nga Bardhi; po ashtu Kamsi jep si proverb toskë “S’është përditë Pashkë e Bajram” (1943, f. 68), kurse te Dizdari, po nga Jugu, “S’është përditë bajram” (2005, f. 61). Proverbi turqisht, përveçse te Megiser [M173], edhe në përmbledhjet bashkëkohore të proverbove turke (Aksoy, 1988, f. 232), është “Deliye her gün bayram” (Budallai bën festë përditë / Budallai e ka përditë festë).

¹⁵⁸ Kamsi (1943, f. 47), nga Bardhi; po aty si e gegërishtes “Fjala e guri ikën e nuk kapën”.

shtresa sociale etj., përdoren proverba, apo edhe shprehje proverbiale të ndryshme.

Nga këto proverba veçanërisht ato që trajtojnë temën e besimit fetar, që kanë pjesë të imazhit marrëdhënien e njeriut me Zotin, kanë qenë të përjashtuara sistematikisht nga sistemi arsimor i kohës para viteve 1990, për arsye që mendojmë se merren lehtë me mend dhe që nuk do të trajtohen me këtë rast. Ashtu si në veprën që i referohet, edhe Bardhi proverbat e para i ka nga kjo temë. Këtu futet deri diku edhe proverbi nr. [3] që japim në listën më sipër. Këto shprehje që jepen në listën me proverba burojnë nga mësimet të besimeve monoteiste, maksima rregulla etj.

Nga proverbat që nuk i kemi hasur kund tjetër janë:

Qish me gjukuem s kã me mëguem. [7], *Nieriu urtë gjithë kafshënë tendon.* [10], *Shkumë shtënë, ani të bãmëtë.* [12], *Maimuni nukë të zihetë mb lak.* [18], *Anëmiknë mos e qëll dhënë.* [19], *Skifteri s gjitetë mbas mizashit.* [23], *Gjithëkush duhetë të mbae pajë mieshtrë se vet.* [29], *Nja nierë gjë kã shumë fialë, nja i shurdhënë e mund.* [30], *Ato kafshë gjë bienë të dhuntunë s duhetë me i kuituem.* [32], *Qish do zogëla ò bilbili, ia bie predevëra.* [34], *Ani i keiq nukë thehetë.* [40], *Të vobegunë ku ta zanë nata, aty ashtë pëllasi i tã.* [62], *Kãli ashtë i atë gjë e kalon.* [65], *Lufta pã të dekunë s ashtë.* [83], *Kush kã hũ, s këcen.* [85], *Kali~t mirë s duhenë shpore.* [89], *Lufta e madhe ban painë e ambëlë.* [91], *Ende deleshit së njefunash ha uku.* [94], *S ashtë i urtë ai gjë mbërshel derënë e oborrit mbasi i vodhnë kãnë ò dhitë.* [108], *Ndë të pãsha tietër herë, kã me kienë e dyta herë.* [110].

Proverba me mesazh të ngjashën përdoren edhe në gjuhën shqipe, p.sh., “Ani i keiq nukë thehetë” ka të ngjashme “S’bie rrufeja në hithra”.

Struktura e (disa) proverbave

Disa proverba kanë një strukturë më elokvente se të tjera. “Sforcimi” strukturor mund të ketë ardhur për arsye të shumta, një prej të cilave është përshtatja në shqipe e një proverbi në gjuhë të huaj.

Nisur nga kjo veçori sintaksore e stilistike, proverbat “elokvente” i përkasin të tre grupeve të mësipërme. Ashtu siç gjejmë proverba më një sintaksë që ne naduket e sforcuar, p.sh., *Mialtëtë shumë herë ban me lëpëm gishtatë.* [69] ose *Ende deleshit së njefunash ha uku.* [94]. Por mund të themi që pjesa më e madhe qofshin edhe sajime apo përkthime, kanë strukturë të realizuar relativisht mirë.

Nuk i kemi hyrë këtu një analize mjaft të rëndësishme krahasuese e kontrastive si ajo që bën Friedman-i (1999), por mjaftohemi për momentin vetëm duke e sjellë punimin e tij në vëmendje. Po ashtu nuk kemi trajtuar

shumë çështje që lidhen me paremiologjinë shqiptare e që duhet të merren në shqyrtim.

Përfundim

Në përmbyllje mund të themi që Bardhi modelin për listën me proverba, siç e thotë edhe vetë, e ka marrë nga material në gjuhë të huaj. Ky material rezultoi që ka qenë i hartuar fillimisht në gjuhën turke dhe më pas është përkthyer a përshtatur në gjuhën latine, italiane e gjermane, sipas rastit, nga Megiser-i, hartuesi i veprës ku është mbështetur Bardhi.

Vetë Bardhi duket se ka përdorur si proverbat e shprehjet në gjuhën latine e italiane, ashtu edhe ato në gjuhën turke, duke i kthyer në shqipe ose duke gjetur proverba gjegjëse të shqipes. Një pjesë të tyre mendojmë se shqipja i ka kopjuar nga gjuhët në fjalë. Një arsye është se një pjesë e proverbave që jep Bardhi kuptohen më mirë kur marrin parasysh variantin e tyre turqisht, apo edhe në gjuhët tjera.

Në një pjesë të proverbave Bardhi mbështetet në variantin e tyre latinisht apo italisht, që ne e quajmë variant “të ndërmjetëm”.

Për vetë natyrën e një materiali si proverbat dhe fjalët e urta, është mjaft e vështirë të gjendet burimi në rastin kur hasen në më shumë se një gjuhë. Kjo lloj analize e tyre ndryshon mjaft nga, fjala vjen, ajo e shprehjeve frazeologjike. Për gjuhën shqipe kjo është pak më e ndërlikuar, pasi një burim i vetëm nuk është i mjaftueshëm për të dhënë gjykime të prera mbi këtë çështje. Paremiologët janë të vetëdijshëm për këtë, madje edhe për rastet kur ka më shumë se një burim të shkruar, edhe kur ka burime shumë të hershme.

Një pjesë e proverbave të *Dictionarium*-it vazhdojnë të përdoren edhe sot. Një pjesë duket se nuk janë në përdorim. Është pak e vështirë të thuhet se nëse janë futur apo jo në përdorimin popullor proverbat apo shprehjet e grupit të dytë (këtu përgjithësisht **§Error! Reference source not found.**) dhe nëse po, kur mund të kenë reshtur së përdoruri.

Në lidhje me proverbat që vazhdojnë të përdoren, përsërisim edhe njëherë që çdo proverb që përdoret në gjuhën shqipe, cilido qoftë burimi, i përket shqipes dhe rëndësi, më së pari, ka të shihet si pasuri e gjuhës dhe të njihet e të përdoret si duhet. Më pas të bëhen përpjekjet për t'i gjetur origjinën, përçapje të cilat mund të mos na çojnë kurrë te burimi i vërtetë i proverbit, për shkak se proverbat e Bardhit janë në shumicën e tyre proverba me referenca universale, që nuk i atribuohen lehtë një gjuhë e kulture të vetme.

Bibliografi:

- Aksoy, Ö. A. (1988). *Atasözleri ve deyimler sözlüğü: I Atasözleri sözlüğü*. İstanbul: İnkılap.
- Althusser, L. (1971). Ideology and ideological state apparatuses (Notes towards an investigation). Në *Lenin and Philosophy and other Essays* (B. Brewster, Përkth., fv. 127-186). London - New York: Monthly Review Press.
- Arora, S. L. (1989). On the importance of rotting fish: A proverb and its audience. *Western Folklore*, 48(4), 271-288.
- Baklaciçev, S. (1982). Bulgarca ve Türkçe Atasözlerinde Bağlantı. Në *II. Milletlerarası Türk Folklor Kongresi Bildirileri - II. Cilt Halk Edebiyatı* (fv. 45-52). Ankara: Kültür Bakanlığı.
- Başgöz, İ. (1993). Proverb image, proverb message, and social change. *Journal of Folklore Research*, 30(2/3), 127-143.
- Berberi, D. (1964). *Phonological and morphological adaptation of Turkish loanwords in contemporary Albanian Geg dialect of Kruja: A synchronic analysis*. Ph.D. Thesis: Indiana University.
- Boratav, P. N. (1969). *100 Soruda Türk Halkedebiyatı*. İstanbul: Gerçek Yayınevi.
- Boratav, P. N. (2007). *Nasreddin Hoca* (bot. i 5). İstanbul: Kırmızı.
- Bowers, S. R. (1989). Stalinism in Albania: Domestic affairs under Enver Hoxha. *East European Quarterly*, 12(4), 441-457.
- Chase, W. J. (1922). *The Distichs of Cato, a famous medieval textbook (Translated from Latin, with introductory sketch)*. Madison: University of Wisconsin.
- Demiraj, B. (Re.). (2008). *Dictionarium Latino-Epiroticum (Romæ 1635) Per R. D. Franciscum Blanchum*. Shkodër: Botime Françeskane.
- Demiraj, S. (2003). Frano Bardhi - veprimtar i shquar i kulturës. Në *Gjuha shqipe, probleme dhe disa figura të shquara të saj* (fv. 168-176). Tiranë: Globus R.
- Dibra, F. (2016). Mbi burimin e Fjalorit të Frang Bardhit: Një qasje turkologjike. *Hylli i Dritës*, 36(2), 71-108.
- Dizdari, T. (2005). *Fjalori i orientalizmit në gjuhën shqipe*. Tiranë: AIITC.
- Dozon, A. (1879). *Manuel de la langue chqipe ou albanaise: grammaire - vocabulaire, chrestomathie*. Paris: Ernest Leroux.
- Đurčo, P. (2015). Empirical research and paremiological minimum. Në H. Hrisztova-Gotthardt, & M. A. Varga (Red.), *Introduction to paremiology: A comprehensive guide to proverb studies* (fv. 183-205). Warsaw-Berlin: De Gruyter.
- Dushi, L. (2016). Fjalori italisht-shqip i Luca da Monte Giove (Dorëshkrim i vitit 1848) - (Pjesa e dytë). *Hylli i Dritës*, 36(2), 109-120.
- Erdem, H. (2005). Osmanlı Kaynaklarından Yansıyan Türk İmaj(lar)ı. Në Ö. Kumrular (Re.), *Dünyada Türk İmgesi* (fv. 13-26). İstanbul: Kitap Yayınevi.
- Eren, İ. (1982). Güney İslav Atasözleri ve Deyimlerinde İstanbul. Në *II. Milletlerarası Türk Folklor Kongresi Bildirileri - II. Cilt Halk Edebiyatı* (fv. 167-176). Ankara: Kültür ve Turizm Bakanlığı.
- Eren, İ. (1986). Güney İslav Atasözleri ve Deyimlerinde Nasreddin Hoca. Në *III. Milletlerarası Türk Folklor Kongresi Bildirileri - II. Cilt Halk Edebiyatı* (fv. 101-114). Ankara: Kültür ve Turizm Bakanlığı.

- Friedman, V. A. (1999). Proverbial evidentiality: On the gnomic uses of the category of status in languages of the Balkans and the Caucasus. *Mediterranean Language Review*, 11, 135-155.
- G.= Gega, A. (1931). Mësimi i gjuhës shqype në Romë në shek. XVIII-XIX. *Hylli i Dritës*, 7(4), 215-222.
- Gallotta, A. (1986). Latin harfleri ile yazılmış bir kaç Osmanlı atasözü. *İstanbul Üniversitesi Türk Dili ve Edebiyatı Dergisi 1980-1986*, 24-25, 235-249.
- Grannes, A. (1996). Turkish influence on Bulgarian. Në *Turco-Bulgarica. Articles in English and French concerning Turkish influence on Bulgarian* (fv. 1-30). Wiesbaden: Harrassowitz.
- Hrisztova-Gotthardt, H., & Varga, M. A. (Red.). (2015). *Introduction to paremiology: A comprehensive guide to proverb studies*. Warsaw-Berlin: De Gruyter.
- Kaleshi, H. (1971). The importance of Turkish influence upon word formation in Albanian. *Balkanica*, 2, 271-293.
- Kaleşi, H. (1964). Arnavut Edebiyatında Türk Etkileri. Në *X. Türk il Kurultayında Okunan Bilimsel Biliriler 1963* (fv. 61-74). Ankara: Türk Tarih Kurumu Basımevi.
- Kalpaklı, M. (2003). Turk and Ottoman: a brief introduction to their image in the Ottoman Empire. Në M. Soykut (Re.), *Historical image of the Turk in Europe: 15th century to the present (Political and civilizational aspects)* (fv. 13-18). İstanbul: Isis Press.
- Kamsi, K. (1931). Goja e kombit t' onë: Bujqsija e gjâja e gjallë. Zanati e tregtija. *Leka*, 3(9), 279-281.
- Kamsi, K. (1931). Goja e kombit t' onë: Familja. Shtepija e vëndi. *Leka*, 3(4), 114-118.
- Kamsi, K. (1931). Goja e kombit t' onë: Gjâja e fitimi. *Leka*, 3(11), 342-344.
- Kamsi, K. (1931). Goja e kombit t' onë: Puna e pritesa. *Leka*, 3(6), 176-179.
- Kamsi, K. (1931). Goja e kombit t' onë: Puna e pritesa. Bujqsija e gjâja e gjallë. *Leka*, 3(8), 246-248.
- Kamsi, K. (1932). Goja e kombit t' onë: Bashkimi, shoqnija e besa. *Leka*, 4(10), 320-321.
- Kamsi, K. (1932). Goja e kombit t' onë: Fjalë popullore qi u-përshtaten kombevet të hueja si edhe lumebet e vendevet të ndryshme të Shqipnís. *Leka*, 4(7-8), 230-235.
- Kamsi, K. (1932). Goja e kombit t' onë: Gjâja e fitimi. Roja e kursimi. *Leka*, 4(1), 20-23.
- Kamsi, K. (1932). Goja e kombit t' onë: Tamahi. Borxhi, uhaja e dorzanija. *Leka*, 4(4), 122-124.
- Kamsi, K. (1932). Goja e kombit t' onë: Të mirët e të këqít. *Leka*, 4(12), Goja e kombit t' onë: Të mirët e të këqít.
- Kamsi, K. (1933). Goja e kombit: Dashtnija. Krenija, duka e lavdi. *Leka*, 5(11-12), 383-384.
- Kamsi, K. (1933). Goja e kombit: Fati. Haeja, pija e vesha. *Leka*, 5(6), 190-192.
- Kamsi, K. (1933). Goja e kombit: Haeja, pija e vesha. Jeta, shëndeti e lëngatët. *Leka*, 5(8), 260-262.
- Kamsi, K. (1933). Goja e kombit: Koha e rasat e jetës. *Leka*, 5(4), 122-123.
- Kamsi, K. (1933). Goja e kombit: Rinija e pleqsija. *Deka*. *Leka*, 5(9-10), 321-323.
- Kamsi, K. (1934). Goja e kombit: E vërteta e rrëna. *Leka*, 6(2), 61-62.
- Kamsi, K. (1934). Goja e kombit: Idhnimi e smira. *Leka*, 6(5), 168-169.

- Kamsi, K. (1934). Goja e kombit: Miku e anmiku. *Leka*, 6(11), 400-402.
- Kamsi, K. (1934). Goja e kombit: Përbûjtinja. *Leka*, 6(8), 279.
- Kamsi, K. (1935). Goja e kombit: E keqja e nevoja. E mira, e liga e dhuna. *Leka*, 7(7), 301-304.
- Kamsi, K. (1935). Goja e kombit: Ndera e bâmirsija. Urtija. *Leka*, 7(10), 429-430.
- Kamsi, K. (1935). Goja e kombit: Vobsija. *Leka*, 7(6), 252-253.
- Kamsi, K. (1936). Goja e kombit t' onë: Dijsja, padijsja e marrijsja. Shamata, gjygsji e ndëshkimi. *Leka*, 8(12), 550-552.
- Kamsi, K. (1936). Goja e kombit t' onë: Goja – gjuha – fjala. *Leka*, 8(8), 375-378.
- Kamsi, K. (1936). Goja e kombit t' onë: Miradijsja e pamiradijsja. *Leka*, 8(9), 403.
- Kamsi, K. (1936). Goja e kombit t' onë: Nderi. Turpi. Vesi. *Leka*, 8(5), 234-235.
- Kamsi, K. (1936). Goja e kombit t' onë: Pasunija. *Leka*, 8(3), 123-124.
- Kamsi, K. (1936). Goja e kombit t' onë: Qindresa e durimi. *Leka*, 8(1), 31-32.
- Kamsi, K. (1937). Goja e kombit t' onë: Shamata, gjygsji e ndeshkimi. Fjalë e të bame. *Leka*, 9(2), 83-84.
- Kamsi, K. (1937). Goja e kombit t' onë: Trimnija, fuqija e frika. *Leka*, 9(4), 181-183.
- Kamsi, K. (1938). Goja e kombit t' onë: Fejsja. Gjendjsja e jetës së nierzvet. Gjumi e pushimi. Hainija. *Leka*, 10(6-7), 282-284.
- Kamsi, K. (1938). Goja e kombit t' onë: Këshilli, ndigjesa, qortimi. *Leka*, 10(8-9), 407.
- Kamsi, K. (1939). Goja e kombit t' onë: Fajsi e ndeshkimi. Qeverijsja. *Leka*, 11(4), 112.
- Kamsi, K. (1939). Goja e kombit t' onë: Nxitimi. *Leka*, 11(1), 34.
- Kamsi, K. (1943). *Folklorë – Përmbledhjsja vrojtimsesh përmbi zakonet edhe giuhen popullore të botueme në Rivistën "Leka" nder 11 vjetët e para – IV Gojsja e popullit t'onë (Proverba)*. Shkodër: Botim i Ministris s'Arsumit.
- Kashgari, M. (1984). *Maħmūd al-Kāşğari: Compendium of Turkic dialects (Dīwān Luyāt at-Turk) / Maħmūd el-Kāşğari: Türk şiveleri lügati (Dīvānū Luyāt-it-Türk)* (Vëll. i 2). (R. Dankoff, J. Kelly, Red., R. Dankoff, & J. Kelly, Përkh.) Cambridge: Harvard University.
- Kazazis, K. (1972). The Status of Turkisms in the Present Day Balkan Languages. Në H. Birnbaum, & S. Vryonis (Red.), *Aspects of the Balkans. Continuity and change - Contributions to the International Balkan Conference held at UCLA, October 23-28, 1969* (fv. 87-116). The Hague - Paris: Mouton.
- Lloshi, X., & Thomaj, J. (1967). Paralele frazeologjike të shqipes me gjuhë të tjera të Ballkanit. *Studime Filologjike* (1), 97-112.
- Lory, B. (2011). XIX Yüzyılda Osmanlı Balkanları'nda Türkçe Konuşmak. Në F. Georgeon, & P. Dumont (Red.), *Osmanlı İmparatorluğu'nda Yaşamak* (M. Selen, Përkh., bot. i 5, fv. 291-306). İstanbul: İletişim.
- Lyuboteni, G. (1987). Türk ve Arnavut atasözleri arasında bazı paralellikler üstüne. Në *Beşinci Milletler Arası Türkoloji Kongresi (23-28 Eylül 1985) - I. Türk Dili, Cilt 2* (fv. 111-124). İstanbul: Edebiyat Fakültesi Basımevi.
- Maggio, F. M. (1643). *Syntagmaton Linguarum Orientalium, quae in Georgiae regionibus audiuntur liber secundus. Arabum et Turcarum Orthographicam ec Turcicae linguae Institutiones*. Romae: Ex Typographia Sacrae Congregationis de Propaganda Fide.

- Mahmut, N. (1976). Fıkra (Anekdotik) Atasözlerinin Özellikleri. Në *I. Milletlerarası Türk Folklor Kongresi Bildirileri - II. Cilt Halk Edebiyatı* (fv. 173-179). Ankara: Kültür Bakanlığı.
- Manek, F., Pekmezi, G., & Stotz, A. (2010). *Bibliographija shqype / Albanesische Bibliographie* (bot. i 2 [1. 1909, Wien]). Shkodër: Botime Françeskane.
- Marvin, D. E. (1922). *The antiquity of proverbs. Fifty familiar proverbs and folk sayings with annotations and lists of connected forms, found in all parts of the world.* New York - London: G. P. Putnam's Sons.
- Megiser, H. (1605). *Paroemiologia poliglotta, hoc est: Proversia et Sententia complurium linguarum.* Leipzig.
- Megiser, H. (1612). *Institutionum linguae Turcicae libri quatuor.* [Leipzig].
- Mehmet, A. M. (1982). Türk-Romen Kültür İlişkileri: Benzer Atasözleri ve Deyimlerden Örnekler. Në *II. Milletlerarası Türk Folklor Kongresi Bildirileri - II. Cilt Halk Edebiyatı* (fv. 297-305). Ankara: Kültür Bakanlığı.
- Meyer, G. (1883). *Albanesische Studien I. Die Pluralbildungen der albanesischen Nomina.* Wien: Carl Gerol's Sohn Buschändler der Kais. Akademie der Wissenschaften.
- Meyer, G. (2007). *Fjalor etimologjik i gjuhës shqipe.* (A. Omari, Përkth.) Tiranë: Çabej.
- Mieder, W. (1993). *Proverbs are never out of season. Popular wisdom in the modern age.* New York - London: Oxford University Press.
- Mieder, W. (2004). *Proverbs - A handbook.* Westport, Connecticut - London: Greenwood Press.
- Mieder, W. (2015). Origin of proverbs. Në H. Hrisztova-Gotthardt, & M. A. Varga (Red.), *Introduction to paremiology: A comprehensive guide to proverb studies* (fv. 28-48). Warsaw-Berlin: De Gruyter.
- Miklošič, F. (2007). *Gjurmime Shqiptare - Albanische Forschungen.* (S. Gashi, Përkth.) Prishtinë - Ljubljana: Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës - Slovenska Akademija Znanosti in Umetnosti.
- Miklosich, F. (1870). *Albanesische Forschungen. I. Die slavischen Elemente im Albanesischen.* Wien: Kaiserlich-Königlichen Hof- und Staatsdruckerei.
- Mitko, T. (1878). *Αλβανική μέλισσα (Βηλιεττα Σςκιυπητάρε) [Bleta shqipëtare].* Aleksandri [Αλεξάνδρεια]: Ξενοφώντος Ν. Σαλτη.
- Norrick, N. R. (2015). Subject area, terminology, proverb definitions, proverb features. Në H. Hrisztova-Gotthardt, & M. A. Varga (Red.), *Introduction to paremiology: A comprehensive guide to proverb studies* (fv. 7-27). Warsaw-Berlin: De Gruyter.
- Oy, A. (1982). Türk ve Sırp Atasözleri Benzerliğine Bakışlar. Në *II. Milletlerarası Türk Folklor Kongresi Bildirileri - II. Cilt Halk Edebiyatı* (fv. 319-330). Ankara: Kültür Bakanlığı.
- Pekmezi, D. [. (1908). *Grammatik der albanesischen Sprache, Laut- und Formenlehre.* Wien: Dija.
- Płaskowicka-Rymkiewicz, S. (1965). État des recherches concernant la parémiographie et parémiologie turques. *Rocznik Orientalistyczny*, 28(2), 59-74.
- Roques, M. (1932). *Recherches sur le anciens textes albanais – avec huit fac-similés.* Paris: Librairie Orientaliste Paul Geunther.

- Roques, M. (2008). Frang Bardhi dhe fjalori i tij. Në B. Demiraj (Re.), *Dictionarium Latino-Epiroticum (Romæ 1635) per R. D. Franciscum Blanchum* (W. Kamsi, Përkth., fv. 9-49). Shkodër: Botime Françeskane.
- Rotta, N. (1914). *Albanische Sprüche und Redensarten*. (G. Pekmezi, Re.) Wien: Josef Roller.
- Roucek, J. S. (1958). The sovietization of Albanian education. *The Slavic and East European Journal*, 2(1), 55-60.
- Sako, Z. (1984). *Studime për folklorin*. (M. Gërcaliu, & Q. Haxhihasani, Red.) Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë Instituti i Kulturës Popullore.
- Sako, Z., Harito, K., & Haxhihasani, Q. (1984). Fjalët e urta të popullit tonë. Në Z. Sako, M. Gërcaliu, & Q. Haxhihasani (Red.), *Studime për folklorin* (fv. 265-281). Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë Instituti i Kulturës Popullore.
- Sandfeld, K. (1968). *Linguistiques balkanique: problèmes et résultats* (bot. i 2). Paris: La Société de Linguistique de Paris.
- Skëndo, L. (1909). Istori e shkrimit shqip. *Diturija*, 1(1), 1-6.
- Spahiu, A. (2008). *Fjalët e urta në FGJSSH*. Gjetur në http://www.shkenca.org/pdf/gjuhe/fjalet_e_urta.pdf
- Stein, H. (1984). Eine Türkische sprichwortsammlung des 17. Jahrhunderts. *Acta Orientalia Academiae Scientiarum Hungaricae*, 38(1-2), 55-104.
- Stein, H. (1994). Zur Frage der gegenseitigen Abhängigkeit türkischer Transkriptionstexte. Në C. Wunsch (Re.), *XXV. Deutscher Orientalistentag. Vorträge, München 8.-13.4.1991* (fv. 203-214). Stuttgart: Steiner.
- Thomai, J., Samara, M., Kole, J., Daka, P., Haxhillazi, P., Shehu, H., . . . Hidi, A. (Red.). (2002). *Fjalor i shqpes së sotme*. Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë.
- Tuda, R. (1995). *Çështje paremiologjike*. Tetovë: Bashkësia Kulturore Shqiptare.
- Tuda, R. (1996). Fjala e ürtë në hapësirën ballkanike. Në *Seminari XVIII ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare (Përmbledhje e ligjëratave, referimeve, kumtesave dhe e diskutimeve. Tiranë 19-31 gusht 1996)* (fv. 713-720). Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë - Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Filologjisë.
- Xyländer, J. R. (1835). *Die Sprache der Albanesen oder Schkipetaren*. Frankfurt am Main: Andreäichen Buchhandlung.

Whose is the wisdom of the proverbs in the Frang Bardhi's dictionary?

ABSTRACT

The present article is a an attempt to investigate the origin and the development / continuity up to recent times (20th century) of the Albanian proverbs (from the proverbs in Latin-Italian-Albanian and sporadically in Turkish) included in the Frang Bardhi's *Dictionarium Latino-Epiroticum* (Rome, 1635) – the first known dictionary of Albanian. This bulk of proverbs is compared with the Turkish proverbs of the Turkish-Italian-

Latin-German proverbs found in *Institutionum lingua Turcicae libri quatuor* (Liepzig, 1612), the first printed grammar of Turkish prepared by Hieronymus Megiser. The scholars dealing with the *Dictionarium*'s Albanian proverbs have seen them mostly as part of an original Albanian stock, collected by Bardhi, and accepted the *Dictionarium* as a *terminus*. Other scholars – not necessarily dealing with the *Dictionarium*'s material – considered the similarity between Albanian and Turkish proverbs as a sufficient evidence of the Turkish origin of the Albanian proverbs (any of their examples coincides with the Bardhi's proverbs).

The main aim of the actual contribution is to suggest a different perspective while dealing with the material of the *Dictionarium*, as the proverbs of the two works are not merely two main lists of proverbs in the given languages: actually Bardhi's *Dictionarium* is a partial translation of Megiser's *Institutionum*, and, in a first sight, so may be the proverbs.

Considering the image (imagery) and the semantic, lexical, linguistic and prosodic properties of the proverbs, the current study suggests that the Albanian proverbs in some instances may be copies (translations or borrowings) of the Turkish proverbs, or of their corresponding and sometimes potentially mediator versions in Latin or Italian, but in some other instances may be a product of independent or not easily traceable cultural, social and linguistic developments. The similarities between the Bardhi's Albanian proverbs and the Turkish proverbs must be scrutinized carefully and in a wide(r) perspective. In the case of Bardhi's work, the continuity or discontinuity up to date of the proverbs may not always be indisputable criterion of an Albanian or foreign origin of the proverbs; and this may also be valid in the case of their linguistic and prosodic realization. In this fashion Bardhi didn't simply collect and transmit the wisdom of his people, he also tried to enrich it by collecting and transmitting the wisdom of other peoples and languages.

The outcome of the analysis shows that some proverbs seem indisputably of Turkish origin, on the other hand very similar Albanian and Turkish proverbs can be found in one or more other modern and ancient languages and the origin and the spreading direction(s) of these proverbs cannot be indisputably established. There are a few Albanian proverbs which don't seem correspond to any of the Megiser's proverbs. These proverbs perhaps may be considered of a different layer.

Keywords: *Dictionarium Latino Epiroticum*, paremiology, Albanian proverbs, Turkish proverbs, *Institutionum lingua Turcicae libri quatuor*.

Mimoza PUTO

PASQYRIMI I VEPRËS DHE FIGURËS SË SHKRIMTARIT TË NJOHUR SHQIPTAR, ISMAIL KADARE, NË GAZETËN SPANJOLLE “EL PAÍS”

Hyrje

Në këtë artikull do të trajtoj se si e ka pasqyruar gazeta spanjolle, “El País” veprën letrare të Ismail Kadaresë, shkrimtarit shqiptar më të njohur në botë. Gjithashtu do të sjell dhe komentet që kjo gazetë i ka bërë këtij shkrimtari kur braktisi vendin në fund të periudhës komuniste, në vitin 1990, dhe u vendos në Francë ku kërkoi azil politik. Do të trajtoj dhe se çfarë imazhi të Shqipërisë përcjell Kadareja tek lexuesi spanjoll.

Për të shkruar artikullin jam konsultuar me arkivin on line të gazetës gjatë periudhës 1990-2016. Kam zgjedhur si objekt studimi këtë gazetë pasi është më e rëndësishmja në Spanjë dhe si e tillë ndikon në formimin e opinionit publik. Duke qenë se lajmet me objekt Shqipërinë të botuara në shtypin spanjoll janë të pakta mendova ta shtrij studimin në këtë periudhë të gjatë kohore.

Gjatë viteve 1990-2016 gazeta “El País” i ka dedikuar këtij shkrimtari 35 nga 39 lajmet kulturore që kanë si temë Shqipërinë. Gazeta e ka botuar në faqen e parë të datës 25 qershor 2009 lajmin kur shkrimtari shqiptar u nderua me çmimin prestigjioz letrar spanjoll *Príncipe de Asturias de las Letras*. Po ashtu suplementi kulturor i “El País”, *Babelia*, ia dedikon Kadaresë faqen e parë më datë 3 tetor 2009 duke e shoqëruar fotografinë e tij me titullin: “Enigma Kadare”.

Të gjithë artikujt e konsultuar flasin pozitivisht për Kadarenë, veprat e të cilit kanë shërbyer për njohjen e Shqipërisë tek lexuesit spanjishtfolës. Kjo vërtetohet dhe nga fjalët e shkrimtarit peruan fitues i çmimit Nobel në Letërsi, Mario Vargas Llosa, i cili në një editorial të El País-it shkruan se “*Shqipërinë, vend që nuk kam shkelur kurrë, e njoh vetëm nga romanet e mira të Ismail Kadaresë*”¹⁵⁹.

¹⁵⁹Llosa, Mario Vargas. *El país de las águilas*. El País. 23.03.1997, marrë nga: https://elpais.com/diario/1997/03/23/opinion/859071603_850215.html

Ai stereotipizohet si “kandidat i përjetshëm” i çmimit Nobel në Letërsi, “një nga shkrimtarët më të mëdhenj të kohës”, “mjeshtër i prozës”, “baba i letërsisë shqipe”.

“El País” i rezervon hapësirë Kadaresë në faqen e saj kulturore sa herë që në Spanjë botohen libra të tij në gjuhën spanjolle të përkthyer me mjeshtëri nga Ramón Sánchez Lizarralde, i cili në vitin 1993 fitoi në vendin iberik “Çmimi Kombëtar i Përkthimit” me romanin “Koncerti”.

Kjo gazetë pasqyron dhe lajmin kur Kadareja, vepra e të cilit është përkthyer në mbi 40 gjuhë të botës, fitoi në vitin 2009 çmimin prestigjioz letrar *Príncipe de Asturias de las Letras* dhënë nga mbreti i sotëm i Spanjës, Felipe VI.

Përveç karrierës së tij artistike, kjo gazetë pasqyron dhe momente të tjera të jetës së tij si largimi nga Shqipëria komuniste dhe vendosja në Paris në vitin 1990, si dhe disa opinione të shkrimtarit Ismail Kadare rreth vendeve të Ballkanit.

Pasqyrimi i veprës letrare

Shqipëria mbetet një vend enigmatik për spanjollët dhe në këtë kuadër dhe letërsia e saj. Në Spanjë letërsia shqipe përçohet tek publiku në mënyrë pothuajse ekskluzive nga shkrimtari Ismail Kadare, fitues i një sërë çmimesh ndërkombëtare prestigjioze, midis të cilave Man Booker Prize në 2005, i njohur në botën anglosaksone. Gjithashtu, ai ka shërbyer si burim për krijimin e imazhit të Shqipërisë për të gjithë lexuesit e veprës së tij. Ky imazh është negativ për Shqipërinë komuniste, që u kthye në vendin më të izoluar në Evropë dhe ku individi u tjetërsua nga pushteti.

Gazeta nxjerr në pah faktin se Kadaresë i është dashur të krijojë në një vend të vështirë, ku shkrimtarët ishin të detyruar të mos dilnin jashtë kornizës së realizmit socialist të imponuar nga regjimi komunist.

“Një pjesë e mirë e veprave dhe kryeveprave të tij u botuan në Shqipëri dhe madje u përkthyen në disa gjuhë pikërisht në atë periudhë, kur regjimi stalinist shqiptar ishte më shtypësi dhe më i mbylluri në Evropë”¹⁶⁰, shkruan për “El País”-in shkrimtari shqiptar Bashkim Shehu, mik i Kadaresë, i cili jeton në Spanjë.

Me rastin e marrjes së çmimit letrar *Príncipe de Asturias de las Letras*, Shehu pohon për gazetën se Kadareja “nuk ka qenë as disident, as zëdhënës i regjimit. Por nuk ishte as përzierje e të dyjave, pasi nuk

¹⁶⁰ Shehu, Bashkim, *Ni disidente, ni portavoz*, El País, 25.06.2009, marrë nga: https://elpais.com/diario/2009/06/25/cultura/1245880801_850215.html

përputhen dhe as diçka e ndërmjetme”¹⁶¹.

Sipas gazetës, fama ndërkombëtare e shkrimtarit e ndihmoi atë që të mos ndëshkohej nga regjimi komunist. *“Fama e tij ndërkombëtare ishte motiv krenarie i parëzistueshëm për diktatorin, një koracë që e mbronte nga ndëshkimet dhe përjashtimet”*¹⁶².

Megjithatë, “El País” citon Kadarenë të thotë se liria politike që ai e gëzon që nga viti 1990 *“nuk e ka bërë më të lirë si shkrimtar: në fund të fundit, në se liria politike do të ishte vendimtare për letërsinë, ajo nuk do të ekzistonte, pasi me ca përjashtime, ajo që ka dominuar botën është shtypja”*¹⁶³.

Kadare gjeti forma për ta denoncuar regjimin në veprat e tij duke përdorur figura letrare, simbole, paralelizma e metafora.

Duke e cilësuar si shkrimtarin “më të famshëm” të vendit të tij, gazeta pohon se Kadare ia ka kushtuar një pjesë të mirë të krijimtarisë ngjarjeve historike të Shqipërisë, që nga periudha osmane, pushtimi italo-gjerman gjatë Luftës së Dytë Botërore, e deri te prishja “traumatike” e marrëdhënieve me Bashkimin Sovjetik të Nikita Hrushovit në vitin 1968 dhe me Kinën e Mao Ce Dunit në vitin 1978.

Po ashtu, ajo e vë theksin në faktin se Kadareja nuk dëshiron që të angazhohet në jetën politike të vendit të tij ashtu si shkrimtari çek disident, Vaclav Havel, por preferon të vazhdojë të ushtrojë profesionin e shkrimtarit.

Kadare paraqitet si mjeshtër i përdorimit të miteve, legjendave popullore dhe baladave si në novelat “Kush e solli Doruntinën”, “Gjenerali i ushtrisë së vdekur”, “Muzgu i perëndive të stepës”, “Kamarja e turpër”, “Pallati i ëndrrave”, “Krushqit janë të ngrirë”, etj.

*“Duke qendisur legjenda mijëvjeçare mbi realitete historike, duke përzierë ëndrrat me epopetë, Kadare ngjan si Gorki që këndon sipas mënyrës së Homerit të vjetër, por dhe që ka dhe një ndjenjë fataliteti tragjik si Eskili, humbësi i përjetshëm, të cilit i kushtoi një esë të bukur”*¹⁶⁴.

Në romanet e tij, realiteti, fantazia dhe historia ndërthurren me një lloj realizmi magjik ballkanik, duke iu shmangur realizmit socialist. Më

¹⁶¹ Ibidem.

¹⁶² Galán, Lola, *Kadare, el sobreviviente*, El País, 03.10.2009, marrë nga: https://elpais.com/diario/2009/10/03/babelia/1254528735_850215.html

¹⁶³ Vidal-Folch, Ignacio, *Chapado a la antigua*, El País, 13.03.2002, marrë nga: https://elpais.com/diario/2002/03/13/catalunya/1015985242_850215.html

¹⁶⁴ Clavel, Andre, *Ismail Kadare, profundamente albanés*. El País. 22.11.1990, marrë nga: https://elpais.com/diario/1990/11/22/cultura/659228416_850215.html

shumë se kushdo tjetër Kadareja ka ditur të ngrejë lart letërsinë e një vendi të vogël. Ai, ashtu si dhe shkrimtarët e tjerë të mëdhenj, arrin të ngjallë kureshtjen e lexuesit dhe për detajet me të parëndësishme të personazheve të librave të tij.

Ai krahasohet me Kafkën duke qenë se shumë nga romanet e tij janë alegori e vetmisë dhe pafuqisë së individit ndaj makinës së pashpirt, komplekse dhe absurde të pushtetit dhe me Borgesin, pasi krijon hapësira metaforike të paharrueshme¹⁶⁵.

Krahas vlerësimit të stilit të tij, i cili në shumë raste është humor i zi, Kadareja përcaktohet nga gazeta si shkrimtar që trajton tema universale e sidomos është mjeshër i trajtimit të marrëdhënieve të individit me pushtetin, dhe i funksionimit të makinerisë së pushtetit në regjimet totalitare.

Një nga veprat më të mira “El País” renditet “Pallati i ëndrrave”, me anën e **së cilës**, sipas fjalëve të vetë shkrimtarit, “*donte të tregonte forcën e Shtetit, i cili kontrollonte jo vetëm ndërgjegjen njerëzore, por edhe subkoshiencën, gjë që ndodhte në komunizëm*”¹⁶⁶.

Gazeta evidenton dashurinë intelektuale të Kadaresë për shkrimtarin spanjollin Migel Servantes, autor i romanit “Don Kishoti i Mançës”, një nga perlat e letërsisë botërore. “*Kalorësi i Mançës, dhe Prometeu janë për Kadarenë dy personazhet e letërsisë universale që janë shndërruar në pasuri të njerëzimit*”¹⁶⁷. Artikulli përfundon duke cituar Kadarenë të thotë se udhëtimi titanik i Kolombit nuk i sollti njerëzimit asnjë vepër të madhe letrare, përkundrazi, ndodhitë imagjinare të Don Kishotit u kthyen në një pasuri të madhe të trashëgimisë kulturore.

Azili politik në Francë

Duke gjetur si pretekst organizimin e një ceremonie për promovimin e një prej librave të tij në Francë nga botuesi i tij Fayard, Kadare braktis Shqipërinë në shtator të vitit 1990 dhe kërkon azil politik në Francë. Në letrën që i dërgoi presidentit të fundit komunist, Ramiz Alia, Kadareja shpjegon se me këtë veprim synonte të nxiste demokratizimin e vendit, ku regjimi komunist vazhdonte të ishte në fuqi edhe pse Muri i Berlinit kish rënë që në vitin 1989.

Këtë ngjarje gazeta spanjolle e pasqyron në faqet e saj të asaj periudhe. Kështu në

¹⁶⁵ Vidal-Folch, Ignacio. *Un sabor inconfundible*. El País. 25.06.2009, marrë nga: https://elpais.com/diario/2009/06/25/cultura/1245880803_850215.html

¹⁶⁶ Moret, Xavier. *La gran literatura no se hace sólo con la libertad*. El País, 04.06.1997, marrë nga: https://elpais.com/diario/1997/06/04/cultura/865375213_850215.html

¹⁶⁷ Sierra, Israel Punzano. “*La literatura se independizó de la vida*” con la obra de Cervantes, afirma Ismail Kadare. El País. 26.04.2005, marrë nga: https://elpais.com/diario/2005/04/26/cultura/1114466403_850215.html

shkrimin me titull: “*Kadare ikën, Stalini mbetet*”, El País thekson se Ismail Kadare, shkrimtari kombëtar shqiptar *par excellence*, ka kërkuar azil politik në Francë, ku udhëtoi për të prezantuar veprën e tij të fundit të përkthyer në frëngjisht. Ajo e paraqet Kadarenë si “*hero kombëtar, që vitet e fundit ishte përpjekur të nxiste regjimin që të reformohej, por gjithnjë pa u konfrontuar hapur me të*”¹⁶⁸.

Kurse në artikullin “*Ikja e Kadaresë trondit Shqipërinë*”, “El País” vë në dukje se “*kërkesa për azil politik në Francë nga shkrimtari shqiptar Ismail Kadare shkaktoi një shok të madh në Shqipëri. Sapo lajmi umor vesh në Tiranë, librat e Kadaresë, që zinin vendet më të mira nëpër librari u tërhoqën menjëherë nga raftet*”¹⁶⁹.

Në një intervistë dhënë kësaj gazete nga Parisi në vitin 1991, Kadare thotë se “*Mua më intereson letërsia. Dua ta ndihmoj demokracinë si shkrimtar dhe jo si politikan*”¹⁷⁰. **Në këtë mënyrë ai shpreh qëndrimin e tij se dëshiron të mbetet shkrimtar dhe se nuk synon ndonjë post politik në Shqipërinë post-komuniste.**

Gazeta i ka kushtuar vëmendje dhe opinioneve të tij për Ballkanin, të cilin e karakterizon si një hapësirë ku ndërthuret ngushtësisht tragjika me komiken. Ballkani ka qenë një skenar i përhershëm i argëtimit të politikës ndërkombëtare, për të vënë në skenë shfaqjet më të përgjakshme dhe më qesharake¹⁷¹, thotë Kadareja për “El País”. Ai kujton se nuk duhet të harrojmë se Ballkani ka qenë pjesë e Evropës, që iu shkëput asaj për pesë shekuj dhe se gjatë kësaj periudhe pësoi transformime të thella fizike dhe shpirtërore. Ballkani ka qenë “*fëmija i izoluar i Evropës, i shkëputur prej saj dhe i kompleksuar*”¹⁷², prandaj “*nëna*”, duhet t’i shtrijë dorën e ta ndihmojë, pohon Kadare.

Konkluzione. Nga ky studim rezulton se shtypi spanjoll dhe konkretisht gazeta më e madhe “El País” ka transmetuar tek lexuesi i saj një imazh pozitiv të shkrimtarit Ismail Kadare, të cilin e identifikon si “*kandidat i përjetshëm*” i çmimit Nobel në Letërsi dhe “*baba i letërsisë shqipe*”. Por kjo nuk ndodh me imazhin e Shqipërisë komuniste, që nëpërmjet veprave të Kadaresë, lexuesi spanjoll e percepton në mënyrë negative **si vend i izoluar, i mbyllur, ku shteti nëpërmjet shërbimeve sekrete kontrollonte gjithçka dhe ku mungonin të drejtat dhe liritë themelore të njeriut**. Kjo gazetë ia rezervon shkrimtarit pothuajse të gjithë hapësirën kulturore dedikuar Shqipërisë. Falë Kadaresë, i cili

¹⁶⁸ Tertsch, Hermann. *Kadare se va, Stalin se queda*. El País, marrë nga:

https://elpais.com/diario/1990/10/26/internacional/656895609_850215.html

¹⁶⁹ Tertsch, Hermann, *La fuga de Kadare, conmociona Albania*, El País, 27.10.1990, marrë nga: https://elpais.com/diario/1990/10/27/internacional/656982020_850215.html

¹⁷⁰ Valenzuela, Javier, *El exilio como escándalo*, El País, 23.09.1991, marrë nga:

https://elpais.com/diario/1991/09/23/cultura/685576810_850215.html

¹⁷¹ Rojo, José Andrés. *IsmailKadare vuelve a Homero para atrapar el misterio profundo de la guerra*. El País. 17.09.2004, marrë nga:

https://elpais.com/diario/2004/09/17/cultura/1095372003_850215.html

¹⁷² Ibidem.

punoi në kushte të vështira të një regjimi totalitar, letërsia shqipe e shkruar në gjuhën e një kombi të vogël u ngrit lart dhe u bë e njohur ndërkombëtarisht.

Webografia:

- Clavel, Andre, *Ismail Kadare, profundamente albanés*. El País. 22.11.1990, marrë nga: https://elpais.com/diario/1990/11/22/cultura/659228416_850215.html
- Galán, Lola, *Kadare, el sobreviviente*, El País, 03.10.2009, marrë nga: https://elpais.com/diario/2009/10/03/babelia/1254528735_850215.html
- Llosa, Mario Vargas. *El país de las águilas*. El País. 23.03.1997, marrë nga: https://elpais.com/diario/1997/03/23/opinion/859071603_850215.html
- Moret, Xavier. *La gran literatura no se hace sólo con la libertad*. El País, 04.06.1997, marrë nga: https://elpais.com/diario/1997/06/04/cultura/865375213_850215.html
- Rojo, José Andrés. *Ismail Kadare vuelve a Homero para atrapar el misterio profundo de la guerra*. El País. 17.09.2004, marrë nga: https://elpais.com/diario/2004/09/17/cultura/1095372003_850215.html
- Sierra, Israel Punzano. *“La literatura se independizó de la vida” con la obra de Cervantes, afirma Ismail Kadare*. El País. 26.04.2005, marrë nga: https://elpais.com/diario/2005/04/26/cultura/1114466403_850215.html
- Shehu, Bashkim, *Ni disidente, ni portavoz*, El País, 25.06.2009, marrë nga: https://elpais.com/diario/2009/06/25/cultura/1245880801_850215.html
- Tertsch, Hermann. *Kadare se va, Stalin se queda*. El País, marrë nga: https://elpais.com/diario/1990/10/26/internacional/656895609_850215.html
- Tertsch, Hermann, *La fuga de Kadare, conmociona Albania*, El País, 27.10.1990, marrë nga: https://elpais.com/diario/1990/10/27/internacional/656982020_850215.html
- Valenzuela, Javier, *El exilio como escándalo*, El País, 23.09.1991, marrë nga: https://elpais.com/diario/1991/09/23/cultura/685576810_850215.html
- Vidal-Folch, Ignacio, *Chapado a la antigua*, El País, 13.03.2002, marrë nga: https://elpais.com/diario/2002/03/13/catalunya/1015985242_850215.html
- Vidal-Folch, Ignacio. *Un sabor inconfundible*. El País. 25.06.2009, marrë nga: https://elpais.com/diario/2009/06/25/cultura/1245880803_850215.html

Ismail Kadare's Portrayal in the Spanish Newspaper "El País"

ABSTRACT

Ismail Kadare is the Albanian most famous writer in Spain, where there have been published around 40 of his works. During the period 1990-2016, the biggest Spanish newspaper "El País" has published 32 articles, interviews, columns, chronicles, news which are related to the work and personality of our most known writer.

All these writings convey to the audience a positive image of the writer, characterizing him as "the eternal Nobel Prize candidate in Literature", "father of the Albanian literature", "distinguished chronicler of the long dictatorship night", "one of the most important writers of the second half of the XX century".

Eliana LAÇEJ, Lindita KAZAZI

FIGURA FEMËRORE NË VEPRËN E BASANIT

Të flasësh dhe të studiosh veprën e Xhorxho Basanit do të thotë, ndër të tjera, të ulesh këmbëkryq me disa nga personazhet e tij, pashmangshmërisht me personazhin femëror që vërtitet e zë vendin e saj të rëndësishëm e të këndshëm jo vetëm në të gjithë krijimtarinë e tij, por edhe në historikun e letërsisë italiane.

Basani dhe figura femërore duket sikur ecin krah për krah, të pandashëm dhe plotësues të njëri-tjetrit, prandaj edhe ndalesa jonë në trajtimin e saj kërkon të nxjerrë në pah atë çka e bën të magjishme, sa të prekshme aq edhe imagjinare, sa letrare aq edhe reale.

Një personazh që zë një vend të rëndësishëm në linjën e personazheve femërore të Basanit është Lidia Mantovani. Kemi të bëjmë me një personazh mjaft pasiv dhe – siç shprehet vetë Basani – pothuajse “inegzistent”, por tepër thelbësor për t’i dhënë realitet një qyteti të tërë përmes pranisë së saj “të kuptimtë”. Është historia e një vajze – nënë, edhe ajo vetë bijë e një vajze-nënë, e cila bashkë me të ëmën dhe krijesën e saj të mitur jetojnë në varfëri të plotë të strehuara në një kat përdhes. Aty, në zemër të Ferrarës, qepin rrobat, e klientët që hynë e dalin, ndërkohë që Lidia vuan gjithnjë e më shumë nostalgjinë e një dashurie të humbur. Pak kohë më vonë fillon të frekuentojë shtëpinë e tyre një burrë, që ngjan i dashuruar pas Lidias së cilës do t’i duhet të arsyetojë nëse duhet ta pranojë apo jo një dashuri të sigurt të zhveshur nga pasioni që ajo e kishte humbur njëherë e përgjithmonë. Kemi të bëjmë me një histori pa emocione, thjesht të pranuar në ekzistencën e saj, jashtë çdo filli kohor, e përjashtuar nga fati. Një histori gruaje e rrëfyer gjatë një dimri të jashtëzakonshëm në Ferrara, muret e kuqe të së cilës zbardhuan nga bora dhe ngrica. Brenda këtij peizazhi të kristalizuar ndodhet ngrohësia njerëzore e kësaj historie minimaliste.

Për të kaluar tek një personazh tjetër femëror, Xhema Brondi. Vajza e një familjeje të thjeshtë, “fshatarë qyteti”, e cila do të martohet me çifutin Elia Corcos, nga një derë zotërinjsh, e cila hap tregimin “Shëtitja para darke” dhe përmes pamjes së saj “*të zakonshme dhe aspak domethënëse*” në sfondin e fundit të Rrugës Xhoveka merr rrugë një tjetër tregim i mrekullueshëm ku hyjnë në lojë ëndrra të njëpasnjëshme e të

parealizueshme, ndërkohë që historia me “H” të madhe vazhdon të përshkojë udhën e saj. Nëse më së shumti Basani ia beson figurave mashkullore rolin e vëzhguesve të qytetit e të jetës që bën, është po aq e vërtetë që motra e Xhemës, Auzilia, na shfaqet si një sy që vështron nga jashtë, që jeton si pasojë ngjarje private dhe ndryshime historike.

Bjondja e përhershme Ana Repeto tek “Një natë e ’43-it”, tregim i vëllimit “Pesë histori ferrareze” fitues i çmimit Strega në vitet Pesëdhjetë, vajza e çlirtë e cila me flokët e gjata të hedhura pas shpatullave dhe me buzë e trasha të lyera “*ndërsa nxirrte kofshët dhe bile akoma më sipër këmbët e gjata të nxira nga dielli, shkonte e vinte para tavolinave të Kafja e Borsës*”. Ishte shtatëmbëdhjetë vjeçe kur u martua me farmacistin, duke ngjallur si përherë në Ferrara miliona fjalë e thashetheme se përse kishte dashur të rehatohet sa më shpejt në vend që të shkonte në Romë e të bëhej divë e kinemasë, kështuqë borgjezët e vegjël e akuzuan si lakmiqare dhe prostitutë. Prostitucioni, në kuptimin filozofik ferrarez, njëherë e një kohë, i ngjeshet të gjitha vajzave që nuk vinin nga Ferrara, mbartëse të dyshimit për ekzotizëm ndryshe nga rrethi i shumëdëshiruar dhe mbytës i ferrarezeve të mirëfillta, të cilat ndërkohë rrallëvinin në jetë strategjitë e studiura në përshkrimin e Mikol Finci-Kontini, merrnin mësim të tenisi dhe për më tepër heshtnin, duke lënë të flisnin shikimet. Megjithatë, Ana Repeto, kishte shkuar të jetonte me të shoqin në apartamentin sipër farmacisë, para Kështjellës. Natën e 15 dhjetorit 1943, ndërsa Brigadat e zeza vrisnin njëmbëdhjetë persona dhe i mbështesnin tek muri i Fosa del Kastelo, tamam përballë farmacisë, Ana ndodhej në shtratin e kushedi cilit të dashur, ku kishte shkuar, pasi kishte vënë në gjumë të shoqin, por me të dëgjuar krismat nuk arriti të kthehet në shtëpi para orës katër të mëngjesit. U kthye me vrap në këmbë (avantazhi i të jetuarit në një qytet të vogël të përgjumur) dhe pa grumbujt e kufomave që ngjanin me dëngje leckash: u afrua e në atë çast i erdhi ndërmend i shoqi. Ngriti sytë dhe ai ndodhej aty, si gjithmonë, i ngulur pas xhamave të dritares, dhe e shikonte. Ia ngulën sytë njëri-tjetrit për një çast. Ai nuk i tha asnjëherë asgjë. Kur ajo ngjiti shkallët ai ishte shtrirë tashmë me kokën nga muri, me frymëmarrjen e dikujt që e ka zënë gjumi e që nga ai moment nuk nxorri më asnjë fjalë. Vetëm rrinte në dritare, me dylbitë në dorë, e shikonte trotuarin përballë (ishte i vetmi dëshmitar historik i asaj nate të përgjakshme dhe terrori që Ferrara e kujton përmes dy lapidarëve të mermertë të murosur në murin rrethues Fosato del Kastelo, dhe e kurorëzon me dafina). Pra, Ana Repeto, e cila nuk ishte as tridhjetë vjeçe e nuk kishte ndër mend të çmendej bashkë me të, e la, mori një apartament të vogël dhe filloi të dilte me biçikletë; u regjistrua në Akademinë e pikturës, nisi të vishte bluza të ngjeshura pas

trupit të cilat i vinin në dukje format “e papërmbajtshme”, shkruan Basani (jo me entuziazëm, sepse vajzat e familjes së mirë nuk duhet të kenë forma të papërmbajtura) dhe trukohej më shumë se asnjëherë, ëndërronte të imitonte vajzat ekzistencialiste të Parisit dhe Romës dhe here pas here zhdukej për t’u rishfaqur në shoqërinë e ndonjë mikeje. Në fakt, të zhdukurit në Ferrara nuk është dhe aq e ngatërruar, siç shkruante Basani: edhe pse është një vrimë, një vrimë shumë e bukur, “*arrin shumë mirë, nëse do, të zhdukësh për vite e vite me radhë disa nga disa të tjerë, të jetosh të gjithë së bashkur sikur me të vdekurit*” (ishin kohët e mjegullës së dendur, ata, por dimrit atmosfera është gjithnjë po e njëjta, nga ora gjashtë e më tej). Më tepër se sa të zhdukurit, ajo që bën më përshtypje dhe zgjon interesin valë- valë, është të shfaqurit, e paturpshëm, krah për krah me një vajzë që nuk është as nga Ferrara. Ja, pra pyetjet e shumta që lindnin pa pushim duke ndërtuar dhe vulosur gjithnjë e më shumë mentalitetin e njerëzve të Ferrarës: Kush mund të ishte vallë ajo brunia e lezetshme me sy dinakë që shoqërohej tani me Anën? – pyesnin ngado – mos ishte bolonjeze? Mos ishte romane? Mos vallë ishte ndonjë fiorentine apo ndoshta një e huaj? Interesi i ferrarezit gjithmonë shoqërohet të paktën me një ngërdheshje dyshimi dhe nga një minimum përçmimi, siç ndodh për më tepër me qytetet e vogla e të mbyllura në vetvete. Ana, siç të gjithë protagonistët në fund të fundit, duhet t’i përshtatet një province italiane e cila nga njëra anë të ngushëllon, nga ana tjetër refuzon çdo gjë që nuk e konsideron të vetën. Njerëzit përfshirë. Faktikisht Ana Repeto e jetonte jetën, mirëpriste në shtëpinë e saj këdo që i trokiste në xhamat e dritares, kështuqë rreth mesnatave të korrikut dhe gushtit, ishte normale të shihje në trotuarin poshtë apartamentit të saj tre a katër burra të ndalur, ndoshta ish-shokët e saj të gjimnazit, rreth të tridhjetave apo dyzetave, të martuar e me fëmijë. Ajo i linte të hynin, llafoste me ta, dhe sipas metodës ferrareze vajtonte se sa e kishte dashur burrin e saj.

Në botën imagjinare basaniane shfaqet në formën e një filli të hollë ndarës kufiri mes gruas reale dhe asaj publike. Është pikërisht momenti kur gruaja shfaqet më pak ideale e më shumë reale, kur në përfaqësimin e saj tenton ta infektojë pothuajse pashmangshmërisht figura imagjinare e gruas mendjelehtë. Në librin “Romani i Ferrarës” të gjitha gratë rrezikojnë të gjenden në atë rol. Janë prostituta potenciale.

Duhet të kemi parasysh se, pikësëpari, Basani është trashëgimtar i një tradite të gjatë kulturore maskiliste ku gratë si Pandora apo Eva janë përgjegjëse të të këqijave të njerëzimit, dhe së dyti, në tregimet e tij imazhi sundues i gruas mendjelehtë ka shumë mundësi të jetë simboli i një faji jo specifikisht femëror, por e projektuar nga burrat ndaj grave. Mjafton të

kthejmë vëmendjen tek personazhi i Lida Mantovanit, e cila e njollosur nga shikimet lakmiqare të meshkujve të cilët e perceptojnë si një grua mendjelehtë duke qenë e dashur e fshehtë e Davidit:

britmat “e ndiqnin nga afër. Ishin si duart e ftohta dhe të lagshhta që kërkonin ta kapnin, ta preknin poshtë rrobave”.

Nisur nga një këndvështrim mashkullor, tregimet basaniane nxjerrin në pah ngulmimin e skemave imagjinare misogjene, por edhe treguesit e fallsitetit të këtyre skemave, falë marrjes në konsideratë të pikëpamjeve femërore dhe kritikave të nënkuptuara ndaj personazheve mashkullorë. Në këtë mënyrë tregimet paraqesin disa elemente që i lejojnë lexuesit të realizojë një reflektim të tipit femëror, që gjithsesi nuk paraqitet hapurazi nga Basani ose nga ndonjë zëdhënës i mundshëm i simuluar.

Brenda atij afresku të madh që përbën “Romani i Ferrarës”, ja një tjetër gruaja, Mikol, e cila shfaqet jo vetëm si protagoniste e veprës “Kopshti i Finci-Kontinëve”, por flatron në të gjithë veprën si një frymëzim poetik, i pakapshëm dhe plot vërtetësi, ironik dhe tragjik si një perëndi kapriçoze të cilën është e pamundur ta zotërosh. Vetë Basani, përveçse gjen në të veten e tij përmes një hovi të tipit flobertian “*Madam Bavari jam unë!*”, e ngarkon të çlirojë një botë të destinuar drejt zhdukjes. Mikol spikat mbi personazhet e tjera femërore sepse është simboli i diçkaje që po zhvillohet: përmes saj, autori imagjinon një evoluim të gruas në kulturën hebraike.

Pra, mbretëresha është Mikol. Më e bukura, protagonistja më e pakapshme dhe tragjike e historive të Basanit. Kanë kaluar 56 vjet (nga 1962 kur u botua “Kopshti i Finci-Kontinëve”), dhe Mikol Finci-Kontini mbetet gjithmonë arketipi biond në bojë hiri i vajzës e cila të bën ta dashurosh menjëherë, e përkryer për të nxitur dëshirën e pamatë për ta riparë, në fillim, dhe për ta dashuruar deri në marrëzi, më pas.

E bukura dhe rebelja Mikol, me inteligjencën e saj, mrekuillinë e saj, paqëndrueshmërinë, sekretet, shndërrohet në gruan që të gjithë burrat kanë dashuruar, të paktën një herë gjatë jetës së tyre.

Mikol është projektimi shkatërrues i një rinie të shpikur, është nostalgjia e parajsës së humbur, por është edhe një model femëror i parëzistueshëm: vajza me veshjen e tenisit që flet një gjuhë krejtësisht të sajën, një deformim vetjak i italishtes, duke u mbështetur në rrokjet e disa fjalëve, kuptimin e vërtetë të të cilave dukej sikur e dinte vetëm ajo, një e folur familjare, finci-kontinishtja. Një vajzë e bukur dhe inteligjente që dashuron poezinë e Emili Dikenson, pikturat e De Pizis. Mikol dashuronte

çmendurisht pemët e kopshtit të saj. Ishte e sjellshme me shoqet e saja, por e krahasonte veten me to vetëm tek loja:

“jam edhe unë si të gjitha të tjerat: gënjeshtare, tradhëtare, e pabesë... Jo shumë ndryshe nga cilado Adriana Trentini, në fund të fundit”

i thotë Xhorxhos, zëvendësit letrar të Basanit, ndërsa i shpjegon që ata të dy nuk mund të dashurohen asnjëherë mes tyre sepse rrinë jo përballë, por përkrah njëri pranë tjetrit, ndërkohë që dashuria, ashtu siç e paramendon ajo, është për njerëz të vendosur ta vënë përposh njëri-tjetrin, është një sport mizor. Është portreti, përsosmërisht realist dhe i mundshëm, por me diçka më shumë, me madhësinë poetike të tragjedisë, i vajzukes së familjes së madhe – dhe për Basanin të gjitha vajzat ferrareze të familjeve të mëdha ishin flokëverdha të ëmbla, si *fille aux cheveux de lin*, dhe meshkujt që i shikonin pyesin vazhdimisht veten: “*Kush është? E bija e kujt është?*”, sepse familja, mbiemri, shtëpia ku banon, farefisi janë, historikisht në Ferrara, më absolute se sa çdo shkëlqim. Dhe ja që keqardhja e Basanit del nga çdo faqe e romaneve dhe tregimeve të tij: mosqenia e një borgjezi çfarëdo, mosbërja pjesë e atij rrethi të ngushtë, edhe mendërisht, borgjezësh ferrarezë.

E shpenguara dhe misteriozja Mikol, fjalëshumta dhe papritur e pakujtuar gojëmbyllur, është keqardhja më fatale e veprës “Romani i Ferrarës”. Asnjëra nuk është si Mikol, asnjëra nuk ka atë mënyrë të pari, të mërziturit, të biseduarit në telefon, të zemëruarit dhe të treguarit të gënjeshtrove joshëse, të shtirjes si e shenjtë dhe të plasurit gazit.

Për asnjë grua tjetër të romaneve të tij Basani nuk ka treguar asnjëherë tronditje sensuale si në përshkrimin e bukurisë trupore të Mikolit.

Po kush ishte Mikol atëherë? Para se të vdiste, tregimtarja Rozeda Tumiati rrëfeu:

Përmbledh një numër të konsiderueshëm grashë që Basani ka dashuruar dhe frekuentuar. Ne mendonim se mund të ishte motra ime Katerina, bionë, me sy bojë qielli, shumë e ëmbël. Xhorxho ishte i dashuruar pas saj. Është pasë dashuruar edhe me një tjetër: e vogël, enigmatike, joshëse. Ishte edhe një tjetër në Bolonja që luante mirë tenis...

Mbivendosjet shumëfishohen. Tek paraqet vajzën, ka mundësi që Basani të ketë përdorur një marifet letrar, duke ndriçuar përmes atij

personazhi historinë e trishtë të “Magrini-Finci-Kontinëve”. Kur shkroi romanin e tij, protagonistët kishin vdekuar tashmë të gjithë. Basani thoshte shpeshherë se nuk i shpiku temat ose personazhet e romanit të tij: qenë ata që erdhën tek ai, duke i kërkuar që të shihen dhe të dëgjohen.

Pra, kush ishte Mikol, protagonistja e emancipuar, e çlirtë, ironike dhe që të bën për vete në qasjet e saja, por që nuk përfshihet asnjëherë deri në fund? Kush ishte kjo vajzë, më pas grua shumë e gjallë, entuziaste, e aftë për empati dhe miqësi, që i përkushtohet me një pasion të pamatë gjithçkaje që bën, për t’u shfaqur e vetëdijshme për atë që e pret?

Ndoshta përgjigjja na ka mbërritur pikërisht në njëqind vjetorin e lindjes së autorit kur doli në dritë dorëshkrimi i librit “Kopshti i Finci – Kontinëve”: I përkiste mikes (muzës) Tereza Foscari Foscologo. Kemi të bëjmë me katër fletore të mëdha, si regjistra për mbajtjen e llogarive, të përbëra para e prapa një total prej rreth tetëqind faqe, që mbajnë dorëshkrimin e plotë të librit “Kopshti i Finci – Kontinëve”. Ky material i jashtëzakonshëm iu dorëzua nga vetë Basani mikes së tij Tereza Foscari Foscologo me një dedikim, që daton “Venecia, 17 dhjetor 1961” dhe e firmosur “Xhorxho”: *“E dashur Tereza, pa ndihmën tënde “Kopshti i Finci – Kontinëve” nuk do të ishte shkruar asnjëherë. Dëshiroj që këto fletore të mebetn përgjithmonë me ty”*.

Fisnikja Tereza Foscari Foscologo, bashkëmoshatare e Basanit e njohu shkrimtarin në vitet ’50. Njihej si “kontesha e kuqe” dhe vdiq në vitin 2007. Ka shumë mundësi që Tereza e Xhorxho u njohën në mjediset e Italia Nostra, një ndër themeluesit e së cilës është vetë Basani në vitin 1955 dhe kryetar i saj nga 1965 në 1980. *“Një grua e përgatitur, e çlirtë, thumbuese, rebele, shumë e bukur, e cila fliste shumë mirë frëngjisht dhe kishte një bibliotekë të pafundme”*. Të ketë qenë ajo muza e Xhorxho Basanit, ajo muza që e ndihmoi të krijonte një prej prej personazheve femërorë më të bukur, më kuriozë dhe më të dashur të letërsisë italiane të shekullit të njëzetë? Ndoshta po, ndoshta jo.

Nëse tradita e hebrenjve ortodoksë anonte ta shihte praninë femërore si të syrgjynosur në planin dytësor, Basani paraprin në kohë duke paraqitur personazhe grash, të cilat shquhen për dëshirën e tyre të lirisë dhe të pavarësisë së mendimit, duke përjashtur mundësinë efektive për t’i konkretizuar në realitetin që do të jetojnë. Galeria e figurave femërore – në dialog të qëndrueshëm me ata mashkullorë – është shprehje e universit basanian në përpjekjen e tij, absolutisht të realizuar, për të përfaqësuar shumëllojshmërinë e sjelljeve me të cilat i bën ballë një epoke e cila – edhe pse larg nga e tashmja jonë – e pasqyron shumë nga afër. “Mikoli dhe të tjerat”, pra, janë një gjinece grash që, ose forcohet për ndarjen dhe izolimin

e vet, ose i mposht për të gjetur një rrugë ikje në favor të një jete më të plotë.

BIBLIOGRAFIA

- Bassani, G., *Dietro la porta*, in *Il romanzo di Ferrara*, Milano, Feltrinelli, 1980, ed. Le Comete, 2012.
- Ed. Dolfi, A. e Venturi, G., *Un film quasi impossibile; qualche appunto in margine all'uso del codice di realtà. Ritorno al "Giardino"*: Una giornata di studi per Giorgio Bassani.. Roma, Bulzoni, 2006.
- Rinaldi, M., ed. Giorgio Bassani. *Il giardino dei libri*. Roma, De Luca, 2004.
- Neiger, A., *Bassani e il mondo ebraico*. Napoli, Loffredo, 1983
- Gaeta, M. I., ed. *Giorgio Bassani. Uno scrittore da ritrovare*. Roma, Fahrenheit 451, 2004.
- Ed. Dolfi, A. e Venturi, G., "*Ut Pictura*"; *Bassani e l'immagine dipinta*". *Ritorno al "Giardino"*: Una giornata di studi per Giorgio Bassani. Roma, Bulzoni, 2006.

The female figure in Bassani's production

ABSTRACT

In the imaginary Bassani's world the boundary between the real-life woman and the public woman appears in the form of a thin line of demarcation. It is precisely the moment when the woman proves to be less ideal and more real, when in her representation the imaginary figure of the gullible woman tends to infect her almost inevitably. In the "The novel of Ferrara" work, all women run the risk of being found in that position. It should be taken into consideration that Bassani is, firstly, the heir of a long cultural tradition according to which women like Pandora or Eve are responsible for the evils of mankind and, secondly, the dominant image of the gullible woman is very likely to be the symbol of a blame, not a specifically feminine one, but designed by men to the detriment of women. If Jewish and Orthodox traditions were inclined to see the female presence as marginalized, Bassani precedes time by presenting female characters who are distinguished by their desire for freedom and independence of thought, despite their effective ability to put it into practice in the real-life

context they will live. The gallery of female images - in a constant dialogue with the masculine ones - is an expression of Bassani's universe in his absolutely fulfilled effort to represent the variety of behaviors by means of which he faces an era that, although remote in time – brings it closer.

Alva DANI, Aterda LIKA

TË PATHËNAT E BASANIT TE “FINCI - KONTINI”

Kopshti i Finci-Kontinëve është një roman që e ka zanafillën në një kujtim të largët, historia e të cilit shtrihet në një distancë të tillë kohore, ku e shkuara nuk ka asnjë lloj lidhjeje me të tashmen. Basani përpunoi një histori njerëzore të jashtëzakonshme, duke u kujdesur për të deri në detajet më të vogla, ku asgjë nuk i lihet rastësisë, e përkundrazi mund të thuhet se çdo gjë është fryt i një studimi të kujdesshëm që ngulit në memorien e lexuesit çdo element që e bën të paharrueshëm kopshin, *magna domus*- in, Sinagogën, ritet hebreje. Si mund të mos kujtohet Ferrara e nënshtuar nga lufta? Si mund të mos kujtohen viktimat e persekutimit racor? Ky stil shumë elegant i të rrëfyerit është mirëmenduar për të paraqitur një vepër letrare që synon të depërtojë menjëherë tek publiku. Basani kthen në të pavdekshme një histori, një epokë, një familje, gjithë qytetin e Ferrarës, i cili qëllimisht përshkruhet me detajet më të imëta, kryesisht nëse i referohemi edhe kopshtit që nuk ka ekzistuar ndonjëherë. Megjithatë ajo që ka rëndësi është paraqitja e përjetimeve dhe ndjenjave të protagonistit, i cili e ka ëndërruar një histori të tillë duke u nisur nga një përjetim djaloshar.

“Sa vite kanë kaluar nga ajo pasdite e largët qershori? Më shumë se tridhjetë. Sidoqoftë, nëse mbyll sytë, Mikol Finci-Kontini është ende aty që më sheh dhe më flet, e varur në murin rrethues të kopshtit të saj.” f. 53

Kopshti, në të cilin zhvillohet ngjarja e viteve 1938 dhe 1941, është i mbrojtur pavarësisht nga ajo që ndodh përjashtë tij. Ndryshe nga çfarë paraqesin veprat e Primo Levit, në romanin e Basanit kampet e përqendrimit mbeten jashtë përshkrimit. Kopshti i Finci-Kontinëve paraqet dashurinë, miqësinë, projektet e jetës, ndeshjet e tenisit të disa të rinjve hebrej nga Ferrara, të integruar më së miri në jetën e qytetit, gjatë viteve universitare, ndërsa ndërkohë, Italia bënte aleancë me Gjermaninë dhe hynte në luftë.

Gjithsesi historia e vërtetë zhvillohet përtej mureve. Një ndër historitë më të tmerrshme dhe më të dhimbshme e të gjithë njerëzimit shërben si prolog i pothuajse gjithë narrativave basaniane. Në vjeshtën e vitit 1943, 183 persona që i përkisnin komunitetit hebre të Ferrarës, u arrestuan e u dërguan në kampet e përqendrimit gjerman. I riu Giorgio

gjendet i rrethuar nga lufta dhe nga kërcënimet e nazizmit dhe fashizmit republikan, (ndërkohe që të afërmit e tij të mbetur në Ferrara do të dërgohen në Buchenwald dhe prindërit rrezikojnë të arrestohen) megjithëse arrin t'i shpëtojë rrezikut dhe poshtërimin të dërgimit në kampe e për më tepër kërcënimin të vdekjes në një lager.

Megjithatë “... *Holokausti në vetvete nuk kthehet kurrë në temën e vertetë të veprave të Basanit, i cili nuk ka për qëllim të denoncojë apo të mbajë qëndrim ndaj antisemitizmit apo fashizmit* ” shprehet Tim Parks¹⁷³, në një analizë që bën mbi aspektin modern të veprës. Qëllimi i tij është të nxjerrë në pah jetën ashtu siç e sheh ai, bazuar në rrethanat e veçanta të cilat ekzistonin në të gjithë Italinë, por në veçanti në qytetin e tij të lindjes Ferrara. Lexuesi nuk e percepton tmerrin që sjell lufta (vdekjen, internimet, poshtërimet, prishjen e lidhjeve familjare), por percepton një qetësi shpirtërore të trishte, si të dikujt që ndjehet i mbrojtur, por që është i detyruar në mënyrë të pashmangshme të vëzhgojë e të kuptojë atë që po i ndodh njerëzve të tjerë.

“ *Vërejmë një lloj maturie dhe një fshehje të realitetit në figurën dhe veprën e Basanit –pohon Giulio Ferroni- sikur gërmimi në kujtesë ..., dëshira dhe impenjimi i tij për të nxjerrë në pah botën shpirtërore të përjetimit të ndjenjave të konsumuara në rrjedhën shkatërrimtare të kohës, përpjekja për të shpëtuar ngjyrën e ngrohtësinë e jetëve të jetuara e të humbura, duhej gjithmonë të përballlej me të pathënën, me pritjen gjithmonë zhgënjyese të një mirënjohjeje, me pasigurinë dhe paqëndrueshmërinë e vetë kujtimeve*”.

Kopshti i *magna domus-it* me murin simbolik me rrethim të lartë, paraqitet si vendi dhe hapësira e përsosur për të realizuar një lloj izolimi hapësinor dhe mendor. Ky kopsht i stërmadh kthehet në një hapësirë të mbrojtur dhe të mbyllur në sfondin e historisë dhe të tragjedisë që ka kapluar Italinë e kryesisht hebrenjtë. “*Mbetet fakt se i njëjti izolim, e njëjta ndarje me të cilën Finzi-Kontinët kishin rrethuar të vdekurit e tyre, në shtëpinë e mbrame e të përjetshme, rrethonte edhe shtëpinë tjetër, atë rrethojë të përkohshme që ata zotëronin në fund të rrugës Ercole Primo*

¹⁷³ Tim Parks, *Controllo e negazione. L'allarmante modernità dei Finzi-Contini*. Kjo ese e shkruar në anglisht është botuar në New York Book Review (14 korrik 2005) si parathënie e përkthimit në gjuhën angleze (The garden of the Finzi-Contini), 2005.

d'Este”, shkruan Bassani. E përjetësuar nga Xhozue Karduçi dhe Gabriele D’Anuncio, kjo rrugë e Ferrarës është aq e njohur për adhuruesit e artit dhe poezisë së mbarë botës sa çdo përshkrim për të është i tepërt. E pra, në këtë “kështjellë” jetonin Finci Kontinët, të shkëputur nga bota, duke ruajtur një marrëdhënie të brishtë me ambientin e jashtëm, me gjithçka i rrethonte.

Basani jo rastësisht e ndërton historinë e tij brenda mureve të vilës, një histori dashurie ndërmjet rrëfyesit që Montale¹⁷⁴ parapëlqen ta quajë B, dhe të vajzës së re magjepsëse të Finci-Kontinëve. Prirja që paraqet familja hebreje e Finci-Kontinëve për izolimin, e bën të zhvendoset jashtë shoqërisë italiane, duke ushqyer atë që babai i rrëfyesit e interpretonte si pretendim absurd fisnikërie. Finci-Kontinët janë me të vërtetë princër borgjezë, të lidhur pas kultit të rrënjëve dhe të gjuhës së veçantë, me elemente zhargonit të epokës së një stili letrar të rafinuar, jetojnë në vendbanimin e tyre në fund të rrugës më të vjetër dhe më të rrahur të Ferrarës, në izolimin e tyre të artë, duke injoruar rrezikun e afërt të tragjedisë së persekutimit që pa kaluar shumë kohë do t’i dërrmojë.

Përshkrimi i jashtëzakonshëm i familjes duket aq bindës sa edhe enigmatik. Ata nuk shihen asnjëherë jashtë mureve të kopshtit të madh, me përjashtimin e vetëm të frekuentimit që i bëjnë sinagogës. Kanë mundësi të ftojnë miqtë, por për arsye të cilat e kemi të pamundur t’i kuptojmë plotësisht, nuk mund të ftohet për të dalë jashtë një pjesëtar i familjes së Finci Kontinëve. Jemi në 1938-ën, vitin kur qeveria fashiste vendos ligjet raciale të cilat përjashtojnë nga jeta publike hebrenjtë. Për këtë arsye Mikola dhe Alberto Finci-Kontini, dy të rinj nga borgjezia e kamur hebraike e Ferrarës, hapin dyert e kopshtit të tyre ku ndodhet edhe një fushë tenisi, për bashkëmoshatarët.

Kopshti i mahnitshëm përkohësisht shërben si mburojë e mirë që të rinjtë të largojnë vëmendjen nga ajo që ndodh përreth tij. Lind aty idili mes narratorit dhe Mikolës, një dashuri e shpresuar, mallëngjyese në dëlirësinë dhe shpirtin poetik, që nuk i përmbushet asnjëherë e që venitet muaj pas muaji. Por nuk është kjo arsyeja që “Kopshti i Finci Kontinëve”, ky klasik i letërsisë italiane mbështillet me një tis trishtimi të vazhdueshëm.

¹⁷⁴ Eugenio Montale, në “*Giorgio Bassani, Kopshti i Finci – Kontinëve*”, Botimet IDK, Tiranë, 2015.

Rrëfimi i Basanit nuk synon të jetë asnjëherë i qartë. Ai përhumbet nëpër kopsht, me orë të tëra në xhirot e vazhdueshme me biçikletë që bën narratori me Mikolën. Miqësia mes të dyve, e fortë dhe e dyshimtë, komplikohet nga rrëfyesi me synimin e një dashurie më të vetëdijshme dhe më të pjekur. Në një skenë mjaft përcaktuese, Mikol dhe rrëfyesi gjenden të vetëm në një garazh, brenda një karroce të vjetër e të rrënuar të Finci Kontinëve, por përsëri ata ndjehen të pavendosur për t'i dhënë shpresë dashurisë së tyre.

“Përgjatë dimrit, pranverës dhe beharit që pasoi, iu ktheva pafundësisht asaj që kish ndodhur (ose më saktë, që s’kish ndodhur) mes meje dhe Mikolës brenda karrocës së preferuar të plakut Perroti. [...] Dhe harroja t’i bëja vetes pyetjen kryesore: nëse atë çast sublim, të papërsëritshëm e të paprapësueshëm- një çast që mbase kish vendosur për jetën e saj e timen, - isha vërtet në gjendje të provoja të hidhja një hap, të thosha një fjalë çfarëdo. Fjala vjen, a e dija qysh atëherë se isha njëmend i dashuruar? E pra jo, e vërteta ishte se ende nuk e dija.”(p.125)

Edhe nisja e Mikol për Venecia për të vazhduar universitetin, në fillim të pjesës së tretë të *Kopshtit*, nuk i ndërpret vizitat e protagonistit në shtëpinë e Finci- Kontinëve, me bindjen që për të mbajtur atë lidhje duhet mbajtur gjallë shpresa për një dashuri të ardhshme. Është vetë vajza, që pas disa tentativave jo të suksesshme i shpjegon protagonistit pamundësinë për një dashuri të vërtetë dhe reale ndërmjet dy personave të ngjashëm për gjithçka e në gjithçka. Duke biseduar me rrëfyesin, Mikol krejtësisht e vetëdijshme që lufta është shumë afër, ngatërron emërtimet e koncepteve dashuri dhe luftë, duke pretenduar se dashuria është për të dhunshmit, për ata që janë të gatshëm të kapërcejnë njëri-tjetrin çdo ditë: është një sport i pamëshirshëm shumë më tepër se tenisi.

Unë... unë i qëndroja përbri, a e kuptoja?, jo përballë: ndërsa dashuria – kështu së paku e përfytyronte ajo – ishte diçka për njerëz të vendosur për të vënë poshtë njëri-tjetrin; një sport mizor dhe i ashpër edhe se tenisi, që ushtrohet pa marrë parasysh asnjëherë mirësinë e shpirtit apo sinqeritetin e qëllimeve, për ta bërë gjënë më të lehtë. [...] Po ne? Të sinqertë deri në marrëzi, që të dy, njëlloj në gjithçka si dy pika uji(“dhe të njëllojtët nuk mund të luftojnë mes tyre, besomë!”) ne të dy, a do të kishim

*qenë ndonjëherë të zotët ta vinim poshtë njëri-tjetrin?*¹⁷⁵

Edhe ajri është i tejngopur me një lloj seksualiteti të shtypur e të fshehur. Dy të rinjtë duken si të ngrirë, si të bllokuar në një vend. Ndoshta situata politike fsheh vështirësi më të mëdha, siç është përballja me botën dhe jetën jashtë kopshtit të mbrojtur. Ligjet racore i shtojnë familjes edhe një justifikim më shumë për të bërë një jetë të mënjanuar. Shtëpia dhe kopshti shndërrohen në një moment të caktuar, sidomos pas ligjeve racore të '38-ës, në një mishërim të lagerit, aq sa të gjithë banorët dhe frekuentuesit me përjashtim të protagonistit, i cili largohet ose thënë më mirë dëbohet në kohë, do të vdesin, përfshirë këtu edhe jo hebrenjtë. Basani nuk ka për qëllim të zbulojë apo të flasë për atë çfarë ndodh, por të thurë poezi duke u bazuar në cilësinë e ngjarjeve. Ai e refuzon jetën në emër të krijimit të një të reje më të vërtetë e më të patjetërsueshme, me talentin e lirisë së veprimit, me aftësinë për të depërtur qartësisht në kujtimet e tij, ndjenjën e dhimbjes dhe të izolimit, ku edhe përqaftimi i vdekjes duket më i butë dhe më i pranueshëm:

*“ ... per me, non meno che per lei, piu' del possesso delle cose contava la memoria di esse, la memoria di fronte alla quale ogni possesso, in se', non puo' apparire che delusivo, banale, insufficiente... La mia ansia che il presente diventasse subito passato, perché potessi amarlo e vagheggiarlo a mio agio, era anche sua, tale e quale. Era il nostro vizio, questo: d'andare avanti con la testa sempre voltata all'indietro ”*¹⁷⁶.

Është vetëm kujtesa ajo që i perfeksionon gjërat, kur ato nuk janë më të ekspozuara përballë tekave të kohës dhe ndryshimeve të saj traumatike. Drama e rrëfyesit konsiston në faktin që edhe Mikol është kthyer në një nga ato sendet perfekte të cilat mund të ruhen vetëm nëpërmjet kujtimeve. Prandaj vetëm falë një kujtese të saktë deri në detaje, shpesh të udhëhequr nga “zemra”, është e mundur të rishohësh vende dhe ndjenja të cilat përndryshe do të kishin qenë të destinuara për të humbur në kujtesë. Zëri i rrëfyesit ngarkohet edhe me përgjegjësinë për t'i dhënë zë e fjalë edhe atij që s'është më. Gjithsesi, nuk dihet nëse Mikol ka ekzistuar ndonjëherë, nuk dihet gjë as për *magna domus*-in apo për kopshtin. Në një intervistë të 1991-it Basani shprehej se shkrimtari nuk duhet të njësohet

¹⁷⁵ Giorgio Bassani, Kopshti i Finci – Kontinëve, Botimet IDK, Tiranë, 2015, f. 226 – 227.

krejtësisht me lëndën e tij, por duhet të tejkalojë pasionet individuale dhe interesat praktike edhe nëse flet në vetë të parë apo vë në skenë vetveten, nuk duhet të krijojë përpuethshmëri me autorin, sepse edhe personazhi që shprehet me “unë” mbetet gjithsesi një personazh, apo një trillim letrar. Mikol, Alberto, Signor Ermano Finzi-Kontini, i riu Malnate janë ndër ato personazhe që mbeten gjatë në kujtesën e lexuesit. Talenti i Basanit e ka skalitur aq shumë memorien, në mënyrë që të mos harrohet e shkuara, femijëria, adoleshenca, rinia, por edhe persekutimi racor, por edhe rrjedha shkatërrimtare në dukje e pashpjegueshme e një historie armike.

Kopshti i Finci- Kontinëve kishte për qëllim të ishte së pari një roman i çështjeve historike të persekutimit të hebrenjve të përndjekur e të vrarë nga diktaturat nazifashiste. Kjo vërehet ama vetëm në epilog, kur rrëfyesi shpjegon rrjedhën e ngjarjeve. Alberto vdes në vitin 1942 nga një tumor, i cili i kishte shfaqur shenjat gjatë zhvillimit të historisë, Finci-Kontinët dërgohen në kampet e shfarosjes pas 8 shtatorit 1943 dhe Giampiero Malnate vdes gjatë fushatës shkatërrimtare ruse. Romani mbyllet ashtu siç ishte hapur, i dedikohet vdekjes dhe kujtesës. Kritika e ka konsideruar si një ndër romanet më të bukura të letërsisë moderne italiane, prej të cilit është frymëzuar një nga prodhimet kinematografike më të suksesshme italiane, fitues i çmimit Oskar, me regjisor, Vittorio de Sica. Sipas kritikut letrar dhe shkrimtarit Albert Asor Rosa, bëhet fjalë për “ *një roman të paharrueshëm, e mjaft prekës për kujtesën, që rikrijon një periudhë tragjike të historisë. Kopshti i Finci-Kontinëve, përfaqëson atë pjesë magjepsëse të së shkuarës sonë, që aq shumë e duam, por që pikërisht për këtë arsye, ndiejmë aq nevojë të çlirohemi prej saj, në mënyrë që, të kemi mundësi të vazhdojmë të jetojmë e të jemi ata që jemi në të vërtetë*”¹⁷⁷.

Basani me narrativen e tij të veçantë, me heshtjen e tij, me ndjeshmërinë e lartë letrare dëshiron të shkojë përtej dokumentimit apo të dhënave historike, përtej britmave të lager-it. Për këtë arsye ndoshta nuk befasonemi kur lexojmë që Basani nuk e çmonte Primo Levin dhe nuk e pëlqente në mënyrë të veçantë veprën e tij “Se questo e un uomo”, duke shkruar me shumë rezerva, duke mbërritur edhe gati në mohimin e statusit

¹⁷⁶ G. Bassani, *Il giardino dei Finzi-Contini*, Torino, Einaudi, 1999.

¹⁷⁷ Vjen në shqip romani i Giorgio Bassanit, “Kopshti i Finci-Kontineve”, Gazeta *Panorama*, 11.04.2015

të tij si roman i mirëfilltë.

Si përfundim vlen të citojmë edhe një herë Basanin: “*Nuk mjafton vetëm madhështia tragjike e argumentit, as vënia në dukje e dëshmime dramatike, as sinqeriteti i rrëfimeve autobiografike për të krijuar romane të mirëfillta, përkundrazi janë pikërisht këto elemente që e lënë të paplotësuar realizimin e tyre si vepra arti.*”

BIBLIOGRAFIA:

1. Giorgio Bassani, *Kopshti i Finci – Kontinëve*, Botimet IDK, Tiranë, 2015.
2. Gazeta Panorama, *Vjen ne shqip romani i Giorgio Bassanit, “Kopshti i Finci-Kontineve”* 11.04.2015.
3. G. Bassani, *Il giardino dei Finzi-Contini*, Torino, Einaudi, 1999.
4. Tim Parks, *Controllo e negazione. L'allarmante modernità dei Finzi-Contini*. New York Book Review, (14 korrik 2005).
5. Beti Njuma, *Bassani, muret dhe letërsia*, Gazeta Shqip, 16.12.2016.
6. E.Montale, G. Bassani, *Il giardino dei Finzi-Contini*, Torino, Einaudi, 1999.

The silence of Bassani's confessions in “Finzi Contini”

ABSTRACT

The Finzi-Contini Garden is a novel that originated in a distant memory whose history extends over a distance of time, where the past has no connection with the present. Bassani turns an immortal story, an era, a family, the entire city of Ferrara, which deliberately is described with the finest details, mainly referring to the garden that has never existed. What matters, however, is the presentation of the emotions and feelings of the protagonist, who has dreamed of such a story, starting with a young experience. The true story goes beyond walls. One of the

most terrible and painful stories of all umanity serves as the prologue of almost all Bassanian narrative.

Dalila KARAKAÇI

**PASQYRIMI I PERSONALITETIT TË SHQIPTARIT
NËPËRMJET SYRIT TË AUTORËVE ANGLO-SAKSONË
TË GJYSMËS SË DYTË TË SHEK. XIX:
TOZER, NAJT DHE BRAUN**

1. Shekulli XIX: Koha e eksplorimeve

Shekulli i 19-të u bë kohë eksplorimesh për shumë udhëtarë të huaj e në veçanti ato anglo - saksonë, të cilët lënë gjurmë të një letërsie në formën e përshtypjeve mbi vendet e hulumtuara, shënimeve etnografike, antropologjike apo social - historike. Tipike për aristokracinë angleze këto udhëtime, sipas Bejkënit, shërbenin si “pjesë e edukimit për moshat e reja” dhe si eksperiencë jetësore “për moshat më të thyera”¹⁷⁸. Udhëtarët e parë evropianë udhëtuan nëpërmjet Greqisë në drejtim të tokave ku sundonte Ali Pashë Tepelena. Ndër to mund të përmendim Eduard Doduellin (Edward Dodwell)¹⁷⁹, Th.S. Hjuzin (T. S. Hughes)¹⁸⁰, Uilliam Martin Likun (William Martin Leak)¹⁸¹, Xh. Best (J.J. Best)¹⁸², D. Urkhartin (D. Urquhart)¹⁸³, Eduard Lirin (Edward Lear)¹⁸⁴ dhe, mbi të gjithë Bajronin (George Gordon Byron). Të gjithë udhëtarët që vizituan Shqipërinë, pas poetit të madh anglez, patën si referim udhëtimin e tij.

Shekulli ku pati një zhvillim të lëtërsisë së udhëtimeve, nëpërmjet udhëtarëve anglo-saksonë, në Ballkan fillon dhe mbaron simbolikisht me Shqipërinë, e cila në imagjinatën anglo-saksone vazhdonte të përfaqësonte pjesën më misterioze dhe më ballkanase të Ballkanit.¹⁸⁵ Tema shqiptare u bë më e prekshme dhe më e përgjithshme pikërisht nëpërmjet poemës

¹⁷⁸ Bacon, Francis, *Of Travel*. Kessinger Publishing LL, 2010, f.15.

¹⁷⁹ *A Clasical and Topographical Tour through Greece*. London, 1819.

¹⁸⁰ *Travels in Sicily, Greece and Albania*. London, 1820.

¹⁸¹ *Travels in Northern Greece*. London, 1835.

¹⁸² *Excursions in Albania*. London, 1842.

¹⁸³ *The Spirit of the East*. London, 1839.

¹⁸⁴ *Journals of a Landscape painter in Albania*. London, 1851.

¹⁸⁵ Goldsworth, Vesna, “The Ballkans in the 19th century British Travel Writing”. *Nw:Travel writing in the 19th century: Filling the Blank Spaces*, Anthem Press, London, 2006, f. 23.

liriko-epike të Bajronit: “Udhëtimet e Çajld Haroldit”. Goldsuorthi e përshkruan Bajronin si “*Kolombi i Ballkanit*” kryesisht, ngaqë shumë nga pasuesit e tij, teksa vizitonin Ballkanin nga gjysma e shek. XIX, dallohet qartësisht se ato po ndiqnin hapat e tij, duke konfirmuar, refuzuar apo përditësuar përshtypjet e tij.¹⁸⁶ Përmes vargjeve që ai i kushtoi Shqipërisë dhe shqiptarëve në këtë poemë, Bajroni arriti të shprehë vlerat më të mira kulturore, historike, bukurinë shpirtërore dhe atë natyrore të vendit tonë.

Ndër vizitorët e shumtë të Shqipërisë gjatë gjysmës së dytë të shekullit të 19-të janë Tozeri, Najti (Knight) dhe Brauni (Brown). Në ndryshim nga udhëtarët e mëparshëm, ato eksplorojnë Shqipërinë e Veriut apo më saktë atë pjesë të Shqipërisë, e cila shtrihet në pjesën veriore të Shkumbinit. Të tre e vizitojnë si pjesë të udhëtimeve në Malin e Zi, Dalmaci e Greqi. Gjatë kontakteve me njerëzit e thjeshtë vërehen traditat, zakonet, krijimtaria gojore, niveli ekonomik-shoqëror dhe politik i kësaj pjese të Shqipërisë jo shumë e hulumtuar më përpara.

Këto udhëtarë e vizituan Shqipërinë gjatë një periudhe kur po bëheshin përpjekjet për shkëputjen nga Perandoria Osmane. Shekulli XIX krijoi kushtet për ngritjen e ndërgjegjes kombëtare, zhvillimin e kësaj lëvizjeje dhe formimin e shqiptarëve si komb. Por ky shekull shënon edhe fillimin e Rilindjes Kombëtare. Një lëvizje me karakter kombëtar dhe përmbajtje ideologjike, politike, kulturore, ekonomik-shoqërore. Rilindja çoi në lindjen e nacionalizmit, karakteristikë për të gjithë Evropën, e cila kishte si qëllim forcimin e shtetit kombëtar dhe konsolidimin e idesë së kombit. Ajo shoqërohej me ndryshime në fushën politike, ekonomike dhe kulturore. Nëpërmjet saj bëhet e mundur vetëdija e të qenit një komb, etni, e të pasurit e një prejardhjeje të përbashkët në kulturë, histori, gjuhë dhe zakone të njëjta. Gjendja që përshkruan Najti është “*e një anarkie pozitive, ku në asnjë vend tjetër nuk janë kushtet më të pashpresa për pushtimin osman sesa në Shqipëri.*”¹⁸⁷

2. Personaliteti i shqiptarit sipas autorëve anglo-saksonë: realiteti historiko-shoqëror

Shqipëria e Veriut karakterizohej nga një organizim fisnor i shoqërisë

¹⁸⁶ Goldsworth, Vesna, “The Balkans in the 19th century British Travel Writing”. Në: *Travel writing in the 19th century: Filling the Blank Spaces*, Anthem Press, London, 2006”, f. 24

¹⁸⁷ Knight, Edward Frederick, *Albania: A Narrative of Recent Travel*. Sompson Low, Marston, Searle & Rivington, London, 1880, fq.117

në gjysmën e dytë të shek.XIX. Koncepti i *fisit* konsiderohej si një grupim njerëzish apo klan dhe i përngjan fjalës latine *gens*.¹⁸⁸ Ai ishte karakteristikë e shoqërive primitive. Sipas këtij koncepti bërthama e fisit është familja, ndërsa kryetari i saj është mashkulli më i moshuar apo patriarku i familjes. Shpërndarja territoriale është e mirëpërcaktuar dhe dallohet nga gjuha, kulti e emri i përbashkët.

Ky konceptim i organizimit fisnor të shoqërisë reflektohet tek një njësi administrative territorialo-politike, siç është *bajraku*.¹⁸⁹ Në veçanti në zonat malore një fis përbëhet nga disa bajraqe, të drejtuar nga një prej malësorëve të bajrakut. Rëndësia e pozicionit të bajraktarit u rrit gjatë sundimit të Karamahmut Pashë Bushatit, sundimtarit të Shkodrës nga fundi i shekullit XVIII, sepse tashmë nuk ishte vetëm përfaqësues i sanxhakbeut, por dhe udhëheqës ushtarak. Çdo bajrak është në vetvete një shtet i vogël autonom i qeverisur nga zakone dhe rregulla juridike të përbashkëta me bajraqe të tjerë.

Vetëm bajraquet e krahinës së Mirditës u bashkuan në një njësi administrative më të gjerë. Këto bajraqe u udhëhoqën nga një kryebajraktar të quajtur kapedan. Tozeri në librin e tij i referohet këtij drejtuesi të bajrakut, Bib Doda, me nominimin "*princ*".¹⁹⁰ Kjo përbën një ngatërrim termash, sepse nuk përkon me realitetin historik dhe shoqëror të kësaj krahine. Meqenëse principata nuk ekzistonte, atëherë përdorimi i termit nuk është i saktë. Sipas Tozerit kushtetuta e Mirditës është "*e një lloj aristokracie ushtarake; prandaj ekziston një kryetar me pushtet trashëgues dhe një asamble, në të cilën të gjithë janë të përfaqësuar. Pushteti përqendrohet në kryetarët e familjeve më të rëndësishme.*" (f. 307)

Për të marrë vendime rreth ligjeve që do të drejtonin jetën e tyre organizohen kuvendet e fiseve ku merrnin pjesë krerët e shtëpive nën drejtimin e kreut të fisit. Këto kuvende kishin si rregullues të normave e zakoneve në zonën e veriut **kanunin e Lekë Dukagjinit**, që i atribuohet

¹⁸⁸Skendo, Stavri, *The Albanian National Awakening, 1878-1912*. Princeton University press, New Jersey, 1967, fq.14

¹⁸⁹Bajraku (fjalë turke - flamur), njësi e vogël administrative territoriale në Shqipërinë Veriore dhe Verilindore e organizuar nga Perandoria Osmane në shek.XVIII. Në disa vise bajraku përputhej me shtrirjen territoriale të fisit. Në disa raste, bajraku përfshinte një varg fshatrash të afërt, banorët e të cilave nuk kishin lidhje gjaku ndërmjet tyre. Qëllimi i krijimit të tyre nuk ishte në vendosja e sistemit të timareve që po ndërtoheshin edhe atje ku ekzistonin. (Shih: Dhama, Todi, & Kuri, Wilson, *Fjalor Shpjegues i Termave Historike*. SHLNSH, Tiranë, 1989, f.23)

¹⁹⁰Tozer, Henry Fanshawe. *Researches in the Highlands of Turkey*, vol I, II. William Clowes & sons, London, 1869, f.307

Lekë Dukagjinit III, figurë e rëndësishme e Dukagjinit të shekullit XV. Këtij rregulluesi i drejtohej si zgjidhje për probleme të pronësisë, trashëgimisë, marrëdhënieve familjare, institutit të krimit, të dënimit dhe të gjakmarrjes në kushtet e një mungese të kontrollit të institucioneve ligjore. Xhyher Cani shprehet se *“rendi shoqëror që pasqyroi e drejta kanunore e Lekë Dukagjinit është ndërtuar mbi një strukturë që ruan mbeturinat e organizmit fisnor në periudhën e shpërbërjes së tij dhe lindjes së bashkësisë territoriale, madje këto dy struktura gjenden në bashkëjetesë.”*¹⁹¹

Shqiptarët e Veriut ndahen në disa fise, prej të cilëve ato të Kelmendit dhe të Mirditës janë më të rëndësishmet. Fiset e Mirditës ishin në kushte të rënda ekonomike, gati urie në zonat e tyre malore si rezultat i një lufte të pafund me qeverinë qendrore për shkak të refuzimit të mbledhjes së taksave. Këto luftëra vazhduan për një kohë të gjatë, derisa këta malësorë, për të ruajtur ekzistencën, u detyruan të bëjnë jetën e të paligjshmit.

Kjo mbijetesë e kësaj të drejte në zonën e Shqipërisë së Veriut e sidomos në atë të malësisë shpjegohet për disa arsye. Theksi mund të vihet tek veçimi i këtyre zonave nga e përgjithshmja e përbashkët me pjesët e tjera të territorit shqiptar. Mospasja e një pushteti shtetëror dhe e ligjit civil lejonte lulëzimin e mënyrave të tjera të organizimit të jetës shoqërore. Element tjetër mund të jenë pushtimet e shumta të vendit tonë, që krijuan mundësitë për një ruajtje e forcim të asaj çfarë ishte identifikuese shqiptare tek këto zona. Sipas Canit është pikërisht *“qëndresa e përgjithshme që thekson identitetin kombëtar të saj”*.¹⁹² Banimi në zona të largëta e të veçuara, në kushte të rënda ekonomike bën ruajtjen e identifikimin me organizimin fisnor. Çdo zakon dhe traditë shqiptare është mirëpërcaktuar në kanun. Prandaj për t'i vëzhguar e analizuar ato dhe karakterin shqiptar, duhet të nisemi nga ky “institutcion”.

Në Dukagjinin ku veproi kryesisht ky kanun, por edhe në zonat e tjera të Shqipërisë Veriore, **gjakmarrja** përbënte institutin e saj juridik. Forca e saj në fillim ishte mbi të gjithë fisin, pastaj me kalimin e viteve vjen duke u ngushtuar tek një grup i caktuar individësh, kryesisht anëtarët e familjes. Vrasja konceptohet si një krim i rëndë, por edhe kur nuk provokohet vrasja, ndëshkimi është po i rëndë, sepse është cënuar nderi i personit të sulmuar. Kur flasim për këtë zakon të zonës së veriut, të tre këto udhëtare vënë theksin tek mungesa e plotë e kontrollit të këtij fenomeni nga qeveria turke.

¹⁹¹ Cani, Xhyher, *Kërkime mbi Kanunin e Skënderbeut*. Camaj-Pipaj, Shkodër, 2000, f. 167.

¹⁹² Po aty, f. 41.

Najti thotë se “... administrimi i ligjit mbi krimin nuk është ndër funksionet e qeverisë turke. Çdo gjë i lihet një gjykatësi të papaguar (gjakmarrjes) dhe mbi të gjitha është një e ashtuquajtur ‘drejtësi’ e toleruar nga vetë njerëzit e shprehur tek rregullat e gjakmarrjes”.¹⁹³ Sipas Tozerit gjakmarrja është “rrjeti i armiqësive vdekjeprurëse ku barbari e kalon gjithë jetën duke vegjuar dhe ia lë si trashëgimi fëmijëve”. (f. 310) Ligjet e gjakut janë më të rëndësishme se çdo lloji tjetër.

Trajtimi që Brauni i bën kësaj çështje është më e thellë dhe jo aq sipërfaqësore sesa ajo e Najtit dhe Tozerit. Duke analizuar në thelb problemin ai e paraqet gjakmarrjen “jo si një impuls barbar i njeriut për të qenë i jashtëligjshëm. Përkundrazi, ajo përbën një detyrim shoqëror nënshtruar një kodi të rreptë. Mbi të gjitha është një kod nderi që ka ndikuar në karakterin krenar, të vetërespektimit dhe mikpritjes së të gjithë shqiptarëve.”¹⁹⁴ Brauni thekson numrin e madh të familjeve të përfshira në këtë kohë hakmarrjeje. Koncepti që këto fise kanë për jetën është sipërfaqësor. Dikush vret fqinjën e tij me gjakftohtësi dhe në të njëjtën kohë ai pret shpagimin me vrasje me po këtë ndjenjë. Vrasja e një burri kompensohet me vrasjen e dorasit (personit që kryen krimin) apo një të afërmi të tij mashkull. Gjakmarrja shtrihet tek individit dhe familja. Ky gjak mund të paguhet me një shumë të caktuar parash, në varësi të pozicionit shoqëror të viktimës, nëse të dy palët bien në marrëveshje.

Një element tjetër i rëndësishëm që përbën të drejtën zakonore është edhe mbajtja e fjalës së dhënë apo **besës**. Roli i saj duhet të vëzhgohet në lidhje me gjakmarrjen si rregullues ndaj këtij zakoni dhe njëkohësisht frenues, sepse bën të mundur zgjidhjen e konflikteve në mënyrë paqësore. Ajo paraqet anën humane të marrëdhënieve shoqërore në një ambient patriarkal e të vrazhdë gjeografik. Ajo shpreh nderin dhe burrërinë e banorëve të këtyre krahinave, kuptimin heroik të jetës. Në shoqërinë shqiptare krijohet kulti i saj, ndërsa ndëshkuesit dënohen me vdekje.

Sipas Braunit “fjala e nderit apo besa, nuk është një betim, por thjesht një fjalë e dhënë, e cila në asnjë rrethanë nuk thyhet.” (f. 66) Kjo shfaq një anë të rëndësishme të karakterit të shqiptarëve si miq të besuar. Për t’u vënë në dukje është se të tre këto udhëtarë, kur i referohen kësaj të drejte zakonore, nuk përdorin një përkthim të thjeshtë të fjalës në gjuhën e tyre, por gjithmone i referohen me shprehjen **kodi i nderit** apo **fjala e nderit**. Kjo për shkak të mitit të krijuar rreth saj.

¹⁹³ Termi që përdoret nga autori është vendetta. (Shih: Knight, E.F., *Albania: A Narrative of Recent...* vep. cit. f.123)

¹⁹⁴ Brown, H.A., *A Winter in Albania*. Griffith, Farrow, Okeden & Welsh, London, 1888, f.67.

I arratisuri nga drejtësia kanunore lejohet të hyjë në çdo shtëpi dhe të kërkojë ushqim e strehim për 24 orë. Mikpritësit janë të detyruar ta mbrojnë ose në të kundërt ta dërgojnë në një vend më të sigurtë. Ai është në besën e tyre për 24 orë dhe mikpritesit bëhen anëtarë të familjes së tij. Najti thekson *“besën që mikpritësit u japin miqve të tyre, duke i mbrojtur me jetë në rast nevoje. Miqtë i lënë në besë armët parpara se të futen në shtëpi.”* (f. 245) Besa nuk është element i veçuar i traditës shqiptare, por pjesë përbërëse e lidhëse me mikpritjen, me karakterin e personalitetin e fortë të shqiptarit. Asgjë nuk shkëmbehet përpos mirënjohjes ndaj mikpritësve. Gratë janë të përjashtuara nga gjakmarrja. Por gjaksori që kryen vrasje, mund të vihet në besën e saj dhe t'i konsiderohet jeta e sigurt.

Me kalimin e viteve forca e saj i kapërcen caqet e familjes apo të fisit, duke shërbyer si forcë lidhëse e fiseve dhe e krahinave. Mark Krasniqi e përcakton besën si një *“garanci e besnikërisë dhe miqësisë reciproke në kryengritjet e shumta kundër Perandorisë Osmane për lirinë kombëtare të shqiptarëve.”*¹⁹⁵ Sipas Braunit dhe Tozerit në rast të një lufte të përgjithshme, apo sulmi të një fisi, *“gjakmarrja pezullohet deri në mbledhjen e një kuvendi që i rihap nga e para.”* (f.65) Rëndësia e saj është edhe ekonomike. Kur familjet jetojnë në një fshat, njëra prej tyre detyrohet të largohet diku tjetër duke e lënë pronën në duart e gruas. Tozeri vazhdon me mendimin se *“gjatë periudhave të vështira të ikurit lejohen të kthehen në vendin e tyre, por duke dhënë besën, fjalën e nderit, për moscënimin e tij”* (f.65), sipas këtij *“kodi kalorsiak”* (f.154) në zonën e Mirditës, ku ishte shumë e theksuar, gratë lëvizin lirshëm duke u kujdesur për nevojat e familjes.

3. Personaliteti i shqiptarit sipas autorëve anglo-saksonë: zakonet, tradita

Mikpritja është një ndër zakonet e shqiptarëve që Brauni e quan një *“virtyt të egër të shfaqur jo vetëm ndaj vendasve, por edhe udhëtarëve të huaj. Sipas zakonit miku pritet me kafe dhe pyetje rreth prejardhjes e përshtypjeve për Shqipërinë.”* (f.60) Për shkak të kushteve të vështira ekonomike në të gjithë zonat e largëta malore, por edhe në qytet, kushtet që ofrohen janë jo të mira, për të mos thënë të mjerueshme. Por mikut i rezervohet një trajtim i veçantë brenda mundësive ekonomike. Në çdo shtëpi mund të gjendej mikpritje e njerëz të ngrohtë dhe ushqim i bollshëm.

¹⁹⁵Krasniqi, Mark, *Gjurmë e Gjurmime*. 8 Nëntori, Tiranë, 1979, f.171.

Këto autorë vënë theksin tek shprehjet mikpritëse që njerëzit përdorin si “*Bramimir*”, “*Mir s’erd*” dhe “*Ju baft mir.*”¹⁹⁶ (fq.223) Najti tregon eksperiencën e tij në fshatin e Kastratit dhe zakonet që e shoqërojnë këtë mikpritje si një eksperiencë komplekse, ku “*të gjithë njerëzit ulen pranë zjarrit dhe gruaja i heq keputët mikut.*” (fq. 223) Ky zakon i bën përshtypje mikut anglez, sepse ishte “*shumë larg civilizimit evropian.*” (f. 223) Kushtet e jetesës në përgjithësi në të gjithë territorin shqiptar janë tepër të varfra, sidomos në zonat e largëta malore, por armët janë të vetmet zbulime në këto shtëpi dhe madje shërbejnë si mjet identifikues. Sipas këtij udhëtari, “*në zakonin oriental gruaja e kryetarit të familjes i hedh ujë duarve të miqve, pastaj ushqimi konsumohet me duar shoqëruar me raki.*” (f. 225) Udhëtarët vërejnë edhe një aspekt tjetër të karakterit të vendasve: krenarinë. Najti shprehet se “*është ofendim i rëndë t’i ofrosh para për mikpritje këtyre njerëzve. Në të kundërt diçka mund t’i dhurohet fëmijëve. Pas largimit të miqve nëna merr paratë e fëmijëve për të blerë ushqime në pazar.*” (f.111)

Tozeri e përshkruan eksperiencën e tij në fshatin e Mirditës, i ftuar nga i ashtuquajti Princi i Mirditës, Bib Doda: “*si rregull, miqtë vendosen në të djathtë të mikpritësit, duke u rreshtuar nga më i moshuari tek më i riu. Gati në përfundim të vaktit sillet koka e zier e një qëngji dhe mikpritësi e vendos me duart e tij tek pjata e mikut kryesor.*” (f.312) Kjo tregon nderin që i tregohet mikut duke ia shërbyer njeriut që kryetari dëshiron të nderojë. Sasia e ushqimit që vendosej për t’u ngrënë ishin shenja të zakonit të mikpritjes. Kjo mënyrë e të imponuarit tek tjetri ishte thellësisht patriarkale dhe mëse e pritshme, ashtu siç ishte edhe vetë shoqëria shqiptare në tërë ato vite.

Kanuni, duke shërbyer si rregullator për çdo aspekt të jetës shqiptare jep edhe udhëzime për **fejesën e martesën** ndër çifte. Mosha e djalit për t’u martuar ishte 16 vjeç ndërsa ajo e vajzës 14-15 vjeçe. Dita e martesës nuk mund të ndryshohej. Dita e hënë ishte dita e dasmës për fenë katolike, e enjte për fenë myslimane, ndërsa dita e diel ishte për të dy besimet. Për të tre këto udhëtarë të gjysmës së dytë të shekullit XIX, martesë shqiptare dhe ritet e saj mund t’i jenë dukur sa të çuditshme, tërheqëse, aq dhe të largëta. I fejuari asnjëherë nuk e shikon të premtuarën e tij deri në ditën e dasmës. Vajza qëndron në shtëpinë e të atit deri në moshën e arritur për martesë. Asnjë mashkull nuk lejohet ta shohë atë, përveç të afërmeve. Me të arritur moshën e martesës prindërit hapin fjalë tek miqtë e tyre se kanë vajzë për martesë. Mund të ndodhë që vëllai i vajzës të zgjedhë vetë

¹⁹⁶ Këto shprehje gjenden të përfshira në veprat e të tre autorëve.

bashkëshortin për motrën e vet. Djali i përzgjedhur e konsideron ofertën si nder të madh për të prandaj, refuzimi as nuk mendohet.

Në zonën e Mirditës ekzistonte zakoni i të grabiturit të femrave. Ato nuk martoheshin me ndërmjetësi, por rrëmbenin femra nga fiset fqinje të besimit mysliman. Pastaj femra pagëzohej dhe martohej. Në shkëmbim, familja e bashkëshortes paguhej për vajzën e marrë. Megjithëse fanatikë në besim, ndjenja e kombësisë mbizotëronte.

Koncepti që shqiptarët kanë për martesën dhe marrëdhënien në çift, është pjesë e traditave, zakoneve dhe e mënyrës së konceptimit të jetës. Të kushtëzuar nga izolimi në zonat e thella malore, vështirësitë ekonomike dhe politiko-shoqërore bënë të mundur zhvillimin e saj nën influencën patriarkale-fisnore. Qëllimi kryesor për banorët meshkuj ishte “*biznesi i luftës*” dhe gratë ishin thjesht mbështetëse të tyre. Për shkak të këtij konceptimi të jetës nuk lejohej të shfaqeshin ndjenjat e mashkullit ndaj femrës, tepër të papërshtatshme për karakterin e fortë, patriarkal e burror të meshkujve.

Riti i festës së dasmës përshkruhet me shumë kureshtje. Gjatë asaj dite nusja qëndron në një dhomë të veçantë. Dhëndri refuzon të futet në dhomën e saj, por të ftuarit dhe të afërmit e nuses i bien mbi kurriz për ta detyruar të futet me forcë. Siç u shpreha më lart, deri në ditën e dasmës, vajza qëndron me familjarët si për të përjetuar më thellë ndryshimin e statusit të saj familjar. Nëse me kalimin e viteve asnjë mashkull i përshatshëm nuk e pranon atë për grua i mbetet vetëm një rrugëzgjdhje: vajza mund të bëhet murgeshë e të veshë rrobën e bardhë të Urdhrit të Murgeshave të Shkodrës. Kjo i lejon që të kryejë disa shërbime në kishë, por në pjesën më të madhe të kohës kanë liri absolute, të cilën nuk e gëzojnë femrat e martuara në Shqipëri e, aq më pak, në vendet e Lindjes.

Për të kuptuar më mirë marrëdhëniet martesore duhet të analizojmë rolin e gruas në shoqërinë shqiptare të asaj periudhe, me në qendër zonën e Veriut. Këto tre udhëtarë, e në veçanti Najti, mahnitet nga “*mënyrat e bukura dhe plot hir të të sjellurit*.” (f.128) Gratë e Veriut në ndryshim nga ato të zonës jugore të vendit dhe të Orientit në përgjithësi tregojnë më shumë kujdes për bukurinë e tyre, duke u përpjekur ta ruajnë atë sa më gjatë. Gratë e fshatit janë të stërmunduara nga punët e rënda, ndërsa ato të qytetit kanë një jetë kryesisht sedentare, duke dalë shumë rrallë jashtë shtëpie. Najtin e befason fakti që “*gjatë një feste në shtëpi ato janë të detyruara të qëndrojnë në cep të dhomës duke parë burrat, që festojnë e duke pritur që t’i japin fund gëzimit, për t’i lënë rradhën atyre që të festojnë me atë që ka mbetur për t’u ushqyer*.” (fq.255) Në të gjithë Shqipërinë gratë përdoren si mjet për të mbajtur ngarkesa të rënda në vend

të kafshëve. Ky keqtrajtim i tyre mund të shihet tek një episod i shprehur nga Tozeri ku thuhet se “*natyra nuk na ka dhënë mushkat, por na ka dhënë gratë.*” (f.207) Arsyetimi i burrave shqiptarë shpreh pushtetin e pakufizuar në familje, pozitën nënshtruese të gruas, vrazhdësinë, anën prapanike të karakterit mashkullor.

Në Kanunin e Lekë Dukagjinit ka vepruar **ekzogamia**¹⁹⁷ një zakon në shoqërinë primitive, i cili ndalonte martesën brenda gjinisë. Elementi patriarko-fisnor ekzistonte në shoqëri shqiptare të shekullit XIX. Në përgjithësi martesat bëheshin ndërmjet fiseve të ndryshme. Për të mbajtur të pastër traditën fetare të familjes, sidomos atë të krishterë, kufizimi i ekzogamisë u vendos deri në pesë breza. Malësoret e Veriut nuk e merrnin në konsideratë këtë kufizim, edhe pse ekzistonin shumë ndalime në Kanunin e Lekë Dukagjinit. Në Mirditë, meqenëse martesat brenda fisit ishin elemente të ekzogamisë, ato shoqëroheshin me rrëmbimin e grave nga fiset e tjera për ta eliminuar sa më shumë të ishte e mundur. Tozeri vë në dukje se “*Mirdita ishte ndër të vetmet vende në Evropë ku ky fenomen akoma ekzistonte.*” (f. 319)

Për të kuptuar më mirë arsyet e ekzogamisë, duhet të analizohen edhe kushtet shoqërore e ekonomike të shoqërisë ku ajo zhvillohej. Shoqëria shqiptare e këtij shekulli, në rrafshin ekonomik karakterizohej nga një varfëri e plotë, për shkak të konflikteve me fqinjët në favor të sundimit të territorit dhe konfliktit me Perandorinë Osmane për vënien me forcë nën kontroll të këtyre zonave. Ndjenja e armiqësisë ishte normale në këto fise, prandaj ishin të shpjgueshme edhe mosmarrëveshjet e shumta. Si rezultat i kësaj, kur numri i femrave ishte në proporcion të zhdrejtë me atë të meshkujve, atëherë meshkujt i kërkonin gratë e tyre tek fiset e tjera. Për shkak të kësaj atmosfere, gratë fitohen pas sukseseve në betejë ose pas plaçkitjeve. Zakoni i të martuarit të grave jashtë fisit u vendos si kusht i domosdoshëm për të mos shkelur ekzogaminë, e cila, në të kundërt lejonte rrëmbimin sistematik të grave. Në momentin që praktikata e martesës brenda fisit nuk ekzistonin më, të bën të besosh e të arrish në konkluzionin, se ato ishin martesat të inçestit, sepse të gjithë fiset kishin një paraardhës të përbashkët.

Gjatë hulumtimeve të shumta, thotë Tozeri “*ekzogamia është parë si pjesë përbërëse e shoqërive të Amerikës Jugore, Veriore, të Australisë, në ishujt e Paqësorit, Indi dhe Afganistan. Edhe në këto vende është shoqëruar me rrëmbimin e femrave dhe zakonisht martesat brenda fisit ndalohej si*

¹⁹⁷ Fjalë me prejardhje nga greqishtja e lashtë. Ekso-jashtë, gamos-martese. Zakon në shoqërinë primitive, që ndalonte martesën brenda gjinisë. (Shih: Dhama Todi & Kuri, Vilson. Fjalor... vep. cit. f.58)

inçest.” (fq.320) Sipas kësaj arrihet në përfundimin se shkëputja nga inçesti nuk ishte shkak thelbesor i ekzogamisë, pasi vetë ekzogamia, si faktor përbërës i shoqërisë, ka qenë me karakter universal, ndërsa në shoqëritë primitive, martesat ndërmjet të afërmëve nuk ishin të papërshtatshme. Për këtë i referohemi shembullit nga Tozeri të “*Abrahamit në Dhjatën e Vjetër*”. (f.321) Akoma më tepër, në shoqëritë barbare, lidhjet e gjakut nuk duket të kenë pasur peshë të madhe. Në këto kushte gati çdo racë e qenies njerëzore ka kaluar afërsisht të njëjtat hapa zhvillimi e ka shumë mundësi që ekzogamia të ketë ekzistuar ndërmjet tyre.

Si konkluzion, sistemi i ekzogamisë në Mirditë është i arrirë. Ai paraqet realitetin e rrëmbimit, i cili shoqërohet me pagesë nga ana e rrëmbyesit e pak rezistencë nga ajo e personit të rrëmbyer. Gratë që rrëmbehen janë të besimit tjetër dhe vetëm në këtë mënyrë mund të martohen me të krishterë. Ajo është edhe shprehje e një mendësie tradicionale dhe primitive, sepse ishte më e hijshme apo me burrërore të rrëmbeje një grua me forcë e me kalimin e kohës, të kthehej në detyrim që kërkimi i femrës të bëhej nga një fis apo besim tjetër.

Shqiptarët i kushtojnë vëmendje **festave fetare**. Najti merr pjesë në festimet në Shkodër të Zojës së Shkodrës, që, sipas tij, i kushtohej ikjes së statujës të Virgjëreshës Mari nga qyteti në mënyrë të pashpjegueshme. Gjatë procesionit, Najti vëren “*gjendjen e brendshme të kishës pa asnjë ornament tipik për këtë vend kulti e asnjë shenjë që të përcaktonte përkatësinë fetare. Është vështirë të imagjinohet se po merret pjesë në një procesion të fesë katolike.*” (f.153) Brauni përshkruan myslimanin shkodran gjatë festimeve të Bajramit. Ai i kushton vëmendje veshjes, të cilën e ka të stolitur me të gjithë ornamentet e mundshme. Spikat fustanella e bardhë. Gjatësia e saj ndryshon sipas pozicionit që zë në shoqëri. Najti përshkruan një mbrëmje “*me një bandë që luante jashtë kishës, ndërsa fretërit e urdhrit françeskan organizonin hedhje me balona për të zbavitur njerëzit e pranishëm. Rrugët ishin të ndriçuara me fenerë shumëgjyresh kinez dhe njerëzit festonin sipas mundësive. Në veçanti ky ishte një rast për të pirë raki e dehur*”. (f.154)

Elementi më i rëndësishëm që vinin në dukje festat fetare ishte klima shoqërore në vend. Të tre këto udhëtarë, në varësi të copëzave të eksperiencës, tregojnë dallimet fetare, por mbi të gjitha marrëdhëniet pozitive që ekzistonin ndërmjet feve. “*Malësorët bashkoheshin me të krishterët dhe myslimanët shkodranë në festime, duke dhënë përkushtimin e tyre në ditën, kur nderohej nëna e Krishtit,*” thekson Najti. (f.153) Megjithëse gjysma e Shqipërisë e quante veten të krishterë dhe gjysma e

besimit mysliman, ndarjet nuk ishin të thella. “*Myslimanët adhurorin kultin e Virgjëreshës Mari*”, ndërsa të krishterët “*bënin peligrinazh në varrezat e shenjtoreve të besimit mysliman*,” (fq.153) duke përzier çdo lloj **bestytnie** në fenë e tyre. Prandaj, themi se feja nuk ka qenë element ndarës në Shqipëri edhe në sytë e të huajve. Vetëdija e të qenit shqiptar sundonte mbi çdo gjë.

Pjesë e riteve të shumta është pjesë edhe ai i **mortit**. Përshtypja që këto udhëtarë kanë është se shqiptarët e pranojnë vdekjen me seriozitet dhe gjakftohtësi, sikur duhet të bëjnë një udhëtim nga një vend në një tjetër. Najti rastësisht vëzhgon një funeral të fesë së krishterë dhe ajo që bie në sy janë të qarat e të bërtiturat e grave, të cilat qëndrojnë pas kufomës së të vdekurit të marrë në sup nga burra të shumtë. Ky zakon është tipik oriental dhe ka ekzistuar që në kohët e lashta.

Gjatë vajtimit gratë përmendin cilësitë më të mira të të vdekurit, e thërrasin me emër, sikur të ishte gjallë e t’u përgjigjej, ankohen pse po ikë: “*Ai ishte i dliurë, i pashëm, i këndshëm dhe trim. Qyqja! Askush nuk do t’i falë më dashuri, kurrë më nuk do të shkojnë këmbët e tij për gjah. Armiqve do t’i bëhet zemra mal e nuk do të kenë më frikë. Qyqja! Qyqja! Ai nuk është mes nesh! Dheu i ftohte do ta mbulojë...*” (fq.154) Ky version i është përshtatur mjaft mirë realitetit, por një mënyrë më origjinale e shprehur në vargje sipas traditës popullore do të ishte kjo:

*Qyqjy unë për ty bir,
Çka ke djalë i nanës bir,
Pse si çilë ata sy të bukur, bir,
A thua po flen ala, bir!*¹⁹⁸

Malësoret e vajtojnë të vdekurin me të njëjtin intensitet si gratë, madje ndjesia e hidhërimit shprehet me një forcë fjale e gjeste mbresëlënëse. Këto burra, të quajtur vajtojës, i shoqërojnë fjalët duke i rënë ballit me grushta, gërvishten me duar në fytyrë, herë pas here ulin kokën duke iu afruar të vdekurit.

Në veprat e këtyre udhëtarëve vërehen shprehje të ndryshme në

¹⁹⁸ Mihaçević, Lovro, *Nëpër Shqipëri. Mbresa Udhëtimesth dhe Etnografi*. Fishta, Tiranë, 2006, f.70.

gjuhën shqipe, **urime dhe mallkime**, që theksojnë anë të ndryshme të karakterit shqiptar. “*Bothmir, mik*”, “*Me teneson miku idaxtun*”, “*Kismet*”, “*Ku Turku vee kambet atu sdel baar*”, “*Ana e kecie nuk schet*”. Gjithë këto shprehje theksojnë virtytet e vendasve. Sipas Najtit, “*ato janë miq të mirë, prind të mirë, bashkëshortë të mirë, njerëz të besës, mikpritës, jo hileqarë, qokatar, por fisnikë. Janë indiferentë ndaj jetës njerëzore dhe kanë për dëshirë të vrasin. Herët apo vonë çdo njeri vritet. Ata dëshirojnë të vdesin. Të vdesësh në shtrat është njollë turpi.*” (f. 237)

Brauni, Tozeri dhe Najti bëjnë një krahasim të vendasve me popujt e tjerë të Ballkanit e vënë në dukje prejardhjen e lashtë dhe fisnike si komb me të cilën sllavët nuk krahasohen. Tek malësorët e paqytetëruar dhe banorët e qytetit të Shkodrës “*vërehen mënyrat politese të të sjellurit. Armiq të dhunshëm, të egër dhe të pamëshirshem, por miq për kokë.*” (fq.125)

PËRFUNDIME:

Tozeri, Najti, dhe Brauni udhëtuan në Shqipëri gjatë gjysmës së dytë të shekullit XIX. Këto tre udhëtarë pasqyrojnë përshtypjet e tyre mbi territorin e vizituar me një diferencë kohore, e cila njëkohësisht shpreh edhe qasjen e ndryshme të çështjeve të trajtuara. Në përshtypjet e mbledhura gjatë këtij udhëtimit vërehen shënime mbi realitetin historiko-shoqëror, zakonet dhe traditat më të spikatura të malësorëve të veriut, por edhe të banorëve të qytetit të Shkodrës. Vepra e tyre dimensionon vlera origjinale, pasi këtë informacion e paraqesin thuajse në një truall të paeksploruar më parë nga ato anglo-saksonë apo të cekur pjesërisht. Shumica e udhëtarëve anglo-saksonë kishin arritur deri në pjesën jugore të Shkumbinit. Me rëndësi paraqiten dhe krahasimet me vendet e tjera të Ballkanit dhe jo të trajtuara më vete.

REFERENCA:

1. Bacon, Francis, *Of Travel*. Kessinger Publishing LL, 2010.
2. Best, J.J., *Excursions in Albania*. London, 1842.
3. Brown, H.A., *A Winter in Albania*. Griffith, Farrow, Okeden & Welsh, London, 1888.
4. Dodwell, Edward, *A Classical and Topographical Tour through Greece*. London, 1819.
5. Dhama, Todi, & Kuri, Vilson, *Fjalor shpjegues i termave historike*. SHLNSH, Tiranë, 1989.
6. Goldsworth, Vesna, "The Balkans in the 19th century British Travel Writing". Në: *Travel Writing in the 19th century: Filling the Blank Spaces*, Anthem Press, London, 2006.
7. Hughes, T.S., *Travels in Sicily, Greece and Albania*. London, 1820.
8. Leak, William Martin, *Travels in Northern Greece*. London, 1835.
9. Lear, Edward, *Journals of a Landscape painter in Albania*. London, 1851.
10. Knight. E.F., *Albania: A Narrative of Recent Travel*. SompsonLow, Marston, Searle & Rivington, London, 1880.
11. Skendo, Stavri, *The Albanian National Awakening, 1878-1912*. Princeton University press, New Jersey, 1967.
12. Tozer, Henry Fanshawe. *Researches in the Highlands of Turkey*, vol I, II. William Clowes & sons, London, 1869.
13. Urquhart, D., *The Spirit of the East*. London, 1839.
14. Mihaçević, Lovro, *Nëpër Shqipëri. Mbresa udhëtimesh dhe etnografi*. Fishta, Tiranë, 2006.

**Representing the Self through the Eyes of the Others.
The Albanians in the British Travel Writing of the Second Part of the
19th Century: Tozer, Knight, and Brown.**

ABSTRACT

19th century was a time of exploration for many foreign travellers, especially British, who left traces of their experience about the places surveyed in ethnographic, antropological and socio-historical notes taking the form of British travel writing.

Tozer, Knight, and Brown travelled across Albania in the second part of the 19th century. They explored Northern Albania, mainly the region

lying in the northern part of Shkumbini river. These visitors went to Albania as part of the Grand Tour in Montenegro, Dalmacia, and Greece. The travel writing produced in this era give hints of originality as the region was unexplored by the English speaking travellers. While meeting the simple people of Mirdita and Shkoder comes to light the traditions, customs, socio-economic and political conditions of the natives. The information revealed is essential for other travellers and the Albanians too.

Iri Pirani

ANALIZË E VLERAVE NË VEPRËN “VUAJTJET E DJALOSHIT VERTER”

*“Efekti i këtij libri të vogël ishte i madh, madje i jashtëzakonshëm, sidomos ngaqë erdhi në kohën e duhur... Kështu, shpërthimi që pasoi tek lexuesit, ishte aq i fuqishëm, sepse të rinjtë tashmë shpërthyen me kërkesat e tyre, pasionet e papërbushura dhe vuajtjet e imagjinuara.”*¹⁹⁹Johan Wolfgang GËTE

Romani “Vuajtjet e djaloshit Verter” i shkrimtarit gjerman Gëte, botuar më 1774 dhe i sjellë në shqip nga gjuhëtari dhe përkthyesi i mirënjohur Petro Zhejinë, Tiranë, 2004, ishte një sukses i menjëhershëm dhe u konsiderua simbol i rrymës letrare gjermane “Stuhi dhe vrull” (Sturm und Drang). Nëpërmjet glorifikimit të ndjenjës, kjo rrymë e re letrare do të kapërcente sundimin e arsyes së Iluminizmit, si dhe do t’i paraprinte Romantizmit.

Përpara shfaqjes së romanit, publiku ishte mësuar me lexime konstruktive didaktike, qëllimi kryesor i të cilave ishte të udhëzonin lexuesin në tema të caktuara. Me Verterin, paraqitet për herë të parë një letërsi, në të cilën mungon vlerësimi dhe korrigjimi i veprimeve të diskutueshme morale. Më vonë, në autobiografinë e tij “Dichtung und Wahrheit” (Trillimi dhe e vërteta), Gëte shkroi: *“Vepra s’ka asnjë qëllim didaktik. Ajo nuk miraton, nuk qorton, por zhvillon botëkuptimet dhe veprimet në rrjedhën e saj, e në këtë mënyrë, ajo ndriçon dhe udhëzon.”*²⁰⁰ Kjo do të thotë se vepra nuk ka udhëzime direkte, por i paraqet ato indirekt.

Në këtë roman, trajtohen një larmi vlerash, si dhe konfliktet e Verterit me vlerat e shoqërisë asokohe. Vetë titulli i romanit na tregon për rolin e rëndësishëm të vlerave të kësaj vepre: Emri Verter (Werther) është i ashtuquajtur “telling name”²⁰¹: Në gjuhën gjermane, mbiemri “wert” ka

¹⁹⁹ Goethe, J. W.: Dichtung und Wahrheit. In: Goethe Werke, Hg. v. Klaus Detlef Müller. Darmstadt, 1998, f. 529-530.

²⁰⁰ Po aty, f. 530.

²⁰¹ “Telling name” do të thotë “emër tregues”: Një autor mund t’i vërë qëllimisht personazhit të tij një emër, që përmban domethënien e cilësive të veçanta të këtij personazhi.

kuptimin “*me vlerë*”, ndërsa emri i personazhit “*Werther*” është shkalla krahasore e këtij mbiemri. Siç pohon edhe profesori i letërsisë gjermane Matthias Luserke-Jaqui, kjo do të thotë se Verteri ka më vlerë sesa ndonjë personazh tjetër: “*Verter ka më shumë vlerë sesa Alberti... Përpjekja për ta emancipuar pasionin, një mënyrë, në të cilën jeton Verteri, vlen më shumë sesa përpjekja e Albertit të disiplinuar për ta ndrydhur atë.*”²⁰²

Vlera e lirisë

“*Fakti që ky libër u bë romani më popullor i kohës, dëshmon se ai erdhi në momentin e duhur për historinë e njerëzimit. Ishte koha kur njerëzit mësuuan ta perceptojnë veten si individë më vete. Mjeshtri u shkëput nga esnafët, qytetari u shkëput nga bindja ndaj një monarku absolut, i krishteri u shkëput nga pretendimet dogmatike të kishës për besim. Dhe individi i çliruar e përjetoi përmbushjen e tij përmes ndjenjës.*”²⁰³ Duke u nisur nga koncepti i lirisë së individit, Matthias Luserke-Jaqui e konsideron “*Stuhi dhe vrull*” si “*iluminizim i Iluminizmit.*”²⁰⁴

Një aspekt tjetër i kërkimit të vetëvendosjes është vetë forma e romanit. Sipas teorive të poetikës asokohe, romani tradicional me letërkëmbim i Iluminizmit kishte funksion të rëndësishëm në edukimin e shoqërisë. Ky roman duhej të kishte dialog, duke i kushtuar kështu shumë rëndësi komunikimit si tipar kryesor të sjelljes në shoqërinë borgjeze. Gëte, me qëllim që të provokojë dhe të shprehë haptazi dëshirën për çlirim nga normat, i shpërfill pikërisht këto rregulla të poetikës. Romani i tij merr formën e një ditari, pasi letrat janë monologje, gjë që e pengon formën komunikative të tekstit. Pra, kjo formë e re e romanit me letërkëmbim nuk ka në plan të parë dialogun, por shprehjen e gjendjes psikologjike të personazhit.²⁰⁵

Zemra dhe natyra si vlera të lidhura me njëra-tjetrën

“*Zemra*” është fjala që shfaqet shumë shpesh në letrat e Verterit dhe përbën temën e gjithë romanit.²⁰⁶ Që në letrën e parë, ai shpreh pakënaqësinë e tij në lidhje me kufizimet e qytetit, i cili i duket i shëmtuar, pasi, me normat dhe rregullin e tij, i kundërvihet dashurisë së tij për liri. Verteri,

²⁰² Luserke-Jaqui, M.: *Deutsche Literaturgeschichte in 10 Schritten*, Tübingen, 2017, f. 86.

²⁰³ Beutler, E: *Die Leiden des jungen Werthers*. In: Goethe, J. W., *Die Leiden des jungen Werthers* –Reclams Universal-Bibliothek, Stuttgart, 1948, f.149.

²⁰⁴ Luserke-Jaqui, M.: *Deutsche Literaturgeschichte in 10 Schritten*, Tübingen, 2017, f. 79.

²⁰⁵ *Po* aty, f. 84.

²⁰⁶ Beutler, E: *Die Leiden des jungen Werthers*. In: Goethe, J. W., *Die Leiden des jungen Werthers* –Reclams Universal-Bibliothek, Stuttgart, 1948, f. 148.

përkundrazi, ndjehet mirë në kopshtin e kontit të ndjerë: *“Kopshti vjen i thjeshtë dhe ndjen, posa hyn, se s’ke të bësh aspak me një kopsht të punuar nga një dorë e stërvitur, por nga një njeri me zemër të ndjeshme, që e ndërtoi atë sipas qejfit dhe shijes së tij”* (shih: Letrae dt.04.05.1771). Në këtë frazë, vërehet injorimi i individit racional të “Iluminizmit” (dorë e stërvitur) dhe vlerësimi i njeriut të ndjeshëm e të lirë të “Stuhi dhe vrull” (njeri me zemër të ndjeshme).

Në letrën e dytë të romanit, përshkruhet një luginë, në të cilën Verteri “rri shtrirë përdhe mes barit të lartë, atje buzë një përroi”. Ai i gëzohet rrezeve të diellit, bimëve të vogla dhe mizërisë së krimbave e insekteve... Kjo natyrë përbëhet nga ndjenja e jo nga dija. Ajo nuk është një sistem, ligjet e të cilit duhet t’i kuptosh.²⁰⁷

Parimi që e ngre zemrën në një tregues të vlerës njerëzore, është në kundërshtim me vlerësimin e njeriut bazuar në performancën dhe arritjet e tij: *“Veç kësaj, çmon më tepër tek unë inteligjencën dhe talentin se sa zemrën, që është e vetmja gjë për të cilën unë jam krenar... Ah, ato sa di unë, Ndokush mund t’i dijë, po zemra ime është vetëm imja dhe e askujt.* (shih: Letra e dt.09.05.1772)

Muzika

Verteri thekson që gjendja fizike ka një ndikim të madh në gjendjen shpirtërore të njerëzve.

Sipas tij, “humori i rëndë” duhet parë si një “sëmundje”, për të cilën duhet kërkuar ilaç. Charlota përgjigjet duke u nisur nga eksperiencia personale: *“Kur diçka më mërzit, unë nuk pres që mërzia të më vërë poshtë, po rend nëpër kopsht, zë e këndoj atje ndonjë arie dansi dhe mërzia sakaq kalon”* (shih: Letra e dt.01.07.1771). Kjo mënyrë e Sharlotës për të larguar humorin e rëndë bie ndesh me udhëzimet mjekësore e psikologjike të Iluminizmit.²⁰⁸ Pra, natyra dhe muzika, sipas Sharlotës, janë ilaçi më i mirë për një arsye të shëndoshë. Në letrën e 16 qershorit 1771, Verteri shkruan: *“Biseda u vërtit më tej mbi kënaqësinë që të jep dansi. Pasioni i të kërcyerit mund të gjykohet edhe si i lig, - tha Charlota, po për mua, pse ta fsheh, nuk ka si dansi! Dhe ndonjëherë kur më ndodh të jem e mërzitur, mjafton të luaj në pianon time të shkurdisur një kontradans dhe mërzia sakaq kalon!”* (shih: Letra e dt.16.06.1771). Me këtë frazë, Charlota pranon se ka pasione që ajo i miraton dhe i pëlqen.²⁰⁹ Nga ana tjetër, edhe Verteri shpreh

²⁰⁷ Petersdorff, D: Ich soll nicht zu mir selbst kommen. In: Goethe-Jahrbuch, Göttingen, 2006, f. 69-70.

²⁰⁸ Luserke-Jaqui, M.: Deutsche Literaturgeschichte in 10 Schritten, Tübingen, 2017, f. 91.

²⁰⁹ Po aty, f. 92.

kënaqësinë që i fal muzika. Në letrën e 16 korrikut, ai përshkruan sesi Sharlota luan një melodi në piano: “*Është motivi i saj i preferuar që mua me çliron përfundimisht nga çdo vuajtje e turbullesë e kujdes e brengë, posa që ajo zë e i bie notës së parë*” (shih: Letra e dt.16.07.1771). Pra, muzika e Sharlotës ndikon pozitivisht në depresionin e Verterit dhe shëron paksa vuajtjet e tij. Duke konfirmuar efektin e veçantë të muzikës, ai vazhdon: “*Besoj tashmë verbazi në të gjitha mrekullitë që të vjetrit i vishnin fuqisë magjike të muzikës.*” Pra, Sharlotën dhe Verterin i bashkon pasioni për muzikën me efektin e saj qetësues.

Vlera e fjalës dhe limitet e saj

Verteri shpreh pakënaqësi për pamjaftueshmërinë e gjuhës së shoqërisë. Ajo nuk mjafton për të shprehur bukurinë e natyrës apo situata të tjera me shumë rëndësi. Mund të përmendim, për shembull, momentin kur ai kërkon t’i rrëfejë Vilhelmit fjalët e Sharlotës për nënën e saj të vdekur, por ai ndjen që fjalët nuk mjaftojnë për të rrëfyer një ligjërim aq prekës të saj. Ai i quan shkronjat “*të ftohta e të vdekura*” (shih: Letra e dt.10.09.1771).

Kur Verteri përpiqet të përshkruajë veçantinë e Sharlotës, ai e quan atë një “*ëngjell*”. Por edhe në këtë moment haset vështirësia e të shprehurit, si pasojë e mangësisë së gjuhës: “*Një ëngjell... Dhe prapë, megjithatë, unë nuk jam në gjendje të të them se sa e përsosur është ajo dhe përse është e përsosur*” (shih: Letra e dt.16.06.1771).

Në mënyrë që gjuha mos të duket kaq e varfër dhe e ftohtë, duhet përshkruar çdo gjë në mënyrë identike, si të ishte një pikturë. “*Kështu, Verteri ndërmerr rolin e një Prometeusi. Si një Zot krijues, ai do t’i “japë jetë” letrës, duke hedhur në letër atë çka jeton tek ai “kaq e plotë dhe e ngrohtë”*”²¹⁰.

Si shembull mund të sjellim përshkrimin e pusit: “*Varesh në të tatëpjetën e një kodre të ulët e ndodhesh sakaq përpara një shpelle; zbrete aty nja njëzet shkallë dhe ja, së fundi, një shkëmb i mermertë nga ku shpërthen një ujë që s’ka si bëhet më i kulluar*” (shih: Letra e dt.12.05.1771).

Integrimi shoqëror dhe refuzimi i punës si një rol funksional

Verteri has vështirësi në integrimin në shoqëri dhe shpeshherë gjendet i përjashtuar nga mjedisi që e rrethon. Aspiratat e tij për shpалosjen e lirë të individit ia pengojnë rrugën drejt integrimit shoqëror. Kështu, ai

²¹⁰ Luserke-Jaqui, M.: Deutsche Literaturgeschichte in 10 Schritten, Tübingen, 2017, f. 88.

duhet të paguajë çmimin e vetmisë së brendshme, sepse shoqëria nuk ndan të njëjtin mendim me të për vlerat e individualitetit.

*“Individin nuk e shkatërrojnë pasionet e as pretendimi për emancipimin e pasioneve, por vetëm paaftësia e shoqërisë për të gjetur një mënyrë tjetër sesi të veprojnë me to, përveç disiplinimit e vetëpërmbajtjes.”*²¹¹

Kërkimi i lirisë në të gjitha aspektet qëndron në krye të konflikteve të tij me shoqërinë. Verteri mendon se qëllimi i punës nuk është fitimi i parasë, por ushtrimi i pasionit të njeriut: *“Një njeri që ... jo i shtyrë nga pasioni, bie përmbys në punë për para, për lavdi apo për çfarëdo gjë tjetër, është, s’ka dyshim e kurdoherë, një hajvan”* (shih: Letra e dt.20.07.1771).

Për Verterin, i cili e ka të siguar anën financiare përmes nënës së tij, në plan të parë nuk janë dobitë ekonomike, por vetëpërmbushja dhe individualizmi. Megjithëse ai nuk e pëlqen punën dhe sidomos vartësinë, pranon të punësohet vetëm me qëllim që të shpërqëndrohet nga brenga e tij e dashurisë. Në pozicionin si sekretar diplomatik, ku duhet të ndjekë një stil specifik për shkrimin e teksteve juridike, Verteri nuk dëshiron t’u përmbahet këtyre kodeve të komunikimit. Ai është kundër kufizimeve të çdo lloji, si në art, ashtu edhe në punë. *“Kështu ai përpiqet të mbajë qëndrimin e tij për t’u perceptuar si njeri, si individ, dhe jo si një rol apo funksion social.”*²¹²

Per shembull, ai përdor shpesh inversionin, i cili është tipik për gjuhën e tij emocionale. Ky stil shkrimi, i cili i përket më shumë sistemit artistik sesa juridik, kritikohet nga ambasadori: *“Mjerë ti në harrofsh një “dhe” a ndonjë lidhëz tjetër çfarëdo, sado e vogël dhe e parëndësishme qoftë, dhe le pastaj në të shpëtoftë ndonjë inversion, siç ndodh me mua jo fort më të rrallë, se atëherë është gati të të hajë të gjallë. Ja kështu! Në qoftë se frazat nuk ujdisen pas stilit të tij kalorsiak, të mykur e rutinë, të polli belaja me të”* (shih: Letra e dt.24.12.1771).

Sipas Verterit, të qenët funksional dhe orientimi i përhershëm sipas rregullave çon në humbjen e identitetit. *“Ai mendon që këto nuk janë vetëm kërkesa të tepruara, por gjithashtu paralizojnë unin e njeriut. Ai është i detyruar të ndjekë ligjet e një bote të kufizuar dhe kjo e bën të ndihet i drejtuar nga të tjerët, gjë që për të është njësoj si vdekja”*²¹³: *“... tjetërkush luan me mua si me një marionetë ...”* (shih: Letra e dt.20.01.1772).

²¹¹ Luserke-Jaqui, M.: Deutsche Literaturgeschichte in 10 Schritten, Tübingen, 2017, f. 91

²¹² Kemper, D: Goethe und die Individualitätsproblematik der Moderne. Paderborn, 2004, f. 79.

²¹³ Petersdorff, D: Ich soll nicht zu mir selbst kommen. In: Goethe-Jahrbuch, Göttingen, 2006, f.80.

Verteri kupton tashmë që në shoqërinë borgjeze iluministe s'ka vend për emancipimin e pasioneve. Njerëzit e dhënë pas pasionit do të përjashtohen nga shoqëria. *“Meqë pretendimi i tij për individualitet kanoset nga izolimi shoqëror deri në mbylljen në çmëndinë, atëherë Verterit i mbetet vetëm vetëvrasja.”*²¹⁴

Piramida e shoqërisë

Verteri i gëzohet ftesës për në darkën e organizuar nga konti, por, meqë ishte thjesht një vartës, ai është i detyruar të largohet nga mbrëmja. Aristokratët e tjerë bezdisen nga prania e një borgjezi dhe kërkojnë largimin e tij. *“Dje isha tek ai (konti) për darkë, pikërisht ditën kur në shtëpinë e tij mblidhet një shoqëri e fisnikshme zotërinjsh e zonjash të nderuara. Unë këtë s'e dija dhe mua s'më kishte shkuar kurrë mendja se ne, si vartës e deprorë, s'kishim vend atje”* (shih: Letra e dt.15.03.1772). Në këtë mënyrë, mund të shohim sesi shoqëria aristokrate vlerësonte njeriun në bazë të shtresës shoqërore.

Lidhja e Verterit me fëmijët dhe me njerëzit e varfër

Dy kategoritë e njerëzve që Verteri vlerëson dhe ndihet i vlerësuar, janë fëmijët dhe njerëzit e varfër. Në njërën nga letrat e para, ai shkruan: *“Njerëzit e thjeshtë këtu, ndonëse s'ka vetëm pak ditë që kam ardhur, më njohin fare mirë dhe më duan, veçanërisht fëmijët”* (shih: Letra e dt.15.05.1771). Ai i idealizon ata dhe vetëm me këto kategori njerëzish ndihet i plotësuar dhe mund të marrë energji pozitive.

Mes të gjitha formave të ndryshme të jetesës që Verteri i has gjatë rrugëtimit të tij, ajo fëmënorja i duket më tërheqëse. Në letrën e 29 qershorit 1771, i drejtohet Vilhelmit me këto fjalë: *“Nuk dua tjetër në këtë botë sa fëmijët!”* Ata janë aq *“të papërlyer”* (shih: Letra e dt.29.06.1771). Ai i sqaron Vilhelmit se *“më të lumtur nga të gjithë janë pikërisht ca njerëz të tillë që ashtu si fëmijët, rrojnë të shkujdesur të sotmen pa u merakosur për të nesërmen”*(shih: Letra e dt.22.05.1771). Verteri krahason spontanitetin dhe ndjeshmërinë e fëmijëve me vetëpërmbajtjen dhe planifikimin e jetës ekonomike të borgjezëve.

Ai i gëzohet lojës *“ulur përdhe, i rrethuar nga fëmijët e Sharlotës”*(shih: Letra e dt. 29.06.1771). Këtë ai e lidh me natyrshmërinë që e konsideron ideale. Duke luajtur me ta, ai mund të shprehë lirisht ndjenjat e veta. Megjithatë, Verteri ankohet se të rriturit i trajtojnë fëmijët si *“të nënshtruarit”* (shih: Letra e dt. 29.06.1771) e tyre, në një kohë kur ata

²¹⁴Luserke-Jaqui, M.: Deutsche Literaturgeschichte in 10 Schritten, Tübingen, 2017, f. 97.

duhen marrë shembull. Mjeku, i cili përfaqëson njeriun racional të Iluminizmit, teksa e sheh Verterin duke luajtur përdhe me femijët, kritikon sjelljen feminare të tij si “*aspak të denjë për një njeri me mend*” dhe i quan femijët “*shumë të përkëdhelur.*” Verteri, përkundrazi, sheh tek femijët “*farën e çdo cilësie a fuqie, të cilat do t’u nevojiten në të ardhmen*”. Nëse ata shprehen lirisht përmes lojërave, atëherë “*kryeneçësia*” e tyre do të shndërrohet më vonë “*në qëndrueshmëri, në forcë karakteri*”; ndërsa “*çamarrokësia*” e tyre në “*humor të lehtë e të gëzuar*” (shih: Letra e dt.29.06.1771).

Verteri vlerëson jetën e “popullit të varfër” për shkak të dëlirësisë, pafajësisë dhe natyrshmërisë që e karakterizon. Në këtë mjedis, ai mundet të jetë krejt spontan dhe të komunikojë lirisht, pa qenë i detyruar të përdorë kode etike konvencionale. Edhe njerëzit e thjeshtë e duan atë, sepse ai nuk sillet me përbuzje ndaj tyre si borgjezët e tjerë: “*... disa njerëz me një pozitë shoqërore disi të ngritur, prirjen të qëndrojnë gjithnjë të ftohtë e mbajnë gjithnjë njëfarë distance nga njerëzit e thjeshtë, sikur të paskëshin pasur frikë, se diç mund, duke u afruar, të humbisnin*” (shih: Letra e dt.15.05.1771). Verteri e kërkon gjithmonë kontaktin me njerëzit e thjeshtë, pasi kështu ndihet në harmoni me vetveten: “*Qëkur kam nisur e vij rrotull ndër njerëz dhe shoh me sytë e mi se sa u vlen lëkura dhe se ç’jane të zotët të bëjnë, jam shumë më i kënaqur nga vetja*” (shih: Letra e dt.20.10.1771). Për përfaqësuesit e lëvizjes “Stuhi dhe vrull”, antikiteti përfaqëson përsosmërinë, prandaj Verteri është shumë i dhënë pas “*Homerit të tij*” (shih: Letra e dt.21.06.1771). Ai lexon vetëm Odisenë, sepse skenat idilike të eposit përmbushin dëshirën e tij për natyrshmërinë dhe jetën e thjeshtë. Këtë natyrshmëri, ai e gjen rrallë tek shoqëria.

Malli i tij për jetën e thjeshtë shprehet edhe në këto rreshta: “*Kur nisem e shkoj që në agim në Valhajmin tim dhe këpus e mbledh vetë atje me dorën time, në kopshtin e mejhanexheshës, ca bizele dhe ulem e i qëroj ... dhe pres pastaj gjalpin dhe i vë bizelet në zjarr ... Asgjë tjetër në botë nuk ma mbush zemrën me një ndjenjë kaq të qetë e të vërtetë se sa keto tipare të një jete patriarkale, të cilat unë mund t’i gërshetoj, falë Zotit, pa u shtirur, me jetën time*” (shih: Letra e dt.21.06.1771). “*Me këtë lloj pune, Verteri nuk ndihet vartës i dikujt, por thjesht i lirë. Ai zgjohet me lindjen e diellit, pra bëhet një me procesin e natyrës.*”²¹⁵

Më pas, ndërkohë që gatuan bizelet, ai e shoqëron këtë moment me leximin e vargjeve të Homerit, në mënyrë që të ndjejë edhe më pranë e të

²¹⁵ Petersdorff, D: Ich soll nicht zu mir selbst kommen. In: Goethe-Jahrbuch, Göttingen, 2006, f.75.

përfytyrojë sa më mirë kohët e lashta me jetën primitive: “Kjo skenë tregon sesi heroi ynë lexon ... që të përjetojë qëndrimin e Odisesë tek derrari.”²¹⁶ Është një mënyrë e thjeshtë jetese: Një kusi, pak gjalpë e një kuzhinë e vogël. “Pretendimi për luks, që është produkt i qytetërimit modern, nuk bën pjesë në idealet e Verterit.”²¹⁷

Ekonomia si vlerë e shtresës borgjeze

Në këtë roman ka shumë rëndësi edhe paraia. Që në letrën e parë, Verteri shprehet për financën. Ai është nisur udhëtim për të rregulluar çështjet e trashëgimisë: “Bisedova me teton ... I fola për ankesën e nënës lidhur me pjesën e trashëgimisë që është mbajtur prej saj ... Ajo më parashtroi kushtet me të cilat ishte gati të na i kthente të gjitha e gjer edhe me shumë nga ç’kërkonim” (shih: Letra e dt.04.05.1771).

Duke folur për pikëpamjet e tij mbi edukimin e formimin e njeriut, Verteri sjell si shembull fjalët e një “borgjezi të mirë e zyrtar”, i cili po këshillon një djalë të dashuruar:

“Të dashurosh është diçka njerëzore, vetëm se duhet dashuruar njerëzisht! Pra dhe kujdesuni që ta ndani kohën siç duhet, një pjesë kushtojani punës dhe tjetrën, atë të çlodhjes, vashës suaj; llogarisni të ardhurat dhe me çfarë të mbetet, pasi të hiqni mënjanaq sa ju duhen për shpenzimet e përditshme, s’ju ndaloj aspak t’i bëni asaj herë pas here, por jo shpesh, ndonjë dhuratë; si bie fjala me rastin e ditëlindjes apo për ditën e emrit etj” (shih: Letra e dt.26.05.1771).

Pas kësaj, Verteri shton këndvështrimin e vet: “Dhe djaloshi ynë, në i ndjektë këto këshilla, do të bëhet me siguri një njeri shumë i dobishëm ..., por vetëm dashuria e tij sakaq mori fund dhe, në qoftë artist, gjithashtu edhe arti i tij” (shih: Letra e dt.26.05.1771).

Nëpërmjet këtij shembulli, Verteri tregon ironikisht se sa e pavlerë i duket një jetë e orientuar gjithmonë sipas maturisë e dobisë së punës e parasë. “Me fjalën “i dobishëm” nënkuptohet dobia e njeriut në punë, si një vlerë e jetës shoqërore ... Këtu, Verteri flet për veten. Sipas rregullave të shoqërisë, pasioni i pamasë dhe individualiteti i përsosur janë të papajtueshëm me njëri-tjetrin.”²¹⁸

Nga ana tjetër, Alberti me zellin dhe arsyen e tij, përfaqëson borgjezin tipik. Mirëpo Verteri rebelohet ndaj tij, ku pohon se ai nuk balancon punën

²¹⁶ Goethe, J. W.: Die Leiden des jungen Werthers. Wilhelm Meisters Lehrjahre. In: Goethe Werke, Hg. v. Wilhelm Voßkamp. Darmstadt, 1998, f. 648.

²¹⁷ Petersdorff, D: Ich soll nicht zu mir selbst kommen. In: Goethe-Jahrbuch, Göttingen, 2006, f.75.

²¹⁸ Luserke-Jaquai, M.: Deutsche Literaturgeschichte in 10 Schritten, Tübingen, 2017, f. 90.

me marrëdhënien bashkëshortore, duke u dhënë kështu më shumë pas punës sesa pas Sharlotës: *“A nuk i jepet gjer edhe më të papërfillshmes punë ai me një përkushtim shumë më të madh sesa bashkëshortes së tij të dashur e hirplotë? Mos di ta çmojë si duhet ai lumturinë e tij?”* (shih: Botuesi lexuesit, f.135). Pra, në ndryshim nga Verteri, Alberti ndihet i përmbushur nga puna e tij.

Në një moment tjetër, paraqitet marrëdhënia e një çifti e bazuar në planifikimin ekonomik. Verteri përshkruan këtu jetën e një prej shoqeve të Sharlotës, burri i së cilës *“ishte një kurrnac i ndyrë e i pangopur, që e kishte torturuar të shoqen tërë jetën dhe e kishte kufizuar në të gjitha, ndonëse ajo kishte ditur prapë të çalltiste”* (shih: Letra e dt.11.07.1771). Përpara se të vdiste, ajo i rrëfen të shoqit se si është përkujdesur për ekonominë e shtëpisë. (shih: Letra e dt.11.07.1771). Pra, në çastet e fundit të jetës, ajo nuk flet për dashurinë mes tyre, gjë që na jep një panoramë të jetës borgjeze, që në plan të parë ka planifikimin ekonomik.

Shndërrimet në “objekte kulturi”

Çdo gjëje, me të cilën Sharlota ka pasur të bëjë, si p.sh., vendeve, objekteve, madje edhe njerëzve që ajo ka takuar, Verteri u jep një vlerë të madhe emocionale. Në sytë e tij, ajo “shenjtëron” çdo gjë që prek: *“Po tanimë, Sharlotë, s’ka asnjë që nuk lidhet tek unë me kujtimin tënd, unë jam i rrethuar, o e dashur, nga ty, nga të gjitha anët dhe si një fëmijë i pangopur kam mbledhur rreth vetes lloj-lloj vogëlsirash të shenjtëruara nga prekja e dorës sate!”* (shih: Pas orës njëmbëdhjetë, f.171).

Burimi në Valhajn i bëhet edhe *“një mijë herë më i dashur”*, pasi Sharlota ulet pranë tij (shih: Letra e dt.06.07.1771).

E njëjta gjë vlen edhe për shërbëtorin e Verterit, të cilin ai e dërgon tek Sharlota. Pasi kthehet nga shtëpia e Sharlotës, shërbëtori ka tanimë vlerë shumë më të madhe në sytë e Verterit. *“Me sa padurim e prita këtë njeri, me sa gëzim e pashë atë sërish! ... Mendimi që sytë e Sharlotës qenë pështetur mbi fytyrën, mbi faqen e mbi kopsat dhe jakën e setrës së tij, i bënte të gjitha këto kaq të vyera, kaq të shenjta për mua! Nuk do ta kisha dhënë atë çast atë djalë as për një mijë talera”* (shih: Letra e dt.18.07.1771).

Një objekt tjetër i lartësuar është revolja që Verteri e merr me shumë kënaqësi nga shërbëtori. *“Ti ma dhe, ti i hoqe pluhurin dhe ja, unë, duke ditur që u prek nga dora jote, po e puth tani mijëra e mijëra herë”* (shih: Letra e fundit, f.169).

Edhe për fjongon rozë, që Sharlota dhe Alberti ia dhurojnë Verterit bashkë me librin e Homerit, në letrën e lamtumirës, Verteri lë këtë amanet:

“Kjo fjongo do të hyjë bashkë me mua në dhe! Ti ma dhurove atë për ditëlindje!”(shih: Letra e fundit, f.172).

Vetëvrasja si manifestim i lirisë

Duke qenë se Verteri e sheh lirinë si shumëdimensionale, insistimi i tij për vetëvendosje arrin kulmin, kur ai e kërkon lirinë e njeriut edhe për të përcaktuar orën e vdekjes. Në momentin që nuk e gjen lirinë në mjedisin e tij shoqëror, atëherë e kërkon atë në një jetë tjetër... *“do të desha të hapja një damar, gjë kjo që do të më falte lirinë e përjetshme”* (shih: Letra e dt.16.03.1771).

Një moment kyç, ku diskutohet mbi vlerat dhe antivlerat e çështjes së vetëvrasjes, është biseda mes Verterit dhe Albertit. Këtu, Verteri përfaqëson gjeninë e lëvizjes “Stuhi dhe vrull”, i cili nuk i bindet askujt, përveç vetes, si dhe pika e tij e referimit është vetëm *ndjenja*, ndërsa Alberti përfaqëson njeriun e matur dhe kalkulues të Iluminizmit, i cili drejtohet vetëm nga *arsyeja* dhe normat shoqërore. Alberti e gjykon vetëvrasjen si *“marrëzi”* dhe si *“të dënueshme”* (shih: Letra e dt.12.08.1771), pasi, sipas udhëzimeve fetare, vrasja dhe vetëvrasja kanë të njëjtën peshë, duke u konsideruar të dyja si mëkat. Ai e quan dobësi vetëvrasjen: *“Se është pa dyshim më e lehtë të vdesësh se sa të durosh i patundur një jetë plot mundim”* (shih: Letra e dt.12.08.1771).

Përkundrazi, Verteri e konsideron aktin e vetëvrasjes si një përpjekje ekstreme, ku është gjithmonë forca e pranishme (shih: Letra e dt.12.08.1771). Ai e krahason atë me *“një njeri që, duke parë shtëpinë e tij në flakë, mbledh nga frika të gjitha forcat dhe mund, falë kësaj, të ngrejë me lehtësinë më të madhe disa pasha kaq të rënda, që i qetë dhe gjakftohtë as nuk do t’i lëvizte dot.”* Pra, sipas Verterit, të ndërmarrësh këto veprime, nuk është dobësi, përkundrazi duhet një forcë e madhe.

Ai e justifikon vetëvrasjen duke shpjeguar që vetë natyra njerëzore është e tillë që ka kufijtë e saj: *“Gëzimi, vuajtja dhe dhimbjet mund të durohen deri në një pikë të caktuar.”*²¹⁹

Pra, vetëvrasja ndodh kur vuajtja fizike apo morale bëhet e padurueshme, duke e barazuar në këtë mënyrë me vdekjen si pasojë e një sëmundjeje: *“Pra, dhe mua më duket po aq e çuditshme që të cilësohet si frikacak një njeri që heq dorë nga jeta e tij, sa edhe po të quhej kështu një i sëmurë që vdes nga shkaku i ca etheve të liga”*(shih: Letra e dt.12.08.1771).

²¹⁹ Luserke-Jaqui, M.: Deutsche Literaturgeschichte in 10 Schritten, Tübingen, 2017, f. 90.

Analogjitë mes romanit dhe dëshmime fetare

Koncepti i vuajtjes në roman lidhet ngusht me historinë e *mundimeve të Krishtit*. Që në titull paraqiten “Vuajtjet e djaloshit Verter” si ekuivalente me “Vuajtjet e Krishtit”.²²⁰

Pavarësisht se vetëvrasja ishte e ndaluar nga kisha si një mëkat i madh, që në fillim të romanit kërkohet mirëkuptim për këtë veprim. Në parathënien drejtuar lexuesit, thuhet: “*Nuk ka sesi të mos admirosh zgjuarsinë e tij, si të mos ndjesh dashuri për karakterin e tij e të mos derdhësh lot për fatin e tij*”. Sipas Gëtes, Verteri meriton dashuri dhe admirim, sepse ai vetëflijohet për Sharlotën dhe Albertin. Kjo frazë mund të krahasohet me *mundimet e Krishtit*: “*Vetëm ca pak të zgjedhurve u është dhënë të derdhin gjakun për të afërmit e tyre dhe të ndezin për miqtë, me vdekjen e tyre, pishtarë të pashuar*” (shih: Letra e fundit, f.172). Në roman, ekziston një sërë frazash të tilla me ngjashmëri biblike: “*Jo, nuk është dëshpërimi që më shtyn të zgjedh këtë rrugë, por siguria që unë më shumë se kaq nuk jam i zoti të vuaj dhe që s’më mbetet pra tjetër tani, veçse të flijohem për ty*” (shih: Letra e fundit, f.148); ose: “*Dhe unë po rend përpara, për tek im Atë, për tek yt Atë. Atij dhe do t’i qahem, e ai do të më ngushëllojë derisa ti të vish*” (shih: Letra e fundit, f.165). Verteri është i ndërgjegjshëm për gjendjen e tij të pashpresë, por nuk e humb besimin e dashurinë për Zotin: “*... sodis ca yje te rrallë që rendin nëpër qiellin e amshueshëm! Jo, ata nuk do të bien, sepse i mban në gjirin e tij, ashtu sikurse edhe mua, vetë i Amshueshmi*” (shih: Letra e fundit, f.171).²²¹

Adhures dhe kritikë

Vuajtjet e djaloshit Verter, një libër i vogël në krahasim me veprat e tjera me shumë vëllime të bashkëkohësve të tij, sollti reagime të ndryshme që nga adhuresit e deri tek kritikët.

Kishte nga ata që iu bashkangjitën grupit të lëvizjes “Stuhi dhe vrull”, duke u identifikuar me qëndrimin e tyre rebel. Mund të përmendim shkrimtarin gjerman Schubart, i cili jep mbështetjen e tij me këto fjalë:

“Ja ku po rri ulur me një zemër që rreh fort, dy sy me një dhimbje plot afsh dhe të them ty o lexues, që sapo *lexova* “Vuajtjet e djaloshit Verter” nga Gëte im i dashur? Jo, atë e *përpiva*. Ta kritikoj? Do të isha zemërgur, po ta bëja. Edhe vetë Perëndesha Kritikë do të shkrihej përpara kësaj kryevepre

²²⁰ Luserke-Jaqui, M.: Deutsche Literaturgeschichte in 10 Schritten, Tübingen, 2017, f. 85.

²²¹ Beutler, E: Die Leiden des jungen Werthers. In: Goethe, J. W., Die Leiden des jungen Werthers –Reclams Universal-Bibliothek, Stuttgart, 1948, f.153.

të ndjenjës më të bukur njerëzore.”²²²

Nga ana tjetër, dihej gjithashtu që përfaqësuesit e Iluminizmit dhe të kishës do të ndiheshin të fyer. “*Ata e konsideruan romanin qesharak ... ose të rrezikshëm, përse i përket vetëmbrojtjes me anë të vetëvrasjes ...*”²²³ Kështu shkruan, për shembull, kritiku zviceran Johann Jakob Bodmer: “*Të rinjtë gjejnë sofizma në pasionin e shturur të veprës së Gëtes.*”²²⁴

Përfundime

“Vuajtjet e djaloshit Verter” sjell vlera në shumë aspekte. Ai konceptohet si roman kritik ndaj shoqërisë. Racionaliteti i kërkuar nga shoqëria moderne bie në kundërshtim me rëndësinë e veçantë të zemrës. Përpjekjeve të Verterit për individualizëm i bien ndesh normat shoqërore të shtresës aristokrate dhe borgjeze.

Alberti, i cili si një borgjez iluminist, paraqitet gjithmonë i arsyeshëm e i përgjegjshëm, përfaqëson të kundërtën e Verterit. As ai nuk duhet të merret si shembull i mirë, pasi i jep rëndësi absolute punës duke neglizhuar balancën mes punës dhe jetës.

Si përfundim, mund të themi se njeriu ideal mund të kishte të gërshetuara disa nga cilësitë e secilit prej këtyre dy personazheve kaq të ndryshëm nga njëri-tjetri. Do të duhej, pra, një balancim i këtyre të kundërtave, duke harmonizuar kështu zemrën dhe arsyen, pasi të dyja luajnë rol të rëndësishëm në përmirësimin e shoqërisë.

²²² Killinger, R.: *Literaturkunde. Gestalten und verstehen*, Wien, 1999, f. 104.

²²³ Goethe, J. W.: *Die Leiden des jungen Werthers. Wilhelm Meisters Lehrjahre*. In: *Goethe Werke*, Hg. v. Wilhelm Voßkamp. Darmstadt, 1998, f. 643.

²²⁴ Luserke-Jaqui, M.: *Deutsche Literaturgeschichte in 10 Schritten*, Tübingen, 2017, f. 101.

BIBLIOGRAFI

- Beutler, E.: Die Leiden des jungen Werthers. In: Goethe, J. W., Die Leiden des jungen Werthers –Reclams Universal-Bibliothek, Stuttgart, 1948.
- Gëte, J.V: Vuajtjet e djaloshit Verter, Tiranë, 2004.
- Goethe, J. W.: Dichtung und Wahrheit. In: Goethe Werke, Hg. v. Klaus Detlef Müller. Darmstadt, 1998.
- Goethe, J. W.: Die Leiden des jungen Werthers. Wilhelm Meisters Lehrjahre. In: Goethe Werke, Hg. v. Wilhelm Voßkamp. Darmstadt, 1998.
- Kemper, D.: Goethe und die Individualitätsproblematik der Moderne. Paderborn, 2004.
- Killinger, R.: Literaturkunde. Gestalten und verstehen, Wien, 1999.
- Luserke-Jaqui, M.: Deutsche Literaturgeschichte in 10 Schritten, Tübingen, 2017.
- Petersdorff, D.: Ich soll nicht zu mir selbst kommen. In: Goethe-Jahrbuch, Göttingen, 2006.

**An analysis of the values in the novel
“The Sorrows of the Young Werther”**

ABSTRACT

Goethe's novel “The Sorrows of Young Werther” captured the readers’ imagination by dealing with a variety of values concerning the society of the 18th century. The aim of this article is the summary of these values based on various text passages. Werther’s attitude opposed to social conventions is emphasized. A very important value is the individual freedom. There are different evaluations of this freedom in the novel. “The heart” is another precious value for Werther and it’s also the key word of the German literary movement “Sturm und Drang”. Nature and music are also a great medicine for Werther’s soul. A delicate issue is the limit of the language use. According to Werther, the language doesn’t offer enough words to express some important issues. The work is another important value in this novel.

Werther can’t accept the idea of the social functionalism, which could prevent the self-fulfillment of people. Children and poor people are his dearest categories of society, because they are sensitive and pure. In this novel it’s also described how life of the bourgeoisie was organized based on economic planning. One of the most significant issues is Werther’s escape through death. Suicide is considered as an act between foolishness and strength through various arguments representing the ideals of the

Enlightenment and “Sturm und Drang.” Through these summarized values, this article offers an evident view of the society during the 18th century.

Key words: “Werther, heart, individual, conflict, society, Sturm und Drang”.

Kurt Gostentschnigg, Karl Kaser

**AUSTRIA'S CONTRIBUTION TO ALBANIA'S
CONSOLIDATION
(1918 – 1938) FROM A POSTCOLONIAL PERSPECTIVE.
A SUBMITTED ASF RESEARCH PROJECT**

Rationale

The previous ASF-project “Austro - Hungarian albanology 1867-1918 – a case of cultural imperialism?”¹ had the primary task to investigate the character of the relationship between one of the European Great Powers (Austro-Hungary) and a minor Balkan nation (Albania) and the role that Austro-Hungarian albanology played in it, especially from the 1890s to the end of WWI. Research resulted in a voluminous monograph² by Kurt Gostentschnigg, the designated collaborator in this ASF-project, submitted at the beginning of February 2018. He concludes that the relationship between the two countries constituted a clear case of cultural imperialism; albanology was a powerful instrument in this regard. Furthermore, in this cultural-imperialistic relationship, based on structural violence, additional fields of power were involved: politics, military, and submissive historical actors of all kinds. Austro-Hungary considered itself protector of the Albanian nation and Albania as an instrument of colonialistically inspired great-power politics.

However, all these plans and visions vanished in the fall of 1918. Caused by the established new political landscape, the Republic of Albania as well as the Republic of German-Austria had to formulate completely new foreign policies. In doing so, Albanian-Austrian relations were downgraded, for instance, compared to Albania's relations to Italy and Austria's relations to Germany. Despite this fact, the question is legitimate: What remained of this intensive relationship in the decades before and

¹ Austrian Science Fund (ASF), projectnr. P26437–G15; see Gostentschnigg, Kurt; Kaser, Karl (2014): *Albanologjia austro-hungareze 1867–1918 – një rast i imperializmit kulturor?* In: *Hylli i Dritës*, 1–2 (279–280), p. 3–26.

² Gostentschnigg, Kurt (2018): *Wissenschaft im Spannungsfeld von Politik und Militär. Die österreichisch-ungarische Albanologie 1867-1918*. Wiesbaden: Springer VS. (828 p.).

during WWI? Can this heritage be labelled as “post-colonial” and did Austria play any role in the stabilization of the emerging weak Albanian state?

Albanian-Austrian relations during the interwar period have not been investigated in their totality until now. There are only a few single studies about certain aspects of these bilateral relations. Therefore, the overall aim of the submitted research project is the first reviewing of the Albanian-Austrian relations from the proclamation of the Republic of German-Austria on November 12th 1918 until the annexation of Austria to the German Reich on March 13th 1938. The most important question is whether these relations between a former Central European monarchy and a peripheral Balkan country should be considered postcolonial ones.

Aims

In the period between the world wars Austria fostered primarily bilateral relations to its neighbouring countries Germany, Italy Switzerland and Hungary. Its relations to Czechoslovakia and Yugoslavia were problematic, because the two countries were members of the Little Entente, an alliance formed in 1920/1921, whose purpose was the defence against Hungarian revanchism and the prevention of Habsburg restoration. The “Anschluss” or annexation of Austria to Germany constituted the central idea in their bilateral relations, although forbidden by the Treaty of Saint Germaine. During the twenties, a gradual convergence took place, for example by a partial unification of the law systems. The projected customs union in 1931 failed because of the vigorous protests of France, Italy and Czechoslovakia. These countries were afraid of the Anschluss and of a hegemonic position of Germany in Central and South-East Europe. Besides that it was incompatible with the Geneva Protocols of the League of Nations of October 4th 1922 signed by Austria and the Allies, by which Austria committed itself to maintaining its economic independency.²²⁷ Since 1933, Hitler’s policy aimed at the annexation of Austria to the German Reich. Austria’s Chancellor Dollfuß tried to counteract and signed the Rome Protocols of March 17th 1934, which should enable a close political and cultural cooperation between Austria and Italy. However, since 1936, the Italian foreign policy was oriented to Germany and Austria

²²⁷Koch, Klaus; Rauscher, Walter; Suppan, Arnold (ed.) (2006): Außenpolitische Dokumente der Republik Österreich 1918-1938. Vol. 7: Das österreichisch-deutsche Zollunionsprojekt. Vienna: Österreichische Akademie der Wissenschaften.

lost its ally.²²⁸ After the agreement of Berchtesgaden on February 12th 1938 about a number of measures in favour of the Austrian Nazis, Hitler intensified the pressure on the Austrian chancellor Kurt Schuschnigg, which resulted in the Anschluss one month later.²²⁹

After WWI, Albania needed foreign long-term funds and the support of foreign experts for the consolidation of its statehood and the creation of a modern economy,²³⁰ and addressed the League of Nations in 1922, which, in return, sent the Dutch financial advisor J. Hunger in June 1923. His reports for the League of Nations and the Albanian government demanded a deep reform of the tax system and the combatting of the corruption in the state administration.²³¹ However, this was not in the interest of the big landowners; the Albanian government had to annul the contract with Hunger in May 1924. Afterwards, Prime Minister Ahmet Zogu devoted himself to Mussolini, who embraced the favourable opportunity to enforce his 'Mare Nostrum' policy in the Adriatic.²³²

The objective of Mussolini's foreign policy was to make Italy the hegemonic power in the Mediterranean. This policy was based on the secret Treaty of London signed by Italy and the Triple Entente on April 26th 1915, which designed Italy's entering the war in exchange for the recognition of various territorial claims.²³³ According to article 6 of the treaty, Italy was entitled to occupy the strategically important Albanian port of Vlora and its hinterland.²³⁴

In 1925, Albania's President Ahmet Zogu allowed the foundation of the Albanian National Bank by Italian capital and gave Italy, beside other states, the concession for oil exploration.²³⁵ In the same year, Italy founded the "Società per lo Sviluppo Economico dell Albania" (SVEA) – an

²²⁸ Koch, Klaus; Vyslonzil, Elisabeth (ed.) (2014): Außenpolitische Dokumente der Republik Österreich 1918-1938. Vol. 10: Zwischen Mussolini und Hitler. Vienna: Österreichische Akademie der Wissenschaften.

²²⁹ Rauscher, Walter; Suppan, Arnold (ed.) (2016): Außenpolitische Dokumente der Republik Österreich 1918-1938. Vol. 12: Österreich zwischen Isolation und Anschluss. Vienna: Österreichische Akademie der Wissenschaften.

²³⁰ Gross, Hermann (1949): Albanien zwischen den Mächten: Ein Beitrag zur Erschließung unentwickelter Gebiete. In: Wirtschaftsdienst 29, nr. 6, p. 37.

²³¹ Akademia e Shkencave e Shqipërisë (ed.) (2007): Historia e Popullit Shqiptar. Vëll. III: Periudha e pavarësisë 28 nëntor 1912 – 7 prill 1939. Tirana: Toena, p. 209 f..

²³² Gross (1949), p. 37.

²³³ Hürter, Johannes; Rusconi, Gian Enrico (ed.) (2007): Der Kriegseintritt Italiens im Mai 1915. Sondernummer der Vierteljahrshefte für Zeitgeschichte. München: Oldenbourg.

²³⁴ Bartl, Peter (1995): Albanien. Vom Mittelalter bis zur Gegenwart. Regensburg: Pustet; p.184.

²³⁵ Akademia e Shkencave e Shqipërisë (2007), p. 257-259; Bartl (1995), p. 207.

association that aimed at the economic development of Albania, helping to facilitate a loan to Albania worth 50 million gold francs. Thus, Italy established a far-reaching control over Albania's capital market.

In the First Treaty of Tirana signed on November 27th 1926,²³⁶ Albania and Italy agreed not to conclude any agreements with any other states prejudicial to their mutual interests. On the one hand, this Italian-Albanian "pact of friendship and security", concluded for five years with the possibility of its renewal, guaranteed Zogu's political position as well as the country's territorial integrity. On the other hand, it established de-facto protectorate relations. In return, Albania got new Italian loans and support for the armament and training of its police. In the Second Treaty of Tirana signed on November 22nd 1927,²³⁷ Albania and Italy concluded a defensive alliance for twenty years, which obliged the contracting partners to provide each other with active support in the case of a military attack. Thus, Italy sent many officers to train the Albanian army, and the Albanian government allowed the Italian navy access to the ports of Vlora and Durrës; Albania became de facto Italy's military base in the Balkans. In 1934, Zogu tried in vain to reduce this one-sided dependency by the conclusion of trade agreements with Greece and Yugoslavia after Italy had stopped its financial assistance.

Thus, after WWI, Austro-Hungary's primary foreign-political role for Albania was replaced by Italy. Many ministers of Albanian governments had studied in Italy and were considered as italophiles such as the finance ministers Myfit Libohova (1925) and Fejzi Alizoti (1927).²³⁸ During the interwar period, the little Balkan country was irrelevant for Austria. There was no Austrian foreign-policy interest in Albania, only interests of private persons and groups. Little Austria, as the remaining German speaking part of the Austro-Hungarian Empire, was busy with solving its own economic, political and social problems.

The scientific interests of the successor states of the Habsburg Monarchy in Albania and the Albanians vanished – but not those of albanologists. Franz Nopcsa, Milan von Šufflay, Norbert Jokl, Maximilian Lambertz, Franz Seiner, Carl Patsch and others continued their albanological work. Of course, the lack of financial support had negative effects on their engagement, but their research conducted already before 1918 allowed them to publish their results in the interwar period.²³⁹

²³⁶ Akademia e Shkencave e Shqipërisë (2007), p. 261-266; Bartl (1995), p. 208.

²³⁷ Akademia e Shkencave e Shqipërisë (2007), p. 266-270; Bartl (1995), p. 209 f..

²³⁸ Akademia e Shkencave e Shqipërisë (2007), p. 258, 266.

²³⁹ Gostentschnigg (2018), p. 766-788.

The cultural presence of Austro-Hungary – apart from some excesses during its military occupation (1916-1918) – remained in good memory, not least because of the already effective cultural transformation caused by its Religious Protectorate (gjerm. Kultusprotektorat), its school policy and the exertion of influence on the Albanian nation- and state-building process. On the one hand, the already before WWI inaugurated training of Albanian students in Vienna, Graz and other Austrian cities was prolonged and intensified between the two wars. These students, while living in Austria, initiated many cultural activities such as creating associations and clubs as well as publishing journals and books. In most cases, they returned back to Albania and made major contributions to the consolidation of the Albanian state in various professional fields.²⁴⁰ On the other hand, members of the so-called “Austrian colony” lived and worked in Albania, some in the direct sphere of the austrophile Albanian King Zogu (king since 1928): former actors of the monarchy such as the Austrian honorary consul in Albania with Albanian nationality Zef Curani, the publisher Leo Freundlich and the army officers Leon Ghilardi and Gustav von Myrdacz. Freundlich was King Zogu's close friend, Ghilardi was general in the Albanian army and King Zogu's closest confidant and Myrdacz was the general chief of staff in the Albanian army and the first military adviser of the king. Another former army officer, Hermann Kirchner, pensioned after WWI, served since 1928 in the Albanian army and became 1931 chief of the personnel department. In 1929, the Austrian-Albanian Society was founded in Vienna, which aimed at fostering the economic and cultural relations and at playing an intermediary role between the two states.

Thus, Austria could not have direct impact on Albania's internal and external politics, but only indirect one through education, expertise and research. Therefore, we could conclude that the Austria of the interwar period, due to its many problems, had only the merit of an indirect, but significant influence on the later established Albanian albanology and on some aspects of Albania's administration. However, due to the fact that the state of the art with regard to the Albanian-Austrian relations in the interwar period is still negligible, there are the following fundamental questions to be raised and answered. Only after having answered these questions also an answer to the central research question can be dared: Can Albanian-Austrian relations be characterized as postcolonial or not?

²⁴⁰ Gostentschnigg, Kurt (2013): Die Aktivitäten der albanischen StudentInnen in Österreich bis 1939. In: Ramaj, Albert (ed.): „Poeta nascitur, historicus fit – ad honorem Zef Mirdita”. Albanisches Institut & Hrvatski Institut za povijest. St. Gallen u. Zagreb, p. 1123–1145.

- (1) What was the post-colonial legacy of the Austro-Hungarian colonial epoch in Albania, visible in the interwar period? For example the former departments for finance, justice and education, installed by the Austro-Hungarian military administration 1916-1918: was there a personal and institutional continuity to the ministries for finance, law and education in the interwar period? If yes: was there a change in 1926 when Italy's political, economic and financial influence increased?
- (2) What was the post-colonial legacy in Austria? For example Skanderbeg's helmet and sword, the origin and authenticity of which are disputed, in the Hofjagd- und Rüstkammer of the Viennese Kunsthistorisches Museum: what was the principal position of the Austrian government to movable property of great importance to the cultural heritage of a nation?
- (3) Which were, during the interwar period, the Albanian and the Austrian perceptions of the former Austro-Hungarian policy and rule in the Albanian territories? Regarding the mutual perception: Did Austrian officials consider Albanians as 'subaltern actors'? What opinions had Albanians about Austria and Austrians? Are there any pertinent indications in the research literature and in the Austrian and Albanian archive files?
- (4) What was the role of Ghilardi, Myrdacz and Kirchner, who held crucial positions in the Albanian army, regarding the organisation of the army and the military policy of Albania, especially in respect of Italy's leading influence on Albania since 1926?
- (5) Are there, since 1926, any indications of unofficial or official Italian exertion of influence on censoring or even forbidding of Albanian positive press coverage or historiography about the time of the Austro-Hungarian military administration 1916-1918?
- (6) How was the former role of Austro-Hungary in Albania interpreted by the Albanian literature during the interwar period? Did, for example, the poet Millosh Gjergj Nikolla, known as Migjeni (1911-1938), refer to the Austro-Hungarian military administration with regard to the solution of the social question?
- (7) In which fields did Austria's indirect contribution to Albania's consolidation consist? In which fields did the former Albanian students in Austria contribute to the consolidation of Albania? Which were the effects of all these contributions?
- (8) Who were, beside Gjergj Pekmezi, Zef Curani, Ahmet Zogu and the former Albanian students in Austria, the Albanian austrophile

actors? Did some of them play a leading role in order to forward both the Austrian interests in Albania and the Albanian interests in Austria? If yes: who were the Austrian businessmen in Albania and what were their interests?

- (9) Related to the Austrian colony in Albania: What was its number and composition? Did it originate from before 1918 or/and did it immigrate to Albania in the interwar period? Did these Austrian albanophiles represent both the Albanian interests in Austria and the Austrian interests in Albania? What kind was the concurrency between Austria and Nazi Germany from 1933 until 1938 with regard to influence on the Austrian colony?
- (10) What was the role of Austrian albanologists like Patsch, Lambertz and Jokl in the context of the general bilateral relations, especially with regard to the intended establishment of an Albanian albanology, the preservation of the antique monuments and the foundation of an Albanian national museum?
- (11) What was the intermediary role of the Austrian-Albanian Society in Vienna and of its branch in Tirana?
- (12) Why did the project for the establishment of an Austrian diplomatic representation in Tirana fail?
- (13) Was the provisional trade agreement between Austria and Albania concluded in 1927 the only one of its kind? If yes – why was it not possible to sign a definite trade agreement?
- (14) Regarding the Albanian reception of Austrian know-how, culture and art: The Republic of Austria inherited a strong film industry from the late Monarchy – which Austrian movies were shown in Albania? And, in addition, which Austrian plays, concerts, operas and operettas were performed?

International status of research

Related to the general question whether the remnants of colonial relationships can be characterised as postcolonial the status of research is relevant in the following fields:

- 1) Austro-Hungarian military administration of Albania 1916-1918,
- 2) Austrian albanology in the interwar period,
- 3) Albanian-Austrian relations between the two world wars.

Austro-Hungarian military administration of Albania 1916-1918

Hugo Kerchnawe²⁴¹ was the first and Wolfgang Etschmann and Erwin Schmidl²⁴² are the most recent Austrian military historians who studied the Austro-Hungarian military administration of Albania during the Great War. Both studies emphasize its mutual benefit because of its investments into infrastructure, administration, health, education, culture, research, social policy and successful pacification, although not all measures, like the confiscation of arms, were welcomed by the Albanians.

The major contribution to this topic is Helmut Schwanke's dissertation²⁴³ which focused on three questions: the conflict between the foreign ministry and the High Command of the army, the first census organized by Franz Seiner in 1918 and the chase for mineral resources. Schwanke's conclusions are: (1) the conflict between the foreign ministry and the High Command of the army arose because the foreign ministry emphasized a peaceful penetration of the Albanian territories by means of education, trade and transport, whereas the High Command advocated the annexation of North Albania;²⁴⁴ (2) most likely, an annexation was prepared because a population census and a registration of the livestock was conducted;²⁴⁵ (3) and details about mineral resources, industrial plants and mines were collected.²⁴⁶

Some years ago, also Albanian historians started to publish about this subject. Sali Kadria's investigation of Albanian nationalism during the Austro-Hungarian military administration of Albania was long overdue.²⁴⁷ The two main results of his article are: (1) the Austro-Hungarian government has refused the irredentist Albanian nationalists' leaders demand for the unification with Kosovo and other Albanian territories, because it was convinced of the political "immaturity" of Albanians; (2) however, the administration removed the cultural boundaries among

²⁴¹ Kerchnawe, Hugo (1928): Die Militärverwaltung in Montenegro und Albanien. In: Kerchnawe, Hugo (ed.): Die Militärverwaltung in den von den österreichisch-ungarischen Truppen besetzten Gebieten. Vienna: Hölder, Pichler, Tempsky, p. 270-304.

²⁴² Etschmann, Wolfgang; Schmidl, Erwin A. (1997): Albanien im Ersten Weltkrieg. Spielball von Machtinteressen. In: Österreichische Militärzeitung 5, p. 545-554.

²⁴³ Schwanke, Helmut (1982): Zur Geschichte der österreichisch-ungarischen Militärverwaltung in Albanien (1916-1918). Vienna: Diss..

²⁴⁴ Ibid, p. 24 f., 91 f..

²⁴⁵ Ibid, p. 149-156.

²⁴⁶ Ibid, p. 331-334.

²⁴⁷ Kadria, Sali (2014): Aspekte të gjendjes së nacionalizmit shqiptar gjatë viteve 1916-1918 në zonën e pushtimit austro-hungarez. In: Studime Historike 51, 3-4, p. 111-128.

Albanians by improving the communication system and by providing the Albanians with passports, which strengthened their national identity. Ledia Dushku's article²⁴⁸ treats the internal Austro-Hungarian mentioned dispute between the military officers and the diplomats about the status of the occupied Albanian territories and the influence of this dispute on the Dual Monarchy's policy towards the Albanians as well as their reaction to this policy. Marenglen Kasmi's article²⁴⁹ is also about this internal Austro-Hungarian conflict and concludes that the Austro-Hungarian military administration suppressed Albanian nationalism on the one hand, but invested into the infrastructure and administrative system of the country on the other hand. Elena Kocaqi has recently published the first small Albanian monograph²⁵⁰ about the Austro-Hungarian military administration of Albania during WWI without considering the international status of research. Her study comes to the conclusion that Austro-Hungarian rule in Albania cannot be considered as colonial.²⁵¹

Gostentschnigg's monograph concludes that during WWI the character of the Albanian-Austro-Hungarian relations changed from cultural and informal imperialism to semi-formal imperialism. "Semi-formal" because the Dual Monarchy truly occupied temporarily Albanian territories for military reasons, but its diplomacy considered the Albanian population as austrophile and had no intention to annex the country, but rather to support its autonomy under some kind of protectorate.²⁵²

Austrian albanology in the interwar period

The young and middle aged (at the end of WWI between 29 and 44 years old) Austrian albanologists continued their work in the interwar period. Undoubtedly, the linguistic genius among the albanologists was Jokl whose early death left undiscovered some treasures of Albanian linguistics. His major work was the "Linguistisch-kulturhistorische Untersuchungen aus dem Bereiche des Albanischen", published 1923, in

²⁴⁸ Dushku, Ledia (2016): Shqiptarët përballë ushtarakëve dhe diplomatëve austro-hungarezë (1914–1916). In: Studime Historike 53, 3–4, p. 73–90.

²⁴⁹ Kasmi, Marenglen (2016): Shqipëria 'austriake' dhe komiteti që paguheshin me flori. In: Gazeta Dita, February 13th, online: <http://www.gazetadita.al/shqiperia-austriake-dhe-komitet-qe-paguheshin-me-flori/>.

²⁵⁰ Kocaqi, Elena (2016): Administrimi i Shqipërisë nga Austro-Hungaria 1916-1918. Tirana: Emal.

²⁵¹ Ibid, p. 6.

²⁵² Gostentschnigg (2018), p. 741.

which he tried to integrate linguistic research and the philological movement “Wörter und Sachen”. The linguistics of today, dealing with Albanian language, still relies on Jokl’s findings.²⁵³ With regard to productivity, Lambertz was equal to Jokl, but focused more on the folkloristic field. After Jokl’s death, he was the leading albanologist in the German language area who knew to integrate language, literature and folklore and who started collecting and exploring Albanian fairy tales.²⁵⁴

Information about Patsch’ work for the Albanian national-museum project is available in Nathalie Clayer’s basic article.²⁵⁵ In 1922, the Albanian government asked Patsch to establish a national museum that should contribute to the national consciousness of the Albanian population. His network and know-how should be used for this project. But political unrest in the country in 1925 resulted in the cancellation of the museum project. Patsch’ legacy was on the one hand the training of students, among them Hasan Ceka, one of the founders of Albanian archaeology after WWII,²⁵⁶ and on the other hand the influence of his in 1923 in Albanian language published book “Ilirët” on research about the Illyrians.

Later Albanian albanologists, such as the linguist Eqrem Çabej and the historian Aleks Buda, both leading figures in their fields after WWII, were trained at Austrian universities in the interwar period. Thus, Austrian albanology became the main basis for the emerging Albanian albanology after WWII. Other Austrian resources could not be exploited fully by Albania, for instance the census taken by the Austrian military administration in 1918 under the supervision of Franz Seiner – a geographer and expert on statistics. Only the publication of some basic results in 1922 – among them the first map on the distribution, size and borders of the tribal territories – could be supported by funds of the Albanian government.²⁵⁷ It is almost an irony that this census has been

²⁵³ Ibid, p. 163-165, 223.

²⁵⁴ Ibid, p. 207.

²⁵⁵ Clayer, Nathalie (2012): Carl Patsch et le Musée national de Tirana (1922-1925). In: *Revue germanique internationale*, 16, p. 91-104.

²⁵⁶ Schmitt, Oliver Jens (2015): *Balkanforschung an der Universität Wien*. In: Grandner, Margarete Maria; König, Thomas (ed.): *Reichweiten und Außensichten. Die Universität Wien als Schnittstelle wissenschaftlicher Entwicklungen und gesellschaftlicher Umbrüche*. Göttingen: V&R unipress, p. 93.

²⁵⁷ Seiner, Franz (1922a): *Ergebnisse der Volkszählung in Albanien in dem von österreichisch-ungarischen Truppen 1916–18 besetzten Gebiete*. Vienna, Leipzig: Hölder, Pichler, Tempsky. (= *Schriften der Balkan-Kommission. Linguistische Abteilung 13*); Seiner, Franz (1922b): *Die Gliederung der albanischen Stämme*. Graz: Selbstverlag.

analysed within the framework of three FWF research projects decades later: “The 1918 Albanian Population Census: Data Entry and Basic Analyses (2000–2003)”; “Migration in Albania at the beginning of the 20th century (2002–2003)”; “Tirana and Shkodra: Demographic and historical–anthropological trends in two Albanian cities 1918–1938 (2003–2006)”. These projects have been carried out at the applicant’s institution. As results, two dissertations²⁵⁸, two articles²⁵⁹ and two documentations²⁶⁰ have been published.

Albanian-Austrian relations between the two world wars

The Albanian-Austrian relations in the interwar period were concentrated in the following fields: the bilateral official representations, the Austrian colony in Albania, the Albanian austrophiles in Albania, the government of the “German culture”, the Austrian-Albanian Society in Vienna, the Albanian students and Albanian clubs in Austria, the unofficial Balkan policy of Albanians in Vienna, reception of Austrian culture in Albania, Austrian businessmen in Albania as well as the bilateral provisional trade agreement of 1927. There is still very little or no secondary literature about these issues. The article of Pranvera Dibra treats the diplomatic and consular relations between Austria and Albania from 1922 until 1992.²⁶¹ Robert Elsie edited a volume about Freundlich’s “Albanische Korrespondenz”²⁶², where we can find biographical details of Freundlich’s life and work.²⁶³ Krisztián Csaplár–Degovics was the first to

²⁵⁸ Kera, Gentiana (2013): Tirana. Demography, Family and Urban Life (1918–1939). Graz: Dissertation; Pandelejmoni, Enriketa (2013): Shkodra, Household, Family and Urban Life (1918–1939). Graz: Dissertation.

²⁵⁹ Kera, Gentiana; Papa, Enriketa (2002): Karakteristikat e familjes shqiptare sipas regjistrimit të popullsisë të vitit 1918. In: Politika & Shoqëria, nr. 1 (10), p. 83–96; Gruber, Siegfried (2007): Die albanische Volkszählung von 1918 und ihre Bedeutung für die Wissenschaft. In: Kostka, Helga (ed.): SeinerZeit. Redakteur Franz Seiner (1874 bis 1929) und seine Zeit. Graz: Academic Publishers, p. 253–265.

²⁶⁰ Gruber, Siegfried (2001): The Albanian Census of 1918: Documentation of the data base. Manuscript, Graz; Kaser, Karl; Gruber, Siegfried; Kera, Gentiana; Pandelejmoni, Enriketa (2011): 1918 census of Albania, Version 0.1 [SPSS File]. Graz: n.p..

²⁶¹ Dibra, Pranvera (2016): Marrëdhëniet diplomatike konsullore Shqipteri-Austri 1922-1992. In: Studime Historike 53, 3-4, p. 311-323.

²⁶² Elsie, Robert (ed.) (2012): Leo Freundlich: Die Albanische Korrespondenz: Agenturmeldungen aus Krisenzeiten (Juni 1913 bis August 1914). München: Oldenbourg.

²⁶³ Strommer, Roswitha (2012): Leo Freundlich und die Albanische Korrespondenz. Der Versuch einer biographischen Annäherung. In: Elsie, Robert (ed.): Leo Freundlich: Die

write a comprehensive article²⁶⁴ about the Croatian with Italian origin, Leon Ghilardi, who had worked as an army officer in Austro-Hungary and later in Zogu's Albania. Ghilardi's function as commander of the "Djelmënija", an Albanian youth organization, was the topic of Aqif Domini's short monograph²⁶⁵. The Albanian military officer Marenglen Kasmi published an article²⁶⁶ about the Austrian Hermann Kirchner who also held a position in the Albanian army. Another Albanian military officer, Pëllumb Qazimi, did not mention Kirchner at all in his history of the Albanian army from 1912 until 1991, but he mentioned Ghilardi and the Austrian Gustav von Myrdacz who had served as an officer in the Albanian army, too.²⁶⁷

The Albanian historian Redi Halimi has published an article²⁶⁸ about the government of the "German culture" or of the "Young" 1935-1936. In the first half of the thirties, young intellectuals started to criticise some members of parliament and higher civil servants. A debate between the "elder men" and "young men" was set off.²⁶⁹ In the view of the young men, Albania was governed by old feudal, oriental and anachronistic officials, still educated in the Ottoman Empire, hence provided with an eastern mentality. This ruling class was not expected to be able to modernize the country.²⁷⁰ In October 1935, the monarch appointed the liberal Mehdi Frashëri as Prime Minister.²⁷¹ His cabinet was expected to carry out overdue reforms and to improve the economic and political situation. Except for the veteran Frashëri, all the other ministers were under age of forty years.²⁷² Fuat Asllani, minister of foreign affairs, and Nush Bushati, minister of education, were graduates from

Albanische Korrespondenz: Agenturmeldungen aus Krisenzeiten (Juni 1913 bis August 1914). München: Oldenbourg, p. XLIII–LXVII.

²⁶⁴ Csaplár–Degovics, Krisztián (2016): Komandanti i Djelmënis Shqiptare. In: Schmitt, Oliver Jens (ed.): Për Ardian Klosin, gjermanin nga Shqipëria. Tirana: Fjala Publishing, p. 112–177.

²⁶⁵ Domini, Aqif (1931): Djelmënija, shpresa e ardhëshme, duhet të përgatitet: [këshilla për djelmëninë]. Tirana: Mbrothësia.

²⁶⁶ Kasmi, Marenglen (2013): Hermann Kirchner. Im Dienste der albanischen Armee. In: Truppendienst. Zs. des Österreichischen Bundesheeres. Folge 336, Ausgabe 6, online: <http://www.bundesheer.at/truppendienst/ausgaben/artikel.php?id=1640>.

²⁶⁷ Qazimi, Pëllumb (2013): Histori e ushtrisë shqiptare 1912-1991. Tirana: Naimi, p. 67-69, 72, 87, 91.

²⁶⁸ Halimi, Redi (2014): A Liberal Government in King Zog's Albania? Mehdi Frashëri and the Cabinet of the "Young" (1935–1936). In: SOF 73, p. 306-333.

²⁶⁹ Halimi (2014), p. 307; Akademia e Shkencave e Shqipërisë (2007), p. 376-379.

²⁷⁰ Halimi (2014), p. 308.

²⁷¹ Akademia e Shkencave e Shqipërisë (2007), p. 328-331.

²⁷² Halimi (2014), p. 309.

University of Vienna. Ndoc Naraçi, minister of public works, had graduated from the Technical High School in Vienna, while Rrok Gera, minister of finance, had obtained a degree from the School of International Trade in Vienna. Due to the education of these four ministers in Austria, the Frashëri cabinet was called a government of “German culture”.²⁷³

Basic information about the Austrian-Albanian Society in Vienna, founded by the Austrian writer Friedrich Wallisch on April 30th 1929, is provided by Uran Asllani's monograph²⁷⁴, also available as manuscript²⁷⁵ translated into German and revised by Gostentschnigg in the library of the Albanian Institute at the Institute for Eastern European History in Vienna, and by Gostentschnigg's article²⁷⁶. The membership list of the society with important actors from the late Habsburg Monarchy reflects the significance of the bilateral relations: the Albanian albanologist and diplomat Gjergj Pekmezi, the diplomat and albanologist Theodor Ippen, the diplomat Remi Kwiatkowski, the diplomat Richard Riedl, the geographer and professor at University of Vienna Eugen Oberhammer, the albanologist Carl Patsch, the folklorist Michael Haberlandt and the diplomat Alfred Rappaport.²⁷⁷

Because of the albanophile policy of Austro-Hungary and its merits for the establishment of Albania, many Albanians sent their children to Austrian schools and universities. Asllani (2000), Asllani and Gostentschnigg (2001) and Gostentschnigg (2013) provide also a basic documentation of the activities of former Albanian students in Austria after their return to Albania. These intellectuals formed the most qualified and emancipated part of the Albanian intelligentsia and made an outstanding contribution to the consolidation of the Albanian state. Until now we know about 350 Albanians who finished their secondary and/or tertiary education in Austria. Many of these intellectuals with West European education were persecuted by the communist regime. More than 130 of them were imprisoned and more than 30 executed due to their political convictions.²⁷⁸

²⁷³ Ibid, p. 311.

²⁷⁴ Asllani, Uran (2000): *Studentët shqiptarë të Austrisë dhe veprimtaria e tyre*. Tirana: Ilar.

²⁷⁵ Asllani, Uran; Gostentschnigg, Kurt (2001): *Die albanischen Studenten in Österreich(–Ungarn) bis 1939. Ihre Rolle beim Aufbau des albanischen Staates im Kontext der albanisch–österreichischen Beziehungen*. Manuskript in the library of the Albanien–Institut at the Institut für Osteuropäische Geschichte in Vienna.

²⁷⁶ Gostentschnigg, Kurt (2013): *Die Aktivitäten der albanischen StudentInnen in Österreich bis 1939*. In: Ramaj, Albert (ed.): „Poeta nascitur, historicus fit – ad honorem Zef Mirdita”. Albanisches Institut & Hrvatski Institut za povijest. St. Gallen u. Zagreb, p. 1123–1145.

²⁷⁷ Asllani, Gostentschnigg (2001), p. 44 f..

²⁷⁸ Gostentschnigg (2013), p. 1142-1144.

Oliver Schmitt's article "Balkan-Wien"²⁷⁹ presents Vienna as one of the centres of unofficial Balkan policy of Albanians, Macedonians and Bulgarians. The Austrian-Albanian lobby of the late Monarchy continued its work under the changed political conditions.²⁸⁰

There are very few publications dealing with the reception of Austrian know-how and culture in interwar Albania. The anthology "Tirana: the challenge of urban development"²⁸¹ evaluates the Austrian influence in the field of architecture and city planning. The Albanian historian Gentiana Kera has treated the urban development of Tirana in the interwar period and the impact of Austrian architects and city planners in the first chapter of her dissertation.²⁸² With his contribution²⁸³ for the publication on the occasion of the Viennese exposition "Tirana: planning, building, living", the Albanian architect Artan Shkreli provides us with a good insight into the Austrian share in the city planning of Albania's capital. In 1916, Tirana was surveyed by the Austro-Hungarian military administration. One year later, Austrians laid the foundations of the future Skanderbeg Square. After the city's designation to the new capital in 1920 the Albanian authorities requested some Austrian experts to design a first urban plan, which was known as the Austrian Plan of 1923. It aimed at establishing a compromise between the existing unsystematic road system and the orthogonal system, which was to be extended to the south-western side of the bazaar.²⁸⁴ In 1928, the Austrian architect Wolfgang Köhler revised the Austrian Plan of 1923. His plan laid down the foundations of the ring road and the Zog I Boulevard. In the thirties, young Albanian architects, such as Skënder Luarasi, Qemal Butka or Anton Lufi, who had graduated in Vienna, started working in Albania.²⁸⁵

Until now, there has been no research conducted neither about the activities of Austrian businessmen in interwar Albania nor about the Austrian-Albanian provisional trade agreement of 1927. We only know that

²⁷⁹ Schmitt, Oliver Jens (2014): „Balkan-Wien“ – Versuch einer Verflechtungsgeschichte der politischen Emigration aus den Balkanländern im Wien der Zwischenkriegszeit (1918-1934). In: SOF 73, p. 268-305.

²⁸⁰ Ibid, p. 271, 303.

²⁸¹ Aliaj, Besnik; Lulo, Keida; Myftiu, Genc (ed.) (2003): Tirana: the challenge of urban development. Tirana: Cetus.

²⁸² Kera (2013), p. 35-72.

²⁸³ Shkreli, Artan (2010): 25 years of Tirana's urban planning from 1916-1941. In: Stiller, Adolph (ed.): Tirana. Planen. Bauen. Leben. Salzburg, Vienna: Müry Salzmann, p. 21-42.

²⁸⁴ Ibid, p. 22.

²⁸⁵ Ibid, p. 30.

at the beginning of the twenties the Austrian businessman Rudolf Pentz was owner of the café “Orient” in Tirana, where also film screenings have been taken place.²⁸⁶

Methods and theoretical framework

The most appropriate approach for the investigation of the interwar relations between Austria and Albania seems to be a theory-based postcolonial one. The question is what had been left of the relations between the two countries. What are we looking for if we assume a postcolonial perspective? Postcolonial approaches explore cultural, economic, and political relations both of the colonial era and of the time after. The focus lies on the understanding of interactions, interconnections and complex patterns of power and resistance as well as on the effects and the leftovers of colonialism in nations, societies and cultures before and after independence, including both the decolonized societies and the societies of the (former) “mother countries”.²⁸⁷ A very important factor is the cultural dispositions, which made colonial expansion and rule at all attractive and acceptable – and more fundamentally: thinkable.²⁸⁸ Without an emerging comprehensive colonial discourse we cannot understand neither the colonial ambitions of the propagandists or the willingness of large groups of the population to take part in the expansion project. Even on the part of the colonized people – if we think in this case of the Albanian austrophiles –, central assumptions of this discourse are shared.

The research field of the postcolonial studies has been opened 1961 by Frantz Fanon's major work “*Les damnés de la terre*”. Fanon, the first theorist of decolonisation, argued that colonialism leaves a lasting legacy in economy, politics and culture. The political legacy often creates difficulties for the young postcolonial state, if a national bourgeoisie, which is not interested in a radical change of the colonial conditions, asserts itself against other social classes.²⁸⁹ The state leader is a moral power, under the protection of which the bourgeoisie of the young nation decides to enrich

²⁸⁶ Kaser, Karl (2018): *Hollywood auf dem Balkan. Die visuelle Moderne an der europäischen Peripherie (1900-1970)*. Wien: Böhlau, p. 230.

²⁸⁷ Hirschhausen, Ulrike von (2015): *A New Imperial History? Programm, Potenzial, Perspektiven*. In: *Geschichte und Gesellschaft* 41, 4, p. 753 f.; Kerner, Ina (2012): *Postkoloniale Theorien: Zur Einführung*. Hamburg: Junius, p. 41 f..

²⁸⁸ Conrad, Sebastian (2012): *Kolonialismus und Postkolonialismus: Schlüsselbegriffe der aktuellen Debatte*. In: *Kolonialismus. Aus Politik und Zeitgeschichte* 62, 44-45, p. 7.

²⁸⁹ Kerner (2012), p. 47.

itself.²⁹⁰ Corruption on the one side, misery on the other side, are the consequences, meanwhile the regime bases its power – like the colonial regime before – on army and police, which are advised by foreign experts.²⁹¹ Referring to interwar-Albania, this was exactly that what Zogu did, namely to bring foreign advisers for army, police and other fields into the country.

According to their interdisciplinary background and with the methodical approach and claim of a deconstruction of the colonial discourse and of the binary opposition of (post)colonial cultures, the postcolonial studies further developed i.e. in the English-speaking historical sciences, especially in cultural history and historical anthropology.²⁹² The programmatic anthology, edited by the historian Frederick Cooper and the anthropologist Ann Laura Stoler, “Tensions of Empire”²⁹³ proved as very influential for the further colonial historiography. It analysed the interweaving histories of colony and metropolis in the English, French, Belgian and German colonial empires and unfolded a number of new fields, so, for instance, cultural transfers and interrelations between the colonized and the colonizing. Stoler’s and Cooper’s concern was to bring together the metropolis and colony, the colonizer and the colonized in a common analytic field, in order of being able to understand them with regard to their co-implications and moments of mutual constitution.²⁹⁴ Beyond that, their method consists in exact investigations on the micro level aiming at describing the diverse strategies and complex forms of interaction, which have resulted in the formation of specific historical constellations. Colonial legacies or even continuities cannot be simply supposed, but have to be reconstructed historically in their respective specificity. For example, we have to investigate, how those persons, who were positioned in the centre of the colonial system of authority, could restructure their relations inside and outside the national political room.²⁹⁵ If political decolonization is to be

²⁹⁰ Fanon, Frantz (1981): *Die Verdammten dieser Erde*. Frankfurt/Main: Suhrkamp, p. 141.

²⁹¹ *Ibid.*, p. 147.

²⁹² Hall, Stuart (ed.) (1997): *Representation: Cultural Representations and Signifying Practices*. London: Thousand Oaks; Kerner (2012), p. 41.

²⁹³ Cooper, Frederick; Stoler, Ann Laura (ed.) (1997): *Tensions of Empire. Colonial Cultures in a Bourgeois World*. Berkeley: University of California Press.

²⁹⁴ Stoler, Ann Laura; Cooper, Frederick (1997): *Between Metropole and Colony. Rethinking a Research Agenda*. In: Cooper, Frederick; Stoler, Ann Laura (ed.): *Tensions of Empire. Colonial Cultures in a Bourgeois World*. Berkeley: University of California Press, p. 15.

²⁹⁵ Cooper, Frederick (2005): *Colonialism in Question. Theory, Knowledge, History*. Berkeley/Los Angeles: University of California Press, p. 19 f..

understood as the disengagement between colonizer and colony, then it becomes part of a large and complicated complex of social change and we have to look at a large range of interventions varying from administrative institutions to businesses, education and lifestyles.²⁹⁶

The Habsburg Monarchy was no colonial state in the strict sense, no dominion like those, which the postcolonial studies have originally referred to. Its power position was not primarily based on the violent imposition of administrative structures, the development of overseas areas for its economic exploitation as well as on the legal segregation of colonial masters and indigenous population by the lack of general citizenship.²⁹⁷ An interesting, but ambivalent exception of this Austrian rule is the Austro-Hungarian conquest of Bosnia-Herzegovina. Here we are dealing with a remarkable mesh of structural features of European colonialism and Austro-Hungarian social manners with regard to cultural and economic difference.²⁹⁸ The long lasting military occupation status until the annexation in 1908 and, connected with it, the administrative segregation led, in comparison with the old crown lands, to an insufficient representation and legal position of the province and its ethno-religious communities. This was also justified as civilization or "Europeanization" project.²⁹⁹ The instruments of this strategy were the codification of a Bosnian variant of the Serbo-Croat language, cultural integration projects like the foundation of the Landesmuseum in Sarajevo in 1888 as well as the creation of Bosnian military elite units. In doing so, a lot of Austrian representation forms and identity discourses followed colonial patterns ranging from the imagination of the own cultural superiority, communicated in travel and authority reports, to the sense of mission of the European-Christian metropole in view of the non-Christian periphery and its "wilderness areas".³⁰⁰

In the case of Austro-Hungary and Albania it is about a very unique case of cultural and informal imperialism with only two years of direct semi-formal imperialism; therefore we are dealing with a very complex

²⁹⁶ Boegaerts, Els; Raben, Remco (2012): *Beyond Empire and Nation*. In: Boegaerts, Els; Raben, Remco (ed.): *Beyond Empire and Nation. Decolonizing Societies in Africa and Asia, 1930s – 1970s*. Leiden: KITLV Press, p. 18.

²⁹⁷ Wendland, Anna Veronika (2010): *Imperiale, koloniale und postkoloniale Blicke auf die Peripherien des Habsburgerreiches*. In: Kraft, Claudia; Lüdtkke, Alf; Martschukat, Jürgen (ed.): *Kolonialgeschichten. Regionale Perspektiven auf ein globales Phänomen*. Frankfurt/Main, New York: Campus, p. 212.

²⁹⁸ *Ibid.*, p. 213.

²⁹⁹ *Ibid.*, p. 213 f..

³⁰⁰ *Ibid.*, p. 215.

process. At first we have to find out, if the colonial image of decolonization as a retreat and the national representation of independence as national destiny have emphasized the event as a rupture,³⁰¹ or more as fundamental continuities between colonial and postcolonial times. We have to examine the narrative of decolonization in Albanian historiography and journalism of the interwar period and to investigate in the ministerial file holdings, if any institutional, personal and ideological continuity have existed and if any political, administrative, legal and social models as well as cultural paradigms from the Austro-Hungarian imperial past have been used. Another question to be answered is the role of the successful acquisition of the originally foreign Austrian culture in the later strategy of differentiation from the new hegemonic power Italy, which has met in Albania with fewer acceptances, even by King Zogu himself.

Gostentschnigg's spot checks both in the Archive of the Republic in Vienna (in the Department of Foreign Affairs in the Federal Chancellor's Office, for example on the Austrian colony in Albania and the Austro-Albanian provisional trade agreement of 1927) and in the State Archive in Tirana (for example personalities; parties, organizations and associations; foreign advisers and specialists; relations between Albania and Austria) have proven that there is enough file material in order to answer the question, whether the Austro-Albanian relations in the interwar period did have a postcolonial character or not, and if yes, of what kind it was.

About *Freundlich* several files in the Archive of the Republic in Vienna and in the State Archive in Tirana as well as a biographical article³⁰² are at disposal. Information about *Ghilardi's* work in Albania is available in a number of files in the State Archive in Tirana as well as in *Csaplár–Degovics'* abovementioned article³⁰³ and in *Domini's* monograph³⁰⁴. *Myrdacz's* Work for the Albanian army is mentioned in several files in the State Archive in Tirana, and there are some reports of him in the files in the Archive of the Republic in Vienna. Relating to *Kirchner's* work for the Albanian army, we can refer to respective files in the State Archive in Tirana and to the abovementioned basic article³⁰⁵ of *Kasmi*. In the National Library in Tirana, there are two writings of *Kirchner* for the officer's school at hand: a paper about the military geography of Albania and a practical guide about topography. As checked by Gostentschnigg, information about

³⁰¹ Boegaerts, Raben (2012), p. 13 f..

³⁰² Strommer (2012).

³⁰³ Csaplár–Degovics (2016).

³⁰⁴ Domini (1931).

³⁰⁵ Kasmi (2013).

the Austrian-Albanian Society in Vienna and its branch in Tirana can be found in August Kral's unpublished works in the Viennese House-, Court- and State Archive and in the Albanian State Archive. As also already abovementioned, basic information about Wallisch and his Austrian-Albanian Society in Vienna is provided by Asllani's monograph³⁰⁶, available as revised manuscript³⁰⁷, and by Gostentschnigg's article³⁰⁸. Patsch's unpublished works and correspondence, is stored in the Bavarian Main State Archive and belonging to the holdings of the Leibniz-Institute for East and Southeast European Studies in Regensburg. A minor part of Jokl's books, unpublished works and correspondence – the major part has been lost in WWII – is accessible in the National Library in Vienna. About Jokl two conference volumes³⁰⁹ and Petrit Kotri's monograph³¹⁰ have been published. Lambertz' unpublished works and correspondence are stored in the National Library in Vienna too, where we may find relevant data about his work in the interwar period. Information about Scheiger, who has worked as commercial attaché at the German embassy in Tirana, can be found in the Political Archive of the Federal Foreign Office in Berlin and in Scheiger's voluminous unpublished works, stored in the Leibniz-Institute for East and Southeast European Studies in Regensburg. Relating to Zogu, Curani, Pekmezi and many former Albanian students in Austria, the file holdings in the Austrian Archive of the Republic, the Albanian State Archive and the pertinent literature in the National Library in Tirana have to be consulted. King Zogu's life and work are well documented by several monographs³¹¹. Basic information about the former Albanian students in

³⁰⁶ Asllani (2000).

³⁰⁷ Asllani, Gostentschnigg (2001).

³⁰⁸ Gostentschnigg (2013).

³⁰⁹ Osmani, Tomor; Kotri, Petrit; Kazazi, Njazi (ed.) (2003): *Norbert Jokli 1877-1942: Albanolog i shquar austriak. Materiale të Konferencës Shkencore në nderim të N. Joklit, mbajtur në Shkodër, më 28-29 Qershor 2002*. Shkodra: Camaj-Pipa; Ölberg, Hermann (ed.) (1977): *Akten des internationalen Kolloquiums Innsbruck 1972 zum Gedächtnis an Norbert Jokl*. Innsbruck: Institut für Sprachwissenschaft.

³¹⁰ Kotri, Petrit (2003): *Norbert Jokl und seine Studien zur albanischen Sprache*. Peja: Dukagjini Publishing House.

³¹¹ Fischer, Bernd Jürgen (1984): *King Zog and the struggle for stability in Albania*. New York: Columbia University Press; Schmidt-Neke, Michael (1987): *Entstehung und Ausbau der Königsdiktatur in Albanien (1912-1939)*. München: Oldenbourg; Tomes, Jason (2003): *King Zog, Self-Made Monarch of Albania*. Stroud: Sutton; Pearson, Owen (2004): *Albania and King Zog. Independence, Republic and Monarchy 1908–1939*. London: I. B. Tauris; Fevziu, Blendi (2014): *Ahmed Zogu. Presidenti që u bë mbret*. Tirana: UET Press.

Austria we can find in Asllani's monograph³¹², in order to verify, if an entire generation of intellectuals, facing a "cultural and historical hybridity"³¹³, has been educated and imbued with certain visions of modernity.

Basic information about the Albanian national museum project is available in Clayer's abovementioned article³¹⁴, further information in the State Archive in Tirana and, as also already checked by Gostentschnigg, in Patsch's unpublished works and correspondence. Concerning the provisional trade agreement between Austria and Albania, signed on April 14th 1927, the relevant files in the Austrian Archive of the Republic and the Albanian State Archive have to be sighted. Information about the beginning of the diplomatic and consular relations between the two countries can be found in the relevant file holdings in the Austrian Archive of the Republic and the Albanian State Archive, basic information is provided by the abovementioned article³¹⁵ of Dibra. For the investigation of the Albanian literature with regard to their interpretation of Austria-Hungary's exertion of influence on Albania we have Robert Elsie's basic monograph³¹⁶ and the literature in the National Library in Tirana. About Migjeni, one of the main representatives of Albanian literature in the interwar period, we have Eljon Doçe's dissertation³¹⁷. Regarding the representation of Austria-Hungary's role for Albania in Albanian historiography and newspapers of that time, we can rely on the rich holdings in the National Library in Tirana. A true treasure in the Viennese War Archive is the conscientious work³¹⁸ of Mariano San Nicolò, who has written an extensive description (362 pages!) of the Austro-Hungarian-Albanian legislative work in the occupied territories. It is a for official purposes revised collection of all issued orders of the High Command in Albania with normative character. Last but not least Gostentschnigg has got from the Austrian Embassy in Tirana a list of 45 Albanian descendants of Austrian citizens. Some of them are relatives of

³¹² Asllani (2000).

³¹³ Boegaerts, Raben (2012), p. 9.

³¹⁴ Clayer (2012).

³¹⁵ Dibra (2016).

³¹⁶ Elsie, Robert (1995): *History of Albanian Literature*. New York: Columbia University Press.

³¹⁷ Doçe, Eljon (2014): *Studim monografik mbi veprën e Migjenit*. Tirana: Disertacion.

³¹⁸ San Nicolò, Mariano (1918): *Die Verwaltung Albaniens durch die k. u. k. österreichisch-ungarischen Truppen in den ersten zwei Jahren der Besetzung des Landes an der Hand der ergangenen Befehle. Zum Amtsgebrauch bearbeitete Sammlung der vom Höchsten Kommando in Albanien erlassenen Verordnungen normativen Charakters*. Vienna: Kriegsministerium.

former Albanian students in Austria. So, he can contact their children and grandchildren for conducting oral history interviews, in order to investigate the self-classification and memory practices of those actors,³¹⁹ who have been dealing with imperial experiences during the postcolonial processes. There will be approx. 15 interviews conducted; five interview partners are already identified.

The analyses of all these file holdings, unpublished works and correspondence, monographs and articles as well as oral history interview records will be guided by the postcolonial approach of Cooper and Stoler, in order to answer the above-mentioned research questions and to document the Austrian contribution to the consolidation of the Albanian state and the Albanian legacy in Austria. The possible interplay between the political, economic, cultural and albanological (in the case of the Austrian albanophiles) field will be investigated. Possible interactions between Austrian albanophiles, represented also by former colonizers, and the Albanian austrophiles, represented also by former colonized, will be studied, too. The joint interests and common beliefs of Albanian austrophiles to contribute to the consolidation of Albania by means of their in Austria gained know-how and network, and of Austrian albanophiles to contribute to the consolidation of Albania and to the bilateral relations by means of their especially in Austria gained expertise, have to be found out. The visible and invisible networks of these actors have to be reconstructed.

³¹⁹ Egger, Michael (2016): *Der kleine Oral History Ratgeber*. Schriftenreihe der Arbeitsgemeinschaft für Wirtschafts- und Sozialgeschichte. Ed. by Gerald Schöpfer. Second edition. Graz: self-published.

Kurt Gostentschnigg: Wissenschaft im Spannungsfeld von Politik und Militär. Die österreichisch-ungarische Albanologie 1867-1918.

Wiesbaden: Springer VS 2018. (828 f.)

(shqip: “Shkenca në fushën tensionuese të politikës dhe ushtrisë. Albanologjia austro-hungareze 1867-1918”).

Përmbledhje

Kjo monografi ofron për herë të parë një paraqitje përmbledhëse të të gjitha marrëdhënieve austro-hungaro-shqiptare në shkencë, politikë, ekonomi, ushtri dhe kulturë si dhe një përpjekje të rikonstruksionit të fushave “shkencë/albanologji”, “politikë”, “ushtri” dhe “austrofilë” sipas teorisë së fushës të Pierre Bourdieu-s. Ky studim i përgjigjet pyetjes së lidhjes së shkencës, politikës dhe ushtrisë në këto marrëdhënie bilaterale duke zbatuar teorinë e imperializmit kulturor të Johan Galtung-ut, emërton aktorët individualë dhe kolektivë të fushave të lartpërmendura, tematizon perspektivat e tyre, tipizon aktorët individualë si dhe përmban një tematizim të ndërveprimit të fushave dhe një rikonstruksion të ashtuquajturës “fushë të pushtetit”.

Përmbajtje (kapituj kryesorë)

- Fusha Shkencore
- Fusha Politike
- Fusha Ushtarake
- Fusha e Austrofilëve
- Ndërveprimi i fushave
- Përfundimi: Fusha e Pushtetit si motor për imperializmin kulturor me anë të dhunës strukturore dhe kulturore

Lexues të synuar

- studentë, pedagogë dhe studiues të disiplinave historike, shkenca politike, diplomaci, gjuhësi, albanologji, etnografi, gjeografi dhe arkeologji
- të punësuar në shërbimin diplomatik

* **Mag. Dr. phil. Kurt Gostentschnigg** është historian, albanolog, gjermanist, përkthyes dhe interpretues i çiftit gjuhësor gjermanisht-shqip si dhe shkrimtar dhe poet, banues në Graz, Austri.

Kurt Gostentschnigg: Wissenschaft im Spannungsfeld von Politik und Militär. Die österreichisch-ungarische Albanologie 1867-1918. Wiesbaden: Springer VS 2018. (828 p., print-on-demand and e-book)

ABSTRACT

The main question of the research project was, if, regarding the creation of the Austro-Hungarian albanology and its support by the public sector in the second half of the 19th and the beginning of the 20th century, it was about a neutral research support or an interlinking with imperialistic interests. The result of the research project is that the second supposition clearly predominated, because

- 1) individual and collective/institutional actors shaped Austro-Hungarian-Albanian relations in the fields of albanology, politics, military, and Albanian austrophiles, who put their property, connections, education, career and prestige as capital in the rivalry for the most influential positions in the respective field;
- 2) the interest of Austro-Hungarian albanology was to cast light on yet unknown aspects of Albanian history, culture and language, believing naturally that the Dual Monarchy had to pioneer them, which influenced in turn the selection of their research topics;
- 3) the interest of the Austro-Hungarian politics and diplomacy was to gain Albania as a political ally against pan-Slavism and Italian imperialism;
- 4) the interest of the Austro-Hungarian military was to arm Albania and to integrate it, for the case of war, in the own tactics and strategy;
- 5) the interest of the Albanian austrophiles was – always in accordance with their own nationalist interests – to act as agents of Austro-Hungarian interests in Albania;
- 6) the interconnected main individual and collective actors of these fields formed the 'field of power', which was the motor for cultural imperialism by means of structural and cultural violence;
- 7) the political program of the Foreign Ministry to instrumentalize Albanian Studies for political, commercial and military aims was only achieved in part but, nevertheless, albanology was supported in generous manner by subsidies and permission of research projects and research

expeditions so that it would willingly devote itself in case of emergency to the service of politics and military;

- 8) Austro-Hungarian albanology had three different types of actors – the pure scientific type, the mixed political-scientific type with proximity to or involvement in the political field, the mixed military-scientific type with proximity to or involvement in the military field –, by which the interweaving of science, politics and military can be linked to persons.

Rokin DABERDAKU

MARRËDHËNIET E SKËNDERBEUT ME VATIKANIN (1444-1467)

Për marrëdhëniet ndërkombëtare të shtetit të Skënderbeut ka pasur vlerësime të ndryshme. Sipas historiografisë shqiptare të para Luftës II Botërore, Skënderbeu ka qenë në marrëdhënie të mira me shumicën e shteteve evropiane dhe sidomos ato italiane dhe me Hungarinë. Këto marrëdhënie janë vlerësuar si marrëdhënie të frymëzuara nga karakteri i luftës kryqtare. Skënderbeun e ndihmuan shumë shtete italiane në mënyrë efektive, sidomos Papati. Në shek.XV mund të thuhet se bota mesjetare me qendrën e vet të rendesës përreth pellgut të Mesdheut ishte e ndarë kulturalisht, akoma më tepër politikisht, por edhe nga pikëpamja fetare, në dy kampe të mëdha: ai i quajtur mysliman dhe ai i quajtur kristian. Nga njëra anë një kulturë dhe një qytetërim në një fazë akoma patriarkale të përfaqësuar nga turqit e asaj kohe, e nga ana tjetër, një kulturë që kishte nisur gjallërisht të zhvillohej në bazë të traditave kulturore, civile, klasike dhe kristiane të tipit modern. Tabloja politike e fetare ishte interesante, sepse nuk mungonin princër e popuj kristianë të shndërruar në vasalë të turqëve³²⁰ e për këtë arsye të shtrënguar për të luftuar ushtarakisht përkrah tyre, ashtu si nuk mungonin princër e popuj myslimanë në kontradikta me turqit, të cilët mund të lidhnin aleancë me kristianët³²¹.

Disa historianë shqiptarë, pa bërë asnjëherë kërkime dhe hulumtime shkencore në ndonjë arkiv të rëndësishëm ku ruhen burime dhe dokumente origjinale për marrëdhëniet e Selisë së Shenjtë dhe Gj. K. Skënderbeut, të mbështetur në pohime të historianëve të huaj si p.sh., Voigt dhe Fallmerayer, pohojnë pa asnjë argument se papët e ndihmuan Skënderbeun vetëm me bekime apostolike dhe me ligjërata panegjrike, zëra këto që gjejnë jehonë të fuqishme edhe sot e kësaj dite jo vetëm në historiografinë e huaj, por për fat të keq edhe në atë shqiptare. Më rënien e Kostandinopojës në duart e osmanëve, u rrit shqetësimi në Evropë. Përballë rrezikut osman u bënë përpjekje për organizimin në shkallë evropiane të një lufte të përbashkët për t'i dëbuar ata nga Ballkani. Këto përpjekje u konkretizuan

³²⁰ Pastor, L., Storia dei papi dalla fine del Medio Evo, vëll I, Roma, 1942, f. 167.

³²¹ Po aty, f. 616.

me hartimin e projekteve të një kryqëzate me pjesëmarrjen e shumë vendeve. Për vende të rajonit të Evropës Juglindore, si: Arbëria, Serbia, Bosnja, Rumania etj., “kryqëzata” ishte një koncept i imponuar, për ta ajo kishte thjesht karakter defensiv duke synuar mbrojtjen e vetë ekzistencës të tyre, përzier me elemente mësymëse që funksiononin vetëm si përplotësues të nevojshme të kësaj mbrojtjeje. Ndërkaq për fuqitë e krishtera të Perëndimit, sikurse ishin Dukati i Burgundit, Mbretëria Aragonese-Napolitane, Republika e Vendeikut, Dukuati i Malanos etj., “kryqëzata”, ishte gjithashtu koncept i sugjeruar nga politika e Shtetit Papnor, por duke pasur karakter mirëfilli mësymës. Në shkakun e luftës kundër “islamit” secila prej shteteve synonte edhe ralizimin e interesave të ekspandimit tregtar, politiko-ushtarak dhe territorial në Mesdheun Lindor ose në Evropën Juglindore. Në mënyrë të veçantë paraqitej Republika e Venedikut, e cila ishte fuqia më e madhe mesdhetare, dhe interesi kryesor i saj ishte garantimi i rrugëve tregtare tokësore dhe detare.

Edhe Papati e shihte marrëdhënien me Skënderbeun mbi baza interesi të ndërsjellë, interesa këto që erdhën duke u forcuar me kalimin e kohës dhe me rritjen e famës së Skënderbeut si strateg në luftën kundër osmanëve. Ishte pikërisht dështimi i kryqëzatës së Varnës (1443-1444)³²², e mbështetur nga papati dhe e udhëhequr nga Vladislavi III, mbreti polak, që e bëri papatin që të kthejë vëmendjen e tij nga Skënderbeu, i cili me qëndresën e pandërprerë në territoret shqiptare ndezi përsëri shkëndijat e shpresës për papatin dhe pengimin e depërtimit osman në Evropën perëndimore. Megjithatë, që Skënderbeu të fitonte plotësisht besimin e Selisë së Shenjtë, iu desh kohë dhe shumë fitore kundër turqve. Atij iu desh jo vetëm të çonte ushtritë nga fitorja në fitore, por edhe të demonstronte që ishte serioz në sipërmarrjet e tij kundër turqve dhe që do të luftonte si një princ i krishterë

Papët Eugjeni IV, Nikolla V, Kalisti III, Piu II dhe Pali II e afruan mjaft Skënderbeun, duke i dhënë një rol kryesor në të gjitha kualicionet antiosmane, që u ndërmorën në kuadër të një Evrope të krishterë. Kjo mbështetje normalisht nuk i vlejti vetëm Skënderbeut, por ajo pati një rol në faktorizimin e shqiptarëve të hershëm si të barabartë me shtete të tjera antiosmane, si: Venediku, Raguza, Mbretëria e Sicilisë, Mbretëria e Hungarisë etj. Marrëdhëniet e Selisë së Shenjtë me Skënderbeun kishin filluar qysh herët dhe patën një vazhdimësi të pandërprerë deri në fund të jetës së Skënderbeut, mund të themi pa frikë edhe për rrugë diplomatike të konsoliduara midis tyre. Ndër më të hershmit zë diplomatik i Selisë së

³²² At Giuseppe (Zef) Valentini. *Skënderbeu dhe Papati*, Plejad; Tiranë, 2009, f. 11.

Shenjtë pranë Skënderbeut që daton nga 1 Prilli i vitit 1444, është Paganino³²³, ipeshkëv i Ulqinit. Papa Eugjeni IV e konfirmon, ipeshkvin e Ulqinit në autoritetin dhe postin e nuncit të Selisë së Shenjtë për Shqipërinë dhe Dalmacinë.

Papa Nikolla V, me 19 mars të vitit 1447³²⁴, nëpërmjet një bulë (dekret i papës), u jep *indulgentia plenaria*³²⁵ të gjithë atyre që do të ndihmonin Gjergj Kastriotin Skënderbeun me para. Duhet të kemi parasysh që indulgjencat luanin një rol shumë të rëndësishëm në jetën e besimit të asaj kohe, dhe që ishin një ndër motorët kryesorë që kisha përdorte për të mbledhur para, të cilat ishin në shuma të konsiderueshme. Që më 20 qershor të vitit 1447, po ky papë dërgoi françeskanin Antonio de Oliveton si “nunc të Selisë Apostolike në viset e Arbërisë dhe Dalmacisë” (ad partes Albaniae et Sclavoniae), që mund të jetë edhe nunci i parë apostolik që vjen si i tillë zyrtarisht në Arbëri, me porosi që të bënte çmos për të bindur besnikët e krishterë t’i jepnin mbështetje luftës kundër turqve të drejtuar nga Gjergj Kastrioti Skënderbeu, të cilin e përmend shprehimisht “*t’i japim birit të dashur, burrit fisnik Gjergj Kastriotit zot në Arbëri përkrahje dhe ndihmë kundër turqve*” (*dilecto filio nobili viro Georgio Castriothi, domino in Albania*)³²⁶. Nëse viti më 1450, që ishte për krishtërimin vit jubilar, mbas fitoreve të Skënderbeut, Nikolla V i kishte dërguar atij disa ndihma, duke quajtur “*luftëtar të krishtit*” dhe “*kampion dhe shqyt të krishtërimit kundër turqve*”, viti 1451 duket më i gjallëruar prej lëvizjesh të ndërsjellta ambasadorësh, kryesisht klerikë, prej Skënderbeut në kurjen e Romës dhe prej kurjes së Romës tek Skënderbeu. Papa Nikolla V për të përcjellë tek Skënderbeu një pjesë të të hollave që ishin mbledhur nga ndjesat e 1450-s, caktoi edhe me ngulmimin e Skënderbeut për marrëdhënie të drejtpërdrejta me Selinë e Shenjtë, françeskanin Eugjen Suma (de Somma) si “*internunc papnor*” me autoritet jo vetëm në Arbëri, por edhe në Bullgari dhe Rashje³²⁷. Gjithashtu të gjitha subvencionet jubilarë që mblidheshin në

³²³ Alesandro Serra, *Relazioni del Castriota con il Papato nella lotta contro i turchi (1444-68)*, Roma, 1956, f. 124.

³²⁴ Basilio Pandzic. *Françeskanët në shërbim të Shqipërisë*. Romë, 1956, f. 48-50.

³²⁵ Shënimi ynë; *Indulgentia plenaria* janë letra kishtare që shpallin faljen e mëkateve për cilindo që paguante një sasi të caktuar të hollash ndaj kishës.

³²⁶ *Françeskanët...* vep. e cit., f. 49.

³²⁷ Aurel Plasari. *Skënderbeu një histori politike*. Instituti i Studimeve Shqiptare “Gjergj Fishta”, Tiranë, 2010, f. 443.

Kotorr (1.500 dukate), papa porosiste t'i jepeshin Skënderbeut në marrëveshje me Sinjorinë e Venedikut. Por bashkësia e Kotorrit synonte të mbante për vete të paktën 1/3 e tyre³²⁸. Mbas disa negociatave të vitit 1451, në Marsin e vitit 1452 internunci papnor Eugjen Suma do t'ia dilte të merrte në emër të Skënderbeut 4893 perperë nga të hollat e mbledhura prej ndejsave të vitit 1451 në rajon, sipas urdhrorit të Papës³²⁹.

Me tej Selia e Shenjtë në vitin 1452, më konkretisht me 13 gusht 1452, papa Nikolla V, emëron Paolo Dussus (Pal Dushin)³³⁰, ipeshkvin e Drishtit si nunc dhe mediator të paqes midis Skënderbeut dhe Pal e Nikoll Dukagjini, e cila u arrit në Durrës më 25 tetor 1452, falë punës së mirë të bërë nga nunci papnor³³¹. Një rast tjetër intervenimi apostolik shfaqet në vitet 1463-1464 kur Skënderbeu dhe Dukagjinasi kishin marrë një qëndrim neutral përkundrejt osmanëve. Duke qenë se po bëheshin plane sulmi nga ana e krishterëve kundër turqve nën udhëheqjen e papës Piu II, ky i fundit i donte që Skënderbeu dhe Dukagjinasi të ishin aktiv në fushatën anti-osmane³³². Për zellin e këtij pape kemi edhe një letër ku kardinali Carvajal, i cili ishte mbrojtës i papës Nikolla V, i shkruante kardinalit Barbaroja dhe peshkopit Enea Silvi, të cilët përfaqësonin krahun: se papa ende nuk bënte sa duhej për organizimin e kryqëzatës. Në përgjigje të letrës Enea Silvi, thotë se ndihmat e dërguara nuk mjaftojnë për t' bërë ballë një ushtrie siç ishte ajo turke³³³. Rënia e Kostandinopojës krijonte rrethana të reja, kështu që Papës Nikolla V në kuvendin vitit 1453-1454, iu paraqit një projekt për organizimin e një kryqëzate nga mbreti Alfons i Napolit, ku Skënderbeu do të jetë i pranishëm. Por siç e dimë ky kuvend nuk rezultoi frytdhënës. Si të mos mjaftonte kjo, për Skënderbeun u rikthye situata e dy viteve më parë, ajo e konfliktit me Dukagjinët të cilët tashmë kishin lidhur aleancë me turqit. Situata ishte tepër delikate, sepse për Skënderbeun kjo nuk paraqitej më si çështje opozite, por ekzistonte rreziku i një lufte civile. Duke e vlerësuar masimalisht situatën si “dëm të çështjes së krishterë”, papa

³²⁸ Aurel Plasari, *Skënderbeu një histori politike*. Instituti i Studimeve Shqiptare “Gjergj Fishta”, Tiranë, 2010, f. 443.

³²⁹ Po aty.

³³⁰ Peter Bartl, *Albanien unter osmanischer Herrschaft*. Munchen, 1998, f. 117-119.

³³¹ Biemmi, G., *Istoria di Giorgo Castrioto detto Scander-Begh*. Brescia, 1742, f. 297-298.

³³² *Skënderbeu një histori...* vep. e cit., f. 621.

³³³ Po aty, f. 461.

Nikolla V, me mesazhin e 22 gushtit të vitit 1454, i shtrëngonte Dukagjinët që ta prishinin ujdinë me turqit dhe të pajtoheshin me Skënderbeun. Pajtimin duhej ta shoqëronin me një “*betim fetar*”, për të cilin angazhoheshin dy peshkopë: Andrea i Lezhës dhe Nikolla i Pultit.³³⁴ Një orvatje pranë Dukagjinëve bëri në tetor të atij viti edhe mbreti Alfons: një i dërguar i Dukagjinëve me emrin “Brexanus” kryente një vizitë në oborrin e tij dhe Alfonsi ia porosiste atë papës për t’i dhënë “zgjidhjen nga mëkati” të zotit të tij Dukagjin për betimin e bërë me rastin e paqes me turqit”. Papa Nikolla V i zgjidhte Dukagjinët nga shkishërimi që i kishte dhënë për shkak të lidhjes me turqit, ndërsa mbreti Alfons detyrohej t’i lidhte Pal Dukagjinit një provision prej 300 dukatesh në vit, që do të nxirreshin prej të ardhurave të kripës në Arbëri, për këtë ujdë mbreti i Napolit do të njoftojë si Pal Dukagjin ashtu edhe Skënderbeun³³⁵. Një vit më pas me 24 mars papa Nikolla V do të vdiste dhe në politikën e tij mund të fshihet një element kontradiktor, sepse ai në vend që të sheshonte kontradiktat midis shteteve italice i nxiste ato në favor të fuqizimit të shtetit papnor³³⁶.

Papa Kalisti III (1378-1458) ishte papa i dyqindenëntë (209) i Kishës Katolike prej vitit 1455 deri në vdekjen e tij, që ndodhi në Romë më 6 gusht të vitit 1458. Emri i tij i vërtetë ishte Alfonso Borgia dhe lindi në Valencia të Spanjës. Sipas historiografisë, është konsideruar një papë, i cili kishte ndërmend të organizonte një kryqëzatë kundër turqve, për këtë ai nxori vetëm disa ditë pasi u shpall papë një akt papnor, më 15 maj 1455, ku urdhërohej predikimi i kryqëzatës në mbarë botën e krishterë³³⁷. Por një kryqëzatë e tillë kërkonte mjete financiare, papa Kalisti III trashëgoi nga parardhësi i tij humanist Papa Nikolla V, rezerva të shteruara si pasojë e politikës së admirueshme, por edhe të rrezikshme të mecenatizmit³³⁸. Në përgjithësi shoqëria feudale e Evropës pasqyrore në atë kohë ngallënjimin e një sistemi interesash të ngushta individuale dhe dukej qartë se Universalizimi i Kishës po humbte terren. Kjo gjë dukej nga qëndrimet

³³⁴ Cordignano, F. & Valentini, G., *Saggio di un regesto storico dell’Albania*. Scutari, 1940, f. 846.

³³⁵ *Skënderbeu një histori...* vep. e cit., f. 476.

³³⁶ Po aty, f. 482.

³³⁷ *Skënderbeu një histori ...* vep. e cit., f. 485.

³³⁸ At G. Valentini. Kalisti III, *Skënderbeu, Shqipëria dhe kryqëzata e vitit 1455-1458*. Plejad, 2009, f. 174.

morale ndaj Kryqëzatës të njerëzve që ishin përgjigjur apelit papanor. *Kishte edhe njerez që e rroknin kryqin veç për të gëzuar avantazhe, duke iu përvjedhur detyrimeve: për shembull kishte kryqtarë që nuk u nisën kurrë për në luftë, duke gëzuar ndërkaq privilegjin kanonik të të mos qenit të detyruar të paguanin borxhet e tyre. Të tjerët bëheshin kryqtarë falë një ethshmërie të shkujdesur fetare, apo ndoshta për të zgjidhur situata të përvetshme të vështira e të dëshpëruara, duke qenë veçse krejt të pazotë nga ana ushtarake, aq sa edhe vetë Papës, iu desh të urdhëronte lirim të tyre përfundimtar³³⁹. Skënderbeu, nëpërmjet ambasadorit të tij dhe zotërve të tjerë arbër, Nikoll Berguzzi³⁴⁰ (i njohur qysh prej vitit 1451), i dërgon një përgjigje gatishmërie dhe bashkëpunimi kardinalit Juan de Carvajal, për kryqëzatën e lançuar nga papa Kalisti III. Duket qartë se Skënderbeu dhe Arbëria kishin një interes maksimal për të qenë pjesë e rëndësishme e kësaj kryqëzate. Edhe pse Skënderbeu kishte pësuar disfatën e Beratit me 26 korrik 1455 dhe luhatjeve të pushtetit të tij pas tradhtive të nipërve të vet Gjergj Stres Balshës, që kishin dorëzuar kështjellën e Modricës në 1456 dhe Hamzait në 1457, e përfitoi sërish mbështetjen e vazhdueshme të Papës Kalisti III dhe mbi të gjitha vlerësimet pozitive të shpërndara në të gjitha oborret e Evropës përmes korrespondencës së tij. Kështu shembulli i tij nga motiv ndihmash, u shndërrua në motiv inkurajimi për princat e krishterë në luftën kundër turkut. Ky fakt duket qartë në letrën që i dërgonte mbretit të Hungarisë, Matia Korvini: “*Falë fitoreve të tjera të arritura nga biri ynë i shtrenjtë, fisniku Skënderbe i Shqipërisë kundër turqve, forcat e armikut duhet të jenë ligështuar në maksimum*³⁴¹”. Sipas një breve e shkurtit të vitit 1458, papa Kalisti III u jepte një shumë prej 5000 florinash për Skënderbeun abatit të Shën Mërisë së Nëndrafinës dhe Pal Gazullit (duhet të kenë qenë emisarët që i kishin çuar papës lajmin e fitores së betejës së Ujit të Bardhë) si dhe i shprehte Skënderbeut edhe lavdërim pa kursim “*I falemi nderit Zotit që, në ato vise prej të cilave si nëpër një portë armiku dinak dhe fort i egër mund të çajë rrugë për t’iu vërsulur krishtërimin, të ka vendosur ty si ledh dhe mur fort të fuqishëm për të bërë qëndresë dhe, nëpërmjet teje, me lavdinë dhe zulmën tënde më të madhe, për t’i dhënë**

³³⁹ Po aty, f. 170.

³⁴⁰ Skënderbeu një histori ... vep. e cit., f. 503.

³⁴¹ Skënderbeu dhe Shqipëria ... vep. e cit., f. 208.

*dërrmen vijimisht armikut me të cilin të duhet të ndeshesh drejtpërsëdrejti. Të kishim mes princërve të tjere të krishterë asish me shpirtin tënd, atëherë nuk do të ishim as të shqetësuar e të brengosur për mbrojtjen e fesë*³⁴². Kjo korrespondencë inkurajuese i drejtohej edhe Matias Korvinit për ta tërhequr në Kryqëzatë duke i kujtuar fitoret e “*birrit të dashur dhe burrit fisnik Skënderbe në Arbëri*”, përkrah asaj të vitit 1456 korrur në Beograd nga Janosh Huniadi³⁴³. Në rastin e marrëdhënieve me Gjergj Kastriotin Skënderbeun janë rreth 180 fletë të vëllimit modest të Kalistit III, që ruhen në “Archivio Segreto Pontificio” në Vatikan e që janë quajtur prej prej arkivistëve *Liber brevium*, kuptohet se papa Kalisti III ia doli të vinte në lëvizje princërit e krishterë të Evropës, si dhe sinjorinë italiane, për të kontribuar në organizimin e kryqëzatës. Në vitet e papnimit të tij trima të krishterë, pa përjashtuar aventurierë, nga vise të ndryshme të Evropës, me shenjën e kryqit në sup, çastisnin për të luftuar edhe në krah të Skënderbeut. Një gjë e tillë është përshkruan mëse një herë edhe nga Barleti³⁴⁴. Përgjithësisht pranohet se dështimi apo mosrealizimi i “Kryqëzatës së Përgjithshme” në kohën e Kalistit III i detyrohet më fort përçarjes së princërve të krishterë, se atyre çfarë vareshin drejtpërsëdrejti nga papa: projektim, predikim, organizim, mbledhje ndihmash e deri në kërcënime e ndëshkime.

Pozicioni i Skënderbeut në politikën evropiane do të mbërrinte pikën e vet kulmore gjatë periudhës së papnimit të Enea Silv Piccolominit në emrin e Piut II (1458-1464). Papa Piu II, i cili pas vdekjes së Kalistit III, përfaqësonte një nga figurat më të spikatura të humanizmit evropian të kohës³⁴⁵, por projekti i kryqëzatës antiturke nuk mund të mbështetej vetëm mbi “Atin e Shenjtë” dhe mbi forcat e Selisë Apostullore: fitorja mbi turqit nuk mund të ishte vepër e kësaj apo asaj mbretërie, por kërkonte përpjekjen e përbashkët të të gjithë krishtërimin³⁴⁶. Vëmendja që tregonte Piu II ndaj Arbërisë lidhej me rëndësinë që i kushtonte asaj si front i dorës së parë për kryqëzatën, por edhe personalisht Gjergj Kastriotit si njëri ndër

³⁴² *Burime të zgjedhura për Historinë e Shqipërisë, II* përgj. A. Buda, I. Zamputi, K. Frashëri, P. Peppo. Tiranë, 1962, f. 223.

³⁴³ Po aty, f. 224.

³⁴⁴ Aleks Buda. *Fan. S. Noli historian i Skënderbeut*. Shkrime Historike I, f. 33.

³⁴⁵ *Skënderbeu një histori...* vep. e cit., f. 554.

³⁴⁶ Po aty.

komandantët më potencialë të saj. Deri në atë shkallë është llogaritur kjo rëndësi që i kushtonte Piu II Skënderbeut sa historianët mëtojnë që ai iu dërgonte vit për vit hungarezëve 100 mijë skude arid dhe po aq edhe arbërve të Skënderbeut³⁴⁷, ndonëse prej regjistrave apostullore të kohës së papnimit të Piut II nuk janë nxjerrë të dhëna dërgesah të rëndësishme në të holla për Gjergj Kastriotin. Tregues i interesit të Piut II për Arbërinë, posaçërisht për qëndresën dhe luftërat e Gjergj Kastriotit, duhet llogaritur edhe një akt i marsit të vitit 1459, emërimi “kryepeshkop i zgjedhur i Durrësit”, nëpërmjet një *bulle* nga Siena, i abatit të manastirit benediktin të Shën Gjonit të Sivalit në dioqezën e Drishtit, Pal Engjëlli³⁴⁸. Mund të hamendësohet, që prej këtij çasti, Pal Engjëlli të ketë luajtur pranë Skënderbeut dhe pranë zotërve të tjerë arbër, ndonjë rol politik. Mirëpo në bregun e Ankonës, në pritje të grumbullimit të të gjitha forcave të premtuara (megjithëse nuk po mbërrinin), natën e 14 gushtit duke gdhirë 15-ta, Piu II do të vdiste. Se si mund të jetë pritur në kampin e Skënderbeut lajmi i vdekjes së papës në Ankonë dhe dështimi i kryqëzatës aq vështirësisht të ngritur në këmbë, kjo nuk është e dokumentuar. Për Skënderbeun dhe Arbërinë, me asnjë tjetër papë kryqëzata ose iluzioni i saj, nuk kishte qenë aq pranë. Mirëpo ka mendime se papa nuk kishte dashur të kuptonte se pasioni i një njeriu edhe papë të ishte nuk mund të bënte asgjë kundër përlllogaritjes së ftohtë politike dhe se në mesin e shek.XV ishte e kotë të shpresoje se popujt të ngriheshin në këmbë të shtyrë nga arsye thjesht ideale. “*Duke e vendosur çështjen e luftës kundër islamit në rrafsh kryesisht fetar, Piu II e kishte dënuar çështjen më dështim qysh në lindje të saj. Duke e zhvendosur problemin nga fusha fetare në atë politike do të ishte dashur të shfaqej jo si Bariu, por si qeveritari i mençur që u dëfton syve të verbër se ku është udha e humbjes dhe ku ajo e shpëtimit*”³⁴⁹. Pas vdekjes së Piut II, papa pauses do të jetë Pali II, i cili si individ ndryshe nga papët e tjerë paraardhës nuk është shquar për ndonjë mbështetje të madhe ndaj Skënderbeut. Arsyet janë të ndryshme, si politiko - ekonomike, ushtarake dhe diplomatike. Vizita e fundit e Skënderbeut në kurjen romake sipas dëshmimeve na paraqitet shumë modeste, pamja e tij “si një

³⁴⁷ Po aty, f. 555.

³⁴⁸ *Skënderbeu një histori...* vep. e cit., f. 563.

³⁴⁹ Cutolo, A., *Scanderbeg*. Milano, 1940, f. 170 -171.

burrë shumë i moshuar, kaluar të 60-at, i ardhur me pak kalorës dhe si njeri i varfër".³⁵⁰ Nuk mund të përfytyrohet veçse tronditëse skena e ballafaqimit të tij dhe e shoqëruesve të tij të "paktë" me kardinalët në purpur, me bujën e tyre, me shkëlqimin dhe vezullimin e tyre dhe të familjeve të tyre. Ishte ky figurativisht ballafaqimi mes realitetit të gjendjes së Arbërisë të mbërritur në ekstrem të travajeve të veta dhe realiteti që mbretëronte në oborret evropiane, e mbështetur në dokument: "*Pikërisht dje mbërriti Skënderbeu, të cilit Shënjtëria e Tij urdhëroi t'i bëhet një nderim i madh, duke dërguar që t'i delnin përpara familjet e kardinalëve, atë të Shtëpisë së tij, të shumë klerikëve të tjerë, si dhe mjaft oborrtarë*"³⁵¹. Pamja e Skënderbeut, e përshkruar si një burrë i varfër që i kishte kaluar të 60-at, që përshkruhet në dokumentet e asaj kohe me siguri që nuk ka qenë shumë shpresëdhënëse për kardinalët, që sipas atyre me ato që kishin dëgjuar, me siguri prisnin që të shihnin një kalorës të fuqishëm që do të marshonte në mënyrë solemne. Faktikisht vdekja e Skënderbeut një vit më vonë, i përlligji veprimet e palëve kundërshtuese në politikat vendimmarrëse sidomos të çështjes delikate të financave. Megjithatë, parë realisht, është Selia e Shenjtë ajo që mbështeti me shumë forcë financiarisht Gjergj Kastriotin Skënderbeun ndoshta më shumë se çdo pushtet tjetër i asaj kohe.

Skanderbeg's relationships with the Vatican (1444-1467)

ABSTRACT

There have been done different evaluations on the international relations of the Skanderbeg's State. Skanderbeg has been in good relations with most European countries and especially Italians and Hungarians, mostly inspired by the character of the Crusader War.

In XV century the medieval world around the Mediterranean basin was culturally, politically and religiously divided into two large camps: the

³⁵⁰ *Burime të zgjedhura...* vep. e cit., f. 239.

³⁵¹ *Skënderbeu një hist...* vep. e cit., f. 702.

one called the Muslim and the other one called the Christian. At that period there were Princes and Christian people, converted to vassals of the Turks who fought alongside them, but there were also some princes and Muslim people contradicting the Turks, who did the alliance with the Christians. The relationship of Skanderbeg with the Holy See was the same kind of relationship which was built mainly on mutual interest. Skanderbeg's position in European politics would reach its peak during the papacy of Pope Pius II (1458-1464). Piu II's interest in Arbëria was related to the importance of devoting it to the crusade's first front, but also to Gjergj Kastrioti himself as one of its most potential commanders. That is why the Holy See was the one that financially supported Gjergj Kastrioti - Skanderbeg, perhaps more than any other power of that time.

Ilda ERKOÇI

SHQIPTARËT NË SYTË E UDHËTARËVE BRITANIKË TË SHEKULLIT XIX

Ky artikull synon të japë një panoramë të shkurtër të Shqipërisë së parë nga udhëtarët britanikë të shekullit XIX. Metodologjia e përdorur do të jetë ajo e deduksionit përmes krahasimit të motiveve të natyrës etnografike që shfaqen në një sërë shkrimesh udhëtimit të kësaj periudhe për të parë ngjashmëritë, me një theks të veçantë tek stereotipet perëndimore. Megjithëse punimi ka kryesisht karakter përshkruues – si i përshkruajnë udhëtarët britanikë shqiptarët nga pikëpamja fizike, karakteri dhe mënyra e jetesës - baza kryesore teorike mbi të cilën është punuar është *Orientalizmi* (1978) i Edward Said. Koncepti i Orientalizmit ka të bëjë me vënien në dukje të dallimeve mes Lindjes e Perëndimit me theks të veçantë në epërsinë e së dytës dhe përdorimin e klisheve të gatshme në perceptimin e Lindjes. Lindorët përshkruhen si primitivë, të paarsyeshëm, të dhunshëm, despotë e fanatikë e për rrjedhojë, inferiorë ndaj perëndimorëve. Në librin e tij kritik që vazhdon të jetë edhe sot një nga shtyllat teorike kryesore për të kuptuar qëndrimet perëndimore ndaj Lindjes, Said shkruante se “*Ndikimi gjithnjë e më i madh i letërsisë së udhëtimit, utopive imagjinare, udhëtimeve morale dhe raportimeve shkencore sollën Orientin në fokus ku Evropa ishte në qendër dhe kishte rolin e privilegjuar të vëzhgueses. Sa më tej zhvendosej, aq më shumë forcohej besimi i saj se ishte një fuqi kulturore... dhe kështu u krijuan këndvështrimet etnocentrike*”³⁵²

Një tjetër studiuese e cila ka shkruar rreth qëndrimeve superiore perëndimore jo thjesht ndaj Lindjes, por Ballkanit në veçanti, është Maria Todorova. Në analogji me Orientalizmin e Saidit, ajo krijon termin Ballkanizëm, një koncept që i referohet stereotipeve që ekzistojnë rreth Ballkanit. Në librin e saj *Imagining the Balkans* (1997), Todorova shprehet se imazhi i gabuar Ballkanit është krijuar në vite nga një numër “vëzhguesish” perëndimorë që variojnë nga politikanët, shkrimtarët e deri te udhëtarët e thjeshtë: “*Si mund*”, pyet ajo, “*të shpjegohet vazhdimësia e një imazhi të tillë të ngrirë? Si është e mundur që një rajon i thjeshtë gjeografik të shndërrohet në një prej përcaktimeve më negative në histori, marrëdhënie ndërkombëtare shkenca politike e diskurse intelektuale deri në*

³⁵² Edward Said, *Orientalism*, f. 117.

*ditët e sotme?*³⁵³

Të dy këta libra kritikë përbëjnë kornizën bazë të këtij punimi për të kuptuar rolin e shkrimtarëve britanikë të udhëtimit në Ballkan dhe ndikimin e tyre në krijimin e imazhit të Ballkanit.

Drejt Ballkanit!

Po të mendosh hapësirën gjeografike e popullsinë e një vendi të vogël si Shqipëria është e habitshme të zbulosh sa shumë është shkruar për të! Mesa duket, izolimi i gjatë ka bërë që të nxitet edhe më shumë kureshtje. Kjo kureshtje duket se i ka rrënjët në shkrimet e udhëtimit të shekullit XVIII, pasqyrë e interesit të britanikëve për Lindjen e Afërt. Përpara kësaj periudhe burimi i vetëm i “informacionit” për këtë rajon ishte përkthimi frëngjisht i *Njëmijë e një net*.³⁵⁴ Pikërisht ky libër ishte shpesh motivi që nxiste udhëtimin në këtë zonë.

Një arsye më praktike ishte shtimi i udhëtimit në pjesë të tjera të botës që erdhi si rrjedhojë e zgjerimit të Perandorisë Britanike si dhe ndryshimi i itinerarit fillestar të *Grand Tour*-it. Shtresat e mesme tashmë të pasuruara filluan të udhëtonin jashtë vendit. Një pjesë e tyre kishin interes për pasurinë arkeologjike të zonës, dhe kjo gjë bëri që mjaft anglezë të përfshinin në itinerarin e tyre të *Grand Tour*-it edhe vende, si: Greqia, Egjipti dhe Azia e Vogël. Një tjetër arsye ishin edhe luftërat kontinentale në gjysmën e dytë të shekullit XVIII, sidomos me Francën e Rusinë si dhe luftërat e Napoleonit në fillim të shekullit XIX që mbyllën dyert e Evropës perëndimore për turistët. Po kështu, Lindja e Afërt ishte një territor strategjik prej ku shtriheshin rrugët për në Indi.³⁵⁵

Udhëtarët britanikë kishin shkelur në tokat shqiptare që herët, por shkrimet e tyre të para dokumentohen në shekullin XVII. Sipas R.Elsie, ishte Edward Brown i pari që në vitin 1669 shkroi për udhëtimin e tij në Shkup e Kosovë.³⁵⁶ Por, shekulli XIX është veçanërisht i rëndësishëm, pasi për herë të parë solli një numër të madh udhëtarësh britanikë (mes të cilëve edhe shumë gra) në Ballkan e Shqipëri që u shoqërua edhe me një numër të madh shkrimesh. Po kështu, kanë rëndësi, pasi sollën një element të ri, këndvështrimin politik, sidomos në gjysmën e dytë të shek. XIX. Nëse më

³⁵³ Todorova, f. 3.

³⁵⁴ Thomas Shaw. *Travels or Observations Relating Several Parts of Barbary and the Levant*, f. 261.

³⁵⁵ Wallace Cable Brown. “The Popularity of Travel Books about the Near East, 1775-1825”. *Philological Quarterly*. Jan 1, 1936, f.70.

³⁵⁶ Robert Elsie. *Texts and documents of Albanian History*. “Albanian History 1000-1799”.

parë udhëtarët mjaftoheshin me përsëkrim, tashmë është pothuajse e pamundur të mos mbajnë qëndrim. Një pjesë e mirë e tyre bëhen mbrojtës të kauzave të ndryshme kombëtare në Ballkan.

Studiuesi Brown vëren se “*deri në 1815 edhe për një vend deri atëherë të padëgjuar si Shqipëria, ishte shkruar gjerësisht në librat e Hobhauzit dhe Hollandit, libra që njiheshin mjaft mirë*”, siç do pohohej edhe në revistën *Edinburgh Review*: “*Vetëm pak vite më parë, zoti Gibon mund të thoshte se vendi që është qendra e këtyre udhëtimeve njihet nga bota e qytetëruar po aq sa zonat e pashkelura të Amerikës Veriore. Tashmë kjo nuk vlen.*”³⁵⁷

Prapëseprapë, në krahasim me banorët e tjerë të rajonit, shqiptarët mbeteshin më pak të njohur edhe në vitin 1848 kur James Henry Skene, udhëtar e diplomat skocez do të shkruante: “*Turqit dhe grekët kanë qenë shpesh subjekt i shkrimeve të udhëtimit dhe spekulimeve politike, ndaj tiparet e tyre njihen mirë në Evropën perëndimore. Shqiptarët kanë tërhequr më pak vëmendje, dhe kur janë konsideruar si komb, ose janë keqinterpretuar ose janë ngatërruar me banorë të tjerë të Turqisë evropiane. Shqiptarët muhamedanë janë identifikuar me osmanllinjë e të krishterët me grekët, ndërsa karakteri i ashpër i ndonjë prej fiseve të tyre i është mveshur të gjithë kombit.*”³⁵⁸ Me një gjuhë tipike orientaliste, një mendim i ngjashëm shprehet edhe nga Lady Blunt (Fanny Janet Blunt), në vitin 1878: “*Shqiptarët, si pjesa më e madhe e racave të parëndësishme që banojnë në Turqinë evropiane, njihen pak nga bota e qytetëruar.*”³⁵⁹

Po kush ishin këta udhëtarë?

Ata vinin kryesisht nga shtresat e larta të cilat mund të përballonin koston e udhëtimit. Për rrjedhojë, mund të thuhet se letërsia e udhëtimit e kësaj periudhe u krijua nga një kategori udhëtarësh të shkolluar e me bindje të caktuara politike. Ra në sy një numër i konsiderueshëm udhëtarësh femra në moshë mesatare. Sipas të dhënave, asnjë rajon tjetër nuk kishte tërhequr më shumë udhëtare femra se Ballkani. Mes tyre gjendeshin emigrante, infermiere, misionare, eksploruese si dhe shkrimtare udhëtimi. Sipas Bërket, “*gratë në shekuj kanë kërkuar të udhëtojnë për t’u larguar nga shoqëria ku ishin rritur e cila nuk i lejonte të bënin çfarë donin. Larg presionit të familjes dhe roleve shoqërore të paracaktuara, ato shpesh gjenin lirinë e munguar. Në shkretëtirë, në male a në pyje tropikale, një grua mund të linte pas zakonet e shoqërisë nga vinte e të ishte vetvetja. Për*

³⁵⁷ *Edinburgh Review*, tetor 1815, xxx, 455, cituar sipas Brown, f. 77.

³⁵⁸ James Henry Skene. “*The Albanians*”. *Edinburgh New Philosophical Journal*, f. 307.

³⁵⁹ Lady Blunt. *The People of Turkey*: ... f. 62.

gra që kishin ndenjur në një qoshe të salloneve viktoriane, pa u vënë re, thjesht duke u kujdesur për të afërm të sëmurë, duke u marrë me qëndisje a duke shkuar në festa çaji, kjo liri e gjetur jashtë vendit ishte dehëse."³⁶⁰

Çfarë i tërhiqte udhëtarët britanikë drejt Shqipërisë?

Mënyra e jetesës e shqiptarëve, që shumë prej udhëtarëve e përshkruajnë si mesjetare dhe shprehen se i kujton të shkuarën, dukej se përbënte një burim interesi për ta. Shqipëria u bë një destinacion i preferuar për mjaft britanikë që e shihnin atë si një vend romantik e ekzotik në të njëjtën kohë. Bajroni kishte pjesën e vet në këtë drejtim. Ai ishte i pari që hapi rrugën dhe deri diku përcaktoi itinerarin për t'u përshkuar si dhe pritshmëritë e udhëtarëve që do e ndiqnin.

Karakteri i shqiptarëve ishte një tjetër motiv që nxiste kureshtjen e britanikëve. Siç shprehen vetë udhëtarët, shqiptarët i kujtonin skocezët dhe e njëjta gjë vlente edhe për natyrën, sidomos malet shqiptare që jo rrallë janë krahasuar me malësitë skoceze. Edwin Pears bën këtë përshkrim: "*Si Toskët, edhe gegët të kujtojnë fiset malësore skoceze të dy shekujve më parë*".³⁶¹ Më herët, një fakt i tillë ishte vënë në dukje edhe nga David Urquhart: "*Ka një ngjashmëri të habitshme mes malësorëve shqiptarë e skocezë. Krerët e fiseve, si keltët dalin me flokët bisht, pistoletë nga njëra anë e shpatë nga tjetra si dhe mushqetë mbi supe*".³⁶²

Tiparet e shkrimeve të udhëtarëve britanikë për shqiptarët

Udhëtarët britanikë vunë re dhe shkruan për një sërë motivesh etnografike që lidheshin me shqiptarët. Mirëpo, shpeshherë, më tepër se vëzhgime objektive, këto shkrime janë thjesht pasqyrë e stereotipeve të kohës, sidomos të natyrës orientaliste. Shqiptarët, si lindorët e tjerë, shihen si inferiorë e primitivë. Për shembull, për Lady Blunt, karakteri i shqiptarëve ishte thjesht "*karakteri i pagdhundur i një populli barbar; ata kanë veset e një populli të pacivilizuar*".³⁶³

H. N. Brailsford mbështet mendimin e saj duke shtuar se "*asnjë racë në Turqinë evropiane nuk gëzonte reputacion më të palakmueshëm se shqiptarët*" dhe se "*shqiptari është një evropian mesjetar*".³⁶⁴ Ironia

³⁶⁰ DeaBirkett, *Women and Travel*. f. 4.

³⁶¹ Sir Edwin Pears. *Turkey and Its People*. London: Methuen & Co., 1911, f. 168.

³⁶² David Urquhart. *The Spirit of the East: Illustrated in a Journal of Travels Through Roumelia During an Eventful Period*, in Volume I. London: Henry Colburn, 1838, f. 270.

³⁶³ Blunt, f. 85.

³⁶⁴ H.N. Brailsford. *Macedonia: Its Races and Their future*. London: Methuen & Co., 1906, f. 221, 235.

vazhdon në komentin e Pears sipas të cilit, të paktën “shqiptari është një barbar i ndershëm”, ku shton se “Ai është i ndjeshëm, njeh nderin dhe ka respekt për veten. Nuk është frikacak dhe as i lig. Më parë bëhet kusar se lypsar.”³⁶⁵

Mendime kundërshtuese ka edhe George Finlay që i sheh shqiptarët si “krenarë, të pafytyrë, gjaknxehtë përfitues”, por, ndryshe nga grekët, ata janë “të ndershëm e të singertë.”³⁶⁶

Sa i takon pamjes fizike, Lady Blunt i përshkruan kështu shqiptarët e shekullit XIX: “Burrat kanë kraharor të gjerë, janë të gjatë e të fuqishëm e kanë tipare të rregullta. [...]ata janë krenarë, burrërorë e të pavarur.”³⁶⁷ H.A. Brown, pas një dimri të kaluar në Shqipëri, shprehet se shqiptarët janë “shtatlartë, bëjnë jetë të thjeshtë, por aktive. Mes malësorëve, rrallë sheh njerëz të çalë, të shëndoshë ose të kërrusur.”³⁶⁸ Charles Eliot thotë se “burrat e kësaj race kanë përgjithësisht flokë të verdhë, kanë kokë të madhe e janë të gjatë.”³⁶⁹

Pika e vetme për të cilën duket se bien dakord dhe flasin vetëm mirë si udhëtarët meshkuj edhe ato femra janë pikërisht gratë shqiptare. Kështu, sipas Blunt, “gratë shqiptare janë të gjalla dhe me shpirt të pavarur, por të pashkolluara ... Sidoqoftë, ato janë krenare e plot dinjitet”³⁷⁰. Ajo shton se “bukuria e tyre venitet me t’u martuar.”³⁷¹ Për Knight, këto gra janë “më të bukurat në Evropën Lindore. Fëmijët janë të mrekullueshëm me sy të mëdhenj e gojë të bukur që u jep një pamje të ëmbël e të mendueshme. Nuk mund të jesh mes shqiptarëve e të mos kuptosh se je mes një racë të lashtë e fisnike, me të cilën malazezët e racat e tjera sllave as që mund të krahasohen ... Gratë e këtij vendi nuk rrudhosen me të mbushur 30 vjeç siç ndodh me gratë e tjera lindore e jugore, por e ruajnë ngjyrën rozë dhe bukurinë rinore si gratë e ishullit tonë.”³⁷²

Disa nga këta udhëtarë bëjnë edhe përshkrime të gegëve e toskëve. Lady Blunt vëren se “toskët janë të gjatë dhe të fortë, të shkathët në lëvizje, me tiparet të rregullta dhe të zgjuar, por si pjesa më e madhe e shqiptarëve kanë çehre të egër, mizore e nganjëherë dinake dhe një krekosje në të ecur...

³⁶⁵ Pears, f. 175.

³⁶⁶ George Finlay. *History of the Greek Revolution*, Volume 1., Edinburgh & London: William Blackwood and Sons, 1861, f. 39.

³⁶⁷ Blunt, f. 69.

³⁶⁸ H.A. Brown, *A Winter in Albania*. f. 62.

³⁶⁹ Sir Charles Norton Edgcumbe Eliot. *Turkey In Europe*, f. 350.

³⁷⁰ Blunt, f. 83.

³⁷¹ Po aty, f. 70.

³⁷² Knight, *Albania*, f. 128-129.

*Janë gati për luftë ... dhe një burim i vazhdueshëm frike për të huajt ...*³⁷³
 Edhe për Mekënzi e Erbi, toskët janë “shumë të ndryshëm nga gegët, një pjesë e të cilëve janë helenizuar dhe shfaqin tipare greke si në fizik, ashtu edhe në karakter. Arnautët (Gegët), nga ana tjetër, janë tipa të fortë e të vështirë ... megjithëse më hijerëndë se toskët, janë gjithashtu më kokëfortë dhe myslimanët më të pabindur ndaj ligjit në Turqi.”³⁷⁴ Arthur Evans gjithashtu mendon se toskët janë më superiorë “falë përzierjes me grekë, e bile në disa zona gjen atë bukuri greke që s’gjendet më tjetërkund. E njëjta gjë vlen edhe për intelektin e tyre.”³⁷⁵

Por edhe zakonet e shqiptarëve nuk i shpëtojnë syrit të udhëtarëve britanikë të cilët duket se kanë ardhur me qëllim të “gjuajnë” çdo tipar që mbron tezat e tyre të gatshme rreth një populli tipik lindor në mentalitet e mënyrë jetese, një provë më shumë se kanë të drejtë t’i quajnë “ekzotikë”. Kështu, gjakmarrja e burrneshat, si dhe supersticionet e ndryshme janë tema që gjenden në mjaft shkrime udhëtimi.³⁷⁶

PËRFUNDIME

Ky artikull ofroi një panoramë të shkurtër të Shqipërisë të parë nga disa udhëtarë britanikë të shekullit XIX. Megjithëse shkrimet e tyre përshkohen jo rrallë nga pasaktësi e plot klishe, gjithsesi, mund të shihen si një burim i mirë informacioni që i dha një goditje miteve të mëparshme të tipit “Oh, unë i njoh shqiptarët. Janë ata njerëzit qesharakë me sy rozë e flokë të bardhë.”³⁷⁷

Mirëpo, përshkrimet etnografike që vënë theksin në fjalë si “i egër”, “barbar”, “mizor”, “dinak”, “gati për luftë”, “burim i vazhdueshëm frike” nuk bëjnë gjë tjetër veçse i mëshojnë stereotipeve të mëparshme. Britanikët duket se e kanë të pamundur t’i shohin ballkanasit e shqiptarët jashtë kornizës së “tjetrit” e inferior në raport me veten. Përkufizimi i tyre si “ekzotikë” në paraqitje e zakone i ndihmon të krijojnë distancën e nevojshme mes qytetërimit të përparuar perëndimor e atij të prapambetur lindor. Sidoqoftë, udhëtarët britanikë të shekullit XIX, në rolin e vetëshpallur të Kolombit, kanë meritën se zgjuan kureshtje për vendin

³⁷³ Blunt, f.70.

³⁷⁴ G. Muir Mackenzie dhe A.P. Irby. *Travels in the Slavonic Provinces of Turkey-In Europe*, f. 469.

³⁷⁵ Arthur J. Evans, *Illyrian Letters...* f. 138.

³⁷⁶ Shih Tozer, Blunt, Garnet, etj

³⁷⁷ Përmendur nga Durham në *The Burden of the Balkans*. London: Thomas Nelson & Sons, 1905, f. 229.

tonë e banorët e saj si dhe shtruan pyetje me interes siç tregon edhe fragmenti i mëposhtëm, gati profetik:

*Shqipëria është kaq afër e njëkohësisht kaq e panjohur. Edhe sa kohë do duhet që Evropa ta kuptojë? Brenda pak vitesh, turistët do dynden atje ... a do ta dëmtojë kjo gjë? A do shkërmoqet jeta e pastër lindore nga dallga e qytetërimit perëndimor? Vetëm koha do e tregojë.*³⁷⁸

REFERENCA:

- Blunt, Lady (Mrs. John E. Blunt), ed. S. Poole. *The People of Turkey: Twenty Years' Residence among Bulgarians, Greeks, Albanians, Turks, and Armenians, By a Consul's Daughter and Wife*, Volume I. London: John Murray, 1878, f. 62-87.
- Brailsford, H.N. *Macedonia: Its Races and Their future*. London: Methuen & Co., 1906.
- Brown, H.A. *A Winter in Albania* (London: Griffith, Farran, Okeden, & Welsh, 1888.
- Brown, Wallace C. "The Popularity of Travel Books about the Near East, 1775-1825". *Philological Quarterly*. Jan 1, 1936.
- Eliot, Charles. *Turkey in Europe*. London: Edward Arnold, 1908.
- Elsie, Robert. Texts and documents of Albanian History. "Albanian History 1000-1799". <http://www.albanianhistory.net/texts1800-1899.html>
- Evans, Arthur J. *Illyrian Letters: A Revised Selection of Correspondence from the Illyrian Provinces of Bosnia, Herzegovina, Montenegro, Albania, Dalmatia, Croatia, and Slavonia, Addressed to the Manchester Guardian During the Year 1877* London: Longmans, Green & Co., 1878, Letter XIII, f. 31-42.
- Finlay, George. *History of the Greek Revolution*, Volume 1 (Edinburgh & London: William Blackwood and Sons, 1861, f. 36-64.
- Knight, E.F. *Albania: a Narrative of Recent Travel*. London: Sampson Low, Marston, Searle & Rivington, 1880.
- Mackenzie, G. Muir dhe A.P. Irby, *Travels in the Slavonic Provinces of Turkey-In-Europe* London: Daldy, Isbister, & Co., 1877.
- Pears, Edwin. *Turkey and Its People*. London: Methuen & Co., 1911.
- Said, Edward. *Orientalism*. New York; Vintage Books, 1994.
- Shaw, Thomas. *Travels or Observations Relating Several Parts of Barbary and the Levant*, London, 1738.
- Todorova, Maria. *Imagining the Balkans*. New York: Oxford University Press, 1997.
- Trevor, Roy. *My Balkan Tour, An Account of Some Journeyings and Adventures in the Near East with a Descriptive and Historical Account of Bosnia & Herzegovina, Dalmatia, Croatia, and the Kingdom of Montenegro*. London: John Lane, 1911.
- Urquhart, David. *The Spirit of the East: Illustrated in a Journal of Travels through Roumelia During an Eventful Period*, Volume I. London: Henry Colburn, 1838.

³⁷⁸ Trevor, *My Balkan Tour*, 447.

Albanians in the image of 19th century British travellers***ABSTRACT***

This paper provides an overview of the image of Albanians in the writings of a few 19th century British travellers. The reasons for going to the Balkans in this specific period and the stereotypes they had about Balkan people in general and Albanians in particular are at focus. The methodology used is that of deduction through comparison of similar features appearing in various writings of the same time.

Ingrit TIRANA

NDIKIMI I ROVLUCIONIT DIXHITAL NË GJUHËN E TË RINJVE

Tundimi për të përdorur fjalë të huaja në vend të shqipes është i madh. Jemi të ekspozuar gjithandej nga terma të huaj, interferenca gjuhësore, terma teknologjike, si dhe përdorimi në mënyrë masive i rrjeteve sociale po ndikon drejtpërsëdrejti në gjuhën që përdorim. Të shkruash në epokën dixhitale kërkon përgjegjësi nga ata që shkruajnë dhe në të njëjtën kohë sjell lexuesin më afër, në çdo kohë. Mirëpo, çështja qëndron se sa të vetëdijshëm janë ata që shkruajnë për përdorimin e drejtë të gjuhës. A duhet të jemi të hapur ndaj fenomeneve gjuhësore e të pranojmë sa më shumë terma që po thyejnë traditat e rregullimit gjuhësor?

Rrjetet sociale gjithnjë e më shumë po dominojnë kohën dhe jetën tonë ashtu si asnjë formë tjetër e revolucionit teknologjik të realizuar ndër vite. Gjuha dhe format e të shprehurit, me të cilat të rinjtë komunikojnë në rrjetet sociale, janë krejtësisht jashtë të folurit apo të shkruarit të shqipes standarde dhe kjo i dëmton ata. Kjo gjë jo vetëm në vendin tonë por edhe në vendet e tjera. Gjuha angleze po dominon në këtë aspekt pothuajse pjesën më të madhe të prurjes leksikore dhe ndërtimin e fjalëve të reja. Sidomos në gjuhën italiane (shembuj që do t'i shohim në vijim), shohim që neologjizmat apo huazimet nga fusha e teknologjisë dhe jo vetëm, janë kthyer në modë dhe po vërshojnë vrullshëm në gjuhën gazetareske, në media, në blogje apo portale të ndryshme, si dhe në zhargonin e të rinjve në rrjete sociale, si: Instagram, Twitter apo Facebook. Kjo gjë vlen edhe për shqipen natyrisht.

Në këtë punim kemi për qëllim të vëzhgojmë ndikimin e epokës dixhitale mbi gjuhën, efektin që sjellin rrjetet sociale në të shkruar si dhe disa raste të neologjizmave dhe teknologjizmave në gjuhën italiane, ndikuar nga anglishtja. Si korpus studimi, u jemi referuar disa përdoruesve të rinj, studentët, të cilët përbëjnë pjesën më aktive në rrjetet sociale. Kjo ka bërë të mundur të vrojtojmë në pergjithësi gjuhën që ata përdorin, zhargonin e tyre dhe disa forma të të shprehurit.

- *Lind pyetja: A duhen shmangur huazimet? Sot jemi të ekspozuar ndaj termave të rinj, aq të dëgjuar dhe njëkohësisht të përdorur çdo ditë, të cilët pasqyrojnë konceptin e botës virtuale dhe mënyrën e të shprehurit.*

Zhvillimi teknologjik, ndikimi i mediave të ndryshme elektronike, nevoja për koncepte të reja, janë disa nga arsyet e huazimeve leksikore sidomos në shqip. Debati kryesor mbetet mes atyre që përkrahin mendimin që të huazojnë fjalët duke përshtatur shqiptimin e tyre, pasi pretendojnë që këto fjalë nuk e kanë ekuivalentin e tyre dhe do të ishte më mirë që fjala të përshtatej dhe pjesa tjetër i përket një kategorie që janë kundër, ndryshe të quajtur *puristet*. Ata pretendojnë se më mirë do të ishte të formojmë fjalë të reja, duke e konsideruar gjuhën si një mundësi të pafund për të formuar fjalë të reja. Imagjinojmë dyndjen e këtyre fjalëve si pasojë e zhvillimit teknologjik si për shembull *gugëlloj* ndryshe do të shpreheshim: *kërkoj nëpërmjet motorit të kërkimit "Google"*. Tendenca për të përdorur të parën është më e madhe.

Faktorët kryesorë të pranisë së huazimeve janë: *së pari* ai gjeografik, nga ndikimi i vendeve të huaja, afërsia me vendet e tjera dhe *së dyti* përhapja e termave shkencore, teknike dhe fjalëve të reja. Sipas fjalorit të gjuhës shqipe huazimi përkufizohet si: *"Fjalë a njësi tjetër gjuhësore që është marrë prej një gjuhe tjetër dhe përdoret në gjuhën amtare"*³⁷⁹.

Kjo dukuri është e pashmangshme. Skendaj shprehet se *"Huazimi është një dukuri e pashmangshme e shqipes moderne apo e çdo gjuhe në përgjithësi. Gjuha - trajton Skendaj - në përgjithësi në formen e saj të qenies njej dhe pranon si rregulla shabllone, sisteme, nënsisteme, struktura, nënstruktura të pacënueshme, por edhe një farë ndryshueshmërie të aspekteve, anëve të saj"*.³⁸⁰ Kjo do të thotë që dukuria e pashmangshme ndodh si pasojë e globalizimit dhe që sot në epokën dixhitale, nuk mund t'i shmangemi këtyre sistemeve. Por kur bëhet fjalë për shmangie, shkelje të gjuhës standarde shqipe kemi plot, sidomos duke lejuar përdorimin masiv të fjalëve me prejardhje nga gjuhë të tjera, sidomos nga anglishtja.

Objekt i shmangieve nga normat gjuhësore, në rastin tonë, është gjuha e rrjeteve sociale dhe neologjizmat teknologjike, si dukuri tashmë të përquafuara dhe të domosdoshme, që po dominojnë dhe që janë faktorët kryesorë për krijimin e neologjizmave.

Le të sjellim një shembull, që kohëve të fundit ka të bëjë me një *mësuese e cila kishte dëgjuar një fjalë nga nxënësi i saj "petaloso" (me shumë petale). Ngaqë nuk ishte e sigurt për ekzistencën e fjalës, vendosi të konsultojë fjalorin dhe vërtetoi që kjo fjalë nuk gjendej asgjëkund.*

³⁷⁹ Fjalor i gjuhës shqipe, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Tiranë, 2006.

³⁸⁰ Skendaj, A., *Huazimi si një dukuri e pashmangshme e shqipes moderne*- Akte të Seminarit të 3-të: "Rreth huazimeve në shqipen standarde", U. T. Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Pegi, 2004, f. 129 – 135.

Ajo vendosi t'u shkruante, për këtë rast, gjuhëtarëve të akademisë italiane "La Crusca", në Firence dhe u kërkoi ndihmë se çfarë shpjegimi mund t'i jepte djalit, pasi fjala ishte vërtet me kuptim dhe e ndërtuar mirë. Menjëherë specialistët e gjuhës e morën rastin në shqyrtim dhe vendosën që fjala më e re e shpikur nga një djalosh 12 vjeçar, të bëhej pjesë e fjalorëve. Në fund ajo mori dhe falënderim nga ana e tyre me motivin që, gjuhëtarët në përgjithësi, janë aq të vëmendshëm se çfarë po ndodh me prurjet e reja nga bota dixhitale, nga të cilat disa kanë një kohëzgjatje të shkurtër, saqë harrohet që këto fjalë qënkërkan me të vërtetë të thjeshta e aq domethënëse për t'i kushtuar rëndësi.³⁸¹

Kësisoj termash kanë tërhequr vëmendjen e vetë gjuhëtarëve të akademisë "La Crusca", saqë shpesh botojnë volume të ndryshme, duke këshilluar lexuesin për "përdorimet e sakta të fjalëve".³⁸²

Zakonisht në rrjetet sociale shkruhet ashtu siç flitet. Mes gjuhës së folur dhe gjuhës së shkruar ka lindur një regjistër i tretë gjuhësor. René Decartes i njohur si (Cartesio), në shprehjen e tij të famshme "*Cogito, ergo sum*" – mendoj, pra ekzistoj, është kthyer në "*Digito, ergo sum*" me idenë se ekzistoj nëse jam i lidhur me botën jashtë, pra me internet.

Sigurisht që komunikimi në linjë është një formë e re e shkëmbimit të informacioneve, ndjesive, madje dhe mënyrë të të shprehurit dhe jetese, i cili shihet si një sferë e madhe gjigande mesazhesh verbale dhe joverbale, kodesh dhe sinjalesh, që transmetohen në mënyra të ndryshme. Kjo gjuhë e përdorur po rritet me hapa galopante duke ndryshuar shumë shpejt dhe njëkohësisht po huazon fjalë dhe terma të huaj, të cilët shumë shpejt bëhen pjesë e përditshmërisë sonë, madje duke zëvendësuar edhe ato terma të cilët e kanë ekuivalentin e tyre.³⁸³ Këtu kemi të bëjmë, jo më me një fenomen të tkurrjes së fjalëve apo përdorimit të tyre si kode për të rinjtë, por bëhet fjalë për një çështje gjuhësore. Vëme re që shpesh po rikthehen zakonet e vjetra siç është rasti i përdorimit të shkronjës "k". Në dokumentet e para të gjuhës italiane, "*Il Placito Cassinese*" të vitit 960 p.k., "*Sao ke kelle terre per kelli fini que ki contene trenta anni le possette parte Sancti Benedicti*", hasim përdorimin e shkronjës "k", aq

³⁸¹ Revistë online "*Focus cultura italiana*",

<https://www.focus.it/cultura/curiosita/petaloso-e-una-parola>

³⁸² La rivista della Crusca in Rete, *Italiano digitale*, Editore online Marco Biffi, 2017, nr 2, (korrik-shtator) - f. 3.

³⁸³ Bonomi, Ilaria, "*Tendenze linguistiche dell'italiano in rete*", Informatica Umanistica, 2010, f. 17.

të përdorur në ditët e sotme në vend të shkronjës “**ch**” – për italianët, si për shembull: *ciao ke fai; Xke – perché.*

Gjatë komunikimit ndërmjet të rinjve në rrjetet sociale, janë tepër të pranishme huazimet nga gjuhët e huaja, kryesisht nga anglishtja dhe italishtja që përfaqësohen në trajtë shkurtesë për shprehje të ndryshme si:

Grz –grazie,në vend të faleminderit,
Cmq –comunque (megjithatë),
Xke-perché,
Ci 6’?- a ndodhesh aty,
Tt-tutto (gjithçka),
Omg – “oh zot”(oh my god),
Nthg –asgjë (nothing),
Np- pa problem,
Nvm – (Never mind),
Btw – (meqë ra fjala)by the way,
Idk- nuk e di (I don’t know).

Gjithashtu këto shkurtime hasen dhe në shqip :

Flm – faleminderit,
Mgjs- megjithëse,
Nrm– normal.
Skgj- s’ka gjë,
Sps- s’ka perse,
Prbl - problem,
Tjt - tjetër.

Ka edhe fjalë që kthehen në formën e mbrapshtë, si për shembull: “*op*” në vend të pohimit ‘*po*’. Për fat të mirë shohim që këto shkurtime nuk janë të dëmshme për gjuhën. Ato krijohen si pasojë e një gjuhe të koduar nga të rinjtë. Problemi qëndron në ato fjalë të cilat ndryshojnë krejtësisht kuptimin dhe formën. Shohim që fjalët janë të prirura të shkurtohen dhe t’u hiqen zanoret, për të përfutur kështu kode gjuhësore, të cilët përdoren përgjithësisht nga një brez i ri që quhen të “*lindurit dixhitalë*” dhe e kundërta e tyre “*emigrantët dixhitalë*” (që kanë mësuar të përdorin teknologjinë, në sajë të nevojës dhe detyrës, të cilëve nuk u

vjen natyrshëm përdorimi i tyre).³⁸⁴ Kemi rastin e një fjalie të koduar si: “*Dove sei? Ti aspetto*” që bëhet “*Dv 6 t asp*”; “*Sei proprio tremendo-6 proprio 3mendo*”- (je me të vërtetë i tmerrshëm); “*Xki nn kpisce*”- për atë që nuk kupton.³⁸⁵

Interneti dhe rrjetet sociale janë publike dhe këto shkurtime fjalësh, që lindin nga mesazhet, po gjejnë legjitimitet të plotë dhe në rrjetet sociale. Struktura e gjuhës po i përshtatet sistemit të ri kibernetik, duke përdorur terminologji alternative në raport me një vizion të ri të të shprehurit.

“*Bashkëndaj*”, është fjala magjike e ditëve të sotme që tashmë është në përdorim masiv dhe që menjëherë identifikohet nga përdoruesit e rrjeteve me termin *share* ose *condividi*. Mjafton një klik për të ndarë me të gjithë, për të komunikuar atë çfarë “*uni*” ndjen, beson, lajmëron, mediton e me radhë.

Jo të gjithë anglicizmat që kanë depërtuar në gjuhën italiane vitet e fundit përkthehen, dhe kjo jo sepse nuk ekzistojnë ekuivalentet e mundshme. Ato konsiderohen si terma universalë dhe madje përdoren ashtu siç janë.

Jo shumë kohë më parë *gjuhëtari* dhe mendimtari i shquar *italian Tullio de Mauro*³⁸⁶, në një intervistë të publikuar në të përditshmen *La stampa*, theksonte që në këtë drejtim, gjuha italiane është dembele, preferon të asimilojë fjalë të huaja, sidomos nga anglishtja, edhe nëse ka ekuivalentin e saj. Por kur bëhet fjalë për teknologjinë atëherë janë të mirëpritura, pasi bëhet fjalë për gjuhë specifike. Nga ana tjetër ai beson se epoka e internetit dhe përdorimi i rrjeteve bën të mundur të lexuarit në një formë tjetër nga ana e të rinjve prandaj duhet të ngulmojmë për të gjetur mënyra që t’i përshtatemi dhe që ata të mos braktisin leximin. Gjithashtu edhe Prof. Esheref Ymeri, në botimin e tij “*Përkthimi, një histori pasioni*”- i përgjigjet pyetjes nëse i duket shqetësuese futja në fjalor e fjalëve dhe kuptimeve të cilat gjuha shqipe nuk i ka aspak dhe shprehet: “*Në kuadrin e marrëdhënieve mes*

³⁸⁴ Rossi. Paolo, Mantovani ,S. “*Digital Kids*”, Rizzoli Etas, 2012, f. 12.

³⁸⁵ Antonelli.Giuseppe, “*Un italiano vero.La lingua in cui viviamo*” Rizzoli Libri S.p.A, 2016.f 183.

³⁸⁶ www.ilsussidiario.net/News/Educazione/2012/7/5/SCUOLA-Nativi-digiali.../298979/

popujve të ndryshëm, edhe gjuhët marrin e japin me njëra-tjetrën. Unë mendoj se huazimi i fjalëve të huaja, më se të nevojshme, nga sfera e shkencës dhe e teknologjisë bashkëkohore, të cilat nuk janë të përfshira në fondin e terminologjisë në gjuhën shqipe, është më se i nevojshëm. Por të përfshish në gjuhën shqipe fjalë të tilla si “performancë”, “event”, “trend në gjuhën shqipe, do të ishte diçka me të vërtetë revoltuese.”³⁸⁷

Një konstatim të fundit e hasim në fushën e përkthimit, pasi këto terma janë shumë të përdorura dhe në modë, por kur përkthehen nga një gjuhë në gjuhën tjetër, nuk pësojnë shumë ndryshime si në formë ashtu dhe në kuptim. Janë terma globalë të cilët përkthehen në mos fjalë për fjalë, me ekuivalentin e tyre. Kësisoj termash ruajnë pothuajse të njëjtën rrënjë, pa sinonime, pasi janë unike në përdorim e në llojin e vet. Në këto raste mund të themi që kulturat ecin dhe zhvillohen paralel.

Me futjen e re të teknologjisë së informacionit ka shumë fjalë që janë të vështira për t’u përkthyer. Si p.sh., website, browser etj. Si duhet të veprohet në raste të tilla? Të lihen në anglisht apo të bëhet një përkthim në shqip, por për përdoruesit kjo do të duket pa kuptim.

Për fjalën "website" duke iu referuar mendimit të blogjeve të ndryshme dhe studentëve, të cilët e hasin në përkthim, do të ishte e përshtatshme ta përkthenim në shqip si “faqe interneti”. Natyrisht lind pyetja: Përse duhet ta përkthejmë në shqip në këtë rast? Sepse ky term përdoret nga pjesa më e madhe e shqipfolësve dhe reflekton kuptimin e plotë të fjalës anglisht.

Ndërsa përsa i përket "browser" sipas fjalorit elektronik online anglisht-shqip është i përkthyer "shfletues, qëmtues". Ndryshe nga "website" kjo fjalë ka kuptim më të ngushtë dhe përdoret nga ekspertë dhe si të tillë ata zakonisht preferojnë lënien e fjalës në anglisht.

Termet universalë mbeten: *home, aggiornamento, privacy, notifica* etj. Duke bërë një vëzhgim të drejtpërdrejtë, është shumë interesante të studiohet gjuha ose më saktë zhargoni i të rinjve. Në momentin që hulumtojmë dhe marrim pjesë në diskutime online ose në chat(çat), vëmë re që fjalori që përdorin dhe mënyra e komunikimit s’ka lidhje me gjuhën që ne flasim; nëse krahasojmë pastaj gjuhën

³⁸⁷ Ymeri, Esheref, “ *Përkthimi, një histori pasioni*”, Omska, Tiranë, 2015, f. 472.

teknike, atë të programimit, është e saktë dhe ka një sintaksë dhe semantikë të përcaktuar qartë. Gjuha e përdoruesve në web është e shfrenuar, pa rregulla drejtshkrimore, kakofoninë të shprehur, fjali të ndërtuara plot gabime nga ana sintaksore, e cila shpesh përkufizohet si *kamaleonitizëm*. Përdoruesit e sotëm kur shkruajnë postimet e tyre, nuk e kanë zakon t'i rikthehen edhe një herë pjesës, gjë që ishte traditë më përpara sa herë që bënim një shkrim. Inercia, instikti për të ndarë momentin ia kalon arsyes. Përdorimi i një foljeje, i një parafjale në vendin e duhur, një lidhëze apo shenje pikëzimi mbeten në plan të dytë. Gjuhëtari Giacomo Devoto, pyetjes se si duhet folur e shkruar iu përgjigj: “*Gjëja më e rëndësishme, -thotë ai- është përdorimi i përgjegjshëm i fjalëve*”. Mesa duket përgjeshmëria në të shkruar në mesazhet apo statuset e çastit, nuk merret parasysh.

Le të vëzhgojmë disa fjalë të reja të epokës dixhitale (Teknologjizmat), të cilat pasuruan gjuhën në harkun e një kohe të shkurtër, që vijnë si rrjedhim i zhvillimit teknologjik të kompjuterave, smartfonëve, tableteve etj.

Një rast i mirë për të mësuar anglishten, përse jo? Ose më keq për të harruar italishten apo edhe gjuhën tonë. Nëse duam të dukemi *greek* (të magjepsur pas teknologjisë) nuk mund të mos kemi një smartphone dhe të endemi pas lajmeve *fake news*³⁸⁸, të bëjmë një *selfie*, të përdorim njërin nga rrjetet sociale, të ngarkojmë një *file* në *youtube*, të postojmë në wall (mur) një link ose të linkojmë, ose ndryshe siç i thonë në gjuhën italiane *embeddarlo* (copy –paste). Me fat do të ndihen të lindurit dixhitalë që nuk kanë nevojë të bëjnë kësisoj pyetjesh. Këto janë rritur *nën petkun e teknologjisë*.³⁸⁹ Më e vështirë është për emigrantet dixhitalë, për të cilët është e vështirë të lidhen (loggarsi), pra të identifikohen me një sistem informatik. Duke lundruar, hasim fjalë të thjeshta si *chat* (bisede në linjë, ndryshe “*chatim*”) ose bashkime fjalësh si *e-book* (libër në format dixhital) etj.

Po çfarë mendojnë ekspertët? Në hyrje të botimit të parë, të fjalorit të gjuhës italiane Zingarelli, që u publikua në vitin 1922, Nicola Zingarelli nuk ishte aq kundër neologjizmave dixhitale, pasi ai shprehet se dyndja e

³⁸⁸ Lajme të rreme - term i përdorur nga anglishtja.

³⁸⁹ Rossi. Paolo, Mantovani, S. “*Digital Kids*”, Rizzoli Etas, 2012, fq. 12.

madhe e tyre nuk i bën keq gjuhës.³⁹⁰ Fjalori *Devoto Oli* përmban 500 fjalë të reja, në krahasim me botimin e mëpërparshëm, nga të cilat pjesa më e madhe e tyre janë fjalë nga fusha e teknologjisë. Fjalori *Zingarelli*, rreth 1200 fjalë. Legjitimiteti i internetit i ka detyruar fjalorët të përditësohen me fjalë të reja që lidhen me fenomene dhe risi teknologjike. Folja *chattare* hyn në përdorim në vitin 1995, termi *rrjete sociale* në 1994,³⁹¹ por pas lindjes së Facebook, Twiter, Intagram (Fejsbuk, Tuitër-fjalë që duken të çuditshme po t'i shkruash në shqipe), pra nga viti 2004 e më pas, do të përballemi me një dyndje termash të rinj.³⁹² Folja *gugëlloj*, 2004; *googlare në italisht (ad aziendam)*³⁹³, një ndër motorët e kërkimit më të avancuar. Gjuhëtarët tregohen të kujdesshëm në hyrjen e këtyre termave në përdorim, por gjithashtu vëzhgojnë fjalë të cilat kanë një përdorim masiv, por në një kohë të shkurtër.

Shqipja ka një traditë të gjatë të pasurimit të gjuhës, sidomos nga ana e shkrimtarëve. Nëse në një kohë ishin dialektet dhe zhargonet që sugjeronin fjalët e reja, tani interneti, rrjetet sociale, mediat dhe publiciteti po vënë në dukje bumin e fjalëve si *app*, (aplikacion) *linkoj*, *ngarkoj*, *atashoj*, *skanoj* etj. Të kësaj fushe janë edhe fjalë të tjera që po përdoren në shqip, të cilat në vitet e fundit kanë gjetur përdorim shumë të gjerë. Të tilla janë: *monitor*, *printer*, *password*, *update* (apdejt), *e-mail*, *laptop*, *chat*. Huazime në formë kalku janë disa terma shqipe në fushën e kompjuteristikës, për shembull për *password* përdoret fjala shqipe *fjalëkalim*, për *e-mail* - postë elektronike, për *update*-përditësim, për *download* - shkarkim. Po kur themi në shqip kompjuter personal do të kemi të njëjtin efekt sikurse *laptop* ose *Pc*?

Shumë nga fjalët që lindin në këto raste janë huazime nga gjuhët e tjera. Një nga tendencat e fundit është të merret folja nga gjuha angleze dhe për të evituar lodhjen për ta përkthyer në gjuhën italiane, i shtohen temës së foljes anglisht mbaresat foljore (për t'u vënë re në fakt, të gjitha foljet i përkasin zgjedhimit të grupit të parë që mbarojnë me *are* si për shembull:

³⁹⁰ <https://www.fanpage.it/da-selfie-a-svapore-i-5-neologismi-dello-zingarelli-2015/>

³⁹¹ Po aty.

³⁹² Antonelli, Giuseppe, “*Un italiano vero. La lingua in cui viviamo*”, Rizzoli Libri S.p.A, 2016, f. 170.

³⁹³ Antonelli, Giuseppe, “*Un italiano vero. La lingua in cui viviamo*”, Rizzoli Libri S.p.A, 2016, f. 171.

chattare, linkare, draftare etj.). Kemi rastin e pjesoreve të cilat kthehen në emra si fjalët: *badante, utente* etj.³⁹⁴. Gjithashtu fjalë të cilat ndryshojnë kuptimin e tyre të mëparshëm si: *navigare* –lundroj, tashmë në botën e *palimit* të internetit ose rastet e foljeve vetvetore *whatsapparsi*- sipas fjalorit Treccani³⁹⁵, do të thotë shkëmbime fotosh, mesazhesh, videosh ndërmjet kontakteve.

Më pas vijojmë me terma nga politika si *no global*- jo normal, jo i kësaj bote, apo *neocon* (neoconservatore) - konservatorët e rinj. Termat e rinj janë të shumtë, disa nga ato i përdorim pa e kuptuar, disa janë të padëshiruar.

Nëse lexojmë blogjet apo shtypin italian hasim aq shumë terma të tillë, si: “Ogni azienda ha la sua *mission*”; *skillato* - për ata që janë të aftë; *upgradato* - për ata që kalojnë provimin.

Pastaj kemi *target, la location* ose *braimstorming* (*tempesta di pensieri*) - stuhi mendimesh, *off - topic* - jashtë teme - briffati –të qenit i kënduar.

Le të shohim çfarë termash të rinj përdoren për dokumentet elektronike: *draftare un documento* – i bëj draft një dokumenti, *deliverarlo* – e dorëzoj atë, *sharare ocondividere* marrë nga anglishtja, – ndaj informacione, *uplodare un documento* – ngarkoj një video ose një program, *restartare* - ristartoj, *schedulare* - vendos në kartelë, *updatare* – azhurnoj - përditësoj, *linkare* – vendos linkun, në foto apo statuse, *scannare* –skanoj.

I shtohen kësaj liste termat e tmerrshëm të lindur nga *Fejsbuku* (Facebook): *loggarsi* – lidhem, *addare* – shtoj në listë një mik, *postare* – postoj diçka në murin tim (pra në *bacheca* ose *wall*), *taggami su fb*, *nelle foto o stati* – më tago në fb, *bannare* – eliminoj, censuroj .

PËRFUNDIME

Si përfundim, futja e fjalëve të reja, sidomos nga sfera e zhvillimit teknologjik, mbetet një dukuri e pashmangshme dhe si e tillë, po përdoret nga të gjithë duke i përshtatur qoftë shqiptimin, qoftë duke ruajtur rrënjën

³⁹⁴ Biffi, Mario (2017), “*Le parole nella rete*”, Gedi , Settima edizione, Firenze, f. 47-48-49.

³⁹⁵ Treccani, Vocabolario della lingua italiana, neologismi sinonimi e contrari, 2011.

apo duke i përshtatur sipas rregullave të gjuhës përkatëse dhe në ato raste duke krijuar fjalë të reja.

Këto fjalëformime apo huazime duhet të zyrtarizohen në fjalorët e gjuhës së sotme, sidomos termat e huaj që vijnë në shqip që kanë nevojë për përditësim, në drejtshkrim e në shqiptim. Duke pasur parasysh që zhvillimi teknologjik po ecën me hapa galopant, si pasojë, do të jemi të detyruar të përballemi me terma të shumtë.

Debati mes huazuesve të pakujdesshëm dhe puristëve të paanshëm do të mbetet gjithmonë. Çështja qëndron *çfarë* dhe deri në ç'masë duhet përdorur, a është i nevojshëm përdorimi i termave teknologjike që të jetë i përshtatur deri diku apo duhet të përkrahim idenë e ndërtimit të fjalëve të reja?

Nga pikëpamja gjuhësore besojmë se duhet të tregohemi në thelb purist, por nga ana tjetër, tendenca e përdorimit të këtyre termave ka karakter specifik, dhe përdoren vetëm në dimensionin teknologjik: prandaj të kemi fjalë të reja apo të përshtatura, pasuron thjesht gjuhën tonë dhe duhet të ngjajnë sa më të përafërta.

Fenomene të tilla do të jenë të pashmangshme për aq kohë sa, një shoqëri përqafton dhe mirëpret shndërrime të tilla dhe domosdoshmërisht do të mbeten gjatë në përdorim.

BIBLIOGRAFIA:

- Antonelli, Giuseppe, “*Un italiano vero. La lingua in cui viviamo*”, Rizzoli Libri S.p.A, 2016, f. 170.
- Biffi, Mario, “*Le parole nella rete*”, Gedi, Settima edizione, Firenze, 2017, f. 47-48-49.
- Bonomi, Ilaria, “*Tendenze linguistiche dell’italiano in rete*”, Informatica Umanistica – 2010, f. 17.
- Jorgaqi, K., *Mbi huazimet italiane në gjuhën shqipe*, “Përpyekja”, 1997, Nr. 10, f. 132.
- Marazzini, Claudio, “*Scrivere nell’era digitale*”, vol3. Accademia della Crusca, Gedi, Roma, 2018. F. 170-171.
- Migliorini, B., *Storia della lingua italiana*, Sansoni, Firenze, 1978, f. 45.
- Rossi, Paolo, Mantovani, S., “*Digital Kids*”, Rizzoli Etas, 2012, f. 12.
- Skendaj, A. *Huazimi si një dukuri e pashmangshme e shqipes moderne* - Akte të

- Seminarit të 3-të: “Rreth huazimeve në shqipen standarde”, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Shtëpia Botuese Pegi, 2004, f. 129 – 135.
- Ymeri, Esheref, “*Përkthimi, një histori pasioni*”, Omska, 2015, f. 472.

Sitografia e këshilluar

- <http://www.accademiadellacrusca.it/it/scaffali-digitali/articolo/social-network-lingua-italiana-neologismi-anglicismi>
- <https://www.fanpage.it/da-selfie-a-svapare-i-5-neologismi-dello-zingarelli-2015/>
- <https://www.focus.it/cultura/curiosita/petaloso-e-una-parola>
- La rivista della Crusca in Rete, *Italiano digitale*, 2017, nr 2, (Korrik-shtator)-f.3 ,Editore online Marco Biffi.

Impact of digital revolution in the language of young people

ABSTRACT

Social networks are increasingly dominating our time and our lives like no other form of the technologic revolution has even done over the years. It is sure that this revolution has influenced the way of living of the users of these networks and what is more it has influenced the way of expressing, interacting with the virtual world, by breaking in this way all communication barriers, regarding distance as well as freedom toward the subject to who we speak. This style has conditioned our daily life, the way of expressing and has absolutely brought forth innovations and changes into our language. The language and speech forms, with which youngsters communicate in social networks, are completely out of the standard way of speaking or writing and this damages them. In this paper we will see some cases of the usage of new words from the field of technology and social networks that are being used massively and how they affect the usage of language. Firstly, it is spoken about neologisms' phenomena as an inevitable occurrence for all languages, by treating phenomena of words

borrowed from English, how they enter into Italian language and of course a comparison with Albanian. The whole paper brings forth different examples, personal observations, investigations in social networks, forms of expressing in the Italian language and vice-versa, from universal and untranslatable terms to the most “hit” ones of the moment.

Bresena KOPLIKU, Nevila DIBRA

POTENCIALET E AGROTURIZMIT PËR NJË ZHVILLIM TË QËNDRUESHËM RAJONAL

Agroturizmi përfaqëson çdo aktivitet turistik që ndodh kur udhëtimi lidhet me produktet, shërbimet ose eksperiencat bujqësore. Pavarësisht se është një degë e hershme e turizmit në botë, dhe pavarësisht se Shqipëria ka një traditë të hershme të zhvillimit të ekonomisë bujqësore, gjenden pak aktivitete të pastra agroturistike në rajonin verior të Shqipërisë. Megjithatë duket se vitet e fundit kjo degë e ekonomisë së turizmit po kthehet në prioritet për grupe të ndryshme të popullsisë. Gjithashtu vihet re një rritje e vëmendjes së strukturave të pushtetit lokal për mundësinë e zhvillimit të kësaj dege në zonë. Po ashtu dallohet edhe një rritje e ndërgjegjësimit të vetë banorëve të zonave rurale të rajonit për mundësitë e zhvillimit duke u bazuar në agroturizëm. Gjithnjë e më tepër ai po konsiderohet si një ndër akset kryesore në të cilat bazohen planet e përgjithshme vendore të Bashkisë së Shkodrës dhe Malësisë së Madhe. Bashkia e Shkodrës në diversitetin e potencialeve të saj për zhvillim të turizmit, paraqet edhe mundësi të zhvillimit të agroturizmit kryesisht në njësitë administrative të Postribës, Gurit të Zi, Shoshit, Shalës, Pultit si dhe zonës së Nënshkodrës. Ndërsa për Malësinë e Madhe, për shkak të përqindjes më të lartë të popullsisë që merret direkt me ekonomi bujqësore, kjo mundësi shihet e shpërndarë pothuajse në gjithë territorin. Nëpërmjet intervistave të thelluara me përfaqësues të pushtetit lokal si persona kyç, me fermerët e rajonit si aktorët e drejtpërdrejtë të këtij zhvillimi, dhe analizës së të dhënave dhe potencialeve mbi zhvillimin e turizmit të zonës, artikulli arrin në përfundimin se agroturizmi është një ndër drejtimet kryesore të zonës për një zhvillim të qëndrueshëm.

Hyrje


Agroturizmi përfaqëson çdo aktivitet turistik që bazohet në produktet, shërbimet apo eksperiencat bujqësore. Ai është një formë e turizmit brendapërbrenda kontekstit të turizmit rural që sot po njeh një rritje shumë të shpejtë në industrinë e udhëtimit dhe të turizmit. Shpeshherë vija ndarëse në mes turizmit rural dhe agroturizmit është e paqartë. Turizmi

rural përfshin një gamë më të gjerë të aktiviteteve që zhvillohen në hapësirat rurale, aktivitete të lidhura direkt me sigurimin e shërbimeve dhe të eksperiencave argëtuese për turistët. Pra turizmi rural bazohet përgjithësisht në mjedisin rural, ndërsa agroturizmi bazohet tek ferma dhe fermeri. Për rrjedhojë, brendapërbrenda kornizës së turizmit rural, sipërmarrjet agroturistike janë më të lidhura me agrikulturën se sa bizneset e tjera turistike rurale (Kosmaczewska, 2008).

Kjo formë e turizmit ka lindur si një kundërpërgjigje ndaj kërkesës së re turistike për aktivitete rurale që të jenë autentike, ndjesi personale, të përfaqësojnë kontaktet me rrënjët rurale si dhe të shërbejnë si forma alternative të edukimit. Ky trend i ri i industrisë së turizmit në Shqipëri duket se po zgjerohet gjithnjë e më tepër vitet e fundit me raste konkrete, iniciativa më së shumti private, që kanë devijuar nga ofrimi i shërbimeve për një turizëm masiv për të kaluar në shërbime më specifike dhe më interesante sikurse është agroturizmi. Arsyet e këtij devijimi lidhen edhe me diversifikimin e kërkesës turistike në Shqipëri, me rritjen e numrit të turistëve si dhe rritjen e të ardhurave në funksion të kësaj industrie. Thirrjes së hapur nga Ministria e Bujqësisë dhe e Zhvillimit Rural iu përgjigjën 30 aplikime në agroturizëm gjë që tregon për rritjen e vëmendjes ndaj këtij sektori të përfshirë tashmë në politikat e qeverisë. Edhe paketa fiskale ka përsuar disa ndryshime në favor të biznesit agroturistik.

Metodologjia e punimit bazohet në kërkimin cilësor dhe cilësor. Janë realizuar disa intervista të thelluara me persona kyç në Bashkinë e Shkodrës dhe të Malësisë së Madhe, sikurse me kryetarët e njësive administrative në bashkitë përkatëse, si njohës më të mirë të terrenit, të mundësive për zhvillimin ekonomik që ofrojnë zonat përkatëse si dhe të mendësisë dhe kulturës së banorëve të këtyre zonave. Gjithashtu janë realizuar 50 pyetësorë me fermerë, pronarë të bujtinave dhe restoranteve dhe të dy bashkive, sipërmarrës lokalë dhe banorë të tjerë të zonës. Qëllimi ishte analiza e marrëdhënies në mes zhvillimit të agroturizmit dhe potencialit të komunitetit vendas për orientim drejt kësaj dege. Të dhënat e mbledhura direkt nga terreni janë plotësuar edhe me të dhëna indirekte nga databazat e bashkive dhe të organizatave joqeveritare që operojnë në zonë.

Llojet e bizneseve të anketuara të ndara në përqindje



Agroturizmi si potencial zhvillimi për zonat rurale të Rajonit të Veriut

Bashkitë e përzgjedhura për studim, Bashkia e Shkodrës dhe e Malësisë së Madhe, kanë potencial të dukshëm për zhvillimin e kësaj dege relativisht të re për turizmin shqiptar. Kalimi i stinës së verës ose “*verimi*” ka qenë një traditë e hershme për familjet qytetare shkodrane që kishin pronat e tyre private në rrethinat e Shkodrës ose shtëpi të dyta më së shumti në Razëm dhe në Bogë. Këto fillesa të turizmit kryesisht klimatik ishin më të shpeshta në fillimet e shekullit XX dhe u rralluan gjatë periudhës së komunizimit. Gjithsesi, mbeti traditë kalimi i pushimeve verore pranë brigjeve të liqenit të Shkodrës, në Shirokë, ose në pikën turistike të Razmës në trajtën e pushimeve familjare ose të fëmijëve në kampet e pushimeve për të rinj. Rivlerësimi i peizazhit rural shfaqet vonë, në fillimin e viteve 2000, ndërsa koncepti i agroturizmit vetëm në vitet e fundit. Aktualisht agroturizmi është shumë më pak i rëndësishëm për ekonominë shqiptare krahasimisht me llojet e tjera të turizmit. Numri i fermave agroturistike në Shqipëri është në rritje, por gjithsesi përbën një përqindje shumë të vogël të fermave në Shqipëri. Zhvillimi i agroturizmit kërkon kombinimin e disa faktorëve të cilët varen nga burimet natyrore të zonës, nga pasuria kulturore, potenciali i

komunitetit lokal, ekonomia lokale e diversifikuar, produktiviteti i fermave apo një sektor shërbimesh i zhvilluar mirë.

Potenciali i zhvillimit të këtij tipi relativisht të ri për Shqipërinë bazohet në rritjen e përgjithshme të kërkesës turistike në vend, në periudhën 2013-2017, hyrjet e shtetasve të huaj të ardhur në Shqipëri kanë qenë afërsisht 21 milionë persona. Në këtë hark kohor, hyrjet e të huajve kanë pasur tendencë rritjeje mesatarisht 12,0% (INSTAT 2018). Bashkia e Shkodrës numëron afërsisht 100 000 turistë në vit për 2017-ën, ndërsa Malësia e Madhe numëron 10 000 tillë të ndarë në 40% për turizmin liqenor dhe 60% për turizmin malor.

Potenciali i zhvillimit turistik të rajonit bazohet në disa pika të forta të tij. Ai është rajon ndërkuftar, me dy pika të rëndësishme doganore, të Muriqanit dhe të Hanit të Hotit. Nga pika doganore e Muriqanit kanë hyrë në Shqipëri gjatë vitit 2017 631.523 të huaj, që përbënin 12% të të huajve të ardhur në Shqipëri, ndërsa nga pika doganore e Hanit të Hotit 279149 të huaj që përbënin 5 % të hyrjeve në Shqipëri (INSTAT 2018). Rajoni verior i Shqipërisë dallohet për një trashëgimi natyrore dhe kulturore të pasur ku përfshihet kultura materiale dhe jomateriale. Potenciali natyror shfaqet në peizazhet e mrekullueshme natyrore të zonës malore alpine si dhe të Fushave të Nënshkodrës dhe të Mbishkodrës. Sipërfaqet pyjore, fushat dhe livadhet e zonës, tokat pjellore, sipërfaqet dhe rrjedhjet ujore janë burime me të cilët zona është mjaft e pasur. Zona malore veriore në Shqipëri, shtrihet në një lartësi nga 300 m deri në 2700 m mbi nivelin e detit. Mbi 70% e sipërfaqes së saj është e zënë nga pyjet, kullotat, etj. Këtyre burimeve u shtohen liqenet e bukur piktoreske akullnajore (Dobi etj. 2013). Në kornizën e trashëgimisë natyrore hyjnë edhe mundësitë për lloje të tjera të turizmit, përveçse atij agroturistik, të cilët e plotësojnë ofertën turistike të zonës, sikurse ecje, ngjitje, biçikletë, not etj. Trashëgimia kulturore është gjithashtu e pasur, me elemente të traditës, veshjeve, mjeteve të përdorura në punët bujqësore, folklori, gatimet tradicionale, të cilat gjenden dukshëm në zonë dhe janë diverse nga një krahinë në tjetrën.

Agroturizmi përveç se ndihmon në rritjen e të ardhurave të vetë fermerëve që merren direkt me të, ndihmon edhe në stimulimin e aktiviteteve nga banorët e tjerë të zonës. Ai shihet si mundësi e zvogëlimit të papunësisë që mbetet sot një ndër problemet kryesore të komuniteteve

rurale. Pavarësisht se agroturizmi nuk shihet si një aktivitet që gjeneron punë të reja, meqenëse është përgjithësisht një biznes i vetëmjaftueshëm, ai ndihmon në replikimin e fermave kur ato janë të suksesshme, ose në angazhimin e komunitetit me ofrimin e shërbimeve për të gjithë llojet e turistëve.

Agroturizmi shihet sot si një degë alternative e zhvillimit të turizmit në Shqipëri. Edhe në zonën e marrë në studim ka disa gjurmë të para të shfaqjes së agroturizmit, si dhe shërbime të tjera ekzistuese, miqësore me mjedisin, të cilat mund ta plotësojnë kornizën e zhvillimit të tij.

Vitet e fundit ka një rritje të numrit të bizneseve të lidhura direkt me aktivitetin turistik. Mundësitë për zhvillimin e agroturizmit në dy bashkitë e marra në konsideratë i bazojmë në disa pika të forta të tyre, sikurse popullsia e re në moshë, pasuri natyrore dhe kulturore që shërbejnë si elemente atraksioni jo vetëm për turistët kombëtarë, por edhe ata ndërkombëtarë, shfaqja e mënyrave alternative të përfshirjes së të rinjve me ide të reja kryesisht në formën e start-upeve apo të bizneseve sociale, rritja e numrit të projekteve që operojnë në zonë me qëllim zhvillimin direkt apo indirekt të agroturizmit, rritja e interesit dhe ndërgjegjësimit për mundësitë e zhvillimit të agroturizmit edhe nga vetë përfaqësuesit e pushtetit vendor dhe qendror, edhe nga vetë banorët e zonave rurale.

Bashkia e Malësisë së Madhe ka një popullsi afërsisht 58,964 banorë (sipas të dhënave të gjendjes civile) dhe 38,358 banorë (sipas vlerës të grantit të llogaritur nga Ministria e Financës). Në total në të gjithë territorin e Bashkisë numërohen 1 qytet dhe 61 fshatra.

Format dominuese të agroturizmit janë pushimet në zona rurale nëpërmjet akomodimit në ferma dhe pjesëmarrja aktive në jetën e përditshme rurale. Brendapërbrenda kornizës së turizmit rural, agroturizmi bazohet tek ferma dhe fermeri, pra përfshin ato biznese që janë më afër aktivitetit bujqësor se sa bizneset e tjera turistike rurale (Kosmaczewska J, 2008). Ndër sektorët kryesorë të ekonomisë në Malësinë e Madhe përmenden bujqësia, blegtoaria, sektori i ndërtimit dhe i përpunimit (agro). Ajo ka një traditë të gjatë në ekonominë bujqësore e bazuar në tokat e lehta dhe pjellore sidomos në pjesën perëndimore, dhe në klimën mesdhetare. Banorët e zonës janë të lidhur me traditën e mbjelljes së drithrave, bimëve foragjere, patateve, perimeve apo e kultivimit të duhanit, të bimëve mjekësore dhe të vreshtarisë. Ndërsa pjesa lindore me reliev kodrinor dhe malor është e bazuar më së shumti në blegtori. Aktiviteti bujqësor i zonës përmban shumë elemente të lidhur jo vetëm me kulturën e prodhimit, por edhe të jetës së përditshme të shfaqur në kulturë ameriale dhe jomateriale

që mund të kthehen në elemente të tërheqjes turistike. Malësia e Madhe dhe Shkodra kanë grupe të popullsisë që merret me ekonomi bujqësore. Për rrjedhojë vendbanimet rurale të të dy bashkive mund të kthehen në pritëse të dy kategorive më të njohura të agroturizmit (klasifikim i Pitman 2009):

- Agroturizmi i pastër, ku vizitorët i mbushin pushimet me aktivitete të ekonomisë bujqësore sikurse kujdesi për kafshët, mjelja, bërja e djathit, korrje, mbjellje, bletari, kantinë vere etj. Këto aktivitete ato i plotësojnë edhe me peshkim, ngjitje ose ecje, gjueti, kalërim etj. Bashkia e Shkodrës ofron mundësi të tilla në të gjitha njësitë administrative të saj, sidomos në ato të zonës së Nënshkodrës, në Anën e Malit që konsiderohet edhe si furnizuesja kryesore me zarzavate për banorët e qytetit; në Gurin e Zi, Postribë, Shalë, Shosh apo Pult. Ndërsa për Malësinë e Madhe harta e shpërndarjes së agroturizmit është edhe më e gjerë, sepse përfshin gjithë bashkinë, me mundësi të tilla edhe për rrethinat e qytetit të Koplikut.
- Agroturizmi kompleks ku turistët përveç aktiviteteve të mirëfillta bujqësore, mund të plotësojnë kohën e pushimeve edhe me elemente të tjera të turizmit, sikurse turizmi kurativ, sportiv, kulturor etj. Për turizëm të tillë të përzier ofrohen mundësitë në Parkun natyror të Shkrelit, në Luginën e Shalës, përgjatë gjithë bregut të liqenit të Shkodrës që i përket pjesës shqiptare, në Malësinë e Kelmendit që ofron disa prej peizazheve më impresionuese të Alpeve Shqiptare etj., në Gurin e Zi që përveç trashëgimisë natyrore ofron edhe mundësi të trashëgimisë kulturore (kalaja e Ganjollës, vendbanimi i Gajtanit etj.).

Përfitimet më të shpejta dhe të dukshme nga agroturizmi janë fillimisht për vetë pronarët e fermave, por rrethi i përfshirjes është më i gjerë. Përveç përfshirjes së banorëve që janë direkt pritës të agroturistëve, agroturizmi rrit kërkesën edhe për shërbime të tjera në zonë duke përfshirë edhe banorë të tjerë të hapësirave rurale të dy bashkive. Këtu nënkuptojmë lloje të aktiviteteve që ofrohen tashmë ose mund të afrohen në të ardhmen nga banorët e zonës, megjithëse nuk janë akoma hallka të një zinxhiri të vetëm shërbimesh agroturistike. Këtu nënkuptojmë aspekte specifike të ofertës që ka zona në fushën e trashëgimisë kulturore dhe natyrore. Punimet e tezgjahut, të drurit, sportet ujore dhe malore, konsumimi i produkteve organike të zonës, apo dëshira për të njohur traditat lokale, janë elemente që nga njëra anë plotësojnë qëndrimin rekreativ të agroturistit dhe nga ana

tjetër ndihmojnë ekonominë lokale.

Agroturizmi mund të shihet edhe si një mënyrë e zvogëlimit të hendekut në mes kushteve të jetesës së banorëve të zonave urbane dhe atyre të zonave rurale. Vihet re një rritje e interesit të strukturave të pushtetit vendor dhe qendror për përmirësimin e standardit të jetesës për banorët këtyre të fundit. Planet e Përgjithshme Vendore të Bashkisë së Shkodrës dhe të Malësisë së Madhe e kanë marrë në konsideratë degën e agroturizmit si një mundësi potenciale drejt zhvillimit të qëndrueshëm. Në planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Shkodër thuhet “*Akset prioritare të turizmit në Bashkinë Shkodër do të jenë Ekoturizmi, agroturizmi, turizmi kulturor dhe historik, turizmi malor, turizmi det dhe rërë*” (PPV, Bashkia Shkodër, f. 15). Qeveria shqiptare ka deklaruar tashmë nismën e saj për mbështetjen e ekonomisë bujqësore në 100 fshatra të Shqipërisë të cilat do të jenë pjesë e një programi 4- vjeçar. Në të përzgjedhurit e saj nga bashkitë e Shkodrës dhe të Malësisë së madhe gjejmë fshatrat e Thethit, Drishtit, Zogaj, Lëpushë, Razëm dhe Vrith, disa prej të cilëve janë tashmë destinacione të rëndësishme të tërheqjes turistike. Secili prej tyre ofron mundësi të përshtatshme edhe për zhvillimin e agroturizmit.

Nga ana tjetër edhe vetë banorët e zonave rurale kanë ndërmarrë iniciativa konkrete, pavarësisht se në fillesat e tyre, për ngritjen e strukturave pritëse të orientuara drejt zhvillimit të agroturizmit. Nga pyetëtori i realizuar rezulton që në 90% të të anketuarve shprehet qartë interesimi i bizneseve për pritjen e vizitorëve në aktivitetin e tyre prodhues. Pjesa e paimentuar për pritje i përket më tepër aktiviteteve të cilat nuk planifikojnë zgjerimin e biznesit në fushën e turizmit, por mbeten të fokusuar në aktivitetin përkatës. Këtu përfshihen gjithashtu bizneset e vogla që e kanë të pamundur zgjerimin e aktivitetit si dhe biznese që nuk përbëjnë atraksion agroturistik, sikurse marketet. Akoma më e lartë, në 95 % të rasteve, shprehet dëshira për të mësuar më tepër mbi agroturizmin. Të anketuarit e shohin si një fushë potenciale të zgjerimit të aktiviteteve të tyre agrobujqësore. Të njëjtin interes shfaqin edhe bizneset që tashmë janë të përfshira në aktivitetin turistik, sikurse njësitë akomoduese dhe restorantet. Interesi i të anketuarve për agroturizmin ritheksohet në gatishmërinë e tyre për të vizituar ferma agroturistike në 85% të rasteve. Pjesa tjetër i përket bizneseve që janë të interesuara për trajnim në aspekte të tjera të aktivitetit,

por jo në fushën e agroturizmit




Figura 17. Harta e propozimit strategjik për Bashkitë Malësi e Madhe

KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Agroturizmi, përveçse si formë e tërheqjes turistike për banorët e zonave urbane, ka si qëllim edhe rritjen e të ardhurave nga ekonomia rurale, përmirësimi i cilësisë së jetës së banorëve të zonave rurale, dhe për rrjedhojë ndikon indirekt në zvogëlimin e emigrimit masiv nga zonat rurale në ato urbane. Studimet tregojnë që agroturizmi ndihmon në shfaqjen e sjelljeve sipërmarrëse, sidomos tek të rinjtë dhe rritja e mundësive për aplikimin e tij do të ndihmonte në uljen e shkallës së emigrimit nga zona. Për shkak të mungesës së politikave mbështetëse për zhvillimin e bujqësisë dhe të blegtorisë dhe transformimit të tokës bujqësore, ka një rënie të përqindjes së popullsisë që merret me bujqësi dhe blegtori dhe rritje të papunësisë. Zhvillimi i suksesshëm i agroturizmit nuk varet vetëm nga iniciativa e pronarëve të shtëpive pritëse, por ai duhet të mbështetet edhe

nga politikat shtetërore për transformimet ekonomike të zonave rurale, për përmirësim të infrastrukturës apo për përfshirjen aktive të autoriteve lokale dhe komunitetit.

Zhvillimi i agroturizmit në zonë mund të arrihet nëpërmjet kombinimit të disa indikatorëve sikurse zhvillimi ekonomik, ndërhyrja e pushtetit lokal, ndërhyrja e pushtetit qendror, sidomos në përmirësimin e infrastrukturës, potenciali natyror, kulturor dhe social.

LITERATURA:

- Bashkëpunimi gjerman, GIZ, Ministria e mjedisit, VIS The Guide of Kelmend 2016.
- Belias, D., Velissariou, E., Kyriakou, D., Konstaninos, V., Labris, V., Mantas, C., Sdrolias, L., Koustelios, A., *Tourism Consumer behaviour and alternative tourism; the case of Agrotourism in Greece* In International Journal of Cultural and Digital Tourism, ISSN (Online): 2241-9705
- Dobi, P., Muhametaj, A., Pacara, N., (2013) *Manual i agroturizmit*, RASP, AG Studio, Tiranë.
- Hoti, M., *Trashëgimia natyrore e Shqipërisë*.
- Kosmaczewska, J., (2008) *In relationship between development of agrotourism in Poland and local community potential*, In Studies in Physical Culture and Tourism, Vol. 15, No. 2
- Maho, N., (2018) *Momenti i agroturizmit*, Revista Monitor.
- Plani i zhvillimit të territorit, Plani i përgjithshëm vendor 2015 - 2030, Bashkia Shkodër.
<http://www.instat.gov.al/media/4169/turizmi-ne-shifra-2018.pdf>

Agrotourism as a potential for Sustainable Regional Development***ABSTRACT***

Agrotourism represents every touristic trip that is based on agricultural products, services or experiences. Even though agrotourism is an early branch of tourism in the world and even though Albania has a long tradition of farming, there can be found only a few cases of typical agroturistic businesses in the region. The article argues that there is an increase of the attention from the local and central government units to the ways of developing this kind of tourism in overall Albania. There is also a growing interest of the inhabitants of rural areas in the region to find the opportunities for agrotourism development. General Local Plans of Shkoder and Malesi e Madhe municipality has taken in consideration agrotourism as an important way for sustainable development. In the diverse panorama of tourism development, Shkodra Municipality considers the administrative units of Dajc, Ana e Malit, Posttribe, Guri i Zi, Shale, Shosh and Pult as most appropriate for the implementation of agrotouristic farms. Whilst this opportunity is seen as possible in all of Malesi e Madhe Municipality, because of the high percentage of population working in agriculture. Through the in-depth interviews with key informants, the questionnaires conducted with farmers in the area and the analyzing of the data on agriculture, the article concludes that agrotourism is one of the most important ways toward sustainable development.

Sokol AXHEMI

POLITIKAT MBI POPULLSINË NË SHQIPËRI SITUATA AKTUALE DHE TENDENCAT

Hyrje

Çështjet dhe tematikat e ndryshme mbi popullsinë dhe elementet e saj paraqiten mjaft aktuale gjatë ditëve dhe muajve të fundit në vendin tonë. Në mënyrë të veçantë rënia e numrit të lindjeve dhe tkurrja e popullsisë shqiptare gjatë këtyre viteve, e sidomos të dhënat e fundit në këtë fillim viti 2018 ka ngjallur jo vetëm nevojën për të pasur një debat publik, por edhe urgjencën dhe domosdoshmërinë e marrjes në konsideratë të efekteve dhe pasojave me të cilat shoqërohen këto procese të zhvillimit të popullsisë shqiptare. Tashmë shifrat dhe të dhënat e shumta statistikore të ofruara nga INSTAT tregojnë një “alarm imediat” të marrjes në konsideratë të riaktivizimit të politikave mbi popullsinë, në mënyrë të veçantë të politikave pronataliste, me një sistem efikas masash të domosdoshme ndërhyrjeje.

Riaktivizimi i politikave të tilla paraqitet emergjent duke synuar një rritje të numrit të lindjeve dhe shtesës natyrore të popullsisë shqiptare në të ardhmen. Indiferenca ndaj politikave të tilla, mungesa e seriozitetit për t'i trajtuar dhe marrë në analizë këto çështje, lënia mënjanë e masave që duhet të merren, nuk bën gjë tjetër veçse shton alarmin “SOS” për të ardhmen e zhvillimeve të popullsisë në vendin tonë. Sinjalet tashmë nga viti në vit, tremujori në tremujor, e muaji në muaj, duken qartazi të zymta, aq sa edhe projeksionet më optimiste demografike përcjellin dyshime për të ardhmen e “vitalitetit” të popullsisë së vendit tonë.


Rënia e numrit të lindjeve, ulja e shtesës natyrore të popullsisë, rritja e moshës mesatare të popullsisë shqiptare, trende gjithnjë e në rritje të migrimit të popullsisë në përgjithësi dhe moshave të reja e të mesme në veçanti gjatë këtyre viteve të fundit, projektojnë problematika serioze për zhvillimet e popullsisë në vendin tonë, të cilat kërkojnë edhe një përgjigje efikase institucionale nga ana e strukturave të ndryshme shtetërore. Tashmë shkaqet dhe faktorët ndikues në krijimin e problematikave të tilla janë evidentuar dhe njihen jo vetëm nga studiuesit, por edhe nga opinioni i gjerë publik dhe i specializuar. Larmia e tyre, ndërthurja dhe impaktet e shprehura në rolin e faktorëve ekonomikë, politikë, socialë, gjenerojnë domosdoshmërinë e analizave serioze, me qëllim marrjen në konsideratë të

një problemi të tillë kaq serioz dhe të rëndësishëm, që duhet të impenjojë ndërtimin e politikave të menjëhershme shtetërore për të ndërhyrë.

Në materialin e mëposhtëm tentojmë të paraqesim një analizë të përgjithshme të situatës aktuale të zhvillimit të popullsisë në vendin tonë. Krahas dhënies së saj kemi bërë përpjekjet tona që të evidentojmë faktorët ndikues përkatës shoqëruar me efektet e drejtpërdrejta në shtesën natyrore të popullsisë shqiptare, në lëvizjet migrative të kësaj popullsie dhe elementeve të veçanta përbërës të saj. Gjithashtu synojmë që nëpërmjet trajtesave të mësipërme të japim mendimin tonë në lidhje me tendencën në të ardhmen të zhvillimeve të popullsisë shqiptare, së bashku me disa sugjerime të nevojshme dhe të domosdoshme për momentin, lidhur ngusht me aplikimin e politikave të popullsisë. Materiali është i pajisur me tabela, grafikë dhe statistika në funksion të konkretizimit të situatave dhe elementeve të ndryshme, që kanë të bëjnë me popullsinë shqiptare të kësaj periudhe që po analizojmë.

Situata aktuale dhe faktorët ndikues. Efektet në popullsi

Zhvillimet e popullsisë në vendin tonë janë paraqitur mjaft dinamike dhe të larmishme pas viteve 1990. Larmishmëria dhe dinamika e tyre kanë ndjekur kurba të ndryshme shfaqjeje dhe zhvillimi në tërësinë e elementeve që kanë të bëjnë me numrin, shtesën natyrore, strukturat e popullsisë, lëvizjet migrative të brendshme e të jashtme, etj. Megjithatë, sidomos pas viteve 2010 një tendencë e re është përvijuar në zhvillimet e popullsisë lidhur ngusht me shtesën natyrore të saj. Rënia në vazhdimësi e kësaj shtese natyrore ka qenë një nga impaktet kryesore të tkurrjes së numrit të popullsisë, krahas lëvizjeve migratore të jashtme. Një gjë e tillë konfirmohet edhe nga të dhënat e INSTAT.



Grafiku Nr.1. Ecuria e numrit të popullsisë 2010-2017.
(Illir Beqaj,JavaNews.al,shkurt 2018)

Nga grafiku i mësipërm ne eidentojmë në mënyrë të qartë një zbehje graduale të numrit të përgjithshëm të popullsisë shqiptare gjatë kësaj periudhe. Niveli më i lartë i numrit të popullsisë shqiptare rezulton në vitin 2010 me rreth 2 918 000 banorë, për të arritur nivelin më të ulët në vitin 2010 me rreth 2 870 000 banorë. Në tërësinë e saj evolucioni i popullsisë në Shqipëri ndjen një trend ulës gjatë kësaj periudhe, i cili shfaqet mjaft eident në shifër absolute në fillim të këtij viti (pra në fillimin e vitit 2018) me rreth 48 mijë banorë më pak se 2010.

Një tkurrje e tillë graduale e numrit të popullsisë së vendit tonë tregon respektivisht nevojën për të analizuar shkaqet dhe faktorët përkatës. Pa dyshim vëmendja jonë është orientuar në domosdoshmërinë e analizës së dy faktorëve kryesorë ndikues, të cilët lidhen me shtesën natyrore të popullsisë nga njëra anë dhe lëvizjen migruese të jashtme nga ana tjetër. Të dy këto faktorë kanë eidentuar impakte të drejtpërdrejta në rënien dhe tkurrjen graduale të kësaj popullsie në vendin tonë. Aq më tepër që shfaqet një lidhje e menjëhershme dhe e drejtpërdrejtë e tyre me efektet bashkëshoqëruese me ndikim të menjëhershëm në treguesit e lindshmërisë. Largimi nga Shqipëria i një numri gjithnjë e në rritje të popullsisë shqiptare, moshë e re dhe e mesme e tyre (që përfaqëson popullsinë me fertile shqiptare) ka shfaqur efektin e menjëhershëm në rënien e numrit të lindjeve. Nga ana tjetër edhe popullsia shqiptare rezulton me tendencë rënëse në vetë treguesin e lindshmërisë e ndikuar nga pozita dominante të riskut ekonomik dhe social që shfaqin çiftet shqiptare (pasiguria ekonomike, mungesa e stabilitetit në punësimin e tyre, papunësia, karriera, rënia e numrit të martesave, shtimi i divorceve, etj.). Të dy këto elemente (rënia e numrit të lindjeve dhe proceset migratore të jashtme) të paraqitur më sipër kanë bërë të mundur edhe shfaqjen e mjaft problemeve në vetë shtesën natyrore të popullsisë shqiptare gjatë këtyre viteve të fundit.

Viti	Lindjet	Vdekjet	Shtesa natyrore
2010	56 984	20894	36 090
2011	56 010	21 509	34 501
2012	56 031	22 454	33 577
2013	53 502	21 903	31 599
2014	52 127	22 383	29 744
2015	50 004	24 160	25 844
2016	47 960	23 529	24 431
2017	42 132	24 171	17 961

Tabela Nr.1. Ecuria e shtesës natyrore të popullsisë 2010-2017.
(Iilir Beqaj.JavaNews.al, shkurt 2018)

Siç shihet nga tabela e mësipërme kemi një rënie të qartë ndonëse në gradualitet të numrit të lindjeve, të cilat në vitin 2010 paraqiten në shifër absolute afro 56 984 lindje, ndërsa në vitin 2017 në afro 47 960 lindje. Duke analizuar në mënyrë të detajuar këtë lindshmëri absolute edhe përgjatë viteve të tjera brenda këtij harku disavjeçar të marrë në studim, dallohet qartë se nga viti në vit rënia është e evidente. Njëkohësisht duhet të vlerësojmë faktin se krahas rënies së numrit të lindjeve, në mënyrë të menjëhershme dhe drejtpërdrejt efektet shfaqen edhe në rënien e shtesës natyrore të popullsisë shqiptare. Konkretisht kjo shtesë natyrore pëson tkurrjen graduale ku ajo në fillim të vitit 2010 shfaqet në afro 36 090 banorë, ndërsa në vitin 2017 në afro 17 961 banorë. Shifrat janë shumë evidente, sepse tregojnë se rënia në shtesë natyrore është afro 52 % më pak banorë në harkun e 7 viteve, që rezultojnë si shtesë natyrore absolute në popullsinë shqiptare.

Njëkohësisht të dhënat e shumta statistikore në lidhje me indikatorë të tillë të spektrit social siç janë martesat dhe divorcet evidentojnë tregues sinjifikativ edhe përsa i përket raportit ndërmjet martesave nga njëra anë dhe divorceve nga ana tjetër. Të dhënat e analizuara tregojnë se gjatë vitit 2017 në çdo 4 martesa kemi 1 divorc, ndërsa martesat në vitin 2017 kanë rënë me afro 11.5 % në raport me 2010, ndërsa divorcet janë shtuar me rreth 60 % në po të njëjtën periudhë të marrë në studim.

Një ndikim të jashtëzakonshëm në rënien e shtesës natyrore të popullsisë dhe tkurrjen graduale të numrit të popullsisë shqiptare gjatë kësaj periudhe kanë pasur lëvizjet migrative të jashtme. Riaktivizimi i tyre, në mënyrë të veçantë gjatë periudhës 2014-2017 ka qenë një faktor ndikues i drejtpërdrejtë në krijimin e këtyre problematikave mjaft shqetësuese për popullsinë shqiptare. Faktorët socialë, ekonomikë dhe aktivizimi i rëndësishëm dhe rolit të faktorit politik, nxitën një migrim individual të shtuar dhe një risi në kuadrin e migrimit familjar i shprehur në rekorde mjaft intensive nga rajone të ndryshme të Shqipërisë. Pritshmëria e lartë nga ndryshimet politike të ndodhura në Shqipëri gjatë vitit 2013, zhgënjimi i grupeve të ndryshme sociale nga politika e ditës dhe premtimet e shumta sociale e ekonomike, aplikimi i reformave problematike në fusha e sektorë mjaft të ndjeshëm për ekonominë familjare siç ishin ato të taksave e reformës fiskale, të energjisë, në fushën e pronësisë dhe të planifikimit urban krijuan shqetësime serioze për mjaft familje shqiptare, të cilët panë si një mundësi të rëndësishme për jetën e tyre emigrimin.

Statistika të ndryshme evidentojnë në lëvizje migratore të tillë gjatë këtyre viteve që ju referohemi në analizën tonë (në 2011 janë larguar nga Shqipëria afro 55 162 persona, në vitin 2012 janë larguar nga vendi ynë

afro 52 307 persona, në vitin 2013 largimi përfshin afro 49 425 persona të larguar, në vitin 2014 numri i personave të larguar arrin në afro 46 525, në vitin 2015 afro 41 443 persona të larguar, në vitin 2016 shifra e ofruar nga INSTAT shkon në rreth 32 532 persona dhe në vitin 2017 rezultojnë afro 39 905 persona të larguar nga vendi ynë.

Nga tërësia e materialit të analizuar jemi të mendimit se krahas problematikave të shfaqura në rënien e shteses natyrore të popullsisë dhe rënies graduale të numrit të përgjithshëm të popullsisë shqiptare, është e domosdoshme edhe evidentimi i mjaft efekteve që bashkëshoqërojnë këto zhvillime të popullsisë. Këto efekte janë të lidhura ngusht në mënyrë të veçantë me rritjen e moshës mesatare të popullsisë shqiptare (e cila gradualisht ka pësuar rritje gjatë kësaj periudhe nga 34,1 vjeç në vitin 2010 në 37.1 vjeç në 2017), me fillimin në mënyrë graduale të kalimit të kësaj popullsie nga vitaliteti i saj në shfaqjen e nuancave të orientimit drejt fenomenit të plakjes së popullsisë, të mungesës në të ardhmen të ofrimit të grupmoshës së punës ku spikat rënia e saj dhe pamundësia për të furnizuar tregun e punës me fuqi punëtore, etj.

Të dhënat e ndryshme statistikore që ofrohen nga INSTAT, nëpërmjet publikimeve të ndryshme shfaqin të dhëna mjaft specifike edhe në kuadrin e grupmoshave të ndryshme të popullsisë së vendit tonë. Në këto të dhëna spikasin rënia gjithnjë e më e konsiderueshme e popullsisë moshore të re, ndërsa në anën tjetër një rritje në vazhdimësi e popullsisë së moshës së tretë. Në mënyrë konkrete popullsia deri në moshën 15 vjeç paraqet në mënyrë graduale një rënie në vazhdimësi në kuadrin e totalit të popullsisë së vendit tonë. Statistikat tregojnë një nivel pakësimi me rreth 23 % gjatë periudhës 2010-2017. Pa dyshim ashtu siç theksuam më sipër faktorët kryesorë ndikues janë të lidhur ngusht me rënien e lindshmërisë, por edhe me migrimin, kryesisht atë familjar. Nga ana tjetër popullsia mbi 64 vjeç është shtuar me 24 %, duke rritur ndjeshëm peshën e kësaj popullsie në kuadrin e numrit total të popullsisë shqiptare. Njëkohësisht, një situatë e tillë në grupmoshat e treta, shoqërohet me problematika serioze, ndikues të karakterit social.

Aplikimi i politikave pronataliste të popullsisë. Domosdoshmëria e tyre.

Zhvillimet aktuale me të cilat po përballet popullsia shqiptare nuk janë të reja dhe as të panjohura në kuadrin e zhvillimit të popullsisë sot në botë. Problematika të tilla janë shfaqur në vende dhe shtete të ndryshme të botës, madje në mjaft raste evidentohen edhe ripërsëritje të tyre, ndonëse në

forma dhe përmasa të larmishme. Një gjë e tillë tregon se sa dinamike paraqitet sot evolucioni i popullsisë botërore. Çështjet që kanë të bëjnë me rënien e shtesës natyrore të popullsisë, rënien e lindshmërisë, migrimet dhe shpërndarjen e tyre gjeografike, kanë qenë të pranishme edhe në shtete të tjera evropiane dhe më gjerë në periudha të ndryshme të zhvillimeve të popullsisë në to. Duhet të theksojmë se edhe në këto momente debatet mbi lëvizjet migratore në Evropë dhe më gjerë, efektet në zhvillimet e popullsisë se shteteve të veçanta evropiane, problematikat me shtetas natyrore të popullsisë në këto vende, përfaqësojnë tema të rëndësishme diskutimi në forumet shkencore dhe politike evropiane dhe të këtyre shteteve të veçanta.

Por ajo që e bën mjaft të diskutuar dhe në qendër të vëmendjes në Shqipëri, tematikat mbi popullsinë, janë të lidhura ngusht me realitetin ekonomik-social të vendit tonë. Një realitet i tillë ka ndikuar dukshëm në lindjen dhe zhvillimin e “defekteve” apo problemeve të tilla të popullsisë, të cilat kërkojnë në mënyrë emergjente ndërhyrjen me anë të masave të ndryshme nën petkun e politikave të ndryshme e të larmishme, që janë të pranishme sot në vende të ndryshme të botës mbi popullsinë. Ndaj mendimin me studiues dhe njohës të tjerë të fushës që paraqitet mjaft efikase në kuadrin e ndërhyrjes që duhet realizuar suportimi i elementeve të veçanta të politikave pronataliste të popullsisë me ndikim në rritjen e lindshmërisë dhe shtesës natyrore të saj. Ndërhyrja në këtë drejtim kërkon që të merren në konsideratë drejtimet themelore ndikuese të shprehura në masa dhe akte të përcaktuara ligjore dhe juridike, ekonomike dhe sociale, të cilat duhet të ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në grupe të caktuara sociale të popullsisë, që karakterizojnë moshën fertile të saj. Tërësia e këtyre masave duhet të synojë në mënyrë të menjëhershme në ndikim në drejtim të shtesës natyrore të popullsisë, rritjen e lindshmërisë, frenimin e lëvizjes së konsiderueshme migratore, në mënyrë të veçantë në moshat e reja dhe të mesme të popullsisë, të cilat përfaqësojnë edhe shtresat e rrisht në kuadrin e ndikimit që kanë në shtesën natyrore.

Me interes të veçantë paraqiten sidomos masat e ndryshme të karakterit juridik. Në këtë sistem masash imperative rezultojnë se mund të jenë ato të cilat kanë të bëjnë me realizimin e akteve ligjore e nënligjore, ku të krijohen mundësi më të mëdha suportuese e lehtësuese për çiftet e

reja. Këto akte juridike duhet të synojnë zgjatjen e periudhës së lejelindjes për nënat, pagesën nga shteti të pensioneve sociale për nënat e papuna për një kohëzgjatje 3-vjeçare (derisa fëmijët e tyre të ndjekin institucionet parashkollore) vendosjen e një kuote të caktuar të sanksionuar me akte ligjore në punësimet e ndryshme shtetërore dhe private për familjarët e rinj apo çiftet e reja, etj. Një hap juridik në drejtimin e duhur mund të jetë edhe krijimi i paketave të veçanta fiskale, me anë të të cilave bëhet e mundur krijimi i lehtësirave fiskale për çiftet dhe familjet e reja, madje përjashtimi i tyre nga mjaft taksa, ashtu siç aplikohet për disa kategori sociale të tjera të popullsisë. Hapa të tillë lehtësues do të përbënin një element të një sistemi masash ndikuese dhe suportuese ndaj tyre. Ndërmarrja e akteve të tilla juridike ligjore bën të mundur detyrimin e instancave të ndryshme shtetërore e ato jopublike që të angazhohen për të përmbushur detyrimet përkatëse, lidhur ngusht me çështjet e paraqitura më sipër. Theksojmë se ky sistem masash nuk përbën risi në kuadrin e aplikimit të tyre, për faktin se mjaft prej vendeve evropiane dhe më gjerë i kanë përfshirë në momente të veçanta të historisë së zhvillimeve të popullsisë kur kanë kaluar apo kalojnë situata të ngjshme. Evidentojmë në këtë rast disa prej shteteve nordike apo ato të Evropës Qendrore e më gjerë.

Pa dyshim, ndërmarrja e masave të karakterit ekonomik nga ana e institucioneve shtetërore paraqitet si një nga elementet më të rëndësishme të politikave pronataliste të popullsisë. Tashmë është i njohur fakti dhe argumenti se një nga faktorët kryesorë ndikues në lindshmëri dhe shtesën natyrore të popullsisë është i lidhur ngusht me ekonominë. Njëkohësisht faktori ekonomik paraqitet prioritar në kuadrin e lëvizjes migratore të popullsisë shqiptare. Prandaj ndërhyrja në drejtim të ndërmarrjes së paketave suportuese ekonomike për familjet shqiptare, do të ishte një mundësi për zhvillimin ekonomik të vendit me impakt të drejtpërdrejtë në krijimin dhe hapjen e vendeve të reja të punës, në rritjen dhe fuqizimin e të ardhurave individuale dhe familjare, në shtimin e sigurisë ekonomike të familjeve shqiptare në të ardhmen e tyre.

Aplikimi i këtyre masave ekonomike në vendin tonë do të përbënte një garanci të rëndësishme për të ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në familjet e ndryshme shqiptare e në mënyrë të veçantë tek çiftet e reja. Krijimi i mundësive për punë, përfshirja e çifteve të reja në programet e

ndryshme të punësimit, ndërmarrja e hartimi i vendimeve të ndryshme qeveritare qendrore dhe lokale për të suportuar çiftet e reja në punësim, strehim, kreditim, etj., janë hapa të duhur ndikues dhe të rëndësishëm që do të ndihmonin dukshëm këto grupe sociale që përfshihen në potencialet e rëndësishme të shtimit natyror të popullsisë, duke ndikuar në një element kaq të rëndësishëm siç është lindshmëria. Shembuj në këtë drejtim nuk mungojnë nga ana e disa strukturave vendore, siç është rasti i Bashkisë së Tiranës. Ndonëse në mënyrë sporadike një mundësi e tillë për mbulimin e kostove të kredisë për strehimin e çifteve dhe familjeve të reja, suportimi i tyre në kreditime afatgjata që merren përsipër nga shteti është një hap në drejtimin e duhur.

Krahas tyre me mjaft interes duhet të shihen edhe tërësia e masave sociale, të cilat duhet të përfshijnë një rol dhe kujdes më intensiv social e shëndetësor nga ana e institucioneve përkatëse. Në këtë drejtim mjaft efikase duhet të jenë politikat që synojnë një kujdes më të veçantë për jetën dhe shëndetin e nënës dhe të fëmijës. Problematikat e shfaqura në këtë sektor, vdekshmëria foshnjore mjaft e shprehur apo humbjet e jetës së nënës gjatë apo pas lindjes, ndiejnë nevojën e domosdoshmërisë së ndërhyrjes. Njëkohësisht gjenerimi dhe rritja e objekteve sociale në shërbim të fëmijëve pranë qendrave të punës të nënave ndikon dukshëm në rritjen e cilësisë së jetesës dhe lehtësimin e nënave të reja në kujdesin e tyre për mirërritjen e fëmijëve. Një masë tjetër e rëndësishme, kemi mendimin se duhet të konsistojë në drejtim të një kontrolli më rigoroz dhe strikt në drejtim të klinikave të ndryshme që trajtojnë abortin. Në mjaft raste ndërhyrjet jo të duhura kanë sjellë problematika serioze për të ardhmen e mëmësisë dhe shkak për këtë është bërë gjenerimi i ndërhyrjes për abort në moshat e reja, shoqëruar me praninë në proces të ndërhyrjes diletante dhe jo të specializuara. Kjo gjë ka bërë të mundur krijimin e problemeve serioze për të ardhmen e këtyre grupmoshave për t'u futur në procesin e riprodhimit të popullsisë. Në një situatë të tillë, krijimi i klinikave të posaçme të specializuara, licensimi i tyre dhe kontrolli serioz e rigoroz mbi to, kemi mendimin se paraqitet si një domosdoshmëri e ngutshme.

Padyshim që një tematikë e tillë paraqitet shumë e zgjeruar si në kuadrin e analizës që nevojitet, ashtu edhe në përcaktimin e duhur të masave që duhet të ndërmerren në kuadrin e politikave efikase të

domosdoshme për ndërhyrje. Prandaj shprehim mendimin e riaktivizimit të politikave pronataliste në këtë fazë të zhvillimeve që kanë prekur popullsinë e vendit tonë.

PERFUNDIME

Materiali i paraqitur më sipër bart në vetvete edhe mundësinë që të konturohen disa përfundime kryesore në lidhje me situatën aktuale të zhvillimeve të popullsisë në Shqipëri dhe tendencën e saj në të ardhmen. Në tërësinë e tyre, përfundimet që do të paraqesim më poshtë, shtrojnë përpara studiuesve e hulumtuesve shkencorë si dhe strukturave të pushtetit qendror dhe lokal, domosdoshmërinë e reagimit të shpejtë në lidhje me masat dhe politikat që duhet të aktivizohen në drejtim të çështjeve problematike që po shfaq në këto momente popullsia e vendit tonë.

Një nga përfundimet më të rëndësishme ka të bëjë me faktin se tashmë popullsia shqiptare është përfshirë nga dy momente të rëndësishme dhe mjaft problematike në ecurinë e saj. Kjo popullsi gjithnjë e më tepër po karakterizohet nga ritme mjaft të ulëta të shtesës natyrore të popullsisë, me një tendencë mjaft të shprehur rënëse të lindshmërisë. Nga ana tjetër një tipar tjetër mjaft i spikatur është se në vazhdimësi gjatë dekadës së dytë të shekullit XXI popullsia shqiptare po tkurret në numrin e saj nga njëri vit në tjetrin.

Faktorët kryesorë ndikues janë të larmishëm. Por ndërmjet tyre më evidentët janë të lidhur ngushtësisht me migrimin e popullsisë shqiptare gjatë kësaj periudhe, në të cilin pesha kryesore i takon moshës së re dhe asaj të mesme, të cilët bëjnë të mundur shfaqjen e një mungese të theksuar të kësaj moshe fertile në lindshmëri. Gjithashtu, faktorë të tjerë mjaft evidentë, paraqiten ato që kanë të bëjnë me elementet sociale, ekonomike dhe politike, të cilët në mënyrë të harmonizuar po frenojnë proceset reale që lidhen me shtesën natyrore të popullsisë, duke ndikuar në krijimin e një ankthi apo pasigurie tek grupet sociale predominante me ndikim në lindshmëri.

Është e nevojshme hapja e një debati të gjerë publik në lidhje me çështje të tilla madhore për të ardhmen e vendit, siç është tematika e

popullsisë në situatën aktuale. Përfshirja e aktorëve të ndryshëm, qeveritarë, ekspertë dhe studiues, do të krijojë mundësinë e një analize të gjerë dhe të detajuar të faktorëve, shkaqeve dhe pasojave që kanë bërë të mundur një situatë të tillë në zhvillimet aktuale të popullsisë shqiptare. Njëkohësisht një debat i tillë do të shenjojë edhe tendencën në zhvillimet e kësaj popullsie, lidhur ngusht edhe me planin e masave për veprim në kuadrin e politikave mbi popullsinë.

Jemi të mendimit se paraqitjet e domosdoshme, përfshirja e popullsisë shqiptare nën efektet e aplikimit të menjëhershëm të masave emergjente nën politikën pronataliste të popullsisë. Politika të tilla pronataliste ndjejnë nevojën e aplikimit të masave të ndryshme e të larmishme të karakterit juridik, ekonomik dhe social. Nën efektin e këtyre masave, aplikimin e shpejtë me anë të ndërhyrjeve intensive, zbatimin të tyre hap pas hapi, besojmë e shpresojmë drejt orientimit të shfaqjes në të ardhmen të tendencave pozitive në zhvillimin e popullsisë së vendit tonë.

LITERATURA:

- Axhemi, Sokol: *Nevoja e aplikimit të politikave të reja për popullsinë*. Gazeta Panorama, 28 shkurt 2018
- Axhemi, Sokol: *Gjeografia e popullsisë dhe vendbanimeve*, Tekst mësimor universitar, Tiranë, 2007.
- Axhemi, Sokol: *Migracioni shqiptar i vitit 2015. Faktorët, karakteristikat dhe tendencat e tij*. Buletini i Shkencave të Natyrës. Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, 2017.
- Barjaba, K.: *Shqiptarët këta ikës të mëdhenj. Ese dhe shkrime për emigrimin*, Tirana: Korbi, 2003.
- Beqaj, Ilir: *Lindjet, vdekjet, martesat dhe divorcet: Analiza tronditëse në shifra e Shqipërisë së sotme*. Javanews.al 09 mars 2018
European Migration Network (EMN): www.emn.ie
INSTAT Të dhëna të ndryshme statistikore mbi popullsinë www.instat.gov.al
Instituti për politikën e migracionit: www.migrationinformation.org
World Bank. Albania Interim poverty reduction strategy paper, may 2000. The contribution of human.
Resources development to migration policy. ETF December, 2007.

Population Policies in Albania. The Current Situation and Trends

ABSTRACT

Different issues and themes on the population and its elements are quite present in recent days and months in our country. Especially the decline in the number of births and the shrinkage of the Albanian population during these years, and especially the latest data at the beginning of 2018, has prompted not only the need for a public debate but also the urgency and necessity of taking into account of the effects and consequences with which these processes of Albanian population development are associated. Now, the numerous statistics and statistics provided by INSTAT show an "immediate alarm" to consider reactivating population policies, in particular pronatalist policies, with an efficient system of necessary intervention measures. Reactivating such policies is urgent, aiming at an increase in the number of births and natural additions of the Albanian population in the future. Indifference to such policies, the lack of seriousness to address and analyze these issues, the omission of measures to be taken, adds to the "SOS" alarm for the future of population developments in our country. The signals from year to year, quarter to quarter, month to month, appear to be gloomy, as well as the most optimistic demographic projections convey doubts about the future of the "vitality" of our nation's population.

In the following material we try to present a general analysis of the current situation of population development in our country. In addition to this, we have made our efforts to highlight the relevant influencing factors associated with the direct effects in the natural growth of the Albanian population, the migratory movements of this population and its components. We also aim to give our opinion on the future trends of the Albanian population, along with some necessary suggestions for the moment, closely related to the application of the policies of the population. The material is equipped with tables, graphs and statistics in order to

concretise the different situations and elements that have to do with the Albanian population of this period we are analyzing.

Key words: population, migration, birth, policies.

RECENSION

ELENI KARAMITRI: “*SHQIPTARË NË LIRI. DIASPORA SHQIPTARE NË AMERIKË*”

(Studime letrare, dëshmi, bibliografi)

Ky botim i ri i shtypshkronjës Volaj, Shkodër, 2017, është një ngulmim shkencor karakteristik për autoren e shtatë veprave të thukëta studimore; përndryshe një vazhdim i drejtpërdrejtë i librit të saj “*Zëra nga diaspora*”, botuar plot një dyzinë vitesh më parë. Në këtë distancë kohore, ajo e ka strukturuar veprën e re ndryshe, duke e plotësuar me informacion kulturor më të thellë përsa i përket ndihmesës përtej një shekulli të figurave më të spikatura të shqiptarëve, që kanë jetuar suksesshëm apo që vepronjë intensivisht në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Prandaj studimet letrare të Karamitrit, ndjekin njëra–tjetrën si kuadrot e një filmi me ekran të gjerë, me ngjyra dhe me metrazh të gjatë.

Në kapitullin e parë autorja, znj.Eleni, ka zbërthyer çelësin etimologjik të mbarë problematikës: *Diaspora shqiptare–tërësia e bashkësive shqiptare të vendosura në kohë dhe në vise të ndryshme jashtë e larg trojeve etnike*. Ajo parashtron teorikisht çështjet e trajtuara rrallë apo pjesërisht nga autorët e tjerë, si: *Dukuri në letërsinë e diasporës; Kritere të mundshme për klasifikim; Letërsia e diasporës ende e pastudiuar; Diaspora shqiptare për kulturën e gjuhës*.

Në kapitullin e dytë trajtohen portrete dhe profile figurash poliedrike, si: Faik Konica, Fan Noli, Arshi Pipa, Stavre Frashëri, Sami Repishti; përmes dy teknikave: asaj të monografive në miniaturë dhe asaj të eseve seriale.

Kapitulli i tretë Refleksione, parashtron mendimet e prof. Shefik Osmanit e prof. Jup Kastratit, si dhe analizon hollësisht punën e gjatë e të palodhur të prof. Petër Priftit.

Në kapitullin e katërt, vlerësimet për veprën mozaik të P. Priftit, dalin drejtpërdrejt nëpërmjet epistolarit selektiv të intelektualëve: At Artur Liolin, z. Nick Pano, z. Kristo Andon Kote, z. Anton Çefa.

Në *Epilog*, studiuësja, sa risjell në kujtesë shpërndarjen e hirit të intelektualit të shquar Petër Prifti në atdhe (sipas porosisë së tij të fundit), aq merret me mbledhjen e hirit (në kuptimin tashmë të bukurisë), të punës së tij të pamort.

238 faqet e librit me peshë malli “*Shqiptarë në liri. Diaspora shqiptare në Amerikë*”, para se të fiksoheshin në laptopin personal të autores, kanë prekur tastet e shpirtit të saj me dinjitetin kombëtar. Një pjesë e temave, është shkruar në Universitetin e Shkodrës *Luigj Gurakuqi*, mbas diskutimeve me kolegët e saj pedagogë dhe mbas *eksperimentimeve* tek tezat e studentëve të saj gjatë diplomave të masterit profesional apo punimeve të masterit shkencor. Një pjesë është shkruar në bibliotekën e kryeqytetit, pranë njohësve të stilit të saj: Prof. dr. Stefan Çapalikut, prozator e dramaturg modern dhe prof. dr. Tefë Topallit, ekspert i gjuhësisë së tekstit, si dhe pranë frymëzuesit e vlerësuesit të angazhimit të kahershëm, konsulentit dhe bashkëshortit, dr. Petri Karamitri. Një pjesë është ideuar në qiell, në sedilet e avionëve me fitim kohe, në praninë e stuardesave të huaja dhe të bashkatdhetarëve tranzit. Një pjesë është realizuar kur ka shkelur kontinentin e ri tej oqeanit, atje ku kultivohet shqipja e mrekullueshme nga personalitete frymëzuese, si: Sami Repishti, apo nga përfaqësues shkencorë më të rinj të antropologjisë sonë kulturore. Paraqitëm vetëm majën e ajsbergut nga vepra më e re e prof. dr. Eleni Karamitrit, për t’ua lënë studiuesve, studentëve dhe lexuesve të interesuar ndaj tematikës së diasporës, që edhe përmes bibliografisë mjaft të pasur e orientuese, ta zbulojnë plotësisht këtë libër letrar e shkencor me peshë të pamatshme malli.

Alfred Çapaliku

Artan HAXHI
Mimoza PRIKU
Alfred ÇAPALIKU

**BIBLIOGRAFI KRONOLOGJIKE E PUBLIKIMEVE
TË PROF. DR. KOLË ASHTËS
(1936 - 2017)**

a. Përkthime :

1. GIUSTI, G(iuseppe), (përktheu Shkaba³⁹⁶): *Uratë (poezi)*, revista "Leka", fëruer, VIII/1936, nr. 2, f.69.
2. CHIABERRA, G. (përktheu Shkaba): *Nji gaz i bukur (poezi)*, revista "Leka", prill, VIII/1936, nr. 4, f. 167.
3. PUSHKIN, A(leksandër), (përktheu Shkaba), *Lulja(poezi)*, revista "Cirka", Shkodër, 19 korrik, 1936, nr.3, fq. 67.
4. Monti, V(incenzo), (përktheu Shkaba) *Shkurtësija e jetës(poezi)*, revista "Cirka", Shkodër, 1937, nr.16, fq. 23.
5. PASCOLI, G(iovanni), (përktheu Shkaba) *Qeni(poezi)*, revista "Cirka", Shkodër, 17 tetuer, 1937, nr.32, fq. 267.
6. FUCINI, Renato (përktheu dr. Kolë Ashta) *Baba im (tregim)*, revista "Shkëndija", Tiranë, maj III/1943, nr. 7 (31), f. 31-33.

b. Poezi origjinale :

1. SHKABA: *Poezija e rinis*, revista "Cirka", Shkodër, 16 gusht 1936, nr.7, fq. 99.
2. SHKABA: *Kështjelli i Shkodrës*, revista "Cirka", Shkodër, 1936, nr.11, fq. 166.
3. SHKABA: *Natë dimni*, revista "Cirka", Shkodër, 17 fruer, 1937, nr.17, fq. 45.
4. SHKABA: *Mari!*, revista "Lajmtari i zemrës së Krishtit", V. 47, majë, Shkodër nr. 5 /1937, f. 157.
5. SHKABA: *Naten*, revista "Cirka", Shkodër, 17 tetuer, 1937, nr. 32, fq. 267.
6. SHKABA: *Rapsodi e malit*, revista "Cirka", Shkodër, 27 nanduer, 1937, nr.33-34, fq. 267.

³⁹⁶ SHKABA – është pseudonimi që përdor Kolë Ashta në krijimtarinë e tij letrare ose si përkthyes, por edhe në ndonjë artikull.

7. SHKABA: *Vjollcës*, revista "Cirka", Shkodër, 10 prill, 1938, nr.43, fq. 94.
8. SHKABA: *Kur të kalojë dimni*, revista "Cirka", Shkodër, 28 qershter, 1939, nr.58, fq. 34.
9. ASHTA, Kolë: *Due*, gazeta "Rinija fashiste", Shkodër, 10 korrik 1940, f. 2.
10. ASHTA, Kolë: *Melodi e venitur*, gaz. "Rinija fashiste", Shkodër, 17 korrik 1940, f. 2.

c. Artikuj letrarë dhe gjuhësorë:

1. SHKABA: *Pse shkruetj?*, revista "Cirka", Shkodër, 31 gusht, 1938, nr.51-52, fq. 226.
2. SHKABA: *Nji poetë*, revista "Cirka", Shkodër, 1938, nr.55, fq. 289.
3. ASHTA, Kolë: *Për një kritikë të poezis*, gaz. "Drita", Tiranë, 12 janar 1939, f. 3.
4. ASHTA, B., Kolë: *Dy fjalë mbi poezin*, gaz. "Jeta e re", Vlorë, 23 mars 1939, nr. 182, f. 2.
5. ASHTA, B., Kolë: *Prohujsoni i "Epikës Popullore" në katedren e Gjuhës Shqipe në Romë nga Prof. E. Koliqi*, "Hylli i Dritës", Shkodër, marc-korrik, XV/1939, nr. 3-7, f. 345-348.
6. ASHTA, Kolë: *Hulumtime n'letërsin t'onë kombtare*, gaz. "Rinija fashiste", Shkodër, 31 korrik 1939, nr, 39, f. 2.
7. ASHTA, Kolë: *Poezija popullore*, gaz. "Fashizmi", Tiranë, 3 shtator 1939, f. 4.
8. ASHTA, Kolë: *Personaliteti poetik i Koliqit*, gaz. "Rinijafashiste", Shkodër, 4 shtatuer 1939, f. 3.
9. ASHTA, Kolë: *"Andrra e jetës"* (studim letrar mbi poemën e Ndre Mjedës), rev. "Numero unico degli studenti albanesi", XIV, Aprile, Firenze 1940.
10. ASHTA, Kolë: *Bota lirike e Prennushit*, "Hylli i Dritës", Shkodër, korrik-shtatuer, XVI/1940, nr. 7-8-9, f. 373-376.
11. ASHTA, Kolë: *Fejesa n'djep a se Ulqini i marrun*, gaz. "Rinija fashiste", Shkodër, 31 korrik, 1940, f. 2.
12. ASHTA, Kolë, B.: *Shpirti shqiptar n'epikën kombtare*, "Shkëndija", Tiranë, gusht, 1/1940, nr. 2, f. 36-40.
13. ASHTA, Kolë, B.: *"Korbi"* (analizohet dhe vlerësohet poezia "Korbi" e Edgar Poe dhe përkthimi mjeshtëror i saj prej F. Nolit), "Shkëndija", Tiranë, tetor, 1/1940, nr. 4, f. 53-55.

14. ASHTA, Kolë: *Nji vegim i poezisë italo – shqiptare*, (Artikull shkencor mbi poezinë arbëreshe). Gaz. “Rinija fashiste”, Shkodër, 28 nanduer 1940, f. 4.
15. ASHTA, Kolë: *Rrmuesi i shpirtit shqiptar (P. Shtjefën Gjeçovi)*, “Shkëndija”, Tiranë, fruer-mars, I/1941, nr. 8-9, 58-60.
16. SHKABA: **Ajo kanga e helmatisun*, “Shkëndija”, Tiranë, korrik, II/1941, nr. 1, f. 5.
17. ASHTA, Kolë: *Gjergj Elez Alija*, “Shkëndija”, Tiranë, korrik, II/1941, nr. 1, f. 32-36.
18. ASHTA, Kolë: *“Rozafa” e D.Ndré Zadëjës*, “Shkëndija”, Tiranë, gusht-shtatuer, II/1941, nr. 2-3, f. 90-94.
19. ASHTA, Kolë: *Prodhimi dramatik i Fishtës*, përmbledhja “Gjergj Fishta”, botuar nën kujdesin e revistës “Shkëndija”, shtëpia botuese “Luarasi”, Tiranë, 1941, f. 77-83.
20. ASHTA, Kolë: *“Vaji i bylbylit”* (studim letrar mbi poemën e Ndre Mjedës), “Shkëndija”, II, kallnduer – fruer, nr. 7 – 8/1942, f. 274-277.
21. ASHTA, Kolë: *Nji odë klasike e Mjedjes* (studim letrar), rev. “Kumbona e së Diellës”, Shkodër, nr. 31, 2 gusht 1942, f. 376-378.
22. ASHTA, Kolë: *Nji vegim i veprimtaris letrare të nji shkrimtari shqiptar. Kolë Thaçi (I)* (studim letrar), rev. “Kumbona e së Diellës”, Shkodër, nr. 36, 6 shtator 1942, f. 443-444;
23. ASHTA, Kolë: *Nji vegim i veprimtaris letrare të nji shkrimtari shqiptar. Kolë Thaçi (II)* (studim letrar), rev. “Kumbona e së Diellës”, Shkodër, nr. 37, 13 shtator 1942, f. 446-447;
24. ASHTA, Kolë: *Nji vegim i veprimtaris letrare të nji shkrimtari shqiptar. Kolë Thaçi (III)* (studim letrar), rev. “Kumbona e së Diellës”, Shkodër, nr. 38, 20 shtator 1942, f. 457-458.
25. ASHTA, Kolë: *Vdekja e një letrari të ri: Gaspër Pali*, rev. “Tempo-Koha”, Romë, 8 tetor 1942, nr. 20, f. 28 - 29.
26. ASHTA, Kolë: *Urdhnimet e poezis*, gaz. “Balli i rinisë”, Tiranë, 5 dhetuer 1942, nr. 1, f. 3.
27. ASHTA, Kolë: *Përmbajtja epike e “Lahutës së Malcis”* (studim letrar – pjesë nga laura universitare mbi kryeveprën e Gjergj Fishtës), rev. “Tempo – Koha”, Romë, nr. 25, 17 dhetor 1942, f. 31; Milano nr. 30, 25 shkurt 1943, f. 32; Milano, nr.31, 25 mars 1943, f. 32.
28. ASHTA, Kolë: *“Lahutae Malcis” në nji vegim*, gaz. “Balli i rinisë”, Tiranë, 15kallnuer 1943, nr. 3, f. 3.
29. ASHTA, Kolë: *“I tretuni” i Ndré Mjedës*, “Shkëndija”, Tiranë, kallnduer, III/1943, nr.3, f. 26-33.

30. ASHTA, Kolë: *28 fruer 1903*, (artikull shkencor mbi De Radën), gaz. “Balli i rinisë”, Tiranë, 28 fruer 1943, f. 1.
31. ASHTA, Dr. Kolë: *Tingëllime të jetës shqiptare: Tue përkujtue katërdhjetë vjetorin e vdekjes së Hjeronym De Rades, ndihmestari i Rilindjes letrare e kombtare*, “Shkëndija”, Tiranë, fruer, III/1943, nr.4, f. 32-34.
32. ASHTA, Kolë: *Shenjime rreth epikës së Hjeronym de Radës*, “Tomori i vogël”, viti II, nr. 5, XXI, 1 mars, 1943, fq. 1-2.
33. ASHTA, Kolë: *Në botën e librave* (Aleksandër Manzoni, “*Të fejuemit*”, përkth. i At Mark Harapi, S.J.), “Shkëndija”, Tiranë, mars, III/1943, nr.5, f. 46-48.
34. ASHTA, Dr. Kolë: *Ndieshmënia (sensibiliteti) i ré lirike te Nexhat Haku*, “Shkëndija”, Tiranë, prill, III/1943, nr.6, f. 23-26.
35. ASHTA, Kolë: *Përmbajtja epike e “Lahutës së Malcis”*, gaz. “Tomori”, Tiranë, 28 prill 1943, f. 3.
36. ASHTA, Kolë: *Vrojtime mbi poezin e Gjergj Fishtës*, (Artikull shkencor), gaz. “Balli i rinisë”, Tiranë, 31 maj 1943, nr. 12, f. 3.
37. ASHTA, Dr. Kolë: *Treqindvjetori i datëvdekjes së një shkrimtari shqiptar: Fran Bardhi (1606-1643)*, “Shkëndija”, Tiranë, qershuer-korrik, III/1943, nr. 8-9 (32-33), f. 55-57
38. ASHTA, Dr. Kolë: *Dyqindvjetori i veprës së Gjon Nikolle Kazazit*, “Shkëndija”, Tiranë, gusht III/1943, nr. 10 (34), f. 44-45.
39. ASHTA, Dr. Kolë: *Çashtje mbi çashtje*, (bën fjalë për çështjen e kritikës letrare) “Shkëndija”, Tiranë, shtatuer III/1943, nr. 11 (35), f. 1-3.
40. ASHTA, Kolë: *Përmbajtja epike e “Lahutës së Malcis”*, (studim letrar – një pjesë nga thezi i Laurës së shkrimtarit), gaz. “Kosova”, shtatuer, Tiranë, nr. 48-49-50/1943, f. 6.
41. ASHTA, Kolë: *Ngjyra e vendit te Filip Shiroka*, “Revista letrare”, 15 prill, Tiranë, nr. 5/1944, f. 1, 2.
42. a.³⁹⁷: *Një kujtim shokut të vdekun, Gjon Kujxhija*, gaz. “Bashkimi i Kombit”, Tiranë, nr. 138, 14. VI. 1944, viti II, f. 3.
43. O.³⁹⁸: *Mendimet e Gjon Kujxhis mbi vallet shkodrane*, gaz. “Bashkimi i Kombit”, Tiranë, nr. 215, 12. IX. 1944, viti II, f. 3.

³⁹⁷ “Pseudonimia në fund tëshkrimtështë i Kolë B. Ashtës” - shënim i EnoKoço: “*Gjon Kolë Kujxhija, ‘Njëilir i ndezun’*”, FLESH, Tiranë, 2018, fq. 55. Në koleksionin e gazettes “*Bashkimi i Kombit*” të kësaj date, që ndodhet në Bibliotekën e Universitetit të Shkodrës, poshtë artikullit një dorë e kujdesshme (me shumë mundësi e vetë autorit) ka shënuar emrin e Kolë Ashtës.

³⁹⁸ Pseudonimi O. – Kolë Ashta. Nisur nga tematika, veçoritë e gjuhës dhe të stilit

44. ASHTA, Kolë: *Mbi mbledhjen e landës leksikore për fjalorin e madh tëshqipes* (diskutim), “Buletin i shkencave shoqërore”, Tiranë, 1952, nr. 4, f. 95-98.
45. ASHTA, Kolë: *Shënime e vërejtje rreth gjuhës së leksikut të Matrëngës*, “Buletin i shkencave shoqërore”, Tiranë, 1957, nr. 1, f. 83-108.
46. ASHTA, Kolë: *Vokalizmi në veprën “Kuvendi i Arbënit” (1706)*, “Buletin shkencor”, Instituti i Lartë Pedagogjik i Shkodrës, 1957/1, f. 45-54.
47. ASHTA, Kolë: *Tue u ndalë ndër shkrimtarë të veriut nga shek. i XVI në shek. XVIII*, revista “Shkodra”, nr. 1, 1961, f. 181-184.
48. ASHTA, Kolë: *Vëzhgim historik në fjalorin e parë të shqipes, Bardhi 1635*, revista “Shkodra”, 1962, nr. 1, f. 33-64.
49. ASHTA, Kolë: *Leksiku i plotë i veprës së Gjon Buzukut (1555) (I)*, “Buletinshkencor”, Instituti i Lartë Pedagogjik i Shkodrës, viti I i botimit, 1964 (1), f. 97-130.
50. ASHTA, Kolë: *Leksiku i plotë i veprës së Gjon Buzukut (1555) (II)*, “Buletinshkencor”, Instituti i Lartë Pedagogjik i Shkodrës, viti I i botimit, 1964 (2), f. 119-184.
51. ASHTA, Kolë: *Leksiku i plotë i veprës së Gjon Buzukut (1555) (III)*, “Buletinshkencor”, Instituti i Lartë Pedagogjik i Shkodrës, viti II i botimit, 1965 (3), f. 59-96.
52. ASHTA, Kolë: *Në kërkim të anës letrare të Matrëngës*, revista “Shkodra”, 1965, f. 169-188.
53. ASHTA, Kolë: *Pjetër Budi, prozator e vjershëtar*, revista “Shkodra”, 1966, f. 282-302.
54. ASHTA, Kolë: *Rreth disa çështjeve të leksikut të Pjetër Budit*, “Studime filologjike”, 1966/4, f. 159-165.
55. ASHTA, Kolë: *Leksiku i plotë i veprës së Gjon Buzukut (1555) (IV)*, “Buletin shkencor”, Instituti i Lartë Pedagogjik i Shkodrës, viti III i botimit, 1966 (4), f. 27-66.
56. ASHTA, Kolë: *Ndër burime të fjalës së shkrueme të ilirishtes si periudhë e vjetër e historisë së gjuhës shqipe*, “Buletin shkencor”, Instituti i Lartë Pedagogjik i Shkodrës, viti III i botimit, 1966(5), f. 181-207.

mendojmë se ky artikull është shkruar nga Kolë Ashta dhe është vijim i shkrimit të mëparshëm (nr. 41) kushtuar mikut të tij të fëmijërisë Gjon Kujxhija. Gjithashtu edhe poshtë këtij artikulli të botuar në gazetën “*Bashkimi i Kombit*” e njëjta dorë ka shënuar emrin e Kolë Ashtës.

57. ASHTA, Kolë: *Ndër burimet të fjalës së shkrueme të arbënishtes si periudhë e mesme e histories së gjuhës shqipe* (I), "Buletin shkencor", Instituti i Lartë Pedagogjik i Shkodrës, viti IV i botimit, 1967 (6), f. 53-70;
58. ASHTA, Kolë: *Ndër burimet të fjalës së shkrueme të arbënishtes si periudhë e mesme e histories së gjuhës shqipe* (II), "Buletin shkencor", Instituti i Lartë Pedagogjik i Shkodrës, viti V i botimit, 1968(7), f. 61-75.
59. ASHTA, Kolë: *Frang Bardhi shkroi të parën apologji për Skënderbeun më 1636*, revista "Shkodra", 1968, f. 11-22.
60. ASHTA, Kolë: *Neologjizmi dhe vëzhgimi i tij në leksiografinë e sotme*, "Buletin shkencor", Instituti i Lartë Pedagogjik i Shkodrës, viti VI i botimit, 1969 (8), f.83-92.
61. ASHTA, Kolë: *Ndër burime të fjalës së shkrueme të ilirishtes, "Përparimi", Prishtinë*, 1969, nr. 11-12, f. 860-886.
62. ASHTA, Kolë: *Vërejtjet e para për alfabetin e shqipes të botuar më 1716*, në përmbledhjen "Kongresi i Manastirit", Shkodër, 1969, f. 45-48.
63. ASHTA, Kolë: *Fjalorth i vjetit 1497 nga von Harff*, "Buletinshkencor", Instituti i Lartë Pedagogjik i Shkodrës, viti VII i botimit, 1970 (9), f. 47-59.
64. ASHTA, Kolë: *Terminologjia dhe vëzhgimi i saj në leksiografinë e sotme*, "Buletin shkencor", Instituti i Lartë Pedagogjik i Shkodrës, viti VII i botimit, 1970 (9), f.329-340.
65. ASHTA, Kolë: *Leksiku i shqipes nxjerrë nga "Dictionarium Latino-Epiroticum" i Frang Bardhit (1635)* (I), "Buletin shkencor", Instituti i Lartë Pedagogjik i Shkodrës, viti VIII i botimit, 1971/1 (10), f. 139-167.
66. ASHTA, Kolë: *Leksiku i shqipes nxjerrë nga "Dictionarium Latino-Epiroticum" i Frang Bardhit (1635)* (II), "Buletin shkencor", Instituti i Lartë Pedagogjik i Shkodrës, viti IX i botimit, 1972/1 (11), f. 131-155.
67. ASHTA, Kolë: *Gjon Nikollë Kazazi dhe vepra e tij (1743)*(I), "Buletin shkencor", Instituti i Lartë Pedagogjik i Shkodrës, viti IX i botimit, 1972/2 (12), f. 241-265.
68. ASHTA, Kolë: *Gjon Nikollë Kazazi dhe vepra e tij (1743)* (II), "Buletin shkencor", Instituti i Lartë Pedagogjik i Shkodrës, viti X i botimit, 1973/1 (13), f.77-97.

69. ASHTA, Kolë: *Leksiku i shqipes nxjerrë nga "Dictionarium Latino-Epiroticum" i Frang Bardhit (1635)* (III), "Buletin shkencor", Instituti i Lartë Pedagogjik i Shkodrës, viti X i botimit, 1973/2 (14), f. 109-134.
70. ASHTA, Kolë: *Mbi shkrimin e fjalëve me burim latin, që kanë një ct (=kt) të ndjekur nga -io*, në përmbledhjen "Kongresi i Drejtshkrimit të gjuhës shqipe" (20-25 nëntor 1972), Tiranë, 1973, II, f. 263-269.
71. ASHTA, Kolë: *Gjon Nikollë Kazazi dhe vepra e tij (1743)*(III), "Buletin shkencor", Instituti i Lartë Pedagogjik i Shkodrës, viti XI i botimit, 1974/1 (15), f. 122-144.
72. ASHTA, Kolë: *Gjon Nikollë Kazazi dhe vepra e tij (1743)* (IV), "Buletin shkencor", Instituti i Lartë Pedagogjik i Shkodrës, viti XI i botimit, 1974/2 (16), f. 91-111.
73. ASHTA, Kolë: *Mbi shkrimin e fjalëve me burim latin, që kanë një ct (=kt) të ndjekur nga -io*, në përmbledhjen "Kongresi i Drejtshkrimit të gjuhës shqipe", Prishtinë, 1974, f. 371-374.
74. ASHTA, Kolë: *Mbi drejtshkrimin e diftongut ose të togut zanor (të plotë, pa monoftongim), në lidhje me mësimin e gjuhës në shkollë*, në përmbledhjen "Gjuha shqipe dhe letërsia në shkollë", Tiranë, 1974, nr. 2, f. 76-79.
75. ASHTA, Kolë: *Leksiku i nxjerrë nga "Kuvendi i Arbënit" (në botimin e parë më 1706)*(I), "Buletin shkencor", Instituti i Lartë Pedagogjik i Shkodrës, viti XV i botimit 1978/1, f. 81-89.
76. ASHTA, Kolë: *Leksiku i nxjerrë nga "Kuvendi i Arbënit" (në botimin e parë më 1706)*, (II) "Buletin shkencor", Instituti i Lartë Pedagogjik i Shkodrës, viti XV i botimit, 1978, 2, f. 79-86.
77. ASHTA, Kolë: *Leksiku i nxjerrë nga "Kuvendi i Arbënit" (në botimin e parë më 1706)*(III), "Buletin shkencor", Instituti i Lartë Pedagogjik i Shkodrës, viti XVI i botimit 1979/1 (25), f. 149-157.
78. ASHTA, Kolë: *Leksiku i nxjerrë nga "Kuvendi i Arbënit" (në botimin e parë më 1706)*(IV), "Buletin shkencor", Instituti i Lartë Pedagogjik i Shkodrës, viti XVI i botimit 1979, 2 (26), f. 57-69.
79. ASHTA, Kolë: *Leksiku i nxjerrë nga "Kuvendi i Arbënit" (në botimin e parë më 1706)*(V), "Buletin shkencor", Instituti i Lartë Pedagogjik i Shkodrës, viti XVII i botimit 1980/1 (27), f. 29-40.
80. ASHTA, Kolë, *Çështja e pastrimit të shqipes nga fjalët e huaja në zhvillimin e saj e vështruar nga Aleksandër Xhuvani*, në përmbledhjen "Studime për nder të Aleksandër Xhuvanit", Tiranë, 1986, f. 245-250.
81. ASHTA, Kolë: *Leksiku i nxjerrë nga "Kuvendi i Arbënit" (në botimin e parë më 1706)*(VI), "Buletin shkencor", Instituti i Lartë Pedagogjik i Shkodrës, viti XVII i botimit 1980/2 (28), f. 29-37.

82. ASHTA, Kolë: *Leksiku i nxjerrë nga "Kuvendi i Arbënit" (në botimin e parë më 1706)(VII)*, "Buletin shkencor", Instituti i Lartë Pedagogjik i Shkodrës, viti XVIII i botimit 1981/1 (29), f. 35-52.
83. ASHTA, Kolë: *Disa shënime mbi gjuhën e Pjetër Bogdanit (1685)*, "Buletin shkencor", Instituti i Lartë Pedagogjik i Shkodrës, viti XVIII i botimit 1981/2 (30), f. 141-143.
84. ASHTA, Kolë: *Leksiku i nxjerrë nga "Kuvendi i Arbënit" (në botimin e parë më 1706)(VIII)*, "Buletin shkencor", Instituti i Lartë Pedagogjik i Shkodrës, viti XIX i botimit 1982/1 (31), f. 91-113.
85. ASHTA, Kolë: *Leksiku i plotë i shqipes nxjerrë nga "Cuneus Prophetarum" i Pjetër Bogdanit (1685)(I)*, "Buletin shkencor", Instituti i Lartë Pedagogjik i Shkodrës, viti XIX i botimit 1982/2 (32), f. 69-83.
86. ASHTA, Kolë: *Leksiku i plotë i shqipes nxjerrë nga "Cuneus Prophetarum" i Pjetër Bogdanit (1685)(II)*, "Buletin shkencor", Instituti i Lartë Pedagogjik i Shkodrës, viti XX i botimit 1983/1 (33), f. 79-94.
87. ASHTA, Kolë: *Leksiku i plotë i shqipes nxjerrë nga "Cuneus Prophetarum" i Pjetër Bogdanit (1685)(III)*, "Buletin shkencor", Instituti i Lartë Pedagogjik i Shkodrës, viti XX i botimit 1983/2 (34), f. 95-109.
88. ASHTA, Kolë: *Leksiku i plotë i shqipes nxjerrë nga "Cuneus Prophetarum" i Pjetër Bogdanit (1685)(IV)*, "Buletin shkencor", Instituti i Lartë Pedagogjik i Shkodrës, viti XXI i botimit 1984/1 (35), f. 141-186.
89. ASHTA, Kolë: *Leksiku i plotë i shqipes nxjerrë nga "Cuneus Prophetarum" i Pjetër Bogdanit (1685)(V)*, "Buletin shkencor", Instituti i Lartë Pedagogjik i Shkodrës, viti XXI i botimit 1984/2 (36), f. 139-151.
90. ASHTA, Kolë: *Leksiku i plotë i shqipes nxjerrë nga "Cuneus Prophetarum" i Pjetër Bogdanit (1685)(VI)*, "Buletin shkencor", Instituti i Lartë Pedagogjik i Shkodrës, viti XXII i botimit 1985/1 (37), f. 165-183.
91. ASHTA, Kolë: *Leksiku i plotë i shqipes nxjerrë nga "Cuneus Prophetarum" i Pjetër Bogdanit (1685)(VII)*, "Buletin shkencor", Instituti i Lartë Pedagogjik i Shkodrës, viti XXII i botimit 1985/2 (38), f. 165-189.
92. ASHTA, Kolë: *Leksiku i plotë i shqipes nxjerrë nga "Cuneus Prophetarum" i Pjetër Bogdanit (1685)(VIII)*, "Buletin shkencor", Instituti i Lartë Pedagogjik i Shkodrës, viti XXIII i botimit 1986/1 (39), f. 179-193.

93. ASHTA, Kolë: *Leksiku i plotë i shqipes nxjerrë nga "Cuneus Prophetarum" i Pjetër Bogdanit (1685)*(IX), "Buletin shkencor", Instituti i Lartë Pedagogjik i Shkodrës, viti XXIII i botimit 1986/2 (40), f. 161-181.
94. ASHTA, Kolë: *Leksiku i plotë i shqipes nxjerrë nga "Cuneus Prophetarum" i Pjetër Bogdanit (1685)*(X), "Buletin shkencor", Instituti i Lartë Pedagogjik i Shkodrës, viti XXIV i botimit 1987/1 (41), f. 151-167.
95. ASHTA, Kolë: *Leksiku i plotë i shqipes nxjerrë nga "Cuneus Prophetarum" i Pjetër Bogdanit (1685)*(XI), "Buletin shkencor", Instituti i Lartë Pedagogjik i Shkodrës, viti XXV i botimit 1988/1 (43), f. 195-207.
96. ASHTA, Kolë: *Leksiku i plotë i shqipes i nxjerrë nga "Cuneus Prophetarum" i Pjetër Bogdanit (1685)*(XII), "Buletin shkencor", Instituti i Lartë Pedagogjik i Shkodrës, viti XXVI i botimit, 1989/1 (45), f. 151-165.
97. ASHTA, Kolë: *Leksiku i plotë i shqipes i nxjerrë nga "Cuneus Prophetarum" i Pjetër Bogdanit (1685)*(XII), "Buletin shkencor", Instituti i Lartë Pedagogjik i Shkodrës, viti XXVI i botimit, 1989/2 (46), f. 181-191.
98. ASHTA, Kolë: *Neologjizmat e Kristoforidhit*, "Studime filologjike", 1990/2, f. 113-142.
99. ASHTA, Kolë: *Pasqyrimi i punës për hartimin e leksikut të gjuhës shqipe*, "Buletin shkencor" (seria e shkencave shoqërore), Universiteti i Shkodrës, viti XXVII i botimit 1994, (47), f.7-22.

d. Monografi :

1. ASHTA, Kolë: *Leksiku historik i gjuhës shqipe*, vëllimi I, (Tri dokumentet e para të gjuhës shqipe (gjysma e dytë e shekullit XV); Gjon Buzuku dhe leksiku i plotë, nxjerrë nga vepra "Meshari", 1555), Shkodër, 1996 (ribotim 2000), 496 faqe.
2. ASHTA, Kolë: *Leksiku historik i gjuhës shqipe*, vëllimi II, (Lekë Matrënga dhe leksiku, nxjerrë nga vepra (1592); Pjetër Budi dhe leksiku, nxjerrë nga vepra (1618, 1621), "Toena", Tiranë, 1998, 311 faqe.
3. ASHTA, Kolë: *Leksiku historik i gjuhës shqipe*, vëllimi III, (Pjetër Mazrreku dhe leksiku, nxjerrë nga vepra e tij (1633); Frang Bardhi dhe leksiku, nxjerrë nga vepra (1635)), Shkodër, 2000, 303 faqe.

4. ASHTA, Kolë: *Leksiku historik i gjuhës shqipe*, vëllimi IV, (Pjetër Bogdani dhe leksiku i plotë i shqipes, nxjerrë nga vepra “Cuneus Prophetarum”; Onomastika e plotë, nxjerrë nga pjesa e shqipes (1635)), Shkodër, 2002, 457 faqe.
5. ASHTA, Kolë: *Leksiku historik i gjuhës shqipe*, vëllimi V, (Kuvendi i Arbnit (1706); Leksiku, nxjerrë nga Gramatika e parë e shqipes e Da Leçes; “Vërejtje gramatikore në gjuhën shqipe”, botuar më 1716) Shkodër, 2009, 287 faqe.
6. ASHTA, Kolë: *Leksiku historik i gjuhës shqipe*, vëllimi VI, (Gjon Nikollë Kazazi dhe vepra e tij (1743); Jul Variboba dhe vepra e tij (1762)), Shkodër, 2012, 300 faqe.
7. ASHTA, Kolë: *Leksiku historik i gjuhës shqipe*, vëllimi VII, (Leksiku i shqipes, nxjerrë nga “Fjalori greqisht-vllahisht-shqip” i Theodor Kavaliotit-Voskopjarit (1770); Dhanil Haxhiu-Voskopjari dhe “Fjalori...” i tij (1802), Leksiku i shqipes, nxjerrë nga përkthimi i Vangjel Meksit-Labovitit, botuar më 1824), Shkodër, 2018, 602 faqe.

e. Dorëshkrime :

1. ASHTA, Kolë: *Fjalori i plotë i nxjerrun nga shkrimet e Ndre Mjedës dhe rimari*, Shkodër, 1955, 655 faqe.
2. ASHTA, Kolë: *Neologjizmat e Kristoforidhit*, fletore 74 faqe.
3. ASHTA, Kolë: *Mbi mbledhjen e lëndës leksike për Fjalorin e madh të gjuhës shqipe*, i daktilografuar 8 faqe.
4. ASHTA, Kolë: *Neologjizmat ndër shkrimet e Kristoforidhit. Fjalori i neologjizmave dhe studimi i tyre*, i daktilografuar 84 faqe.
5. ASHTA, Kolë: *Mbi neologjizmat e Kristoforidhit*, i daktilografuar 33 faqe.
6. ASHTA, Kolë: Skeda A-Z, 4862 skeda (shënim: Nga fjalori i Kolë Ashtës mungojnë skeda për geramat: k, l, ll, m, n, o, p, q. Skedat shoqërohen me një letër të autorit).

* * *

**NEKROLOGJI
MAHIR HOTI
1948 – 2018**



Më 07. 04. 2018, në moshën 70- vjeçare, ndërron jetë një ndër emrat e spikatur të fushës së arsimit shqiptar, prof. dr. Mahir Hoti, një nga intelektualët më të shquar të viteve të fundit. Prof. dr. Mahir Hoti për 8 vjet me radhë (2000 – 2008) ishte rektor i Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”. Ai do të kujtohet për kontributin e tij për arsimin, për mjedisin, por edhe si një veprimtar shoqëror i spikatur.

Prof. dr. Mahir Hoti lindi në 15 janar 1948, në një familje të vjetër shkodrane. Në vitin 1970 ai kryen studimet në Universitetin e Tiranës, dega Histori - Gjeografi. Punon si arsimtar në nivelet e ndryshme të arsimit përmbi 35 vjet, duke kryer detyrat e ndryshme: Më 1971-1972, mësues në shkollën e mesme të përgjithshme “28 Nëntori”; në vitet 1972-1975, pedagog në Institutin e Lartë Pedagogjik Shkodër (sot Universiteti “Luigj Gurakuqi”); në vitet 1978-1982, kryeinspektor i arsimit në rreth dhe më pas pedagog në Universitetin e Shkodrës dhe në periudhën 2000-2008, rektor i këtij institucioni. Prof. dr. Mahir Hoti është përzgjedhur në listën e 100 arsimtarëve më të mirë të botës në vitin 2006. Emri i tij do të renditej në sallat e Qendrës Ndërkombëtare të Biografive në Cambridge të Anglisë, përkrah shumë personaliteteve të tjera nga i gjithë globi, që kanë dhënë një kontribut të vyer në fushën e arsimit. Gjatë kohës së drejtimit të tij, Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, është ngritur në një stad më të

lartë procesi të mësimdhënies, përmirësim infrastrukture, ndërsa janë nënshkruar shumë marrëveshje bashkëpunimi me universitete të ndryshme të Ballkanit dhe të Evropës.

Kontributi i prof. dr. Mahir Hotit në fushën shkencore për departamentin e gjeografisë, të cilin e drejtoi për më se 8 vjet me radhë, ishte si lektor i mjaft lëndëve bazë, hartues i planeve e programeve mësimore dhe organizator i shumë konferencave shkencore e workshopeve, të cilat ndikuan në rritjen e prestigjit dhe të pozicionit të kësaj strukture akademike në kuadrin e Universitetit “*Luigj Gurakuqi*” të Shkodrës. Një ndihmesë të madhe dha edhe në themelimin dhe në zhvillimin e Seminarit Ndërkombëtar “*Shkodra në shekuj*”, ku ai për mjaft vite ishte bashkorganizator dhe drejtues i seksionit të gjeografisë. Njëkohësisht në karrierën prej mëse 8 vjetësh si Rektor i Universitetit të Shkodrës “*Luigj Gurakuqi*”, prof. Mahiri punoi me vullnet e përkushtim për t’i dhënë rolin dhe vizionin që duhej të kishte si universitet bashkëkohor. Së bashku me stafin e tij akademik ai inicoi hapjen e degëve dhe të strukturave të reja universitare, krijoi disa programe kërkimore, punoi për lidhjen e marrëveshjeve e të protokolleve të përbashkëta të bashkëpunimit me universitete homologe në Evropë e më gjerë, duke ndikuar në pasurimin e përmbajtjes së këtij institucioni të nderuar të Shkodrës e të dijes sonë kombëtare.

Kontributi dhe prania e prof.dr. Mahir Hotit do t’i mungojë botës akademike, kolegëve, miqve e bashkëpunëtorëve. Ai ka lënë një kontribut të madh me karrierën e tij për qytetin e Shkodrës. Ndarja nga jeta e tij është një humbje e madhe për familjarët, miqtë e dashamirët e shumtë, për kolegët dhe për mbarë hapësirën akademike.

Ervis Krymbi

NEKROLOGJI
HASAN LEKAJ
(1940-2018)



Lindi në Shkodër më 01.06.1940. Shkollën mesme e mbaroi në gjimnazin “28 Nëntori” në Shkodër. Në vitin 1965 diplomohet në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, në degën e Gjuhës Shqipe dhe të Letërsisë. Në vitet 1959-1960 punon në Institutin Pedagogjik dyvjeçar me detyrën sekretar i korrespondencës dhe bibliotekar. Gjatë periudhës 1966-1975 ishte mësues i letërsisë në Gjimnazin “28 Nëntori” në Shkodër dhe në vazhdim pedagog në Universitetin “Luigj Gurakuqi”,

deri në vitin 2010, ku ligjëron si titullar lëndët: *Letërsia Bashkëkohore Shqipe* dhe *Letërsia Bashkëkohore Ballkanike*; ndërsa me ndërprerje ka ligjëruar *Letërsinë e huaj shek. XVIII-XIX*; *Letërsinë për fëmijë*; *Metodikën e leximit dhe të Letërsisë*.

Në vitet 1992-1996 dhe 1998-2002 ishte përgjegjës i sektorit të Letërsisë Shqipe në Katedrën e Letërsisë. Në vitet 2003-2008 ishte Drejtor i Departamentit të Letërsisë. Në periudhën korrik-gusht të vitit 1996 kryen një kurs kualifikimi në Universitetin e Kozencës, Itali.

Ishte pjesëmarrës aktiv në veprimtaritë shkencore dhe pedagogjike në shkallë kombëtare dhe ndërkombëtare. Bashkautor i tekstit “*Letërsia e huaj e shekullit XX*”. Ka botuar mbi 150 studime dhe artikuj kritikë në revistat periodike shkencore, njëkohësisht ka udhëhequr 76 tema diplome. Si botues ka redaktuar rreth 200 studime, monografi dhe përmbledhje kritike të veprave letrare.

Në vitet 1966-1973 drejton Almanakun letrar “*Shtigje të çeluna*”. Ishte anëtar i redaksisë së Almanakut “*Shkodra*”. Nga viti 1967 deri në

vitin 2007 ishte anëtar i Këshillit artistik në Teatrin “*Migjeni*”. Në vitet 1992-2000 zgjidhet nënkryetar i “*Shoqatës kombëtare për mirëkuptim dhe paqe*” të cilën e përfaqëson në Athinë, Moskë, Tivat etj. Nga viti 1996-2008 ishte anëtar i “*Mensa International*” me qendër në Londër. Nga viti 1994 deri në vitin 2018 ishte kryetar i Shoqatës Kulturore “*Camaj-Pipa*” dhe drejtues i entit të saj botues. Mori pjesë në panairot e librave të zhvilluara brenda vendit dhe në Kosovë, Maqedoni e Mal të Zi. Gjithashtu ishte dhe kryetar i shoqatës së pakicës kombëtare malazeze “*Duklja*”. Si njohës i gjuhëve sllave mori pjesë me ligjërime dhe si përkthyes në tubimet që zhvilloheshin në Beograd e Podgoricë. Ishte dashamirës i madh i librit. Krijoi bibliotekën e vet personale me mbi 13000 tituj librash dhe mbi 12 botime periodike. Është dekoruar me Urdhrin “*Naim Frashëri*” të klasit të tretë dhe me “*Mirënjohjen e Universitetit Luigj Gurakuqi*” më 26.10. 2012. Prof. Hasan Lekaj ishte dhe mbetet adhurues dhe përçues i artit të fjalës, një nga pedagogët më të shquar të letërsisë. Ai përcolli për vite me radhë shumë breza studentësh në këtë universitet, të cilëve përmes punës së tij të pasionuar u ngjizi dashurinë për letërsinë dhe profesionin e mësuesit. Puna e tij e përkushtuar do të kujtohet gjatë jo vetëm nga ne kolegët e tij, por edhe nga krijuesit e këtij qyteti e më gjerë, të cilët ai i mbështeti përmes promovimit dhe botimeve të krijimtarisë së tyre. Ishte modeli i punës së palodhur dhe të dobishme në shërbim të letërsisë dhe kulturës. Ai la një emër të mirë edhe në bashkëpunimet e ndryshme që ka pasur Departamenti i Letërsisë me institucione të tjera të arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit.

Vinçens Marku, Gëzim Puka

**NEKROLOGJI
KOLEC TOPALLI
(1938 – 2018)**



Më 24 maj 2018, në moshën 80-vjeçare ndërron jetë akademiku Kolec Topalli, gjuhëtar i njohur, profesor dhe “*Mësues i Popullit*”.

Lindi në Shkodër më 4 dhjetor të 1938-ës, në një familje fisnike qytetare shkodrane. U shkollua dhe u formua në qytetin e lindjes dhe në kryeqytet, ku kreu studimet e larta në degën Gjuhë shqipe – Letërsi të

Universitetit Shtetëror të Tiranës.

Në vitet e regjimit komunist, për shkak të prejardhjes së tij, kaloi një jetë të vështirë, plot privime. Punoi si mësues për 36 vjet me radhë në Kukës, Lezhë, Gramsh e Krujë e më pas, me ndryshimet demokratike, për plot 15 vjet radhazi (1994 - 2009), si pedagog i gjuhësisë historike në Fakultetin e Histori – Filologjisë të Universitetit të Tiranës. Ai qe Sekretar i përgjithshëm i Presidentit të Republikës (1992–1997), punonjës shkencor në Institutin e Gjuhësisë e të Letërsisë (1997–2005), këshilltar në ambasadën e Shqipërisë në Romë (2006), koordinator shkencor në Qendrën e Studimeve Albanologjike (2007-2014).

Ndërkohë një kontribut tepër të vyer ka dhënë edhe për Universitetin e Shkodrës, qoftë si lektor i gjuhësisë historike, qoftë si pjesëmarrës në shumë aktivitete shkencore, qoftë edhe si mik, koleg e dashamirës i institucionit tonë.

Autor i 15 veprave madhore me vlera të padiskutueshme shkencore (mes të cilave vepra e fundit me vlera të veçanta “*Fjalori etimologjik i gjuhës shqipe*”), pjesëmarrës me kumtesa e referate në mbi 170 kongrese e

konferenca shkencore kombëtare e ndërkombëtare, hartues i mbi 200 studimeve e artikujve të botuar në revista e përmbledhje prestigjioze shqiptare e të huaja, mbajtës i shumë ligjëratave pasuniversitare në Shqipëri e jashtë saj, prof. Koleci, falë punës së tij vetëmohuese u bë personalitet i shquar i shkencës gjuhësore shqiptare, mjaft i njohur brenda e jashtë vendit. Duke vlerësuar këtë kontribut shkencor, në vitin 2010, prof. Koleci u zgjodh anëtar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, ndërsa në vitin 2012, u pranua anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës.

Akademiku Kolec Topalli qe shkencëtar me tërë kuptimin e fjalës; korrekt e dashamirës me të gjithë, shembull i një qytetari të nderuar të Shkodrës.

Me vdekjen e tij bota shkencore humbi një dijetar me përvojë dhe një njeri të suksesit shkencor, Universiteti i Shkodrës humbi mikun dhe bashkëpunëtorin e vyer, ndërsa familja dhe të afërmit njeriun e tyre të dashur.

JETA SHKENCORE

KONFERENCË SHKENCORE NDËRKOMBËTARE “MUSINE, MUZA IME”

Më 14 nëntor 2017, në ambientet e Bibliotekës së Universitetit të Shkodrës, Fakulteti i Shkencave Shoqërore, Instituti i Studimeve Albanologjike dhe Shoqata Muzeu “Musine Kokalari”, me mbështetjen e Fondacionit “Friedrich Ebert Stiftung”, organizuan veprimtarinë ndërkombëtare shkencore “Musine, muza ime”, kushtuar personalitetit shumëdimensional të Musine Kokalarit.

Në këtë aktivitet shkencor morën pjesë me kontributin e tyre shkencor studiues nga vendi dhe të huaj.

Fjalën përshëndetëse e mbajti rektori i Universitetit të Shkodrës, prof. dr. Adem Bekteshi, i cili pasi vlerësoi aktivitetin shkencor, duke konsideruar si vijim shumë të rëndësishëm të punës kërkimore shkencore që zhvillon ky universitet, theksoi domosdoshmërinë dhe rëndësinë e madhe të ridimensionimit të figurave të shquara të letrave shqipe, siç është rasti i Musine Kokalarit.

Në fjalën e saj përshëndetëse, Kryetarja e Bashkisë Shkodër, znj. Voltana Ademi ritheksoi domosdoshmërinë e forcimit të bashkëpunimit ndërmjet USH-së dhe pushtetit vendor në të gjitha drejtimet. Ajo e vlerësoi figurën e Musine Kokalarit, duke theksuar se figura të tilla meritojnë një vend nderi në panteonin e letrave shqipe.

Gjithashtu tubimin e përshëndeti edhe përfaqësuesja e Fondacionit “Friedrich Ebert Stiftung”, e cila në fjalën e saj shprehu falënderimet e saj për kontributin shkencor të kumtuesve dhe për punën e tyre në vlerësimin e një figure jo shumë të studiuar, siç është rasti i Kokalarit. Pjesëmarrja në këtë veprimtari ishte e larmishme, me pedagogë e studentë të degës gjuhë shqipe-letërsi, gazetari, studiues të ndryshëm dhe qytetarë të Shkodrës, të cilën ndoqën me interes kumtimet.

Konferenca i zhvilloi punimet në dy seanca.

Në seancën e parë kumtuam:

Prof. dr. Hamit Xhaferi (Universiteti i Evropës Juglindore - Tetovë): *Musine Kokalari, një zë i disidentit dhe i fjalës së shpirtit në kulturën e letrave shqiptare;*

Prof. dr. Alfred Çapaliku (Universiteti i Shkodrës): *Bota femërore e*

Kokalarit tek “Siç më thoshte nënua plakë”;

Dr. Anisa Kosteri (Universiteti i Shkodrës): *Tipare të toskërishtes jugore në veprën e Musine Kokalarit;*

Prof. as. dr. Arben Prendi (Universiteti i Shkodrës): *Ceremoniali i dasmës në veprën “sa u tunt jeta”. Ndërthurja e rrëfimit artistik me të dhënat faktike të traditës zakonore;*

Prof. dr. Mimoza Kore (Universiteti i Tiranës): *Vepra e Musine Kokalarit, mbështetje për studimet etnolinguistike mbi rajonin tosk.*

Në seancën e dytë u mbajtën këto kumtesa:

Prof. as. dr. Rrezarta Draçini (Universiteti i Shkodrës): *Varianti dhe invarianti i Musine Kokalarit;*

Prof. Meliza Krasniqi (Instituti Albanologjik i Prishtinës): *Krahasimi i Migjenit me Musine Kokalarin në poezi dhe në jetë;*

Prof. dr. Mimoza Priku & Prof. dr. Artan Haxhi (Universiteti i Shkodrës): *Intelektualja Musine Kokalari dhe vepra e saj në vëmendjen e albanologut Carlo Tagliavini;*

Mr.sc. Bedri Zyberaj (studiuës nga Kosova): *Një jetë e penguar, një përjetësi e fituar;*

Alina Wagner (Fondacioni “Friedrich Ebert Stiftung”): *Musine Kokalari dhe socialdemokracia në Shqipëri;*

Doktorant Eduard Grishaj (Muzeu Historik -Shkodër): *Konteksti historiko-letrar i shfaqjes së Musine Kokalarit në letërsinë shqipe;*

Ndue Dedaj (studiuës): *Musineja dhe Mirdita – Komunikimi përmes kodit të heshtjes;*

Paolo Muner (studiuës nga Italia): *Aventura e gjatë italiane e Musine Kokalarit.*

Në fund të aktivitetit organizatorët falënderuan auditorin dhe studiuësit që kontribuan në lartësimin e kësaj figure jo fort të njohur dhe të lëvruar, duke kërkuar që studimet kushtuar kësaj figure të thellohen në të ardhmen.

KONFERENCË SHKENCORE
“PROF. DR. KOLË ASHTA DHE STUDIMET
ALBANOLOGJIKE NDËR VITE”

Në kuadrin e veprimtarive kushtuar 550 - vjetorit të vdekjes së heroit tonë kombëtar, Skënderbeut dhe 100 - vjetorit të lindjes së dijetarit Kolë Ashta, Fakulteti i Shkencave Shoqërore dhe Instituti i Studimeve

Albanologjike të Universitetit tonë, me mbështetjen e Konsullatës Austriake të Nderit në Shkodër, më 29 qershor 2018, organizoi konferencën shkencore “*Prof. dr. Kolë Ashta dhe studimet albanologjike ndër vite*”. Kjo konferencë u organizua në kuadrin e 100-vjetorit të lindjes së profesorit të nderuar dhe në përfundim të projektit të botimit të monografisë “*Leksiku historik i gjuhës shqipe*”, një vepër prej shtatë vëllimesh, me mbi 7000 faqe në dorëshkrim dhe mbi 3000 faqe në shtyp, fakt që e solli përmes kumtesës së tij prof. dr. Tomor Osmani, i cili i kushtoi vite të tëra pune, në bashkëpunim me anëtarë të tjerë të Institutit. Është nder për institucionin tonë që pas kaq vitesh pune të palodhur projekti përfundoi me sukses dhe studimi i prof. Kolë Ashtës pa dritën e botimit. Janë plot 23 vite punë e përkushtim të një grupi gjuhëtarësh që dhanë kontributin e tyre të pakursyer. Në këtë aktivitet morën pjesë studiues nga Shkodra, Tirana, Prishtina, Graci (Austri), si dhe pedagogë e familjarë të prof. dr. Kolë Ashtës. Konferenca ngjalli interes në rrethet akademike dhe pati jehonë në shtypin periodik.

Aktivitetin e përshendetën dhe falënderuan përmes fjalës së tyre kryetarja e Bashkisë Shkodër, znj. Voltana Ademi dhe rektori i Universitetit të Shkodrës, prof. dr. Adem Bekteshi.

Punimet e konferencës u hapën me kumtesën e prof. dr. Artan Haxhi & prof. dr. Mimoza Priku - “*Kolë Ashta dhe personaliteti i tij në gjuhësinë shqiptare*”, për të vijuar pastaj me kumtesën e prof. dr. Tomor Osmanit - “*Leksiku historik i gjuhës shqipe nga prof. Kolë Ashta - një kontribut me vlerë të veçantë për leksikografinë shqiptare (Rreth botimit të kësaj monografie)*”, prof. dr. Valter Memishajt - “*Dosja Kolë Ashta në Arkivin e Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë*”, prof. dr. Imri Badallajt - *Kuantiteti vokalik në vëllimet Leksiku historik i gjuhës shqipe të Kolë Ashtës (Meshari i Buzukut)*, dr. Nikë Ukgjinit - *Interpretimi i Kolë Ashtës për Kuvendin e Arbrit, (1703) - koha dhe hapësira e tij*.

Konferenca i vijoi punimet në tri seksione paralele :

Në seksionin e parë, të drejtuar nga: Rrezarta Draçini, Begzad Baliu, Artur Lame, Idriz Metani, kumtuan: Begzad Baliu - *Kërkimet gjuhësore të Kolë Ashtës dhe vendi i tij në albanologjinë e shekullit XX*; Rrezarta Draçini - *Trajtime sintaksore të veprave të autorëve të vjetër nga Kolë Ashta*; Artur Lame - *Elemente socio-kulturore në disa burime leksikografike të Kolë Ashtës*; Idriz Metani - *Shtresa leksikore në fjalorin e Bardhit sipas studimit të prof. Kolë Ashtës*; Elvada Paci - *Kolë Ashta, gjurmues inovator i teksteve të vjetra shqipe*; Erzen Koperaj - *Kolë Ashta mbi shqipen e shkruar me*

alfabet grek (vëllimi VII); Elvis Bramo - Vështrim mbi greqizmat në veprën e P.Budit; Anisa Kosteri - Pasqyrimi i leksikut të Budit dhe Bardhit në monografinë e Kolë Ashtës (vëllimmi II, III); Rezearta Murati - Mes polisemisë dhe homonimisë në leksikun e autorëve të vjetër.

Në seksionin e dytë, të drejtuar nga Tefë Topalli, Xhilda Prendushi, Anila Kananaj, Juliana Kume, u mbajtën këto kumtesa: Xhilda Prendushi (Alimhilli) – *Arritje në fushën e aspektologjisë*; Anila Kananaj - *Ndryshime semantiko-sintaksore në folje të shqipes*; Artan Haxhi & Tefë Topalli – *Disa veçori gjuhësore në krijimtarinë e poetit dhe përkthyesit Kolë Thaçi*; Juliana Kume - *Elementi grek në të folmen arbreshe*; Bora Logu - *R. Ritter von Xylander dhe vepra e tij, gjuha e albanezëve ose e shqiptarëve (1835)*; Aida Uruçi - *Leksiku i autorëve të vjetër në krijimtarinë e M. Camajt (Leksiku i K. Ashtës)*; Zamira Shkreli - *Përvoja e shqiptarëve të Malit të Zi pëmes një libri didaktik dygjuhësh (shqip- gjuhë malazeze)*

Në seksionin e tretë, të drejtuar nga Alfred Çapaliku, Vjollca Osja dhe Sereta Koperaj, u kumtuara: Alfred Çapaliku - *Ashta letrar (Përkthyesi, poeti, kritiku)*; Kurt Gostentschnigg - *Esenca e marrëdhënieve austro-hungaro-shqiptare*; Vjollca Osja - *Kontributi i K. Ashtës në studimin e letërsisë së gjysmës së parë të shek. XX*; Gëzim Puka - *Kolë Ashta si kritik letrar*; Sereta Koperaj - *Nga Budi te Bogdani, dëshmitarët e qëndresës antiosmane të shek. XVI*; Lisandri Kola - *Mbi sprovat kritike letrare të Kolë Ashtës*; Ermira Alija - *Shpirti shqiptar në studimet letrare të Kolë Ashtës, referuar revistës “Shkëndija” (1940 - 1943)*; Isida Hoxha – *Diskursi mediatik në shtypin e shkruar të viteve 2009 – 2013.*

Pas përfundimit të kumtimeve në çdo seksion u bënë pyetje dhe pati diskutime lidhur me temat e kumtuara. Punimet e konferencës i përshëndeti edhe studiuesi prof. dr. Bardhyl Demiraj, i cili vlerësoi figurën e prof. K. Ashtës, si dhe punimet e konferencës.

LIGJËRATA NGA ALBANOLOGIA KINEZE KE JING

Pas disa ligjëratave të mbajtura në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, në Universitetin e Prishtinës dhe në qendra të tjera albanologjike, ditën e hënë, datë 20.01.2018, në ambientet e Fakultetit të Shkencave Shoqërore të Universitetit të Shkodrës, përfaqësuesja e Universitetit të Gjuhëve të Huaja të Pekinit (Beijing Foreign Studies University), albanologia Ke Jing përzgjodhi Universitetin tonë për të mbajtur një leksion të hapur me studentë dhe pedagogë të degës Gjuhë

shqipe - Letërsi me temë “*Disa zhvillime të albanologjisë në Kinë - arritje dhe perspektiva*”.



Prof. dr. Ke Jing është lektore e gjuhës shqipe dhe zëvendësdekane e Fakultetit të Gjuhëve dhe Kulturave të Evropës në Universitetin e Gjuhëve të Huaja të Pekinit. Ajo ka mbaruar studimet universitare në degën Gjuhë shqipe - Letërsi në Universitetin e Prishtinës (Kosovë) gjatë viteve 1985- 1989 dhe është doktoruar për

shkenca humane në Universitetin e Louisville-it (SHBA), ku ka mbrojtur disertacionin me temë “*The Four 'Others' in I. Kadarës Works - A Study of the Albanian National Identity*” (Katër “Të tjerët” në veprat e I. Kadesë – një studim mbi identitetin kombëtar shqiptar). Ajo është hartuese fjalorësh dhe teksteve mësimore për mësimin e gjuhës shqipe, si dhe autore e mjaft artikujve shkencorë.



Me një shqipe të kulluar prof. dr. Ke Jing bëri një panoramë të arritjeve të albanologjisë në Universitetin e Pekinit dhe në Kinë, në përgjithësi. Albanologia kineze i njohu të pranishmit me punën e bërë ndër vite nga ajo dhe të gjithë kolegët e saj jo vetëm për themelimin e degës së shqipes, por

edhe përpjekjet për ta mbajtur të gjallë e thelluar këtë traditë. Falë këtij përkushtimi, theksoi ajo, sot në Universitetin e Gjuhëve të Huaja të Pekinit (Beijing Foreign Studies University) shqipja mësohet në tri nivele: *bachelor*, *master* dhe *doktoraturë*. Në fjalën e saj profesoresha Ke Jing argumentoi se interesi i studentëve kinezë për shqipen po njej rritje këto vitet e fundit. Gjithashtu ajo prezantoi edhe thelbin e tezës së saj të doktoraturës mbi veprën e shkrimtarit shqiptar Ismail Kadare.

Leksioni zgjoi interesin e profesorëve dhe të studentëve dhe u përmyll me pyetje e diskutime.

PROMOVIM I LIBRIT

“SHKENCA NË FUSHËN TENSIONUESE TË POLITIKËS DHE USHTRISË. ALBANOLOGJIA AUSTRO-HUNGAREZE 1867-1918”

Më 31 janar 2018 u promovua në mjesidet e Bibliotekës së Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi” monografia e prof.dr. Kurt Gostentschnigg: *Wissenschaft im Spannungsfeld von Politik und Militär. Die österreichisch-ungarische Albanologie 1867-1918*, Wiesbaden: Springer VS 2018. (828 f.) (Shkenca në fushën tensionuese të politikës dhe ushtrisë. Albanologjia austro-hungareze 1867-1918), një bashkëpunim në mes të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja dhe Ambasadës Austriake në Tiranë, me të cilin u çel sipari i veprimtarive për vitin kulturor Austri – Shqipëri.

Veprimtaria u moderua nga vetë autori i monografisë, Mag. Dr. phil. Kurt Gostentschnigg, historian, albanolog, gjermanist, përkthyes dygjuhësh, gjermanisht dhe shqip, shkrimtar e poet, ish-lektor me kohë të plotë pranë Departamentit të gjuhës gjermane në FGJH, çfarë e lejoj atë të ndjehej në shtëpi.

Sipas autorit, monografia ofron për herë të parë një paraqitje përmbledhëse të të gjitha marrëdhënieve austro-hungaro-shqiptare në shkencë, politikë, ekonomi, ushtri dhe kulturë si dhe një përpjekje të rikonstruksionit të fushave “shkencë/albanologji”, “politikë”, “ushtri” dhe “austrofile” sipas teorisë së fushës të Pierre Bourdieu-s. Ky studim i përgjigjet pyetjes së lidhjes së shkencës, politikës dhe ushtrisë në këto marrëdhënie bilaterale duke zbatuar teorinë e imperializmit kulturor të Johan Galtung-ut, emërton aktorët individualë dhe kolektivë të fushave të lartpërmendura, tematizon perspektivat e tyre, tipizon aktorët individualë si dhe përmban një tematizim të ndërveprimit të fushave dhe një rikonstruksion të ashtuquajturës “*fushë të pushtetit*”. Kapitujt kryesorë të kësaj monografie përqendrohen në kërkime sipas fushave shkencore, politike, ushtarake, austrofile dhe ndërveprimit mes tyre.

Pas një pune kërkimore të përmasave kolosale, përmes një analize të thukët autori arrin në përfundimin se “*Fusha e pushtetit*” mund të konsiderohet motor për imperializmin kulturor me anë të dhunës strukturore dhe kulturore.

Punimi, përveç vlerave shkencore, arkivore dhe historike, sjell ngacmime dhe pista studimore për studentë, pedagogë dhe studiues të

disiplinave histori, shkenca politike, diplomaci, gjuhësi, albanologji, etnografi, gjeografi dhe arkeologji, për të punësuar në shërbimin diplomatik.

PROMOVIM LIBRI “FJALOR ETIMOLOGJIK I GJUHËS SHQIPE”

Fakulteti i Shkencave Shoqërore dhe Instituti i Studimeve Albanologjike, në kuadrin e Vitit Mbarëkombëtar të Skënderbeut, organizuan në ambientet e Bibliotekës Shkencore të Universitetit, më datë 4 maj 2018, promovimin e veprës së akademikut Kolec Topalli “*Fjalori etimologjik i gjuhës shqipe*”. Veprimtaria bashkoi një numër studiuesish nga Universiteti i Shkodrës dhe Akademia e Studimeve Albanologjike - Tiranë, të cilët vlerësuan punën e palodhur të prof. Kolec Topallit në fushë të studimeve gjuhësore në përgjithësi, e të atyre në fushë të etimologjisë, në veçanti. Në këtë veprimtari morën pjesë drejtues të Universiteti të Shkodrës, drejtues të pushtetit vendor, studiues të disiplinave albanologjike dhe studentë.

Fjalën e hapjes e mbajti dekania e Fakultetit të Shkencave Shoqërore, e cila vlerësoi veprën e përmasave të pazakonta të profesorit të nderuar, duke e falënderuar për kontributin e vyer që ai i solli shkencës shqiptare, por jo vetëm. Ajo theksoi se vepra e prof. Kolecit ditët e fundit është vlerësuar me çmimin më të lartë “*Çabej*”.

Aktivitetin e përshëndeti rektori i Universitetit të Shkodrës, prof. dr. Adem Bekteshi, i cili falënderoi pjesëmarrësit dhe e quajti nder për Universitetin dhe Shkodrën, që po promovon një vepër të tillë madhore dhuruar nga studiuesi shkodran, i cili përherë ka qenë pranë Universitetit tonë.

Më pas e mori fjalën prof.dr. Artan Haxhi, për të referuar materialin e përgatitur në bashkëpunim me prof.dr.Mimoza Priku, ku u lartësua figura e profesorit të nderuar si një ndër personalitetet e shquara të shkencës gjuhësore shqiptare dhe, në veçanti, puna më e fundit e tij, “*Fjalori etimologjik i gjuhës shqipe*”, të cilin ata e konsideruan si një nga veprat themelore në lëmë të albanologjisë. Autorët e kumtesës theksuan se përmes kësaj vepre madhore prof. Kolec Topalli ka arritur të na japë në dorë një fjalor, i cili përfshin në vetvete pjesën më të madhe të pasurisë leksikore të shqipes. Ata theksuan se korpusi i plotë i studimeve historike të prof. Topallit dhe, në veçanti, fjalori i tij etimologjik, shërbejnë si një mbështetje e sigurt dhe tepër e rëndësishme për gjuhësinë ballkanike, por edhe atë indoevropiane, në përgjithësi.

Në kumtesën e tij, drejtori i Akademisë së Studimeve Albanologjike – Tiranë, prof. dr. Valter Memishaj, kishte përzgjedhur fjalët e duhura për të përshkruar figurën shumëdimensionale të prof. Kolecit, duke e quajtur *shkencëtari fisnik* (fisnik në shpirt, fisnik në qytetari e fisnik në shkencë). Më pas ai i bëri një analizë të hollësishme veprës së prof. Kolecit, duke theksuar se kemi të bëjmë me një vepër madhore me karakter informativ e sintetizues, me lëndë të përzgjedhur shkencërisht, të argumentuar e të mbështetur në të dhënat e gjuhës shqipe e të shumë gjuhëve të tjera, e cila vjen sot para nesh si një vepër e dinjitetshme, e hartuar nga njëri prej autoriteteve më në zë në studimet gjuhësore shqiptare.

Po ashtu prof. dr. Anila Omari, si kolege e profesorit të nderuar në Akademinë e Studimeve Albanologjike, kishte shumë të fliste rreth kontributit shkencor dhe punës këmbëngulëse të studiuesit, qëi kishte kushtuar një jetë të tërë realizimit të kësaj vepre, për realizimin e së cilës do të duhej të kishte punuar një grup autorësh, por që studiuesi ynë ia ka dalë ta realizojë i vetëm për ta sjellë tek ne. Profesor Koleci, - thotë prof. Omari, është studiuesi që i referohet vazhdimisht autorëve të vjetër edhe me ndihmën e teknologjive të reja informatike, duke gjetur aty materiale të çmuara, që shërbyen qoftë si shtysë për një interpretim të ri etimologjik, qoftë edhe si konfirmim i ideve të kristalizuara në kohë. Fjalori paraqet gjendjen dhe nivelin e studimeve etimologjike të shqipes në kohën e sotme dhe u ofron një bazë të qëndrueshme shkencore brezave të ardhshëm të gjuhëtarëve që do t'i çojnë më tej këto studime.

Këtij aktiviteti nuk i munguan as fjalët dhe komplimentet e bashkëpunëtorit dhe bashkëkohësit të profesorit të nderuar prof.dr.Tomor Osmani, i cili në bashkëpunim me prof. as. dr. Rrezarta Draçini, kishte përgatitur një material ku nuk kurseheshin fjalët më të përzgjedhura për punën dhe kontributin e pakundshoq të autorit të veprës.

Në fund të këtij aktiviteti e mori fjalën dr. Erzen Koperaj, i cili e falënderoi dhe e vlerësoi profesorin për të gjithë kontributin e tij në lëmë të historisë së gjuhës dhe të etimologjisë. Në veçanti ai u ndal në disa etimologji të reja, të cilat shpjegoheshin për herë të parë nga prof. Topalli. Në përfundim të aktivitetit e mori fjalën vajza e profesorit, Joana Topalli, e cila pasi falënderoi të pranishmit dhe organizuesit e këtij tubimi shkencor, përcolli edhe fjalët e profesor Kolecit, duke thënë: “*Uroj që ky fjalor të zërë vendin e duhur në studimet etimologjike, duke i hapur rrugën hulumtimeve të mëtejshme në këtë fushë*”.

VEPRIMTARI PROMOVUESE TË DEPARTAMENTIT TË LETËRSISË

Departamenti i Letërsisë i Fakultetit të Shkencave Shoqërore pranë Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, në kuadër të 60-vjetorit të krijimit të USH-së, më 13 dhjetor 2017, organizoi në Bibliotekën Shkencore Universitare një veprimtari promovuese të disa botimeve shkencore të pedagogëve të këtij departamenti.

Në këtë aktivitet promovues, titulluar “*Studime letrare 2016-2017*”, u prezantuan librat :

- “*Shqiptarë në liri. Diaspora shqiptare në Amerikë*” – me autore prof. dr. Eleni Karamitri;
- “*Probleme, autorë dhe vepra nga letërsia shqipe bashkëkohore*” –me autor prof. as. dr. Arben Prendi;
- “*Arti poetik*” dhe “*Fjalori i rimave*” –me autor prof. as. dr. Vinçens Marku;
- “*Në kërkim të një drame “ndryshe”*” dhe “*Albanian authors in search of a “peculiar” drama type*” –me autor dr. Gëzim Puka.



Në fjalën e tij përshëndetëse prof.dr.Adem Bekteshi, rektor i Universitetit të Shkodrës, vlerësoi punën shkencore të pedagogëve të departamentit të Letërsisë dhe përgjegjësinë e tyre përmes vëzhgimit dhe oponencës që i bëjnë punës akademike në këtë njësi bazë.

Drejtori i departamentit të Letërsisë, prof. as. dr. Vinçens Marku, pasi bëri një paraqitje historike të punës së departamentit, duke evidentuar figurat më të spikatura të profesoratit ndër vite, vlerësoi veprimtarinë

botuese aktuale dhe përkushtimin e kolegëve. Në përfundim të fjalës së tij ai theksoi: “*Kjo është një ditë e shënuar për pedagogët tanë, sepse kurorëzojnë veprimtarinë e tyre kërkimore e studimore letrare gjatë vitit akademik 2016-2017, por kjo ditë është e veçantë edhe për një arsye tjetër, sepse kjo veprimtari po ndodh në vitin e 60 të jetës së Universitetit tonë, pjesë e të cilit është edhe departamenti i Letërsisë, si një njësi themeltare e këtij institucioni të rëndësishëm të arsimit të lartë në Shqipëri*”.

Prof. dr. Alfred Çapaliku diskutoi për studimin më të fundit të prof. dr. Eleni Karamitrit “*Shqiptarë në liri. Diaspora shqiptare në Amerikë*”, duke theksuar se ai përcjell një pikëvështrim interesant mbi letërsinë shqiptare të prodhuar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. “*Letërsia e diasporës është një letërsi e prodhuar në liri jashtë domeneve të politikës dhe modeleve të imponuara estetike*”, theksoi A.Çapaliku.

Prof. as. dr. Arben Prendi diskutoi mbi veprën studimore dhe përkthimore “*Artipoetik*” të teoricienit francez Nicolas Boileau, të studiuar dhe të sjellë në shqip nga prof. as. dr. Vinçens Marku. Ai theksoi se këtu riafirmohet modeli horacian. Shkrimi në vargje, ekuilibri, mjete i saktë, natyrshmëria dhe harmonia dalin në dritë si vlera të mirëkuptimit. Në vijim të këtij diskutimi, prof. as. dr. Arben Prendi, u fokusua edhe tek studimi i dr. Gëzim Pukës, “*Në kërkim të një drame “ndryshe”*”, duke thënë se “*Ky studim mbi dramën shqipe bashkëkohore shquhet për asimilimin e lëndës teoriko-letrare në dobi të analizës dhe interpretimit të tekstit dramatik duke pasur në qendër vlerën estetike të tij. Studimi me gjerësinë e veprave dramatike të bëra objekt analize, me thellësinë e vështrimit të stukturës artistike dhe përmbajtësore, me alternimin e metodave të analizës kritike tradicionale me ato të analizës tekstuale e semiotike, sjell një kontribut të rëndësishëm në studimet tona mbi dramën shqipe bashkëkohore*”.

Dr. Gëzim Puka në kumtesën e tij vlerësoi librin studimor të prof.as.dr. Arben Prendit “*Probleme, autorë dhe vepra nga letërsia shqipe bashkëkohore*”, si një studim i thelluar mbi letërsinë shqipe bashkëkohore, mbi letërsinë romantike e moderne dhe mbi folklorin e letërsinë gojore shqiptare. “*Autori A. Prendi përmes këtij punimi jep një ndihmesë të re në njohjen, analizën dhe interpretimin e veprës letrare të disa autorëve me synimin që të jetë i dobishëm sidomos për studentët dhe mësuesit e letërsisë apo të interesuar të tjerë, që dëshirojnë të kenë një pamje më të qartë për letërsinë shqiptare*”, theksoi G. Puka. Në vijim folësi diskutoi rreth librit tjetër që promovohet “*Fjalori i rimave*” i prof.as.dr.Vinçens Markut, duke e vlerësuar si një mjet të qëlluar pune për poetët, gjuhëtarët, përkthyesit, studentët etj. Rreth veprës “*Probleme, autorë dhe vepra nga letërsia shqipe bashkëkohore*” të prof.as.dr.Arben Prendi, diskutoi Dieleta Përllëshi, studente e ekselencës.

Veprimtaria u mbyll me shfaqjen në ekran të një fragmenti nga komedia “*Rinoceronti*” e Joneskos e vënë në skenë disa muaj më parë nga Universiteti i Shkodrës, në të cilën interpretuan edhe studentë të degës gjuhë shqipe-letërsi.

VEPRIMTARI TË DEPARTAMENTIT TË GJUHËS ANGLEZE

Në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies së Gjuhës Angleze, Departamenti i Gjuhës Angleze në bashkëpunim me Educational Centre Albania më datë 21 janar organizoi një trajnim metodologjik me temë “*Motivating Young Adults*”. Educational Centre Albania operon për më shumë se 20 vjet në Shqipëri distributor ekskluziv për botimet akademike dhe material didaktike përmësimin e gjuhëve të huaja.

Trajnimi u drejtua nga lektorja e huaj Lilika Couri dhe kishte për qëllim trajnimin e mësuesve të Gjuhës Angleze në nivel universitar dhe të studenteve të vitit të dytë të “*Masterit profesional*” në Mësuesit e Gjuhës Angleze. Trajnimi iu referua metodave aktuale që përdoren në universitet dhe përmirësimit të metodologjisë së mësimdhënies së gjuhës angleze në përgjithësi.

Në fund të aktivitetit mësuesit e gjuhës angleze morën certifikata për pjesëmarrje në trajnim.

* * *

Në kuadër të përmbylljes së kursit vjetor të Letërsisë Angleze, për vitin akademik 2017-2018, është zhvilluar një veprimtari shkencore me titull: “*Periudha Viktoriane në lëmin e Letërsisë Angleze*”, me kontributet e 16 studentëve të programit Bachelor gjuhë angleze. Prezantimet shkencore reflektojnë temat, motivet, simbolet letrare dhe problematikën, që pasqyrohen në këtë periudhë letrare, duke u ndalur në rrafshin krahasimtar, për autorët e ndryshëm, apo për specifikat e vëzhguara në autorë të veçantë. Në to janë përfshirë materiale fotografike mjaft interesante që pasqyrojnë realitetin e kohës. Është për t’u vlerësuar zhdërvjelltësia e studentëve gjatë prezantimeve dhe komunikimi me audiencën, për të tërhequr vëmendjen ndaj çdo tematike të përzgjedhur. Aktivitete të tilla tentojnë të kthehen në traditë të përvitshme.

VEPRIMTARI TË DEPARTAMENTIT ROMANISTIKË

Një tryezë e rumbullakët në gjuhën frënge, është organizuar me 19 mars 2018 nga departamenti i Romanistikës i Universitetit “Luigj Gurakuqi” dhe Aleanca Franceze, dega Shkodër.

Pedagogë dhe studentë sollën për një publik frankofon dhe frankofil, por edhe më të gjerë, figurën e Skënderbeut, por të trajtuar në optikën e pikëtakimeve me kulturën franceze dhe kontributit të shkollës franceze në fushën e albanologjisë. Në referimet e ndryshme u analizuan shkrimet më të rëndësishme të autorëve francezë mbi jetën dhe veprën e Skënderbeut, si vepra me karakter historik (“*Historia e Gjergj Kastriotit, i quajtur Skënderbe, Mbret i Shqipërisë*” nga Zhak de Lavardin apo “*Historia e Skënderbeut, ose turqve dhe të krishterëve në shekullin XV*” të Kamil Paganel); artistiko-letrar (opera kushtuar Skënderbeut në Paris në 1735, e cila u luajt rreth 35 herë dhe janë ruajtur disa botime të libretit, partiturat e shtypura, si dhe skicat e disa kostumeve) apo përkthime, duke sjellë edhe fragmente ku flitet për figurën e Skënderbeut dhe bëhen krahasime me personazhe historike (si p.sh. me figurën historike franceze Charl Martel në veprën “*Burrat e shquar*” nga Alexandre Kampion) apo vlerësime të qëndrësës dhe të luftës së shqiptarëve të kryesuar nga Skënderbeu.

Në fushën e letërsisë u sollën në vëmendje krijimet e poetëve dhe të shkrimtarëve të shquar francezë, si Ronsar apo Volter, në të cilat falë penës së tyre, figura e Skënderbeut lartësohet si strateg dhe kapiten i madh, duke i veshur cilësitë e një luftëtari të drejtë e të vendosur për të zhdukur robërinë. Në fund studentët sollën historitë e përjetësimit të figurës së Skënderbeut në portrete, buste apo emërtime rrugësh në Francë apo vende të tjera frankofone, si Belgjikë e Zvicër.

* * *

Me datë 24 prill 2018 në mjediset e Bibliotekës së Universitetit të Shkodrës, Departamenti i Romanistikës organizoi takimin me shkrimtarin dhe përkthyesin Zija Vukaj me titull: “*1 orë me prof.Zijanë*”. Përmes bisedës mes z. Zija Vukaj dhe prof.as. Eliana Laçej, si dhe ndërhyrjeve të prof.as. Alma Hafizi, prof. Alfred Çapaliku dhe dr. Irida Hoti dolën në pah vlerat konceptuale dhe artistike të veprës “*Shtjellë letrare*” të autorit Zija Vukaj.

* * *

Më datë 3 maj 2018 në mjediset e Bibliotekës së Universitetit të Shkodrës, Departamenti i Romanistikës në bashkëpunim me Departamentin e Gjermanistikës organizuan hapjen e workshop-it prej 4 fazash: “*Udhëtim nëpër trashëgimi*”. Në fazën e parë me titull “*Vend ku shkon, bukuri që gjen*”, pedagogët e dy departamenteve A.Hafizi, Dh.Hoxha, K.Darragjati

dhe V. Gjylbegu përmes një udhëtimi ujqor mes bukurive natyrore magjepsëse të vendeve italishtfolëse, frëngjishtfolëse dhe gjermanishtfolëse i dhuruan publikut një panoramë të mbartur me vlera artistike, historike e kulturore të këtyre vendeve.

* * *

Me datë 7 qershor 2018 në mjediset e Bibliotekës së Universitetit të Shkodrës, Departamenti i Romanistikës në bashkëpunim me Departamentin e Gjermanistikës vijoi punimet e workshop-it: “Udhëtim nëpër trashëgimi”. Faza e dytë me titull “Vend ku shkon, personazhe që gjen”, përmes pedagogeve të të dy departamenteve E. Laçej, A. Dani, I. Selmani dhe E. Cermijani njohu publikun e pranishëm me vlerat madhështore të personazheve që bënë artin, kinemanë, muzikën, modën dhe ndikuan në zhvillimin ekonomik, industrial e shoqëror të Italisë dhe të Austrisë.

* * *

Studentët e vitit të parë të departamentit të Romanistikës morën pjesë me punimin e tyre në Ekspozitën Kombëtare “Muri i shprehjeve me 10 fjalët e Frankofonisë 2018” afishuar në Qendrën e zhvillimit për dialog pranë Kryeministrisë, më 28 mars 2018. Gjithashtu, studentët e departamentit të Romanistikës morën pjesë në atelietë e zhvilluara nga dy piktorë francezë dhe autorë të librave vizatimorë mbi teknikat e shkrimit dhe vizatimit të librave vizatimorë, më 30 maj 2018.

MBROJTJE DOKTORATURE

Në vijim të punës së shkollës doktorale dhe në mbështetje të thellimit të punës kërkimore-shkencore, më 13 korrik 2018, pranë Institutit të Studimeve Albanologjike të Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi” organizohen mbrojtjet e doktoraturës :

- Më 01 dhjetor 2017, doktorantja **Karmen Lazri** mbrojti disertacionin me temë: “*Tipat e fjalëformimit në Fjalorin terminologjik të emrave të bimëve dhe kafshëve shqip-latinisht, latinisht - shqip të Xhevat Lloshit*”, me udhëheqës shkencor prof. dr. Artan Haxhi.

- Më 04 dhjetor 2017, doktoranti **Zeki Morina** mbrojti disertacionin me temë: “*Toponimia dhe antroponimia e Gjakovës me rrethinë*”, me udhëheqës shkencor prof. dr. Gjovalin Shkurtaç.
- Më 11 dhjetor 2017, doktorantja **Orjeta Dushi** mbrojti disertacionin me temë: “*Fjalësi në veprën e Zef Pllumit*”, me udhëheqës shkencor prof. dr. Tefë Topalli.
- Më 13 korrik 2018, doktoranti **Aimir Osmani** mbrojti disertacionin me temë: “*Gegërishtja në veprat e Arshi Pipës, Sami Repishtit dhe Filip Ndocajt në rrafshin leksikor, fonetik, fjalëformues dhe morfologjik*”, me udhëheqës shkencor prof. dr. Mimoza Priku.

Paraqitja e punimeve të doktoraturës ishte e kënaqshme, çka u pasqyrua edhe në vlerësimin e jurive përkatëse. Doktorantët u inkurajuan që ta çojnë përpara punën e tyre në rrugën e mundimshme të shkencës albanologjike.

ISSN 2221-6855

*Doli nga shtypi nëntor, 2018 – tirazhi 120 kopje –Formati 176 x 250 mm.
Shtypur në shtypshkronjën e Universitetit të Shkodrës
“Luigj Gurakuqi”*